



Universiteti i Tiranës
Fakulteti i Drejtësisë, Departamenti i tëDrejtës Penale

VEPRAT PENALE NË FUSHËN E DOGANAVE

(Temë Disertacioni)

Udhëheqës:
Prof. Dr. Vasilika HYSI

Përgatiti:
Dr. Alket HYSENI

ABSTRAKT

Ky punim i kushtohet studimit të veprave penale të kontrabandës, analizës së elementeve të kësaj vepre, mekanizmave të ndjekjes dhe sanksioneve të veprave në të drejtën doganore, në mënyrë që të dallojmë veçoritë e tyre dhe të kuptojmë perspektivat që ato mbartin. Ajo çka duhet të theksohet është se, a duhet të qëndrojnë dispozitat e veprave penale në fushën doganore të izoluara në brendësi të Kodit Penal dhe procedurës penale, apo duhet të përfshihen në Kodin Doganor.

Krimet në fushën doganore dallohen nga një sërë tiparesh të veçanta juridiko-penale, si dhe prej specifikës që kanë këto vepra, të cilat çdo ditë e më shumë kërcënojnë jo vetëm interesat financiare të vendit, si pjesë e Buxhetit të Shtetit, por cenojnë gjithashtu sigurinë kombëtare dhe mbrojtjen e jetës së njerëzve, të kafshëve, të ekosistemit, si dhe të pasurive me vlera arkeologjike, shpirtërore dhe artistike, ashtusikundërtë vështirësive për t'i kuptuar, për shkak të mënyrave të sofistikuara të mashtrimit dhe kontrabandimit që përdoren për t'i kryer ato.

Është e nevojshme qartësimi dhe kuptimi i veprave penale të kontrabandës, përforcimi i misionit dhe kompetencave të shërbimit doganor për kërkimin dhe zbulimin e veprave doganore, po ashtu edhe për ushtrimin e ndjekjes penale dhe sanksionimin e tyre.

E Drejta Penale Doganore, në tërësi, dhe dispozitat e krimit në fushën doganore, në veçanti, kanë evoluuar drejt ravijëzimit të dallimeve, që kanë me veprat penale në fushat e tjera, por edhe me karakterin e tyre në lidhje të ngushtë me çështjet fiskale. E Drejta Penale Doganore është origjinale në kompetencat e konstatimit, e veçantë në mekanizmat e ndjekjes penale dhe specifike në sanksionet e saj.

Krimet në fushën doganore po bëhen çdo ditë e më shumë gjyqësore, madje po konstitucionalizohen ndjeshëm, qoftë në juridiksionin evropian, qoftë në atë kombëtar. Prerogativat e veçanta që ka pasur dogana po evoluojnë, megjithatë ato janë konsekuente në fushat ku historia ka bërë të vetën.

Organi i akuzës, gjykatat, autoritetet doganore, por edhe studiuesit e kësaj fushe duhet t'i mbajnë parasysh këto evoluime të kohës, me qëllim që të zhvillojnë me sukses teorinë dhe praktikën e luftës kundër krimit në fushën doganore.

Fjalët kyç: kontrabanda, dogana, kodi doganor, vepër penale, kundërvajtje doganore, importi, eksporti, mallra, procedurë doganore, deklarim.

ABSTRACT

This work is dedicated to the survey of penal actions of smuggling, the analysis of these actions, the mechanisms of the survey and the sanctions over the customs law rights, in order for us to define their specialties and to understand the perspectives those are carrying on.. The question set is:

“What will happen with the provisions of the penal offences in the Customs Area. Do will those stay only within and isolated in the Penal Code and the Penal Procedure, or those can be included within the Customs Code.

Crimes in the Customs Service are defined by a number of several judicial-penal features, as well as from some specifics those crimes contain, which every day and more threaten not only the financial interests of the country as a part of the State Budget, bridge the national security and the protection of humans lives, animals, ecosystems and archeological, spiritual and artistic resources. Those offences contain difficulties to capture, because of the sophisticated manners of fraud and smuggling used for those.

It is clearly needed the clarification and the basic concept of the penal act of smuggling, the enforcement of the mission and the competence of the Customs Service over the research and the uncover of those fraud actions, as well as for the penalties and legal acts against them.

The Penal Law in Total and especially the provisions of crime in the Customs Field have evaluated toward the alignment between the differences those have with the penal acts in other areas, but even for their close characteristics in the fiscal area. The Customs Service Penal Right is original in its findings, special in the penal suit mechanism and specific in its sanctions.

The crimes in the Customs Service Field are becoming more and more judicial and are becoming constitutional sensitively in the European Legal System as well as in the International Courts. The Cases of the Customs are going forward and are progressing, although those remain stable were the History has played its role.

The Prosecutor, The Judicial Authorities but even the researchers of this field must keep in mind those progresses of our times in order to successfully develop the theory and the practice of the crime in Customs Areas.

Key Words: smuggling, customs, customs code, penal act, customs contravention, import, export, goods, customs regimes (procedure), customs declaration(SAD)..

PËRMBAJTJA**Në vend të hyrjes****PJESA I****Kreu I**

Vështrim historik i kontrabandës dhe legjislacionit penal për luftën kundër tij.....	21
1. Dogana, kuptimi, misioni dhe legjislacioni në luftën kundër kontrabandës.....	21
1.1. Vështrim historik	21
2. Legjislacioni i luftës kundër kontrabandës në vendin tonë.....	34
2.1. Legjislacioni i luftës kundër kontrabandës gjatë periudhës së pushtimit të Shqipërisë nga fuqitë e huaja më 1916.	34
2.2. Kodi Doganor i vitit 1938.....	37
2.3. Legjislacioni doganor dhe penal në vitet 1944 -1992.....	37
2.4. Kodi Doganor i vitit 1992.....	41
3. Misioni i shërbimit doganor dhe sfidat e shekullit XXI në luftën kundër kontrabandës.	42

Kreu II

Shkelja doganore në kontrabandë	53
1. Kontrabanda, kuptimi në Kodin Doganor dhe në vendet komunitare	53
1.1 Kontrabanda në Shqipëri e në rajon, si dhe ndikimi në ekonomi.	57
2. Llojet e kontrabandës.....	61
2.1. Metodat e kontrabandës.	63
3. Lufta kundër kontrabandës.	64

PJESA II**Kreu I**

Analiza e veprës penale të kontrabandës	67
1. Disa aspekte të përgjithshme të së drejtës penale doganore	68
1.1 Kuptimi i të drejtës penale doganore	69
1.2 Probleme teorike praktike lidhur me figurën e veprës penale të kontrabandës. .	70
2. Elementet e veprës penale të kontrabandës.	77
2.1. Objekti i përgjithshëm.....	78

2.1.1	Struktura grupore dhe objekti i krimit të kontrabandës	79
2.1.2	Objekt i drejtpërdrejt.....	81
2.2	Ana objektive	84
2.2.1	Fshehtësia dhe mashtrimi.....	92
2.2.2	Përgatitja, tentativa dhe përfundimi i krimit të kontrabandës.....	94
2.2.3	Shmangia nga detyrimet doganore.....	102
2.2.4	Mënyra e kryerjes së kontrabandës.....	105
2.2.5	Vendi për kryerjen e kontrabandës.	109
2.3.	Ana subjektive.	111
2.3.1.	Përgjegjësia, paramendimi dhe pakujdesia	111
2.3.2.	Motivi dhe qëllimi	112
2.3.3	Faji.	116
2.3.4.	Përjashtimi nga faji dhe arsytet justifikuese.	120
2.4	Subjekti i shkeljes doganore.	122
2.4.1.	Subjekti i posaçëm.	125
3.	Konkurrimi.....	127
4.	Rrezikshmëria shoqërore e krimit të kontrabandës.....	129

Kreu II

Sanksionet në veprat penale të kontrabandës	132
1. Natyra dhe regjimi juridik i gjobës doganore.	134
2. Baza e përlllogaritjes së gjobës doganore.	135
3. Dënimi plotësues.....	137
3.1 Natyra e konfiskimit doganor.	137
3.2. Efektet e konfiskimit doganor.....	141

PJESA III

Kreu I

Procedimi nga autoriteti doganor dhe prokuroria lidhur me veprat penale të kontrabandës.....	141
1. Kërkimi/Zbulimi dhe konstatimi i veprës penale në fushën doganore.	142
1.1 Kompetencat.	143

2. Kontrolli për konstatimin e shkeljes doganore.	147
2.1 Kontrolli i mallrave të deklaruar për zhdoganim dhe pas zhdoganimit.	149
2.1.1. Objekti i kontrollit të përgjithshëm.	150
2.1.2. Kontrolli i mjeteve të transportit.	152
2.1.3. Kontrolli i mallrave.	154
3. Sekuestrimi i mallrave në procesin e kontrollit dhe hetimit të çështjeve doganore.	157
4. Kompetencat e autoritetit doganor për hetimin në ambientet private.	158
5. Kontrolli i personave.	161
5.1. Kufizimet e specifikuar nga jurisprudenca.	162
5.2. Masat e sigurisë ndaj personave.	164
5.2.1. E drejta e ndalimit dhe arrestit.	164
5.2.2. Masat e tjera doganore të privimit të lirisë.	165
6. Procesverbali i akteve të hetimit dhe i veprave penale doganore.	166
6.1. Llojet e ndryshme të procesverbaleve doganore.	167
6.1.1. Procesverbali i konstatimit.	167
7. Vlerësimi mbi respektin e kontradiktoritetit në gjetjen e provave doganore.	170
8. Vlerësimi mbi rregullsinë e akteve të procedurës doganore.	171
8.1. Pavlefshmëria e akteve të procedurës doganore.	171
9. Ushtrimi i procedimit penal në të drejtën penale doganore.	173
9.1. Oficerët e Policisë Gjyqësore.	173
9.1.1. Kushtet e ushtrimit të misionit të policisë gjyqësore nga punonjësit doganor.	173
9.1.2. Kompetenca të deleguara.	175
9.2. Ushtrimi i procedimit në të drejtën penale doganore.	175
9.2.1. Kushtet e ushtrimit të ndjekjes penale në të drejtën penale doganore.	175
9.3. Palët e procedimit penal në të drejtën penale doganore.	177
9.4. Koekzistenca dhe pavarësia e ndjekjeve fiskale dhe penale.	177
9.5. Transaksioni doganor.	180
9.5.1. Zgjidhje administrative e kontrabandës.	180
9.6. Ushtrimi i rekurseve në të drejtën penale doganore.	182
9.7. Pengesat për ushtrimin e ndjekjes (penale ose fiskale) në të drejtën penale doganore.	184
9.7.1. Parashkrimi i ndjekjes së ushtruar për ndëshkimin e veprave doganore.	184

Kreu II

Llojet e krimeve në fushën doganore.....	187
1. Disa probleme lidhur me klasifikimin e kontrabandës si kalim në/dhe nga kufiri shtetëror dhe krimet e kontrabandës që shmangen nga pagesat doganore.....	187
1.1. Ndryshimet midis kontrabandës nëpërmjet kalimit, zhvendosjes së mallrave në/dhe nga kufiri shtetëror nga kontrabanda nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore.....	190
2. Figurat e veçanta të krimit doganor	194
2.1 Kontrabandë me mallra të ndaluara.	194
2.1.1 Objekti i drejtëpërdrejtë.	197
2.1.2 Ana objektive.	199
2.1.3 Ana subjektive.	200
2.2. Kontrabanda me mallra të licencuara.	199
2.3. Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë.....	201
2.4. Kontrabanda e vlerave kulturore.....	203
2.5. Kontrabanda e mallrave duke përfshirë edhe ato që paguajnë akcizë.	205
2.6. Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore.....	208
2.7. Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm.	211
2.7.1 Objekti i krimit të kontrabandës.....	214
2.7.2 Ana objektive.	216
2.7.3 Subjekti i veprë penale.....	217
2.8. Tregtimi, tjetërsimi ose transportimi i mallrave që janë kontrabandë dhe ndihma që u jepet personave që merren me këtë veprimtari... ..	229

Kreu III

Analiza kriminologjike e veprave penalenë fushën e doganave 2003-2013 dhe politika penale	231
--	------------

PËRFUNDIME	241
-------------------------	------------

BIBLIOGRAFI.....	251
-------------------------	------------

I. Në vend të hyrjes

Kalimi në marrëdhëniet e vërteta të ekonomisë së tregut, si dhe përballimi i sfidave të Globalizmit dhe të rregullave të Tregut të Përbashkët të BE-së, nuk mund të kuptohen dhe të orientohen drejt, për të shërbyer si bazë e zhvillimit social dhe mirëqenies së vendit, nëse nuk funksionon si duhet veprimtaria ekonomike e importimit, e eksportimit, e tranzitimit, si dhe ajo e vendosjes së mallrave në regjimet doganore. Kuptimi i rëndësisë së veçantë të kësaj veprimtarie konsiston në faktin, që ky aktivitet jep një kontribut të madh në rritjen e të ardhurave në Buxhetin e Shtetit, në pajisjen teknike dhe në modernizimin e të gjitha degëve dhe sektorëve të ekonomisë, ashtu sikurse në krijimin e një baze materiale të fuqishme për shoqërinë, por edhe për mbrojtjen e saj, si përfundim rezultati dobiprurës i këtij aktiviteti mundëson plotësimin gjithnjë e më efikas të kërkesave dhe nevojave jetësore të qytetarëve të vendit.

Përveç kësaj, në ekonominë e tregut, veprimtaria ekonomike me jashtë, e realizuar nëpërmjet pranisë së drejtpërdrejtë e të përhershme të rregullave ligjore dhe të përsosjes së vazhdueshme të politikave doganore e atyre penale, janë në tërësinë e tyre burim dhe bazë e rëndësishme për profilaksinë penale, por edhe për kompletimin e dënimeve që realizon shteti.

Është fakt që në Shqipëri, për vetë qenien në këtë tranzicion të gjatë, por edhe për shumë vende të tjera me ekonomi të zhvilluar, veprimtaritë doganore të realizuara nëpërmjet aktiviteteve ekonomike me jashtë, përbëjnë pjesë të rëndësishme në buxhetin shtetëror.¹

Prandaj, një ndër synimet kryesore politike të drejtimit të veprimtarisë ekonomike, ka qenë dhe mbetet detyra e zhvillimit dhe e zgjerimit të mëtejshëm e të gjithanshëm të tregtisë me vendet anëtare të OBT-së, veçanërisht me vendet e BE-së. Po ashtu, përsosja e mekanizmave prodhues dhe e llojeve të tjera të bashkëpunimit me BE-në, sikurse dhe me shtetet e tjera jashtë saj, pa të cilat do të ishte i pamundur realizimi i treguesve ekonomikë të punës prodhuese, furnizimi i plotë e i gjithanshëm i tregut të brendshëm me sendet dhemallrate domosdoshme për plotësimin e nevojave dhe kërkesave të qytetarëve, duke siguruar në këtë rast sasinë dhe cilësinë e duhur për një jetesë normale.

Realizimi praktik i kësaj detyre të rëndësishme, i shoqëruar me kryerjen e transformimeve ekonomikenë të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore, në tërësinë e tyre, varet kryesisht edhe nga realizimi i veprimtarisë së sigurt dhe mbi baza ligjore të shtetit e të subjekteve ekonomike në fushën ekonomike me jashtë. Megjithatë, siç tregojnë analiza e legjislacionit

¹ P.sh. Në Britaninë e Madhe të ardhurat e realizuara nga veprimtaritë doganore përbëjnë 40% të të gjitha të ardhurave që derdhen në buxhetin e shtetit. Në këto shifra, madje më të larta, paraqiten edhe të ardhurat e import/eksportit në Shqipëri.

penal në fushën doganore, gjatë gjithë periudhës së ekzistencës të shtetit shqiptar, si legjislacioni, ashtu edhe praktika e zbatimit të tij, jo gjithmonë i kanë plotësuar funksionet e tyre të domosdoshme në mbrojtje të ligjit.

Transformimi i veprimtarisë ekonomike me jashtë, nisur në fillim të proceseve demokratike dhe, më vonë, kalimi në ekonominë e tregut, krijoi kushte objektive për lëvizjen e lirë të mallrave e të teknologjive. Por, nga ana tjetër, transformimi i shoqërisë, shndërrimi i administratës së vjetër, krijimi i strukturave dhe ngritja e mekanizmave të rinj në ekonomi, në Shqipëri krijoi njëherazi një mori mangësish e boshllëqesh, të cilat janë përdorur dhe janë shfrytëzuar më së miri nga kontrabandistët me qëllim përfitimi maksimal. Ndërkohë që papunësia, kriza ekonomike dhe niveli i lartë i korrupsionit, influencuan në zgjerimin e menjëhershëm të aktiviteteve të jashtëligjshme, si rrjedhojë krijuan mundësi konkrete për kontrabandim dhe veprimtari të tjera kriminale të një pjese të konsiderueshme të subjekteve, të cilat realizonin lidhjen ekonomike me vendin tonë dhe, nëpërmjet tij, me shtetete tjeratë rajonit.

Korridoret e kontrabandës nga shtetet e tjera drejt Shqipërisë, nuk funksionojnë vetëm me shtetetme të cilatekonomia shqiptare orientohet ekonomikisht, por edhe me shtetete rajonit, të cilët janë shkëputur nga ish-Jugosllavia, duke krijuar shtete të pavarura, me rregulla dhe norma të reja, por që kanë pamjaftueshmëridhe mungesa në organizimin e veprimeve për të luftuar këtë fenomen negativ, i cili shfaqet haptazi në territorin e shteteve të tyre. Gjithsesi, për shkak të mungesës, apo për shkak të kushteve të vështira objektive (gjeografike) për menaxhimin e kufijve shtetërorë, por edhe të atyre doganorë, bëhet i mundur kalimi i mallrave, duke iu shmangur kontrollit dhe pagesave të detyrimeve të import/eksportit.

Përveç sendeve dhe mallrave tradicionale të përdorimit të gjerë: prodhime industriale, ushqimore, mallra me akcizë, si karburant, cigare, pije alkoolike, etj., objekt i import-eksportit dhe tranzitimit në përmasa të konsiderueshme dhe në kundërshtim me ligjin ka qenë dhe vazhdon të kryhet gjithashtu edhe me mallra të ndaluar, si armatime, materiale ushtarake, mbeturina industriale të dëmshme për ambientin rrethues, materiale helmuese e radioaktive, narkotikë të llojeve e formave të ndryshme, shuma të konsiderueshme parash të pista (Black money...), etj., ndërkohë që *“pirateria dhe trafikimi i mallrave të falsifikuara janë në lulëzim të plotë”*.

Të gjitha këto të marra së bashku, jo vetëm që shkelin normalitetin e veprimtarisë ekonomiketë vendit me jashtë, por i sjellin absolutisht një dëm të pallogaritshëm sigurisë kombëtare, ekonomisë, si dhe mbrojtjes së shëndetit të popullsisë, të kafshëve, të bimëve dhe të ekosistemit në tërësi.

Përveç kësaj, meqenëse fenomeni i liberalizimit të marrëdhënieve ekonomike me jashtë të gjitha degët e ekonomisë, po gjen shtrirje edhe në hapësira të reja drejt integritit me atë të BE-së, në këtë kuadër u shfaqën forma të reja të kontrabandës dhe të veprimtarive të tjera kriminale, të panjohura e të patrajtuara më parë, si rrjedhojë përballja me to ishte e vështirë jo vetëm për shkak të nivelit të ulët të administratës doganore dhe legjisllacionit të fushës doganore, por edhe për shkak të vështirësive të hasura për të luftuar korrupsionin. Në këtorrethana ka ndryshuar në mënyrë të ndjeshme natyra dhe karakteri i personave që kryejnë këto vepra kriminale.

Aktualisht organet doganore dhe ato ligjzbatuese nuk kanë të bëjnë me elementë të veçantë kriminalë, por me struktura të mirëorganizuar, që veprojnë në degë të shumta të biznesit kriminal. Këto grupe kriminale, nëpërmjet importimit, eksportimit², tranzitimit të mallrave, por edhe duke shfrytëzuar lehtësitë në hyrjen e mallrave në territorin doganor dhe vendosjen e tyre nën procedura të veçanta doganore, kontrabandojnë në/dhe nga territori doganor mallra, duke iu shmangur detyrimeve të importit apo duke përfituar padrejtësisht rimbursime të taksave nëpërmjet eksporteve fiktive.

Vlen të theksohet se në këtë proces kriminal, përveç individëve dhe shoqërive tregtare, shpeshherë përfshihen edhe individë që shteti i ka ngarkuar me detyrën e "Rojës Financiar", doganierë dhe nëpunës të tjerë zyrtarë, të cilët lidhen drejtpërsëdrejti me këtë veprimtari në fushën doganore. Në këtë realitet shpjegohet edhe fakti, që në procesin e importimit të mallrave mendohet se 50% e cigareve i shmangen detyrimeve të importit, ndërkohë që sasia e kafes së importuar dhe zhdoganuar është larg shifrave reale³.

Në përmasa të konsiderueshme vazhdon të jetë kontrabandimi i karburanteve, prodhimet ushqimore, alkooli. Sipas të dhënave zyrtare, në Shqipëri, 25% e gjithë rasteve të kontrabandës së regjistruar në vitin 2005, kanë të bëjnë me kontrabandë bagëtisë (gjësë së gjallë). Ndërsa, në vitin 2004, numri i regjistruar është dyfishuar me 164 raste, shumë prej të cilave përfshijnë mallrate akcizës, që kapin një vlerë monetare përafërsisht 144.000 euro. Ndërkohë që vazhdon hyrja e mallrave të falsifikuara dhe pirateria në nivele të pallogaritura, duke cenuar haptazi pronësinë intelektuale dhe industriale.


² Rasti i eksportit fiktiv të naftës "Virxhin", në kundërshtim me ligjet në fuqi, krijoi burime të sigurta dhe të plota për përfitime në shuma marramendëse valutore për efekt të shmangies së pagesës të akcizës dhe rimbursimit të TVSH-së.

³ Në korrikt të vitit 2004, "Philip Morris International" një oftoise kishte arritur një marrëveshje me Komisionin Evropian, në bazë të së cilës do t'ipaguante një miliard dollarë Komisionit Evropian dhe do të merrte masa paraprake për kontrollimin e kontrabandës, ndërkohë që Komisioni Evropian do të tërhiqte padinë pranë Gjykatës së Shteteve të Bashkuarave të Amerikës. Më shumë shiko (www.ash.org.uk/html/press/040709.html)

Tabela 16 Mallrat kryesore të Akcisës sipas viteve (Kafe, Birrë,Cigare,Karburante)

Table 16 Main Excise Commodities by years (Coffee,Beer,Cigarette,Fuel)

	Kafe Coffee	Birrë Beer	Cigare Cigarette	Karburante Fuel	
	Sasia/Ton	Sasia/ 000/Litra	Sasia/Ton	Sasia/ Ton	
2009	6,913	36,601	4,064	432,132	2009
2010	6,336	33,943	4,501	484,392	2010
2011	6,546	31,446	3,250	457,250	2011
2012	6,884	29,674	3,631	431,858	2012
2013	7,165	27,961	3,697	459,831	2013



Në të njëjtën kohë, mungesat në përsosmërinë e legjislacionit penal të fushës doganore, të normave të tjera, që mundësojnë marrjen e masave ndëshkuese për veprimtari apo aktivitete me rrezikshmëri shoqërore në sferën e veprimtarisë ekonomike të import/eksportit, bëjnë të mundur që në praktikë organet ligjzbatuese shpesh të vihen në kushte të atilla, që sjellin interpretime të ndryshme juridike të thelbit të këtyre veprimtarive jo ligjore.

Për rrjedhojë bëhen gabime serioze në klasifikimin dhe në përcaktimin e masës dhe llojit të ndëshkimit nga gjyqtarët, nga ku, jo rrallë jepen dënime të pajustificuar, duke ndëshkuar subjektin e veprës penale apo duke e shmangur atë nga ndëshkimi. Këto veprime shkelin rëndë të drejtat kushtetuese dhe të drejtat procedurale të qytetarëve e për rrjedhojë i sjellin një dëm të rëndë prestigjit dhe autoritetit të shtetit, i cili është garant i zbatimit të ligjeve ekzistuese.

Për sa i përket çështjes që trajtuam më lart, nëpërmjet organeve ligjvënëse e ligjzbatuese të shtetit, lind domosdoshmëria epërpunimit dhe vënies në jetë jo vetëm të një programi të ri të veprimeve për të luftuar krimete fushës doganore, por edhe të krijimit të një legjislacioni të ri, që t'i përgjigjet frymës dhe kërkesave të kohës.

Me miratimin e Kodit të ri Doganor në vitin 1992, hartuar me asistencën e drejtpërdrejtë të ekspertëve amerikanë, si dhe të ndryshimeve në Kodin Penal në vitin 1996, ndodhën ndryshime substanciale në politikën penale të fushës doganore. Në Kodin Doganor dhe në ndryshimet që iu bënë në vitin 1996, përcaktohet qartë kuptimi i kontrabandës⁴. Në Kodin Penal u shtua seksioni i veprave penale të kontrabandës, të cilat më parë ishin të panjohura, apo ishin tepër të përgjithshme⁵. Më 1 janar të vitit 2000, mbi bazën e ligjit të miratuar nga Parlamenti hyri në fuqi Kodi Doganor⁶, i cili, nga ana objektive, solli ndryshime të rëndësishme në klasifikimin e veprave penale të kontrabandës, përfshirë edhe përkufizimin e kësaj vepre penale⁷.

Në këtë mënyrë dispozitat e Kodit Penal që përcaktojnë veprat penale në fushën doganore kanë marrë një kuptim më të plotë edhe nëpërmjet neneve të kontrabandës të përcaktuara në Kodin Doganor.⁸

⁴ Kodi Doganor i vitit 1992, neni 63.

⁵ Kodi Penal i vitit 1995: "Krimet në fushën doganore"; neni 171-178.

⁶ Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë

⁷ Neni 256: "Shmangia ose tentativa për të shmangur me çfarëdo mënyre kontrollin dhe/ose mbikëqyrjen doganore mbi mallrat, me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve të importit dhe eksportit, siç është përshkruar në nenet 276 deri në 280, si dhe secili prej veprimeve të përshkruara në këto nene përbën kontrabandë dhe dënohet si i tillë.

⁸ Neni 256, 276 & 280 i Kodit Doganor.

Lidhur me çështjen e sipërpërmendur, është arritur që në dispozita të veçanta penale, të përcaktohen vepra penale të fushës doganore, që kanë të bëjnë me mallrat e ndaluar, me mosdeklarimin e mallrave nën procedurat e veçanta doganore (regjimeve doganore), të deklarimit të parave, si dhe të eksport-importit të objekteve me vlerë në fushën kulturore--artistike, historike dhe arkeologjike. Në këtë ndarje ligjvënësi orientohet nga kategoritë e mallit, ndërkohë që ka përfshirë edhe një dispozitë që shqyrton përgjegjësinë penale të doganierëve, si subjekt i posaçëm në rast përfshirjeje si bashkëpunëtor në kontrabandë. Po ashtu, në Kodin Doganor ligjvënësi ka parashikuar edhe zgjidhjen administrative të kontrabandës⁹, ndërkohë që ligji parashikon përgjegjësinë penale të shoqërive tregtare¹⁰. Në këtë mënyrë, në Kodin Penal dhe në Kodin Doganor kemi të bëjmë me një paketë normash, që parashikojnë përgjegjësinë penale për krimet e kryera në një prej degëve më të rëndësishme të ekonomisë së vendit, pra të veprimtarisë ekonomike të importimit, të eksportimit, të tranzitimit të mallrave, si dhe vendosjes nën një procedurë të veçantë doganore.

Studimi që po prezantohet para jush i kushtohet një prej çështjeve më aktuale të së drejtës doganore dhe penale, domethënë problemit të sigurimit të interesave të vendit jo vetëm në sferën ekonomike, por edhe më tej, në atë të *sigurisë dhe mbrojtjes*, shqyrtuar nga këndvështrimi i goditjes së krimit në fushën doganore.

Ndryshimet që kanë ndodhur këto 20 vitet e fundit në sferën ekonomike dhe politike, globalizimi i tregtisë, si dhe rreziqet e shekullit XXI, kërkojnë gjetjen e balancës së duhur ndërmjet liberalizimit të tregtisë dhe kontrolleve doganore, ashtu sikurse lehtësimin dhe thjeshtimin të proceseve doganore në përballimin e fluksit të mallrave, nga njëra anë në zinxhirin e furnizimit me sa më pak pengesa doganore dhe, nga ana tjetër, në forcimin e luftës kundër aktivitetëve kriminale, nëpërmjet implementimit të kontrolleve të mbështetura në menaxhimin e riskut. Natyrisht, gjithçka e formuluar drejt lehtësimit dhe thjeshtimit të procedurave doganore reflektoi edhe në situatën ekonomike, ku gjatë kësaj periudhe shënohet një rritje e fuqishme të evazionit fiskal, ku ndikim të madh ka dhe vazhdon të ketë kontrabanda, e cila, së fundmi, ka marrë një karakter të vërtetë kërcënues.

Në këto rrethana, ligjvënësi duhet të reagojë në kohën e duhur ndaj ndryshimeve që pëson vendi dhe, njëkohësisht, nuk duhet të lejë në harresë interesat financiare të shtetit, sepse një nga kushtet kryesore për zgjidhjen e suksesshme të problemeve me karakter ekonomik-social, që qëndrojnë aktualisht përpara shoqërisë, është mbi të gjitha zbatimi i një politike të drejtë financiare. Gjithsesi, që vendi të integrohet kryekëput në të gjitha fushat e domosdoshme me atë të BE-së, kërkonte përdorimin e instrumenteve dhe

⁹ Kodi Doganor, neni 291.

¹⁰ Ligj Nr. 9754, Datë 14.6.2007 - Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë.

metodave tradicionale për vende me ekonomi tregu. Për këtë arsye dhe, në këtë kuadër, krahas ndryshimeve në fushën e Legjislacionit Fiskal, duke i përafuar gjithnjë më shumë me ato të BE-së, është aderuar në një sërë Konventash¹¹ dhe është përgatitur një paketë e Legjislacionit Doganor, ku hartimi i “Kodi Doganor i Unionit”¹² zë vendin kryesor.

Me gjithë hapat e bëra dhe masat e marra nga ana e qeverisë për rregullimin dhe përsosjen e marrëdhënieve ekonomike me jashtë, prapëseprapë, në fushën doganore, kriminalitetivijon të ketënjë ndikim të fuqishëm negativ në të gjitha sferat e veprimtarisë jetësore të shoqërisë, duke frenuar kështu transformimin social-ekonomik dhe atë politik, po duke i sjellë gjithashtu edhe një dëm material të pallogaritshëm, si dhe dëmton autoritetin ndërkombëtar të vendit.

Mendoj se jemi larg ditës kur kurba e rritjes së krimit në fushën doganore do të fillojë të bjerë, në krahasim me llojet e tjera të kriminalitetit. Në këtë mënyrë, nëpërmjet shmangies së pagesave dhe detyrimeve doganore, si dhe nëpërmjet kalimit të mallrave, në/dhe nga kufiri shtetëror jashtë zonës doganore, kontrabanda në vetvete përbën elementin bazë të përgjithshëm të krimit në fushën doganore në vend dhe mund të pohohet gjithashtu se i përket një nga vendet kryesore në sistemin e krimeve, nisur nga vëllimi i dëmit material të shkaktuar dhe sipas mënyrës universale të kryer.

Si pasojë e rritjes së kriminalitetit në sferën ekonomike, sikurse venditë rëndësishëm që zënë pagesat doganore në hartimin e buxhetit të shtetit, por edhe rrezikshmëria e lartë e kontrabandës, e cila është e aftë të kryejë jo vetëm dëme financiare në sistemin e vendit, por njëherazi të realizojë edhe krime me rrezikshmëri të lartë shoqërore, të shqyrtuara në këtë punim, kërkojnë sigurisht kualifikime të drejta të krimeve në fushën doganore, në mënyrë që të mundësojnë realizimin e sigurisë ekonomike, ashtu edhe sigurinë kombëtare, madje dhembrojtjen e jetës së njerëzve, të kafshëve dhe të bimëve.

¹¹ World Customs Organization 2002, Kyoto 2000: The International Convention on the Simplification and Harmonization of Customs procedures (Revised) – Pathway to efficiency and effectiveness in the Customs Environment, World Customs Organization, Brussels (e rishikuar)-Shqipëria ka aderuar në vitin 2012.

Konventa e Kiotos; World Customs Organization 2002, Kyoto 2000 - The International Convention on the Simplification and Harmonization of Customs procedures. (Ligji Nr. 37/2012 për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare: “Për thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave doganore).

2. Konventa Ndërkombëtare: “Për sistemin e harmonizuar të kodifikimit dhe përshkrimit të mallrave” (Ligj. Nr. 35/2012, datë 29.03.2012 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë”).

3. Konventa Ndërkombëtare: “Për asistencë të ndërsjellë administrative, për parandalimin, për hetimin dhe për goditjen e shkeljeve doganore”. Johannesburg -1950, këtë e tutje “Konventa e Johannesburgut”.

4. Konventa TIR. “Transport International Routier” e OKB-së, 1975.

5. Konventa Ndërkombëtare: “Për harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave”. Konventa e Nairobi, 1997.

6. Konventa Ndërkombëtare për sistemin e harmonizuar e kodifikimit dhe përshkrimit të mallrave.

¹² Kodi Doganor i RSH, i cili është të njesuar me Direktiven e BE 952/2013, datë 9 Tetor 2013 “Kodi Doganor i Unionit” (të vendeve të BE-së).

Kësisoj çështja e vënies së kriminalitetit para përgjegjësisë ligjore për kryerje të krimit doganor lidhet jo vetëm me problemine procedurave penale, por mirëfilli edhe me karakterin formal të normave, sikurse me karakteristikate veçanta që karakterizojnë këto vepra penale, pa anashkaluar problematikën dispozitive ligjore tek të cilat ato bazohen.

Për këtë arsye, është e domosdoshme t'u drejtohem normave doganore të së drejtës doganore, madje edhe atyre penale, që lidhendrejtëpërsëdrejti me krimet në fushën doganore, madje janë specifike në veprimtarinë e tyre dhe, si rrjedhojë, për të pasur një vlerësim të drejtë të veprimtarive me rrezikshmëri shoqërore, do na duhet t'u referohemi gjithashtu edhe normave administrative, tatimore¹³, financiare dhe degëve të tjera të së drejtës.

Nga ana tjetër, gjatë këtij punimi është mbajtur parasysh fakti, se, lidhur me aktet ligjore në fushën doganore, të cilëve rëndom lind nevoja t'u drejtohem për kualifikimin e krimeve të parashikuara në nenin 171-178 të Kodit Penal dhe neneve 279-280 të Kodit Doganor, qoftë gjatë diskutimeve doktrinare, qoftë gjatë diskutime të studiuesve të fushës penale apo ligjbërëse, ashtu sikundër ndërmjet prokurorëve dhe gjyqtarëve, asnjëherë nuk ka ekzistuar mendimi njëjtë ose unik. Madje, qëndrime të ndryshme janë konstatuar edhe për faktin se ku duhet të përfshihen dispozitat ligjore për veprat penale të kontrabandës, në Kodin Doganor apo në Kodin Penal. Në këtë këndvështrim, nëse i referohemi praktikës gjyqësore, diskutimet arrijnë deri në atë pikë sa mendohet, se: "bashkëzistenca e Kodit Penal me Kodin Doganor krijon jo pak probleme në cilësimin ligjor të rasteve të kontrabandës"¹⁴.

Të gjitha këto, qoftë për mungesë të përvojës në konceptimin e veprimtarisë doganore në tërësi, qoftë të krimeve në fushën doganore dhe praktikës së vakët gjyqësore, kanë bërë që studiues të ndryshëm të fushës penale t'i shmangen analizës së këtyre çështjeve, ose t'i përmbahen mendimit, që, *për të gjitha rastet e kontrabandës, të bëhet referencë në Kodin Penal, por gjithashtu edhe "veprime që në kodin aktual (doganor) përfshihen në kategorinë e kontrabandës, mund të klasifikohen në grupin e kundërvajtjeve administrative"*¹⁵, duke anashkaluar kështu jo vetëm jurisprudencën dhe doktrinën botërore, por edhe praktikën gjyqësore të vendeve komunitare.

Më duhet të theksoj, se nga përvoja ime si nëpunës - jurist i administratës doganore, gjatë veprimtarisë pedagogjike e shkencore në Universitetin "**Aleksandër Moisiu**" në Durrës,

¹³ Baza juridike ku referohet Kodi Penal për kontrabandën me mallra që paguajnë akcizë është "Ligji i posaçëm për akcizat". I. Elezi, "E drejta penale", pjesa e posaçme, viti 2009, Shtëpia Botuese "ERIK".

¹⁴ Ismet Elezi "E drejta penale", Pjesa e posaçme, viti 2009, po aty.

¹⁵ Shihstudimin me titull "Lehtësimi i Procedurave Doganore dhe i Marrëdhënieve të Biznesit me Administratën Doganore", realizuar nga Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT), nëntor 2004, fq. 30, pika 73.

etj., por edhe si avokat, kam vërejtur se jo rrallë kualifikimi i krimeve në fjalë shkakton shumë probleme të diskutueshme, kuptime jo të njëjta për njërin apo tjetrin veprim në shkeljet doganore për t'i klasifikuar kontrabandë apo kundërvajtje, gjë që, në disa raste, çon në shmangien e shkelësit ligjor nga përgjegjësia, ndërsa, në raste të tjera, përkundrazi, shkelësi merr një dënim të pamerituar¹⁶.

Gjyqtarët, si rregull, lejojnë të bëhen gabime tipike, gabime që lidhen me procedurën e zbatimit të dispozitave për masën e sigurisë, me shqyrtimin kualifikimit të krimeve në fjalë (krimeve të konstatuara), në përgjegjësinë penale të personave juridikë, në mospërcaktimin e saktë të objektit të kontrabandës dhe shmangien nga pagesat doganore, si dhe në përmbajtjen e anës objektive dhe subjektive të veprimtarive të trajtuara apo të shqyrtuara, madje duke vënë në lëvizje edhe Kolegjet e Bashkuar të GJL në unifikim të praktikës gjyqësore¹⁷.

Çfarë synohet në këtë punim.

Për sa parashtrova më lart, ky punim i kushtohet studimit të veprave penale në fushën doganore, mekanizmave të ndjekjes dhe sanksioneve të veprave në të drejtën penale doganore, në mënyrë që të dallojmë veçoritë e tyre dhe të kuptojmë perspektivat që ato mbartin.

Është fakt, se sanksionimi i veprave penale në fushën doganore dallohet nga një partikularizëm i fortë, që, nga njëra anë, shpjegohet nga historia dhe, nga ana tjetër, siç parashtruam më lart, nga specifikimi veçantë që kanë këto vepra, të cilat çdo ditë e më shumë kërcënojnë interesat financiare të shtetit, ngaqë është vështirë të kuptohen për shkak të mjeteve të mashtrimit dhe metodave të paimagjinueshme të cilat përdoren për t'i kryer. Çka është dashur të bëhet, ka qenë përforsimi i kompetencave të administratës, duke filluar pikësisht me gjurmimin dhe zbulimin e veprave doganore, ashtu sikurse me ushtrimin e ndjekjeve dhe sanksionimin e tyre.

Në këto kushte, mosnjohja në thellësi e veprave penale në fushën e doganave përbën problem. Është e vërtetë që vepra penale e kontrabandës gjen trajtim në Kodin Penal dhe Kodin Doganor, por si një ligj i përafuar. Pra, natyrshëm kërkohet që gjithçka të jetë në harmoni me legjislacionin e vendeve të ndryshme komunitare, me përvojë në goditjen e krimit doganor, si dhe t'i përgjigjet stadi të zhvillimit ekonomik dhe pozicionit gjeografik të Shqipërisë.

Gjithsesi, duhet të pranojmë se gjendemi përpara vështirësive që na propozon tematika, duke u orvatur t'i anashkalojmë vlefshmërinë e interpretimeve në kushtet e

¹⁶ Shih çështjen gjyqësore "Shteti kundër administratorit të Shoqërisë Porto Romano".

¹⁷ Vendimi Nr. 1, datë 26.03.2002, i Kolegjeve të Bashkuara "Shteti kundër Shoqërisë Tregtare (Ojal) "Kafe do Brazil".

pamjaftueshmërisë së studimeve të mirëfillta, të cilat, nga njëra anë, të trajtojnë analizën e figurës së veprave penale të kontrabandës, dhe, nga ana tjetër, rrethanat kur në këto vende mungon unifikimi i krimeve në fushën doganore.

Nëse do t'i shtojmë edhe faktin se:

- praktika gjyqësore paraqitet ende e varfër dhe në vetë pjesën e VIII të Kodit: "Shkeljet në fushën doganore dhe sanksionet" (Kreu 3 Kontrabanda), evidentohen mangësi¹⁸;

dhe, së fundmi, por jo nga rëndësia vërejmë se:

- në kontekstin e luftës efektive kundër kontrabandës ngrihet një hendek i madh në brendësi të kriminit të kontrabandës, i cili katë gjitha mundësitë të testohet në teknologjinë e komunikimit dhe të vëzhgimit, po ashtu edhe nga organet e zbatimit të ligjit, që, ngapikë pamjae buxhetit¹⁹, janë shumë të kufizuara.

Pra, duke mbajtur parasysh këta faktorë, nuk mund të mos arrijmë në përfundimin se krimet e kontrabandës përbëjnë një problematikë aktuale, për të cilën nevojitet një punë kolosale për t'ia arritur qëllimit përfundimtar, veçanërisht në kushtet e nivelit të lartë të kontrabandës, që kërkon medoemos intensifikimin e luftës ndaj tij.

Në këtë kuadër, mendoj se është më së e domosdoshme që :

- a) Hartimi i dispozitave të kontrabandës së Kodit të Ri Doganor t'i nënshtrohet analizës së thellë, kuptimit të qartë të tyre, ndërkohë që një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet dhe përgatitjes së organeve të policisë doganore, të organeve hetimore, të akuzës dhe, në veçanti, gjyqtarëve e avokatëve.
- b) Përballimi i sfidave në kushtet e lirisë së qarkullimit, të krijimit të një tregu gjithnjë e më të gjerë, ka çuar në një sërë Konventash, Marrëveshesh dhe veprimtarish të bashkërenduara, të cilat duhet të implementohen dhe të shndërrohen në pika orientimi për hartimin e legjislacionit për luftën kundër kontrabandës.

Si rrjedhojë, edhe Tema: "Veprat penale në fushën e doganave", ngarkuar nga departamenti i së Drejtës Penale, të Fakultetit të Drejtësisë, për të mbrojtur gradën shkencore "Doktor i Shkencave" synon të bëjë jo thjesht një analizë të veprave penale të fushës doganore, por të analizojë gjithashtu edhe problematikat e shfaqura jo vetëm në praktikë, por edhe në diskutimet akademike-doktrinale, për shkak të attributeve të veçanta

¹⁸ Kodi Doganor, neni 256 e në vijim.

¹⁹ Një faktor tjetër, i cili është sidomos i rëndësishëm në luftimin e pastrimit të parave, është ekonomia e bazuar në kesh. Pavarësisht modernizimit të sistemeve bankare në rajon, një pjesë e madhe e aktiviteteve ekonomike dhe transaksioneve financiare kryhen ende me paratë dorë (cash). Veprim ky që e bën hetimin financiar shumë të vështirë.

që i karakterizon këto vepra penale të fushës fiskale dhe më gjerë, siç janë ato që kanë të bëjnë me problemet jetike të sigurisë dhe të mbrojtjes. Ndërkohë që, duke u mbështetur në doktrinën e sotme, dëshiroj të prezantoj disa mendime në lidhje me përmirësimin e dispozitave të veprës penale të kontrabandës, në mënyrën e kuptimit dhe zbatimit të tyre, si nga ana e administratës përgjegjëse doganore, ashtuedhe nga organi i akuzës, gjykata dhe avokatët, në mënyrë që të dallojmë më së miri veçoritë e tyre dhe të kuptojmë perspektivat që ato mbartin.

Në këtë mënyrë, në kuadrin e veprimtarisë shkencore të Universitetit, punimi do të kontribuojë në analizën e veprave penale të kontrabandës dhe do të tregojë kërcënimet e reja, që rrjedhin nga krimet e kontrabandës në kohën e sotme, si dhe çështjetshqetësuese për administratën doganore, njëkohësisht do të ndihmojëpolitikëbërësit të mirë informohen pasi të marrin vendime drastikembipolitikat kundër krimit të kontrabandës dhe hartimit të një ligji adekuat në këtë fushë²⁰, si dhe do të rrisëndërgjegjësiminepublikut, në veçanti të biznesitmbi këto çështje.

Studimi është i ndarë në 3 pjesë me disa kapituj:

Pjesa e parë përfshin dy kapituj:

Në kreun e parë, studimi është përqendruar në sfondin historik të legjislacionit për krimin e kontrabandës në vende të ndryshme, kryesishtAngli, Francë, Itali, por edhe në vendin tonë. Për këtë, duke u mbështetur si në studime të mirëfillta, ashtu dhe në pikëpamjet që kanë sunduar në epoka të ndryshme, jam përpjekur të prezantoj elementët më pozitivë të luftës kundër krimit të kontrabandës, që nga lashtësia deri më sot. Një vëmendje të veçantë i kam kushtuar legjislacionit të luftës kundër krimit në fushën doganore në vendin tonë, që prej fillimit të krijimit të shtetit tonë, në vitet 1937, ku, për herë të parë, në KodinDoganor të Mbretërisë së atij viti gjejmë kornizën ligjore të veprave penale doganore, sikundër në vitin 1952 dhe 1957, ku pasqyrohen paketat e dispozitave të kontrabandës si në Kodin Penal dhe nëKodin Doganor, mandej, në mënyrë më të detajuar, do të prezantoj dispozitat lidhur me veprat penale të kontrabandës në Kodin Doganor në vitin 1992 dhe në Kodin Penal në vitin 1996.

Në kreun e dytë, të kësaj pjeseshpjegohet kuptimi i kontrabandës, diferencat dhe kufizimet që lidhen me këtë shkelje doganore. Duke iu referuar doktrinave bashkëkohore, pornjëherazi edhe literaturës penale dhe doganore, kryesisht të vendeve të BE-së,në vijimësi të studimit kuptimi i kontrabandës përcaktohet si njëjtësim me shkeljet në fushën

²⁰ Natyrshëm nëse katedrën e nderuar do të konsiderojnë dhe vlerësojnë si një institucion shkencor duke i kërkuar mendime dhe ekspertizën shkencore përpara se të diskutojnë në Qeveri dhe në parlament ligjin doganor dhe jo siç ndodhë rëndomë që këto institucione të larta të shtetit mjaftohen me draftet e përgatitura nga disa inspektor doganor.

fiskale; kushtet që e favorizojnë, si dhe faktorët që mund ta frenojnë. Veçanërisht nënvizoj faktin, se, nga pikëpamja tregtare, kontrabanda është formë e tregtisë ndërkufitare, që ndalohet me ligjnga shteti, por jo nga e drejta natyrale. Gjithashtu, një vëmendje të veçantë i kam kushtuar prezantimit të llojeve të kontrabandës, sidomos kontrabandës absolute, e cila, në ditët tona, paraqet një rrezikshmëri jashtëzakonisht të madhe, për sa i përket kuadrinë sigurisë kombëtare dhe mbrojtjes së jetës të njerëzve, kafshëve, bimëve dhe ekosistemit në tërësi.

Në pjesën e dytë, “Analizë e veprës penale të kontrabandës” studimi përqendrohet te drejta penale doganore si një tërësi rregullash, që kanë të bëjnë me krimet në fushën doganore.

Pjesa e dytë përfshind kapituj:

Në kreun e parë, analizohen elementet e veprës penale të kontrabandës. Me ndihmën e ballafaqimeve, edhe pse me pikëpamje të ndryshme të autorëve të jurisprudencës, argumentohet se veprat penale të kontrabandës janë kryesisht vepra penale formale, megjithëse, nga ana tjetër, nënvizohet se kontrabanda që konsiston në shmangien e detyrimeve doganore përbën vepër penale materiale. Gjithashtu, një vëmendje të veçantë në këtë punim i kam kushtuar çështjeve që kanë të bëjnë me përgatitjen, tentativën apo fajin, duke sjellë një risi për sa u përket veçorive që paraqesin veprat penale të kontrabandës, në rastet kur kemi të bëjmë me tentativë, apo kryerjete veprës penale në kushtet e pakujdesisë.

Në kreun e dytë, studimi synon parashkrimin e pikëpamjeve lidhur me veçoritë që paraqesin sanksionet tek e drejta penale doganore. Duke polemizuar me disa autorë të cilët kundërshtojnë dënimet e përcaktuara në nenin 281 të Kodit Doganor, krahas dënimeve të parashikuara në Kodin Penal për veprat penale të kontrabandës, në bazë të argumentimeve teoriko-shkencore dhe qëndrimeve të jurisprudencës së vendeve të BE-së, parashtrij mendimin tim personal lidhur me domosdoshmërinë e dënimeve kryesore dhe dënimeve plotësuese, që duhet të parashikohen në Kodin e ri Doganor.

Në pjesën e tretë, trajtohet analiza e figurës së veprave penale doganore, njëkohësisht edhe pjesa kryesore e studimit, ku analizohen figurat kryesore të veprave penale të kontrabandës, si dhe procedurat që duhet të zbatohen nga autoriteti doganor, policia gjyqësore doganore, akuza dhe gjykata.

Në kreun e parë dhe të dytë, që, në fakt, trajtohen për herë të parë, synohet të mbushet boshllëku në lidhje me procedimin, për sa i përket hetimit dhe shqyrtimit të veprave penale të fushës doganore.

Në **kreun e tretë**, studimi i kushtohet veçanërisht analizës së kontrabandës me mallra të ndaluar, duke propozuar domosdoshmërinë e ndarjes dhe dallimit të mallrave, ashtu edhe për mallrate ndaluar për importimin e të cilave kërkohet autorizim apo licencë. Një vëmendje të veçantë i kushtohet edhe analizës së veprës penale me mallra që janë vendosur në regjimin pezullues.

Në një kapitull të posaçëm, studimi është përqendruar edhe në analizën kriminologjike të veprave penale në fushën e doganave për periudhën 2003-2013, si dhe të politikave penale.

Në përfundim të punimit, propozohendisa rekomandime, të cilat mund të jenë të rëndësishme, nëse merren parasysh përpjekjet eintensifikuara kundrejtkrimit të kontrabandës. Me anë të këtyre përfundimevesynohet gjithashtu edhe zgjidhja e problematikave të evidentuara në fushën e veprave penale të kontrabandës, kryesisht për hartimin e një sërë dispozitave të reja, por edhe për përmirësimin e tyre në fuqi, nisur sidomos nga fakti që jemi përpara diskutimit dhe miratimit të Kodit të ri Doganor. Mirëpo, qasja sa më pranë këtyre aspekte, ashtu sikursedhe angazhimi më i madh i shkencës, apo i organeve të jurisprudencës, madje dhe faktorëve në drejtim të aplikimit sa më adekuat të normave ligjore, që kanë të bëjnë drejtpërsëdrejti me krimet në fushën doganore, kërkojnë rishqyrtim të praktikës gjyqësore të deritanishme.

Është e kuptueshme që këto rekomandime nuk synojnë të shprehin definicione përfundimtare, përkundrazi ato mund të shndërrohen në objekt diskutimi, madje edhe kontestimi e kundërshtimi, të cilat i mirëpres si një ndihmë konstruktive që më jepet në procesin e përmirësimit të këtij punimi drejt një botimi të mirëfilltë, i cili përbën edhe synimin tim të kahershëm.

PJESA E PARË

KREU I

VËSHTRIM HISTORIK I KONTRABANDËS

DHE

LEGJISLACIONIT PENAL PËR LUFTËN KUNDËR TIJ

- 1. Dogana, kuptimi, misioni në luftën kundër kontrabandës dhe legjislacioni përkatës**
 - 1.1 Vështrim historik**
- 2. Legjislacioni i luftës kundër kontrabandës në vendin tonë**
 - 2.1 Legjislacioni i luftës kundër kontrabandës, gjatë periudhës së pushtimit të Shqipërisë nga fuqitë e huaja më 1916**
 - 2.2 Kodi Doganor i vitit 1938**
 - 2.3 Legjislacioni Doganor dhe Penal në 1944 –1992**
 - 2.4 Kodi Doganor i vitit 1992**
- 3. Misioni i shërbimit doganor dhe sfidat e shekullit XXI**

1. Dogana, kuptimi, misioni dhe legjislacioni në luftën kundër kontrabandës

1.1. Vështrim historik

Në lashtësi

Dogana ^{21/22} është autoriteti ose agjencia qeveritare e një vendi, që ka për detyrë mbledhjen e detyrimeve të importit, si dhe kontrollin e mjeteve dhe mallrave që hyjnë/dalin në/nga territori doganor i atij vendi. Ajo ka lindur dhe është zhvilluar së bashku me shtetin. Nuk është aspak gabim të mendohet se dogana ka lindur së bashku me tregtinë, megjithatë roli dhe misioni i saj kanë mbetur për mijëra vjet të pandryshuar²³.

²¹ Në përgjithësi, dogana dallohet nga autoritetet e imigracionit, të cilat kanë për detyrë të mbikëqyrin dhe të kontrollojnë personat që mbërrijnë apo largohen nga vendi. Në gjuhën shqipe, fjala "doganë" duket se është huazuar nga italishtja "la dogana". Në gjuhën angleze "dogana" përkthehet "customs" dhe artikullohet "castem". Ndoshta kjo fjalë rrjedh nga shprehja "customary payments"(pagesa te zakonshme), së cilës i referohet edhe Adam Smithi tek vepra e tij "Pasuria e kombeve". (Shën. i autorit)

²² Doganat janë institucione, të cilat merren me kontrollin e mallrave që hyjnë ose dalin nga një shtet në një shtet tjetër. Ato merren edhe me arkëtimin e taksave të parashikuara për to. Janë pika ose vende në kufirin shtetëror ose në një aeroport, ku bëhen veprime... (Fjalori i gjuhës shqipe, viti 1976.)

²³Adam Smith në veprën e tij të famshme "Pasuria e kombeve" tregon se dogana, si një pagesë e zakonshme detyrimesh, ka ekzistuar qysh prej kohëve që nuk mbahen mend. Duket se edhe fjala

Në disa dokumente që i përkasin periudhës së Mbretërisë së Re në Egjiptin e Lashtë, janë gjetur gjurmë që provojnë ekzistencën e doganës që në atë kohë²⁴.

Në Kinëdogana duhet të ketë ekzistuar që në kohën e mbretërimit të dinastisë Si Zhou, gjatë shekujve XI-VII para Krishtit. Kështu, letërsia e shkruar gjatë asaj epoke i referohet taksës doganore, si “një e shtata e një shume totale të formuar nga nëntë taksat, me anë të të cilave mblidheshin të ardhurat”²⁵.

Me interes janë edhe një sërë faktesh, të cilat mund të konstatohen lehtësisht dhe meshumicë midis faqevetë librit më të lexuar mbi rruzullin tokësor, Bibla, ku, përveç rrënjëve të traditës, mund të hasim edhe probleme që na shqetësojnë edhe sot e kësaj dite, si për shembull tendenca për të mos paguar taksat dhe korrupsioni i personave që merren me mbledhjen e tyre.²⁶ Padyshim që taksat doganore duhet të kenë ekzistuar edhe më herët, por dikur ato konsistonin vetëm në nivelin taksimit (*flat rate*), i cili ishte i zbatueshëm për të gjitha llojet e mallrave. Në të kundërt, tarifa doganore e Palmyras përbëhej nga tarifa të niveleve të ndryshme për mallra të llojeve të ndryshme, duke shënuar kështu lindjen e asaj që sot quhet nomenklaturë doganore e mallrave²⁷.

Nga ana tjetër, së bashku me doganën dhe kërkesën për vjelje të detyrimeve doganore, duhet të ketë lindur gjithaq tendenca për të mos paguar detyrimet e caktuara, dukuri që aktualisht e quajmë kontrabandë tregtare. Për këtë fakt, dëshmon indirekt ekzistenca e

angleze “Customs”, me të cilën anglezët emërtojnë doganën rrjedh nga “customary payments”, që do të thotë “pagesa të zakonshme”.

²⁴ Thuhet se dogana ka ekzistuar që në kohën e Mbretërisë së Vjetër në Egjiptin e Lashtë, rreth viteve 2700-2200 para Krishtit. Gjenden fakte që tregojnë se “drejtuesit e karvanëve”, titull ky për një nga postet që i përkiste administratës zyrtare të asaj kohe, i cili ishte përgjegjës për regjistrimin e mallrave që hynin dhe dilnin nga Egjipti, mblidhte bashkë me statistikat edhe detyrimet doganore, duke pasur kështu funksione të ngjashme me ato të një drejtori të përgjithshëm të doganave të sotme. Shumë libra i referohen tregtisë dhe doganave në Egjiptin e Lashtë. Për shembull, shkrimtari dhe arkeologu britanik Leonard Cottrell e përshkruan kështu gjendjen në portin e Tebës (Thebes) (Luxori i sotëm) në librin e tij “Jeta nën sundimin e Faraonëve”. “Që nga anija, ndërsa hidhje sytë nga bregu, mund të shihje një numër të madh ndërtesash me mure prej tullash argjile, që nuk ishin gjë tjetër, veçse hangarët e portit, magazina, zyrat e doganës, dyqane, taverna, shtëpi publike dhe kasollet e lagjeve të varfra”.

²⁵ In China, During the Song (960–1279) and Yuan (1279–1368) dynasties. Xiamen, i njohur ndryshe si ishulli Jiahe, pjesë eqarkut Tong'an, përbënte qendrën e tregtisëkontrabandë.

²⁶ Ka të ngjarë që tarifën e parë doganore ta kenë shpikur senatorët e qytetit Oazë të Palmyras, në shkretëtirën siriane. Ishin pikërisht ata që sajuan një sistem tarifimi doganor, parimet e të cilit u përdorën gjerësisht edhe gjatë shekullit të 20-të e vazhdojnë edhe sot.

²⁷ Tarifa e Palmyras, e gdhendur në gur, është zbuluar më vitin 1881, nga një princ rus, i quajtur Abamalek Lazarov dhe sot ruhet në “Hermitage Museum” të Shën Petërburgut. Po citojmë disa pasazhe nga teksti i gdhendur në atë gur: “Personi i caktuar si doganier, duhet të mbledhë një detyrim për çdo ngarkesë deveje: tre dinarë për çdo deve që hyn në Tadmor (Palmyra) dhe tre dinarë për çdo deve me ngarkesë që del nga Tadmori”.

ligjeve dhe rregulloreve që mundoheshin ta parandalonin kontrabandën, të cilat (ligjet dhe rregullat) gjendeshin kudo ku ekzistonte tregtia dhe dogana.²⁸

Në Mesjetë e në vijim.

Në lashtësi shtetet zbatonin përherë një sistem takse për mallrat që kalonin kufirin. Këto taksa, të marra sidomos për import, i përgjigjeshin një shqetësimi fiskal, pra atij të mbushjes së arkave të shtetit. Vlen të theksohet se edhe kufizimi përdorej si metodë, sidomos në rastin e eksportit të mallrave të domosdoshme, në mënyrë që të mbroheshin territoret nga mungesa e tyre²⁹. Krahas rritjes së veprimtarisë tregtare, import/eksportit, zhvilloheshin paralelisht format dhe mënyrat e kontrabandimit të mallrave, nëpërmjet të cilave siguroheshin fitime më të mëdha, se safitimet që realizoheshin nga tregu.

- *Në Angli.*

Historia e kontrabandës në Angli përparon hap pas hapi me historinë e Institutit të Doganave. Të dhënat më të hershme datojnë periudhën saksone, kohë kur mbreti *Ethelred II* imponoi një taksë, tarifë ose detyrim importi, për anijet që transportonin verë të huaj në *Billingsgate*. Mirëpo, me kalimin e kohës u shndërrua në “traditë” për vreshtarët e huaj, me qëllim që të hiqnin dorë nga një pjesë e mallrave të tyre në këmbim të lejes për të tregtuar. Tarifa të tilla ishin vendosur vetëm në porte të caktuara, kështu që evazioni nuk ishte as i vështirë dhe as ilegal.

Në fund të shekullit XIII, mbreti *Eduardi II*, në gjueti për të kërkuar burime të reja të ardhurash, vendosi taksë mbi eksportin e leshit. Në atë kohë, leshi ishte shtyllë e ekonomisë kombëtare, për më tepër kërkohej jashtëzakonisht shumë në kontinent. Për të

²⁸ Një nga ligjet më të spikatur në këtë drejtim është ligji i lashtë indian i njohur si “Ligji i Manu”-së. Studiues të shumtë janë marrë me këtë ligj, që duket se ka hedhur bazat e filozofisë indiane dhe që i takon periudhës së shekullit të dytë para Krishtit, deri në shekullin e dytë pas Krishtit. Ky ligj nuk harron të formulojë edhe disa dispozita, që lidhen me kundërvajtjen doganore: “*Ai që i shmanget doganës, ai që blen ose shet mallra në një kohë të papërshtatshme, ose ai që bën një deklaratë të rreme gjatë numërimit të mallrave të tij, do të gjobitet sa tetë herë shuma që kërkon të mos paguajë*”. Mbreti caktonte nivelet për blerjen dhe shitjen e mallrave të tregtueshme, duke marrë në konsideratë faktin se nga vijnë dhe ku shkojnë këto mallra, sa kohë janë mbajtur në zotërim, si dhe fitimin e mundshëm. Një herë në pesë net, ose në mbyllje të një dyjavori, mbreti caktonte çmimet e tregtarëve. Ajo që paraqet interes studimi në këtë tekst 2000 vjeçar, është dënimi me gjoba të shumëfishta që vazhdon të aplikohet edhe sot, në rastet e konstatimit të kontrabandës tregtare. (*Shënim i autorit*).

²⁹ Në fund të shekullit XVI, Sully, inspektor i financave, vjeljen e taksave doganore për zonën e quajtur “*Pesë fermat te mëdha*”, me përbërjen e disa provincave, të cilat nga ana fiskale i nënshtroheshin mbretit, ia besoi vetëm një kompanie. Përveç kësaj, ai diktoi edhe një rregullore të përgjithshme doganore në mënyrë që të hiqte kufijtë e brendshëm ndërmjet kësaj zone “*Pesë fermave të mëdha*” dhe zonave të quajtura si “*Të huaja*”, për të ndërtuar kështu një territor doganor unik, por që këto të fundit nuk e pranuan këtë tekst.

mbledhur të ardhurat, u krijua një personel i përhershëm doganor dhe, sakaq, u shfaqën edhe kontrabandistët e parë. Operacionet e tyre kontrabandë kryheshin përgjithësisht natën³⁰. Prandaj, kur u vendos detyrimi doganor për eksportin e leshit, për të cilin kishte kërkesa të larta në Evropë, tregtarët e zonës e panë më të arsyeshme, që këtë artikullta kalonin nëpërmjet porteve lokale *Cinque*, ku shërbente një numër i paktë zyrtarësh doganorë, duke iu shmangur kështu detyrimeve doganore³¹. Me kalimin e viteve, shtoheshin edhe nevojat ekonomike të monarkisë, për pasojë taksat rriteshin në përputhje me këto kërkesa, madje ishin vendosur edhe për mallra të tjerë. Sa herë që ndodhte diçka e tillë, kontrabandistëve u ofroheshin mundësi të reja, ndërkohë që në themelet e epokës së madhe të kontrabandës^{32/33} vendosej edhe një tjetër gur themeli.

Në njëfarë mënyre jeta për brezat e parë të kontrabandistëve ishte krahasimisht e lehtë. Në të vërtetë, rojet bregdetare filluan t'i patrullojnë ujërat bregdetare vetëm në shekullin e XIV, megjithëse duhet theksuar se zonat e patrullimit të tyre ishin tejet të kushtëzuara, si për shembull portet apo zonat rreth tyre, mirëpo ky faktbëri që për kontrabandistët të mbetej ende shumë bregdet i papatrulluar, nga ku ata mund të kalonin mallrat. Megjithatë, shumë prej tyre nuk e panë si të nevojshme shmangien e mësipërme, duke preferuar në shumicën e rasteve dhënien ryshfet doganierëve të portit. Veprim që nuk ishte aspak i vështirë. Korrupsioni ishte përhapur gjerësisht në shoqëri, doganierët paguheshin shumë pak, kështu që prezenca e ndonjë doganieri të ndershëm ishte më tepër një përjashtim sesa një kërkesë normale.

Gjithsesi, një nxitje e mëtejshme për kontrabandistët ishte edhe mbështetja e popullsisë, pasi në sytë e tyre biznesi konsiderohej i favorshëm dhe i parapëlqyeshëm, deri në atë masë sa nuk mund të gjykoreshin me juri.

³⁰ Rreth viteve 1300.

³¹ Ky ishte sistemi i parë doganor i përhershëm i themeluar në Angli. Fillimisht, detyrimi doganor ishte i ulët, por si pasojë e luftërave 100 vjeçare, kjo taksë filloi të rritej, në mënyrë që të paguhej për trupat dhe për armatimet.

Fillimisht, Shërbimet Doganore u vendosën me qëllimin e thjeshtë për të mbledhur taksat në porte dhe jo për të parandaluar kontrabandën. *Chichester* ishte porti i vetëm në *Sussex*, ku lejohej importimi dhe eksportimi i mallrave. Megjithatë, tregtarët e zonës e gjetën më të lehtë t'i kalonin të mirat nëpërmjet porteve lokale *Cinque*, ku ishin vendosur vetëm pak zyrtarë doganorë. Në vitin 1357, u zhvillua një çështje gjyqësore në *Rye*, për të gjykuar një numër tregtarësh të cilët kishin kontrabanduar të mira (mallra) nëpërmjet portit *Pevensey*.

³² Fjala *kontrabandë* është përdorur në fjalorin anglez që në vitin 1592, vjen nga fjala mesjetare franceze *contrabande* dhe i referohet sendeve, të cilat, për nga natyra, janë të paligjshme për t'u poseduar apo shitur.

³³ Këto mallra konsiderohen të ndaluara, por kemi dhe të ashtuquajturën kontrabandë derivative, d.m.th. mallra që normalisht mund të jenë në pronësi, por janë të mundshme për t'u konfiskuar sepse mund të jenë përdorur për kryerjen e një akti apo veprimi të paligjshëm dhe kthehen në të paligjshme, të tilla janë:

- Mallrat kontrabandë.
- Mallrat e vjedhura – marrja pjesë me vetëdije në tregtinë e tyre është një vepër penale më vete.
- Frytet e mashtrimit apo të falsifikimit, etj.

Në vitin 1614, eksporti i leshit u bë i paligjshëm dhe kështu vëllimi i kontrabandës së leshit nëpërmjet eksporteve filloi të rritej. Me kalimin e kohës, kontrabanda po bëhej gjithnjë e më përfituese, ndërsa tashmë kontrabandistët ishin të aftë t'i korruptonin edhe më shumë zyrtarët e porteve, të cilët, në këmbim, e lejuan kontrabandën të lulëzonte më shumë. Në këto kushte, në vitin 1661, për eksportimin e paligjshëm të leshit zbatohet dënimi me vdekje.

Në 1698, u miratua një Akt ligjor që i ndalonte njerëzit të blinin lesh brenda rrezes detare prej 15 milje, me përjashtim të rasteve kur ata garantonin se nuk do ta shisnin tek askush tjetër brenda 15 miljeve detare. Gjithashtu, çdo fermer, brenda 10 milje detare, ishte i detyruar të informonte organet kompetente për qethjen e gjedhit brenda një afati kohor 3 ditor. Një ndryshim tjetër ishte rekrutimi i një numri zyrtarësh, të cilët paguheshin për parandalimin e kontrabandës. Efekti fillestar i këtyre policëve ishte kufizimi i kontrabandës së leshit, e cila, në fakt, pësoi një rënie serioze rreth vitit 1703, por më pas edhe zyrtarët u korruptuan dhe kështu u rikthye përsëri kontrabanda.

- *Në Francë*³⁴

Në kohën e mbretërimit të Luigjit XIV, e ashtuquajtura *Kolbertizmi*³⁵, u ndërtua mbi politikën intervencioniste që kishte influencë të fortë mbi taksat doganore: kryesisht mbi taksën e transportit për transportuesit e huaj, si dhe krijimin e depove për riekспорт nën kontrollin doganor. Në atë kohë, u vendos tarifa doganore unike, me qëllim që të mbronte mallrat franceze. Ishin Dekretet e viteve 1681 dhe 1687 që përbënin bazën e legjislacionit doganor modern.

Ferma e Përgjithshme (autoriteti doganor i asaj kohe), krijonte mekanizma efikas për kontrollin e personave dhe të mallrave. Në atë periudhë, pjesa dërrmuese e lëvizjes së mallrave bëhej nëpërmjet transportit detar; në këtë mënyrë, punonjësit e Fermës mbikëqyrnin brigjet për t'i detyruar anijet që ta zbankonin mallin në port. Brigadat (njësi kontrollit doganor), kishin si detyrë të parandalonin, të këqyrin dhe të ndëshkonin aktet e kontrabandës.

Në Francë, për të luftuar kontrabandën, autoritetit doganor iu dhanë kompetenca të rëndësishme.³⁶ Meqenëse kontrabanda po shkaktohetumbje të konsiderueshme të të

³⁴Në 1784, qeveria reduktoi taksën mbi çajin dhe verërat franceze, duke hequr po ashtu edhe interesin për kontrabandimin e këtyre produkteve, megjithëse kërkesa për duhan ngeli.

³⁵*Jean-Baptiste Colbert* ka qenë një ndër ministrat më të rëndësishëm gjatë kohës së mbretit Luigji XIV, gjithashtu inspektor i përgjithshëm i financave në vitet 1665-1683

³⁶P.sh. agjentët e vetë ishin të armatosur, kishin të drejtë të kontrollonin gjithandej, duke përfshirë këtu edhe vendet ku jetonin njerëz fisnikë apo klerikë, madje ata mund të gjobonin jo vetëm brenda për brenda territorit, por edhe më tej. Në prezencë të një kontrabandisti, doganierët kishin të drejtë, në rast sekuestroje të kripës së huaj, të shisnin jo vetëm kripën, po edhe mjetin me të cilin transportohej.

ardhurave shtetërore, po ashtu edhe cenimine rendit dhe sigurisë publike, ishte e domosdoshme që të ndiqej një politikë e rreptë për ndëshkimin e saj. Punonjësit e doganave gëzonin autoritetin t'i ndiqnin mashtruesit edhe jashtë territorit. Për këtë arsye, u vendosën kontrollorësi në vendet ku përpunohej kripa, ashtuedhe në magazinat ku rezervohej, me qëllim që të siguronin parandalimin e kontrabandës së kripës.

Sistemi i ndëshkimit sigurohej nga Ferma, veprim i cili është shoqëruar deri në ditët e sotmenga ekzistenca e konfuzionitmidis autoritetit ndjekës dhe autoritetit hetues në fushën e të drejtës penale doganore. Kështu, kur një kontrabandist arrestohej, sakaq vihej në dijeni “shefi i doganierëve” ose kapiteni i tyre, për të mbajtur procesverbalin e ndalimit dhe sekuestrimit të mallit. Më pas, kapiteni e çonte çështjen në gjykatë, e cila ishte një prerogativë ekskluzive e punonjësve të doganës. Tekstet parashikonin që malli i sekuestruar dhe primati i takonin personit që ndalonte mashtruesit.³⁷

Më pas, mundësia për ta çuar çështjen në gjykatë kaloi edhe rojeve, në mënyrë që të përshejtoheshin procedurat dhe të kishte efikasitet. Ata kishin privilegjin të vendosnin se cila gjykatë ishte kompetente për të shqyrtuar çështjen, duke u bazuar në rrethanat kohore dhe vendore. Nëpërmjet akordeve të kooperimit, limitet territoriale për të ndjekur mashtruesit, i kapërcyen kufijtë edhe përtej territoreve mbretërore. Në këtë epokë u ndërmoren gjithashtu masa për luftën kundër kontrabandës³⁸.

Në të vërtetë, në atë epokë, e drejta penale doganore i mundësonte doganës kompetenca të dyshimta dhe të rrezikshme. Vepra penale mund të konstatohej në çdo vend, privilegj i cili mandej u shndërrua në një kompetencë klasike: pra, “doganierët” kishin të drejtë të futeshin kudo, në çfarëdolloj ambienti, nëpër shtëpi, përfshirë këtu edhe ndërtesat e fisnikërisë dhe të klerikëve, pa qenë nevoja e paraqitjes së një imuniteti të çfarëdollojshëm. Këto kompetenca të jashtëzakonshme kishin si synimpërballimin e imagjinatës së kontrabandistëve. Megjithëse, kontrabanda kishte falsifikuesit e vetë, të cilët e shprehnin artin e tyre të falsifikimit të firmave, duke bërë pasaporta false, lejkalim fals apo masa false. Arrestimi mund të bëhej nga çdo person që konstatonte veprën penale. Më pas, personi i kapur i dorëzohej oficerit gjyqësor, i cili angazhonte

³⁷ Kuajt, karrocet dhe armët e sekuestruara, iu takojnë atyre që kanë kryer arrestin, por edhe të mirat materiale të personave të arrestuar i atribuohen kapësit n.q.s. kemi konfiskim juridik. Këta persona marrin gjithashtu një shpërblim, vlefta e të cilit përlllogaritet në bazë të gjobës që i vendoset mashtruesit.

³⁸ Për shembull, rastin e kripës e cila transportohej në fuçi, duke u mbuluar sipër me një copë të trashë për të mbrojtur ngarkesën, metodë që sot konkretizohet nga vula doganore. Vërejmë gjithashtu, se, në të njëjtën kohë, u përpilua një rregullore, e cila impononte mbajtjen e një dokumentacioni strikt. Lejet e lëshuara nga autoritet doganore luanin një rol shumë të rëndësishëm në luftën kundër kontrabandës, duke paraqitur mbiemrin e tregtarit, adresën e tij dhe çmimin e mallit. Vetëm duke paraqitur këto leje pranë rojeve ose kryetarëve të bashkive ku ata ushtronin aktivitetin e tyre, transportuesi mund të çlironte mjetin e transportit. Kur malli eksportohej, këto leje duhej të paraqiteshin tek oficeri i fshatit të fundit para kufirit dhe, në kthim, duhej t'i paraqiteshin guvernatorit të kripores, nga ku ishte bërë furnizimi, në të kundërt mund të merrej gjobë.

menjëherë procedurën, në mënyrë që të respektoheshin kësisoj të drejtat e atij që ishte ndaluar.

Sipas nenit 22 të Dekretit të 1733-it, në qoftë se gjatë ndjekjes personi vdes, personat që po e ndiqnin nuk ngarkohen me përgjegjësi³⁹.

Autoriteti doganor i asaj kohe kishte kompetenca të gjera edhe për personat, të cilët ishin kapur gjatë kontrolleve, por që kishin mundur të arratiseshin. Në këtë kuadër, këta persona, mund të dënoheshin nga gjykata vetëm në bazë të procesverbaleve të mbajtura nga doganieri, pa qenë nevoja që ata të ishin prezent në proces.

Vetëm personat që s'kishin njohurinë e mjaftueshme rreth procedurës, mund të kundërshtonin procesverbalin e punonjësve të Fermës, sipas procedurës së regjistrimit të rremë, regjimi i të cilit u fiksua nga Dekreti Mbretëror i vitit 1720, i cili pësoi një transformim në vitin 1754.

Afati për të ndërmarrë një procedurë për regjistrim të rremë ishte 3 ditë, ndërkohë që duhej të lihej si garanci edhe një shumë e caktuar. Nga momenti i regjistrimit, derisa gjykata të vendosë mbi vërtetësinë e çështjeskalon njëfarë kohe, çka paralizon aplikimin e dënimeve nga njëra anë, dhe, nga ana tjetër, i lejon kontrabandistët ta përdorin për të vonuar procedurat. Në vitin 1754, shuma që lihej si garanci u caktua e barasvlershme me shumën e gjobës që mund të jepej, gjë që ishte shumë bindëse. Për sa i përket provave gjegjëme fillesa të aplikimit të metodave moderne, që do të thotë se sasia dhe kualiteti i kripës së sekuestruar regjistrohej, madje dy mostra vendoseshin në një zarf të mbyllur me vulën e autoritetit doganor (Fermës) dhe i dërgoheshin sekretarisë së gjykatës që do shqyrtonte çështjen.

Një procesverbal nënshkruhej dhe i jepej personit që ishte në ndjekje penale. Në gjyq, gjyqtari kërkonte paraqitjen e palëve dhe ekspertëve, të cilët ishin pranuar nga palët. Këta të fundit analizonin mostrat e kripës dhe mbanin një raport për cilësinë e kripës, duke verifikuar imtësisht nëse malli kishte ardhur nga jashtë apo jo. Në Dekretin Mbretëror të 1733-it thuhej, se vendimi duhej të jepej “brenda 24 orëve mbas marrjes në hetim të procedurës”⁴⁰. I dënuari kishte një muaj kohë për të paguar shumën e gjobës, për të cilën ishte dënuar tashmë. Në qoftë se paguante, çështja mbyllej, në të kundërt, dënimi mund të konvertohej me dëbim apo dërgim të detyrueshëm në anije për të kryer punë të rëndomta në favor të shtetit, kjo për një periudhë kohore të caktuar ose përgjithnjë. Apeli nuk kishte efekt pezullues, pra i dënuari ose duhej të paguante gjobat, ose duhej

³⁹ Sipas nenit 22 të Dekretit të 1733-it: “Nuk do ketë ndjekje penale kundër atyre që kanë vrarë tregtarë mashtrues, të cilët po i rezistonin ndjekjes duke u imponuar në këtë mënyrë heshtjen prokurorëve”.

⁴⁰ Neni 29 i Dekretit Mbretëror të vitit 1733.

të dorëzonte mallin për të cilin u dënua, po ashtu një person i tretë mund të merrej për garant.

Dënimet ishin të rënda dhe të ashpra; shpeshherë konsistonin në gjoba, konfiskim të mallit, po ashtu dhe mjeteve të transportit. Sipas rëndësisë së veprës penale gjoba varionte në varësi të shkallës së kontrabandës, po ashtu mund të kishte edhe ndëshkime trupore. Duke nisur nga viti 1756, të dënuarit mund ta paguanin gjobën e tyre në çdo moment, ose mbas vendimit, por edhe përgjatë kohës që ata vuanin dënimin. Aksh mënyrë ishte një lloj transaksioni, i cili shuante dënimin.⁴¹ Ndërkohë që nga këto të ardhura mbulonin shpërblimet për doganierët (anëtarët e Fermës).

Dogana nuk kishte vetëm funksione administrative dhe fiskale, përkundrazi ajo mbartte edhe kompetenca që shërbenin për të ruajtur rendin publik duke ndëshkuar kundërvajtësit. Misionet e rendit publik që mbartte dogana po bëheshin çdo ditë e më shumë të rëndësishme, ndaj doganierët me uniformë, tashmë relativisht më shumë se doganierët menaxhues, shoqëroheshin herë pas here nga forcat ushtarake. Krijimi i sanksioneve gjyqësore dhe rreptësia e tyre sollën një ndjenjë persekutimi në popull. Raportet e autoriteteve publike dhe Fletoret e Ankimeve⁴² propozonin më shumë masa për taksën e kripës, veprim i cili pretendonte se mund të ulte kontrabandën. Në këtë pikëpamje ishte e nevojshme të studioheshin shkaqet e kontrabandës, d.m.th. ekzistenca e taksave shumë të larta dhe menaxhimi i administratës, në mënyrë që të thjeshtonte vjeljen e tyre dhe jo të shtoheshin kompetencat policore të administratës doganore⁴³. Megjithatë, nuk duhet të shpërfillim assesin anën tjetër të doganës, atë të

⁴¹ Efikasiteti i ndëshkimeve, si rezultat i një procedure ekspeditive, po ashtu edhe fuqizimi i tij, si rezultat i shumimit të veprave penale, sollën që populli të ishte i pakënaqur nga Ferma dhe sistemi doganor. Pakënaqësia ndaj taksës së kripës, taksë shumë e lartë për një produkt të rëndësishëm së parë, por që i siguronte shumë të ardhura thesarit publik, do të çojnë në heqjen e saj përgjatë Revolucionit Francez.

⁴² Fletoret e Ankimeve - Në regjimin e vjetër, gjatë mbledhjeve të Asambleve, të cilat kishin si qëllim zgjedhjen e deputetëve të ardhshëm, secili prej anëtarëve kishte në dispozicion këto dokumente, në të cilat shënonin ankesat e popullit ndaj administratës mbretërore.

⁴³ Por, nga ana tjetër, sistemi i Fermës furnizonte buxhetin e shtetit me të ardhura në rritje, të cilat falë rritjeve të taksave kompensonte deficitin që ekzistonte në financat mbretërore. Përveç kësaj, kemi edhe një diferencim ndërmjet provincave dhe klasave sociale, gjë që çoi në kryengritje të fshatrave në korrik dhe gusht të vitit 1789. Taksat e kripës u hoq në vitin 1790. Të këqijat e taksave doganore do të denoncoheshin edhe nga filozofët e kohës. Kështu Volteri do të denoncojë efektet perverse të Dekretit të quajtur “tarifa” të Mazarinit, i cili kishte rritur taksat mbi importin e të mirave materiale dhe mallrave ushqimore. Dekreti i “tarifës”, vendosur nga një pakicë mbretërore, shkaktoi revoltë në gjykatat, çka shkaktoi luftën e pakuptimtë të Frondës⁴³ ose të paguhej 1000 herë më shumë për luftën civile, që tarifa nuk do kishte kushtuar kurrë. Përgjatë shekullit XVIII u zhvillua një debat në rangjet e elitës së kohës, si pasojë e teoritë ekonomike zunë një vend shumë të rëndësishëm. Fiziokratët u bënë avokatë për liri tregu. Ndërmjet tyre kishte dhe persona që ishin drejtues në poste të rëndësishme. Heqja e pengesave të brendshme, transferimi i zyrave doganore vetëm në kufijtë e mbretërisë, krijimi i një tarife doganore unike ishin objektivat që synonin këta drejtues, por që s’i arritën dot, pasi militantët e regjimit ishin ende të shumtë. Montesquieu në librin e tij “Shpirti i ligjit” përkulo-

mbrojtjes së kufijve për të mos lejuar hyrjen e mallrave brenda territorit, mallra të cilat vijnë nga shtete armike, duke i dhënë kështu një rol nxitës në luftën kundër kombeve.

Gradualisht po punohej për modernizimin e administratës doganore, ku elementi më i spikatur në këtë drejtim ishte kodifikimi i rregullave doganore. Për këtë qëllim, më 22 gusht 1791, u hartua ligj doganor, nëpërmjet të cilit u përcaktuan disa parime të rëndësishme në fushën e luftës kundër kontrabandës. Kështu, mes të tjerash vlen të theksojmë kërkesën, që, në rast se deklarimi rezultonte i rremë, atëherë malli konfiskohej si objekt kontrabande, madje zbatohej edhe një gjobë. Në rast konfiskimi të mallit të ndaluar, njëherazi konfiskohej edhe mjetii transportit me të cilin ai transportohej.

Përveç këtyre prioriteteve, doganës iu akorduan edhe kompetenca të gjera në fushën e sekuestrimit dhe të ndjekjes penale. Personi që transportonte mallin gjatë operacionit të sekuestrimit ishte i detyruar të asistonte në përshkrimin e mallit, si dhe në redaktimin e procesverbalit. Po ashtu, ai duhej të nënshkruante procesverbalin dhe, në qoftë se refuzonte, kjo gjë shënohej në procesverbal, kërkesë e cila vazhdon të ruhet edhe sot. Procesverbali dhe detyrimi për t'u paraqitur në gjykatë i njoftohet me anë të përmbaruesit, në adresën e deklaruar, brenda 24 orëve.

Bashkëpunimi në luftën kundër kontrabandës ndërmjet forcave policore, ushtarake dhe atyre doganore u forcua më shumë. Efikasiteti i dënimeve ishte i sigurt, pasi gjyqtari nuk mund ta moderonte gjobën e dhënë. Gjithashtu, nuk mund të bëhej kurrësi transaksion, në qoftë se kishim një vendim gjykatë të formës së prerë dhe në shkallë të fundit. Nga ana tjetër, transaksioni lejohej për vendimet dhe ishte një metodë efikase për të zgjidhur çështjet doganore.

Lufta kundër Anglisë nuk ishte vetëm një luftë ushtarake, por edhe ekonomike, gjë që u bë shkak për forcimin e goditjes së kontrabandës. Në 1806, perandori Napoleon nënshkroi "*bllokimin kontinental*", duke ndaluar hyrjen e anijeve angleze në portet evropiane, ashtu sikurse duke ndaluar të gjithë tregtarët francezë, por edhe tregtarë të shteteve të nënshtruara ose aleatëve, të bënin tregti me Anglinë. Që prej këtij momenti u vu re krijimi i një rrjeti të mrekullueshëm kontrabande.

Në fakt, në këtë periudhë kemi të bëjmë me një konsolidim të kompetencave të Doganës kundrejt kontrabandës së shkaktuar nga mosbalancimi ekonomik. Përveç mjeteve

fizon rolin e doganës në lidhje me tregtinë: "Aty ku ka tregti, ka dogana". Objekti i tregtisë është eksporti dhe importi i mallrave në favor të shtetit; dhe, objekti i doganës është vjelja e taksa e vendosur për këto importe apo eksporte, kjo gjithashtu në favor të shtetit. Shteti duhet të jetë asnjëherë ndërmjet tyre, pasi vetëm në këtë mënyrë mund të kemi liri tregu.

materiale, si dhe shtimit të numrit të personelit, bie në sy edhe përforsimi i mjeteve juridike. Kjo shpjegohet me faktin, se, nga njëra anë, u shtua numri i dënimeve që i aplikoheshin kontrabandës dhe, nga ana tjetër, mori hov shkarkimi i gjykatave të zakonshme në interes të gjykatave speciale të krijuara në fushën e të drejtës penale doganore⁴⁴. Ligji parashikonte gjithashtu dënime të reja. Nuk lejohej më transaksioni për vepra penale të një rrezikshmërie të veçantë. Masa juridike të jashtëzakonshme u ndërmoren edhe për sa i përket konstatimit të veprës doganore dhe procedurës, duke sjellë në këtë mënyrë daljen e të drejtës doganore nga sfera e të drejtës së zakonshme.

Në vitet 1810-1813 Napoleoni okupoi jo vetëm Ticinon me trupat e tij ushtarake, por edhe funksionarët doganierë të Mbretërisë së Italisë, me qëllimin e vetëm për të luftuar kontrabandën. Në zonat kufitare, bllokada kontinentale dhe luftërat revolucionare sollën një limitim të qarkullimit ilegal të mallrave, të cilat, megjithatë, përjetuan një ringjallje në vitet 1820 – 1830.

Në 1825 u redaktuan për herë të parë statistikat e tregtisë ndërkombëtare. Gjatë epokës së Perandorisë së Dytë ra në sy vullneti për ekonomi tregu, gjë që solli zbutje të prerogativave të administratës doganore dhe uljen e kontrabandës, megjithëse kjo e fundit e rikuperoi përgjatë Republikës III, kohë kur patëm një rikthim të Proteksionizmit.

Veçanërisht nga fundi i shekullit XIX, shkeljet e barrierave doganore u bënë pengesë për përmbylljen e marrëveshjeve të ndryshme midis vendeve fqinje, si Italia në 1878, kur kjo e fundit pretendonte nga Këshilli Federal një marrëveshje karteli për tarifatat doganore.

- ***Në Itali***

Në Itali, nisur nga shek. XVI, tregtarët që operonin brenda për brenda territorit kombëtar filluan ta praktikonin në një shkallë të gjerë kontrabandën (si, për shembull, grurin dhe tekstilet) dhe gjithçka për t'iu shmangur pagesës së detyrimeve dhe tarifave doganore. Dispozitat e para, të aplikuara në Italinë e Bashkuar, ishin të përfshira në Rregulloren Doganore shpallur me Dekret Mbretëror më 4 qershor 1816, një legjislacion i ri, i inspiruar nga koncepte dhe principe që praktikisht mbetën të njëjta, u miratua më 21 dhjetor 1862. Teksti Unik 8 Shtator 1889, 6387 ishte vazhdim i legjislacionit të shekullit XIX (1867) dhe pas Luftës së Parë Botërore, kjo e fundit iu nënshtroi ndryshimeve thelbësore, sidomos në pjesën penale, me Ligjin 1424, më 25 shtator 1940.

- ***Në SHBA***

⁴⁴ Me dekret të datës 18 tetor 1810, u krijua Gjykata e Specializuar për të trajtuar çështjet që kishin të bënin me kontrabandën.

Gjatë Luftës Civile Amerikane, sklleverit e Konfederatës, të cilët kërkonin strehim në kampet ushtarake të Bashkimit ose që jetonin në territore, të cilat ishin nën kontrollin e Bashkimit, u deklaruan “Kontrabandë e Luftës”. Fillimisht, kjo politikë u praktikua nga Gjenerali Benjamin F. Butler në 1861-n, dhe u njoh përgjithësisht si “*Doktrina e Fort Monroe*” e themeluar në Hampton, Virginia. Në përfundim të luftës, Unioni-Bashkimi kishte ngritur 100 kampe kontrabandë në Jug dhe Kolonia e Njerëzve të Lirë të Roanoke (1863–1867) u zhvillua aq shumë, sa që arriti të ishte një koloni që vetëfinancohej⁴⁵. Njerëzit e lirë të kolonisë punonin me rrogë për Shoqatën e Misionarëve Amerikanë, madje, me kalimin e kohës, me mijëra njerëz të lirë u rekrutuan nga kampe të tilla në Trupat me Ngjyrë të Shteteve të Bashkuara për të luftuar kundër Konfederatës⁴⁶.

- *Deri në fund të shekullit XX*

Gjatë shekullit XX shohim një interesim në rritje për të bashkëpunuar në luftën kundër kontrabandimit të mallrave të ndaluar në kohë lufte. Traktate të shumta, të cilat përcaktonin kontrabandën dhe luftën kundrejt saj, u nënshkruan mes shteteve. Megjithatë, në kohë lufte, shtetet e përfshira, në mënyrë indirekte shkelën këto marrëveshje, duke i formuluar përkufizimet e tyre sipas fateve të luftës. Deklarata e Londrës, hartuar në Konferencën Detare të Londrës në 1908–1909, filloi të bëhej pjesërisht aktive nga shumica e shteteve detare në Evropë, vetëm pak kohë përpara fillimit të Luftës së Parë Botërore. Kjo deklaratë përcaktonte klasifikime gjithëpërfshirëse për kontrabandën absolute dhe të kushtëzuar. Gjatë Luftës, lista e artikujve në çdo kategori, të përcaktuar nga deklaratat, u rishikua në mënyrë të vazhdueshme nga Fuqi Ndërluftuese të ndryshme, pavarësisht protestave të vazhdueshme të fuqive neutrale të angazhuara në transport. Nga viti 1916, lista e kontrabandës së kushtëzuar përfshinte praktikisht të gjitha ngarkesat detare. Në këto kushte, gjatë zhvillimit të Luftës së Parë Botërore, thuajse të gjitha ngarkesat tranzit drejt një kombi armik, trajtoheshin si kontrabandë lufte nga fuqitë kundërshtarë, pavarësisht natyrës së ngarkesës. Një politikë e ngjashme u zhvillua nga Fuqitë Ndërluftuese në fillim të Luftës së Dytë Botërore.

Sipas të Drejtës Ndërkombëtare, shtetasit e kombeve neutrale kanë të drejtë të tregtojnë, duke marrë përgjegjësinë e rreziqeve, me ndonjë apo të gjitha Fuqitë Ndërluftuese pjesëmarrëse në luftë. Mbi qeveritë e vendeve neutrale nuk u vendos asnjë detyrim, për të konfiskuar tregtinë e kontrabandës, megjithëse këto qeveri nuk kishin të drejtë të ndërhyjnë në emër të qytetarëve të saj, nëse prona e tyre ishte konfiskuar nga fuqitë e përfshira në luftë, në momentin e shkëmbimit me një shtet tjetër. Penaliteti tradicional i

⁴⁵ “The Roanoke Island Freedmen's Colony”, provided by National Park Service, at North Carolina Digital History: LEARN NC, accessed 11 November 2010.

⁴⁶ Për më shumë informacion lidhur me kontrabandën shiko “*Northern Visions of Race and Reform*” www.historymatters.gmu.edu/d/8119/.

vendosur nga Fuqitë Ndërluftuese mbi ngarkesa të përfshira në trafikun e mallrave me armikun qëndronte në konfiskimin e ngarkesës. Kjo veprimtari u zgjerua duke përfshirë dënimin e anijeve transportuese, ku më shumë se gjysma e ngarkesave rezultoi në kontrabandë. E drejta e kombeve ndërluftuese për të fundosur anijet neutrale të transportit të kontrabandës nuk njihet nga e Drejta Ndërkombëtare, por kjo praktikë u nis nga Gjermania në Luftën e Parë Botërore dhe u rimor shpesh dhe nga Fuqitë e Boshtit gjatë Luftës së Dytë Botërore.

Megjithëkëtë, kontrabanda ushtrohej nga të gjitha shtetet, duke u shndërruar në një instrument të politikave nacionale, siç ishte rasti i Anglisë kundër Spanjës dhe Francës⁴⁷, për të tërhequr vëmendjen se gjoja në shtetet neutrale konsiderohej si dukuri normale kontrabandimi i produkteve ushqimore, madje gjente përkrahje edhe nga organet e pushtetit lokal. Në varësi të çmimit dhe kërkesës, deri në mesin e shekullit XX, të mirat më të kontrabanduara ishin përgjithësisht artikuj me përdorim të përditshëm, si vaj, sheqer, kripë, por dhe cigare e alkool. Kështu, gjatë luftës, kryesisht rreth viteve 1943-1944, pavarësisht forcimit të ruajtjes së kufijve nga ana e rojeve kufitare, në Zvicër kontrabandoheshin kryesisht mallra ushqimore dhe veshmbathje. Kontrabanda zinte në njëfarë mënyre vendin e parë për përmbushjene nevojave kryesore të popullit vendas dhe përfaqësohej nga disa familje, në të dy anët e kufirit, si burim i të ardhurave të pazëvendësueshme. Të gjitha regjionet e Zvicrës u prekën nga ky fenomen, edhe pse në modele dhe shkallë të ndryshme⁴⁸.

- ***Në vitet pas Luftës II Botërore***

Në fillim me GATT, sot OBT-ja dhe, më vonë, OBT-ja dhe Bashkimi Evropian në 1993, përpjekjet për të ndërkombëtarizuar luftën kundër kontrabandës u rritën ndjeshëm krahas adoptimit të një Kodi Doganor Komunitar. Megjithatë, pavarësisht nga suksesi i ratifikimit të një sërë konventave të luftës kundër kontrabandës, si Konventa e Nairobit,

⁴⁷Smuggling has been carried on in nearly all nations and has occasionally been adopted as an instrument of national policy, as by Great Britain against Spain and France in the 18th and 19th.

⁴⁸ Në Ticino dhe në Grigioni, pjesërisht deri në vitet 1990–2000, kontrabanda zhvillohej me konsensusin e komandave të rojeve kufitare. Që nga Lufta e Dytë Botërore, ky fenomen ka investuar në sektorë të rinj ekonomikë. Në fillim të shekullit të 21-të, përmirësimi i transportit dhe i teknologjisë u ka lejuar kontrabandistëve të jenë botërisht aktivë dhe jo vetëm në zona të caktuara, duke operuar që nga Zvicra, e cila ka zënë vendin e parë për trafikun e drogës, cigareve, armëve, parave dhe veprave të artit. Më shumë shiko:

- M. Polli, *Zollpolitik und illegaler Handel*, 1989.

- A. Megevand Rakotobarison, «*La contrebande dans le Département du Léman*», 1798-1813, mem. lic. Ginevra, 1990.

- «Das Grenzwachtkorps 1894-1994», in *Rivista delle dogane*, 39, 1994, n. 2 (n. speciale).

- A. Ferrer «Les contrebandiers sur la frontière franco-suisse au XVIII^e siècle», in *RSS*, 49, 1999, 35-46

- M. Kuder «Sigarette, orologi e caffè: le esportazioni di contrabbando dalla Svizzera all'Italia dal 1945 al 1970», in *AST*, 149, 2011, 3-18

Konventa e Kiotos, në stadin aktual, e Drejta Penale Doganore ngelet një “ishull kombëtar”. Edhe pse, shpeshherë, Komisioni Evropian⁴⁹ ka tentuar të marrë një vizion komunitarpër sa i përket çështjes lidhur me shtetet që kishin të bënin drejtpërsëdrejti me veprën penale të kontrabandës, litigacionet doganore ngelen ende jashtë harmonizimit evropian, për rrjedhojë pavarësisht nga unifikimi i procedurave doganore, të drejtave dhe detyrimeve të operatorëve ekonomikë gjatë import/eksportit, por edhe tranzitimit përmes KMD-së, legjislacioni i ndjekjes penale, klasifikimi i veprave penale të kontrabandës apo sanksionet doganore, vazhdojnë të jenë të karakterit kombëtar. Për shkelje doganore të njëjta, mund të kemi klasifikime të veprave penale të ndryshme, ndërkohë që për dy vepra penale të njëjta mund të kemi dënime të ndryshme, në qoftë se kryen në shtete të ndryshme⁵⁰.

Megjithatë, ajo që dëshiroj të sjellë në vëmendjen Tuaj është se Gjykata e BE-së, duke e parë nga këndvështrimi i KDNJ-sëi ka detyruar shtetet evropiane të respektojnë parimet e përgjithshme, si p.sh. parimine proporcionalitetit të sanksioneve, gjë që lehtëson edhe veprimtarinë e administratës, prokurorisë dhe gjykatësjo vetëm në klasifikimin e veprave penale të kontrabandës, por edhe në zbatimin e sanksioneve ndaj personave fajtorë.

Në bazë të sëdrejtës doganore edhe shkelja më e vogël ndëshkohet. Nga këndvështrimi i aplikimit të sanksioneve e drejta doganore nuk bën dallim ndërmjet veprimeve (kriminale) që meritojnë një kualifikim penal dhe gabimeve apo parregullsive, pakujdesive që vijnë nga ana fiskale, megjithëse përfshihet edhe një ndarjepër kundërvajtjen dhe kontrabandën.

Studiues të fushës doganore kanë arritur në përfundimin se si doktrina, ashtu edhe jurisprudenca të drejtën penale doganore e kanë cilësuar si një e drejtë e veçantë. Gjykatat Penale, po ashtu edhe Gjykata Kushtetuese, kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në evoluimin e kësaj të drejte speciale. Mirëpo, faktori kryesor i evoluimit të së drejtës penale doganore qëndron tek e drejta konvencionale evropiane dhe, në veçanti, tek vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sepse ushtron influencë në të drejtën doganore dhe në të gjithë drejtësinë penale në përgjithësi⁵¹. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut i dha mundësinë një individi ta çonte çështjen para një gjykatësi, ndryshe nga ai kombëtar. Gjykata, duke u angazhuar në një kontroll të përputhshmërisë të së drejtës doganore me të drejtë konvencionale, ka

⁴⁹ Kodi Doganor Komunitar, *Rregullorja* Nr.2913/92 *Community Customs Code*(CCC)

⁵⁰ Disa shtete, përfshirë edhe Franca, u japin trajtim penal të gjitha shkeljeve që i bëhen legjislacionit doganor, të cilat kanë natyrë penale.

⁵¹ M. Delmas-Marty... “Materia penale sipas GJEDNJ-së, mjegullimi i të drejtës penale”, Rev. shk. krim. 1987 fq. 819.

kontribuar në qasjen e këtyre parimeve me të drejtën evropiane⁵². Aktualisht përpjekjet jo pa rezultat janë përqendruar në unifikimin e të drejtës doganore të vendeve komunitare dhe atyre që aspirojnë për t'u anëtarësuar në këtë bashkim.

2. Legjislacioni i luftës kundër kontrabandës në vendin tonë.

Në Shqipëri, krimet në fushën e kontrabandës kanë qenë të njohura dhe të rregulluara me akte normative që në kohën e Antikitetit. Gjithçka për faktin se Shqipëria ndodhej në udhëkryq me rrugët që lidhnin perandoritë e asaj kohe, si dhe ngaqë në territorin e saj qarkullonin mallra të ndryshme, si rrjedhojë zhvillohej një tregti e gjerë. Mallrat që importoheshin, po dhe ato që nuk ishin të lejuara, kanë qenë të përcaktuara që në Kodeksin dhe shkrime të ndryshme të Justinianit.

Nga Mesjeta e në vijim, konstatojmë shumë marrëveshje jo vetëm për përjashtimin nga taksat të tregtarëve të huaj që eksportonin në Shqipëri, por edhe përjashtimin nga taksat për mallrat e tregtarëve shqiptarë që eksportonin mallra në vende të ndryshme⁵³. Në fund të shekullit XVII, me qëllim funksionimin normal të doganave, Ali Pasha nxori urdhra (bujurdi), që ndihmonin për të rregulluar importin, eksportin dhe tranzitin e mallrave, por parashikonin njëherazi edhe sanksione për personat që kryenin kontrabandë.

Gjithsesi, përgjatë gjithë kësaj periudhe, si burim bazëi dispozitave doganore, por edhe i dispozitave penale të luftës kundër kontrabandës, ka shërbyer legjislacioni doganor dhe legjislacioni penal i perandorisë turke. Detyrimi doganor në kohën e Sundimit Otoman quhej “*zeqatiashir*”. Nga tagra e vendosur mbi mallrat tregtare, 1/40 merrej nga tregtarët vendas, ndërsa 1/10 nga tregtarët e huaj, ndërkohë që ndahej në katër kategori: import, eksport, konsum dhe tranzit. Tagri doganor përllogaritej në bazë të vlerës doganore, *ad valore*⁵⁴. Qeveria e Ismail Qemalit nuk bëri ndryshime legjislative në fushën e doganave, që do të thotë se trashëgoi kryekëput ligjet turke për funksionimin e doganave dhe vendosjen e taksave doganore, me të vetmin ndryshim në ligj, rriti taksën importimit të duhanit në masën 30%.

2.1. Legjislacioni i luftës kundër kontrabandës gjatë periudhës së pushtimit të Shqipërisë nga fuqitë e huaja më 1916.

⁵²RIDEAU-VALENTINI S, «Contribution à l'étude des particularismes de la matière pénale douanière», thèse 1999.

⁵³ Vendimi i Senatit të Venedikut, dt. 26.01.1303, për tregtinë me Durrësin, Beratin, Vlorën dhe Këlcyrën, i cili përcaktonte masa dënimi për shkak të shkeljeve në rast të ndalimeve të vendosura.

⁵⁴ “Historia e Doganave”. J. Janao.- 2002

Për herë të parë pas krijimit të shtetit shqiptar, më të specifikuar, dispozitat që kishin të bënin me veprën e kontrabandës, i gjejmë në aktet e nxjerra nga Komanda Austro-Hungareze në Shkodër, ku, me anë të një vendimi me 8 nene përcaktoheshin veprat penale të kontrabandës, sipas të cilit me kontrabandë nënkuptohej çdo gjë që i shkaktonte dëm thesarit të shtetit ose popullit, domethënë: *“Importimi ose eksportimi i mallrave të ndaluara kategorikisht me urdhër të posaçëm të Kryekomandës”*⁵⁵, ndërkohë që përcaktohej gjithashtu si kontrabandë edhe *“Importimi dhe eksportimi i mallrave, që realizohen përmes rrugëve ku nuk lejohet kalimi”*.

Siç shihet, ligji i kohës i siguronte mbrojtje të veçantë disa artikujve, të cilët konsideroheshin jetikë dhe të domosdoshëm për vetë kushtet e vështira të luftës, për garantimin e jetesës së popullatës, por edhe të bazës ushqimore të ushtrisë Austro-Hungareze. Kontrabanda ndahej në dy forma, që sot, sipas dispozitave të Kodit Penal, mund të konvertohet, si kontrabandë me mallrat e ndaluar (neni 171) apo ndonjë nga format e tjera (neni 172, 173, apo 174).⁵⁶

Më datën 28. 05.1926, u miratua ligjipër dënimin dhe gjobitjen e kontrabandistëve dhe mallrave të monopolizuar. Në këtë ligj sanksionohet, se: *“Quket kontrabandë edhe çdo sasi e vogël e sendeve që kanë cilësi të mallrave të monopolizuar, kudo që të gjenden dhe të kapen”*. Vërehet se masat ndëshkimore që parashikohen në këtë ligj janë tejet të rëndësishme (më shumë se sa lloji i kontrabandës që parashikohet në këtë ligj). Ato arrijnë në dënim me gjobë sa 5-shi i vlerës së mallit të futur kontrabandë, ose mund të arrijnë deri në dënim me burg, përveç gjobës, deri në një muaj e tre ditë.

Të tërheqë vëmendjen fakti që ende sot gjykatat nuk japin dy dënime kryesore njëherësh, ndërkohë që për krimet me pasojë të rënda financiare për shtetin legjislativi penal e parashikon një gjë të tillë. Në këtë ligj i rëndësishëm është dhe parashikimi i faktit, se, në rast se gjoba nuk paguhej, atëherë konvertohej me burg, por jo më shumë se 3 vjet. Gjithashtu në nenin 8 përcaktohej se:

“Personave që lajmërojnë kontrabandën, kur autorët e saj nuk janë në gjendje të paguajnë gjobën e caktuar dhe e shlyejnë këtë me burgim, u jepet si shpërblim 20% e masës që do të merret. Pra, nga ky 20 për qind, 1/3 i jepet lajmëtarëve dhe 2/3 atyre që i kanë zënë. Kur nuk ka lajmëtarë, shpërblimi u jepet personave që kanë kapur kontrabandën”.

⁵⁵ Mallrat e ndaluar për eksport ishin qetë, delet, qengjat, dhitë, kuajt, mushkat, derrat, pulat, lepujt e gjallë ose të therur, lëkurët e qeve, të buallicave, të demave, të deleve dhe të dhive, leshi dhe qimet e kuajve, të lopëve dhe të dhive, vaji i ullirit, duhani, gruri, misri, elbi e tërshëra. Ndërsa si mallra të ndaluar për import dhe eksport, të cilat konsideroheshin monopol dhe ndaloheshin në tregti ishin: kripa, sheqeri, vajguri, shkrepsët, etj.

⁵⁶ Kodi Penal, neni 171-174.

Në këtë mënyrë, ashtu sikurse edhe legjislacioni doganor i vendeve të tjera të asaj kohe, për të rritur efikasitetin e luftës kundër kontrabandës, ligjvënësi e stimulon nëpërmjet shpërblimeve pasurore (të cilat kapin nivele të larta), luftën kundër shkelësve të ligjit, duke rritur motivimin e personave të cilët në një formë apo një tjetër kontribuojnë në këtë luftë.⁵⁷

Si rrjedhojë, ligji më i rëndësishëm në lidhje me kontrabandën në atë periudhë kohore ishte Ligji mbi Ndalimin e Kontrabandës, i datës 17.06.1928. Në përbërje të këtij ligji do të gjejmë njëherazi edhe përkufizimin e saktë dhe të plotë të kontrabandës. Fillimisht, ligji sqaron shumë qartë detyrimin e çdo personi që transporton mallra që i nënshtrohen detyrimeve doganore, për t'i paraqitur ato në zyrën e doganës. Në vijim, përkufizohet qartazi kontrabanda si vepër penale, format dhe mënyrat e realizimit të kontrabandës⁵⁸. Më pas, ligji përcakton seksionet për kontrabandën, të cilat konsistojnë kryesisht me dënim me gjobë sa 3-shi i taksës doganore të shmangur, si dhe gjoba të tjera fikse. Për më tepër, në këtë ligj parashikohet edhe kontrabanda e kryer nga punonjësit e shtetit, si dhe përsëritja si rrethanë cilësuese, madje në një prej neneve konstatojmë edhe dënimin penal për personat që kryejnë kontrabandë⁵⁹.

Është për t'u theksuar fakti se dënimet qëparashtronte ligji për punonjësit shtetërorë ishin shumë më të ashpra sesa dënimet për shkelësit e tjerë. Në këtë pikë mund të bëjmë një paralelizëm me Kodin Penal në fuqi, i cili, gjithashtu, për kontrabandën e kryer nga punonjës të doganave parashikon dënimet maksimale dhe vetëm me burg, krahasuar me dispozitat e tjera për kontrabandën.

Sipas ligjit të vitit 1928, punonjësit shtetërorë, përveç dënimet me burgim, humbnin automatikisht të drejtën për të punuar më pas në një detyrë shtetërore. Gjithashtu, ky ligj parashikonte dhe konvertimin e dënimet me gjobë në burgim⁶⁰.

⁵⁷Kodi Doganor i sotëm, në nenin 15 të tij "Administrimi i të ardhurave dhe shpërblimet", parashikon pikërisht një gjë të tillë.

⁵⁸Kështu me kontrabandë do të kuptohet:

- Importimi i mallrave të ndaluar ose monopol, ose i mallrave të tjera për import, eksport, tranzit, transportim jashtë vendeve doganore.
- Fshehja e mallit.
- Mospagimi i taksave doganore, duke i paraqitur mallrat për nevoja vetjake apo private.
- Ndryshim i cilësisë së mallit.
- Mosdeklarimi i saktë i mallit në doganë.

⁵⁹Neni 18 i ligjit parashikon: "Personat të cilët veprojnë direkt, si dhe ndihmësit e tyre, në qoftë se janë nëpunës civilë, ushtarakë ose persona të tjerë që paguhen nga arka e shtetit ose e bashkive, dënohen me 2-4 vjet burgim, si dhe me largim të përjetshëm nga shërbimi shtetëror apo komunal".

⁶⁰Po aty.

2.2. Kodi Doganor i vitit 1938

Në vitin 1938, hyri në fuqi Kodi Doganor i Mbretërisë Shqiptare, i cili formonte një ligj të plotë lidhur me normat juridike, që rregullonin procedurat e importit, eksportit dhe tranzitit të mallrave. Ndërkohë që në një kapitull më vete përcaktoheshin shkeljet doganore, kundërvajtjet doganore, si dhe kontrabanda. Në brendësi të tyre jepej një përshkrim i plotë i nocionit të kontrabandës, duke mos u konsideruar (deliktet) si krim. Objekt i këtij delikti konsideroheshin marrëdhëniet juridike për mbrojtjen e tregtisë dhe sigurisë së shtetit. Ndërsa, nga ana objektive, konsideroheshin si veprime të kundërligjshme për kalimin e kufirit: tokësor dhe detar. Dënimi për kontrabandë përfshinte ndëshkimin me gjobë apo burgim dhe konfiskim të mallit.

2.3. Legjislacioni doganor dhe penal në vitet 1944 -1992.

Deri në vitin 1952, lidhur me veprat penale të kontrabandës, për sa u përket shkeljeve, është zbatuar kryesisht Kodi Doganor i Mbretërisë. Në vitin 1952, veprat penale të kontrabandës u përfshinë në legjislacionin penal. Kodi Penal i vitit 1952⁶¹, e parashikonte kontrabandën në një nen të vetëm, neni 91. Në fakt, kjo dispozitë shprehte sanksionimin e nenit 7 në Kushtetutën e asaj kohe, që kishte të bënte me tregtinë e jashtme që konsiderohej si monopol i shtetit.

Nëse i referohemi nenit 91, konstatojmë se një nen i vetëm parashikonte katër figura të krimit të kontrabandës:

- të thjeshtë
- të cilësuar
- në rrethana rënduese
- në raste veçanërisht të rënda⁶²

⁶¹Rëndësi të veçantë paraqesin: Kodi Penal i vitit 1952, Kodi Doganor i vitit 1956, Dekreti Nr. 4748, datë 30.09.1970 “Mbi doganat” VKM Nr. 212, datë 08.07.1976 “Mbi sjelljen dhe dërgimin e sendeve dhe mbi tagrin doganor”, Kodi Penal i vitit 1977, Kodi Doganor i vitit 1992, i cili, në fakt, zëvendësoi Dekretin “Mbi doganat”, por që deri në miratimin e Kodit të Ri Penal të vitit 1995, u zbatua në bazë të Kodit Penal të vitit 1977 dhe Kodi Doganor i vitit 1999. Me analizimin e Kodit Doganor të vitit 1999 dhe të Kodit Penal 1995 do të ndalemi gjerësisht në krerët në vijim.

⁶² Sipas paragrafit të parë të nenit 91, kontrabanda e thjeshtë qëndronte në kalimin e më shumë se një herë të mallrave, vlerave dhe sendeve, në mënyrat si më poshtë :

- a. Fshehja ose vënia në qarkullim e sendeve, që kanë kaluar kufirin pa kaluar nëpërmjet kontrollit doganor.
- b. Shitja pa lejen përkatëse e sendeve të importuara pa taksën doganore.
- c. Shitja sistematike pa lejen përkatëse e sendeve të importuara prej udhëtarëve pa taksën doganore.
- d. Shitja e mallrave të dërguara nga jashtë me postë pa lejen e shitjes.

- *Sanksionet*

Për kontrabandën e thjeshtë dënimet varionin deri në 5 vjet burgim, ndërsa për kontrabandën e cilësuar parashikohej dënimi me burg 10 vjet dhe në kushte tepër të rënduara edhe me vdekje. Përveç këtij dënimi, malli mund të konfiskohej ose jo si objekt kontrabandë. Pavarësisht nga dënimi penal njëherazijepej edhe dënimi administrativ.

Në këtë kuadër, me kontrabandë nënkuptohet kalimi i mallrave, vlerave dhe sendeve të tjera fshehurazi nga kontrolli doganor. Me shprehjen “*fshehurazi nga kontrolli doganor*”, nënkuptohejjo vetëm kalimi i mallrave jashtë pikave të kontrollit doganor, por edhe në pikat e kontrollit doganor, por duke i fshehur ato. Vlen të theksohet fakti se masat e dënimeve që parashikohen në këtë dispozitë, përshkallëzohen nga puna korrektuese, deri në dënim me vdekje. Kjo vërtetohet edhe një herë se për rendin juridik të asaj kohe, në procesin e formimit të shtetit dhe të ideologjisë së tij, kontrabanda konsiderohej një shkelje e rëndë dhe me rrezikshmëri të lartë shoqërore, që cenonte rëndë monopolin shtetëror të tregtisë dhe paraqiste rrezik real për parimet ideologjike. Në funksion të ekonomisë së centralizuar, një vend të rëndësishëm zinte vërtetimi i qëllimit për të fshehur mallrat nga kontrolli doganor dhe jo i qëllimit të posaçëm për t’u shmangur nga pagimi i tagrit doganor.

Në 1 Janar 1957, hyri në fuqi Ligji nr. 2361, datë 16.11.1956 “Mbi Kodin e Doganave”⁶³ Në kapitullin XIII, neni 91-106, jepetkuptimi i kontrabandës (*duke e ndarë në kontrabandë të thjeshtë, neni 91, dhe të cilësuar, neni 92*), mënyra se si do procedohej nga organet administrative, dënimet përkatëse administrative dhe penale që do merreshin.

-
- e. Mbajtja e çdo lloj malli valute dhe titulli të huaj në një rreze prej 15 km nga vija e kufirit, kur mbajtësi ose pronari i këtyre sendeve nuk provojnë se i posedojnë ato në mënyrë të ligjshme.
 - f. Mbajtja në një rreze prej 15 km nga vija e kufirit e mallrave të importuara që kapërcejnë normën e zakonshme për nevojat personale, kur mbajtësi nuk provon se i posedon ato në mënyrë të ligjshme.
 - g. Kryerja e çdo veprimi përgatitor, për shkeljen e dispozitave të parashikuara në këtë nen, paragrafi i dytë i këtij neni parashikon kontrabandën e cilësuar si më poshtë:
 - h. Importi dhe eksporti i mallrave nga vendet që nuk kanë doganë, me mjete të posaçme për këtë punë. Mjete të posaçme janë kafshët, mjetet e transportit, anijet, etj.
 - i. Fshehja e mallrave kontrabandë në vende të përgatitura posaçërisht për fshehjen e tyre. Mjete të përgatitura posaçërisht janë bodrumet e maskuara, gropat nën tokë, etj
 - j. Kryerja e veprimeve kontrabandë duke falsifikuar dokumentet doganore. Në këtë rast, falsifikimi i parashikuara nga neni 250 i këtij kodi nuk konkurron me kontrabandën.
 - k. Pjesëmarrja në organizata që merren me kontrabandë.
 - l. Kontrabanda e kryer nga persona të armatosur.
 - m. Kontrabanda e kryer nga punonjës doganorë dhe punonjës të tjerë zyrtarë.
 - n. Kontrabanda e sendeve plasëse, armëve e pajisjeve luftarake.

⁶³ Kodi i Doganave miratuar me ligjin nr. 2361, datë 16.11.1956.

(Për kundërvajtje parashikoheshin me gjobë deri 500 lekë, për ato më të rëndat deri 2.000 lekë, ndërsa për kontrabandën gjobë në masën e vlerës së sendit kontrabandë, konfiskimin e mallit dhe të mjetit, ose kundërvleftën). Bashkëngjitur me Kodin Doganor dhe për zbatimin sa më efikas të tij, ishin nxjerrë edhe rregulloret për kontrollin e mjeteve të transportit të mallrave, si dhe udhëzimet përkatëse. Në mënyrë të përmbledhur, kontrabanda e thjeshtë konsistonte në kalimin e mallrave pa paguar tagrin doganor jashtë pikave doganore ose duke iu fshehur kontrollit doganor, si dhe mbajtja ose tregtimi i tyre (në formatë ndryshme). Gjithashtu, konsiderohej kontrabandë e thjeshtë “kalimi i mallrave, megjithëse me leje dhe duke paguar tagrin doganor, nëse lidhej me eksportimin, transferimin apo dërgimin jashtë shtetit në rrugë të kundërligjshme të valutës, vleftës apo të hollave”(pika h, neni 91). Siç shihet, legjislatori i ka kushtuar një rëndësi tepër të veçantë garantimit të mosnxjerrjes së valutës jashtë vendit.

Për këtë arsye, si shkelje, kontrabanda e cilësuar konsiderohej vepër penale më e rëndë, sepse kërkonte jo vetëm mjete të posaçme për realizimin e saj, por kërkonte edhe kryerjen nga persona të armatosur ose organizata të posaçme, si dhe nga personeli doganor, madje herë-herë lidhej me mallra të veçantë, si armë eksplozive, materiale propagandistike, etj. Gjithashtu, quhej e cilësuar, kontrabanda e kryer më shumë se dy herë brenda një harku kohor trevjeçar, si dhe kontrabandë e kthyer në mjeshtëri, duke ruajtur, duke transportuar dhe duke tregtuar sende që janë objekt kontrabande.

Më vonë, pas viteve 70, rregullimi i marrëdhënieve doganore u bë me Dekretin nr. 4748, datë 30.9.1970, “Mbi doganat”⁶⁴. Në vitin 1973, Dekreti i mësipërm dhe, pikërisht, neni 15, që trajton kontrabandën, ndryshohet me Dekretin nr. 5126, datë 4.12.1973. Në thelb, nuk bëhen ndryshime në përshkrimin e kontrabandës.

⁶⁴ Dekreti nr. 4748, datë 30.9.1970 “Mbi doganat”. Neni 15 quan kontrabandë:

Kalimin e mallrave, të sendeve me vlerë dhe objekteve të tjera jashtë vendeve ku ka zyra doganore ose kalimi i tyre nëpërmjet zyrave doganore, duke iu shmangur kontrollit doganor.

Fshehja e sendeve që janë objekt kontrabandë, si dhe blerja ose shitja e tyre, kur dihet se janë të tilla.

Kalimi i mallrave nëpërmjet kufirit, megjithëse për to është paguar tagri doganor, në qoftë se këto janë blerë me vlera valutore ose të holla të kaluara, të transferuara ose të dërguara jashtë shtetit në mënyrë të kundërligjshme.

Kalimi i paligjshëm i mallrave nëpërmjet kufirit me mjete të posaçme të destinuara për këtë punë.

Kalimi i mallrave nëpërmjet kufirit, i sendeve me vlerë dhe objekteve të tjera, duke falsifikuar dokumentet doganore.

Kalimi i mallrave nëpërmjet kufirit, i sendeve me vlerë dhe objekteve të tjera, i kryer në bashkëpunim me dy ose më shumë persona, nga persona të armatosur ose në përpjesëtime të mëdha.

Kontrabanda e parashikuar nga germa “a” dhe “b”, kur kryhet për herë të parë, dënohet nga zyra e doganës me konfiskimin e sendeve të zëna kontrabandë dhe të mjeteve të transportit që kanë shërbyer për këtë qëllim, ose kur nuk është i mundur konfiskimi i sendeve, me nxjerrjen e vleftës së tyre. Ndërsa, për rastet e tjera, kontrabanda përbën krim dhe zyra doganore e dërgon çështjen për ndjekje penale.

Në vijim të këtij Dekreti, në vitin 1976, përmes një Vendimi të Këshillit të Ministrave nr. 212, datë 8.7.1976 “Mbi sjelljen dhe dërgimin e sendeve, si dhe mbi tagrin doganor”⁶⁵ parashikohen mallrat e ndaluara, që mund të jenë objekt i kontrabandës së mallrave, të tillë si valuta, metalet e çmuara, armët, narkotikët, apo sendet plasëse. Madje, në këtë kategori përfshihen edhe veshjet ekstravagante, sendet në kundërshtim me shijen e popullit, botimet pornografike, aparaturat për kapjen e stacioneve të huaja, automobilat, etj., duke e çuar në ekstrem konceptin e mallrave të ndaluar.⁶⁶

Ashtu sikurse Legjislacioni i vendeve të tjera të asaj periudhe, kontrabanda e kryer për herë të parë ishte prerogativë e autoritetit doganor dhe dënohej me gjobë. Kështu, në këtë shkronjë saktësohet, se: *“Kontrabanda e parashikuar nga germa a dhe b, kur kryhet për herë të parë, dënohet nga zyra e doganës me konfiskimin e sendeve të zëna kontrabandë dhe të mjeteve të transportit që kanë shërbyer për këtë qëllim, ose kur nuk është i mundshëm konfiskimi i sendeve me nxjerrjen e vleftës së tyre, ndërsa në rastet e tjera kontrabanda përbën krim dhe zyra doganore e dërgon çështjen për ndjekje penale”*.

Në këtë mënyrë, ligjvënësi ngushtonte sferën e veprës penale të kontrabandës, duke e përfshirë në shkelje administrative, kur ajo kryhej për herë të parë dhe, në rast përsëritjeje, mund të konsiderohej vepër penale (pikat c, ç, d, dh, sidhe a, b, në rast përsëritjeje) dhe t'i përcillej prokurorisë për ndjekje penale^{67/68}.

Gjithsesi, në kuptim të doktrinës penale, përcaktimi i mësipërm lidhur me kontrabandën e kryer për herë të parë, nuk duhet të konceptohet si një kundërvajtje, por kontrabandë. Si pasojë, i vetmi ndryshim konsiston në faktin që kjo vepër penale, për shkak të rrezikshmërisë dhe të lehtësisë në procedim, është menduar të jetë nën kompetencën e administratës doganore⁶⁹.

Në vitin 1977, krimet në fushën doganore përfshihen përfundimisht në ligjin doganor, ndërsa në Kodin Penal të vitit 1977, në nenin 72, gjendej një dispozitë e bardhë, qëi

⁶⁵“Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 212, datë 8.7.1976 “Mbi sjelljen dhe dërgimin e sendeve, si dhe mbi tagrin doganor”.

⁶⁶ Në nenin 63 jepet kuptimi i kontrabandës. “Me kontrabandë kuptohet fshehja e mallrave... moskalimi në rrugë ligjore nëpërmjet pikës së kalimit kufitar dhe zyrës doganore, ose kalimi nëpërmjet zyrave doganore jashtë kohës së punës. Çdo veprim ose falsifikim, i cili ka për objekt shmangien e kontrollit doganor të mallrave: blerja, shitja, marrja dhe dhënia dhuratë e mallrave, që dihet se janë mallra kontrabandë e të tjera. Pra, në pjesën e katërt të tij, nenet 62-72, parashikohen 11 dispozita mbi kundërvajtjet dhe kontrabandën.

⁶⁷Këtu duhet të mbahen parasysh edhe faktori determinues, ekonomia e centralizuar dhe për rrjedhojë kontrabanda kishte të bënte veçse me sende të kufizuara të importuara nga persona fizikë që kapërcenin kufirin e përcaktuar me VKM.

⁶⁸ Po aty, fq. 717.

⁶⁹Përafërsisht këtë kuptim ka edhe sot neni 291 i Kodit Doganor në fuqi, që ka përcaktuar se kontrabanda e kryer për herë të parë është prerogativë e doganës dhe dënohet prej saj.

referohej nenit 15, të Dekretit për Doganat. Sipas këtij neni, kontrabandë do të konsiderohej:

- Kalimi i mallrave jashtë vendeve ku ka zona doganore, ose duke i kaluar në zonat doganore, por duke ua fshehur autoriteteve përkatëse.
- Kalimi i mallrave nëpërmjet kufirit, por që janë blerë në valutë me të holla të kaluara, të transferuara ose të dërguara jashtë shtetit në mënyrë të kundërligjshme.

Në këtë akt ligjor vihet re se është ulur ndjeshëm jo vetëm niveli i dënimeve të parashikuara, por gjithashtu nuk janë parashikuar dënime plotësuese. Si dënim për kontrabandën parashikohej riedukimi nëpërmjet punës, ose burgim deri në 5 vjet. Ndërsa kur kjo veprë kryhej në përpjesëtime të mëdha ose në grupe të organizuara, dënimi arrinte me heqje lirie jo më pak se 5 vjet. Kjo edhe për faktin se në atë kohë kontrabanda kishte pak mundësi të realizohej, gjë që nuk mund të kishte vëmendjen e legjislatorit.

2.4. Kodi Doganor i vitit 1992⁷⁰

Ky kod, që në fakt zëvendësoi Dekretin “Mbi doganat”, përbën një aspekt të rëndësishëm të reformës legjislative në fushën e drejtësisë, për të mos thënë një përmbyse të plotë të legjislacionit doganor, si nga pikëpamja e formës, ashtu edhe nga pikëpamja e përmbajtjes. Në të u parashikuan institutet kryesore të së drejtës doganore të përafuara me ato të vendeve të BE-së. Gjithashtu, për shkelje të normave doganore parashikohen kundërvajtja dhe kontrabanda në një gjerësi të mjaftueshme për të goditur shkeljet e kësaj natyre.

Kodi Doganor ishte i ndarë në 4 pjesë me disa kapituj, që përfshinin 74 nene. Në pjesën e fundit, parashikohen shkeljet doganore, kundërvajtjet dhe kontrabanda, ndërsa dënimi penal, pavarësisht nga dënimi i dhënë nga administrata doganore, përcaktohet në shumëfishin e detyrimit doganor të shmangur. Që do të thotë, se:

- Kur shkelja doganore nuk përmbante të gjithë elementët e kontrabandës, si p.sh. dashjen në kryerjen e saj, shkelja konsiderohej kundërvajtje dhe ndiqej administrativisht.
- Kur shkelja i kishte të gjithë elementët e kërkuar dhe ky veprim kryhej më shumë se një herë, atëherë dënohej si administrativisht, ashtu edhe penalisht.

Ky akt, i pari në këtë fushë, pasqyrore absolutisht zhvillimet e reja ekonomike, politike dhe ideologjike të vendit. Që në nenin I, ky Kod parashikon se ka për qëllim “mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë që lidhen me importin, eksportin dhe tranzitin, me

⁷⁰ Ligji nr. 7599, datë 02.09.1992, ndryshuar me ligjin nr. 8020, datë 1.11.1995, ndryshuar me Dekretin nr. 1578, datë 13.08.1996 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

kalimin e kufirit dhe me qarkullimin e mallrave, me dërgesat postare ndërkombëtare dhe me personat fizikë dhe bagazhet e tyre”.

3. Misioni i shërbimit doganor dhe sfidat e shekullit XXI në luftën kundër kontrabandës.

Nëse i referohemi literaturës së fushës doganore, vërejmë se shërbimi doganor, pa dyshimin më të vogël, është administrata që mbart një karakter autonom shumë të konfirmuar. Në këtë aspekt, e pajisur me mjete të veçanta veprimi në rangun juridik, veçanërisht për sa i përket kompetencave represive që ajo gëzon, si dhe sanksioneve që aplikon kundër mashtruesve dhe kontrabandistëve, në mëvetësinë e saj përfshin një arsenal ligjor ndëshkues të veçantë dhe veçanërisht efikas.

Krijimi i një tregu të përbashkët, më 1 janar të vitit 1993, i cili konkretizoi lëvizjen e lirë të mallrave, kapitaleve dhe personave, duke hequr kështu të gjitha formalitetet doganore brenda për brenda zonës së formuar nga shtete anëtarë të Komunitetit Evropian, por edhe përreth, tendenca në rritje drejt integritetit të plotë të vendit tonë në këtë komunitet, si dhe ngjarjet që rrodhën pas 11 Shtatorit për luftën kundër terrorizmit, ka revolucionuar misionet e mëparshme të administratës doganore edhe në fushën e luftës kundër krimit në fushën doganore.

Në këto kushte, shërbimit doganor iu desh të orientohej dhe të adaptohej me mënyra të reja veprimi, për të mbikëqyrur sa më me efikasitet tregun ndërkombëtar. Në këtë kuadër, Administrata Doganore, në radhë të parë, përmbushenjë mision mbrojtës, që konsistonte sidomos në aspektin fiskal, në rritjen e të ardhurave për llogari të buxhetit nëpërmjet arkëtimit të detyrimeve të importit, në bazë të tarifave doganore për produktet e importuara nga vendet jashtë BE-së, si dhe, në raste të veçanta, për llogari të të ardhurave kombëtare, detyra e së cilës konsistonte në vjeljen e akcizës mbi mallrat e akcizës, si për ato të importit, ashtu dhe ato të prodhimit të brendshëm⁷¹, të arkëtojnë TVSH-në për mallrat e importit, si dhe taksa të tjera, për shembull, taksën e karbonit...etj. Gjithashtu, shërbimi doganor, në përputhje me nenin 28 të Kodit Doganor, vepron për të siguruar respektimin e marrëveshjeve komerciale jo vetëm me vendete BE-së, por edhe me shtetet e tjera. Pra, kontrollon zbatimin e rregulloreve mbi kuotat për disa produkte të përcaktuara në marrëveshje për aplikimin e tarifave preferenciale, bën kontrollin e mallrave, të cilat i nënshtrohen kufizimeve për qarkullim, si edhe për shkak të natyrës së tyre të veçantë⁷². Gjithashtu ka për detyrë të ushtrojë kontroll mbi mallrat që importohen, eksportohen, tranzitohen, si dhe, nëse vendosen në procedurën doganore dhe konstatohen

⁷¹ Ligji nr. 62, datë 2012 “Për akcizat” (ngarkon autoritetin doganor për zbatim).

⁷² P.sh. mallra me karakter të dyfishtë: armatime, objekte kulture, medikamente, etj.

shkelje, që lidhen me mosdeklarimin e saktë të mallrave, por edhe të mbledhjes së informacioneve mbi shkëmbimet ndërkomunitare për qëllim statistikor ose për qëllim orientimin e kontrollit fiskal.

Shërbimi doganor luan një rol parësor në luftën kundër falsifikimit dhe piraterisë, veprim i cili sjell një dëm të konsiderueshëm si në ekonominë e vendit, ashtu edhe në kredibilitetin për shkëmbimettregtare⁷³. Ndërkohë që shërbimit doganor, me ligj, i janë ngarkuar detyra të rëndësishme në luftën kundër trafikut, jo vetëm të mallrave të konsumit, detyrë kjo tradicionale, por edhe në fushën e lëndëve narkotike, të cigareve, të armëve, mallrave me karakter të dyfishtë, në luftën kundër pastrimit të parave, etj⁷⁴. Përveç këtyre, dogana ka misionmbrojtës, veçanërisht mbrojtjen e mjedisit⁷⁵ apo mbrojtjen ndaj qarkullimit të plehrave, mbrojtjen e konsumatorit, sepse dogana mban përgjegjësi vetëm për kontrollin sanitar për shërbimet veterinarë, por edhe për kontrollin mbi respektimin e normave teknike të sigurisë dhe, së fundi, por jo nga rëndësia, sidomos pas ngjarjeve të 11 Shtatorit, shërbimi doganor ka si mision primarsigurinë e porteve, aeroporteve, stacioneve të trenit, shkurt sigurinë kombëtare.

Misionet e administratës doganore janë shumë të ndryshme, disa prej tyre janë tradicionale, disa janë më të hershme, por në të vërtetë të gjitha këto kërkojnë aplikimin e një shumëllojshmërie rregullash teknike, qofshin këto të përmbledhura në Kodin

⁷³ Më shumë shiko:

Direktiva 2006/116/KE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 12 dhjetor 2006 "Për mbrojtjen e të drejtës së autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të" (version i kodifikuar i 93/98/KE) – Celex nr. 32006L0116/ Fletorja zyrtare 2006 L372/12.

Neni 82/4 i Kodit Doganor përcakton se "Autoritetet doganore ... mund të ndalojnë ... mallrat e njohura si të falsifikuara ose pirate, sipas procedurave të parashikuara në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi". Kjo dispozitë e përgjithshme në Kodin Doganor, së bashku me dispozitat e parashikuara në TRIPS, detajohet më tej në përgjegjësitë në luftën kundër piraterisë dhe falsifikimit.

VKM nr. 547, datë 01.05.2008 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" dhe VKM-së nr. 274, datë 13.4.2010 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 205, datë 13.4.1999 të Këshillit të Ministrave "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor" të ndryshuar, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 55, datë 10.05.2010, faqe 2082. Këto akte nënligjore kanë përafuar thujse tërësisht Rregulloren e KE-së nr. 1383/2003 dhe pjesërisht Rregulloren 1891/2004, datë 26.05.2008, faqe 3227.

"Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale, Strategjia e Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale nga Administrata Doganore". Botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, 2013

⁷⁴ Ligji për deklarim të parave nëpërmjet kontrollit të lëvizjes së kapitalit me prejardhje ose me destinacion nga jashtë.

⁷⁵ Dogana ka si mision aplikimin e Konventës për mbrojtjen e mjedisit dhe veçanërisht mbrojtjen e disa specieve të faunës dhe florës, Dekreti nr 78-959, datë 30 gusht 1978 "Mbi Publikimin e Konventës mbi tregtinë ndërkombëtare të disa specieve të egra të faunës dhe florës, që janë në zhdukje", e hapur për t'u nënshkruar në Uashington deri më 30 prill 1973.

Doganor⁷⁶, të legjislacionit të dikastereve të tjerë apo organizmave të specializuar, por që fatkeqësisht i takon doganës t'i aplikojë duke ushtruar kompetenca të ndryshme.

⁷⁶Shërbimi Doganor ka mision:

- Fiskal-mbledhje të detyrimeve dhe taksave të tjera, të cilat bëhen pjesë e Buxhetit të Shtetit.
- Ekonomik-forcimin e ekonomisë së vendit për të përballuar sfidat në kushtet e globalizmit të tregtisë
- Mbrojtës.

➤ **Misioni fiskal.** Misioni fiskal është një nga misionet e rëndësishëm tradicional edhe për Doganën Shqiptare, që konsiston në mbledhjen e taksave doganore të mallrave që importohen në Republikën e Shqipërisë. Krahas këtyre, dogana mbledh një sërë taksash të tjera për llogari të organeve tatimore, si TVSH-ja, akcizat, taksat rrugore, etj., çka bën që pesha specifike e të ardhurave që mbledh dhe derdh dogana në buxhetin e shtetit të jetë një shifër e konsiderueshme. Gjithashtu, evidentimi gjithnjë më objektiv i vlerave të mallrave të importuar shërben si një e dhënë thelbësore nga dogana.

➤ **Misioni ekonomik.** Misioni ekonomik i Doganës Shqiptare merr gjithnjë më shumë një rëndësi të veçantë në mbrojtjen dhe zhvillimin e ekonomisë së vendit. Dogana, si organizëm i rëndësishëm i Shtetit, duke zbatuar nivelet e ndryshme të taksave, tarifave sezonale për prodhimet bujqësore, duke kontrolluar sistemin e licencave, mbron prodhuesit vendas dhe stimulon importet në sfera të caktuara, si dhe inkurajon investimet e huaja në vendin tonë. Gjithashtu, zbatimi i legjislacioni të ri doganor sipas modelit evropian, ku vend të rëndësishëm zënë procedurat doganore për importin, eksportin apo tranzitin e mallrave, si dhe regjimet ekonomike, si ai i lejimit të përkohshëm, i përpunimit aktiv e pasiv, i magazinave doganore, ka krijuar kushte të favorshme jo vetëm në zhvillimin dhe shtimin e shkëmbimeve tregtare me jashtë, por edhe në stimulimin e prodhimit vendas.

Administrata doganore, në përbushjen e këtij misioni, luan njëkohësisht edhe rolin e vëzhguesit ekonomik, duke orientuar veprimet e Qeverisë dhe operatorëve ekonomikë, pasi është i vetmi mjet grumbullues, përpunues dhe shpërndarës i statistikave të tregtisë së jashtme.

Misioni Mbrojtës dhe i Sigurisë së Doganës Shqiptare, si edhe ato të vendeve evropiane, po i kushtojnë një rëndësi gjithnjë më të madhe misionit mbrojtës. Veçanërisht pas ngjarjeve të 11 Shtatorit ky mision po shihet me përparësi edhe në fushën e kontrollit dhe mbikëqyrjes doganore, përfshirë edhe luftën kundër pastrimit të parave. Duke pasur një mbështetje ligjore të fuqishme, duke qenë e dislokuar në pikat e kalimit të kufirit, duke pasur në vëzhgim zonën kufitare, si dhe duke mbajtur nën kontroll rrjetin rrugor kombëtar, dogana ka një mision të rëndësishëm mbrojtës që shtrihet në shumë fusha, si për shembull:

A. **Sigurinë kombëtare dhe rendin publik.** Ndalimi i trafikut të jashtëligjshëm të armëve, eksplozivëve, lëndëve helmuese. Kontrolli i sigurisë në aeroport dhe porte, në kuadrin e luftës kundër terrorizmit. Ndalimi i trafikut të narkotikëve dhe substancave psikotrope. Kontrolli i parasë "së pistë". Ndalimi i importit, eksportit, tranzitit të materialeve të shkruara, që rrezikojnë sigurinë kombëtare.

B. **Mbrojtjen e shëndetit publik.** Kontrolli sanitar dhe fitosanitar i kafshëve dhe bimëve të importuara. Kontrolli i prodhimeve farmaceutike të importuara. Lufta kundër trafikut të drogës dhe substancave psikotrope, etj.

C. **Mbrojtja e konsumatorëve.** Kontrolli i respektimit të normave të prodhimit si dhe kontrolli i normave teknike të sigurimit; mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale (pronësia industriale dhe pronësia intelektuale) me qëllim:

- Mbrojtjen e ambientit të biznesit të cilët janë mbajtës dhe/ose përdorues të një të drejtë të pronësisë intelektuale nga konkurrenca e pandershme.
- Mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit publik nga mallra të falsifikuara/piratë për pasojat që shkaktojnë.
- Kufizimin e mundshëm të humbjeve të të ardhurave në buxhetin e shtetit që vinë si pasojë e mallrave që cenojnë një të drejtë të pronësisë intelektuale. "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor".

Edhe pse detyra kryesore e shërbimit doganor qëndron në mbrojtjen e shoqërisë dhe interesave financiarë për mbledhjen e detyrimeve të import/eksportit në favor të buxhetit të shtetit, në mbështetjen e konkurrencës së shoqërive tregtare, si dhe në kontrollin e personave dhe mallrave, në mënyrë që të dallojë personat mashtrues dhe të rrezikshëm, finaliteti dhe qëllimet e këtij misioni kanë pësuar një ndryshim të rëndësishëm. Vullneti politik për t'i siguruar administratës së doganës mjete veprimi të jashtëzakonshme në planin juridik, d.m.th. kompetenca të rëndësishme për të vepruar ndaj personave dhe mallrave që i nënshtrohen kontrolleve, ashtu sikundër kompetencat që mbart për të dënuar mashtruesit e kontrabandistët në kuadër të një procedure represive specifike dhe veçanërisht efikase, rezulton që e drejta penale doganore në fushën e goditjeve të shkeljeve doganore të jetë një e drejtë shumë e veçantë nga e drejta penale e përgjithshme.

Mendoj se interes të madh teorik dhe praktik paraqet studimi i mekanizmave të ndjekjes dhe të sanksioneve në krimet e fushës doganore, në mënyrë që të kuptojmë veçoritë e tyre, të identifikojmë karakterin dhe perspektivat. Mbetet të perceptojmë nëpërmjet ndryshimeve të procedimit për krimet në fushën doganore me ato të fushave të tjera. Për të kuptuar sa më qartë veçantësinë e mekanizmave të ndjekjes penale dhe të sanksioneve në të drejtën doganore, lind domosdoshmëria të rikujtojmë mutacionet historike, të cilat, për një kohë të gjatë, i kanë atribuuar doganës kompetenca të jashtëzakonshme, me qëllim që të sigurohej efikasiteti dhe shpejtësia e dhënies së dënimeve për veprat doganore.

Gjithashtu na duhet të kuptojmë se çfarë e ka shtyrë ligjvënësin që t'i japë kësaj administrate gjithë këtë pushtet të jashtëzakonshëm. E cilësuar si policia e marrëdhënieve komerciale me jashtë, roje e financave, imazhi i saj duhet të pasqyrojë mbrojtjen e interesave të shtetit. Administrata ka një arsenal juridik të përshtatur⁷⁷, ndryshe nga e drejta e përgjithshme, por që kërkon përshtatje me ndryshimet që kërkon koha. Historia e veçantë e doganës dhe evoluimi i shpeshtë i kompetencave të saj, në pjesën dërrmuese të saj dëshmojnë për partikularitetin e drejtës doganore në aspektet penale.

D. **Mbrojtja e ambientit** Ndalimi i importit të mallrave të rrezikshëm që prishin apo rrezikojnë ambientin. Ruajtja e specieve të rralla të faunës dhe florës që janë në zhdukje. Kontrolli i eksport-importit të mbeturinave toksike të rrezikshme, etj .

E. **Mbrojtja e pasurisë kulturore kombëtare** Kontrolli i eksportit të veprave të artit dhe të koleksioneve antike me vlera kombëtare, rikthimin e tyre në destinacion, ndalimi i eksportit klandestin të tyre.

F. Ruajtja e moralit publik. Kontrolli ndaj materialeve që cenojnë moralin publik.

Duke u bazuar në këto misione dhe rëndësinë e tyre nga gjykata ka rëndësi që në procesin e klasifikimit të veprës shkelje administrative apo kontrabandë të konstatojnë rrezikshmërinë e veprës kryer, cenimi i marrëdhënieve të caktuara nga kundërligjshmëria e subjekteve të marrëdhënieve doganore...

⁷⁷ Konventa e Johannesburgut.

Në këtë këndvështrim hasim faktin se doganat tradicionalisht kanë qenë përgjegjëse për zbatimin e një game të gjerë të politikave të menaxhimit të kufijve, shpeshherë në të mirën e institucioneve të tjera. Roli i doganave ka ndryshuar në mënyrë të dukshme në ditët e sotme dhe ajo çfarë mund të përfaqësojë një nga punët apo detyrat kryesore për një administratë, mund të jetë jashtë sferës së përgjegjësive të një tjetre. Ky është reflektim i një mjedisi ndryshues, brenda të cilit autoritetet doganore punojnë. Organizata Botërore e Tregtisë⁷⁸, Organizata Botërore e Doganave dhe agjenci të tjera ndërkombëtare, po përgjigjen nëpërmjet zhvillimit të standardeve globale që njohin natyrën ndryshuese të menaxhimit të kufijve. Mbi këtë bazë ka ndryshuar dhe është zhvilluar edhe legjislacioni kundër krimit në fushën e kontrabandës.

Edhe pse përgjegjësitë e administratës doganore ndryshojnë nga njërishtet në tjetrin, madje shpeshherë bëhen subjekt i rishikimit të rregullave dhe i modifikimit të tyre, për të siguruar përshtatshmërinë e vazhdueshme në një shoqërigjithnjë në zhvillim, tashmë tendenca është drejt unifikimit të legjislacionit doganor.

Dihet se, tradicionalisht, doganat kanë qenë përgjegjëse për implementim e një game të gjerë të politikave qeverisëse, që përfshijnë zona të ndryshme, si për shembull mbledhjen e të ardhurave, lehtësimin e tregtisë, zbulimin e substancave të ndaluara, mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe zbatimin e ligjeve të pronësisë intelektuale.

Kjo fushë e gjerë përgjegjësish reflekton faktin se autoritetit doganor prej kohësh i është besuar administrimi i çështjeve, për të cilat ministri të tjera apo agjenci qeveritare kanë kompetenca direkte, siç është shëndeti, agrikultura, mjedisi, statistikat e tregtisë dhe, në disa raste, edhe imigracioni. Në përgjithësi, gjithçka është arritur si pasojë e implementimit të një game të gjerë e të larmishme marrëveshjesh me shërbimin doganor, të cilat kanë përgjegjësi rregullatore në pikat e hyrjes dhe daljes nga/dhe në territorin doganor. Përgjegjësi të tilla të menaxhimit të kufijve rrjedhin nga shumë role tradicionale doganore të mbledhjes së taksave për mallra që tregtohen ndërkombëtarisht, një shtrirje e formave të mbledhjes së taksave të tilla, si Tatimet mbi vlerën e shtuar-TVSH-ja dhe akcizat.

Si rrjedhojë, fokusi kryesor për autoritetet e tyre doganore, në mënyrë të kuptueshme, do të jetë mbledhja e të ardhurave, "lehtësimi i mëtejshëm i tregtisë së ligjshme"⁷⁹ Megjithatë, trendi i tanishëm drejt tregtisë së lirë globale dhe rritjes së vazhdueshme të terrorizmit internacional, kanë bërë që siguria e kufijve të ketë një prioritet kryesor për të gjitha ekonomitë. Një tregues i përgjithshëm i pikëpamjes së qeverive për rolin e autoriteteve doganore, shpeshherë mund të vërehet në mënyrën sesi administrata

⁷⁸World Trade Organization 2002, Trade facilitation: overview of trade facilitation work.

⁷⁹ "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", projekt 2014.

strukturën përgjegjësitë e saj në fushën respektive. Për shembull, në kohën kur mbledhja e të ardhurave ishte fokusi kryesor, administrata e doganave ishte organizuar në tre departamente⁸⁰.

Pas 11 Shtatorit, si gjithandej, edhe dogana shqiptare u ristrukturua, duke ngritur edhe Departamentin e Menaxhimit...⁸¹ Ky aksion kombinohej me funksionet e doganave, kontrollin dhe inspektimin e produkteve ushqimore, së bashku me ato të menaxhimit të krizave, të sigurisë nacionale, të rregullimeve, të policisë dhe parandalimit të krimin.

Në të vërtetë, po theksohet gjithnjë e shumë që administrata doganore nuk duhet domosdoshmërisht të duket njëloj gjatë gjithë kohërave. Çfarë mund të ketë qenë prioritarë për një periudhë, mund të jetë jashtë sferës së përgjegjësive për periudhën tjetër, fakt ky që, thjesht e qartë, evidenton dhe reflekton prioritete të ndryshme, pra jo vetëm për mënyrën sesi një vend drejton ekonominë, por edhe për mënyrën se si rregullat e lidhura administrative janë vendosur. Në këtë drejtim, edhe disa nga aktivitetet thelbësore tradicionale doganore në kushtet e vendit tonë, do të vazhdojnë të mbeten prioriteti kryesor për shërbimin doganor, ndryshe nga vende të cilat janë pjesë e BE-së⁸².

Ndryshimet që priten.

Tashmë, për gati disa dekada, po ushtohet presion gjithnjë e më shumë nga Bashkimi Ndërkombëtar Tregtar për të minimizuar ndërhyrjet e qeverisë në transaksionet tregtare, si dhe një pritshmëri gjithmonë në rritje për shërbimin doganor. Autoritete në mbarë botën po këmbëngulin për masa lehtësuesetë tregtisë. Për shekuj me radhë, roli i doganave ka qenë ai i portierit, ndërsa autoritetet doganore që përfaqësojnë veçse një pengesë, të cilën duhet ta kalojë tregtia ndërkombëtare, në përpjekje për të mbrojtur interesat e vendit. Thelbi i këtij roli është reflektuar në një simbol tradicional të doganave “të grilës me shufra hekuri”, që është tjetër veçse një përfaqësim simbolik i portave të një kombi⁸³. Një rol i tillë është manifestuar shpesh nëpërmjet ndërhyrjeve rregullatore tregtare të thjeshtëzuara për shkak të ndërhyrjeve që duhen bërë.

Shërbimi Doganor gëzon autoritetin për tazbatuar diçka të tillë, megjithatë, tashmë nuk mund të pranohet konceptimi i ndërhyrjes për “hir të ndërhyrjes”. Në kuadrin e unifikimit të ligjit doganor me atë të BE-së, si dhe integrimin gradual të vendit në këtë komunitet, do të pranohet vetëm “ndërhyrja me përjashtim”, që është ndërhyrje që lind vetëm për

⁸⁰ Më shumë shiko pikën 4 të VKM-së nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat zbatuese...” të ndryshuar.

⁸¹ Vendim nr. 511, datë 01.08.2012.

⁸² Prandaj, nëse persona të ndryshëm do të pyeteshin për të përshkruar rolin e doganave, ka të ngjarë që rezultati të jetë i ngjashëm me historinë e gjashtë burrave të verbër, që formuan perceptime krejtësisht të ndryshme se si mund të dukej një elefant, meqenëse prekën pjesë të ndryshme të kafshës.

⁸³ CC Pond 1992, The portcullis, Factsheet No. 12, Public Information Office, House of Commons, London

nevoja legjitime për ta realizuar, çka do të thotë se ndërhyrja duhet bërë bazuar në identifikimin e rrezikut⁸⁴.

Mungesa e bashkëpunimit dhe modernizimit midis doganave dhe agjencive të tjera të kontrollit ekonomik dhe kufitar përbënte dhe përbën një pengesë serioze në rritjen e fluksit të bashkëpunimeve tregtare dhe të kontrollit doganor. Për këto arsye, OBT-ja dhe OBD-ja kanë inkurajuar negociatat për lehtësimin e tregtisë, për bashkëpunim të mëtejshëm në mënyrë që të sigurohet një rezultat kuptimplotë, ndërkohë që, krahas kësaj, kanë mbështetur edhe ndërmarrjen e masave efikase lidhur me konkurrencën, sigurinë dhe mbrojtjen⁸⁵.

Plani i shërbimit doganor

⁸⁴Pritjet për ndryshim të Bashkimit Ndërkombëtar Tregtar janë bazuar në realitetin tregtar të mjedisit të vetë operues. Mirëpo, është duke u analizuar mënyra më e thjeshtë, më e shpejtë, më e lirë dhe më e besueshme, për të futur dhe nxjerrë të mirat jashtë çdo vendi. Kjo kërkon qartësi, siguri, fleksibilitet dhe afate kohore në mënyrën e bashkëpunimit me qeverinë. Nxitur nga urdhrat tregtare, është duke u parë dhe mënyra më efektive për koston e të bërit biznes, apo lehtësimet në fushën e tregtisë.

Lehtësimi i agjendës tregtare po fiton një vrull në rritje. Si pasojë e Deklaratës Ministrore të Dohse-së dhe vendimeve të mëvonshme të Këshillit të Përgjithshëm të OBT-së, të cilët kanë kërkuar intensifikimin e përpjekjeve ndërkombëtare për përshejtime të mëtejshme, për lirinë e lëvizjes dhe zhdoganimin e mallrave të tregtuara ndërkombëtarisht, duke përfshirë dhe mallrat tranzit. Suksesi i kësaj agjende varet jashtëzakonisht shumë tek aftësia e doganave për të rritur pritshmëri të forta, në mënyrë që të arrijnë një ekuilibër mes efektivitetit në lehtësimin e tregtisë dhe ndërhyrjen rregullatore. Arritja e një balance të tillë mund të sigurojë rrjedhë më të rëndësishme për përfituesit e ekonomive kombëtare, meqë çështja e lehtësimeve të tregtisë është shtuar në agjendën e OBT-së, tashmë me vende të ndryshme që bëjnë rivlerësimin e arritjeve të tyre në fushën legjislative dhe administrative për rregullimin e tregtisë ndërkombëtare. Saktësisht, Deklarata Ministrore e Singaporit drejtuar Këshillit për Tregtinë e Mallrave për të ndërmarrë punë kërkimore dhe analitike, duke u mbështetur në punën e organizatave të tjera të përafërta ndërkombëtare, në arritjen e thjeshtësimit të procedurave tregtare, në mënyrë që të arrihet qëllimi për rregullat e OBT-së në këtë fushë. Më shumë referohu: Singapore Ministerial Declaration, adopt on December 1996

Pas konsultimeve të gjera në industri dhe tregti, OBT-ja ka identifikuar me interes të gjerë në nivel ndërkombëtar fushat e mëposhtme:

- Kërkesat e tepërta në dokumentacionin e qeverisë.
- Mungesa e automatizimit dhe përdorimi i dobishëm i informacionit teknologjik.
- Mungesa e transparencës, kërkesa të paqarta dhe të përcaktuara.
- Procedura jo adekuate doganore, saktësisht kontrolleve audite bazë dhe teknikat e vlerësimit të riskut.

Më shumë referohu: Summarizing the outcome of WTO Trade Facilitation Symposium held in Geneva 9-10.3.1998.

⁸⁵Safety – Siguria është gjendje e “të qenit i sigurt” (nga frëngjishtja “sûr»), gjendja e të qenit i mbrojtur nga ana fizike, shoqërore, shpirtërore, financiare, politike, emocionale, profesionale, psikologjike, arsimore apo lloje të tjera ose pasoja të tjera të gabimit, dëmit, aksidentit, dëmtimit ose çdo ngjarje tjetër, e cila mund të konsiderohet e papëlqyeshme. Siguria mund të përkufizohet edhe si kontroll i rreziqeve të njohura, të cilat arrijnë një nivel të pranueshëm rreziku. Kjo mund të marrë formën e të qenit i mbrojtur nga ndonjë ngjarje apo ekspozim ndaj diçka që shkakton humbje shëndetësore ose ekonomike. Në sigurinë përfshihet mbrojtja e personave ose e sendeve poseduese.

Për sa parashtruam më lart duhet të pranojmë, se:

Së pari,

Dikur, e drejta doganore kishte për vokacion kryesor, sipas doktrinave ekonomike, mbrojtjen e një shteti kundër konkurrencës së produkteve të huaja, gjë që arrihej nëpërmjet një arsenali të përshtatshëm (detyrime doganore, ndalime, kufizime, kuotave, etj). Mirëpo, zhvillimi dhe shumëfishimi i shkëmbimeve ndërkombëtare, si rezultat i “mondializimit” të ekonomive, sollën “dënimin” e proteksionizmit (të paktën ai që ushtrohej në format më të dukshme). GATT-i, sot OBT-ja, simbolizojnë që prej 1948-ës vullnetin e shumë shteteve, për të hequr pengesat për tregtinë ndërkombëtare. Në qoftë se do e lexonim gërmë për gërmë ideologjinë liberale, atëherë zhdukjen e doganierëve do e kishim pasur kohë më parë; gjithsesi, ngelet të bëjmë një nuancim. Pra, kjo nënkupton që, edhe pse Shqipëria në proceset integruese nuk duhet të jetë më proteksioniste, asgjë nuk i pengon ata të mbrohen. GATT-i nuk e ka ndaluar asnjëherë përdorimin e detyrimeve apo taksave doganore, nga momenti kur ato konsiderohen të arsyeshme edhe jo diskriminuese në mbrojtje të “Konkurueshmërisë”⁸⁶. Po ashtu, nevoja për të vënë në kornizë planin juridik të politikave doganore liberale, ende nuk është zhdukur zyrtarisht, çka nënkupton se e drejta doganore një pjesë të themelit të saj vazhdon të ketë mbrojtjen ekonomike.

Gjithsesi, ajo duhet, dhe këtu konstatojmë aspektin e dytë të vokacionit bashkëkohor, të vihet në shërbim të liberalizmit, kur është e nevojshme, domethënë të favorizojë zhvillimin e tregtisë ndërkombëtare në respekt të rregullave që e qeverisin.

Së dyti,

Gjatë vitevetë fundit, çështjet e mësipërme kanë qenë të parat në axhendat e Organizatës Botërore të Doganave, e cila çoi në rishikimin e Konventës për Harmonizimin e Procedurave të Doganave – Konventa e Kiotos⁸⁷ në përpjekje për të promovuar arritje mjaft të larta në mjedisin e transportit dhe tregtisë ndërkombëtare, ndërkohë që ruhen nivelet e duhura “... të kontrolleve rregullatore dhe të menaxhimit të zinxhirit furnizues të përdorur për lëvizjen ndërkombëtare të mallrave ...”⁸⁸ OBD-ja ishte gjithashtu një zanafillë e hershme për nevojat e autoriteteve doganore, për të rishikuar përafrimet tradicionale të kontrollit të tregtisë ndërkombëtare dhe për të braktisur mentalitetin si “portier”, që tradicionalisht ka dominuar mendimin e tyre⁸⁹. Nëpërmjet dispozitave të Konventës së Rishikuar të Kiotos, në thelb OBD-japo përpiqet të arrijë një adoptim të

⁸⁶ Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, projekt 2014, fq. 3.

⁸⁷World Customs Organization 2002, Kyoto 2000: The International Convention on the Simplification and Harmonization of Customs procedures (Revised) – Pathway to efficiency and effectiveness in the Customs Environment, World Customs Organization, Brussels (e rishikuar) - Shqipëria ka aderuar në vitin 2012.

⁸⁸ Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, projekt 2014, fq. 3.

⁸⁹T. Hayes 1993. “Can EDI eliminate Customs?”

përgjithshëm të një stili për menaxhimin e riskut të pajtueshmërisë rregullatore. Në lidhje me konceptin e kontrollit doganor, OBD-ja përcakton:

Parimi i kontrollit doganor është zbatimi i duhur i legjislacionit doganor dhe pajtueshmëri me kërkesa të tjera ligjore dhe rregullatore, me lehtësim maksimal të tregtisë ndërkombëtare dhe të lëvizjes. Kontrollat doganore duhet të mbahen në minimumin e mundshëm për të përmbushur objektivat kryesore dhe duhet të kryhen mbi baza selektive, duke përdorur teknikat e menaxhimit të rrezikut në masën më të madhe të mundshme. Aplikimi i parimit të kontrolleve doganore do të lejojë Administratën Doganore të:

- Përqendrohet në zonat me rrezik të lartë, për faktin që duhet të sigurojë një përdorim efektiv të burimeve që janë venë në dispozicion.
- Rrisë aftësitë për të zbuluar veprat penale të fushës doganore.
- T'u ofrojnë tregtarëve apo udhëtarëve të tjerë, një lehtësim të ndjeshëm gjatë procedurave të import/eksportit dhe tranzitit të mallrave “duke ruajtur balancën e duhur ndërmjet kontrolleve dhe lehtësimin e tregtisë së ligjshme”⁹⁰.

Përshpejtim i tregtisë dhe i lëvizjes⁹¹. Si rezultat i 11 Shtatorit, ndërmarrja e një zinxhiri masash sigurie kundër terrorizimit, mund të na shpjerë përpara rrezikut real në fokusimin e kontrolleve të rrepta rregullatore, duke penguar lehtësimin e tregtisë^{92/93}.

Në këto rrethana, sipas OBD-së, lind nevoja që:

- Të vendosen standarde që ofrojnë sigurinë e këtij zinxhiri furnizues dhe lehtësimin në nivel global për të promovuar siguri dhe parashikueshmëri.
- Të mundësohet menaxhimi i zinxhirit të furnizimit të të gjitha llojeve të transportit.

⁹⁰ Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, projekt 2014.

⁹¹ Kyoto Convention, Ch.6, p.9.

⁹² Në fjalimin e tij në Qendrën për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare më 17 janar 2002, Komisioneri i Doganave Amerikane, Robert Bonner, tha: “Menjëherë pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit, në orën 10:04 a.m., të gjitha doganat në mbarë vendin kaluan në Nivelin 1 në të gjithat pikat hyrëse. Niveli 1 kërkon qëndrueshmëri, pyetje intensive antiterroriste dhe përfshin inspektime të rrepta të udhëtarëve dhe të mallrave në çdo port hyrës. Ngaqë ekziston ende një kërcënim i vazhdueshëm terrorist, ne vijojmë të jemi sot në Nivelin 1.

Menjëherë pas kësaj u krijua “Iniciativa e Përmbajtjes së Sigurisë Doganore” në SHBA (CSI) dhe “Partneriteti Dogana – Tregti kundër Terrorizimit” (C-TPAT). Fillimisht, krijuar për të mbrojtur zinxhirët e furnizimeve globale nga armët dhe sulmet terroriste, këto iniciativa patën jo vetëm impakt të menjëhershëm, por edhe të madh, për mënyrën sesi vepronin doganat dhe zinxhirët e tjerë doganorë.

Ky njoftim bëhet për t'u përqendruar në identifikimin e të dyjave, si pajtueshmëritë, ashtu dhe pa papajtueshmëritë – reflekton një element kyç të menaxhimit të pajtueshmërisë bashkëkohore dhe është në përputhje me Konventën e Rishikuar të Kiotos. Në këtë mënyrë, programi i C-TPAT i jep CBP-së një mundësi për të menaxhuar rrezikun e aktiviteteve të tij, duke vlerësuar integritetin e partnerëve të tij zinxhir të C-TPAT dhe, nga ana tjetër, për t'u siguruar këtyre partnerëve të sektorit privat, përpunim të përshpejtuar dhe pastrim.

⁹³ Duke u tërhequr kryesisht nga iniciativa e C-TPAT-it amerikan, OBD-ja lëshoi Strukturën e Standardeve të Sigurisë dhe Lehtësisë së Tregtisë Globale, (WCO Framework of Standards, p. 6.) me qëllim që të përmirësonte regjimin që do të siguronte dhe lehtësonte tregtinë ndërkombëtare.

- Të rritet roli, funksioni dhe kapaciteti doganave për të përmbushur sfidat dhe mundësitë e shek. XXI.
- Të forcohet bashkëpunimi ndërmjet Administratave Doganore, për të përmirësuar aftësitë e tyre në zbulimin e dërgesave me rrezik të lartë dhe goditjen e trafiqeve.
- Të forcohet bashkëpunimi midis Doganave dhe Biznesit.
- Të promovohet lëvizja e mirave nëpërmjet zinxhirëve tregtarë të sigurt internacional.

Për sa më lart, mund të dalim në këtë përfundim:

Roli i doganave ka ndryshuar në mënyrë të dukshme, si rezultat i evolucionarizimit të dyfishtë, duke përfshirë rritjen e globalizimit të tregtisë dhe faktorëve revolucionarë, si sulmet terroriste, trafiku i paligjshëm.

Zhvendosja e rezultateve në politikat qeveritare dhe mënyra me të cilën këto politika administrohen, na sollën në pikën ku është e panevojshme të përkufizohet qartazi roli doganave. Ndërkohë që përgjegjësitë për menaxhimin e kufijve vazhdojnë të kryen, natyra dhe ndërhyrja e agjencive qeveritare të ngjashme është duke ndryshuar. Si pasojë, ajo që mund të përfaqësohet si pikë kyçe e punës për një administratë, mund të dalë jashtë sferës së përgjegjësisë për një administratë tjetër. Organizata Botërore e Tregtisë, Organizata Botërore e Doganave dhe organe të tjera ndërkombëtare, po përgjigjen nëpërmjet zhvillimit të standardeve globale që njohin natyrën ndryshuese të menaxhimit të kufijve⁹⁴.

Kontrollimë i mirë i kufirit, i trafikimeve dhe byllja kalimeve të paligjshme të kufirit, mund të ndikojë pikë së pari që trendi i kontrabandës të mbështetet më shumë në kalimin e ligjshëm të kufijve, duke gjetur *modus operandi* më të sofistikuar, pra duke përdorur dokumente false, kartat identiteti false, kompani fiktive dhe duke shfrytëzuar korrupsionin për të shtruar rrugë drejt strukturave të ligjshme. Duke mbajtur parasysh se kontrabanda e mallrave të ligjshme i përgjigjet stimulve që vijnë nga tregu dhe nga ekonomia, përpjekjet e organeve të zbatimit të ligjit për një kontroll më rigoroz të kufirit nuk mund të jenë një mburojë për këtë fenomen.

Zgjidhjet e mundshme duhet të ofrojnë kombinimin e masave ekonomike me masat e natyrës së ndëshkuese, duke goditur kontrabandën në të gjithë aspektet e saj.

Së treti,

⁹⁴Proven Safety Countermeasures: "Roundabouts". Federal Highway Administration. Retrieved 2012.08.13.

Edhe pse autoritetet komunitare disponojnë një kompetencë praktikisht ekskluzive, për sa i përket përcaktimit të objektivave ekonomike të së drejtës doganore, ndërhyrja e tyre në fushat ekstra-komunitare është shumë diskrete. Kështu, ndodh p.sh. kur kemi të bëjmë me kërkimin dhe ndëshkimin e shkeljeve doganore, fushë e cila i “shpëton” të drejtës doganore komunitare. Sipas studiuesve të së drejtës doganore, edhe pse zhvillimi i mashtrimit doganor ka qenë i favorizuar nga hapja e kufijve, vendi ynë, por dhe shumë vende të tjera, nuk janë ose janë fare pak të përgatitur për t’u dhënë përgjigje të gjitha problematikave në këtë fushë. Gjithsesi ky afirmim duhet të nuancohet, për faktin se kemi pasur përpjekje për të zhvilluar ndërmjet administratave doganore një kooperim efikas në luftën kundër mashtrimit, përpjekje të cilat shfaqen në konventa për asistencë reciproke dhe në praktikë, nëpërmjet shkëmbimit të informacionit⁹⁵.

Së katërti,

Në stadin komunitar mungesa e harmonizimit të dispozitave penale për veprat penale të kontrabandës krijon jo pak probleme. Në asnjë fushë tjetër të së drejtës doganore, nuk është shfaqur një rezistencë kaq domethënëse për harmonizimin, siç është shfaqur për litigacionet doganore. Deri më sot, theksojnë specialistët e fushës doganore, tentativat e Komisionit për të marrë nga shtetet anëtare një vizion konkret rreth sanksioneve doganore, kanë dështuar. Nga pikëpamja racionale nuk ekziston asgjë pak alogjike, sesa situata aktuale. Kështu, në rast se Kodi Doganor Komunitar iu imponon operatorëve ekonomikë detyrime të njëjta, cilido qoftë vendi ku ata kryejnë operacione doganore, atëherëshkelja e këtyre detyrimeve do të trajtohet nga shtetipërkates sipas rregullave të tyre të brendshme, si ato në themel, ashtu dhe në procedurë⁹⁶.

Një argument domethënës për sa parashtroam më sipër janë edhe dispozitat e veprës penale të kontrabandës në Kodin Penal dhe ato në Kodin Doganor, të cilat kanë pësuar fare pak ndryshime në raport me normat e tjera juridike, si në ato të fushës doganore, ashtu edhe në ato të fushës penale.

⁹⁵ Më shumë shiko “Marrëveshjen për bashkëpunim në fushën e luftës kundër krimit”... në bazë të së cilës procedohet me letërporosi.

⁹⁶BERR C.-J, «Introduction au droit douanier», Economica (Çmimi 18-20 euro), botimi i fundit 2008.

KREU II

SHKELJA DOGANORE NË KONTRABANDË

- 1 Kontrabanda, kuptimi në Kodin Doganor dhe në vendet komunitare.**
 - 1.1 Kontrabanda në Shqipëri dhe në rajon, si dhe ndikimi në ekonomi.**
- 2 Llojet e kontrabandës**
 - 2.1 Metodat e kontrabandës**
- 3 Lufta kundër kontrabandës**

1. Kontrabanda, kuptimi në Kodin Doganor dhe në vendet komunitare

a. Kuptimi

Nëse bëjmë një rishikim të termit "kontrabandë"⁹⁷, kuptojmë se zanafillën e origjinës etimologjike (Mesjetë) e ka nga bashkimi i dy zërave, të cilat i referohen për të pasur një sjellje të kundërt, nëse parashikohet në një dispozitë ligjore doganore në ndonjë dispozitë tjetër, që ka të bëjë me mallrat e importit/eksportit/tranzitimit, në një regjim tjetër tranzitimi, për mbajtjen apo shitjen e tyre⁹⁸.

Sipas studiuesve italianë termi kontrabandë tregon një lloj shkeljeje doganore, që ndikon në interesat e të ardhurave...⁹⁹ "...një shkelje e ligjeve financiare, në mënyrë më specifike, të normave detyruese tatimore për mallrat e huaja, pse jo dhe të hyrjeve apo daljeve në/dhe nga i njëjti territor kombëtar, ashtu sikurse gjithë sjelljet mashtruese në lidhje me detyrat e konsumit të brendshëm, si dhe të monopoleve shtetërore. Sipas tyre, nocioni i kontrabandës i referohet evazionit të taksave të konsumit, të prodhimit dhe të monopoleve. Megjithatë, pranohet se kohët e fundit, kjo tendencë shtrihej edhe në disa kundërvajtje valutore, sepse çdo veprim i parregullt ose hyrje valute, pra instrumente borxhi, (kontrabanda monetare) gjithmonë përfshijnë mashtrimin dhe mjete të tjera të valutës, shuma të ngjashme me ato të cilat praktikohen për të shmangur në kufij një dispozitë ndaluese ose normë kufizuese¹⁰⁰.

Në periudhën bashkëkohore, autorë të huaj vënë dukje, se, duke kaluar nga termi juridiko-teknik i shprehjes, tanimë mund të flitet edhe për "kontrabandë ekonomike", me qëllim evazionin e kostove ekonomike të importit dhe eksportit, evazione jo domosdoshmërisht të lidhura me kontrabandën doganore, siç mund të ndodh në rastin e mallrave të përjashtuara nga tatimi doganor, por me subjekt të të drejtave të tilla. Për më tepër, nisur nga qëllimi i kontrabandës, kur kjo e fundit si qëllim parësor s'ka evazionin e detyrimeve doganore, mund të flitet edhe për kontrabandë luftarë, politike, strategjike, artistike, arkeologjike, të cilat janë praktikuar në një formë të ngjashme, por jo përkatësisht apo vetëm me mashtrimin e të drejtave doganore. Si rrjedhojë, ky evazion i pjesshëm, që ndodh rëndom në kontrabandën doganore të jashtme, ka formë të kontrabandës së brendshme që parashikohen nga ligje financiare jo doganore, nën tutelën

⁹⁷ Contrabbando s. m. [comp. di contra- e bando, propr. «cosa, azione compiuta trasgredendo a un bando, a una disposizione di legge»]. Më shumë referohu: <http://www.treccani.it/vocabolario/contrabbando/>.

⁹⁸ Rrjedh nga fjalët latine *contra-* kundër dhe *bando* – për një njoftim ligjor dhe publik. Termi u kthye në *contrebande* në Francën Mesjetare dhe u huazua nga anglishtja në vitin 1529. Burimi: www.wisegeek.com.

⁹⁹ Termi kontrabandë ka një përdorim të gjerë për të treguar krimin doganor tipik. Edhe në Ligjin Doganor Aktual, Teksti Unik (DPR 43/1973) dallon shkeljet doganore dhe kontrabandën në kapitullin I, ndërsa në kapitullin II gjobat dhe shkeljet administrative. Maria Cristina Bruno "CONTRABBANDO E FRODI: ASPETTI PENALI".

¹⁰⁰ S. Gallo, "Kontrabanda doganore një vepër antike dhe ende aktive", në *Rivista della Guardia di Finanza* nr. 1-2001, fq. 337.

e taksave të tjera, të tilla si taksa e prodhimit, e monopoleve fiskale, apo e taksave të konsumit komunal.

Në fakt, nga pikëpamja e termave ekonomike, kontrabanda është një lloj evazioni nëpërmjet hyrjes ose daljes së paligjshme të mallrave të tatueshëm nga territori kombëtar, që shpeshherë përdoren jo vetëm për të tregtuar një prodhim të paligjshëm, por edhe për shitjen e tyre, duke iu shmangur pagimit të taksave.

Sipas amerikanëve, kontrabanda përbën një transport ilegal përmes shteteve apo kufijve kombëtarë të mallrave apo personave, përgjegjësi e ndaluar nga doganat dhe nga ligji¹⁰¹. Një transportim i fshehtë i mallrave, duke shkelur ligjin dhe rregulloret. Për shembull, dikush mund të kontrabandojë drogë, cigare pa pullë, armë ose të tjerë mallra të ndaluara me ligj. Në mënyrë alternative, dikush mund të kontrabandojë mallra të ligjshme, duke i marrë ato në zona të ndaluara (siç janë burgjet) ose duke mos iu nënshtruar rregullave të aplikueshme, si në rastin e mospagimit të një takse/tarife¹⁰².

Duke iu referuar literaturës që trajton shkeljet në fushën fiskale, “Kontrabanda, konsiston në transportimin ilegal ndërmjet shteteve ose kufijve ndërkombëtarë të mirave ose personave”¹⁰³, lëvizja e fshehur e mallrave në kufijtë e shteteve për të shmangur detyrimet doganore ose kufizimet e vendosura për import dhe eksport. Sipas tyre, zakonisht një fenomen i tillë ndodh kur detyrimet doganore janë mjaftueshëm të larta, sa për të lejuar një trafikant ose çdo person tjetër të nxjerrë përfitime të larta nga mallrat klandestine ose kur kërkesa për mallin e ndaluar në treg është shumë e lartë, siç janë narkotikët ose armët.

“Nga pikëpamja tregtare, kontrabanda është një formë e tregtisë ndërkufitare, që ndalohet nga ligjet e vendosura nga shteti, por jo nga e drejta natyrale”¹⁰⁴. Duke shmangur kontrollin e nëpunësit të doganës ose duke mos deklaruar mallrat që i nënshtrohen taksave apo detyrimeve, kontrabandistët kapërcejnë barrierat e ngritura për arsye tatiimore apo politike ekonomike, duke shfrytëzuar kështu në favor të tyre dallimet në çmimin natyral apo artificial ndërmjet hapësirave të ndryshme ekonomike. Kjo çon në një riekulibrim të çmimit të leverdishëm nga të dyja palët: si nga blerësi, ashtu dhe nga shitësi.

“Nga ana e pikëpamjes ligjore, kontrabanda është e ndaluar, sepse dëmton interesat madhore të vendit”¹⁰⁵. Ajonënkupton transportin e paligjshëm të mallrave përtej kufijve, me

¹⁰¹Enciklopedia Amerikane 1.Smuggling, illegal transport across state or national boundaries of goods or persons liable to customs or to prohibition.

¹⁰²Farlex Financial Dictionary. Published 2012, from Farlex, Inc.

¹⁰³ Smuggling, illegal transport across state or national boundaries of goods or persons liable to customs or to prohibition.

¹⁰⁴Marco Polli-Schönborn “**Contrabbando**”, published 10/11/2011

¹⁰⁵Marco Polli-Schönborn “**Contrabbando**”, published 10/11/2011

qëllim shmangiene detyrimevedoganoredhetatimorembi këto mallra¹⁰⁶. Krimi i organizuarqëpërfshihet absolutishtnëkontrabandë,zakonisht merretmemallrat që kanë akcizë të lartë, të tillasicigaret,alkoolidhenafta,poredhemeautomjetedhemearmë. Në një kuptim më të gjerë “ky term përfshin edhe transportimin e paligjshëm të njerëzve nga rajonet në konflikt, apo me kriza ekonomike drejt kufirit shtetëror”¹⁰⁷.

Megjithëkëtë,në përgjithësi të gjitha legjislacionet përputhen në lidhje me terminologjinë e kontrabandës¹⁰⁸.

Nga këndvështrimi i doktrinës juridike¹⁰⁹ kontrabanda përcaktohet si shkelje e ligjeve financiare, në mënyrë më specifike, e normave të vendosura mbi detyrimet e mallrave të huaja, po ashtu dhe ndalimet e hyrje-daljeve të atyre mallrave në/dhe nga territori doganor kombëtar, sikurse dhe të të gjitha sjelljeve mashtruese të lidhura me detyrimet e brendshme të konsumit, apo me monopolet e shtetit^{110/111}.

Ligji doganor në fuqi¹¹² kontrabandën e përcakton si: “Shmangie ose tentativë për të shmangur me çfarëdolloj mënyre kontrollin dhe/ose mbikëqyrjen doganore të mallrave, me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve të importit dhe eksportit, siç është

¹⁰⁶ “Duke shmangur nëpunësit e doganës ose duke mos deklaruar mallrat që i nënshtrohen takave apo detyrimeve, kontrabandistët kapërcejnë barriera të krijuara për arsye tatimore apo politika ekonomike, duke shfrytëzuar kështu në favor të tyre dallimet në çmimin natyral apo artificial ndërmjet hapësirave të ndryshme ekonomike”. Marco Polli-Schönborn.

¹⁰⁷ “Duke shmangur nëpunësit e doganës ose duke mos deklaruar mallrat që i nënshtrohen taksave apo detyrimeve, kontrabandistët kapërcejnë barriera të krijuara për arsye tatimore apo politika ekonomike, duke shfrytëzuar kështu në favor të tyre dallimet në çmimin natyral apo artificial ndërmjet hapësirave të ndryshme ekonomike. Marco Polli-Schönborn.

¹⁰⁸ Sipas Konventës së Nairobit termi “Mashtrim Doganor” do të thotë: “Një shkelje doganore, nga e cila një person mashtron doganat dhe në këtë mënyrë i shmanget pjesërisht ose tërësisht jo vetëm pagesave të detyrimeve dhe taksave të import/eksportit ose zbatimit të kufizimeve dhe ndalimeve të parashtruara në Kodin Doganor, por përfiton gjithashtu edhe ndonjë avantazh në kundërshtim me ligjin Doganor. Ndërsa termi “kontrabandë” do të thotë mashtrim doganor, që konsiston në lëvizjen e mallrave përmes një kufiri doganor në mënyrë klandestine.

¹⁰⁹ Në jurisprudencë termi përdoret për të përfshirë dhe të mirat, të cilat janë fituar në mënyrë të paligjshme, edhe pse mallrat mund të mos jenë të paligjshme. Mallrat e vjedhura, për shembull, mund të konsiderohen kontrabandë, madje, ashtu si mallrat e kontrabanduara, ato mund të konfiskohen dhe të përvetësohen nga autoritetet. Frytet e mashtrimit dhe falsifikimit gjithashtu mund të konsiderohen kontrabandë, si rasti i një personi që përdor paratë e fituara nga një veprimtari mashtruese për të blerë sende, si shtëpi apo vetura. Më shumë referohu: www.wisegeek.com.

¹¹⁰V. sul punto C. De Vincedintis, Voce Contrabbando doganale in Novissimo Digesto italiano, Vol.IV, Utet Torino, 1959, p.430. Më shumë referohu: “Il nuovo Zingarelli”, minore, gennaio 2001, Milanostampa S.p.A. Farigliano (CN).

¹¹¹ Në enciklopedinë amerikane kontrabanda përkufizohet: “Kontrabanda është lëvizja e fshehur e mallrave në kufijtë e shteteve për të shmangur detyrimet doganore ose kufizimet e vendosura për import dhe eksport”. (West’s Encyclopedia of American Law, by Jeffrey Lehman and Shirelle Phelps, published in 2005).

¹¹² Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë.

përshkruar nga nenet 276 deri në 280, si dhe secili prej veprimeve të përshkruara në këto nene përbën kontrabandë dhe dënohet si i tillë¹¹³. Si rregull, ai përbën një “*transportim të fshehtë të mallrave, duke shkelur ligjin dhe rregulloret*”¹¹⁴.

Ligji doganor i vendeve të BE-së ka përkufizime të ndryshme për kontrabandën, por të gjitha përputhen në lidhje me elementët e veprës penale. Sipas Kodit Doganor Italian, me termin kontrabandë kuptohen të gjitha sjelljet mashtruese të lidhura me detyrimet e brendshme të konsumit, si dhe monopolet e shtetit¹¹⁵.

Ndërkohë që në Kodin Doganor Francez përcaktohet se “Kontrabanda ka të bëjë me import/eksportin jashtë zyrave doganore, sikundër me të gjitha shkeljet e dispozitave ligjore apo rregullave që kanë të bëjnë me ruajtjen dhe transportimin e mallrave në brendësi të territorit”¹¹⁶.

1.1 Kontrabanda në Shqipëri e në rajon, si dhe ndikimi në ekonomi.

Studimet mbi kontrabandën, si një fenomen ekonomik, kanë tërhequr vëmendjen e shumë studiuesve, mendimet e të cilëve janë reflektuar në doktrinat ekonomiko-juridike. Sipas disa autorëve, esencialisht kontrabanda njihet si aktivitet ekonomik import-eksporti. Pikësynimi kryesor i tyre ishte implikimi social i kontrabandës. Në kundërvënietë opinionit të përbashkët se sektori privat është më efikas se sektori publik, ata provuan se kontrabanda nuk mund ta rrisë kurrësi mirëqenien sociale, edhe pse ky fenomen mund t'i devijojë burimet nga qeveria, deri tek sektori privat¹¹⁷.

¹¹³ Kodi Doganor, neni 256/2.

¹¹⁴ Farlex Financial Dictionary. Published 2012, from Farlex, Inc. “Për shembull, dikush mund të kontrabandojë drogë ose mallra të tjera të paligjshme. Në mënyrë alternative, dikush mund të kontrabandojë mallra të ligjshme, duke i marrë ato në zona të ndaluara (siç janë burgjet) ose duke mos iu nënshtruar rregullave të aplikueshme (e tillë si mospagimi i një takse/tarife). Po aty.

¹¹⁵V. sul punto C. De Vincendintis, “Voce Contrabbando doganale in Novissimo Digesto italiano”, Vol.IV, Utet Torino, 1959, p. 430. Më shumë referohu “Il nuovo Zingarelli”, minore, gennaio 2001, MilanostampaS.p.A. Farigliano (CN). Sipas legjislationit doganor italian, kontrabanda mund të verifikohet në rastet e mëposhtme: Në lëvizjen e mallrave përtej kufijve tokësorë dhe në hapësirën doganore (art 282); Në lëvizjen e mallrave në liqenet kufitare (art 283); Në lëvizjen detare të mallrave (art 284); Në lëvizjen e mallrave në rrugë ajrore (art 285); Në zonat extradoganore (art 286); Në mospagim të taksave për përdorimin e mallrave të importuara me lehtësira doganore (art 287); Në magazinat doganore (art 288); Në lëvizjen jo shumë larg bregut (art 289); Në eksportimin e mallrave të pranuar si rikthim të të drejtave (art 290); Në importimin e përkohshëm.

Më shumë referohu: *Francesco Pittaluga*, “Kontrabanda e mallrave dhe kontrabandimi i duhanit të huaj”.

¹¹⁶«Code des douanes », version 20120302. Art. 418. Kategoria e mallrave. Vlerësohen si akt kontrabande: “Ndalohet të hyjnë ilegalisht mallrat, që i nënshtrohen taksave të konsumit të brendshëm” (Në përgjithësi, përshkrimi i figurës së veprës së kontrabandës në Kodi Penal Shqiptar, mbështetet në dispozitat e Kodit Doganor Francez për Kontrabandën (*Shënime të autorit*).

¹¹⁷Report of International Foreign Affairs and International Trade Canada [Human Trafficking and Migrant Smuggling - International Crime and Terrorism](#)

Në kundërshtim me sa më sipër, autorë të tjerë sugjerojnë një model kontrabande “prodhim zëvendësimi”, në të cilën çmimi ndryshon në bazë të kostos së furnizimit. Sipas tyre, kjo e dhënë ka rëndësi kritike, ngaqë çon në nxitje për kontrabandë¹¹⁸.

Duke i kushtuar vëmendje të veçantë çështjes së mallrave të akcizës¹¹⁹, sugjerohet se kontrabanda çon në uljen e prodhimit vendas. P.sh. midis faktorëve që çuan në falimentimin e industrisë së duhanit në Shqipëri, pas viteve 1990, ishte edhe kontrabandimi i cigareve. Prodhimi vendas i cigareve ishte subjekt i tatimit të vlerës së shtuar (TVSH-së), akcizës dhe taksave të tjera të konsumit, që, në atovite, arrinin deri në 100% të vlerës së mallit. Mirëpo, qarkullojnë mendime, se shmangia e taksave në nivel kombëtar mundëson prodhuesin vendas të furnizojë tregun me kosto më të ulët, duke çuar në këtë mënyrë drejt rënies së pabarazisë së çmimeve, faktor që inkurajon kontrabandën¹²⁰. Megjithatë, sugjerohet se ka një limit kufi përtej të cilit mund të ulen taksat e prodhimit vendas, gjë që nuk mund të akordojë një avantazh konkurrues kundër cigareve kontrabandë. Në këtorrethana, administrata doganore duhet të aktivizojë metodat anti-kontrabandë, duke shtuar koston mbi kontrabandën dhe duke e bërë kontrabandën jokonkurrense në treg.

Duhet theksuar se një ndikim të konsiderueshëm në kontrabandimin e mallrave ka stabiliteti në vend dhe rreth tij. Mungesa e stabilitetit në rajon, në periudhën e tranzicionit, dëmtoi rëndëzbatimin e ligjit, duke rritur ndjeshëm koston e tregtisë rajonale dhe, kësaj, edhe tarifave kontrabandës, të cilat për pasojë u kthyen në një tokë pjellore për krimineorganizuar në shkallë rajoni".

Lufta në Ballkan në vitet 90, në përgjithësi, dhe veçanërisht vendosja e embargos së tregtisë dhe armëve kundrejt Serbisë, ofruan një shans unik dhe krijuan kërkesën për mallra me tarifa të larta, të tilla si nafta, cigaret dhe alkooli. Përpjekjet e luftës përfshinin gjithashtu edhe dhënien e licencave tepër fitimprurëse për importin dhe kontrabandën e kontrolluar nga shteti në Serbi, duke krijuar një simbiozë ndërmjet zyrtarëve të sigurimit, politikanëve, zyrtarëve të zbatimit të ligjit dhe të doganave, por edhe kriminelëve të organizuar. Sanksionet nxitën bashkëpunimin ndërmjet kanaleve rajonale të kontrabandës, nëpërmjet vendeve ballkanike dhe rreth tyre, kryesisht të mallrave si nafta, cigaret, armët dhe mallra të tjera.

Në këtë mënyrë, kontrabanda u kthye në një burim të rëndësishëm të ardhurash për grupe të ndryshme, që varionin nga elitat politike, deri tek njerëzit që jetonin në zonat kufitare,

¹¹⁸ Raportet e Interpolitit mbi Trafikimin e Njerëzve “People Smuggling” <http://www.interpol.int>.

¹¹⁹ Fajzul Latif Chowdhury.

¹²⁰ Raportet e Interpolitit “Smuggling ...” <http://www.interpol.int/>

të cilët e shfrytëzojnë korrupsionin jo vetëm në nivel të ulët, por edhe në nivel të lartë, si pjesë themelore e biznesit të kontrabandës.

Ngritja e rrjeteve të kontrabandës, madje edhe përpara viteve 90, lidhur me trafikimin e cigareve, pas viteve 1990, vazhdojnë të jenë ende shumë aktive dhe janë transformuar në rrjete që merren me kontrabandën ose trafikun e mallrave të tjera, të ligjshme ose të paligjshme, të cilat kërkojnë ngatregjet rajonale ose përfundimtare. Përpjekjet aktuale për të vendosur regjimet e TVSH-së dhe një tregti më të liberalizuar ndërmjet vendeve, në zbatim të MSA-së, shërbejnë për uljen e nivelit të kontrabandimit të mallrave të zakonshme. Nëndritë në këtë shtet, ekonomia e vendit dhe të ardhurat publike do të vazhdojnë të kenë humbje.

Në një kontekst më të gjerë, Evropa vazhdon të jetë një nga tregjet kryesore të duhanit. Shtetet anëtare të Këshillit të Evropës zënë rreth 30% të prodhimit botëror të cigareve, 60% të eksportit global dhe më shumë se 50% të importeve globale. Duke pasur parasysh përmasat e tregut dhe mundësinë për të fituar të ardhura shtesë, në rast se shmangen detyrimet doganore dhe taksat, rreth 25% e cigareve që prodhohen në shkallë globale ose më tepër se 210 miliardë cigare (diferencat ndërmjet importit dhe eksportit të raportuar) shkon në tregun e zi. Mendohet se një e treta e kësaj shifre¹²¹ hyn dhe kalon kontrabandë në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës.

Në Evropën Juglindore, Greqia duket se është një prej vendeve kryesore të pikënisjes së cigareve dhe mallrave të tjera të akcizës, si alkooli dhe nafta, prodhimet ushqimore dhe gjëja e gjallë, por edhe veshjet dhe konfeksione të ndryshme të kontrabanduara në Evropë, ndërkohë që Italia, është një nga vendet kyçe të destinacionit dhe të tranzitit. Prandaj, nuk është për t'u habitur se përse vendet e Evropës Juglindore, vazhdojnë të shprehin shqetësime lidhur me kontrabandën e cigareve, akoma më shumë kur kjo çështje është një problem i madh për krimin ekonomik.

Kështu, mallratekstile, telefonacelularë, kompjuter, por edhe pjesë kompjuteri, të cilat e kanë origjinën nga Kina, futen kontrabandë drejt Shqipërisë dhe vendeve përreth nëpërmjet Greqisë, Turqisë dhe Bullgarisë. Gjithsesi, duket se kontrabanda e ushqimeve i shërben më tepër tregut vendas dhe shumë shpesh realizohet nëpërmjet individëve të shumtë, që kalojnë kufirin me automjetet e tyre privatë dhe transportojnë sasi të vogla të mallrave, prandaj bazë të ashtu quajturës "metoda fluturuese". Sipas studimeve dhe konstatimeve nga autoritetet doganore mendohet se këto lloje kontrabande të mallrave ushqimore merren persona të papunë, ose që nuk janë të punësuar në mënyrë të mjaftueshme, të cilët, sipas kësaj mënyre, shpresojnë të fitojnë disa të ardhura shtesë. Riambalazimi, rietiketimi dhe shitja e mallrave, të cilave u ka kaluar afati i përdorimit,

¹²¹ Më shumë shih "Raportin e Qendrës për Studimin e Demokracisë, Korrupsionit, Kontrabandës dhe Krimin i Organizuar në Evropë" (Corruption, Contraband and Organized Crime in Europe, 2013)

por edhe i mallrave ushqimore të falsifikuara që kanë popullaritet tek konsumatorët vendas, kërkon më tepër sofistikim¹²² të mallrave.

Organizatave kontrabandiste përfitojnë nga sistemi i tranzitit, i konceptuar për të lejuar pezullimin epërkohshëm të taksave dhe detyrimeve të tjera, me qëllim lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare. Ato përdorin kompanitë ndërmjetëse, shumica prej të cilave janë fiktive në Ballkan, për të porositur duhan apo cigare. Kompania blerëse, e cilashpeshherë është fiktive, më vonë jep udhëzimin që mallrat duhet të transportohen në vende të tjera, jashtë Bashkimit Evropian. "Transaksionet e shumëfishta që kryhen para se ngarkesa paligjshme të arrijë në destinacionin final, si qëllim të vetëm kanë fshehjen e blerësit të vërtetë, roli i të cilit konsiston në furnizimin e organizatave të kontrabandistëve. "Në këtë rast, cigaret pajisen me dokumente të reja dhe kanalizohen në tregun e zi vendas, ose hyjnë sërish kontrabandë në vendet e BE-së. Luftimi i rrjeteve të kontrabandës ndërkombëtare të duhanit bëhet edhe më i vështirë jo vetëm falë perceptimit të ngushtë të këtij problemi, por edhe duke e konsideruar thjesht si çështje evazioni fiskal.

Rrjetet e krimit të kontrabandës shfrytëzojnë mundësitë dhe strukturat e dobëta, pa përvojën e mjaftueshme të kontrollit dhe të bashkëpunimit ndërshtetëror. Cigaret dhe mallrat e tjera të akcizës të futura kontrabandë, janë më të preferuarat, ndërkohë që keqpërfaqësimi dhe raportimi i mallrave me vlerë më të ulët, rëndom maskohet pas ngarkesave të ligjshme. Korrupsioni i punonjësve të doganave dhe të kufirit, është vendimtar për këtë lloj aktiviteti. Përdorimi i dokumenteve dhe faturave false është gjithashtu vendimtar që ngarkesa të kalojë kufirin pa ndihmën e zyrtarëve "bashkëpunues".

¹²² Mallraves të akcizës dhe naftës ndërmjet Malit të Zidhe Bosnjë-Hercegovinës, po dhe kontrabandës bagëti (gjësë së gjallë) ndërmjet Malit të Zidhe Shqipërisë. Në fund të viteve 90, kontrabandë e duhanit është pakësuar, falë një kombinimi të presionit ndërkombëtar dhe të përpjekjeve të qeverisë vendase. Serbia e ka reduktuar në mënyrë të konsiderueshme kontrabandën e mallrave të akcizës, pas ndryshimit të regjimit politik në vitin 2000. Rruga që dikur shquhej për kontrabandën e cigareve përmes Malit të Zi është mbyllur, ndërkohë që tashmë rrugët e reja kalojnë nëpërmjet Kosovës, ish-Republikës Jugosllave, Maqedonisë, Bullgarisë, Rumanisë dhe Kroacisë. Kontrabandë e mallrave, të cilat rimbalsizohen dhe shiten në treg, është një tendencë relativisht e re në rajon, dhe jo vetëm në Serbi. Në vitin 2003 janë regjistruar shtatëmbëdhjetë raste të kontrabandës lidhur me krimin e organizuar, në të cilat janë implikuar 9 grupe kriminale dhe 70 kriminelë, nga të cilat, 16 raste, ku kanë qenë përfshirë 7 grupe me 32 kriminelë, janë ndjekur penalisht. Alkooli dhe cigaret që futen kontrabandë në Kosovë e kanë origjinën në Slloveni, Austri, Serbi, Mal të Zi, ish-Republikën Jugosllave, Maqedoni dhe Greqi, ndërkohë që markat e falsifikuara prodhohen kryesisht në Kosovë, por edhe në vendet fqinje, nga të cilat, më pas, hyjnë kontrabandë në Kosovë. Në vitin 2004 dhe në pjesën e parë të vitit 2005, janë regjistruar 332 raste të kontrabandimit të mallrave të akcizës dhe naftës ndërmjet Malit të Zi dhe Bosnjë-Hercegovinës, si dhe kontrabandës bagëti (gjësë së gjallë) ndërmjet Malit të Zi dhe Shqipërisë. Kontrabandë e duhanit në fund të viteve 90 është pakësuar, falë një kombinimi të presionit ndërkombëtar dhe të përpjekjeve të qeverisë vendase.

Mendohet se kontrabanda stimulon kërkesën, meqenëse ofron çmim më të ulët, por paprekur çmimin e mallrave të shumicës. Por, gjithsesi, ruajtja e avantazheve konkurruese në treg, ofron stimuj për bashkëpunim ndërmjet prodhuesve dhe kontrabandistëve të organizuar, duke ushqyer në këtë mënyrë një rrethvicioz. Kontrabandashërbënsi një strategji hyrjeje në treg, sepse i gjen mallrat (në rastin konkret cigaret) me çmime të ulëta, që është tepër e leverdishme, sidomos për konsumatorët e rinj, që kujdesen për imazhin e tyre dhe jetojnë në vende me të ardhura të ulëta. Nga ana tjetër, prodhuesit e duhanit e përdorin faktin e kontrabandimit për të lobuar uljen e taksave, me argumentin se taksat dhe akcizat e larta janë stimuj kryesorë për kontrabandën.

Sidoqoftë, në qendër të kontrabandës së mallrave të akcizës ngrihet një kufi tejet i hollë ndërmjet sferës ligjore, në rastin kur këto mallra janë porositur dhe blerë, dhe sferës së paligjshme, në rastin kur ngarkesa me pajisje të blera kalon me dokumente të paligjshme, akoma më keq, kur ajo hidhet në tregun e zi. Pikërisht në këtë zonë ndërmjetëse delikate, supozohet se Shoqëritë Tregtare bashkëpunojnë me kontrabandistët, apo deklarojnë mungesën e dijenisë për tregtinë tepër të abuzuar të tranzitit, shpeshherë me dijeninë apo implikimin e autoriteteve publike. Si rrjedhojë, të dy këta aktorë nxjerrin përfitime më të mëdha nga skema e kontrabandës.

2. Llojet e kontrabandës.

Në literaturën e huaj veprat penale në fushën doganore realizohen nëpërmjet dy kategorive:

- Mashtrim doganor (“intraispettivo”)
- Kontrabandë (“extraispettivo”)

Studiues të ndryshëm i qëndrojnë mendimit, se dallimi tradicional mes kontrabandës “extraispettivo” dhe kontrabandës “intraispettivo” konsiston në faktin se: e para zhvillohet duke mos i nënshtruar mallrat apo të mirat ndaj detyrimeve doganore dhe, e dyta, qëndron në faktin që mallrat i nënshtrohen detyrimeve doganore, por me mashtrime të atilla që çojnë në gabime të organeve apo institucioneve të vendosura për të saktësuar natyrën, sasinë, cilësinë ose destinacionin e mallit¹²³.

Autorë të tjerë, në varësi nga natyra dhe destinacioni i mallrave, tradicionalisht e kanë klasifikuar kontrabandën në dy kategori:

Kontrabanda absolute¹²⁴ dhe kontrabanda e kushtëzuar.

¹²³Stefano Civitelli. “Veprat e kontrabandës në ligjin e taksave”.

¹²⁴ Madje pas 11 shtatorit është bërë evidente “kontrabanda absolute”, që janë mallra që përdoren kryesisht si mallra të luftës. Kjo përfshin mallra, veshje dhe pajisje me natyrë ushtarake ose materiale si kimikate dhe lloje të caktuara makinerish, që mund të përdoren direkt në luftë apo të konvertohen/transformohen në instrumente të luftës. Kjo ndryshon nga “kontrabanda e kushtëzuar”, *ancipitis usus*, tek e cila gjejmë mallra

-Kontrabanda absolute, ndryshe kontrabanda e luftës sipas jurisprudencës, përbën një veprimtari të kundërligjshme, që konsiston në transportin apo furnizimin e fuqive ndërluftuese me gjithçka të nevojshme për zhvillimin e luftës dhe, si rrjedhim, fuqia tjetër, në gjendje lufte me të, ka të drejtë ta parandalojë furnizimin drejtpërsëdrejti ose tërthorazi.

Kontrabanda absolute ka të bëjë me mallra që përdoren kryesisht si mallra të luftës¹²⁵. Këtu përfshihen mallra, armë, teknologji dhe pajisje me natyrë ushtarake, materiale si armët, municionet, apo materiale të ndryshme, si kimikate, por edhe disa lloje të ndryshme aparaturash e makinerish, të cilat mund të përdoren direkt në luftë apo të konvertohen në instrumente të luftës¹²⁶, sikurse dhe llojet e caktuara të makinerive që mund të përdoren direkt në luftë apo të konvertohen/transformohen në instrumente të luftës¹²⁷.

-Në përbërje të kontrabandës së kushtëzuar përfshihen kontrabanda me mallra tregtare dhe mallra me përdorim të dyfishtë(*due use*)¹²⁸, që ushtojnë kontrabandimin me mallra të dyshuara për përdorim, si në luftë dhe për qëllime paqësore, si, për shembull, qymyri, ushqimet, pajisjet. Të gjitha këto janë të mira që përdoren për qëllime paqësore, por që njëherazi mund të jenë ndihmesë për luftën. Këtu qëndron dhe specifika e kontrabandës kushtëzuar, pasi tek ajo gjejmë mallra që mund të përdoren si për luftë, ashtu dhe për qëllime paqësore. Për shembull, qymyri, rezervat ushqimore, pajisje për mjete motorike¹²⁹. Më parë, kontrabanda e kushtëzuar njihej si kontrabandë rastësore. Këto kontrabanda ndryshojnë nga kontrabanda absolute, tek e cila përshihen armët,

që mund të përdoren si për luftë, ashtu dhe për qëllime paqësore. Për shembull, qymyri. Më shumë shiko: US Legal Program, Përkufizime të termave ligjorë për US Legal. Për më shumë <http://www.definitions.uslegal.com/a/absolute-contraband/>.

¹²⁵ Kontrabandimi i materialeve, pajisjeve dhe teknologjive bërthamore, është bërë një kërcënim i madh i sigurisë globale që prej shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. Databeizi i Agjencisë Internacionale për Energjinë Bërthamore përfshin 540 incidente për trafikun e materialeve radioaktive dhe bërthamore, nga viti 1993 deri në vitin 2003, të cilat janë konfirmuar nga qeveria e çdo vendi. Nga këto, 205 përfshinin materiale bërthamore dhe 17 përfshinin armë me përmbajtje uraniumi dhe plutoniumi, që me teknologji minimale ose me një përdorim më të gjerë të materialeve bërthamore, mund të përdoret për të ndërtuar pajisje për shpërndarje bërthamore, siç janë bombat e shfarosjes në masë. Pjesa më e madhe e incidenteve përfshijnë kontrabandistë që shesin materiale të jashtëligjshme. Më shumë shiko: “Modele për moslejimin e kontrabandës nukleare”. Kërkim nga David P. Morton, Feng Pan dhe Kevin J. Saeger. Nga University of Texas Austin. Publikuar në Nëntor 2005.

¹²⁶ San Remo Manual on International Law Applicable to Armed Conflicts at Sea (Cambridge University Press, 1995) at 148] International Committee of the Red Cross.

¹²⁷ Faqja zyrtare e US Legal Program, Përkufizime të termave ligjorë për US Legal. <http://www.definitions.uslegal.com/a/absolute-contraband/>

¹²⁸ Faqja zyrtare e US Legal Program, Përkufizime të termave ligjorë për US Legal <http://definitions.uslegal.com/c/conditional-contraband/>

¹²⁹ Po aty.

municionet dhe mallrat e tjerë me natyrë ushtarake. Kontrabanda e kushtëzuar është gjithashtu e njohur si *incipitis usus*. Ngarkesa të llojeve të tilla, edhe pse në sipërfaqe kanë karakter jo të dëmshëm, i nënshtrohen konfiskimit, sipas mendimit të forcave ndërluftuese që i konfiskon ato, së fundmi këto furnizime janë të destinuara të përdoren për forcat e armatosura kundërshtarë dhe jo për përdorim dhe konsum civil.

Në marrëveshjet e mëparshme midis shteteve, mallra të caktuara, si sapuni, letra, orët, makineritë bujqësore dhe bizhuteritë, u klasifikuan si jo-kontrabandë, por klasifikime të tilla rezultuan të pakuptimta në praktikë. Në kushtet e luftës moderne, ku konfliktet e armatosura përfshijnë në luftë të gjithë popullatën e fuqive ndërluftuese, pothuajse të gjitha mallrat janë klasifikuar nga palët kundërshtarë si kontrabandë absolute.

Në literaturën tonë juridike të fushës doganore, një ndarje e tillë është e paqartë, duke krijuar keqkuptime, si në konceptimin e krimeve të fushës doganore, ashtu edhe në kualifikimin e veprave penale të fushës doganore, gjë që kërkon studime të mirëfillta si në aspektet teorike, ashtu edhe në ato të fushës së praktikës gjyqësore.

2.1. Metodat e kontrabandës.

Në kontrabandë, fshehja mund të përsihjë fshehjen e mallrave kontrabandë ose mund të shkojë dhe më tej, deri në fshehjen e transportit në tërësi. Duke shmangur kontrollet kufitare, transportet bëhen me anë të anijeve të vogla, aeroplanëve privatë, nëpërmjet rrugëve tokësore, apo tuneleve të kontrabandës. Këto kalime të paligjshme janë të vlefshme edhe për emigrimin e paligjshëm. Në shumë vende të botës, sidomos në shtetet ku hapësira detare është tejet e ngushtë, në formën e kanaleve, (siç është edhe rasti i kontrabandimit në kanalën e Otrantos nëpërmjet gomoneve - *Shënimi i autorit*) mjete detar (anija) më efikas për kontrabandë janë varkat e shpejta "*the go fast boat*"¹³⁰.

Shumica e kontrabandistëve ia dalin mbanëduke përdorur mënyra nga më të ndryshmet, herë duke i nënshtuar kontrolleve kufitare me mallra ose njerëz të fshehur nëpër automjete, herë në mes të mallrave të tjerë ose të mirave të fshehura nëpër valixhe, apo nëpër rroba, madje herë-herë duke i fshehur edhe brenda trupit të tyre, kështu ata arrijnë të bëjnë fluturime të rregullta ajrore. Nënvlërësime të tilla kanë bërë që një numër i madh i të dyshuarve si kontrabandistët kapen çdo vit nga autoritetet doganore në mbarë botën. Jo vetëm mallrat, por edhe njerëzit janë kontrabanduar gjithashtu me anë të mjeteve të transportit detar, duke i fshehur në kontejnerë, ashtu sikurse me rrugë tokësore, të fshehur në makina, kamionë dhe trena.

¹³⁰"Snakes on plane averted as Argentina nabs trafficker". Deccanchronicle.com. December 26, 2011. <http://www.deccanchronicle.com/channels/world/latin-america/snakes-plane-averted-argentina-nabs-trafficker-628>. Retrieved December 27, 2011.

Fakt është se niveli i taksave mbi pijet alkoolike dhe duhanin ka çuar në një shkallë të lartë të kontrabandës së tyre mes Francës dhe Britanisë së Madhe, nëpërmjet tunelit që lidh këto dy vende.

Kombinimi midis korrupsionit dhe tarifave të larta të importimit, bëri që, në vitet 1970 dhe 1980, kontrabandistët të lëviznin në vijë ajrore në kufijtë shtetërorë pajisje elektronike, si stereo dhe televizorë nga një vend në një tjetër në mënyrë klandestine, duke përdorura pista të ndryshme në vendin pritës, duke shmangur përplasjet në kufijtë midis dy vendeve¹³¹. Një tjetër mënyrë e kalimit të kufijve,realizohet duke përdorur pasaporta false (pasaporta krejtësisht false ose ilegalisht të ndryshuara, apo pasaporta identike ilegale).

Ekzistenca e kontrabandës “Multi–Consignment” MCC (kontrabandimi i më shumë dy llojeve të ndryshme të mallrave kontrabandë, si droga dhe emigrantët e paligjshëm, ose droga dhe armët në të njëjtën kohë) u vërtetua pas përfundimit të një studimi, që gjeti 16 raste të dokumentuara të kontrabandistëve, që transportonin më shumë sesa një lloj të kontrabandës në po të njëjtën dërgesë¹³².

3. Lufta kundër kontrabandës.

Përkundër dallimeve të tyre, të gjitha marrëdhëniet e paligjshme u binden të njëjtave rregulla kardinale të kërkesës dhe ofertës, madje nxiten nga e njëjtën logjikë konkurrencës, e përfitimit, e vitalitetit për të qenë krijues, të fitojë pjesën e tregut, si dhe të zvogëlojë kostot e prodhimit. Gjithçka përqendrohet në një synim të vetëm: të gjenerojnë fitime të shpejta me rrezik më të vogël. Duke bërë këtë veprim, kufiri mes të ligjshmes dhe të paligjshmes po bëhet i megjullt, si rrjedhojë rreziqet për gjithë lojtarët e përfshirë në prodhimin e konsumit të produkteve, si dhe zinxhirit të ofrimit janë duke u shndërruar në tejet të rëndësishme.

Deri tani, asnjë sistem nuk ka rezultuar i suksesshëm për të luftuar mashtrimin, apo falsifikimin lidhje me kontrabandën (me disa përjashtime). Gjithashtu, mund të pohohet se asnjë kornizë ligjore nuk ka arritur me të vërtetë objektivin e saj kryesor: Pra, të sigurojë qasjen e të gjitha produkteve që janë ekonomikisht të pranueshme, duke siguruar jo vetëm integritetin e tyre,por edhe ligjshmërinë dhe pajtueshmërinë.

Në mbarë botën, më shumë se dy miliardë konsumatorë vuajnë nga problemet që lidhen me produktet që janë të "sëmura", mashtruese apo të falsifikuara, të cilat janë burim

¹³¹Bhagwati, J. and B. Hansen: “A Theoretical Analysis of Smuggling”, *Quarterly Journal of Economics*, 1973, p.172.

¹³²Chowdhury, F. L. “Smuggling, Tax Structure and the Need for Anti-Smuggling Drive”, *Fiscal Frontier*, Vol VI, 2000.

fitimii konsiderueshëm për organizata ndërkombëtare kriminale apo mafies lokale¹³³. Në këtë këndvështrim, lufta e ndërmjetme e kontrabandës, nga njëra anë, varet nga numri i rojeve kufitarë tëpunësuar, nga niveli i organizimit dhe nga motivacioni i autoriteteve mbikëqyrëse, dhe, nga ana tjetër, nga boshllëqet që ekzistojnë në legjislacionin kombëtar

Politikat kundër kontrabandës janë të ndryshme në shtete të ndryshme. Në Shtetet e Bashkuara të Amerikës menaxhohet nëpërmjet agjencive të ndryshme federale, përfshirë Shërbimin Doganor Amerikan¹³⁴. Ligjet federale ndalojnë importimin e një numri të caktuar artikujsh, që janë të dëmshëm për shëndetin publik ose mirëqenien, duke përfshirë këtu bimët dhe kafshët e sëmura, filma dhe revista me përmbajtje të turpshme, si dhe narkotikët e paligjshëm. Importimi i këtyre artikujve të caktuar ndalohet për qëllime ekonomike ose politike. Për shembull, Shtetet e Bashkuara të Amerikës¹³⁵ e kanë të ndaluar tregtinë me Kubën, që do të thotë se purot kubane nuk janë të ligjshme për t'u importuar. Rrjedhimisht, ky kufizim çon në kontrabandën e purove kubane në Shtetet e Bashkuara. Ligji federal ndalon gjithashtu edhe eksportimin e armëve ushtarake apo mjeteve që lidhen me mbrojtjen kombëtare, pa leje të caktuar eksporti. Përveç kësaj, ligji federal ndalon importimin e mallrave, për të cilat kërkohen detyrimet doganore apo akcizë dhe që për më tepër nuk janë paguar. Detyrime të tilla janë të përcaktuara në ligjin federal për të rritur të ardhurat dhe për të ndikuar në tregti.

Për të luftuar kontrabandën, shërbimi doganor gëzon autoritetin dhe përgjegjësinë për të kontrolluar jo vetëm individin dhe bagazhet e tij, por edhe ndonjë pako ose kontejner të dërguar nëvend. Megjithatë ka probleme p.sh. policia nuk mund të kryejë kontrole apo kërkime pa pasur një mandat, ku të shënohet shkaku i dyshimit për veprimtari të paligjshme ose dhe konsensusin e personit që po i nënshtrohet këtij kontrolli. Kërkesa të tilla nuk zbatohen gjatë kontroleve kufitare. Agjentët doganorë kanë të drejtë të kërkojnë këdo në kufi edhe pa pasur asnjë arsye, edhe pse zakonisht ata kryejnë kontrole të sendeve apo kontrole të plota të individëve, të cilët ngjallin dyshime¹³⁶.

¹³³ PierreDELVAL, 02 Shkurt2011, WAITOFondacion:«Një alternativë aktuale kundër antifalsifikimit të politikave».

¹³⁴ Patrullat Kufitare të ShBA-s, Rojet Bregdetare dhe DEA (Drug Enforcement Administration).

¹³⁵ BWest's Encyclopedia of American Law, by Jeffrey Lehman and Shirelle Phelps, published in 2005.

¹³⁶ Kontrabandistët zbatojnë dy mënyra për zhvendosjen e të mirave (mallrave). Njëra realizohet nëpërmjet kalimit të ngarkesave ndërmjet kufijve pa i zbuluar. Kontrabandistët kalojnë narkotikë të paligjshëm nga Meksika nëpër zona të largëta të Amerikës jugperëndimore të izoluar ndërmjet kufijve midis Meksikës dhe Shteteve të Bashkuara, duke përdorur aeroplanë, kamionë apo njerëz "mushka". Metoda tjetër është metoda e fshehjes. Për shembull, një kontrabandist mund të fshehë lëndën narkotike ilegale në vende të paarrishme në anije ose makina, në valixhe apo në ngarkesa të mallrave, madje dhe tek vetë personat. Disa korrierë droge gjëlltisn përmbajtësa droge për të evituar zbulimin e drogës në rast kontrolli. Në rast se ndonjë udhëtar posedon diçka që ai ose ajo nuk ua ka deklaruar inspektoreve doganorë apo çfarëdolloj malli të

Ligji federal në SHBA dhe në BE ka vendosur sanksione të ashpra për veprën penale të kontrabandës. Një individ mund të dënohet thjesht duke pasur në posedim mallra të paligjshme, kur prania e tyre nuk shpjegohet në mënyrë adekuate. Kushdo që është fajtor për kontrabandimin e mallrave në mënyrë të vetëdijshme, për mallra që janë të ndaluara me ligj ose që kanë kaluar doganën, si edhe për mallra që merren, shiten, transportohen ose ndihmon në kryerjen e njërit prej këtyre akteve, mund të akuzohet për vepër penale (krim) dhe mund të vlerësohet me dënime civile. Malli në vetvete, si dhe çdo anije apo mjet që përdoret për të transportuar atë, mund të konfiskohet¹³⁷.

Shtetet Evropës Juglindore e kanë intensifikuar luftën kundër kontrabandës dhe mallrave të falsifikuara të konsumit përreth kufijve të vendit, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mallrave të rreme prodhuar në disa nga vendet e rajonit¹³⁸. Sigurisht, me hyrjen e fuqi të rregullave dhe ligjeve "mbi liberalizimin" e mallrave tranzit brenda Komunitetit Evropian, objekte materiale të kontrabandës mund të jenë vetëm mallrat me origjinë ekstrakomunitare, pra jashtë BE-së. Megjithatë, përse i përket karakteristikave strukturore të rasteve inkriminuese të mëposhtme, ato artikulohe në një gamë masash parandaluese që përshkruajnë analitikisht sjellje, të cilat, sipas përvojës së policisë kufitare, përbëjnë mënyrën më të zakonshme të realizimit të kontrabandës, të kësaj vepre penale ose tregojnë qëllimin e kryerjes së saj, ose ende janë simptoma të evazionit ...

ndaluar, udhëtari detyrohet të paguajë detyrimet e caktuara për mallin, plus gjokat, si dhe rrezikon të arrestohet. Agjentët doganorë kanë të drejtë të konfiskojnë mallrat e paligjshme.

¹³⁷ Kufiri midis asaj që është e ligjshme dhe çfarë është e paligjshme po bëhet i mjegullt, ndaj rreziqet për të gjithë lojtarët ekonomikë dhe konsumatorët po bëhen shumë të rëndësishme. Globalizimi i krimtë është dhe ndoshta do të mbetet, një nga shtrëngesat më të mëdha, që ndikojnë në tërësinë e shoqërisë në shekullin e 21-të. Në fushën e pakicës së vëllimit, trafiku i paligjshëm ka ekzistuar gjithmonë. Por, me globalizimin dhe rënien e Murit të Berlinit, qasja e lehtë për mjetet e transportit dhe zhvillimi i internetit, ka fituar një dimension transnacional. Sot, këto tregje janë bërë të ndërvarura, veçanërisht në mjedisin e konsumit, kufalsifikimi i ushqimit, mashtrimi dhe kontrabanda konvergojnë.

¹³⁸ Doganierët maqedonas thonë se kapja e mallrave të falsifikuara mbron pronësinë private të pronës dhe forcon shkëmbimet ligjore të biznesit. "Vitin e kaluar, 91 akuza penale janë lëshuar për mallrat kontrabandë të 141 subjekteve juridikë dhe individë. Shuma totale e taksave doganore që shmangej ishte rreth 4.800.000 €. Në total, 737 shkelje ligjore, janë paraqitur në gjykatë. Kontrabandistët u gjobitën me shumën totale prej 1.5 milion euro, dhe ishte një total prej 285.000 € në monedhë të huaj të konfiskuara prej tyre", - tha Vanço Kargov, Drejtor i Administratës Doganore Maqedonase për SE Times. Doganierët e Maqedonisë konfiskuan më shumë se 500.000 mallra në vitin 2012, duke përfshirë tekstile, stoli, armë, pajisje mjekësore, mallra teknike dhe ushqim. Studimi i Evropës Juglindore..

Pjesa e Dytë

KREU I

ANALIZA E VEPRËS PENALE TË KONTRABANDËS

- 1. Disa aspekte të përgjithshme të së drejtës penale doganore**
 - 1.1 Kuptimi i të drejtës penale doganore**
 - 1.2 Probleme teoriko-praktike lidhur me figurën penale të kontrabandës**
- 2. Elementet e veprës penale të kontrabandës**
 - 1.1 Objekti i përgjithshëm**
 - 1.1.1 Struktura grupore dhe objekti i krimit të kontrabandës**
 - 1.1.2 Objekti i drejtpërdrejtë**
 - 1.2 Ana objektive**

- 1.2.1 Fshehtësia dhe mashtrimi**
- 1.2.2 Përgatitja, tentativa dhe përfundimi i krimit të kontrabandës**
- 1.2.3 Shmangia nga detyrimet doganore**
- 1.2.4 Mënyrat e kryerjes së kontrabandës**
- 1.2.5 Vendi për kryerjen e kontrabandës**
- 1.3 Ana subjektive**
 - 1.3.1 Përgjegjësia, paramendimi dhe pakujdesia**
 - 1.3.2 Motivi dhe qëllimi**
 - 1.3.3 Faji**
 - 1.3.4 Përrjashtimi nga faji dhe arsyet justifikuese**
- 1.4 Subjekti i shkeljes doganore**
 - 1.4.1 Subjekti i posaçëm**
- 2. Konkurrimi**
- 3. Rrezikshmëria shoqërore e krimit të kontrabandës**

1. Disa aspekte të përgjithshmetë së drejtës penale doganore

Në teorinë lidhur me veprat penale të kontrabandës mund t'iklasifikojmë mendimet apo pikëpamjet e poshtëshënuara siç është për objekt studimi:

- a)** Krimi i kontrabandës është një vepër penale kryesisht formale, megjithëse ka raste që kërkon jo vetëm shmangien nga kontrolli doganor, por edhe shmangien nga detyrimet doganore.
- b)** Kalimi apo zhvendosja e mjeteve nëpërmjet kufirit doganor, duke përdorur dokumente identifikimi false, apo të shoqëruara me mosdeklarim ose deklarim të pasaktë, duhet konsideruar kryesisht si kontrabandë pa tërësinë e normave të shmangies nga pagesat doganore.
- c)** A është kontrabanda, në raport me shmangien, normë speciale, ndërsa shmangia është normë e përgjithshme.
- d)** Kontrabanda nëpërmjet kalimit nga territori i RSH, ka si qëllim të vetëm përfitime kriminale ekonomike, apo qëllime dhe interesa të tjera që mund të mos kenë lidhje me përfitime ekonomike. Ku duhet të përfshihen krimet në fushën doganore: në të drejtën penale doganore apo në të drejtën penale të përgjithshme.

Pamjaftueshmëria e një qasjeje të njëjtë për çështjet e mësipërme, si në teori, ashtu edhe në praktikë, krijon vështirësi në kualifikimin e veprës penale të kontrabandës, madje shpeshherë dhe të padrejtë. Në të njëjtën kohë, kualifikimi i drejtë i krimeve ka njëherazi rëndësi të madhe për veprimtarinë praktike të hetuesve, punonjësve të hetimit paraprak, si dhe gjykatës, për goditjen e veprave penale të kontrabandës me efikasitetin e ligjit.

1.1 Kuptimi i të drejtës penale doganore

Referuar doktrinës, studimi i veprave penale të fushës doganore përbën objektin e së drejtës penale doganore, si pjesë e të drejtës së posaçme penale. Në literaturën tonë juridike nuk përmendet termi “*E drejta penale doganore*”, por nënkuptohet, pasi gjendet në të drejtën e posaçme penale, si tërësi normash juridike të vendosura nga Shteti, që parashikojnë figurat konkrete të krimeve doganore që përmban aktualisht Kodi Penal dhe Ligji Doganor, elementet përbërëse të tyre, si dhe sanksionet përkatëse për çdo figurë të kriminit të kontrabandës¹³⁹. Gjithsesi, veprat penale të fushës doganore përfshihen në konceptimin e të drejtës së përgjithshme penale pasi “parimet”, domethënë legaliteti i veprave penale dhe dënimeve, si dhe elementet përbërëse të veprave penale, janë të aplikueshme edhe në rastin e një vepre penale doganore¹⁴⁰.

Në kushtet kur legjislatori ka vendosur unifikimin e ligjit doganor (KD) të dispozitave zbatuese me atë komunitar (MCC) dhe, nisur nga fakti që çdo shtet i vendeve komunitare vazhdon të ketë një ligj kombëtar për shkeljet doganore, ku përfshihet edhe krimi i kontrabandës, evidentimi i të drejtës penale doganore duhet të përfshihet jo vetëm në terminologjinë juridike, por edhe të konceptohet drejt klasifikimi i krimeve doganore në shërbim të efikasitetit të luftës kundër kriminalitetit, si në fushën ekonomike, ashtu edhe në fusha të tjera: pra, në luftën kundër terrorizimit, në zbatimin detyrimeve ndërkombëtare në tregtinë ndërkombëtare, në mbrojtjen e konkurrueshmërisë, në mbrojtjen e jetës së njerëzve, në mbrojtjen kafshëve dhe bimëve.

Sipas studiuesve të huaj, e drejta penale doganore ka disa tipare të veçanta që e karakterizojnë në raport me të drejtën penale të përgjithshme. Vepra penale doganore konceptohet kryesisht si formale, çka nënkupton se, në të shumtën e rasteve, “thjesht” kryerja e disa akteve (p.sh. *kalimi i parregullt i kufijve, ose ekzistenca e një shtate objektive, mbajtja e mallrave, për të cilat nuk mund të provojmë se janë futur në një shtatë të rregullt*), mjaftojnë për të përcaktuar autorin e veprës pa qenë e nevojshme të tregojmë qëllimin deliktual të tij¹⁴¹. E drejta penale doganore, ashtu sikundër e drejta penale e përgjithshme, një kategori të krimeve doganore, p.sh. Për veprat penale të kontrabandës nëpërmjet kalimit në/dhe nga kufiri shtetëror, i konsideron “të konsumuara që nga çasti i kalimit, pa qenë nevoja që vepra të arrijë rezultatin e dëmshëm”¹⁴², pra përpara se vepra të konsumohet, manifestimi objektiv i qëllimit kriminal është i dënueshëm. Ndërkohë që, për disa krime doganore, ndryshe nga kontrabanda përmes kalimit të kufirit, kërkohet edhe rezultati i pasojës, apo shmangia nga detyrimet e importit. Nga ana tjetër, e drejta penale karakterizohet nga një lehtësi relative, me të cilën

¹³⁹Seksioni i krimeve të fushës doganore, neni 171-179, i Kodit Penal dhe pjesa VIII e Kodit Doganor, nenet 276-280.

¹⁴⁰Jean-François Foucaud.

¹⁴¹BERR C.-J, «Introduction au droit douanier», Economica (Botimi i fundit 2008).

¹⁴² Komentari i Kodit Penal...

ajo lejon që të ndiqen jo vetëm autorët e veprës materiale, por edhe personat që kanë pasur një “interes për mashtrimin”¹⁴³.

Në fushën doganore veprimet kriminale ekzistojnë vetëm në funksion të një sjelljeje objektive të kundërligjshme “si shprehje juridike e rrezikshmërisë shoqërore të veprës”¹⁴⁴. Përveç veprave të cilat paraqesin një lloj aktiviteti (p.sh. kontrabanda nëpërmjet kalimit), kemi edhe vepra me mosveprim (p.sh. mosdeklarimi, apo deklarimi ndryshe nga ai i konstatuar nga autoriteti doganor gjatë importimit, eksportimit dhe regjimeve doganore). Gjithashtu, duhet të mbajmë parasysh se veprat doganore janë në akumulim real me veprat penale të së drejtës penale të përgjithshme. Gjykata mund të prononcohet mbi fajësinë e një individi, duke marrë parasysh të dyja veprat penale, nga njëra anë, sepse kemi të bëjmë me pluralitet vlerash morale të mbrojtura^{145/146} dhe, nga ana tjetër, sepse kemi diferencim të elementeve legalo-materiale dhe morale¹⁴⁷. Kështu ndodh p.sh. në fushën e lëndëve narkotike¹⁴⁸.

1.2 Probleme teorike praktike lidhur me figurën e veprës penale të kontrabandës.

Në literaturën juridike, me vepra penale në fushën doganore, kuptohen ato vepra, veprime ose mosveprime të kundërligjshme, që prekin interesin shtetëror, sepse janë kryer me dashje, ose me qëllim përfitimi material¹⁴⁹.

Mendohet se përcaktime dhe perceptime të kësaj natyre, edhe pse hasen jo rrallë në literaturën juridike, e kufizojnë së tepërmi konceptimin e veprave penale në fushën doganore dhe, në veçanti, qëllimin e krimit të kontrabandës, duke e lidhur vetëm me përfitimin material. Në fakt, siç kemi theksuar në këtë punim, kontrabanda mund të kryhet edhe për qëllime të tjera, siç mund të jetë shmangia nga kontrolli doganor, por jo nga pagesa e plotë e detyrimeve të importit, apo për një veprimtari të kundërligjshme, siç përcaktohet në nenin 171 të Kodit, por që mund të mos kryhet për përfitime materiale, por për qëllime të tjera, si p.sh. për terrorizëm, thyerje embargoje, etj. Ndaj e gjejmë me

¹⁴³BERR C.-J, « Introduction au droit douanier», Economica (Botimi i fundit 2008).

¹⁴⁴ Ismet Elezi & “Komentari i Kodit Penal ...”.

¹⁴⁵Jean-François Foucaud.

¹⁴⁶ Cass. crim, 11 qershor 2008, rekurs nr. 07-83400.

¹⁴⁷ Cass. crim, 2 qershor 1999, rekurs nr. 98-82017.

¹⁴⁸ Pastrimi i parave Cass. crim, 21 shkurt 2007, rekurs nr. 06-85929.

¹⁴⁹ Ismet Elezi. “E Drejta Penale”, Pjesa e posaçme, viti 2009.

vend t'i përmbahemi nenit 256/3 të Kodit Doganor, ku jepet përkufizimi i kontrabandës si “shmangia ose tentativa për të shmangur, në çfarëdo mënyre, kontrollin dhe/ose mbikëqyrjen doganore mbi mallrat me qëllim shmangien e pagesave të detyrimeve të importit/eksportit apo përfitime të tjera, siç është përshkruar në nenet 276 deri 280, të Kodit, si dhe, çdoveprim i përshkruar në këto nene, përbën kontrabandë dhe dënohet si e tillë”¹⁵⁰. Duke iu përmbajtur këtij përkufizimi, vlerësojmë se vepra e kontrabandës, konsiston :

- Në veprimin apo mosveprimin, që ka si qëllim apo synon t'i shmanget me dashje drejtpërdrejtë kontrollit dhe mbikëqyrjes doganore mbi mallrat dhe mjetet që kalojnë, depozitohen, në/dhe nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me qëllim shmangien nga detyrimet e importit/eksportit apo për përfitime të tjera të kundërligjshme.
- Këto veprime apo mosveprime të parashikohen në nenet 276 deri në 280 të Kodit Doganor dhe në nenet 171 deri në nenet 179 të Kodit Penal.
- Shkelja të jetë kryer nga një person fizik ose juridik.
- Kontrabanda si vepër penale ndryshe nga shkeljet e kundërvajtjes përfshin edhe tentativën.

Referuar jurisprudencës së fushës doganore në vendet komunitare dhe praktikës gjyqësore pas viteve 1992, nuk mund të mos pranojmë se vepra penale e kontrabandës përbën krim¹⁵¹, e cila dallohet për kompleksitetin e madh që reflektohet në procesin e kualifikimit, duke ndikuar në shumë raste në keqkuptimin ligjit, si dhe zbatimin e tij në mënyrë të gabuar nga policia gjyqësore në hetimin e çështjes, nga akuza dhe gjykatësit, madje edhe nga avokatët gjatë procesit gjyqësor.

Për klasifikimin e drejtë të veprës penale të kontrabandës është e domosdoshme të trajtohen disa nga çështjet më problematike dhe t'u jepet përgjigjja e duhur mbi baza shkencore. Veçanërisht, çështje që kanë të bëjnë me: Përmbajtjen e veprës penale të kontrabandës, veçoritë dalluese nga vepra penale e zakonshme, çështje të konkurrimit të veprave kontrabandë, objekti, vendi i kryerjes së kontrabandës, momentiindalimit apo përfundimit të kontrabandës, si dhe të bëhet i mundur dallimi i veprës penale të kontrabandës nga kundërvajtja.

Studiues të së drejtës penale doganore, lidhur me veprën penale të kontrabandës, nënvizojnë faktin se çfarëdolloj kontrabande pakëson të ardhurat e buxhetit të shtetit, ngaqë objekti i përgjithshëm janë marrëdhëniet shoqërore të vendosura për funksionimin

¹⁵⁰ Neni 256 i Kodit. Termi “Kontrabandë” do të thotë mashtrimi doganor që konsiston në lëvizjen e mallrave përmes një kufiri doganor në mënyrë klandestine. Konventa Nairobi.

¹⁵¹ Në të vërtetë, në Zvicër kontrabanda nuk është konsideruar përgjithësisht si vepër penale, por ndiqet nga e drejta penale fiskale. Marco Polli-Schönborn “**Contrabbando**”, published 10/11/2011

normal të veprimtarisë doganore dhe për mbrojtjen e interesave ekonomikë të shtetit nga çfarëdo veprimtarie, që ka si qëllim shmangien e pagimit të detyrimeve doganore në buxhetin e shtetit. Pra, kryesisht diskutohet për anën objektive të një krimi të tillë me qëllim shmangien nga pagesat doganore¹⁵².

Në këtë përcaktim duhet të shprehemi me rezerva për faktin, se, edhe pse në Kreun III të veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike elementet e parashikuar në nenet 172 -174,177, të Kodit Penal, madje edhe neni 179, 176 i Kodit Penal, të çojnë në mendimin se kemi të bëjmë me krime të sferës ekonomike, përveç këtyre dispozitave, për krimet e fushës doganore në Kodin Penal dhe në Kodin Doganor¹⁵³ janë përcaktuar dispozita konkrete, që lidhen vetëm me shmangie nga kontrolli apo importimi, eksportimi dhe tranzitimi paligjshëm i mallrave të ndaluara, pa i kushtëzuar me qëllimin e shmangies nga detyrimet doganore¹⁵⁴.

Në këto kushte është e nevojshme të diskutojmë se klasifikimi i kontrabandës, po dhe shmangia nga kontrolli dhe nga pagesat doganore ka disa veçori, që shpjegohen me specifikën e veprimtarive të tilla. Më qëllim që të bëhet një vlerësim i drejtë i veprimtarive me rrezikshmëri shoqërore, të kryera në sferën e çështjeve doganore dhe jo vetëm në të, vlerësojmë se kërkohet t'u referohemi si normave penale, ashtu edhe atyre doganore, administrative, tatimore, financiare dhe degëve të tjera të së drejtës.

Për të diskutuar rreth konflikteve të kësaj natyre, le të marrim rastin e subjektit ekonomik, i cili ka deklaruar 20 ton cigare mall, të blerë nga një firmë me qendër në *Cooper*, mirëpo pas kontrollit doganor konstatua se këto cigare ishin me pullë fiskale të falsifikuar, ndërsa manifesti e kishte të korrigjuar datën e nisjes. Për këtë arsye, autoriteti doganor e konsideroi shkeljen doganor kontrabandë, duke e klasifikuar në nenin 174 – “Kontrabandë me mallra me akcizë”. Pas hetimit, çështja u bë objekt gjykimi. Prokuroria e pushoi çështjen penale, ngaqë mungonte ana subjektive, duke urdhëruar kthimin e mallit të sekuestruar: cigare dhe automjete. Në kundërvënien e vendimit të Prokurorisë për pushimin e çështjes penale, u ngrit padi nga Dogana duke kërkuar shfuqizimin e vendimit për kthimin e mallit të sekuestruar dhe automjetit të subjektit. Pala e paditur e kundërshtoi padinë, me arsyetimin se malli objekt krimi, kur nuk vërtetohet vepra penale, i kthehet subjektit.

¹⁵² Ismet Elezi. “E Drejta Penale”, Pjesa e posaçme, viti 2009.

¹⁵³ P.sh. në nenin 278 “Kontrabanda në det”, theksohet që: “Kryen kontrabandë në lëvizjen e mallrave në rrugë detare kapiteni i mjetit lundrues që: ... (b) ndërsa transporton mallra në mjetin lundrues i afrohet portit, hedh spirancën, ose ndalon në afërsi të portit pa lejen e autoriteteve doganore; ... (f) transporton mallra nga një doganë në një tjetër pa dokumentet përkatëse të tranzitit”, apo në nenin 280 “Rastet e tjera”, ku thuhet: “Quhet gjithashtu kontrabandë: ... (h) thyerja e vulës doganore, zëvendësimi ose ndërrimi i shenjave të tjera të sigurisë, të vendosura mbi mjetin e transportit ose mbi mallrat”, nenin 278/b të Kodit Doganor.

¹⁵⁴ Kodi Penal. Seksioni i Krimeve në fushën e doganave, neni 171; Kodi Doganor, neni 280.

Për zgjidhjen e këtij konflikti duhet t'i referohemi jo vetëm ligjit penal dhe atij doganor, por edhe ligjit tatimor, ku përcaktohet qartë se malli pa pullë konfiskohet. Për rrjedhojë, vendimi i prokurorit është i kundërligjshëm dhe duhet të kthehet, duke vendosur kalimin për procedim në organin doganor apo duke proceduar administrativisht për të konfiskuar mallin: cigare pa pullë fiskale.

Për më tepër, ndryshe nga legjislacioni i vendeve të BE-së, kontrabanda në legjislacionin tonë gjen rregullim juridik në Kodin Doganor, si shkelje doganore, nën 276-279, 280 të Kodit Doganor dhe, si krime në fushën doganore, nën 171- 179 të Kodit Penal. Kjo i ka dhënë shkas faktit, që, si në zbatimin praktik, ashtu edhe në doktrinë, të ketë diskutime në lidhje me dallimet midis kundërvajtjes dhe kontrabandës, rrezikshmërisë të tyre, ligjit material, faktit se ku duhet të përcaktohen normat ligjore të kontrabandës, autoriteti procedues, etj. Madje, referuar praktikës gjyqësore, diskutimet janë shtrirë më tej, me mendimin se “bashkekzistenca e Kodit Penal me Kodin Doganor krijon jo pak probleme në cilësimin ligjor të rasteve të kontrabandës”¹⁵⁵.

Në këto rrethana, natyrisht me rëndësi është jo vetëm kuptimi i drejtë teorik i figurave të krimit në fushën doganore, analiza e elementeve të veprës dhe figurës së kontrabandës, por edhe harmonizimi i dispozitave të Kodit Penal, për sa i përket veprës penale të kontrabandës me ato të Kodit Doganor. Për më tepër, studimet teorike marrin rëndësi për faktin se hartimit i dy ligjeve, pra të ligjit doganor dhe atij penal, është bërë në kohë të ndryshme, në kushtet e një përvojete pamjaftueshme në formulimin e vetë figurave të kontrabandës, ndërkohë që edhe vetë praktika gjyqësore në atë kohë ka qenë e vakët¹⁵⁶, si në fushën penale, ashtu dhe në atë administrative doganore.

Sa më sipër, nuk mund të mos konstatojmë se:

- Ka dublime në përcaktimin e krimeve në fushën doganore, në Kodin Doganor me atë Penal, madje edhe me shkeljen doganore kundërvajtje. (Si shembull shërben vepra penale e kontrabandës me mallra të ndaluara, me atë të sendeve me vlera kulturore kombëtare, neni 280 i Kodit Doganor, me nenin 171, 176 të Kodit Penal;

¹⁵⁵ Ismet Elezi. “E Drejta Penale”. Pjesa e posaçme, viti 2009, Shtëpia botuese “ERIK”.

¹⁵⁶ Në çështjen “Shteti kundër të gjykuarve I.N & Kolegji Penal”, me vendim nr. 56, datë 15.02.06, ka arsyetuar se Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 64, datë 28.02.2005, ka prishur vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe ka pushuar çështjen penale në ngarkim të gjithë të pandehurve, me arsyetimin se Gjykata e Shkallës së Parë, në dhënien e vendimit, ka zbatuar gabim ligjin material penal. Ajo e bazon vendimin e saj në një kod administrativ, ndërkohë që Kodi Penal parashikon dy figurat e veprave penale të kryera nga të pandehurit, në seksionin V, ku përfshihen krimet në fushën e doganave. Përcaktimi që i bën kontrabandës ligjvënësi nën 276 e vijues të Kodit Doganor, ka të bëjë me kontrabandën si kundërvajtje administrative dhe jo si vepër penale. Po të pranohej e kundërta, kontrabanda nuk do të dënohej penalisht dhe dispozita e nenit 174 të Kodit Penal do të mbetej pa fuqi. (Më shumë shiko vendimin nr. 56, datë 15.02.06 të GJL).

tregtimi i mallrave kontrabandë, neni 280 i Kodit Doganor, me nenin 178 në Kodin Penal, tjetërsimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë; apo neni 261- 268 i Kodit Doganor, deklarimi ndryshe në sasi, cilësi, etj., me mosdeklarimin e saktë, deklarimin e rremë për llojin, cilësinë të parashikuar në nenet 172-178 të Kodit Penal), të cilat jo rrallë janë bërë objekt diskutimi teorik, keqkuptimesh, madje edhe në cilësimin ligjor të rasteve të kontrabandës nga praktika gjyqësore me pasojë rëndimin e pozitës së shkelësit, apo lehtësimin e padrejtë të tij.

- Ka pasaktësi në terminologji dhe, në disa raste, formulime të paqarta, të cilat kanë çuar në keqinterpretime, veçanërisht në cilësimin e figurës së kontrabandës, në përlllogaritjen e dëmit të shkaktuar gjatë shqyrtimit të padisë civile në procesin penal.
- Në ndonjë rast, edhe kufijtë ndarës të shkeljes doganore si kundërvajtje nuk janë shumë të qarta, në raport me veprën penale të kontrabandës, duke e vështirësuar deri në njëfarë mase organin e akuzës dhe gjykatën në klasifikimin e shkeljes doganore në kundërvajtje apo kontrabandë. (neni 261-271 i Kodit Doganor me nenet 172-177 të Kodit Penal).
- Përkufizimi i kontrabandës mund të ishte më gjithëpërfshirës jo vetëm në fushën ekonomike, por edhe në fusha të tjera jetike për shoqërinë, ndërkohë pasojat nuk duhet të shprehen vetëm në detyrimet doganore, pasi ato shtrihen edhe në fushën fiskale (si detyrime importi/eksporti dhe jo vetëm si detyrimeve doganore).
- Në Kodin Doganor duhet të jenë të përcaktuara të gjitha figurat e krimit të kontrabandës, përfshirë edhe sanksionet duke mbajtur parasysh që ndarja të bëhet :
 - a) Sipas veprimeve dhe llojit të mallit, regjimit doganor¹⁵⁷.
 - b) Sipas rrezikshmërisë, në vepra penale të kontrabandës së thjeshtë dhe në vepra penale të cilësuar të kontrabandës¹⁵⁸.

¹⁵⁷Në kodin penal ekzistues, ndarja është bërë sipas llojit të mallit, regjimit doganor të tyre, dhe rrezikshmërisë, por nuk parashikohen ndarja e veprave penale të kontrabandës së thjeshtë me atë të rëndë. Lidhur me këtë, në çështjen penale “Shteti kundër J.M.” &.. Kolegjeve të Bashkuara të GJL duke analizuar veprën penale të kontrabandës kanë arsyetuar se: “Në këtë seksion (seksioni i V-të) ligjvënësi ka përfshirë krimet në fushën e doganave, duke i ndarë në nëntë figura të veçanta krimi... Në këtë përfundim arrihet pasi objektin e përgjithshëm të gjithë këtyre figurave të veçanta krimi, që përfshihen në këtë seksion, e përbëjnë të njëjtat marrëdhënie shoqërore. E përbëjnë marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë dhe për mbrojtjen e interesave ekonomike të saj nga çfarëdo lloj veprimtarie që ka për qëllim shmangien nga pagimi në buxhetin e shtetit të detyrimeve doganore, të cilat, në analizë të fundit, llogariten në të holla. Ndarja e figurës së përgjithshme të krimit të kontrabandës në shtatë figura të veçanta kontrabandë është bërë nga ligjvënësi duke u nisur së pari, nga natyra e mallrave, me të cilat bëhet kontrabanda, regjimi juridik i tyre; së dyti, nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të secilit prej këtyre llojeve të kontrabandës dhe së fundi, nga subjekti, duke krijuar kështu, kushte ligjore të përshtatshme për të bërë të mundur zhvillimin e një lufte sa me efektive kundër kriminalitetit në një sferë aq të rëndësishme të ekonomisë, siç është ajo e veprimtarisë së organeve të doganës. (Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të GJL, nr. 1 datë 26.03.2002).

- Për kontrabandën e mallrave të ndaluara të ketë më shumë ndarje të veprës penale, duke përfshirë kontrabandën me mallra për luftën, për trafikimin e materialeve për ndërtime të pajisjeve nukleare, mallrave të tjera radioaktive, si dhe ato të karakterit të dyfishtë, apo për pastrimin e parave¹⁵⁹.
- Rishikimi i dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit Doganor të bëhet njëherazi, duke mbajtur parasysh faktin se gjendemi përpara shkeljeve në fushën doganore, megjithëse përparësiduhet të kenë dispozitat e Kodit Doganor.
 - Në legjislacionin doganor të mëparshëm¹⁶⁰, por edhe në legjislacionin doganor të vendeve komunitare, figura e kontrabandës ndahet në të thjeshtë dhe të cilësuar¹⁶¹. Kjo ndarje, në figurat e veprës penale të kontrabandës, mungon jo vetëm në legjislacionin tonë penal, por edhe në atë doganor, ndaj nëProjekt Kodin Doganor, një ndryshim i tillë do të ishte absolutisht një hap tjetër i rëndësishëm, pasi realisht ekzistojnë rrethana cilësuese të veprës penale të kontrabandës, si kontrabanda e kryer si zakon, trafikim, me grup të organizuar apo të armatosur, me mallra specifike, si cigare, karburant, teknologji që mund të përdoret për armë të shkatërrimit në masë, apo me mallra të karakterit të dyfishtë, etj.
 - Në Kodin Doganor dhe në Kodin Penal, figurat e veçanta të veprës penale të kontrabandës janë “forma të veçanta të figurës së përgjithshme të kontrabandës, variante të veçanta të saj, pasi objekti i përgjithshëm i të gjitha figurave të veçanta të krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për funksionimin normal të doganave...”¹⁶².

Në këtë kuadër, duke iu referuar edhe qëndrimit që mbajtën Kolegjete Bashkuaratë Gjykatës së Lartë¹⁶³, si dhe nisur nga fakti që ligji ynë penal dhe ligji doganor është një ligj i përafëruar me atë të vendeve të BE-së, në Kodin Penal, dispozita e kontrabandës nevojitet të jetë medoemos e hapur, (blanket apo referuese), dhe të gjitha figurat e plota të veprës penale të kontrabandës të përfshihen në Kodin Doganor. Pasi kjo është edhe praktika legjislative e vendeve të BE-së¹⁶⁴.

¹⁵⁸ Këtë e gjejmë edhe në Kodin doganor Italian dhe Francez. Më shumë shiko: Ligji nr. 92 i 2001., Codice Doganale, Code des douanes Version 20120302.

¹⁵⁹ Mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjitë me përdorim të dyfishtë janë ato mallra, lista e të cilave miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, të përditësuar në zbatim të ligjit nr. 9707, datë 05.04.2007, "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import - eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë.

¹⁶⁰ Kodi doganor i Mbretërisë Shqiptare vitit 1938; Kodi doganave i vitit 1957

¹⁶¹ Nuovo codice doganore; Code des douanes Version 20120302. Më shumë referohu edhe Francesco Pittaluga, Kontrabanda e mallrave dhe kontrabandimi i duhanit huaja.

¹⁶² Ismet Elezi. "E drejta penale", Pjesa e posaçme, viti 2009.

¹⁶³ Vendimi nr. 1, datë 26.03.2002, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

¹⁶⁴ BERR C.-J, «Introduction au droit douanier», Economica, botimi i fundit 2008.

Së fundi, por jo nga rëndësia e këtij studimi, duhet të pranojmë se problemi i harmonizimit të së drejtës penale doganore me atë të vendeve të BE-së nuk është aq i thjeshtë, sa ç'është harmonizimi i Kodit Doganor (projekt 2014) me atë të BE-së (MCC) për arsye se:

-Në stadin e tanishëm të arritur nga BE-ja në fushën doganore, e drejta penale doganore shfaqet vetëm si një "ishull kombëtar i pavarur". Në asnjë fushë tjetër të së drejtës doganore, nuk është shfaqur një rezistencë kaq domethënëse për harmonizimin, sa ajo e shfaqur për litigacionet doganore. Deri më sot, tentativat e Komisionit, për të marrë nga shtetet anëtare një vizion konkret rreth sanksioneve doganore, kanë dështuar¹⁶⁵. Mirëpo, nga pikëpamja racionale, asgjë nuk është mëalogjike, sesa situata aktuale. Atëherë, kur Kodi Doganor Komunitar dhe Kodi ynë, që pritet të hyjë shpejt në fuqi, imponon operatorëve ekonomikë detyrime të njëjta, cilido qoftë vendi ku ata kryejnë operacione doganore, shkëlja e këtyre detyrimeve do të trajtohet nga çdo shtet sipas rregullave të tyre të brendshme, si ato në themel dhe në procedurë.

Në këto kushte, shtrohet pyetja rreth arsyeve për të cilat dy vepra penale doganore identike (*p.sh. Dy deklarime të rreme mbi vlerën, dy kalime të paligjshme*) mund të dënohen me sanksione të ndryshme, kjo si rezultat i vendit ose shtetit ku ato janë kryer. Disa studime krahasuese serioze kanë treguar, se, nga shteti në shtet, ekziston më shumë se diferenca në shkallë e rreptësisë së ndëshkimit: sipas rastit, i njëjti veprim mund të ndëshkohet me një gjobëtë thjeshtë ose me dënim me heqje lirie. Disa shtete (duke përfshirë këtu edhe Francën) shkojnë edhe më tej në klasifikimin e veprave penale doganore, duke i konsideruar si vepra të natyrës penale edhe kundërvajtjet doganore, ndërkohë që shtete të tjera bëjnë një dallim midis parregullsisë administrative dhe veprimeve deliktuale, në veçanti, duke marrë parasysh në qoftë se autori i tyre kishte për qëllim apo jo të thyente rregullat.

Në njëfarë mënyre, rezistenca e shteteve ndaj përpjekjeve për të përafruar fushën e litigacioneve doganore, bazohet në disa konsiderata juridike. Është e vërtetë që traktatet komunitare nuk përmbajnë dispozita për të drejtën penale në fushën e tyre të aplikimit, dhe Shtetet kanë përmendur në këtë fushë gjithnjë prezencën e sovranitetit të tyre. Argumenti nuk është i bindshëm, pasi shtetet kanë humbur më shumë nga sovraniteti i tyre, sesa çka mund të humbin në fushën ndëshkuese, p.sh. për rastin e monedhës¹⁶⁶.

Nga ana tjetër, nuk mund të themi kurrëse se litigacionet doganore nuk janë cenuar aspak nga rregullat e BE-së. Edhe përkufizimi i disa prej veprave doganore, mund të kryhet vetëm duke marrë parasysh rregullat në themel të së drejtës doganore komunitare. Po ashtu, KEDNJ-ja dhe GJEDNJ-ja ka mundur t'iu imponojë Shteteve respektin e disa

¹⁶⁵ Po aty BERR C.-J, «Introduction au droit douanier».....

¹⁶⁶ Po aty BERR C.-J, «Introduction au droit douanier»

parimeve, si p.sh. parimin e proporcionalitetit¹⁶⁷. Kjo ka bërë që, me gjithë problemet qëparashtrihen lidhur me të drejtën penale doganore, për hir të së vërtetës nuk mund të mos pranojmë faktin, se, si në Kodin Doganor, ashtu edhe në atë Penal, janë bërë ndryshime të mëdha në lidhje me shkeljet doganore, në tërësi, dhe kontrabandën në veçanti, duke siguruar një *“mbrojtje juridike penale më të efektshme nga shkeljet në fushën doganore”*¹⁶⁸.

Për këto arsye, mendojmë se është e nevojshme të ndalemi veças në shpjegimin teorik të shkeljeve doganore, në veçanti të veprave penale të kontrabandës, duke përfshirë edhe rastet kur dispozita ligjore është e karakterit përshkues, apo kur kërkon një interpretim më të zgjeruar, pasi kështu ndihmohet praktika hetimore dhe gjyqësore në cilësimin e rregullt juridik të shkeljeve doganore dhe në zbatimin e drejtë të ligjit kundër subjekteve fajtoresh. Ndërkohë qëakuzës dhe gjykatës, në cilësimin e veprës penale të kontrabandës, deri në një rishikim tërësor të teorisë së veprave penale të kontrabandës dhe përfshirjen e tyre në Kodin Doganor, do t'u duhet t'i referohen si neneve 171-179 të Kodit Penal, ashtu edhe 276-280 të Kodit Doganor¹⁶⁹.

2. Elementet e veprës penale të kontrabandës.

Legjislatori, në rastin e përcaktimit të shkeljes doganore kontrabandë nëpërmjet dispozitave 276-280 të Kodit, ndryshe nga legjislacioni i vendeve komunitare¹⁷⁰, është mjaftuar vetëm me përshkrimin e anës objektive të veprave penale të kontrabandës, ndërsa në Kodin Penal, në seksionin e krimeve të fushës doganore¹⁷¹ janë analizuar të gjitha elementet e veprës së kontrabandës, duke përfshirë jo vetëm anën objektive, por

¹⁶⁷ RIDEAU-VALENTINI S., «Contribution à l'étude des particularismes de la matière pénale douanière », thèse 1999.

¹⁶⁸ Ismet Elezi. “E Drejta Penale”, Pjesa e posaçme, viti 2009.

¹⁶⁹ Në çështjen “Shteti kundër te gjykuarit A.D”, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke anuluar vendimet e dy gjykatave me Vendimin nr. 531, datë 03.11.2004, ka arsyetuar se: “Vendimet e të dyja gjykatave janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit ... dhe i gjykuari duhet të deklarohet i pafajshëm”. Po t'i referohemi dispozitave të Kodit Doganor, të cilat përcaktojnë edhe veprimin se kush përbën kontrabandë, pasi vetë neni 174 i KP është një dispozitë relativisht e hapur, rezulton se veprimet e të gjykuarit, edhe pse të kundërligjshme në kushtet se si janë pranuar të provuara nga gjykatat, nuk përbëjnë veprë penale. Neni 280 i Kodit Doganor e konsideron kontrabandë heqjen, apo falsifikimin e numrave të identifikimit të mjeteve të transportit, edhe për mbajtësin e automjetit apo pronarin e tij, në rast se ai ka dijeni për falsitetin e dokumentit dhe është bashkëpunëtor me kryesinë e tij. Në këtë procedim, nuk ka persona të tjerë të marrë në përgjegjësi, nuk ka përfundime se kush ka ndërhyrë në regjistrin përkatës të kartotekës së qarkullimit të degës Gjirokastër dhe, nëse i gjykuari ka pasur dijeni, se dokumentacioni i automjetit të tij ishte i falsifikuar. Nisur nga sa më sipër, Kolegji Penal çmon se mungojnë disa nga elementet e figurës së veprës penale në rastin në shqyrtim, ana subjektive dhe objektive, gjë që bën të paprovuar se nga ana e të gjykuarit ekzistojnë veprime që përbëjnë veprën penale të kontrabandës me mallra të tjerë. (Më shumë shiko: Vendimin nr. 531, datë 03.11.2004 të Gjykatës së Lartë).

¹⁷⁰ Shih Kodin Doganor Francez, Italian.

¹⁷¹ Kodi Penal, seksioni i krimeve në fushën doganore. Botim i vitit 2003.

edhe anën subjektive, subjektin, si dhe dënimet përkatëse, madje në dispozita të veçanta ka parashikuar dhe subjektin e veçantë.

Për të zbatuar në mënyrë të përpiktë e të njëjlojtë ligjshmërinë, cilësimin e saktë të shkeljeve doganore, madje në raste të veçanta për të ndarë shkeljen doganore si kundërvajtje nga vepra penale e kontrabandës, gjykatës, organit të akuzës, avokatëve, madje dhe studimeve doktrinare u kërkohet të analizojnë dhe të sqarojnë elementet e veprës penale të kontrabandës, si: objektin, anën objektive, anën subjektive, subjektin dhe, në veçanti, ndryshimet midis anës objektive të kalimit të paligjshëm dhe shmangies nga kontrolli e mbikëqyrja për t'iu shmangur detyrimeve të importit.

- **Objekti i veprës penale**

Për lehtësi studimi të këtij elementi përbërës të krimit në teorinë e së drejtës penale, *objekti* është ndarë në *objekt të përgjithshëm* dhe *objekt të drejtpërdrejtë*.

2.1. Objekti i përgjithshëm

Vëmë në dukje, se objekti i përgjithshëm i gjithë figurave të veçanta të krimit të kontrabandës është marrëdhënia juridike e vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë në kryerjen e misioneve të saj, të cilat mbrohen nga legjislacioni doganor dhe penal¹⁷². Objekti i shmangies nga pagesat e importit është marrëdhënia shoqërore lidhur me “*hyrjet*”, domethënë të ardhura, të cilat futen në buxhetin shtetëror nëpërmjet përfitimit të tyre (pagesat e detyrimeve të importit dhe tatime si akciza e TVSH-së dhe taksa të tjera) nga persona fizikë e juridikë. Duke vepruar në objektin e krimit, kriminelin shkel një marrëdhënie të caktuar shoqërore, e cila mbrohet nga legjislacioni penal. Tek figurat e tjera të kontrabandës, neni 171,175,176,178 të Kodit Penal, objekt është shmangia nga kontrolli doganor, por mund të ndodhe që kjo shmangie të mos ketë qëllime për t'iu shmangur nga pagesat e detyrimeve doganore.

Duke u nisur nga sa më sipër, lidhur me objektin e përgjithshëm të krimeve doganore, pozicioni është i dukshëm e i pranueshëm nga të gjithë, madje nuk është objekt diskutimi midis studiuesve dhe atyre që merren me zbatimin e ligjit penal në fushën doganore. Pozicioni i ndërlikuar i të drejtës penale të fushës doganore, mendoj se ka krijuar përcaktimine nocionit të objektit grupor dhe atë të drejtpërdrejtë për veprat penale doganore, gjë që edhe sot e kësaj dite nuk ka një interpretim të njëjtë unik, si nga studiuesit, ashtu edhe nga organi i akuzës, nga gjykatat, madje edhe nga avokatët.

¹⁷² Ismet Elezi. “E Drejta Penale”, Pjesa e posaçme, viti 2009.

2.1.1. Struktura grupore dhe objekti i krimit të kontrabandës.

Referuar të drejtës penale, çdo veprë penale (këtu përfshihen edhe krimet në fushën doganore), cenon apo vë në rrezik një objekt të caktuar të mbrojtur nga ligji¹⁷³. Në rastin e veprave penale të kontrabandës, po edhe për veprat e tjera penale, përveç objektit të përgjithshëm të përmendur më lart, doktrina njih edhe objektin grupor ku përfshihen vepra penale të kontrabandës me karakteristika të përbashkëta, që lejojnë grupim të marrëdhënies të përbashkëta që cenohen nga krimi kontrabandë dhe vepra e veprave penale, objektine cenimit me karakter të përgjithshëm të kontrabandës dhe objektin e drejtpërdrejtë, që konsiston në marrëdhënien juridike konkrete që preket dhe është nën mbrojtjen e ligjit.

Duke u nisur nga natyra e mallrave, me të cilat bëhet kontrabanda, nga regjimi juridik i tyre, nga shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të secilës natyrë kontrabande dhe, së fundi, nga subjekti, ligjvënësi i ka ndarë në 9 figura të veçanta krimi (nenet 171-179 të Kodit Penal), të cilat, me përjashtim të figurave të krimit të parashikuar nga neni 178 (tregtimi i mallrave që janë kontrabandë) dhe neni 179 (ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë), janë forma specifike të figurës së përgjithshme të kontrabandës, variante të veçanta të saj. Në këtë përfundim arrihet pasi objektin e përgjithshëm të gjithë këtyre figurave të veçanta krimi, që përfshihen në këtë seksion, e përbëjnë të njëjtat marrëdhënie shoqërore: pra, marrëdhëniet shoqërore që janë vendosur për funksionimin normal të doganave në Republikën e Shqipërisë, si dhe për mbrojtjen e interesave ekonomike të saj nga çfarëdolloj veprimtarie që ka për qëllim shmangien nga pagimi në buxhetin e shtetit të detyrimeve doganore, të cilat, në analizë të fundit, llogariten në të holla¹⁷⁴.

Sipas tyre, ligjvënësi, për arsye praktike, duke dashur të lehtësojë zbatimin sa më të drejtë të tyre në funksion të zhvillimit të një lufte sa më efektive në fushën kriminalitetit, e ka ndarë kontrabandën në disa figura krimi, të cilat, teorikisht dhe praktikisht, mund të përbënin paragrafë të veçantë të së njëjtës dispozitë të pjesës së posaçme të Kodit Penal.

Mendoj se nënndarja e mësipërme, parë nga këndvështrimi i nenit 171, mallrat e ndaluara, po edhe për karakteristikate lartpërmendura mund të ketë nevojë për një nënndarje, duke veçuar mallrat e ndaluara, të cilat për nga pikëpamja e objektit mund të dallohen qartë disa ndryshime thelbësore në prekjen e marrëdhënies shoqërore.

Për këtë arsye:

Në grupin e parë, duhet të hyjnë krimet që cenojnë gjithmonë rregullat e vendosura për ndalimin e hyrjes, tranzitimit dhe eksportimit të mallrave apo vendosjes të tyre nën

¹⁷³ Ismet Elezi & Komentari i Kodit Penal.

¹⁷⁴ Vendimi nr. 1, datë 12.03.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës Lartë.

regjime të tjera doganore, për shkak të ndalimeve kategorike me Konventa Ndërkombëtare¹⁷⁵ ose me ligje të veçanta, të cilat paraqesin rrezikshmëri të lartë dhe specifika shoqërore¹⁷⁶.

Në grupin e dytë, përfshihen ato krime të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e rregullave të importimit, eksportimit/rieksportimit/tranzitimit të mallrave në kundërshtim me ligjin, vetëm në rrethana të caktuara dhe që në këtë rast kërkojnë një licencë të veçantë dhe i nënshtrohen një kontrolli të veçantë¹⁷⁷.

Në grupin e tretë, përfshihen krimet që cenojnë marrëdhëniet e vendosura për importimin, tranzitimin, eksportimin apo të vendosjes të mallrave nën një regjim doganor, që, si rregull, kanë të bëjnë me mallra me detyrime të larta (akcizë)¹⁷⁸ apo që kërkojnë autorizim nga një institucion shtetëror¹⁷⁹.

Në grupin e katërt, përfshihen krimet që cenojnë rregullat e vendosura për zhvillimin normal të veprimtarisë së tregtisë dhe vendosjen e mallrave nën procedura të veçanta doganore, të shkëmbimeve kulturore, apo nëtregtimin, transportimin, ruajtjen dhe depozitimin e mallrave. Në këtë grup të përfshihen: Importimi, eksportimi i vlerave kulturore kombëtare¹⁸⁰, si dhe tregtimi, tjetërsimi, transportimi, ruajtja, depozitimi i mallrave që dihet botërisht se janë kontrabandë (Neni 176, 178 të Kodit Penal)¹⁸¹. Mendoj se në grupimin e mallrave me vlera kombëtare, *së pari*, duhet të konsiderohen veprat që kanë të bëjnë me mallrat me vlerë kombëtare brenda territorit shqiptar, pasi vendndodhja e këtyre mallrave i kalon kufijtë shtetëror; dhe, *së dyti*, duhet të përfshihen edhe rastet e moskthimit në territorin shqiptar, të arritjeve në fushën e artit, historisë apo arkeologjisë së popullit shqiptar, brenda dhe jashtë territorit të tij.

Në këto kushte, duke përfshirë gjithashtu edhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të këtyre llojeve të krimit të kontrabandës dhe, së fundi, të subjektit, kompleksiteti i karakteristikave të elementeve të krimit vlerësuar nga ana e së Drejtës Penale të parashikuara në normat e analizuara më lart, kushtëzojnë nevojën e një studimi të thellë juridik, gjë që, nga ana e saj, merr një kuptim të thellë shkencor e praktik, në problemin apo çështjen e vlerësimit të drejtë të rrezikshmërisë shoqërore dhe klasifikimin e krimeve të kryera në importim/eksportim/tranzitim apo në kushtet e një procedure të veçantë doganore.

¹⁷⁵ P.sh. importimi, tranzitimi i lëndëve helmuese, mbetjet radioaktive, etj. është përherë i paligjshëm, pasi këto mallra janë të ndaluara me Konventë Ndërkombëtare apo me ligj të veçantë.

¹⁷⁶ (Neni 171 KP, 179/1 dhe neni 6 i ligjit nr. 9086, datë 19.06.2003).

¹⁷⁷ P.sh. artikulli armatim.

¹⁷⁸ P.sh. artikulli mallra, karburante, cigare, pije alkoolike.

¹⁷⁹ Si p.sh. artikulli fishekjarrë, eksplozivë, etj.

¹⁸⁰ Neni 176 i Kodit Penal.

¹⁸¹ Neni 176 i Kodit Penal.

Në radhë të parë, kjo ta të bëjë jo vetëm me objektin grupor, por edhe me *objektin* e krimeve që analizohen apo merren për studim, d.m.th të rrethit të marrëdhënieve shoqërore që mbrohen nga ligji penal, ku krimi dëmton ose krijohet rreziku i realizimit të një dëmi të tillë. Ky rreth marrëdhëniesh nuk është statik, sepse ndryshon në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm në varësi me kushtet konkrete historike të zhvillimit të shtetit, por edhe nga marrëdhëniet e reja që lindin e forcohen në sferën praktikë-ekonomike e sociale të jetës shoqërore.

2.1.2. Objekti i drejtpërdrejtë.

Gjatë zgjidhjes së problemit të objektit të drejtpërdrejtë të kontrabandës, duke u bazuar në përfytyrimin mbi kundërligjshmërinë e kontrabandës nëpërmjet kalimit, zhvendosjes në/dhe nga kufiri shtetëror, si një – *veprimtari e ndaluar me ligj penal*, formulimi i objektit të drejtpërdrejtë të kontrabandës mund të konceptohet, si *vendosja me ligj e rregullit për kalimin e mallrave apo të objekteve të tjera nëpërmjet kufirit* (kufirit doganor) *nëshkelje të marrëdhënieve shoqërore të lindura midis organeve qeverisëse shtetërore, nga njëra anë, dhe personave fizikë e juridikë, nga ana tjetër, në procesin e kalimit të mallrave nëpërmjet kufirit doganor.*

Si rregull, objekti i drejtpërdrejtë është dëmtim i marrëdhënieve ekonomike, por në kushtet e sotme të misionit të doganës në sigurimin e integruar të kufijve, objekti duhet të konsiderohet në një këndvështrim më të gjerë, duke përfshirë dëmtimin e marrëdhënieve që kanë të bëjnë me konkurrencën, me sigurinë kombëtare, me mbrojtjen e jetës së njerëzve, të kafshëve, të bimëve, të ekosistemit në përgjithësi, të veprave me vlerë artistike dhe pronësisë intelektuale¹⁸².

Për rrjedhojë, objekt i drejtpërdrejtë i trajtimit të krimit mund të lidhet vetëm me veprimet që shkelin rregullat e vendosura për eksport, import, tranzit të mallrave dhe vendosjes së tyre në procedura të veçanta doganore të përcaktuar në ligj, i cili përbën veprimtari ekonomike me jashtë apo veprimtari që ka të bëjë me sigurinë kombëtare, mbrojtjen e jetës së njerëzve, të kafshëve dhe bimëve. Ky konkluzion rrjedh direkt nga përmbajtja e dispozitave të nenit 171 të Kodit Penal, neneve 276- 280 të Kodit Doganor dhe akteve ligjore e nënligjore të fushave të tjera lidhur me importimin, eksportimin dhe tranzitimin e këtyre mallrave. Kështu, ligjvënësi nëpërmjet ligjit “Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, në lidhje me importimin, eksportimin dhe trazitimin apo vendosjen

¹⁸² Kontrabanda është e ndaluar nga ana e pikëpamjes ligjore, sepse dëmton interesat madhore të shteteve kombëtare apo të Fuqive të Mëdha. *Marco Polli-Schönborn*.

në një procedurë të veçantë doganore për një kategori mallrash, ka përcaktuar tre kushtëzime:

A. Cilësitë specifike të objektit, për shkak të të cilave është:

- I ndaluar për t'u futur në territorin doganor në bazë të Konventave apo ligjeve të veçanta.
- I kushtëzuar, importimi/eksportimi/tranzitimi, për arsye të mundësive për përdorim të dyfishtë, d.m.th., nga njëra anë, i destinuar vetëm për prodhimin e produkteve me karakter paqësor qytetar dhe, nga ana tjetër, gatishmëria e menjëhershme për krijimin dhe prodhimin e armatimeve dhe teknikës luftarake, ndër të cilët edhe armët e dëmtimit në masë, ose të mjeteve për transportimin e tyre në destinacionin e duhur

B. Kontroll special për mallrat dhe shërbimet e destinuara për importim, tranzitim, eksport, si dhe vendosjen në një procedurë të veçantë, të cilat kanë synim përdorimin e dyfishtë në treg, pra për realizimin, apo shitjen e tyre (ose dhënien apo ndërrimin d.m.th këmbimin).

C. Hyrjes, tranzitimit dhe daljes jashtë territorit doganor, apo vendosjes në një procedurë të veçantë, duke iu nënshtruar kontrolleve të veçanta për evitimin e eksportit/importit apo tranzitit jashtëligjshëm të mallrave dhe shërbimeve të paraqitura më lart, ngaseme akte ligjore dhe nënligjore janë përcaktuar listimi i mallrave, kompetencat, rregullat e import-eksportit të tyre, si dhe procedurat përkatëse të kontrollit¹⁸³.

¹⁸³ Ligji nr. 9707, datë 05.04.2007, "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë".

Neni 2: Përkufizime: "Transferim ndërkombëtar i mallrave", është eksportimi, importimi, riekportimi i mallrave, lëvizja e përkohshme e tyre, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kalimi tranzit i mallrave përmes territorit të saj, si dhe ndonjë transfertë tjetër mallrash jashtë këtij territori, në të cilën janë përfshirë subjekte të ndryshme.

Neni 4: Lista e mallrave - fusha e kontrolleve.

1) Kontrolli i transferimeve ndërkombëtare shtrihet mbi të gjitha mallrat që janë pjesë e listës së mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë të miratuara me VKM, të përditësuara në mënyrë vjetore dhe që dalin në zbatim të ligjit nr. 9707, datë 5.4.2007.

2) Mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjisë me përdorim të dyfishtë edhe gjatë importit, eksportit, kalimit tranzit, për qëllime jo tregtare dhe që mbahen nga udhëtarët në sasi të vogla, janë objekt ligjësimi nga Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe kontrollohen nga Shërbimi Doganor...

3) Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve është përgjegjës për përditësimin e listave të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjitë me përdorim të dyfishtë, duke informuar në kohë Autoritetet Doganore për të gjitha ndryshimet në të.

2) Mallrat ushtarake dhe mallrat e teknologjisë me përdorim të dyfishtë janë ato mallra, lista e të cilave miratohet me Vendim të Këshillit të Ministrave, të përditësuara në zbatim të ligjit nr. 9707, datë 05.04.2007 "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë".

b. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 43, datë 16.01.2008 "Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve".

Gjithashtu, duke u nisur nga interpretimi shkencor i dispozitave të nenit 171, 176 të Kodit Penal dhe nenit 276 të Kodit Doganor, lidhur me objektin e veprës penale të kontrabandës, shqyrtohet që objekti i kontrabandës të konsiderohet si rregull i lëvizjes, (apo zhvendosjes) të ngarkesave (apo mallrave, sendeve me vlerë apo të çdo mjeti tjetër), si dhe të mjeteve transportuese gjatë kalimit përmes kufirit doganor, rregull ky i vendosur për sigurimin e veprimtarisë ekonomike të importimit, eksportimit apo tranzitimit, d.m.th. marrëdhëniet shoqërore që lindin midis organeve shtetërore të pushtetit e drejtimit, nga njëra anë, dhe të subjekteve, persona fizikë dhe juridikë, nga ana tjetër, në procesin e kalimit të mallrave në/dhe nga kufiri doganor, gjatë importimit, tranzitimit dhe eksportimit.

Ky konceptim, i lidhur drejtpërdrejtë me objektin e kontrabandës, ka gjetur pasqyrim në Kodin Doganor të vitit 1999 dhe në ligjin doganor¹⁸⁴ që pritet të hyjë në fuqi. Kështu, neni 2 i Kodit Doganor përcakton se “Autoritetet doganore duhet të jenë kryesisht përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregtisë ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, për këtë arsye të kontribuojnë për tregtinë e hapur dhe të drejtë të politikës sëtregtisë dhe të politikave të tjera shqiptare, që ndikojnë në tregti dhe, mbi të gjitha, të sigurojnë hallkat e misionit mbrojtës¹⁸⁵”.

Përveç kësaj, për të gjykuar objektin e krimit është e arsyeshme të analizojnë mjetin e atentatit apo të shkeljes, objektin material ku drejtohet veprimi (apo mosveprimi), ndaj të cilit i jep veprimtarisë rrezikshmëri shoqërore të një niveli të caktuar. Duke qenë element apo karakteristikë e domosdoshme e kontrabandës, mjeti i kontrabandës ka një specifikë

c. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 09.02.2011 "Për miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve".

1) Punonjësi doganor duhet të pranojë regjimin doganor, vetëm në rastet kur subjekti plotëson të gjithë dokumentacionin e duhur dhe paraqet licencën apo autorizimin origjinal, si dhe kopje të noterizuar për praktikën doganore përkatëse.

2) Në rastet e eksportit, importit, tranzitit të mallrave, të cilat janë objekt i këtij Memorandumi, Shërbimi Doganor duhet të kryejë kontroll të veçantë.

3) Në rast të ndonjë parregullsie në dokumentacion, në gjendjen fizike, në identifikimin e mallit, apo në rast dyshimi të arsyetuar, punonjësi doganor duhet të kontaktojë personat e kontaktit në AKSHE, të përcaktuar në Aneksin "Personat e Kontaktit".

4) Në rastin kur importuesi apo agjenti i autorizuar doganor i paraqet punonjësit doganor një dokument tranziti për mallra, të cilat bëjnë pjesë në listat e mallrave ushtarake ose mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, punonjësi doganor kontrollon dhe sigurohet që të ketë dokumente të rregullta shoqëruese të ngarkesës, në mënyrë të veçantë licencat përkatëse për transferim ndërkombëtar.

5) Në rastin kur në pikat kufitare paraqitet një ngarkesë dhe punonjësi doganor ka një dyshim të arsyetuar.

d. Akte të tjera në fushën e veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake, mallrave dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë.

¹⁸⁴ Direktiva e BE 952/2013, datë 9 Tetor 2013 “Kodi Doganor i Unionit”;

¹⁸⁵ Ligj nr. 102/2014 datë 31.7.2014 Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë,.

të caktuar, që reflektohet, midis të tjerave, në *kufizimet* e pjesëve të normës të pasqyruara në nenin 171 të Kodit Penal, në lidhje me këtë analiza e *mjetit* të kontrabandës është tepër principal e i rëndësishëm.

Në vështrim të nenit 8 të Kodit Doganor, *mjet* i kontrabandës, konsiderohet çdo produkt i materializuar i veprimtarisë njerëzore që plotëson kërkesat fizike, kulturore, shpirtërore e të tjera kërkesa të individit dhe të shoqërisë, që në mënyrë të jashtëligjshme kanë kaluar në/dhe nga kufiri doganor, të përcaktuara në normën e quajtur “mallra” dhe “objekte të tjerë”. Mjete të kontrabandës konsiderohen çfarëdo lloj mjeteesh, që kanë vlera (në përmasa të mëdha) të pavarura nga natyra e prejardhjes, vendi i prodhimit (brenda apo jashtë shtetit). *Mjetetë kontrabandës mund të jenë* objekte materiale, që plotësisht apo pjesërisht janë hequr nga qarkullimi qytetar.

Këto mjete ndahen në dy kategori :

Një nga simptomat e *mjetit* të krimit për kontrabandën të dënueshme penalisht është parashikuar edhe në nenin 282 të Kodit Doganor. Sipas nenit 282 të Kodit Doganor, me mallra objekt kontrabande kuptohet çfarëdolloj sendi lëvizës, që kalon kufirin doganor si dhe kalimi i mjeteve të transportit jo lëvizëse, me përjashtim të mjeteve transportuese që përdoren për transportet ndërkombëtare me pagesë nga persona fizikë, apo të mallrave që transportohen për qëllime industriale ose komerciale, me apo pa pagesë, si dhe pjesët e këmbimit e pajisjet e tjera të domosdoshme, si në rastin e cisternave dhe lëndëve djegëse apo vajrave lubrifikantë brenda tyre, në qoftë se këto lëndë transportohen brenda këtyre pajisjeve dhe mjeteve transportuese shoqëruese.

Nocioni i mallrave, që janë mjete krimi të parashikuar në Kodin doganor nuk është zbërthyer sa duhet në ligjin penal, për rrjedhojë është e nevojshme të riformulohet në Kodin Doganor, me qëllim që të përcaktohet një kufi i pranishëm i mallrave si mjet i kontrabandës.

Gjithashtu, legjislatori nuk ka përcaktuar saktë nëse mjete objekt kontrabande duhet të ketë përmasa të mëdha apo të vogla, të vetmin përcaktim që gjejmë është ai në rastin e importimit/eksportimit të valutës. Me ligjin doganor, me përjashtim të nenit 179/1, vlera e të hollave dhe sendeve me vlerë si objekt deklarimi përcaktohet me ligjin nr. 9086, datë 19.06.2003¹⁸⁶.

2.2 Ana objektive

¹⁸⁶ Ligji nr. 9086, datë 19.06.2003 "Për disa ndryshime e shtesa në Kodin Penal të RSH".

“Ana objektive, si pjesë përbërëse e veprës penale”¹⁸⁷ të kontrabandës, është një tregues i rëndësishëm, mungesa e së cilës nga ndryshimi i karakteristikave të veprimeve apo mosveprimeve, si dhe lidhja ose jo e këtyre veprimeve si shprehje e vullnetit të subjektit, në disa raste përbën të vetmin kriter për klasifikimin e shkeljes doganore si kundërvajtje apo kontrabandë.

Siç kemi theksuar edhe më lart, vepra penale e kontrabandës përfshihet në të dy kodet, në Kodin Doganor edhe në Kodin Penal. Në Kodin Doganor, në vartësi nga ana objektive, figurat e veçanta të kontrabandës janë më të shumta. Në këto kushte, legjislatori në Kodin Penal, në përshkrimin e veprës penale të kontrabandës, me të drejtë ka përcaktuar së toku fjalët “*apo forma të tjera që kanë për qëllim*”, të cilatshërbejnë si nyje lidhëse, (dispozitë e hapur) për t’iu referuar Kodit Doganor, duke përfshirë si vepër penale të gjitha veprimet dhe mosveprimet e parashikuar në të, në nenet 276-280 të kapitullit Kontrabanda.

Në këtë mënyrë, në këndvështrimin e anës objektive të veprës, konsiderohen kontrabandë të gjitha veprat penale të kontrabandës të përcaktuara në nenet 276-280 të Kodit Doganor dhe jo të klasifikohen si kundërvajtje doganore, siç diskutohet në shkrime të ndryshme, madje edhe nga akuza dhe gjykata.

Nga analiza e dispozitave të neneve 171-179 të Kodit Penal dhe neneve 276- 280 të Kodit Doganor, dalim në përfundimin se simptoma apo shfaqje të domosdoshme të anës objektive të kontrabandës, janë ato mënyra të lëvizjes (zhvendosje) së mallrave ose të sendeve të tjerë, nëpërmjet kufirit doganor, të cilat veçmas apo në tërësi të tyre bëjnë këtë kalim, importim, eksportim dhe tranzitim në/dhe nga kufiri shtetëror në kundërshtim me ligjin doganor.

Bazuar në literaturën tonë juridike, po dhe në atë të huaj, elementët kryesorë dhe fakultativë të anës objektive të veprës së kontrabandës janë të shumtë, megjithatë mund të grupohen në:¹⁸⁸

- a. Veprime apo mosveprime të kundërligjshme, që kryhen nëpërmjet mashtrimit apo formave të tjera të kundërligjshme, në rastet e hyrjes dhe paraqitjes së mallit, bagazheve dhe sendeve personale në zonën doganore.**

Në lidhje me mënyrën e veprimit të personave gjatë importimit, eksportimit dhe tranzitimit të mallrave, legjislatori ka përcaktuar mënyrat e sjelljes së detyrueshme anashkalimi i të cilave përbën shkelje doganore. Kështu, në nenin 41 të Kodit Doganor

¹⁸⁷ Shefqet Muçi. “E Drejta Penale”, Pjesa e përgjithshme, Botim i Shtëpisë Botuese “Dudaj”.

¹⁸⁸ Kontrabandistët kanë dy mënyra për lëvizjen e të mirave (mallrave). Njëra është nëpërmjet kalimit të ngarkesave ndërmjet kufijve pa i zbuluar, ndërsa metoda tjetër është një metoda e fshehjes. (*West's Encyclopedia of American Law, by Jeffrey Lehman and Shirelle Phelps, published in 2005*).

parashikohet se: “Mallrat që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë do t’i nënshtrihen mbikëqyrjes doganore që në momentin e hyrjes në territorin doganor. Këto mallra do t’i nënshtrihen kontrolleve nga autoritetet doganore”. Ndërsa neni 42 parashikon “Mallrat e sjella në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë duhet të çohen pa humbur kohë nga persona që i transportojnë ato në rrugët e përcaktuara nga autoritetet doganore, sipas udhëzimeve të tyre, nëse ka të tilla”.

- a) Në zyrën doganore të caktuar nga autoriteti doganor, ose një vend tjetër të caktuar ose të miratuar prej tyre
- b) Në një zyrë të lirë, nëse mallrat duhet të futen në atë zonë në rrugë të drejtpërdrejtë ujore, ajrore ose tokësore.

Kriteret e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 42, nuk zbatohen për mallrat në bordin e anijeve ose mjeteve lundruese, që përshkojnë territorin tonë ose hapësirat ajrore të Republikës së Shqipërisë, kur këto nuk kanë si destinacion një port ose aeroport të vendit tonë. Sidoqoftë, autoritetet doganore në çdo rast mund të ndërmarrin masa dhe të kryejnë kontrollet e nevojshme për të siguruar që mallrat e transportuara nga mjetet e sipërpërmendura nuk futen ilegalisht në territorin e vendit tonë. Ndërsa në nenin 43 parashikohet, se, kur në rastet e rrethanave të parashikuara, si p.sh fuqi madhore, nuk zbatohen rregullat për t’u futur mallra në rrugën e përcaktuar nga autoritetet doganore, personi që ka detyrimin ose një tjetër që vepron në emër të tij, duhet të njoftojë pa vonesë autoritetet doganore për gjendjen. E njëjta gjë vlen edhe për rastet kur për arsye të paparashikuara, mjetet lundruese ose ato ajrore të huaja që kalojnë në territorin tonë, detyrohen të futen në portet tona ose të zbresin në territorin tonë. Nëse ndodh, duhet të njoftojnë menjëherë autoritetet, në të kundërt do të konsiderohet sikur kryejnë kontrabandë.

Gjithashtu, me dispozita të veçanta është përcaktuar detyrimi për të deklaruar mallrat, bagazhet dhe sendet, si gjatë kalimit në/dhe nga zyra doganore kufitare, ashtu edhe në zyrat doganore të brendshme.

Bazuar në këto përcaktime ligjore të veprimtarisë hetimore, organi i akuzës dhe gjykata, gjatë gjykimit të çështjes, shqyrtojnë faktet që provojnë se veprimet apo mosveprimet, (mosdeklarimi i mallrave objekt importimi, tranzitimi apo eksportimi), janë shprehje e vullnetit të lirë të personit. Për këtë, do të duhet t’i kushtohet vëmendje metodave e mënyrave të përdorura që kanë çuar në rezultatin kriminal, si:

- fshehja e mallit¹⁸⁹.

¹⁸⁹ P.sh. si rregull përbëjnë vepër penale të kontrabandës rastet e deklarimit të artikullit patate dhe brenda tyre të gjenden të fshehura cigare, pajisje elektronike. Deklarohet ujë në autobote dhe në fakt në të gjenden pije alkoolike; deklarohet bimë medicinale dhe gjendet kanabis apo ilaçe me mosdeklarim; në automjet, krahas kolive me pajisje elektronike, gjendet i padeklaruar ose i deklaruar përmes dokumenteve të falsifikuara një sasi më e paktë pajisjesh elektronike. (*Shënim i autorit*).

- depozitimi i mallrave fshehurazi brenda zonës doganore, apo kalimi i tyre nëpër zonën doganore pa i nënshtruar kontrollit doganor, (*p.sh. kontrabandës në bashkëpunim me doganierët apo kalimi me forcë, duke mos u ndalur sipas urdhërimeve të autoritetit doganor, ose kalimi fshehtëazi me mashtrim nëpër zonën doganore kufitare*).
- kryerja e veprimeve pa lejen e autoritetit doganor, duke i transportuar nga një mjet në një tjetër, etj.
- mosdeklarimin e saktë të vlerës, llojit, origjinës, sasisë së mallrave, duke iu shmangur pagimit të plotë të detyrimeve doganore nëpërmjet mashtrimit, falsifikimit të dokumenteve, etj.¹⁹⁰
- përdorimit të mallrave të vendosur në një regjim doganor apo në rast se për to janë dhënë lehtësira fiskale, duke iu shmangur pagimit të detyrimeve të importit.

Siç parashikohet edhe në nenin 280 të Kodit Doganor dhe në nenet 172-178 të Kodit Penal gjatë import-eksportit, aktiviteti objektivisht shfaqet:

- në paraqitjen e mallrave dhe mjeteve për dhënien e një destinacioni doganor, por duke mos i deklaruar mallrat objekt kontrabandë, apo largimin nga zona doganore pa lejen e autoritetit doganor, depozitimit të mallrave brenda zonës doganore për t'i futur në territorin doganor pa paguar detyrimet e importit¹⁹¹.
- në mbylljen e regjimit të tranzitimit apo eksportit, nëpërmjet eksporteve fiktive.
- në hyrjen, me apo pa mjete transporti, të personit fizik që kalon nga kufiri shtetëror në zonën e kontrollit doganor.
- në hyrjen, kalimin e mjeteve të transportit në pikën e kalimit të kufirit shtetëror të Shqipërisë, me qëllim fshehjen e tyre në territorin doganor.
- në dhënien e mallrave organizatave ose shoqërive transportuese, apo organizatave të dërgesave apo posteve ndërkombëtare, me qëllim kalimin e tyre në territorin doganor të Shqipërisë.
- Po ashtu, në kryerjen e tërësisë së veprimeve të kundërligjshme, të parashikuara nga Kodi Doganor, ndaj mallrave e mjeteve të transportit, deri në kalimin e tyre në/dhe nga territori doganor.(kufiri shtetëror i RSH)¹⁹²

¹⁹⁰ Termi “Mashtrim Doganor” do të thotë shkelje doganore, me anë të cilës një person mashtron doganat dhe në këtë mënyrë i shmanget pjesërisht ose tërësisht pagesave të detyrimeve dhe taksave doganore të importit ose të eksportit (Konventa Nairobi 1997).

¹⁹¹ Shiko nenin 280 të Kodit Doganor dhe nenet 171-179 të Kodit Penal.

¹⁹² Këto elemente të anës objektive i gjejmë dukshëm të përcaktuara edhe në dispozitat e legjislacionit doganor të vendeve të BE-së. Në kreun e parë të shkeljeve doganore të Kodit Doganor Italian, në nenet 282-294 Kontrabanda përcaktohet si “Futje të mallrave nga kufiri shtetëror, duke shkelur rregullat, ndalimet, kufizimet, shkarkon ose depoziton mallra nga jashtë territorit doganor në hapësirat e ndërmjetme, shkarkon mallra jashtë zonës doganore duke i fshehur ato; mban mallra të importuara në magazinë të padeklaruara tek autoriteti doganor. Ndërsa, në rrethana rënduese, kur shkelësi kapet me armë, kur kundërshtojnë edhe autoritetin kontrollues, kur kryhet me një grup, kur përsëritet. *Shih. “Nuovo Codice Doganale 2002”*.”

b. Veprime që kryhen jashtë zonës doganore (jo nëpërmjet pikave të kalimit kufitar), në/dhe nga (nëpërmjet) kufiri shtetëror¹⁹³. Në këtë rast elementet e përbashkëta të anës objektive të kontrabandës janë kalimi i kundërligjshëm, si dhe fshehtësia apo mashtrimi.

b.1. Kalimi i kundërligjshëm

Veprimtaria kriminale, si një dukuri objektive e vetë kontrabandës, konsiston kryesisht në kalimin apo lëvizjen si një koncept i gjerë (kalimin apo zhvendosjen nëpërmjet kufirit të Republikës së Shqipërisë, që përkon me territorin doganor, vijën doganore për rastet e kufirit tokësor ajror, si dhe vijën e kalimit të ujërave territoriale, të të gjitha sendeve, mallrave, bagazheve, të cilat parashikohen në nenet 276-279 të Kodit Doganor dhe nenet 172-174 të Kodit Penal).

Mendojmë se është e domosdoshme të ndalemi paksa në interpretimin gjuhësor të termit “lëvizje apo kalim”. “Lëvizja në kuptimin e kalimit, zhvendosje” nënkupton: sjellja e mallra nëpërmjet kufirit shtetëror (njëkohësisht edhe doganor), nxjerrja e mallrave nga territori doganor, transportimi nga/dhe në territorin doganor, kalimi apo zënia e një vendi tjetër në raport me të parin, vendosja në një vend tjetër, duke përfshirë edhe depozitimin e tyre në vijën doganore¹⁹⁴.

Termi i përdorur “lëvizje në kuptimin e “kalimit”, *zhvendosjes* nëpërmjet kufirit shtetëror të Shqipërisë”, është i pranishëm në Kodin Doganor dhe në Kodin Penal për rastet e krimeve në fushën doganore, si një kalim i paligjshëm i kufirit.

Në kuptim dhe zbatim të neneve 276- 279 të Kodit Doganor dhe 172-178 të Kodit Penal me termin *lëvizje apo kalim i kundërligjshëm*, nënkuptojmë një zhvendosje të kundërligjshme të mjeteve dhe mallrave, apo sendeve nëpërmjet kufirit (shtetëror) doganor, d.m.th. zhvendosja e jashtëligjshme nga një anë e kufirit, në anën tjetër të kufirit

¹⁹³ Në nenet 276-279 të Kodit Doganor, kontrabanda përshkruhet si “Lëvizje e mallrave nëpërmjet kufijve tokësorë, në rrugë detare, ajrore dhe në brendësi të zonave doganore...”. Ndërsa në Kodin Penal përshkruhet si import, eksport ... nëpërmjet kalimit jashtë pikave doganore ...apo fshehjes së pjesshme apo të plotë, mosdeklarim të saktë në doganë, deklarim të rremë (KP neni 172-176), eksportim, importim i mallrave të ndaluara... zëvendësimi ose ndërrimi i shenjave të tjera të sigurisë, të vendosura në mjetin e transportit... Kodi Doganor i RSH.

¹⁹⁴ Kalimi-Veprimi dhe gjendja sipas kuptimit: të kalojë p.sh., kalimi i lumit, leje kalimi, vend ku mund të kalohet, ka një kalim këtu. Lëvizje-Veprimi sipas kuptimit të foljes lëviz, lëvizje e vullnetshme, gjendje e sendeve që nuk janë në qetësi, ecje e njerëzve dhe automjeteve në rrugë. (Shiko më shumë: “Fjalorin e Gjuhës Shqipe”).

shtetëror (territorit doganor). Ky është kushti i domosdoshëm (*sine qua non*) për njohjen (pranimin) e kontrabandës si një krim përfundimtar¹⁹⁵.

Theksojmë se përmbajtja e këtij termi qartësohet saktë vetëm në Kodin Doganor, ku përcaktohet se kryen kontrabandë në lëvizjen e mallrave nëpërmjet kufijve tokësorë, detarë, liqeneve dhe në brendësi të zonave doganore, duke *sjellë, shkarkuar, larguar nxjerrë, gjendur, mbajtur*, në afërsi të vijës doganore, mallra në kuptimin e hapësirave jashtë zonës doganore, të pikave të kalimit doganor, pa paguar detyrimet e përcaktuara me ligj. Një përcaktim të tillë e gjejmë edhe në Kodin Doganor Italian.

Për rrjedhojë, kuptimi i shprehjes “*lëvizje*”, “*kalimi*” apo “*zhvendosje*” nëpërmjet kufirit doganor të Shqipërisë, si një element i kontrabandës, mund të trajtohet si kuptim i shprehjes “*kalimi*”, “*zhvendosje*” të përdorur në gjuhën shqipe ose në kontekstin e terminologjisë së përdorur në legjislacionin doganor dhe penal, kur kemi të bëjmë me veprën penale të kalimit të paligjshëm të kufirit¹⁹⁶.

Sidoqoftë, më argumentues paraqitet vlerësimi dhe kuptimi i neneve 276- 279 të Kodit Doganor dhe togfjalët në dispozitat e Kodit Penal për kontrabandën “*nëpërmjet kalimit jashtë pikave doganore*”, si një normë në formulimin përkatës, që parashikon domosdoshmërinë gjatë klasifikimit të veprimitarisë kriminale për të studiuar shenjat konkrete të krimit në fjalë, në përputhje me normat e Kodit Doganor.

Legjitimiteti i këtij pozicioni lind nga principet e mëposhtme:

- Nenet 276-280 të Kodit Doganor dhe nenet 171-179 të Kodit Penal përcaktojnë përgjegjësitë penale, kur shkelet rregulli, normat e vendosur për lëvizjen, largimin, nxjerrjen, hedhjen, depozitimin, shkarkimin, zhvendosjen e mallrave, mjeteve transportuese, si dhe të tjerë objekte, nëpërmjet kufijve tokësorë, detarë, ajrorë, pa u paraqitur në zyrat doganore.
- Norma e treguar plotëson funksionin ruajtës (mbrojtës), në raport me sferat e tjera të rregullave doganore. Këto (norma) janë bërë për të siguruar zbatimin e rregullave dhe kërkesave, të cilat janë vendosur nga Kodi Doganor. Për rrjedhojë, në qoftë se këto të fundit parashikojnë masa ose norma speciale (në këtë rast rregullat e caktuara) për lëvizjen (zhvendosjen) e mallrave, nëpërmjet kufirit shtetëror në zyrat doganore, i

¹⁹⁵ Në Kodin Penal kryesisht si kontrabandë konsiderohet import/eksporti nëpërmjet kalimit jashtë pikave doganore... Ky term (importim/eksportim), është marrë nga legjislacioni doganor francez, por mendojmë se duhet të mbahet parasysh, se realisht veprimi kriminal nëpërmjet importimit, eksportimit, tranzitimit, si kategori doganore kanë të bëjnë me paraqitjen në zyrën doganore apo në zonën doganore, ndaj përcaktimi i bërë në Kodin Doganor është më gjithëpërfshirës, si dhe në përputhje me legjislacionin e vendeve komunitare, pasi parashikon edhe kontrabandën dhe/ nga kufiri shtetëror jashtë zonave doganore. 13 Kodi Penal, nenet 174-179. Shih. *Nuovo Codice Doganale 2002*.

¹⁹⁶ Kodi Penal, nenet 297-298 “Kalim i paligjshëm i kufirit”.

gjejmë në nenin 12 të Kodit Doganor dhe në Konventat Doganore¹⁹⁷. Ato i nënshtrihen të drejtës penale për ruajtje të drejtpërdrejtë të normave të Kodit Doganor, gjë që e bën të domosdoshëm orientimin për sa trajtuam më sipër, gjatë klasifikimit të veprimtarisë kriminale, në rastin konkret, për çështjen se çfarë duhet konsideruar kalim i objekteve kontrabandë.

Elementi tjetër si objekt shqyrtimi lidhet me kuptimin e drejtpërdrejtë të normës së të drejtës penale doganore që parashikon përgjegjësinë për aktin e kontrabandës. Nga mënyra se si shfaqet, rrezikshmëria shoqërore e një krimi nuk varet nga lloji i veprimit të bërë, d.m.th. veprime të kryera në zonën doganore dhe në brendësi të territorit doganor (shkronja “a”), apo jashtë tyre (shkronja “b”). Ndaj gjykata dhe akuza duhet të dalin në përfundimin, se përgjegjësia për veprimet e kryera nuk mund të diferencohet.

Megjithatë, në qoftë se merret parasysh mendimi, sipas të cilit, veprim i hyrjes, daljes së produkteve (mallrave) apo mjeteve të tjera, llogaritet si krim i kryer, vetëm në kushtet e kalimit të kufirit shqiptar që përputhet me kalimin në/dhe nga territori doganor (rastet e përcaktuara në shkronjën “b”), veprimet apo mosveprimet në zonën doganore, që kanë si qëllim realizimin e synimeve për nxjerrjen e mallrave ose mjeteve të tjera të fshehura, të padeklaruaranëpër zonën doganore, në piken e kalimit kufitar (shkronje “a”), apo të deklaruara ndryshe nga ajo ç’është konstatuar nga autoriteti doganor, nenet 261-267 të Kodit Doganor, sikurse të depozituara, të tregtuara në thellësi të zonës doganore, atëherë rastet e fundit mund të shikohen vetëm si raste të veçanta të veprës penale të kontrabandës.

Për analizën dhe vlerësimin e plotë të termit “lëvizje”, kalim i mallrave nëpërmjet kufirit tokësor, detar, ajror (vijës doganore apo “vijës së ujërave territoriale dhe të brendshme” jashtë pikave doganore), përveç sa u theksua në rastet e mësipërme, për organin e akuzës dhe gjykatën është e domosdoshme të shqyrtojnë specifikat e veprës penale të kontrabandës që shfaqet, midis të tjerash, edhe nga veçoritë e territorit doganor dhe kufirit shtetëror, detar, tokësor, ajror, si dhe për rastet e paraqitjes në zonën doganore, duke përdorur mënyra e vendetë fshehta, por edhe të natyrës juridike (përgatitja e dokumenteve të falsifikuara, ndërrimi i shenjave identifikuese, mashtrimi, etj.).

Në çdo rast, nga organi doganor janë përcaktuar vendet konkrete të detyrueshme për hyrjen e mallrave në zonën doganore (nëpërmjet pikave të hyrjes së kontrollit kufitar), për kryerjen e kontrollit doganor (salla pritjeje të kontrollit, sheshe për mjetet e transportit, magazina të përkohshme, etj.) të cilat ndodhen afër vendit të kalimit kufitar në zonën doganore, në zyrat doganore të hyrjes/daljes, të cilat krijohen gjatë vijës doganore, në

¹⁹⁷ Konventat TIR, CMR, ATA.

pikat e kalimit kufitar mbi bazën e ligjit doganor¹⁹⁸ dhe akteve nënligjore në zbatim¹⁹⁹. Në bazë të nenit 3 të Kodit Doganor²⁰⁰ përmbajtja e kuptimit “territor doganor i Republikës së Shqipërisë” si rregull përputhet me kuptimin e shprehjes “Territori tokësor, ujërat territoriale, ujërat e brendshme dhe hapësira ajrore e Republikës së Shqipërisë. Në raste të veçanta, mallra të vendosura në territore doganore të RSH, të cilat janë përcaktuar në bazë të një VKM-je si zona të lira, magazina të lira, duhet të mbahet parasysh se ato shihen apo trajtohen si mallra të ndodhura jashtë territorit doganor të Shqipërisë, ekstraterritoriale (p.sh. *Porto Romano, platformat e kërkim-shfrytëzimit të hidrokarbureve, Free shops, etj*).

Duke iu referuar neneve 8/14,11-12 të Kodit Doganor, kontrollit doganor²⁰¹ i nënshtrohen të gjitha mallrat, bagazhet dhe mallrat e tjera që personat mbajnë me vete, mjetet e transportit që kalojnë në/dhe nga territori doganor i Shqipërisë, nëpërmjet kryerjes së verifikimit dhe veprimeve të ngjashme... për të siguruar respektimin e rregullave doganore, kur është e nevojshme edhe të dispozitave të tjera të zbatueshme mbi mallrat që i nënshtrohen mbikëqyrjes doganore²⁰².

Gjithashtu, mallrat dhe mjetet transportuese konsiderohen të ndodhura në kontrollin doganor gjatë eksportimit nga territori doganor i Shqipërisë, në momentin e mbylljes së regjimit përkatës, apo përfundimit të procedurës veçantë të vendosjes së mallrave në zyrën doganore të daljes, kur kryhen veprime të cilat kanë për qëllim eksportimin, riekportimin (në kushtet e përpunimit pasiv, aktiv, lejimit të përkohshëm) e mallrave nga territori doganor apo zyra doganore, deri në kalimin e kufirit doganor.

Shkelja e kërkesave të mësipërme, të parashikuara edhe në nenet 8/20,11, 41-67 të Kodit Doganor, që shprehet me kalimin e mjeteve jo në pikat e kalimit (apo jashtë pikave të kalimit) të kufirit shtetëror, ose në vende të tjera që nuk janë konform ligjit, si dhe jashtë kohës së caktuar të punës së organit doganor, në thelb, veprime të kryera jashtë kontrollit doganor përbëjnë nën objektive të kontrabandës. Gjithashtu, edhe moskryerja e procedurave për mbylljen e tranzitimit të brendshëm apo të jashtëm nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve, të cilat “konfirmojnë” mbylljen e tranzitimit, “daljen” e mallrave

¹⁹⁸ Neni 11, 42, 45 i Kodit.

¹⁹⁹ VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor...”.

²⁰⁰ Neni 3,8 i Kodit.

²⁰¹ Kontroll doganor do të thotë masat e zbatuara për të siguruar përputhjen me ligjet dhe rregullat, të cilat autoritetet doganore duhet t’i zbatojnë gjatë aktivitetit të tyre. (Konventa ndërkombëtare për harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave. RSH ka aderuar me ligjin nr. 8754, datë 26.03.2001)

²⁰² Më shumë shiko Manualin “Masat për të përmirësuar efikasitetin në pikat e kalimit kufitar”. Botim i Euro customs Sekretariat, si dhe “*Importing into the United States*”.1991.

jashtëterritorit doganor apo “mbërritjen e tyre nëdoganën e destinacionit përfundimtar”, përbën kontrabandë²⁰³.

Në këtë aspekt është e domosdoshme të nënvizojmë, që në bazë të nenit 12 të Kodit Doganor, për disa lloje mallrash, autoriteti doganor ka të drejtë të kufizojë kalimin në çdo pikë kalimi doganor²⁰⁴. Gjithashtu, kalimi i mallrave dhe mjeteve të transportit nëpërmjet kufirit doganor jashtë orarit të punës së organit doganor, është shkelje, edhe pse ky kalim bëhet në vende të caktuara për këtë qëllim.

2.2.1 Fshehtësia dhe mashtrimi

Tipar tjetër i anës objektive të kontrabandës është kalimi (apo zhvendosja) i kryer nëfshehtësi apo nëpërmjet mashtrimit nga kontrolli doganor, të mallrave ose të objekteve të tjerë, nëpërmjet zonës doganore në pikat e kalimit të kufirit të Shqipërisë, d.m.th. kalimi nëpërmjet përdorimit të vendeve të fshehta, apo të mënyrave të tjera, që nëesencën e tyre vështirësojnë zbulimin nga ana e organeve doganore dhe organeve të tjera të ngarkuara me ligj, të objekteve që zhvendosen, ose të objekteve që u është ndryshuar pamja apo forma, duke bërë të mundur paraqitjen e një objekti të tjetërsuar.

Në fakt, mënyrat e fshehjes dhe mashtrimit për klasifikimin e kontrabandës janë të shumta dhe nuk mund të ketë një listë shteruese. Megjithatë, analiza e mënyrave të fshehjes është një domosdoshmëri dhe pjesëpërbërëse e veprimtarisë për mbrojtjen e ligjshmërisë, por njëherazi edhe për një proces hetimor të plotë dhe të gjithanshëm nga akuza dhe gjykata, me synim paralajmërimin, shfaqjen dhe zbulimin e krimeve në fjalë. Aktualisht mënyrat reciproke të zhvendosjes (apo kalimit) kërkojnë përshkrime me saktësinë e nevojshme në dispozitat zbatuese të Kodit Doganor. Mbi bazën e neneve 171-178 të Kodit Penal dhe dispozitave për kontrabandën në Kodin Doganor, akti i kalimit-zhvendosjes së mallrave e të mjeteve të transportit, me fshehje, mashtrim mund të realizohet me një nga mënyrat e mëposhtme:

²⁰³ Në çështjen “Shteti kundër të gjykuarve J.M.&...”, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, me vendim nr.1, datë 12.03. 2002, kanë arsyetuar se: ... e gjithë sasia kafe figuron sikur është riekportuar në Republikën ish-Jugosllave të Maqedonisë, nëpërmjet Pikës Doganore Bllatë (Peshkopi), dokumentacion i cili, me të drejtë, është konsideruar fiktiv nga ana e Gjykatave të të dy shkallëve të gjykimit të çështjes. Të dyja këto gjykata arritën në përfundimin, se, falsifikimi i dokumentacionit për gjoja riekportimin e kësaj sasive kafeje, u krye nga të gjykuarit J. M.&... në bashkëpunim, përfundim i cili u pretendua i drejtë nga Gjykata e Lartë. (Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të GJL, nr. 1, datë 26.03.2002).

²⁰⁴ P.sh. mallrat me risk, si mallrat kineze, artikujt farmaceutikë.

- nëpërmjet përdorimit të vendeve të fshehta, shtigjeve malore, apo përgjatëlumenjve, liqeneve²⁰⁵, që nënkupton vende të përgatitura apo qëshfrytëzohen qëllimisht, synimi i të cilave është kalimi i kundërligjshëm i mallrave nëpërmjet vijës doganore, apo ujërave territorialë, si dhe krijimi i pajisjeve speciale apo formave të mjeteve të tjera, që sigurojnë fshehjen e mallrave (d.m.th. ndryshime të konstruksionit të mjetit të transportit, montimit të pajisjeve shtesë, si depozita të papërfshira në konstruksionin e mjetit të transportit), si p.sh. kalimi i mallrave nëpërmjet valixhes me dy shtresa poshtë saj, nëpërmjet krijimit të shtresave speciale në brendësi të veshjes personale. etj.
- Si një formë e fshehjes konsiderohet edhe prania e mallrave, në vende që nuk janë të destinuara për ruajtje apo për transportim, prania e tyre në vende mevështirësi kontrolli (p.sh. në gomat, shasitë e automjeteve, balustrat e anijes që shërbejnë për të ruajtur ekuilibrin, duke i mbushur me ujë, shfrytëzimi i mjeteve legale për përdorim jashtë destinacionit të tyre si, depozitat e autobotit, fuçive të pretenduara se janë bosh apo duke u ndryshuar destinacionin e lëndës qëtransportojnë, etj.). Kështu, nëpërmjet ndryshimit të pamjes së një objekti, duke e paraqitur të tjetërsuar, domethënë ndryshim esencial i karakteristikave të pamjes së jashtme të mallit, gjë që bën të mundur kalimin e tij në një lloj tjetër malli.
- “Vendet e fshehta” (apo “xhepat e fshehtë”), mund të jenë në mjetet e transportit, ashtu edhe në çdo objekt tjetër, si në sendet e përdorimit personal të përditshëm dhe të atyre ekonomikë, në objekte prodhimi apo të një destinacioni tjetër (frigoriferë, autobote për ruajtjen e lëndëve djegëse, apo të ujit të pijshëm, etj.çanta dore, valixhe, furça, bastunë, kutikonservash, po ashtu edhe në rrobat e veshura, etj.).

Nga sa thamë më lart, mund të konkludojmë se:“Përgatitje e “vendit të fshehtë” është një hapësirë apo vend i posaçëm, i fshehtë, brenda mjeteve të transportit, në bagazhe, në sendet e përdorimit personal dhe të sendeve të tjera të përdorimit, veshjet trupore, sajuar apo bërë me qëllimin e fshehjes në to të mallrave apo objekteve, për të mos iu nënshtuar kontrollit nga organet doganore në zonat doganore gjatë kalimit në/dhe nga kufiri shtetëror, tranzitimit dhe paraqitjes së mallrave nëzyrën doganore të destinacionit. Kjo realizohet nëpërmjet përdorimit të formave dhe metodave të atilla, që faktikisht vështirësojnë zbulimin nga organet doganore të mallrave të fshehura brenda një malli apo mjeteve të caktuar. Ashtu sikurse nëpërmjet zbatimit të llojeve të ndryshme të fshehjes, ku, në këto raste, personi i caktuar për ushtrimin e kontrollit doganor e ka të pamundur zbulimin e mallit të fshehur, ndaj të cilit janë përdorur mënyra speciale për fshehjen e mallrave e të sasisësë tyre, gjë që e bën të pamundur zbulimin nëpërmjet vrojtimitvizual

²⁰⁵ Në vitin 2004-2006 kontrabanda e naftës drejt ish-Jugosllavisë realizohej edhe nëpërmjet lumit Buna, apo në rrugën Shkodër-Hani Hotit, ku si mjete të përgatitura posaçërisht për këto operacione ishin tubacionet e vendosura në brigjet përkundrejt lumit Buna, depozita shtesë në automjete, etj. Sipas raporteve lidhur me kontrabandën e vitit 1994 në Ballkan, nënvizohet fakti se “...më shumë se 1 milion litër gazoil është tranzituar nëpërmjet hekurudhës nga Durrësi drejt Malit të Zi në muajin shtator të vitit 1994”. Më shumë shiko: Marko Hajdinjak: “Smuggling in Southeast Europe Center”.

të zakonshëm, pa bërë shikimin apo kontrollin e drejtpërdrejtë të mallit, si një formë e veçantë e kontrollit, apo përdorimin e mjeteve teknike të kontrollit doganor.

2.2.2 Përgatitja, tentativa dhe përfundimi i krimit të kontrabandës

Sipas nenit 256 të Kodit Doganor përbën kontrabandë “shmangia ose *tentativa për të shmangur...*”. Ajo përbën elementin material faktik kriminal, veprimet e qëllimshme (mosveprimi) të personit, që drejtohen drejtpërsëdrejti për kryerjen e krimit, në qoftë se në këtë rast krimi nuk është realizua plotësisht (*nuk ka shkuar deri në fund*), për shkaqe që nuk varen nga personi në fjalë.

Siç cituam më lart, kontrabanda është krimi me përbërje formale²⁰⁶ dhe heqja dorë nga kryerja e veprës penale, që parashikon se momenti i përfundimit të krimit përcaktohet në varësi:

- a. Nëse realizohet import-eksporti, apo tranzitimi nëpërmjet fshehjes së mallit, mosdeklarimit të saktë, deklarimit të rremë ... të mallrave apo mjeteve të tjerë.
- b. Nga mënyra e kalimi të kundërligjshëm, në/dhe nga kufirishtetëror, si dhe depozitimi, ruajtja e mallrave për të cilat nuk dëshmohet prejardhja e rregullt.

Në këtë mënyrë, veprimtaria e përfunduar do pranohet nga momenti i kryerjes së saj, gjë që pasqyrohet me ligj, ndërsa në raste të tjera elementet përbërëse të mbarimit të kontrabandës formohen me praninë e shenjave plotësuese (*mënyra e kalimit*), d.m.th. të veprimeve dhe kushteve të tjera, ku lindja apo kryerja e tyre ndodhen larg në kohë nga veprimi fillestar. Kryerja e kontrabandës konsiston në kryerjen e veprimeve, të cilat synojnë garantimin e mundësive për kalimin në kundërshtim me ligjin të mallrave ose të sendeve të tjera, përmes kufirit shtetëror me mënyrat e treguara në nenet 276- 280 të Kodit Doganor.

Referuar dispozitave ligjore për kontrabandë konstatojmë, se ligjvënësi nuk ka përfshirë në këtë vepër penale fazën e parë, atë të përgatitjes së krimit të kontrabandës, çka mund të shoqërohet me rëndim të pozitës së shkelësit. Mirëpo, kompleksiteti dhe intensiteti i veprimeve për kryerjen e kontrabandës na detyron të mbajmë parasysh edhe raste të ekzistencës së mundësisë të ndërprerjes së veprimtarisë kriminale në stadin e përgatitjes dhe zbatimit të anës objektive të krimit, përpara momentit kur krimi llogaritet i përfunduar, ndërsa në raste të tjera ajo përjashtohet, për rrjedhojë, janë përjashtuar përgatitja, tentativat dhe mundësia e refuzimit (heqjes dorë) vullnetar nga krimi, ndaj në këtë studim mendoj se është me interes jo vetëm trajtimi teorik, por edhe ai praktik i

²⁰⁶ Ka mendime se cilësimi i këtyre veprave si “figura formale është gabim dhe bie ndesh edhe me institutin e heqjes dorë nga kryerja e veprës penale, analoge me kontrabandën”. Më shumë shiko: Revista Jeta Juridike. “Për kuptimi tentativës...” H. Ligori, 2009

çështjeve që kanë të bëjnë me përgatitjen e krimit të kontrabandës dhe mbetjes së tij në tentativë.

a.Përgatitja

Përgatitja për kontrabandim mund të shfaqet apo të shprehet në gjetjen apo adoptimin e mjeteve të krimit, p.sh sigurimi apo gjetja e mallrave për kalim në kundërshtim me ligjin, përmes kufirit doganor; instalimi për këtë qëllim, në mjetet transportuese të “vendeve, xhepave, hapësirave të fshehtë”, qoftë këto edhe në bagazhe, në çantat e dorës, në këpucë, në rrobat personale, etj., në të cilat fshihen sende kontrabandë. Por gjithashtu edhe në përgatitjen e dokumenteve doganore false përfshi këtu edhe mjetet e identifikimit doganor, si vula doganore, NIPT; në mosdeklarimin apo deklarimin e pasaktë në deklaratën doganore për mallrat dhe mjetet e transportit; në krijimin e kushteve, të cilat bëjnë të mundur kryerjen apo lehtësimin e kryerjes së krimeve, p.sh. bashkëpunimin me një person tjetër për kontrabandim, përpunimin e planit për zhvendosjen e mallrave apo sendeve të çmuara përmes kufirit doganor në kundërshtim me ligjin, ndarja e roleve midis pjesëmarrësve gjatë kryerjes së kontrabandës, zgjedhja e burimeve të fitimit të vendshitjes së mallrave kontrabandë.

b.Tentativa

• Kuptimi

Tentativë quajmë veprimet që kanë për qëllim kalimin në kundërshtim me ligjin të ngarkesave (mallrave apo sendeve të tjera) nëpërmjet kufirit doganor, kur krijohet rreziku i drejtpërdrejtë i shkeljes së rregullit të vendosur për lëvizjen e ngarkesave nëpërmjet kufirit, por që ky rregull nuk është shkelur, meqenëse **lëvizja në kundërshtim me ligjin nuk ka ndodhur për shkaqe që nuk varen nga dëshira e fajtorit.**

N.q.s. vendosmëria për të kryer një veprimtari bëhet realitet, atëherë nuk mendojmë se duhet të flasim për ndonjë hipotezë (domethënë mundësi e vogël, supozime). Situatat në fjalë na japin mundësi të argumentojmë mbi mungesën e pranisë së qëllimit anësor në krim. Gjatë tentativës për kryerjen e kontrabandës, fajtori pranon me ndërgjegje jo vetëm veprimtarinë rrezikshme shoqërore, por edhe rrethanat faktike që karakterizojnë situatat kriminale. Në fushën e vetëdijes së kriminelit hyjnë:

- a) Karakteristikat e objektit të kontrabandës.
- b) Nga njëra anë, veçoritë e vendosjes së mallrave në një procedurë doganore, nga ana tjetër destinacioni doganor në përgjithësi.
- c) Gjithçka e përdorshme në rastet konkrete.
- d) Procedura e përdorur (rregulli i veprimeve juridike të rëndësishme).

Të gjitha këto (a,b,c,d) duhet medoemos të kryhen, me qëllim që të bëhet i mundur kalimi nëpër kufi i mallit objekt kontrabande i të interesuarit, etj. Bashkë me të, ekziston

mundësia të krijohet një situatë e atillë, ku ndërgjegjësimi për situata të veçanta të “gjendjes doganore” paraqet në vetvete karakter të përgjithshëm. Përkundrejt kësaj, cilidoqoftë stadi në të cilin autori i veprës ka arritur në ekzekutim, pranojmë se asnjë ndëshkim nuk është i mundshëm, në qoftë se ndërprerja e ekzekutimit vjen si rezultat i një ndërprerjeje vullnetare.

Konceptimi i nocionit të “ndërprerjes së pavullnetshme” pranohet gjerësisht në të drejtën penale doganore. Përveç karakterit të pavullnetshëm, që duhet të ketë ndërprerja, nocioni i tentativës duhet të supozojë edhe faktin që manifestimi objektiv i vullnetit kriminal të ketë kaluar stadin e të ashtuquajturit “akte të thjeshta përgatitore”. Këtë parim, shërbimi doganor francez e aplikon në një mënyrë shumë origjinale: nga njëra anë, disa akte të cilat kualifikohen në të drejtën penale, si akte përgatitore të drejtës doganore, dënohen nga ligji doganor dhe konsiderohen vepra autonome (p.sh. mbajtja dhe transportimi në rajon i disa mallrave të ndaluara në dalje, sipas disa kushteve të tentativës të eksportit në kontrabandë). Nga ana tjetër, sipas studiuesve të së drejtës penale doganore “kemi një tendencë në jurisprudencë, e cila përpiqet të kufizojë periudhën e akteve përgatitore në interes të periudhës së fillimit të ekzekutimit”. “Gjykatat pranojnë, që përbëjnë akte të fillimit të ekzekutimit ato akte që manifestojnë angazhimin e parevokueshëm të autorit të tyre për realizimin e veprës. Zakonisht, ky manifestim rezulton nga rrethanat objektive në të cilat kapet autori”²⁰⁷.

Kështu, tentativë për kontrabandë duhet të konsiderojmë: përpjekjet apo veprimet për nxjerrjen e mallrave, përpara kalimit të drejtpërdrejtë të kufirit, në hyrje apo në dalje të tij, si dhe veprimet e tjera që kanë si pikësynim zhvendosjen apo lëvizjen e mallrave, duke i fshehur ato nga kontrolli doganor, p.sh. paraqitja e deklaratës doganore, duke mos pasqyruar në të mallrat që i korrespondojnë deklaratimit; paraqitja e dokumenteve doganore dhe e dokumenteve të tjera, në të cilat paraprakisht janë bërë ndryshime apo korrigjime të qëllimshme për sasinë, natyrën, vlerën, cilësinë, origjinën, kodin tarifor të mallrave objekt deklarimi, etj.

Në këto raste duhet pasur parasysh, që në lidhje me përgatitjen ose tentativën për kontrabandim, fjala është vetëm për ato raste kur prova e pasuksesshme për kalimin në kundërshtim me ligjin e mallrave ose sendeve të tjerë përmes kufirit doganor, shoqërohet me praninë, qoftë edhe të një rasti, e simptomave të kalimit të tillë, të cilat janë pasqyruar në dispozitat e neneve 171, 179/1 të Kodit Penal dhe neneve 276-280 të Kodit Doganor, që nga ana e tyre përfshijnë dhe qëllimet e fajtorëve.

Një ndër kushtet e rëndësishme, nga të cilat varet kualifikimi i drejtë i kontrabandës, është përcaktimi apo llogaritja e momentit në të cilin mallrat apo sendet e tjera zhvendosen, kalojnë, në mënyrë të paligjshme nëpërmjet kufirit doganor, si një moment i

²⁰⁷ BERR C.-J., TREMEAU H., «E drejta doganore komunitare dhe kombëtare», Economica, ed 7, 2006.

përfundimit apo kryerjes së krimit. Mendoj se ka rëndësi të kuptohet se përbërësit përfundimtarë të kontrabandës, në rastet e import/eksportit të mallit, nuk janë të domosdoshëm, që ngarkesa kontrabandë, në të gjitha rastet, të jetë apo të ketë mbërritur në territorin e shtetit të huaj ose në kushtet e importit në magazinat e subjektit. Kështu:

- në kundërshtim me ligjin, gjatë eksportimit të mallrave jashtë kufijve shtetërorë me anije detare, kontrabanda do të quhet e përfunduar mbas kalimit të vijës kufitare shtetërore (doganore), megjithëse ngarkesa në fjalë, në këtë rast, nuk ndodhet në territorin e shtetit të huaj, por është p.sh. në ujërat ndërkombëtare, ndërsa anijet e mallrave dhe ato të pasagjerëve që ndodhen në det të hapur me flamurin e njërit apo tjetrit shtet, konsiderohen territore të këtij shteti. Në këto raste, veprimet e personave që mundohen të nxjerrin jashtë vendit mallra ose sende të çmuara nëpërmjet rrugëve kontrabandiste, i nënshtrohen klasifikimit sipas neneve 171-179 të Kodit Penal.
- gjatë importimit të mallrave do të quhet i përfunduar pas deklarimit të mallit, kur malli është në zonën doganore kufitare; kalimi nëpër këtë zonë doganore pa u paraqitur në zyrën doganore ose kalimi jashtë orarit të punës së doganierëve të zyrës doganore të hyrjes, si dhe në të gjitha rastet e kalimit të mallrave në kufirin shtetëror jashtë zonës doganore.

Në këtë mënyrë, për elementët përfundimtarë të kontrabandës, është e domosdoshme të qëndrojmë në dy momente:

- a. Në zhvendosjen, kalimin faktik të ngarkesave në/dhe nga kufiri shtetëror jo nëpërmjet pikave të caktuara për kontrollin doganor (apo shmangie të pikave të kontrollit doganor), ose kalimi në pikat e kontrollit, por jo brenda orarit të përcaktuar për kryerjen e formaliteteve doganore.
- b. Në fshehjen e ngarkesave të transportuara nëpërmjet kufirit doganor nga kontrolli doganor, nëpërmjet përdorimit të “fshehësve” apo “vendeve të fshehta” ose të zbatimit të formave të tjera të cilat në tërësinë e tyre vështirësojnë zbulimin e objekteve apo sendeve, ose dhënia e një objekti pamjen e objekteve të tjerë, ose përdorimi i dokumenteve false, përfshi këtu mjetet e identifikimit doganor, mosdeklarimi apo deklarimi i rremë i mallrave që zhvendosen.

Në kushtet e zhvendosjes apo lëvizjes së mallrave kontrabandë, duke iu shmangur organeve doganore, momenti i kalimit të kufirit përputhet me momentin e fshehjes së mallrave nga kontrolli doganor, mbasi në këtë rast organeve doganore përgjithësisht u hiqet mundësia e kryerjes së kontrollit dhe verifikimit si të mallit, ashtu dhe mjetit të transportit të paraqitur në zonën doganore.

Gjendje tjetër krijohet në kushtet e kalimit kontrabandë të mjeteve nëpërmjet fshehjes së tyre nga kontrolli doganor. Këtu momenti i kalimit të vijës kufitare, si rregull nuk përputhet me momentin e kryerjes së kontrollit doganor, ngaqë pikat doganore ndodhen në largësi të konsiderueshme nga vija kufitare doganore.

Prandaj, gjatë eksportit të mallrave, në fillim bëhet kontrolli doganor për ngarkesat që do zhvendosen në zyrën doganore të nisjes, më vonë në zyrën doganore të daljes dhe, më pas, kontrolli i personit shoqërues të mallit me destinacion jashtë vendit, që e kalon atë përmes linjës apo vijës kufitare doganore. Ndërsa gjatë importit ndodh e kundërta, në fillim kryhet kontrolli i personit dhe regjistrimi i mjetit të transportit që ka në ngarkim, pastaj realizohet zhvendosja e ngarkesës përmes vijës kufitare, së fundmi organet doganore kryejnë kontrollin e hyrjessë mallit. Për rrjedhojë, nga momenti i kontrollit doganor, deri në momentin e kalimit faktik të sendeve përmes vijës kufitare, gjatë eksportit nga territori doganor dhe, nga momenti i zhvendosjes faktike të sendeve përmes vijës kufitare, deri në momentin e kontrollit doganor gjatë hyrjes në territorin doganor, kalon një periudhë e caktuar kohore, ndërkohë që fajtorit i krijohet mundësia të heqë dorë vullnetarisht nga çuarja deri në fund e krimit në fjalë, për rrjedhojë, në lidhje me këtë të fundit, përgjegjësia penale e tij përjashtohet.

Në qoftë se veprimtaria kriminale e tij parandalohet nga njerëz të tjerë, atëherë kryerja e veprimeve të tyre mund të vlerësohet vetëm si tentativë për kontrabandë. Supozojmë, që personi i cili ka vendosur të fusë në Shqipëri mallra ose sende të ndryshme të çmuara, sigurisht këto nëpërmjet kalimit kontrabandë, duke ia fshehur kontrollit doganor, nëpërmjet pajisjeve të fshehta specifike. Në këtë rast, momenti i përfundimit të kontrabandës varet nga një seri kushtesh. P.sh. personi mbas daljes së anijes nga porti i huaj, duke qenë në det të hapur, me iniciativën e vetë, hedh jashtë bordit të anijes sende të ndryshme, të cilat i kishte fshehur në “vendet speciale”(të ashtuquajtura xhepa të fshehtë), ose anasjelltas ua jep pjesëtarëve të anijes. Veprimet e kësaj natyre duhen vlerësuar si refuzim vullnetar për ta vazhduar krimin deri në fund të stadi të tij përgatitor, përderisa apo meqenëse nuk gjendemi në kushtet e ngarkimit me përgjegjësi penale, pasi nuk është realizuar kalimi apo zhvendosja e mallit nëpërmjet vijës së kufirit doganor, më saktë fshehjes së tyre nga kontrolli doganor.

Gjithashtu, në procesin e importimit të mallrave, në qoftë se veprime të kësaj natyre, i njëjti person i bën të mundur pasi ka kaluar vijën kufitare dhe në zonën doganore nuk ka deklaruar ende mallin, porse, deri në çastin e kontrollit doganor, deklaron vullnetarisht tek organet doganore për praninë e mallrave kontrabandë, atëherë veprimi apo gjesti në fjalë duhet vlerësuar si refuzim vullnetar për krim në stadin e tentativës, përderisa veprimet e tij nuk janë shoqëruar me fshehje të objekteve të kontrabandës nga kontrolli doganor.

Ndryshe duhen zgjidhur këto çështje, kur bëhet fjalë për nxjerrje kontrabandë të sendeve nga Shqipëria. Supozojmë se gjatë lëvizjes për të dalë nga Shqipëria, personi ka fshehur objekte kontrabandë në “vende të fshehta”. Mirëpo, përpara fillimit të inspektimit

doganor, ashtu sikurse edhe mbas këtij kontrolli apo inspektimi doganor, i cili ka rezultuar i pasuksesshëm në zbulimin e sendeve kontrabandë, personi në fjalë, i penduar për sa ka bërë dhe për më tepër merr vendimin vullnetar të mos e çojë deri në fund synimin e tij kriminal, duke vënë në dijeni punonjësit doganorë për praninë e sendeve kontrabandë, ose kur ndjekin rrugë të tjera detare, ajrore apo hekurudhore, vënë në dijeni shefat përkatës apo persona të tjerë të administratës së tyre. Në rastet e treguara më sipër, mendoj se faktori ka arsye të mjaftueshme për të mos iu nënshtruar përgjegjësisë penale, pasi ai hoqi dorë vullnetarisht nga finalizimi i krimit të tij në stadin e tentativës, për rrjedhojë, në veprimet e tij mungon gjëja më e domosdoshme e simptomës për përgjegjësi penale: zhvendosja faktike e objekteve përmes vijës apo linjës së kufirit doganor pa dijeninë e autoritetit doganor.

Vetëm kalimi (zhvendosja faktike) e objekteve kontrabandë përmes vijës doganore apo vijës kufitare (territorit doganor), *mbasi është kryer kontrolli doganor*, në praninë e një ose të disa simptomave të parashikuara në dispozitat e Kodit Doganor dhe atij Penal të fushës doganore, bëhet e mundur apo sjell përbërjen *përfundimtare të këtij krimi*. Vlen të theksohet, se në këtë rast, si për akuzën, ashtu edhe për gjykatën dhe avokatin, është i rëndësishëm vlerësimi i situatës që krijohet, kur kemi të bëjmë me vullnetarizëm. Megjithëse, çështja shtrohet vetëm për rastet kur faktori në mënyrë vullnetare, e përfundimisht, ka hequr dorë, apo refuzuar të kryejë kontrabandë në stadin e *përgatitjes ose të mospërfundimit të tentativës*, megjithëse i kishte të gjitha mundësitë që ta çonte krimin deri në fund, gjithsesiai nuk i shtyu veprimet kriminale në një rast më të përshtatshëm ose nuk i kreu si pasojë e pengesave të pakapërcyeshme.

• Kalimi faktik

Me fjalë të tjera, duhet të pranojmë se veprimet e personit për importin e kundërligjshëm të mallrave në territorin doganor të Shqipërisë, i nënshtrohenklasifikimit si tentativë për kontrabandë, në qoftë se është bërë *kalimi faktik* i kufirit shtetëror nëzonën doganore përmes pikës kalimit kufitar, ndërkohë që veprimtaria është ndërprerë për shkaqe objektive që nuk varen nga ky person, deri në momentin kur krimi vlerësohet si i kryer²⁰⁸, dhe pikërisht:

²⁰⁸ Në lidhje me këtë, duke debatuar për një qëndrim të mbajtur nga Kolegji Penal, ku me të drejtë krimet e trafikimit janë konsideruar vepra penale formale dhe të realizuara që në çastin e importimit, pavarësisht nga pasojat, autori i artikullit të lartpërmendur, duke moskuptuar drejt ligjin, ndryshe nga praktika gjyqësore, mendon se "... një formulim i tillë bie në gabimin e zakonshëm të ngritjes së tentativës në nivelin e një krimi të konsumuar". H. Ligori, Revista "Jeta Juridike". "Për kuptimin e tentativës". Më shumë shiko edhe Vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 608, datë 26.09.2007. Duke u bashkuar me qëndrimin ndryshe, edhe pse jo drejtpërdrejtë të mbajtur në Komentarin e Kodit Penal të RSH. Pr. Ismet Elezi, Skënder Kacupu, Maksim Haxhia, mendojmë se mendimet e shprehura më lart nga autori i artikullit "Për

- Deri në momentin e fillimit faktik të kontrollit doganor, si dhe kur kryhen krime me fshehje nga kontrolli doganor.

Tentativa, në këtë rast, fillon gjatë kalimit të personit në/dhe nga kufiri shtetërorpërmes kalimit të paligjshëm nëpër zonën doganore (në pikat e kalimit kufitar). P.sh. malli që kalon është vendosur në vende të përgatitura paraprakisht në ambientet e mjeteve të transportit për të fshehur mallrat, apo të vendosura me mënyra të tjera qëvështirësojnë zbulimin e tyre (vende fshehje të përgatituraposaçërisht apo duke shfrytëzuar vende që janë jashtësferësë kontrollit doganor) dhe kryhet në pajtim me fillimin e momentit të kontrollit doganor, d.m.th. në momentin e lindjes së domosdoshme për kualifikimin e kontrabandës sëpërfunduar si shenjë objektive, që është “fshehje nga kontrolli doganor”. Pra, në momentin që personi paraqitet nëzonën doganore nëzyrën doganore të hyrjes apo daljes (që gjenden në pikat e kalimit kufitar, kalon mallin, por refuzon kryerjen e kimit deri në fund) shfaq dëshirën para apo në kushtet e magazinimit të përkohshëm, për nxjerrjen e mallrave të fshehura nga vendi i fshehtë.

Gjithashtu, në kushtet e tentativës do të konsiderohen rastet, kur tentohet të kalohet kufiri jashtë pikave të kalimit kufitar, p.sh. mjeti i transportit tenton të kryejë kalimin e paligjshëm të kufirit, por pësondefekt nëzonën doganore të mbikëqyrjes,jashtë drejtimeve që të çojnë në pikat e kalimit kufitar (zonën doganore kufitare).

Veprimet kriminale mund të ndërpritengjithashtu edhe për shkaqe apo situata, që nuk varen nga personi fajtor. P.sh në rastin e ndërhyrjes së njerëzve të tjerë të panjohur, të personelit apo organeve të tjera shtetërore apo private, që nuk kanë të drejtë të kryejnë kontroll doganor, nga veprimet e fuqive natyrore (mbytet mjeti i transportit, rrezikohet nga faktorë atmosferikë dhe malli hidhet nga anija në det, në lumë apo liqen), apo shkaqe të tjera të ndryshme, në të cilat mund të përfshihen p.sh. dëmtimi apo çarja e gomës së automjetit, shkarkim i pavullnetshëm i mallit (në të cilën personi fajtor ka fshehur sendin objekt kontrabande me qëllim kontrabandimin).

- Deri në momentin e përdorimit të dokumenteve të falsifikuara ose mjeteve të identifikimit doganor, si vula, shenjat identifikuese doganore. Në këto raste, stadi i tentativës për kontrabandë fillon nga momenti i kalimit nëpër pikën kufitare (tokësore) apo të vijës së ujërave territoriale.
- Deri në momentin e pranimit nga organi doganor i deklaratës doganore, në kushtet e deklarimit të pavërtetë (fals) dhe të mosdeklarimit, në qoftë se në deklarim nuk janë

kuptimin e tentativës...” H. Ligori, janë rrjedhojë e keqkuptimit të ligjit lidhur me veprat penale të natyrës formale, siç është edhe kontrabanda nëpërmjet kalimit të kundërligjshëm të kufirit shtetëror.

shprehur (apo nuk janë deklaruar) të dhëna për mallrat objekt kontrabande. Në këto raste, stadi i tentativës fillon nga momenti i kalimit në/dhe nga territori doganor nga personi që ka ndërmend të kryejë kontrabandëme ndërmjetësinë e një prej metodave të lartpërmendura. Për tentativë mund të shërbejë edhe dëshmia e faktit të pranisë së dokumenteve të pasakta, të pasigurta (apo të pa duhura) nga personi shoqëruar, dokumente, si fatura, TIR Carnet, EUR-1, të cilat nuk përmbajnë informacionin e kërkuar për t'u paraqitur në deklaratën doganore së bashku me këto dokumente, si dhe veprimet e drejtpërdrejta për futjen e të dhënave jo të besueshme në deklaratën doganore.

- Deri në momentin e mbarimit të afateve të parashikuara me ligj, të dorëzimit të deklaratës doganore, të magazinimit të përkohshëm.

Duhet nënvizuar fakti se mundësitë e ndërprerjes së zbatimit të anës objektive të kontrabandës, të kryera me një nga mënyrat e cituara më lart, për shkaqe që nuk varen nga personi fajtor, për më tepër kanë karakter abstrakt. Kryesisht, shkakëputja e stadi të tentativës, mund të ketë kuptim praktik për aplikim apo për zbatim të institutit të refuzimit vullnetar të krimit.

Në kundërshtim me sa thamë më lart, për organin e akuzës dhe gjykatën, ka rëndësi dallimi i tentativës nga vepra e kryer në rastet e kontrabandës, kur veprimi i parë që përbën elementin e mbarimit të kontrabandës është:

- a) Gjatë importit/eksportit në/dhe nga territori doganor, këtooperacione i kryen jashtë kontrollit doganor që konsiderohet - kalimi faktik i (kundërligjshëm) kufirit shtetëror.
- b) Gjatë eksportit/importit të mallrave në/dhe nga zona doganore, dorëzimi i deklaratës doganore, ose kryerja e veprimeve të tjera, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti (apo janë drejtuar) për eksportin/importin e mallrave.

Në këto raste është e pamundur të pranohet si tentativë për kontrabandë, si kalimi faktik, ashtu edhe tërheqja vullnetare për kryerjen e krimit. Gjithashtu, situata vështirësohet kur aktet e pretenduara kundër të akuzuarit shfaqin dyshime në lidhje me vërtetësinë e qëllimit.

Në të drejtën penale të zakonshme lejohet të hezitosh mbi rolin që mund të luajnë deklaratat e të akuzuarit. Por, në të drejtën penale doganore, nevoja për të ndëshkuar, çka lidhet edhe me partikularizmat e provave në këtë fushë, i japin deklaratave të të akuzuarit një rol të rëndësishëm për kualifikimin e fakteve. Kështu p.sh., kur një i akuzuar, i ndaluar në një mal, i cili zotëronte një tërësi objektesh prej argjendi, deklaroi se kishte për qëllim të evitonte kontrollin doganor, kjo deklaratë e ndalon që të pretendojë më tej se ai ka qenë thjesht në “akte përgatitore”²⁰⁹. Disa gjykata kanë shkruar edhe më tej, për sa i

²⁰⁹Aix-en-Provence, datë 29 mars 1954, Dok. Kont., nr. 1099.

përket konceptimit subjektiv të “fillimit të ekzekutimit”. Është gjykuar se “vullneti i pranuar për të futur në Francë mallra importi të ndaluara, përbën një fillim ekzekutimi deliktor”²¹⁰.

Faktikisht, kjo zgjidhje e dematerializon në ekstrem nocionin e tentativës, madje duhet të kemi një rezervim në pranimin e saj. Nuk duhet të harrojmë se “fillimi i ekzekutimit” duhet të paraqesë një aspekt minimal material, në mënyrë që të mos kemi spekulime të rrezikshme. Lirimi, si rezultat i dyshimit, duhet të pranohet kur sjellja e personave të akuzuar paraqet një karakter shumë të dyshimtë dhe nuk lejon kurrsesi që t’i atribuosh një vullnet kriminal të përvokueshëm²¹¹.

2.2.3 Shmangia nga detyrimet doganore.

Për të karakterizuar anën objektive të krimit, me cilësinë e elementit të domosdoshëm për trajtimin e rrezikshmërisë së veprës penale të kontrabandës, ligjvënësi në përkufizimin e kontrabandës, në nenin 256 të Kodit Doganor përdor në mënyrë racionale termin “*shmangie*” tëpagesave të detyrimeve të importit/eksportit dhe në nenet 172-177 të Kodit Penal “*shmangie*” të detyrimeve doganore. Ndërkohë që, po në përkufizimin e kontrabandës, në nenin 256 të Kodit Doganor përdor të njëjtin term “*shmangia* nga ...kontrolli/mbikëqyrja.

Duke qenë se ky term (*shmangie*), është një dukuri që shfaqet në forma të ndryshme, përcaktimi i tij ka krijuar vështirësi praktike në punën e akuzës dhe gjyqtarit, por lidhur me të kanë lindur edhe diskutime teorike që kanë të bëjnë, si me klasifikimin e veprimtarisë së rrezikshme shoqërore për raste konkrete, ashtu edhe me kufizimin e kësaj vepre, nga kriminale në shkelje administrative kundërvajtje.

Mungesa e sqarimit në normat e së drejtës penale të nocionit të papërcaktuar *shmangie* nga pagesat e detyrimeve të importit, eksportit, kërkon nga akuza dhe gjykata, që në vendimmarrjetë vendosin vetë ata nëse kjo apo ajo veprimtari përbën *shmangie nga pagesat doganore*, në vijim, mbi bazën e vendimmarrjes, të përdorë nocione apo kuptime të ngjashme në karakteristikat e tyre, të cilat gjejnë reflektim në legjislacionin ekzistues.

Mendoj se në teorinë e së drejtës penale, përcaktimi i nocionit “*shmangie nga pagesat e import/eksportit*” duhet t’i kushtohet një vëmendje e veçantë. Trajtimet e padrejta të nocionit në fjale sjellin herë konkurrime të panevojshme e të tepërta të normave të së drejtës, herë deformime në realizimin e politikave penale të shtetit, në formën e gjykimit

²¹⁰ Gjykata Korrektuese Franceze Nice, datë 5 tetor 1970, Dok Kont., nr. 1508.

²¹¹ Gjykata e Lartë Franceze Sek. Krim, datë 22 qershor 1987, Bul. krim, nr. 257 fq. 697.

të pabazuar në ligj ose të shmangies apo lirimit nga përgjegjësia penale të personit të akuzuar.

Domosdoshmëria e përcaktimit ligjor të nocionit “*shmangie nga pagesa doganore*” rrjedh, ngaqë, *së pari*, termi “*shmangie*” siç përmendëm më lart, përdoret në përkufizimin e kontrabandës²¹², si motiv për të kryer veprën e kontrabandës. *Së dyti*, përcaktimi i kuptimit të përgjithshëm të nocionit “*shmangie nga pagesat doganore*” lejon apo bën të mundur të zbulohet në thellësi esenca e mënyrave të veçanta të këtij veprimi (*d.m.th. shmangies*), të dallohen pasojat si marrëdhënie juridike penale të cenuara apo të rrezikuara nga vepra penale e kontrabandës.

“Shmangia” është një veprimtari e qëllimshme, e drejtuar apo synuar për mospagimin e plotë apo të pjesshëm të detyrimeve të import/eksportit, brenda afateve të caktuara, të parashikuara në rregulla të përcaktuara mbi bazën e ligjit dhe të ndaluara me ligj penal, si veprimtari me rrezikshmëri shoqërore të dënueshme. Shmangia mund të shprehet nëpërmjet fshehjes së pjesshme ose të plotë të mallit si objekt pagese, apo nëpërmjet refuzimit të plotë të pagesës kur për mallin në fjalë informacioni është i saktëdhe i gjithanshëm.

Pyetja shtrohet nëse me termin “*shmangie*”, që përdoret gjerësisht në legjislacionin penal dhe doganor, nënkuptohet jo vetëm vetë veprimi (mosveprimi), por edhe rezultati/pasoja e tij.

Në bazë të trajtimit të problemeve, nga këndvështrimi ligjor duhet të nënvizojmë se, me *shmangie* nga pagesa e detyrimeve, duhet të kuptojmë veprimtaritë e qëllimshme që kanë për synim mospagimin e detyrimeve të import/eksportit, që sjellin si pasojë mosarkëtimin e plotë apo të pjesshëm të taksave dhe tatimeve të ndryshme në sistemin buxhetor.

Nga kjo pikëpamje, mënyra për shmangien nga pagesa e detyrimeve të import/eksportit, tatimeve, taksave të tjera të barasvlershme me të, si dhe çdo taksë apo tatim mbi mallrat objekt importimi, konsiderohen si veprimet e qëllimshme për plotësimin (deklarimin) në deklaratën doganore, apo në dokumente të tjera, të të dhënave të rreme që bien ndesh me ligjet në fuqi, ashtu edhe mosveprimet që shprehen në mosdhënien e qëllimshme të vetëdeklaratës p.sh. të një deklaratë eksporti të vendit të shitjes (ku e disponon), kontratës apo të dokumenteve të tjera të domosdoshme, si fatura të shitblerjes së mallit, EUR-1, certifikatën e cilësisësë mallit, etj., sipas rregullave të përcaktuara.

Gjatë kalimit përmes pikave të kalimit kufitar dhe paraqitjes së mallrave në zyrën doganore të hyrjes, pagesa doganore, d.m.th. detyrimi i importit mund të bëhet njëkohësisht me dorëzimin e deklaratës doganore. Sipas nenit 216 të Kodit Doganor, borxhi doganor lind sapo deklarohet malli, i cili ose paguhet ose garantohet. Ndërkohë që sipas nenit 11 të Kodit Doganor, mallrat dhe mjetet e transportit i nënshtrohet

²¹² Neni 256 i Kodit Doganor, nenet 172-174 të Kodit Penal.

deklarimit në organet doganore gjatë kalimit në hyrje të territorit doganor, si dhe në rastet e ndryshimit të regjimit doganor, apo edhe në raste të tjera të parashikuara në Kodin Doganor.

Deklarimi i mallrave bëhet nëpërmjet paraqitjes në organet doganore të të dhënave apo informacioneve mbi mallrat, regjimin e tyre, si dhe të dhëna të tjera të domosdoshme për qëllime doganore. Shmangia nga pagimi i taksave doganore, mund të shprehet apo të bëhet edhe me veprime aktive, veçanërisht nëpërmjet deklarimit jo të besueshëm, d.m.th. paraqitje në deklaratën doganore të një dokumenti që nuk ka formën e caktuar dhe përmban të dhëna jo të besueshme të mallit, si në sasi, cilësi, vlerë, lloj, kod tarifor, origjinë, që, nga ana tjetër, këto të dhëna ndikojnë nëpërlllogaritjen dhe pagesën e detyrimeve të importit.

Në këtë mënyrë, krimet e shqyrtuara më lart kryhen nëpërmjet “rrugës” së pabazuar e të pazbatuar të subjektit, ndaj të cilit janë shtrirë detyrime të bazuara në ligje, si pagesat e detyrimeve doganore (në kuptimin e detyrimeve të importit/eksportit).

Në nenet 261-268 të Kodit Doganor dhe 171-179 të Kodit Penal, si shprehje të këtij krimi përcaktohen:

- Mospagesa në kohën e caktuar me ligj të pagesës doganore²¹³.
- Përfitimi i pabazuar në ligj i lehtësirave doganore, nëpërmjet uljes së masës së pagesave doganore, rimbursimit të pagesave të mëparshme të import /eksportit, lirimi i plotë nga pagesat doganore²¹⁴.
- Përdorimi i mallrave, për të cilat janë paraqitur lehtësira në pagesat e importit (doganore), për qëllime të tjera nga ato për të cilat janë parashikuar këto lehtësira.
- Kryerja e operacioneve doganore të paligjshme me mallra, në shkelje të kërkesave të vendosura për regjimin doganor të zgjedhur.

²¹³Siç kemi shpjeguar edhe në kapitujt e mëparshëm, në kuptim të nenit 8 të Kodit Doganor ka një dallim të dukshëm midis detyrimeve doganore me detyrime import/eksporti, megjithatë legjislatori në dispozitat e lartpërmendura, për shkeljet doganore me shmangie nga detyrimet doganore, ka parasysh detyrimet e import/eksportit.

²¹⁴Në çështjen “Shteti kundër LXH”, Kolegji Penal, duke e gjetur të bazuar pretendimin se i gjykuari e ka konsumuar veprën penale të kontrabandës, të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal me Vendimin nr. 602, datë 11.11.2009, ka arsyetuar se: “Siç rezulton nga materialet e dosjes gjyqësore dhe, siç pranohet në vendimet e gjykatave, i gjykuari ka paraqitur të dhëna jo të vërteta në deklaratën doganore për sa i përket çmimit të mallit. Nga krahasimi i dy faturave të mallit, asaj të paraqitur nga i gjykuari dhe asaj origjinale të përcjellë nga Autoritetet Doganore Maqedonase, del qartë ndryshimi në çmim. Nuk rezulton që i gjykuari të ketë pretenduar gjatë paraqitjes së deklaratës doganore, se malli i importuar do të ishte për përpunim aktiv, sepse nëse do të kishte paraqitur këtë pretendim të mbështetur në ndonjë dokument (kontratë), atëherë ai (i gjykuari), në bazë të nenit 137 të Kodit Doganor, duhet të kërkonte autorizim nga Autoritetet Doganore për të kryer operacionin e përpunimit”. (Vendimi nr. 602, datë 11.11.2009).

Duke përfunduarkëtëçështje, duhet të theksojmë se:

Së pari, kontrabanda përmes kalimit të kundërligjshëm në një nga pikat e kalimit kufitar ku ka zyra doganore realizohet nëpërmjet:

- a) **Kalimit të mallrave apo mjeteve të tjera në pikat e kalimit kufitar, ku ka zyra doganore duke iu shmangur kontrollit dhe mbikëqyrjes doganore.**
- b) **Shoqërimit të këtij kalimi me shkelje të rregullave për kalimin në pikat e kontrollit doganor ose nëpërmjet përdorimit të dokumenteve false (mjete të identifikimit doganor),apo edhe nëpërmjet shkeljes së rregullave të deklarimit.**

Së dyti, gjatë shmangies së kontrolleve në rastet e kalimeve në pikat e kalimit kufitar, në zyrat doganore të hyrje- daljes mund të mos ketë shmangie nga detyrimet, mund të jetë kryer kohë më parë, apo do të kryhet më vonë. P.sh. gjatë ndryshimit të regjimit doganor të vendosur për mallrat objekt deklarimi, apo të anashkalimit të përdorimit të mallrave, sipas kushteve për të cilat është fituar një përjashtim apo privilegj. Për më tepër, në shmangien nga pagesat e detyrimeve të importit (doganore), kalimi përmes zonës doganore mund të ketë plotësisht karakter legal në kushtet e pumbosjes së mjetit me mall, ndërkohë që importimi është kryer me dokumente false, ndërsa plotësimi i formaliteteve doganore në doganën e brendshme bëhet me dokumente false që kanë ndryshuar sasinë dhe karakteristikat cilësore të mallit. Po ashtu, mund të mungojnë treguesit real në certifikatën e cilësisë së mallit, të cilët ndikojnë dukshëm tek pagesat e detyrimeve të importit. **Prandaj është e nevojshme të nënvizojmë, se rrethi i mënyrave të shmangies nga pagesat doganore është më i gjerë se gjatë kontrabandës së kryer me kalimin e kundërligjshëm të kufirit.**

2.2.4 Mënyra e kryerjes së kontrabandës.

Karakteristikë cilësore e çdo krimi “si pjesë e anës objektive të saj”²¹⁵ është mënyra e kryerjes së tij, të cilën mund ta përcaktojmë si tërësia e veprimeve të caktuara kriminale për përgatitjen, kryerjen dhe fshehjen e krimit. Mënyrat me anën e të cilave kryhen shmangiet nga pagesat e import/eksportit janë të shumta, në sasi dhe në llojet e tyre, gjë për të cilat dëshmon më së miri praktika e zbatueshmërisë së tyre.

Së fundi, nga gjithë kjo lind domosdoshmëria e studimit dhe përgjithësimin të mënyrave konkrete të kryerjes së krimeve si në njërin, ashtu edhe në degën tjetër, ose në sferën e veprimtarive të ndryshme, midis të cilave edhe ato që lidhen me shmangien nga pagesat doganore.

Duhet theksuar se në kushtet e ndryshimeve të përhershme e intensive të zhvillimit të legjislacionit doganor, të thjeshtëzimit dhe të lehtësimit të procedurave doganore apo edhe të modernizimit dhe përsosjes së teknologjisë kompjuterike, përherë e më tepër po

²¹⁵ Sh. Muça. “E Drejta Penale”, (e përgjithshme).

shfaqen mënyra të reja, ku veçoritë dalluese të tyre janë mekanizmat tepër të ndërlikuara. Kjo edhe për faktin e boshllëqeve dhe mospërputhjet e legjislacionit fiskal me realitetin konkret në mbledhjen e detyrimeve të import/eksportit. Të gjitha këto krijojnë terren të përshtatshëm për përgatitjen, kryerjen dhe fshehjen e krimeve të kontrabandës.

Nga ana tjetër, ndodh fenomeni i quajtur “*grumbullim i natyrshëm*”, që është një mënyrë e sigurt, efektive e me leverdi për kryerjen e krimit. Sasia e mënyrave të kryerjes së krimeve rritet vazhdimisht, duke i bërë ato gjithnjë e më të sofistikuara, çka lidhet me ndryshimet që pëson legjislacioni doganor, por shpesh edhe për shkak të mospërshtatjes të tij të plotë me drejtimin e veprimtarive të brendshme ekonomike²¹⁶. Shumëllojshmëria e mënyrave ekzistuese të shmangies nga pagesat e detyrimeve doganore dhe modernizimi i përhershëm i tyre, si dhe përsosja dhe përtëritja e tyre, nuk e kanë lejuar ligjvënësin të japë listën e plotë të mënyrave të shmangies të pasqyruara në Kodin Penal dhe në Kodin Doganor, apo në akte të dala në zbatim të tyre. “Ndërkohë që, në raste të caktuara pikërisht mënyra e kryerjes së veprës penale është element i domosdoshëm”²¹⁷, gjë që çon në kufizimin e luftës kundër saj, në raport me shkeljet ligjore administrative dhe me krimet e tjera.

Përcaktimi i drejtë i mënyrës së shmangies nga pagesat doganore varet shumë nga mënyrat e përgatitjes dhe kryerjes së deklarimit të mallit të pasaktë, të rremë, që nuk përputhet me gjendjen reale të mallrave në sasi, cilësi, lloj, kodin tarifor, origjinë, objekt importimi, eksportimi apo tranzitimi, nga deklaruesi.

Nëdhënien e deklaratave mund të ketë të dhëna të pavërteta, të karaktereve të ndryshëm. Për më tepër, për të klasifikuar një veprim apo sjellje si veprim kriminal, është e domosdoshme që informacioni apo të dhënat, në radhë të parë, të jenë të rreme, d.m.th. që nuk i përgjigjen realitetit, pra të jenë të gënjeshtër, pasi jo çdo dokument i siguruar, madje edhe nga kontrolli aposterior nëpërmjet informacioneve të siguruar nga dogana homologe në bazë të Konventave²¹⁸ ku Shqipëri ka aderuar, mund të shërbejë si provë për një deklaram të rremë, edhe pse përbën një shkresë zyrtare e ardhur nga dogana e vendit eksportues;²¹⁹ dhe, së dyti, të dhënat e paraqitura nga deklaruesi si të rreme duhet të

²¹⁶ Më shumë shiko: “Report of International Foreign Affairs and International Trade Canada Human Trafficking and Migrant Smuggling - International Crime and Terrorism”.

²¹⁷ Sh. Muça. “E Drejta Penale”, (e përgjithshme).

²¹⁸ Më shumë shiko: “Konventën e Nairobit”, Johannesburg.

²¹⁹ Në çështjen “Shteti kundër të gjykuarit A. G.”, Kolegji Penal, me Vendimi nr. 99, datë 18.03.2008, ka arsyetuar se: “Mbi të njëjtat prova, por në kundërshtim me disponimet e nenit 152 të K. Pr. Penale, Gjykata e Apelit Tiranë, duke i dhënë vlerë të paracaktuar dokumenteve të dërguara nga dogana italiane lidhur me vlerën e deklaruar para kësaj të fundit, në momentin e eksportimit të mallrave, ka ndryshuar vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, duke e deklaruar fajtor dhe dënuar të gjykuarin për veprën e

administrohen si të tilla, të ekzistojë motivi, përfitimi material apo çdo përfitim tjetër, pasi në të kundërt mungon qëllimi apo prapamendimi për kryerjen e krimit dhe, për rrjedhojë, vënia e personit para përgjegjësisë penale në këto raste shkel principin e përgjegjësisë penale. Së treti, të dhënat e pretenduara duhet të provohen me prova dokumentare²²⁰.

Më të përhapura janë mënyrat e shmangies nga pagesat doganore në rastet e importit të mallit. Shpesh, haset ulja e vlerës doganore të mallit të importuar, që mund të bëhet nëpërmjet disa rrugëve, thelbi i të cilave është paraqitja e informacioneve të rreme për vlerën doganore të mallit, që, si rregull, paraqitet nën/apo mbi vlerën reale të mallit. Gjithashtu haset edhe përgatitja e një pakete dokumentesh të falsifikuara, tek të cilat, në ndryshim nga ato origjinale apo të vërteta, vlera doganore e mallit që kalon (apo e mallit që transportohet) në territorin doganor ulet ndjeshëm.

Mënyrë tjetër e shmangies nga pagesat doganore është deklarimi i të dhënave të rreme mbi regjimin doganor të mallit, të vendosjes të tyre në një procedurë të veçantë doganore.^{221/222}

Deklaruesi kërkon vendosjen e mallit në një regjim doganor, që i siguron baza ligjore për përjashtim (ose reduktim) nga pagesat e detyrimeve të importit ose për lehtësira të tjera, si shtyrje të afateve të pagesës në kushtet e importit të përkohshëm të mjeteve të transportit nga persona fizikë, apo të makinerive objekt importi nga shoqëritë tregtare; por edhe pagesë me këste (kryerjen e pagesave në varësi me sasinë e mallit që kërkon gjatë deklarimit në kushtet e magazinimit doganor për t'i zhdoganuar), “import i përkohshëm” për persona juridikë, shmangie të pagesave të plota të detyrimeve të importit të produktit

parashikuar nga neni 174 të Kodit Penal. Kolegji Penal çmon se në veprimet e të gjykuarit nuk gjenden elemente të veprave penale për të cilat ai akuzohet (Vendimi nr. 99, datë 18.03.2008).

²²⁰ Në çështjen penale “Shteti kundër të gjykuarve N.A.&...” Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, duke gjetur të pabazuara pretendimet e ngritura në rekurs nga ana e prokurorit dhe, duke çmuar drejtë dhe të bazuar në ligj vendimin e Gjykatës së Apelit Vlorë, e cila ka rishikuar vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë në lidhje të çmuar për të provuar fajësinë e të pandehurve për veprën penale të kontrabandës, të parashikuar përkatësisht nga neni 174 i Kodit Penal, si dhe i ka deklaruar ata fajtorë, me Vendimin nr. 455, datë 15.10.2008, ka arsyetuar se në kushtet kur nuk ka asnjë provë që të vërtetojë se transformatorët që i gjykuarit Nexhmi i ka shitur “Albpetrolit” kanë kaluar në mënyrë kontrabandë në doganë, përkundrazi provohet se ato janë blerë me faturë të rregullt tatimore brenda vendit, me të drejtë kjo akuzë është pushuar nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë”. (Vendimin nr. 455, datë 15.10.2008).

²²¹ Në çështjen “Shteti kundër të gjykuarve J. M.&Ja” Gjykata e Apelit lidhur me ndarjen e figurave të krimit të kontrabandës thekson: “Figurë specifike e veprës penale, për shkak të regjimit të posaçëm doganor në të cilin ndodhen mallrat me të cilat bëhet kontrabanda, siç ishte regjimi i magazinës doganore i 223.853 kg kafe, është edhe ajo e kontrabandës me mallra me regjim të ndërmjetëm, parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal, dispozitë me të cilën, sikurse u tha, me të drejtë është bërë cilësimi ligjor i veprës penale të kryer prej të gjykuarve J. M.&Ja nga Gjykata e Apelit (Vendimi nr. 1, datë 26.03.2002 të Kolegjeve të Bashkuar të Gjykatës Lartë).

²²² Vendosjen e mallrave në një procedurë të veçantë doganore.

të gatshëm të importuar në kushtet e regjimit të përpunimit pasiv, etj. Gjithashtu, për kryerjen e formaliteteve doganore, mund të paraqesin dokumente fiktive për vetëdeklaruesin (që nuk ekziston, apo që ka një emër tjetër apo të një personi juridik që nuk ekziston, ose që nuk ka të bëjë me mallin objekt import/eksporti), duke futur këtu, në kushte të domosdoshme, edhe dokumente financiare fiktive (garanci financiare, emetime të llogarive personale).

Në këtë rast, informacioni për përdorimin real të mallit të kushtëzuar mund të zbulohet në kuadër të kryerjes së kontrollit aposterior, apo nëpërmjet kontrollit të rregullave dhe afateve të ruajtjes së mallrave në regjimin e “magazinimit doganor” apo në një procedurë tjetër doganore. Duke mbajtur parasysh faktin, që afatet e mbajtjes së mallrave në regjimet doganore favorizuese apo lehtësuese janë relativisht të gjata (për regjimin e magazinimit doganor, lejimin e përkohshëm, deri në 1 vit, me të drejtë shtyrje afati deri edhe një vit), në rastet e zbulimit të shkeljeve ligjore, pasi të kenë mbaruar këto afate, ka pak shanse që të përcaktohet personi fajtor. Në këto rrethana, mendojmë se janë të mundshëm dy variante të vlerësimit penalo-ligjor të veprimtarisë që i nënshtrohet gjykimit konkret.

Në rastin kur konstatohet apo zbulohet personi që ka kryer kalimin e mallrave dhe mjeteve të transportit përmes kufirit shtetëror, por që për to nuk ka për të paguar detyrime doganore, atëherë kjo veprimtari duhet të klasifikohet sipas neneve 257- 260 të Kodit Doganor, apo në varësi nga shkelja, sipas nenit 275 të Kodi Doganor. Gjithashtu, në qoftë se konstatohet apo vërehet që personi ka shkelur regjimin doganor të mallrave dhe të mjeteve transportuese për shkaqe që nuk vareshin nga ai²²³ apo në kushtet e një domosdoshmërie ekstreme, ai duhet të përjashtohet nga përgjegjësia penale.

Në mënyrë analoge ndodh shmangia për pagesat doganore gjatë të ashtuquajturit tranzit të rremë. Gjate vënies në zbatim të kësaj metode, malli, sipas dokumenteve, kalon përmes kufirit shtetëror dhe i adresohet një firme të caktuar, në territorin e një shteti tjetër, ose vendoset në regjimin e magazinës doganore me qëllim rieksporimit, ndërsa faktikisht pas importit në territorin doganor nuk eksportohet, por hidhet në qarkullim brenda vendit, duke iu shmangur pagesave të detyrimeve të importit.

Shmangie nga pagesat e detyrimeve të importit realizohen edhe nëpërmjet deklarimit të kodeve tarifore jo të sakta (tëgënjeshtër) për mallrat të cilat kanë karakteristika përdorimi

²²³Në çështjen “Shteti kundër A. DH.” Kolegji Penal me vendim nr.531 të datës 03.11.2004, ka arsyetuar se: “Vendimet e të dyja gjykatave janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit, ndaj për këtë shkak ato duhet të prishen dhe i gjykuari duhet të deklarohet i pafajshëm. Në këto kushte, pretendimi që ngrihet prej tij, se nuk ka kryer veprime që të përbëjnë figurën e veprës penale të kontrabandës, parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal nga ky Kolegj, gjendet i drejtë. Organi i Prokurorisë, duhej të kishte plotësuar akuzën me elementë të tjerë provë dhe jo ta pranonte atë të konsumuar në kushtet e përshkruara si më sipër. Gabim ky, që është ndjekur më tej edhe nga dy gjykatat që kanë shqyrtuar çështjen dhe ankimin e të gjykuarit. (Vendimi nr.531 i datës 03.11.2004).

të ngjashme, apo nëpërmjet deklarimit të rremëtë certifikatës së origjinës preferenciale, falsifikimit të autorizimeve për përdorim të veçantë të mallit të importuar për të përfituar nga tarifa favorizuese.

Një rëndësi të madhe ka edhe kuptimi i drejtë i momentit të përputhjes së kryerjes së krimit me momentin e kalimit (apo zhvendosjes) përmes kufirit shtetëror. Në kontrabandë, nëpërmjet kalimit faktik të kundërligjshëm të kufirit, këto dy nocione (apo kuptime) janë identike. Gjatë shmangieve nga pagesat doganore një reciprocitet i ngjashëm i tillë nuk ekziston.

Në këtë mënyrë, shmangia nga pagesat e detyrimeve të import/eksportit mund të ketë gjatë kalimit jologjor të kufirit shtetëror, por, në rastin kur zhvendosja apo kalimi bëhet në përputhje me rregullat e caktuara në zonën doganore, atëherë detyrimi për pagesat doganore lind jo nga momenti i sapo kalimit të mallrave, por nga momenti i dorëzimit, apo depozitimit të deklaratës doganore (apo të depozitimit të saj brenda afateve të caktuara). Shmangia nga pagesat doganore mund të bëhet jo vetëm në rajone të kufirit doganor, por edhe në rajonet e brendshme të vendit, në zonën e veprimtarisë apo aktivitetit të doganave të brendshme, ku hartohet dokumentacioni i nevojshëm për zhdoganimin e mallit apo vendosjen në një procedurë tjetër doganore.

Në këtë mënyrë, mendojmë se ana objektive e kontrabandës mund të përputhet me shmangien nga pagesat doganore, por nuk është e njëjtë me të²²⁴.

2.2.5 Vendi për kryerjen e kontrabandës.

Në nenin 5 të Kodit Penal "... është sanksionuar si parim kryesor, parimi i territorialitetit"²²⁵, i cili paraqet rëndësi për "përcaktimin e kompetencës territoriale" të gjykatës që do të gjykojë çështjen, si dhe për zbatimin e ligjit sipas parimit territorial dhe të shtetësisë, në rastet kur veprimtaria kriminale shtrihet edhe në shtete të tjera ose kur veprat penale kryhen jashtë territorit të vendit tonë²²⁶.

Në rastin e veprës penale të kontrabandës, vendi i kryerjes së kontrabandës, ndryshe nga veprat e tjera penale, rëndom bëhet objekt diskutimesh për vetë natyrën e kësaj vepre

²²⁴ Subjekte të ndryshme tregtare, të cilat ushtrojnë aktivitetin dhe biznesin në vendin tonë janë në përpjekje të vazhdueshme për të njohur dhe gjetur mekanizma të reja, me qëllim shmangien e detyrimeve doganore. Në përgjithësi synojnë të fusin kontrabandë ato mallra për të cilat parashikohet detyrim doganor i lartë, dhe kryesisht mallrat për të cilat paguhet akcizë. Këto lloj mallrash kanë edhe fitimin më të lartë, kur shiten në treg, prandaj edhe përbëjnë objektin e personave që merren me kontrabandë. Më e pëlqyer është kontrabanda e cigareve. Fenomeni që po përmendim është përhapur jo vetëm në vendin tonë, por edhe në vende të tjera, kryesisht ato të rajonit. Mall tjetër që vazhdon të mbetet mjaft i preferuar është edhe nafta, së bashku me nënproduktet e saj.

²²⁵ Pr. Dr. I. Elezi, Pr. Dr. S. Kacupi; Prof. as. Dr. M. Haxhia "Komentari i Kodit Penal" Tirane, 2012

²²⁶ Shefqet Muça. "E Drejta Penale", Pjesa e përgjithshme.

penale. Kështu, në përgjithësi, si vend i kryerjes së kontrabandëskonsiderohet territori në të cilin është kryer veprimtaria e fundit që formon elemente përfundimtare të krimit. Vendi, por edhe momenti i përfundimit të kontrabandës, përcaktohen në varësi nga mënyra e kalimit joligjor dhe nga karakteri i veprimtarisë që ndodh gjatë hyrjes (importit) në territorin doganor apo gjatë daljes (eksportit) nga ky territor (apo kufiri) të mallrave apo mjeteve të tjera.

Elementi përfundimtar i kontrabandës, siç u theksua më lart, në ndonjë rast formohet në momentin e kalimit faktik nga/dhe në territorin doganor, në raste të tjerë, nga momenti i kryerjes në territorin doganor të veprimeve të caktuara (mosveprimi gjatë mosdeklarimit), që karakterizojnë mënyrat e kalimit në kundërshtim me ligjin. Për rrjedhojë, në disa raste, vendi i kryerjes së kontrabandës do konsiderohet vija e hyrje-daljes në/dhe nga pikat e kalimit kufitar apo territori, pra nga vendkalimet *jashtë zonave doganore*, ndërsa në disa të tjerë, *në zonën doganore*, në pikat e kalimit kufitar apo në brendësi të territorit doganor.

Mirëpo situata është shumë më komplekse për veprat penale doganore të kryera në territor të huaj, ose të filluara në atë shtet, por të kapura në territorin shqiptar. Për ta kuptuar siç duhet këtë çështje, si fillim duhet të shikojmë kuadrin e të drejtës së përgjithshme, sipas neneve 5,6&7 të Kodit Penal ka përgjegjësi penale, sipas ligjit shqiptar, personi që fillon një vepër penale në territorin e një shteti tjetër, por kapet në territorin shqiptar p.sh. ka blerë drogë, armë apo mallra të ndaluara për të hyrë në territorin shqiptar dhe kapet me to në çastin e hyrjes në zonën doganor apo jashtë saj. Sipas jurisprudencës franceze, “vepra merret si e kryer në territorin francez nga momentikur njëri nga faktet ekzekutive zhvillohet në territorin francez”. Në këtë kuadër, nënkuptojmë, se vepra në të cilën të gjithë elementet materiale zhvillohen në territor të huaj, i shpëton kompetencës së gjykatave franceze. Gjithsesi, herë-herë jurisprudenca e ka mënjanuar këtë pasojë logjike të parimit të territorialitetit, kur, edhe pse vepra është kryer tërësisht në territor të huaj, ajo konsiderohej e lidhur me një delikt të kryer në territorin francez²²⁷ apo në rastin kur aktet e fillimit të ekzekutimit janë kryer në territor të huaj dhe ndërprerja jovullnetare e aktivitetit kriminal ka ndodhur në territorin shqiptar. Në të kundërt, n.q.s. të dy elementet e tentativës (fillimi i ekzekutimit dhe ndërprerja jovullnetare) janë lokalizuar në territor të huaj, mungesa e lidhjes midis tentativës dhe territorit kombëtar, nuk e lejon ndjekjen në territorin shqiptar, edhe kur autori është shqiptar. Gjithsesi jurisprudenca ka pasur si tendencë që ta anashkalojë këtë rregull, duke krijuar mundësi për të ndëshkuar tentativën, edhe kur ajo kryhet në territortë huaj.

Interpretimet e lartpërmendura, lidhur me vendin e kryerjes së kontrabandës paraqesin medoemos vlera teorike dhe praktike, ndaj, meqenëse dispozitat ligjore që lidhen me

²²⁷ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., datë 2 korrik 1932, Gaz. Pal. 1932, 2, 532.

veprën doganore të kontrabandës jo vetëm qëi ngushtojnë së tepërmi hapësirat e kryerjes së kësaj vepre, por në të vërtetë mungojnë dispozita konkrete në Kodin Doganor, ndaj mendoj se duhet të bëhen rregullimet përkatëse në Kodin e Ri Doganor, çka do ta afronte më shumë këtë koncept me atë të vendeve komunitare.

2.3. Ana subjektive.

2.3.1. Përgjegjësia, paramendimi dhe pakujdesia²²⁸

Ana subjektive e kontrabandës përfaqëson në vetvete vlerësimin psikologjik të subjektit për veprimtarinë e tij, të drejtuar për zhvendosjen (kalimin) në kundërshtim me ligjin, të mallrave dhe sendeve në/dhe nga kufiri doganor. Sipas anës subjektive, gjatë zhvendosjes (kalimit) në kundërshtim me ligjin, të mallrave apo sendeve të tjera përmes kufirit doganor, bëhet klasifikimi i kontrabandës, ndërsa në shumë raste të tjera, kontrabanda përcaktohet nga shkeljet e rregullave doganore për mallrat e vendosura në një procedurë të veçantë doganore. Përveç kësaj, ana subjektive e kontrabandës përcakton nivelin e rrezikshmërisë shoqërore të krimit dhe të personit që e kryen, e cila, nga ana e saj, ndikon si në masën e dënimit të kërkuar nga akuza, ashtu dhe në dënimin e dhënë nga gjykata.

Sipas strukturës vetjake, ky element përbërës i veprës penale të kontrabandës, ashtu si edhe në rastet e tjera të veprave penale, përmbledhet në tre shfaqje (simptoma)²²⁹ të pavarura, por të bashkëlidhura e të ndikuara nga njëra-tjetra: *motivi, qëllimi dhe faji*.

Lidhja dialektike e këtyre simptomave qëndron në faktin se lindin dhe marrin zhvillim në një koherencë të caktuar, në hapësira të ndryshme kohore dhe, duke mos humbur cilësitë e të qënurit të pavarur, vetëm në tërësinë e tyre grumbullues formojnë anën subjektive të elementeve të veprës penale të kontrabandës.

Fillimisht në ndërgjegjen e subjektit lind motivi, i cili përcakton qëllimin e krimit, gjë që sjell formimin e fajit. Për më tepër, në kushtet e qenësisës së fajit si element i domosdoshëm i veprës penale të kontrabandës, atëherë motivi dhe qëllimi janë të pranishëm vetëm në simptomat e krimeve me formë të qëllimshme faji. Motivi dhe qëllimi, i lindur para përgatitjes që siguron kryerjen e krimit, i paraprijnë fajit, i cili formohet që prej fillimit të veprimeve përgatitore.

²²⁸ “Krimi i kontrabandës kryhet me dashje të drejtpërdrejtë dhe me qëllim shmangie nga detyrimet doganore”. Ismet Elezi. “E drejta Penale”, Pjesa e posaçme.

²²⁹ Sh. Muca: “E drejta Penale”, Pjesa e përgjithshme.

2.3.2.Motivi dhe qëllimi²³⁰.

Motivi i kontrabandës²³¹ është dëshirat apo shtytjet psikologjike, *nxitësi për kryerjen e veprimit* që provokojnë te subjekti vendosmërinë për të kryer veprime, të cilat synojnë apo janë drejtuar për kalimin, në kundërshtim me ligjin, të mallrave apo sendeve të tjera, në/dhe nga kufiri shtetëror (doganor), si dhe çdo veprim tjetër me mallrat të vendosura në procedura të veçanta doganore, i cili e drejton veprimtarinë e tij në kryerjen e krimit të kontrabandës. Në lidhje të ngushtë me motivin është edhe qëllimi i kontrabandës, i cili konsiston në veprimtarinë mendore që përfshin në përfytyrimin e subjektit rezultatin e dëshiruar, mundësinë e posedimit të mallrave kontrabandë apo të përfitimeve që lidhen me to, të cilat mund të sigurohen *vetëm* me rrugën e kalimit, në kundërshtim me ligjin, të mallrave apo sendeve të tjera përmes kufirit doganor.

Motivet dhe qëllimi i veprimeve për kryerjen e kontrabandës mund të jenë të ndryshme. Kështu, ato mund të jenë tërësisht financiare (kontrabandë me mallra, si cigare, karburant), me qëllim të posaçëm shmangien nga pagimi i detyrimeve të importit/eksportit²³²; në këto raste, shmangia nga pagesa e import/eksportit kryhet për qëllime interesi financiar nga fajtori me synimin për t'i mohuar shtetit të ardhura financiare të llogaritura në buxhetin e shtetit nëpërmjet një forme të veçantë tatimi, që është pagesa e detyrimeve të import/eksportit.

Megjithatë, edhe pse ky qëndrim i referohet dispozitave ligjore në fuqi që kanë të bëjnë me kontrabandën, nenet 172–179 të Kodit Penal, dhe gjejnë mbështetje në tekstet universitare të së drejtës penale²³³, mendoj se duhet të pranohet me rezerva, pasi duke e lidhur qëllimin vetëm me interesin material, apo me shmangien nga detyrimet e importit, eksportit, në fakt ngushtojmë sferën e motiveve dhe qëllimit të kontrabandës. Sipas studiuesve të së drejtës penale të vendeve komunitare dhe në doktrinën juridike të tyre, kontrabanda si akt kriminal mund të realizohet duke pasur edhe motive dhe qëllime të tjera, që mund të mos kenë karakter interesi financiar ose që nuk lidhen drejtpërdrejtë me ato interesa²³⁴:

P.sh. në lidhje me ndalimin e plotë të importit dhe eksportit, tranzitit të një spektri të gjerë mallrash pa zbatuar rregulla speciale (armë gjuetie, fishekzjarrë, lëndë eksplozive, goma

²³⁰ Sipas të drejtës penale, motivet janë “shtysat e brendshme...”, më shumë shiko Shefqet Muça. “E Drejta Penale”, 2007

²³¹ Më shumë shiko: “Konventën e Nairobit”, Johannesburg.

²³² Shih vendimin nr.1, datë 26.03.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

²³³ Më shumë shiko: I. Elezi & E Drejta Penale e RSH, Pjesa e posaçme.

²³⁴ Më shumë shiko: West's Encyclopedia of American Law. By Jeffrey Lehman and Shirelle Phelps, published in 2005, si dhe Steve Thompson, material i cituar: David Widdowson. “Evolucion apo revolucion”. Dott. Nicola Monfreda. Zyra e Gurde De financa.

të përdorura, etj.), motivi dhe qëllimi nuk lidhen me interesa financiare, duke iu shmangur detyrimeve të import/eksportit; përkundrazi, mund të jetë vetë pamundësia për të kaluar në/dhe nga territori doganor në rrugë legale të tyre²³⁵. Në këto raste, subjektet, duke qenë se nuk kanë të drejtë, në mënyrë të pavarur, të kalojnë një kategori mallrash duke i deklaruar ato rregullisht sipas kërkesave të ligjit (p.sh. personat e huaj të paregjistruar si SHT apo si filiale të tyre, persona që nuk disponojnë licencën për importim të mallrave të veçanta të lartpërmendura, apo mallra me përdorim të dyfishtë, mallra të importuara për riekспортim drejt një vendi, ndaj të cilit zbatohet embargoja apo nuk u lejohet importimi, tranzitimi dhe eksportimi i mallrave objekt të veprimtarisë së tyre, për shkak se janë të bllokuar në sistem, pasi rezultojnë me borxhe doganore të papaguara), për të evituar procedura të tilla, importojnë apo eksportojnë mallra përmes kalimit në vijën doganore të kufirit tokësor, ujor dhe aeroporte, në mënyrë të kundërligjshme, pa synuar shmangien nga detyrimet, pra duke deklaruar saktë mallin, por nëpërmjet përdorimit të një NIPT-i që i përket një shoqërie tjetër, në marrëveshje ose jo me të. *Në këto rrethana, interesimi për t'u shmangur nga detyrimet e importit nuk janë shtysat kryesore të motivit të veprimeve të autorëve të kontrabandës dhe qëllimi i kontrabandimit të mallrave nuk është interesi material.*

Praktika e hetimit dhe gjykimit të veprave penale të kontrabandës tregon, që në të shumtën e rasteve ato kryhen për motive e qëllime interesi të ndryshme, për pasojë bëhet i pamundur listimi i tyre. Jo rrallë nxitës të motivit dhe qëllimit është dëshira për të përvetësuar sende apo objekte, të cilat janë të ndaluara për t'u nxjerrë apo për t'u futur në territorin doganor, mirëpo mund të jenë edhe përfitime të tjera personale, interesi, një detyrë e ngarkuar si anëtar i një organizate terroriste, shfrytëzim i detyrave funksionale të një nëpunësi doganor, apo të një nëpunësi që përfaqëson fushën doganore, po ashtu edhe për motive të tjera personale që nuk kufizohen nga çfarëdolloj kornize apo suaze. Megjithatë, kryesori është vetëindividit që kërkon të kryejë kontrabandën, përgatitet apo shfrytëzon çdo përgatitje për kryerjen, si rrjedhim dëshiron me patjetër ardhjen e pasojave, pasoja këto që realizojnë qëllimin që ai kishte vënë për të ardhur pasojat, realizimin e kontrabandës që kryen.

Në këtë rast, si organi i akuzës edhe gjyqësori duhet të marrin parasysh, që realizimi i kalimit, në kundërshtim me ligjin, i mallrave apo sendeve të tjera, përmes kufirit shtetëror, ende nuk sjell realizimin përfundimtar të krimit në fjalë, ndaj të cilit ka pikësynuar kontrabandisti. Për këtë, atij i duhet medoemos jo vetëm të kalojë sendet objekt kontrabandë përmes vijës kufitare doganore, por njëherazi duhet t'i çojë ato, pra sendet, në/dhe nga territori shtetit tjetër për realizimin dhe përdorimin për qëllime të tjera ose t'i fusë po për këto qëllime, nga territori i një vendi të huaj në atëshqiptar. Prandaj, momenti i mbarimit të krimit dhe momenti i arritjes së rezultatit kriminal, nuk përputhen asnjëherë. Veprimet e njerëzve apo personave, të cilët kalojnë apo vendosin

²³⁵ Më shumë shiko botime të "International Conference on Export Control", të vitit 1997-2002.

(depozitojnë), në kundërshtim me ligjin, sende apo materiale të tjera objekt kontrabande përmes kufirit doganor, mund t'i klasifikojmë sipas nenit 171 të Kodit Penal dhe nenit 280 të Kodit Doganor, vetëm atëherë kur vërtetohen me fakte të pakundërshtueshme, që fajtori në këtë rast kishte për qëllim jo vetëm kalimin në kundërshtim me ligjin, të mallrave përmes kufirit doganor, futjen, depozitimin e tyre apo vendosjen në një procedurë të veçantë të sigurt të këtyre mallrave kontrabandë, por edhe realizimin e shitjes së tyre në tregun e brendshëm, dorëzimin e tyre tek persona të tjerë ose tek organizata jo qeveritare, ose në të kundërt, daljen nga territori doganor të mallrave dhe depozitimine tyre në një shtet tjetër.

Në jurisprudencë pranohet fakti se kontrabanda hyn tek krimet, nëse gjatë kryerjes së saj nuk ndikojnë *motivi* dhe *qëllimi*, apo nuk influencojnë në klasifikimin e tyre²³⁶, megjithëse mund të merren parasysh gjatë individualizimit të dënimit. Megjithatë, gjithë kjo nuk do të thotë që përcaktimi i saktë i motivit dhe qëllimit gjatë hetimit të kontrabandës nga akuza dhe gjatë gjykimit nga gjykata, nuk luan rol të rëndësishëm.

Duhet të dimë që kontrabanda, si çdo lloj krimi i qëllimshëm, në çdo rast konkret kushtëzohet si nga një motiv konkret nga tjetri, si dhe nga një qëllim i caktuar, për rrjedhojë zbulimi dhe vlerësimi i tij nga organet hetimore e gjyqësore merr një rëndësi të madhe në përcaktimin e rrezikshmërisë shoqërore për veprën e kryer nga individ kriminel, gjë që, nga ana e saj, ndikon në mënyrë të ndjeshme në llojin dhe përmasat e dëmit. Motivi dhe qëllimi i kontrabandës duhet medoemos të vendosen, edhe pse në bazë të neneve 49-50 të Kodit Penal ato mund të shërbejnë si bazë për pranimin e kryerjes së krimit në kushte lehtësuese apo rënduese të fajit të bërë, ndërsa në raste të veçanta, në përputhje me nenet 53-55 të Kodit Penal, duhet marrë parasysh përcaktimi apo dhënia e dënimeve më lehtësuese, sesa ato që parashikon neni 171 e në vijim i Kodit Penal. Në lidhje me këtë fakt, për motivin dhe qëllimin kontrabandës, duhet të sillenprova të domosdoshme në procesin e hetimit paraprak nga policia gjyqësore, nga akuza, si dhe nga gjyqësori, për të cilën shprehen direkt nenet 2, 29-30, 73-74 të Kodit Penal. Mosrespektimi i kësaj kërkesë mund të sjellë në vetvete *kthimin e çështjes* për rihetim apo dhëniene pafajësisë së gjykuarit për mungesë provash ose për mungesë të elementeve të krimit.

Në kushtet e mungesës së këtij qëllimi, si një hallkë e domosdoshme midis momentit të kalimit të objekteve apo sendeve përmes kufirit doganor dhe arritjes së një rezultati konkret kriminal, veprimtaria në fjalë, për nga niveli i rrezikshmërisë shoqërore, nuk përfshihet në simptomat e elementëve të kontrabandës dhe sjell në vetvete përgjegjësi për shkelje të rregullave doganore, sipas Kodit Doganor²³⁷. Ndërkohë që shkalla e rrezikshmërisë shoqërore të subjektit të kontrabandës rritet, në qoftë se ai i vë qëllim vetes të realizojë zhvendosjen, në kundërshtim me ligjin, të objekteve apo sendeve të

²³⁶ Ismet Elezi, "E Drejta Penale", Pjesa e posaçme, viti 2009

²³⁷ Nenet 261–269 të Kodit Doganor.

ndaluara për eksport apo import (armë, lëndë narkotike, lëndë helmuese dhe mallratë rrezikshme për jetën e njerëzve, të kafshëve dhe të bimëve), si dhe përdorimin e tyre për kryerjen e krimeve të tjera. Në këto raste, gjithçka ndodh për faktin se ai paraqet qartëshkaqe të paevitueshme të dëmeve të shkaktuara nga disa objekte apo sende.

Në praktikën gjyqësore e hetimore, madje edhe në diskutime doktrinare ngrihet pyetja në lidhje me karakteristikën objektive të kontrabandës. Nëse veprimet e njerëzve, që kalojnë në mënyrë të paligjshme mallra apo mjete të tjera në vijën doganore, mund t'i klasifikojmë sipas neneve 171-178 të Kodit Penal vetëm në rrethanat kur vërtetohet në mënyrë të pakundërshtueshme, që fajtori kishte si qëllim jo vetëm tranzitimin e paligjshëm të mallrave drejt kufirit shtetëror, por edhe eksportimin e *detyrueshëm apo të domosdoshëm të mallrave kontrabandë në territorin e një shteti tjetër*. Ose, në të kundërt, jo vetëm importin e mallrave, por edhe realizimin e shitjes në tregun e jashtëm apo të brendshëm (shitje, dhënie personave të tjerë apo shoqërive tregtare, etj.), duke iu shmangur detyrimeve të import/eksportit.

Ndërsa veprimtaria, në rastet e kalimit të mallrave në/dhe nga kufiri shtetëror, por pa u arritur rezultati, pra duke iu shmangur detyrimeve të eksport/importit apo ndonjë përfitimi tjetër, për shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, nuk përmban karakteristikat e kontrabandës, atëherë duhet të ketë si pasojë përgjegjësinë administrative për shkelje të rregullave doganore.

Ky mendim është kontradiktor dhe nuk përputhet me trajtimin që bëjnë dispozitat penale për kontrabandën dhe ato të Kodit Doganor, në të cilat kontrabanda përkufizohet si veprë penale me tipare apo karakteristika *formale*. Për ta konsideruar të përfunduar veprimtarinë e treguar, është i domosdoshëm që personi të ketë kryer veprimtarinë e përcaktuar në dispozitat ligjore. Qëllimi është element i sjelljes dhe i veprimtarisë së ndërgjegjshme të njeriut, që karakterizohet nga një synim i qartë, një formë e të menduarit për rezultatin e veprimtarisë dhe për rrugët që çojnë në realizimin nëpërmjet mjeteve të caktuara.

Në këto kushte duhet të pranohet se vetë qëllimi i kalimit të kundërligjshëm përbën kushtin e domosdoshëm për fillimin e përgjegjësisë penale për kontrabandë. Nga ana tjetër, zbulohet përmbajtja e këtij qëllimi që është realizimi apo dërgimi i mallrave kontrabandë në tregjet e brendshme apo të jashtme. Kështu, qëllimi shprehet si mënyrë mendimi, fillimi i të cilit presupozohet në rezultate konkrete të veprimtarisë së individit apo personit, si dhe mjeteve të zgjedhura prej tij për realizimin apo përmbushjen e kësaj veprimtarie. Për rrjedhojë, në kontrabandë, veprimtaria apo aktiviteti do jetë kalimi i mjeteve në kufirin doganor, ndërsa qëllimi është dalja e rezultatit që ka pasur për synim fajtori, duke kryer në këtë rast krimin.

2.3.3 Faji.

Motivi dhe qëllimi i secilit element të krimit nuk mbarojnë ose nuk sosin përmbajtjen e anës së tij subjektive, në qoftë se, përveç këtyre elementëve, nuk do të përcaktohet faji i subjektit në veprimtarinë kriminale të kryer, d.m.th. marrëdhënie psikike të njerëzve ndaj kryerjes së sjelljeve të padrejta. Faji përbën elementin e domosdoshëm të krimit të kontrabandës, prania e të cilit krijon kushte subjektive të përgjegjësisë penale për kontrabandë.

Faji, në një shkallë a në një tjetër, është vlerësuar gjithmonë nga e drejta penale, e hershme a e vonë, si element i rëndësishëm, determinues për ekzistencën e veprës penale²³⁸.

Në parim penalizohet subjekti që vepron në mënyre të fajshme. Deri në verifikimin ligjor të fajit, i dyshuari për shkelje doganore prezumohet i pafajshëm, ndaj çdo ndërmarrje e veprimeve represive, si ndalimi i personit apo sekuestrimi, bllokimi i mallrave, i mjetit të transportit, etj., përmban riskun e dëmshpërblimit, nëse subjekti i dyshuar rezulton i pafajshëm.

Parimi i mirënjohur "*Nullum crimen, nulla poena sine culpa*" përbën bazën e përgjegjësisë penale edhe për rastin e veprës penale të kontrabandës. Në këtë veprë penale, sipas doktrinës, dashja e drejtpërdrejtë është e evidente. Personi është i ndërgjegjshëm²³⁹ për karakterin e kundërligjshëm të veprimeve, sepse përgatitjet për

²³⁸ Shefqet Muça. "E Drejta Penale". Pjesa e përgjithshme. Shtëpia Botuese "Dudaj" 2007.

²³⁹ Në çështjen "Shteti kundër të gjykuarit A.T &..." Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke përjashtuar përgjegjësinë penale për kontrabandë, në rastet e mungesës së dashjes direkte me vendimin nr. 190, datë 21.04.2004, ka arsyetuar se: "Vendimi i Gjykatës së rrethit gjyqësor Durrës, me të cilin është deklaruar fajtor i pandehuri A. H, për veprën penale të shpërdorimit të detyrës së kryer në bashkëpunim dhe i pafajshëm i pandehuri A. T, për veprën penale të tregtimit të mallrave kontrabandë në bashkëpunim, vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës, me të cilin është lënë në fuqi vendimi i Gjykatës së Rrethit, janë marrë në aplikim të drejtë të ligjit material e procedural dhe duhet të lihen në fuqi. Në rastin në shqyrtim, lidhur me akuzën e bërë të gjykuarit A. T., pasi duhet t'i referohemi nenit 178 të K.P., për të cilin ai është akuzuar... kërkon detyrimisht që personi të dijë që mallrat janë kontrabandë. Që i gjykuari A. T. nuk ka pasur dijeni për sasinë e naftës kontrabandë pranohet në vendimin e marrë nga prokurori më datë 17.04.2003, me të cilin pushohet akuzat në ngarkim të A. T. Për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i K.P. (kontrabanda me mallrat për të cilat paguhet akcizë), pasi nga hetimet ka rezultuar se nuk ka pasur dijeni për mosdeklarimin e sasisë së naftës. Po t'u referohemi problemeve që trajtohen në rekurs, në favor të pretendimit për pafajësi, në themel përmbajnë elementet e veprës penale të shpërdorimit të detyrës, pasi pranohet se i pandehuri nuk ka qenë i ngarkuar për një kontroll të tillë, sepse nga 5 persona që duhej të ishte përbërja e grupit shkuan vetëm dy, se kontrollin e bënë me shikim vizual pa asnjë mjet për të kontrolluar depozitat e naftës dhe se nuk mund t'i gjenin ambientet ku mund të kishte naftë, pasi edhe pasi kërkuan, kapiteni nuk iu dha skicën e anijes. Të gjitha këto pretendime tregojnë qartë, ashtu sikurse del nga

kontrabandë i ka nisur me kohë (*dolus praemeditatus*), sidomos për kalimin e kundërligjshëm apo fshehjen e mallit për t'iu shmangur kontrollit dhe mbikëqyrjes doganore, apo veprime të tjera²⁴⁰.

Arsyetimi i mësipërm gjen mbështetje, në faktin se kontrabanda hyn në shkelje ligjore, veçori karakteristike e së cilës është domosdoshmëria e pranisë së qëllimit ndaj të cilit janë drejtuar drejtpërsëdrejti veprimet e fajtorit dhe për pasojë ai cenon marrëdhëniet shoqërore, të cilat përbëjnë thelbin e objektit të këtij krimi. Në këtë kuptim, vepra penale e kontrabandës nuk është përjashtim, ndaj si çdo krim tjetër me elementë apo përbërje formale, mund të kryhet vetëm nëpërmjet qëllimit të drejtpërdrejtë. Mungesa e këtij të fundit përjashton përgjegjësinë penale për kalimin e paligjshëm të mallrave apo mjeteve përmes kufirit shtetëror, duke kaluar, sipas legjislacionit, në kualifikimin për shkelje ligjore administrative.

Në këto rrethana, sipas jurisprudencës, në shqyrtimin e shkeljeve doganore nga organi i akuzës, avokati dhe gjykata kërkohet të mbahet parasysh paramendimi i dashjes (*dolus praemeditatus*) dhe pakujdesia. Gjithçka për faktin se nga pikëpamja doktrinare, por edhe në zbatimin praktik shpeshherë përbënvijëndarëse për të klasifikuar shkeljen doganore kundërvajtje nga kontrabanda, kur ana objektive është e njëjtë. P.sh. gjetjen e një sasive, cilësie, origjine të mallit të ndryshëm nga ai që konstatohet nga autoriteti doganor.

Përcaktimi nëse ky veprim është kryer me dashje apo nga pakujdesia, në kushtet e mirëbesimit, përbën kushtin kryesor që veprimi apo mosveprimi të klasifikohet

provat e administruara, se i pandehuri A. H. ka konsumuar plotësisht veprën penale të shpërdorimit të detyrës, për të cilën është akuzuar dhe deklaruar fajtor.

Mendimi i pakicës: në këto rrethana mendojmë se është e papranueshme që gjykatat, nga njëra anë, deklarojnë dhe dënojnë të gjykuarin Q.B. (posedues i mallit) për kontrabandë, sipas nenit 178 të K.P., kurse, nga ana tjetër, të deklarojnë të pafajshëm të gjykuarin A. T. Për këtë vepër, me arsyetimin se mungon ana subjektive, megjithëse ata kanë qenë në të njëjtat kushte. Përderisa pranohet përgjegjësia e personit që ka marrë sasinë e naftës jashtë rregullave të parashikuara në Kodin Doganor, natyrisht duhet të pranohet edhe përgjegjësia e atij që e jep atë sasi naftë, pasi ky i fundit, si person që e ka në përdorim atë, është i detyruar të zbatojë rregullat në rast të tjetërsimit të saj, qoftë me të drejtë kthimi ose për çfarëdo shkak tjetër. Për këto arsye, mendoj se të dyja vendimet e gjykatave duhet të prisheshin në pjesën që deklarojnë të pafajshëm të gjykuarin A.T. dhe ky i gjykuar të deklarohej fajtor dhe të dënohej për kontrabandë, sipas nenit 178 të K.P. (vendimin nr. 190, datë 21.04.2004).

²⁴⁰ Në lidhje me këtë Kolegjet e Bashkuara në çështjen “Shteti kundër të gjykuarve Mi& Ar.H” në vendimin nr. 1, datë 26.03.2002, kanë arsyetuar se “..Rezultati kriminal i arritur nëpërmjet kësaj veprimtarie, shmangia nga kontrolli doganor, duke mos paguar në buxhet shumën 62.840.960 lekë, sikundër me të drejtë kanë pranuar gjykatat e dy shkallëve të gjykimit të çështjes, ka ardhur si rrjedhojë direkte e veprimeve të kundërligjshme të kryera nga gjithë të gjykuarit e përmendur, të cilët vepruan me marrëveshje dhe në bashkëpunim midis tyre, në rolin e bashkëzekutorit të kësaj veprimtarie kriminale”. Vendimin nr.1, datë 26.03.2002, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

kundërvajtje i përcaktuar në Kodin Doganor, në veçanti nenet 261- 265 të Kodit²⁴¹, apo përbën veprën penale të kontrabandës²⁴².

Sipas pranimet të rregullit të përgjithshëm, elementi intelektual i qëllimit (apo paramendimit) konsiston në ndërgjegjësimin e subjektit për sjelljen me karakter të rrezikshëm shoqëror, ndërsa ai i vullnetshëm, në dëshirën për kryerjen e tij (d.m.th. të realizimit të krimit të kontrabandës).

Do të konsiderohet veprim me paramendim subjekti qërealizon një rrethanë, e cila përbën një shkelje të veprimit ligjor, duke e konsideruar element të mjaftueshëm faktin që shkelësi, realizimin e veprimit ta konsiderojë seriozisht të mundshëm dhe të pajtohet me të, duke marrë masa përgatitore. Në aspektin material, bazën e përgjegjësisë e përbën vepra e kryer kontrabandë, ndërsa në aspektin formal-juridik, bazën e përgjegjësisë të shkeljes doganore e përbën prania e një prej figurave të veprës penale të kontrabandës.

Referuar neneve 171-179 të Kodit Penal karakteristikë për elementët përbërës të kontrabandës është vetëm prania e fajit të *qëllimshëm* në formën e tij të drejtpërdrejtë. Qëllimi i drejtpërdrejtë përmbledh në vetvete ndërgjegjësimin e subjektit për karakterin e rrezikshëm shoqëror të veprimtarisë së tij (*veprimet ose mosveprimet*), parashikimi i pasojave të rrezikshme shoqërore dhe dëshira për ardhjen e tyre.

Pra, ndërgjegjësimi për karakterin e rrezikshëm shoqëror të një veprimtarie të kryer, term që përdoret rëndom në literaturën juridike dhe praktikën gjyqësore për krimet e kontrabandës, do të thotë kuptimi i thelbit të marrëdhënieve shoqërore, të cilat shkelen nëpërmjet veprimeve kriminale (d.m.th. marrëdhënieve të lindura si pasojë e rregullit të vendosur për lëvizjen e mallrave përmes kufirit doganor dhe pagesave të detyrimeve të importit), përmbajtja e këtij veprimi kriminal (d.m.th. zhvendosja e ngarkesës me anë të lëvizjes, që është në kundërshtim me rregullat që sigurojnë kontrollin doganor ose fshehja nga ky kontroll i mallrave apo sendeve që kalojnë përmes kufirit doganor) dhe një apo disa simptoma të cilat i japin kësaj zhvendosjeje përmbajtje penale. Në këtë rast, për subjektin nuk është e domosdoshme njohja e thelbit juridik të këtyre simptomave, përkundrazi mjafton ndërgjegjësimi për praninë fizike të tyre (p.sh. zhvendosja, kalimi i mallrave me akcizë, mallrat me karakter të dyfishtë, narkotikët, armët, etj.), që të ndodhë apo të realizohet nëpërmjet shmangies së kontrollit doganor.

Në qoftë se njeriu merr një vendim të ndërgjegjshëm për një sjellje të caktuar për kontrabandë, atëherë ai ka dëshirë ta kryejë atë për shkak të qëllimit që i ka vënë vetes (kalimi apo shmangia nga pagesat doganore apo për ndonjë përfitim tjetër). Personi është plotësisht i ndërgjegjshëm se po kryen një veprim antiligjor, sepse sjelljet e tij janë në

²⁴¹ Kodi Doganor, nenet 261-264.

²⁴² Neni 171-179 i Kodit Penal.

kundërshtim me rregullat e vendosura doganore dhe, në një situatë të tillë, (veçanërisht në qoftë se merr në konsideratë variante të mundshme e të menjëhershme) nuk ka vend për hipotezë të ndërgjegjshme, tashmë të kryer. Kjo sepse çdo hipotezë e fillimit të pasojave (shkaku i dëmit) presupozon një nivel të caktuar të mundësisë së fillimit.

Parashikimi i pasojave me rrezikshmëri shoqërore, konsiston në përfytyrimin e subjektit për ndryshimet faktike konkrete, të cilat duhet të ndodhin si rezultat i veprimeve të tij në objektin ndaj të cilit bën atentat, apo shkelje (d.m.th. rregulli i vendosur për zhvendosjen e mallrave dhe sendeve të ndryshme përmes kufirit doganor apo kushtëzimet e vendosura për mallrat në një procedurë të veçantë doganore do të shkelen), si rezultat mund të shoqërohet e dëme të ndryshme të interesave ekonomike. Ndërsa, në kushtet e futjes apo importit të armëve, municioneve, lëndëve plasëse, materialeve me veprim të fortë, lëndëve narkotike, etj., që në tërësinë e tyre si objekt plotësues, do të sjellin dëme në sigurinë shoqërore dhe në shëndetin e njerëzve, kafshëve dhe bimëve, dëshira për fillimin e pasojave të rrezikshme shoqërore do të thotë apo nënkupton tendencën e vullnetshme për realizimin apo përmbushjen e tyre, pavarësisht nga ndërgjegjësimi për dëmin shoqëror dhe ndëshkimin e veprimeve të kryera.

Në njëfarë mënyre kjo tendencë e vullnetshme përcakton qëllimin e kontrabandës, e cila ndahet në të parën dhe në atë që vjen më pas. Qëllimi parësor i subjektit gjatë kryerjes së këtij krimi është kalimi, në kundërshtim me ligjin, të mallrave apo të sendeve të tjerë, në/dhe nga kufiri shtetëror (territori doganor), apo çlirimi i tyre nga kushtëzimet e të qenit në një procedurë të veçantë doganore, që shoqërohet apo pasohet me vendosjen ose daljen e tyre në/dhe nga territori i RSH për realizimin e shitjes në tregjet e brendshme ose të jashtme përmes rieksporimit apo për interesa të tjera. Pa praninë e këtyre 2 komponentëve të domosdoshëm të anës subjektive, përgjegjësia për kontrabandë, sipas neneve 171-179 dhe neneve 276-280 të Kodit Doganor, nuk ka vend apo nuk ekziston dhe duhet trajtuar sipas neneve 256-267 të Kodit Doganor si kundërvajtje doganore.

N.q.s. vendosmëria për të kryer një veprimtari bëhet realitet, atëherë nuk mendojmë se duhet të flasim për ndonjë hipotezë (që do të thotë, mundësi e vogël, supozime). Situatat në fjale na japin mundësi të argumentojmë mbi mungesën e pranisë së qëllimit anësor në krim. Gjatë tentativës për kryerjen e kontrabandës, fajtori pranon me vetëdije jo vetëm veprimtarinë e rrezikshme shoqërore, por edhe rrethanat faktike që karakterizojnë situatat kriminale.

Kështu në fushën e vetëdijes së kriminelit do të përfshihen:

- a) Karakteristikat e objektit të kontrabandës.
- b) Veçoritë e vendosjes së mallrave në një procedurë doganore, në veçanti, apo të destinacionit doganor, në përgjithësi.
- c) Gjithçka e përdorshme në rastet konkrete.

d) Procedura e përdorur (rregulli i veprimeve juridike të rëndësishme)

Të gjitha këto (a,b,c,d) duhet të kryhen medoemos, me qëllim që të bëhet i mundur kalimi nëpër kufi i mallit objekt kontrabandë i të interesuarit, apo çlirimi i tyre nga kushtëzimet e vendosura në autorizimet e lëshuara nga autoritetet doganore për regjimin doganor të miratuar.

2.3.4.Përrjashtimi nga faji ²⁴³ dhe arsyet justifikuese.

Parimi, sipas të cilit nuk ka krim pa pasur dëshirën për ta kryer atë (neni 15 i Kodit Penal), është i aplikueshëm edhe për krimet doganore, por duke marrë parasysh disa rezerva legale dhe jurisprudenciale. Në këtë këndvështrim, krimi doganor i mosdeklarimit të parave para autoritetit doganor i përcaktuar në nenin 179/1 të Kodit Doganor shënjestron ata që “kanë mundur të bëjnë ose tentojnë të bëjnë një operacion financiar ndërmjet Shqipërisë dhe jashtë, operacion lidhur me fonde, të cilat vijnë direkt apo indirekt” nga krimi i parashikuar në ligj si ai pastrimit të parave, prandaj, nëse personi kundërvajtës argumenton se paratë e padeklaruara kanë burime të ligjshme nuk konfiskohen,*kjo sepse për të akuzuarin ekziston jo vetëm mundësia të sjellë provat për të provuar të kundërtën, por edhe të sulmojë në këtë mënyre prezumimin e përgjegjësisë duke vërtetuar sjelljen e ndershme.*

Në prezencë të një prezumimi të përgjegjësisë, barra e provës bie mbi të akuzuarin d.m.th. ai duhet të provojë që ka vepruar në mënyrë të ndershme. Në një nga çështjet e gjykuara në gjykatën franceze, nuk u anulua vendimi i Gjykatës së Apelit, e cila për të deklaruar ekzistencën e parandalimit, u limitua në nxjerrjen e elementeve materialë të veprës penale, pasi kishte kërkuar qëllimin penal të të akuzuarit nga momenti që i akuzuari nuk pretendonte,por as provonte që kishte vepruar në mënyrë të ndershme ²⁴⁴. Në rastet e shkeljeve doganore kontrabandë për gjykatën dhe akuzën, subjekti shkelës nuk mund të quhet as paramendim apo pakujdesi, nëse, në një akt, i ka shpëtuar një gabim që mund të moskonsiderohet si i tillë. P.sh. deklarimi ndryshe në peshë, ndërkohë që malli në njësinë matëse shprehet në copë dhe është deklaruar saktë, apo paraqitja e një

²⁴³ Duke mbajtur parasysh se elementi *faj* ka të bëjë me gjendjen mendore, *mens rea*, të personit që kryen veprën, e cila cilësohet kundërvajtje, përfshirja në përkufizimin e kundërvajtjes edhe të termit *faj*, do ta saktësonte më mirë këtë përkufizim dhe do ishte më në unison me parimin e së drejtës penale *se nuk ka krim, nuk ka dënim pa faj*, “*Nullum crimen, nulla poens sine culpa*”. Megjithatë, elementi faj në rastin e përkufizimit të kundërvajtjes doganore nënkuptohet, pasi, si në vetë përkufizimin, edhe në dispozitat pasardhëse përcaktohet dënimi. Ndaj nuk e gjejmë me vend kontestimin e bërë në studimin “Lehtësimi i Procedurave Doganore...” (ACIT, 2004.), se “përkufizimi i kundërvajtjes në Kodin Doganor është i ndryshëm nga ai i kundërvajtjes administrative, referuar ligjit të Procedurave Administrative. Më shumë shiko studimin: “Lehtësimi i Procedurave Doganore ...”. (ACIT, 2004.)

²⁴⁴ Gjykata e Lartë Franceze (Cass. Crim., 7 mars 1996, kërkesë nr. 94-84553, *Bull, crim.* Nr. 108, fq. 331).

certifikate të origjinës preferenciale të lëshuar nga dogana e vendit nisës, por që malli nuk i përgjigjet kësaj origjine, gjë që nuk e la të kuptonte shkeljen apo të keqen që ka për bazë akti. Nëse gabimi nuk mund të falet, atëherë subjekti debitor mund të konsiderohet se ka vepruar në pakujdesi.

Shkelësi do të konsiderohet i pakujdesshëm edhe kur ai, për një veprim të pasaktë nuk është dhe nuk mund të ishte në dijeni, por për vetë rrethanat e objektit material nuk përbën shkelje doganore. P.sh. drejtuesi i automjetit, apo mjetit detar IT nuk ka qenë i pranishëm në ngarkimin e mallit dhe, nëçastin e deklarimit të mallit në zyrën doganore, gjatë kontrollit të mjetit gjenden mallra me diferencëpeshe në sasi, por këto diferenca janë të papërfillshme apo mallrat janë të përjashtuara nga detyrimet e import/eksportit.

Ndryshe do të konsiderohet rasti kur fajtori nuk pranon, me vetëdije të plotë apo në masën e duhur, karakteristikat speciale të objektit të kontrabandës ose një person në Itali pranon të kryejë porosinë një miku, duke i marrë me vete për në Shqipëri një çantë pa ditur se çfarë ka brenda,ndërkohë që në zyrën doganore në Shqipëri, pas kontrollit, gjendet një artikull që përfshihet në mallrat e ndaluara,sikurse për të shmangur pagesën shtesë për tejkalim peshe A që udhëton me B, i cili nuk ka bagazhe, i jep B-së një valixhe me mallra të ndaluara apo të taksuara p.sh. cigare dhe gjatë kontrollit në doganën e vendit mbërritës, pas kontrollit, i gjenden mallra të padeklaruara dhe të ndaluara për t'u importuar. Shtrohet pyetja nëse këta persona do të ngarkohen me përgjegjësi penale për kontrabandë, që, në kushtet e pakujdesisë, nuk i dinin funksionet apo cilësitë e personit që ndihmuan, apo nuk kontrolloi çantën me mallin që kishte brenda parapakisht? Lidhur me rastet e mësipërme, që nuk janë të rralla në praktikën administrative dhe gjyqësore, ka diskutime nëse veprimet gjatë importimit, eksportimit të mallrave në/dhe nga kufiri shtetëror në kushtet e pakujdesisë si element i fajit, mund të konsiderohet se gjendemi përpara veprës penale të kontrabandës.

Në raste të tilla mendoj se vepron rregulli i vendosur, sipas të cilit, mungesa tek fajtori i informacionit për futjen e njërit apo tjetrit mall në listën e mallrave të rëndësishme strategjike, si lëndë e papërpunuar, teknologji e sofistikuar, software për riekспорт, importimi i mallrave me qëllim të dyfishtë, eksportimi i mallrave që përfshihen në embargon e vendosur ndaj një apo grup shtetesh, apo veprimet e shkujdesura për të ndihmuar si në rastet e mësipërme, nuk është bazë apo arsye për përjashtim nga përgjegjësia për kontrabandë të këtij lloji malli dhe se, në rrethana të caktuara, edhe në kushtet e pakujdesisë, subjekti deklaruesduhet të ngarkohet me përgjegjësi për veprën penale të kontrabandës ²⁴⁵. Në fakt, doktrina jonë nuk e ka pranuar pakujdesinë si element

²⁴⁵ Për fat të keq, shkruan një studiues, është gjithashtu e mundur që të ndiqeni penalisht për një krim të kontrabandës, edhe në qoftë se ju nuk jeni të vetëdijshëm se jeni në zotërim të mallit kontrabandë p.sh., në qoftë se ju merrni hua një makinë të mikut tuaj dhe nuk e dini se në të poseduesi i mjetit ka fshehur një

të fajit në rastet e kontrabandës, por gjithsesi rastet e mësipërme dhe pikëpamjet rreth tyre nuk mund të anashkalohen, përkundrazi duhet të bëhen objekt diskutimi me synim përmirësimin e mëtejshëm të legjislacionit doganor në tërësi dhe të veprave penale të krimit në fushën doganore.

• Përgjegjësia.

Në fushën doganore parimet e së drejtës penale të përgjithshme mbi përgjegjësinë gjejnë aplikim: individi mund të dënohet vetëm kur ai ka vepruar lirisht dhe në impuls të vullnetit të vetë. Çka nënkupton se personi, i cili nuk është i aftë mendërisht, nuk është i përgjegjshëm. Përveç kësaj, parashikohet edhe rasti i veprimit nën presion dhe forcave madhore (ose natyrore).

2.4 Subjekti i shkeljes doganore.

Subjekti i kontrabandës karakterizohet nga cilësi të përgjithshme, të pranishme në të shumtën e krimeve, të parashikuara në Kodin Penal. Sipas neneve 171-179 të Kodit Penal, përgjegjësia *penale* për kontrabandimin bie mbi personat fizikë të përgjegjshëm, qofshin këta qytetarë shqiptarë, të huaj, sikundër dhe mbi ata që nuk kanë nënshtetësi.

Si subjekt i përgjithshëm mund të jetë çdo person fizik i dyshuar, i cili ka arritur (ose ka mbushur) moshën 14 vjeç²⁴⁶. Moshë e treguar më lart shpjegohet me faktin se në këtë moshë arrihet zakonisht pjekuria psikike normale e njeriut, stad kur është plotësisht i aftë të vlerësojë sjelljen personale, në këtë rast edhe rrezikshmërinë shoqërore të një krimi të ndërlikuar siç është kontrabanda. Megjithatë, si praktika hetimore, ashtu edhe ajo gjyqësore, gjatë gjithë kohës së veprimit të ligjeve mbi përgjegjësinë penale gjatë ushtrimit të kontrabandës, praktikisht ka pak precedentë të ushtrimit të saj, d.m.th. të kontrabandës nga qytetarë të moshave 14-18 vjeç. Shkaku i kësaj gjendjeje, sipas mendimit tonë, është sepse sasia e njerëzve të kësaj moshe, të cilët hyjnë apo dalin nga territori doganor shqiptar, në krahasim me personat e moshave më të mëdha, është i vogël. Përveç kësaj, personat e moshave 14–18 vjeç zakonisht e kalojnë kufirin doganor në shoqërimin e njerëzve të rritur dhe fshehja prej tyre e objekteve apo sendeve nga kontrolli doganor, apo çfarëdolloj pjesëmarrjeje në kontrabandë, si rregull, kryhet nën ndikimin e njerëzve madhorë, gjë që nuk mund të mos merret parasysh nga organet hetimore dhe ato gjyqësore gjatë trajtimit të problemit të përgjegjësisë së personave, të

armë, ju mund të akuzoheni për posedim malli kontrabandë nëse ju ndal policia dhe automjeti kontrollohet. Është e rëndësishme të jeni të kujdesshëm, kur merrni diçka që i përket dikujt tjetër. Është po aq e rëndësishme që të këshilloheni në lidhje me ligjet e kontrabandës, në mënyrë që të mos i thyeni kurrë ato.

Steve Thompson/Freelance Writer of different articles for AC and 100 Happy People.

²⁴⁶ Neni 12 i Kodit Penal.

cilët nuk kanë mbushur moshën e pjekurisë, për atë që kanë kryer këta të fundit. Si pasojë, edhe në mbështetje të idesë së hedhur më lart, fajtori që nuk ka plotësuar moshën e pjekurisë në kushtet e kontrabandës së një malli apo sendi të veçantë, duhet trajtuar gjatë dhënies së dënimit si një situatë lehtësuese apo zbutëse.

Personat e huaj²⁴⁷, kur kontrabanda është kryer prej tyre (shtetas të huaj apo persona pa shtetësi) jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, do të përgjigjen penalisht, kur këto vepra cenojnë jetën, shëndetin e shtetasve shqiptarë, siç mund të jete importimi i mallrave të kontrabandës absolute, për mallra të skaduara apo të infektuara, por edhe kur kryejnë veprimtari doganore të kundërligjshme brenda territorit doganor shqiptar.

Në bazë të neneve 80, 216-220 të Kodit Doganor, në kushtet e deklarimit të mallit apo të vendosjes së mallrave në një regjim doganor, subjekt i krimit të kontrabandës mund të jetë:

-deklaruesi (personat e përcaktuar në Kodin Doganor që janë caktuar për të deklaruar mallin).

-mbajtësi i autorizimit të regjimeve doganore, si dhe poseduesit e mallit të vendosur në regjimet doganore të magazinimit, kur në autorizim është përcaktuar një përgjegjësi solidare me mbajtësin e autorizimit, me ruajtjen, shitjen, administrimin e mallrave në Zonën e Lirë dhe Magazinat e Lira. Në kategorinë e subjekteve për krime, mund të hyjnë gjithashtu personat që faktikisht kryejnë detyrën e financierit, administratorit, menaxherit, si dhe çdo person që bie dakord të transportojë²⁴⁸ apo të veprojnë së bashku, me qëllim që të shmangin pagesat doganore, detyrimet e tjera financiare nga organizmat tatimpagues, apo të çdo interesi tjetër.

Personat që kanë organizuar kryerjen e krimit, apo drejtuesit që mbështesin kryerjen e krimit, financierët, shefi i llogarisë, transportuesi, ngarkues-shkarkues të mallit objekt kontrabandë gjatë transportimit nga anija në një mjet tokësor apo e bashkëpunëtorëve të tjerë, përfshirë dhe personat e veprimeve këshillimore për realizimin e krimit, mbajnë përgjegjësi në varësitë të rolit (bashkekzekutor si bashkëpunëtorë, organizatorë, nxitës, frymëzues), përgjegjësi kjo që rrjedh nga Kodi Penal²⁴⁹.

²⁴⁷ Neni 7 i Kodit Penal.

²⁴⁸ Në çështjen “Shteti kundër të gjykuarit A. G.”, Kolegji Penal, me Vendimin nr. 99, datë 18.03.2008, ka vendosur: Prishjen e vendimit nr. 250, datë 11.06.2007 të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 570, datë 14.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me arsyetimin se: “Kolegji Penal çmon se në veprimet e të gjykuarit nuk gjenden elemente të veprave penale për të cilat ai akuzohet. Kështu, me prova të paraqitura gjatë gjykimit, është vërtetuar se i gjykuari A. G. nuk ka realizuar importimin e mallit, pasi në të dy rastet transportimi i mallrave nga Italia për në Shqipëri nuk është bërë nga i gjykuari A. G.” (Vendimi Nr. 99, datë 18.03.2008 i K.P.).

²⁴⁹ Marrëveshja, që është një nga elementet e domosdoshme për të pasur bashkëpunim në kryerjen e veprës penale, madje kryesorja, mund të vendoset jo vetëm midis organizatorit, ekzekutorit, shtytësit dhe ndihmësit, që përbën formën klasike të bashkëpunimit, por mund të vendoset edhe midis vetë ekzekutorëve

Gjithashtu, në vështrim të neneve 178-179 të Kodit Penal, si subjekt të krimit të kontrabandës do jenë personat që me veprimet e tyre nëpërmjet kalimit të mallrave, zhvendosjes në/dhe nga territori doganor, i janë shmangur kontrollit, mbikëqyrjes doganore, apo kanë blerë mallra kontrabandë, etj.

Në bazë të Ligjit nr.9754,datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”²⁵⁰ persona juridikëshqiptarë, madje edhe të huaj mund të jenë subjekt i përgjegjësisë penale për veprën e kontrabandës së kryer, në rastet kur nga organet përfaqësuese, në emër ose në dobi të tij, nga persona të autorizuar nga personi juridik, si dhe, kur në emër apo dobi të tij, për shkak të mungesës së kontrollit apo mbikëqyrjes nga personi që drejton, është kryer vepra penale e kontrabandës. Në legjislacioni tonë penal personi juridik, kryesisht shoqëritë regtare dhe OJF-të, njihen si subjekte pasive dhe aktive të veprës penale. Rrethi i personave fizikë për veprimet e të cilëve mban përgjegjësi penale personi juridik do të jenë personat që veprojnë në emër dhe për llogarinë, dobinë e personit juridik. Tashmë, përgjegjësia dhe ndëshkimi i personave juridikë përbën një fakt të padiskutueshëm, që shkon përtej skemave juridike tradicionale dhe rrënjët e tij i gjen në zgjidhje të caktuara politike kriminale²⁵¹. Pa rënë ndesh me parimin e fajësisë dhe përgjegjësisë personale, personat juridikë mund të thirren për t’u përgjigjur për aktivitetin e kundërligjshëm kontrabandë, evitimin e realizimit të të cilit e kanë pasur të pamundur apo të mbetur në tentativë, si dhe në kushtet kur nga kjo veprimtari kriminale përfiton drejtpërdrejtë personi juridik. Por gjithashtu "përgjegjësia penale e personave juridikë nuk përjashton përgjegjësinë e personave fizikë, të cilët kanë kryer ose janë bashkëpunëtorë në kryerjen e të njëjtave vepra penale²⁵².

të veprës penale (në rastet kur ata janë dy ose më shumë persona) dhe, në këtë rast, gjendemi para bashkëpunimit për të kryer veprën penale në formën e bashkëpunimit të saj. Kur vepra penale kryhet në bashkëpunim në formën e bashkëpunimit, midis bashkëpunëtorëve nuk ka ndarje rolesh, në kuptimin klasik të kësaj fjale (ndarje në rolet organizator, ekzekutor, shtytës dhe ndihmës), por ka një lloj ndarjeje tjetër, e cila ka të bëjë me ndarjen e punëve direkte që duhet të kryejë secili nga bashkëpunëtorët për realizimin e vullnetit të përbashkët kriminal, vullnet ky që, në fund të fundit, manifestohet në botën e jashtme, veç veprimeve të secilit, edhe me arritjen e rezultatit kriminal të dëshiruar prej tyre.

Në çështjen penale “Shteti Kundër të gjykuarve H.D. &...” Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë lidhur me personat e përfshirë në rrethin e subjekteve të kontrabandës ka theksuar se: “Pretendimi i të gjykuarit H. D. për mos ekzistencë të veprës penale në veprimet e tij, për shkak të mungesës së anës subjektive të figurës së veprës penale për të cilën është dënuar, nuk qëndron, pasi ky pretendim mbështetet në një analizë të ndryshme të provave nga ana e tij. Në rastin konkret, gjykatat kanë analizuar dhe çmuar konform ligjit provat dhe rrethanat e tjera të çështjes, duke arritur në përfundimin se i gjykuari ka konsumuar veprën penale të kontrabandës, në rolin e bashkëpunëtorit të të gjykuarit P. Z., i cili ishte iniciatori dhe ekzekutori kryesor i saj. (Vendimit Nr. 598, datë 5.11.2003).

²⁵⁰ Ligji nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”.

²⁵¹ Dr. Av. Ersi N. Bozheku; Prof. Dr. Ismet Elezi. “Përgjegjësia penale e personave juridikë”. Botim i “Toena”.

²⁵² “Konventa penale mbi korrupsionin”; shih dhe “Konventa e Brukselit”, datë 26.05.1995.

Ndërkohë që, sipas ligjit penal, përgjegjësia penale mund të bjerë mbi të gjithë personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore²⁵³. Në këtë kuptim dhe sipas ligjit “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” edhe ndaj personave juridikë të huaj²⁵⁴. Sipas studiuesve të fushës penale, përgjegjësia penale nuk mund të zbatohet mbi personat që përfshihen formalisht në konceptin persona juridikë, si dhe për ata persona juridikë që ushtrojnë veprimtari jofitimprurëse (fondacionet, ente fetare, organizata bamirësie). Gjithashtu, kjo përgjegjësi nuk mund të aplikohet ndaj personave juridikë me aktivitet tepër të vogël me struktura organizimi të vogla²⁵⁵.

Mendoj se edhe në shoqëritë tregtare, ShPK apo Aksionere me ortak/aksioner i vetëm nuk duhet të ngarkohet me përgjegjësi penale për kontrabandë, pasi në të kundërt do të binte ndesh me parimin *bis in idem*, duke u dënuar dy herë, si person fizik, autor i veprës penale dhe, për të njëjtin fakt, në lidhje me personin juridik, i cili ka në personin fizik të dënuar si autor i veprës penale ortakun e vetëm të personit juridik subjekt i shoqërisë.

Përveç subjektit të përgjithshëm në nenin 175 të Kodit Penal parashikohet edhe subjekti i posaçëm për shkak të cilësive si punonjës i doganës apo person që ka të bëjë me çështjet doganore (p.sh. inspektorët e Ministrisë së Financës, anëtarë të komisionit *ad hoc* nëpërcaktimin e të dhënave të disponueshmezyrtare të institucioneve të ndryshe që janë ngarkuar me veprimtari doganore, etj.).²⁵⁶

2.4.1. Subjekti i posaçëm.

Analiza e shumë çështjeve penale, të shqyrtuara nga gjyqtarët për një periudhë mbi 20 vjeçare, tregon se kontrabanda, sidomos në formën e trafikimit, e cila ka kapur përmasa të mëdha, apo me mallra të vendosura në një procedurë të veçantë, në pjesën dërrmuese

²⁵³ Neni 45 i Kodit Penal

²⁵⁴ Neni 2 /2 i ligjit nr. 9754, datë 14.06.2007, për përgjegjësinë penale personave juridikë.

²⁵⁵ Dr. Av. Ersi N. Bozheku; Prof. Dr. Ismet Elezi. “Përgjegjësia penale e personave juridikë”. Botim i “Toena”.

²⁵⁶ Në çështjen “Shteti kundër Mi & Ar. H.” Kolegjet e Bashkuara me vendimin nr.1, datë 26.03.2002, kanë arsyetuar se: “Punonjësit e doganës kanë vepruar në bashkëpunim me të gjykuarit e tjerë, duke qenë në rolin e bashkekzekutorëve në kryerjen e veprës penale të kontrabandës... bazuar në nenin 291 kryen në bashkëpunim veprën doganore të kontrabandës. Dhe, meqenëse, problemi tashmë shtrohet për përgjegjësinë penale jo të bashkëpunëtorëve në kuptimin klasik, por të bashkekzekutorëve të veprës penale, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u nisur nga parimet e përgjithshme të doktrinës së të drejtës penale, sipas të cilave, kur ndodhemi para figurave specifike të veprës penale (*delictum proprium*), në të cilat bashkekzekutimi është i mundur vetëm midis personave që janë mbajtës të disa cilësive të veçanta për të qenë subjekte të disa veprave penale (subjekte të posaçme), vepra penale e kryer prej tyre do të cilësohet sipas dispozitës së Pjesës së Posaçme të Kodi t Penal, subjekt i së cilës mund të jenë vetëm personat që janë mbajtës të këtyre cilësive të veçanta. E tillë është edhe figura e krimit të kontrabandës nga punonjës të doganave parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal”. (Vendimi nr.1, dt.26.03.2002, të K.B. të Gjykatës së Lartë).

të rasteve, nuk do të ishte kryer në qoftë se në to, nuk do të ishin përfshirë persona me funksione shtetërore që përfaqësojnë veprimtarinë doganore. Në kuptim të nenit 175, subjekti i posaçëm duhet të ketë dy cilësi:

- të jetë person me përgjegjësi shtetërore.
- duhet të ketë një pozicion të veçantë shtetëror, përdorimi i të cilit, në bazë të specifikës që ka, bën të mundur apo siguron në të vërtetë kalimin pa pengesa përmes kufirit doganor të mallrave, sendeve të çmuara e të objekteve të ndryshme, në shkelje të ligjit të vendosur për këtë qëllim.

Mbi bazën e kësaj, personi në detyrë, që kryen kontrabandë nëpërmjet shfrytëzimit të pozicionit në punë, në radhë të parë duhet konsideruar punonjësi shtetëror që në detyrat e tij funksionale përfshihen veprimet për realizimin e kontrolleve gjatë zhvendosjes së mallrave apo sendeve të tjera përmes kufirit doganor, d.m.th. persona me përgjegjësi shtetërore në organet doganore, specialistë të shërbimit shtetëror doganor për përpilimin e dokumentacionit doganor, që kanë funksione në Departamentin Operativ Hetimor. Përveç kësaj, persona përgjegjës konsiderohen edhe individë me funksione shtetërore, pra përfshihen absolutisht edhe nëpunësit që ushtrojnë kontrollenë pikat kontrolluese kufitare, p.sh. nëpunësit e krimit ekonomik apo në pikat e kontrollit kufitar, si dhe shefat apo nëpunësit e tyre eprorë, ashtu sikurse persona të tjerë, të cilët mbi bazën e pozicionit të tyre administrativ ushtrojnë kontrolle kufitare të përhershme apo periodike në kufirin doganor dhe shtetëror.

Në mbështetje të kësajshërben përmbajtja e nenit 175 të Kodit Penal, ku parashikohet kontrabanda e kryer nga doganierët, si dhe ligji “Mbi kufirin shtetëror, i cili ingarkonsi detyrë policisë kufitare, që, në pikat e kalimit kufitar, në mungesë të pikave doganore, apo dhe në to, të ndalojnë, kontrollojnë e zbulojnë kalimin e paligjshëm të mallrave apo sendeve të tjera, të armëve, municioneve, lëndëve narkotike, mjeteve valutore e sendeve të çmuara, etj. Në këto raste, personat me funksione shtetërore të forcave kufitare kryejnë funksionet e shërbimit doganor dhe, për rrjedhojë, mund të bëhen subjekte të kontrabandës sipas simptomës klasifikuese “*shfrytëzimi i detyrës nga persona me përgjegjësi administrative shtetërore*”, në qoftë se pozicioni i tij administrativ përdoret apo ndikon në kalimin, në kundërshtim me ligjin, të mallrave apo sendeve të tjera përmes kufirit doganor.

Së fundi, për ekzistencën e elementit kriminal të trajtuar më lart, nuk është e domosdoshme që personi në fjalë të ketë kaluar personalisht kufirin doganor. Mjafton fakti që ky person, nëpërmjet një marrëveshjeje paraprake me pjesëmarrësit e kontrabandës, ka kryer për shkak të detyrës, veprime të cilat kanë bërë të mundur zhvendosjen e mallrave përmes kufirit apo qëllimisht nuk ka marrë masat e duhura për evitimin e hyrjeve ose daljeve të mallrave, në kundërshtim me ligjin, apo ka pranuar të ë mashtrorë ligjin, duke falsifikuar dokumente doganore lidhur me mallrat që janë çliruar

nga kushtëzimi i vendosjes të tyre në një regjim doganor. Në këtë rast nuk kërkohet që në sasinë e objekteve që kalojnë kufirin, në kundërshtim me ligjin, apo që i shmangen kushtëzimeve që kanë të bëjnë me regjimin doganor të mallrave, të cilët i përkasin personit me cilësinë vakantit shtetëror që lidhen me veprimtarinë doganore. Veprimet e këtij të fundit klasifikohen sipas nenit 175 të Kodit Penal, pavarësisht se kush është pronar i mallrave apo sendeve të tjera kontrabandë.

Rrezikshmëria shoqërore e shkallës së lartë të kontrabandës e kryer nga persona me përgjegjësi administrative, duke shfrytëzuar pozicionin e tyre në punë, konsiston në faktin që keqpërdorimi i pozicionit të tyre administrativbën që këta persona të krijojnë kushte të përshtatshme për të mos kontrolluar kalimin e paligjshëm të mallrave dhe sendeve të tjera përmes kufirit doganor shtetëror, ose ndikojnë aktivisht në realizimin e këtij veprimi.

3. Konkurrimi.

Praktikës gjyqësore i është dashur të orientohet nga Kolegjet e Bashkuara lidhur me klasifikimin e veprës penale kontrabandë apo shpërdorim, të kryer nga zyrtari doganor apo çdo zyrtar tjetër qëka marrëdhënie të drejtpërdrejta me çështjet doganore²⁵⁷. Në të vërtetë, kontrabanda, edhe në rastet kur kryhet nëpërmjet shpërdorimit të detyrës nga punonjësi i doganës apo nga punonjësit e tjerë, që kanë të bëjnë me veprimtarinë doganore, nuk konkurren me veprën penale të shpërdorimit të detyrës parashikuar me nenet 248, 186 të Kodit Penal. Për rrjedhojë, cilësimi i veprës dhe kallëziminë organet e prokurorisë do të bëhet për veprën e kontrabandës dhe jo për krimin e shpërdorimit të detyrës²⁵⁸.

²⁵⁷ Në çështjen “Kafe do Brazil” Vendmi nr.1, datë 26.03.2002 i Kolegjeve të Bashkuara, gjykatat në të tre shkallët e gjyqimit kishin arritur në përfundimin se në rastet e favorizimit të kontrabandës nga punonjësit e doganës gjendeshim përpara veprës penale të shpërdorimit të detyrës dhe jo kontrabandës.

²⁵⁸ Në çështjen “Shteti kundër Mi & Ar.H.”, Kolegjet e Bashkuara me vendimin nr.1, datë 26.03.2002, lidhur me këtë çështje kanë arsyetuar, se: “Figura e krimit të kontrabandës me mallra në regjim të ndërmjetëm, parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal dhe ajo e kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 177 i këtij Kodi, nuk konkurrojnë as me njëra-tjetrën, as me figurat e tjera të krimit të kontrabandës që përfshihen në seksionin V të nenit III të Kodit Penal, në të cilin janë përfshirë krimet në fushën e doganave (nenet 171-179 të Kodit Penal). Së pari, nga fakti që, ashtu sikurse u përmend, objekti i të gjitha këtyre figurave, krimi është i njëjtë dhe, së dyti, nga fakti që vetë ligjvënësi, për arsye praktike, duke dashur të lehtësojë zbatimin sa më të drejtë të tyre në funksion të zhvillimit të një lufte sa më efektive në këtë fushë të kriminalitetit, e ka ndarë kontrabandën në disa figura krimi, të cilat, teorikisht dhe praktikisht, mund të përbënin paragrafë të veçantë të së njëjtës dispozitë të Pjesës së Posaçme të Kodi Penal. Figura e krimit nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, nuk konkurren as me figurën e krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i tij. “Kryerja e kontrabandës...” veprimtari kjo, e cila është dukshëm e qartë që është në kundërshtim me ligjin dhe me përmbushjen e rregullt të detyrës së një kategorie të caktuar

Në këto raste, organi i akuzës, por edhe gjyqtari, duhet të vlerësojnë me kujdes faktet, duke bërë dallimine veprës penale të shpërdorimit të detyrës, me veprën penale të kontrabandës të kryer në bashkëpunim, ku doganieri apo punonjësit që kanë të bëjnë me të, p.sh., agjenti doganor, inspektori i ministrisë, inspektori i krimit ekonomik, me veprimet e tyre që ngjajnë me atë të shpërdorimit të detyrës, kryejnë kontrabandë në bashkëpunim²⁵⁹.

Gjykata dhe organi i akuzës duhet të mbajë parasysh, se përfshirja në subjekt të posaçëm të krimit të kontrabandës të punonjësve që kryejnë veprimtari doganore sipas nenit 175 të Kodit Penal, nuk i liron apo shmang personat fizikë apo juridikë importues, eksportues të mallit apo mbajtës të një autorizimi për vendosjen e mallrave në një regjim doganor, në interes të cilit është kryer krimi, nga përgjegjësia në varësi të situatave të shkeljeve ligjore sipas neneve përkatëse të Kodit Penal dhe nga dënimi administrativ përkatës, parashikuar në nenin 281 të Kodit.

Mirëpo, rrethi i personave zyrtarë që mund të konsiderohen subjekte të posaçme nuk mund të jetë më i gjerë se ai që përcakton vetë ligji. Nisur nga sa më sipër, duhet thënë se veprimet e personave me përgjegjësi administrative në organet qendrore apo rajonale të pushtetit dhe të tatimit apo policisë, që në mënyrë të qëllimshme janë orientuar për kalimin e mallrave objekt kontrabande, si dhe nga kufiri doganor të treguar në nenet 171-179 të Kodit Penal dhe në nenet 276 - 280 të Kodit Doganor, madje në kundërshtim me të, nuk hyjnë apo nuk i përkasin simptomave klasifikuese të kontrabandës nga ku mund të përfshihen në subjekte të posaçme. Këto veprime duhet të klasifikohen, në tërësinë e tyre, si keqpërdorim i *kompetencave* gjatë kryerjes së detyrave shtetërore ose tejkalim të kompetencave, së fundi, pse jo edhe si shpërdorim detyre.

Çështjet e trajtuara më lart, lidhur me elementet e veprës penale të kontrabandës, na lejojnë të analizojmë disa nga kushtet e domosdoshme, gjatë të cilave personi mund të klasifikohet subjekt i krimeve të parashikuara në dispozitat e Kodit Penal.

Këto kushte janë:

- Prania e objektit, për të cilin kërkohen detyrime import/eksporti, apo që kanë përdorime të veçanta të ndaluara nga ligji.
- Detyrimi i personave për paraqitjen e detyrueshme në zyrën doganore kompetente (ose më të afërt), deklarimi i mallit para një organi doganor dhe kryerja e pagesave ose garantimi i tyre.

personash dhe konkretisht të punonjësve që lidhen me veprimtarinë doganore... Figura e krimit të kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore, parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, është një variant i figurës së përgjithshme të krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit, e cila realizohet në një fushë specifike të veprimtarisë shtetërore, sikurse është ajo e doganave dhe prandaj këto dy figura krimi nuk mund të konkurrojnë me njëra-tjetrën.

²⁵⁹ Mendojmë se kjo është një risi në Kodin Penal për kushtet e nivelit të lartë të korrupsionit në administratë, pasi në Kodin Penal apo Kodin Doganor të vendeve të tjera nuk gjejmë dispozita konkrete.

- Një krim i tillë, si shmangia e pagesave doganore, mund të realizohet apo kryhet vetëm me qëllim të drejtpërdrejtë. Fajtori dëshiron t'i shmanget pagesës doganore, nëatë masëkurveprimtaria shfaqet si kriminale. Ky opinion apo mendim pranohet në tërësi nëliteraturën juridike. Megjithatë, është e domosdoshme të nënvizohet se rregullat administrative dhe ato të detyrimeve doganore parashikojnë edhe formën e pakujdesisë së fajit gjatë kryerjes sëshkeljeve ligjore në fushën doganore.

Për klasifikimin e veprimtarive antiligjore nuk ka rëndësinëse personat fizikë apo juridikë janë përjashtuar në kundërshtim me ligjin nga pagimi i detyrimit të import/eksportit apo nuk i kanë paguar ato në afatet e vendosura me ligj, ose në rregullat e përcaktuara paraprakisht.

4. Rrezikshmëria shoqërore e krimit të kontrabandës.

Për kontrabandën, përveç simptomave të përgjithshme të cilat karakterizojnë elementët e krimit, në disa raste, të parashikuar me ligj, është e domosdoshme prania e natyrave dhe cilësive të veçanta, të cilat i japin këtij krimi rrezikshmëri shoqërore tepër të madhe, si rrjedhojë konsiderohen si komponentë klasifikues të tij.

Legjislatori, ndryshe nga legjislacioni penal dhe doganor i vendeve komunitare, madje në ndryshim edhe nga legjislacioni ynë i mëparshëm, nuk ka përcaktuar dispozita të veçanta lidhur me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale të kontrabandës. Në këtë këndvështrim, mendoj se klasifikimi i veprës penale sikontrabandë do të varej edhe nga fakti nëse realizohet:

- a) disa herë (ose me përsëritje si trafik kontrabandimi).
- b) me përdorim të forcës ndaj personave që kryejnë kontrollin doganor.
- c) nga grupe të organizuara.

Kontrabanda konsiderohet e kryer me përsëritje, kur zhvendosja apo kalimi i mallrave në kundërshtim me ligjin përmes kufirit doganor, është bërë në më shumë se një rast, pavarësisht nga fakti nëse personi është dënuar apo jo. Në këtë rast, ka rëndësi fakti që ky krim nuk duhet konsideruar i disahershëm (apo i përsëritur), në qoftë se përpara kryerjes së kontrabandës, personit që ishte dënuar më parë, i është hequr ky dënim, e ka kryer atë ose e ka vuajtur) apo personi është liruar nga përgjegjësia penale, në bazë të rregullave ligjore të vendosura.

- në lidhje me veprën penale të kontrabandës që kryhet duke ushtruar dhunë ndaj personave shtetërorë administrativë, të cilët marrin pjesë në kryerjen e kontrollit doganor, vlerësimi i drejtë juridik nga ana e organeve hetimore dhe atyre gjyqësore, të cilët bëjnë klasifikimin e kontrabandës, varet jo vetëm nga dëshmia se sa i saktë është paraqitur rrethi i personave me funksione shtetërore administrative të cilët marrin pjesë në kryerjen e kontrollit doganor, por edhe faktin se çfarë veprimesh të kryera me forcë

ndaj këtyre personave duhet të quajmë *dhunë ndaj tyre*. Treguesi i parë, i sipërpërmendur, duhet të përfshijë personat e poshtëshënuar:

- punonjësit e organeve doganore, zëvendësit e tyre dhe inspektorët doganorë, në detyrat funksionale të të cilëve është ushtrimi i inspektimit apo kontrollit të mallrave apo mjeteve të tjera, që kalojnë përmes kufirit doganor, si dhe zgjidhja e çështjeve që kanë të bëjnë me lejimin e kalimit, të ndalimit apo të bllokimit të tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi, ose personat me funksione shtetërore në organet e larta doganore, në qoftë se në momentin e përdorimit të forcës apo dhunës, ata plotësonin dokumentacionin shkresor doganor ose kryenin inspektimin apo kontrollin doganor

Nga ana tjetër, përdorimi i forcës ndaj ushtarakëve të efektivave të policisë kufitare, që realizojnë në bashkëveprim me autoritetet doganore kontrole doganore, duhet konsideruar gjithashtu si kontrabandë e klasifikuar që duhet të trajtohet ligjërisht në dispozita të veçanta të Kodit Doganor.

Jo më pak e rëndësishme për zgjidhjen e problemit të pranisë ose jo të simptomave të kontrabandës për rastin konkret, është interpretimi i drejtë i termit “*dhunë*” mbi personat që kryejnë kontrollin doganor, në momentin e kalimit, në kundërshtim me ligjin, të mallrave apo sendeve të tjera përmes kufirit doganor apo zonës doganore.

Me *dhunë* duhet të kuptojmë *përdorimin e presionit fizik* ndaj punonjësit doganor ose ndaj efektivit të policisë kufitare, të inspektorëve të luftës kundër krimit ekonomik, të cilët realizojnë apo kryejnë kontrollin doganor, sjellje kjo që shkakton veprime dhune apo forcë nga e cila, për një kohë të shkurtër, dëmtohet shëndeti, sikurse dhe shkaktimin e dëmtimeve trupore të rënda deri në vdekjen e tij.

Për më tepër ligji nuk duhet të kufizojë nocionin “përdorimi i dhunës ndaj personave që ushtrojnë kontrollin doganor” dhe, vetëm në rastet kur gjatë lëvizjes në kundërshtim me ligjin të mallrave dhe sendeve të tjera përmes kufirit doganor, përdoret *dhunë* ndaj personave që ushtrojnë kontrollin doganor, e shoqëruar kjo me shkaktimin në mënyrë të qëllimshme të dëmtimeve të rënda të shëndetit apo edhe të vdekjes së tij, *atëherë* përgjegjësia duhet të përcaktohet sipas tërësisë së normave të lartpërmendura.

Zhvendosja në kundërshtim me ligjin, të mallrave apo mjeteve të tjera, përmes kufirit doganor, e kryer nga grupe të organizuara, është element klasifikues që karakterizon subjektin nga ana objektive e këtij krimi. Sidoqoftë, rrezikshmëria e lartë shoqërore e kontrabandës në fjalë konsiston apo qëndron në faktin që përpjekjet e përbashkëta të disa personave, të bashkuar në një grup të organizuar, me synim kalimin në kundërshtim me ligjin të mallrave dhe vlerave të tjera përmes kufirit doganor, jo vetëm lehtëson zbatimin e një krimi të tillë, por edhe favorizon fshehjen e kujdesshme të gjurmëve të tij.

Duhet të kihet parasysh që niveli i madh ose i vogël i rrezikshmërisë shoqërore të çfarëdo grupi kriminal të organizuar, në këtë rast, të atij kontrabandist, në fund të fundit varet jo

shumë nga sasia e krimeve të planizuara dhe të kryera apo të realizuara, se sa nga kompleksiteti apo koklavitja e këtyre pengesave, të cilat domosdoshmërisht duhen kapërcyer, në rrugën për realizimin e qëllimit të vënë prej tij. Pikërisht ky kompleksitet vështirësish përcakton jo vetëm sasinë e anëtarëve të grupit, nivelin e kompaksimit të tyre, strukturën organizative, por edhe rolin e secilit pjesëmarrës në përgatitjen dhe realizimin e veprimeve kriminale, jetëgjatësinë e grupit. etj.

Bashkëpunimi në kuptimin e bashkekzekutorëve në kontrabandë, në kuptimin që i ka dhënë Gjykata e Lartë, të kryer nga grupe të organizuara, mund të ndodhë vetëm në rastet kur personi nuk është anëtar i një grupi dhe nuk merr pjesë direkt në kalimin, në kundërshtim me ligjin, të mallrave përmes kufirit doganor, por që ndihmon kontrabandistët, p.sh. nëpërmjet vendeve të fshehta të premtuara më parë dhe mallrave kontrabandë pas kryerjes së krimit (fshehja e tyre). Një konkluzioni i tillë buron nga përfundimi që ka arritur Kolegji i Bashkuar, ku theksohet që *personat të cilët kanë ndikuar* në kryerjen e kontrabandës, i nënshtrohen përgjegjësisë penale *për pjesëmarrje* në krimin në fjalë, në qoftë se veprimet e tyre bien apo përputhen qoftë edhe me një simptomë, elementë të treguar në ligj.

Legjislatori nuk ka parashikuar kryerjen e kontrabandës nga grupet kriminale. Prandaj, në shqyrtimin e kësaj situate gjatë hetimit paraprak ose të atij gjyqësor, deri në plotësimin e Kodit Doganor me dispozita të reja, veprimet e fajtorëve duhen klasifikuar sipas dispozitave të përgjithshme penale në kushtet e rrethanave të rënduara. Në legjislacionin italian, në rrethana kur ka bashkëpunim apo vepron një shoqatë kriminale me qëllim kontrabandimin për ata që nxisin, ndërtojnë, drejtojnë, organizojnë apo financojnë këtë organizatë apo bashkim, dënohen, secili për kryerjen e këtij krimi, me burgim nga tre deri në tetë vjet. Madje, ai që merr pjesë në shoqatë, me qëllime kontrabandimi, dënohet me burgim nga një vit deri në gjashtë vjet, dënimi rritet nëse numri i anëtarëve është dhjetë ose më shumë. Nëse organizata është e armatosur ose nëse ndodhemi përpara kushteve të parashikuara nga shkronjat *d* dhe *e* të paragrafit të dytë të nenit 291, aplikohet dënimi i burgimit nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet, në rastet e parashikuara në paragrafin e parë të këtij neni dhe 4-10 vjet në rastet e parashikuara në paragrafin e dytë. Në Kodin Doganor të vendeve të komunitetit, kjo vepër penale kontrabandë parashikohet në dispozitë më vete duke përcaktuar edhe dënime më të rënda.

KREU II

SANKSIONET NË VEPRAT PENALE TË KONTRABANDËS

1. Natyra dhe regjimi juridik i gjobës doganore
2. Baza e përlogaritjes së gjobës doganore
3. Dënime plotësuese
 - 3.1 Natyra e konfiskimit doganor
 - 3.2 Efektet e konfiskimit doganor

Në hetimin e çështjeve doganore, instituti i dënimit merr rëndësi të madhe teorike për faktin se dënimet në fushën e shkeljeve doganore nuk janë ende në shkallën që t'i përgjigjen rrezikshmërisë së veprës²⁶⁰. Ndërkohë që për zbatimin e masave shtrënguese,

²⁶⁰ Më shumë shiko Konventën “Për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komuniteteve Evropiane”. Në çështjen penale “Shteti kundër të gjykuarve V. L. e A. K.”, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë lidhur me mungesën e pasojës me vendimin Nr. 598, datë 5.11.2003, ka arsyetuar se: “Për sa i përket mungesës së pasojës së rëndë, të pretenduar nga të gjykuarit e mësipërm, si element i figurës së veprës penale për të cilën ata janë gjetur fajtorë, Kolegji Penal çmon se ai nuk qëndron, pavarësisht nga shprehja e përdorur nga ana e Gjykatës së Apelit në arsyetimin e vendimit të saj, lidhur me caktimin e dënimit për ta. Në kontekst të arsyetimit të përdorur nga ana e kësaj gjykate, ajo ka çmuar se në rastin konkret ishin para një pasoje jo të rëndë materiale, çka është pasur parasysh nga ajo si rrethanë në favor të të gjykuarve në caktimin e dënimit për ta. Në interpretim të dispozitës penale konkrete, nenit 248 të K. Penal, del se pasoja e rëndë është vërtet element i asaj figure vepre penale, por kjo pasojë konsiston në dëmtimin e interesave të ligjshme të shtetasve ose shtetit, interesa këto që nuk mund të lidhen vetëm me anën materiale. Në rastin konkret, përveç pasojës materiale, të gjykuarit, si punonjës shtetërorë, me veprimet e tyre kanë dëmtuar rëndë

ndryshe nga praktika gjyqësore për veprat e tjera penale, në fushën e hetimit dhe gjykimit të veprës penale të kontrabandës, vazhdon të mos ketë një praktikë gjyqësore të konsoliduar²⁶¹. Në Kodin Doganor dhe Kodin Penal për shkeljet doganore, legjislatori ka parashikuar dënime të natyrave të ndryshme, ku përfshihen:

- a) Dënim administrativ, pavarësisht nga ndjekja penale. Si dënim kryesor, i cili jepet nga autoriteti doganor, parashikohet gjobë nga 2-5-shin e detyrimit të shmangur (neni 281 i Kodit Doganor).²⁶²
- b) Si dënim kryesor parashikohet gjobë deri në kufirin maksimal, ose me burgim që varion nga 3-7 vjet²⁶³.
- c) Dënim ndaj personit sipas dispozitave të përgjithshme të Kodit Penal.
- d) Dënim administrativ, si heqja e licencës, e autorizimit për mallrat në një regjim²⁶⁴ doganor, apo për të importuar /eksportuar një mall për të cilin kërkohet autorizim.

Për disa nga veprat penale të kontrabandës, si në nenin 256 të Kodit Doganor, tentativa dënohet njëlloj, sikurse për kontrabandën e konsumuar si vepër penale. Këtë e hasim edhe në legjislacionin e vendeve komunitare. Kështu, neni 293 i Kodit Doganor Italian parashikon barazinë e krimit të tentuar dhe atij të konsumuar, duke theksuar se për

interesat e ligjshme të shtetit edhe në aspektin e mosfunksionimit normal të asaj veprimtarie shtetërore të realizuar nga ai autoritet doganor, pjesë e të cilit ata ishin. (Vendimin nr. 598, datë 5.11.2003).

²⁶¹ I. Elezi. “E Drejta Penale”, Pjesë e posaçme.

²⁶² Një dënim të tillë e gjejmë edhe në Legjislacionin e Francës në Dispozitat aktuale të nenit 377 bis të Kodit Doganor bëjnë në lidhje me këtë gjë, dallimin duke shprehur se “përveç penaliteteve fiskale, gjykatat duhet të urdhërojnë edhe pagimin e shumave të cilat janë përfituar nga vepra padrejtësisht”.

²⁶³ Në legjislacionin doganor të vendeve të BE-së për mallra të veçantë, si cigare apo mallra të rrezikshme për shëndetin, sigurinë publike...” dënohen me 10 vjet burgim dhe një gjobë sa pesëfishi i vlerës së përfituar. Në Kodin Doganor Francez, Ligji nr. 92 v. 2001 ka përmbledhur në Traktatin e Përbashkët Doganor të gjitha normat që i përkasin ndëshkimeve penale të kontrabandës, ku, për dënimet penale parashikohet: Art. 282, 283, 286 për kontrabandën në lëvizje të mallrave përtej kufijve tokësorë dhe hapësirave doganore, fshih mallra në anije me qëllim për t’i kaluar jashtë kontrollit doganor, kaluar nga/në zonat extradoganore, parashikohet ndëshkimi me gjobë jo më pak se dy dhe jo më shumë se dhjetë herë i detyrimit të kufirit. Art. 291 duke disiplinuar krimin në bashkëpunim, dënimi rritet nëse numri i bashkëpunëtorëve është 10 vetë ose më shumë. Nëse grupimi është i pajisur me armë, atëherë dënimi rritet nga 5 deri në 15 vjet.

²⁶⁴ Nga Gjykata Penale kundër personave që kanë marrë pjesë “si të interesuar në çfarëdolloj mënyre” në një delikt kontrabandë, import-eksport pa deklaram, formula e përdorur nga neni 432 i KD është kaq e gjerë dhe nuk përfshin këtu vetëm autorët dhe bashkëpunëtorët, por edhe njerëzit të cilët kanë një lloj interesi për mashtrimin e kryer. Ndalimi ka të bëjë me të drejtat për t’u prezantuar në Bursë, të ushtrohen funksionet e një agjenti kurtazhi ose agjent në bursë, të jesh i zgjedhur ose të zgjedhësh në dhomat e tregtisë, gjykatat e biznesit ose në gjykatat që merren me çështjet e punës. Përveç këtyre, sipas nenit 432 bis, gjyqtari mund të prononcojë edhe ndalimin për të ushtruar një aktivitet profesional kundër personave që dënohen për veprat e parashikuara në nenet 414 dhe 459 të KD, d.m.th. ndalimi për të ushtruar drejtpërdrejtë apo nëpërmjet personave të tjerë çdo profesion industrial, komercial apo të lirë. Plus këtyre, gjykata mund të prononcojë edhe pezullimin e patentës. Këto dy dënime mund të jepen për një periudhë nga 3 deri në 6 vjet, n.q.s. kemi përsëritje të veprës, ndryshe nga dënimet e dhëna nga neni 432 dhe 459 të cilat janë definitive.

tentativën në kontrabandë aplikohet i njëjti dënim me veprën penale, e cila është kryer apo konsumuar.

Siç mund të konstatojmë, çështjet gjyqësore doganore karakterizohen nga efikasiteti i dënimeve dhe frenimi për të mos përsëritur vepra të tjera. Edhe pse gjopa ngelet mënyra më e privilegjuar e të drejtës ndëshkuese doganore, po jo vetëm, kemi gjithashtu edhe burgimin dhe përdorimin e sanksioneve të tjera, të ashtuquajtura “reale”, si p.sh.: konfiskimi. Klasifikimi i sanksioneve doganore nuk ka të njëjtat kritere tradicionale me ato të përdorura në fushën penale të zakonshme, madje ka debate mbi natyrën e këtyre sanksioneve (n.q.s. është fiskale, penale, mikse, apo “*sui generis*”). Meqë marrëdhëniet e administratës doganore me akuzën dhe autoritetet gjyqësore vazhdojnë të mbeten shumë sipërfaqësore, kjo situatë ka sjellë kufizime dhe moskuptime nëndëshkimet ndaj kontrabandistëve, duke dobësuar luftën kundër krimit në fushën doganore.

1. Natyra dhe regjimi juridik i gjobës doganore.

Originaliteti i gjobës doganore qëndron tek fakti se shuma e saj (fikse ose proporcionale) mund të mos varet nga dëmi që i është shkaktuar rendit publik, por nga vlera reale e mallrave, të cilat kanë qenë objekt i kësaj vepre. Rregullat e ekzekutimit të saj, ashtu sikurse edhe regjimi, i japin gjobës një fizionomi atipike. Për jurisprudencën, gjopa doganore ka një karakter të dyfishtë: pra, atë të riparimit civil dhe të sanksionimit penal. Në këtë kuadër, ajo paraqitet me natyrë mikse, e cila shpreh njëherazi dënimin dhe riparimin civil. Duhet kuptuar se veprimi i ushtruar nga autoriteti doganor, për aplikimin e sanksioneve fiskale në bazë të nenit 281 të Kodit Doganor, nuk duhet të përfshihet në padinë civile, pasi gjopa doganore nuk asimilohet me një riparim civil. Dënimi me gjobë qëndron gjithnjë, edhe kur Thesarit Publik nuk i është shkaktuar asnjë dëm nga vepra doganore p.sh. kemi rastin kur mallrat, të cilat janë objekt i një deklarimi të rremë, nuk janë të taksueshme. Natyra origjinale e dyfishtë e gjobës doganore përkon me regjimin juridik, i cili buron si nga ideja e riparimit, ashtu edhe nga ideja e ndëshkimit.

Ndryshe nga çfarë ekziston në të drejtën penale të zakonshme, në të drejtën doganore çdo vepër sjell prononcimin e një gjobe të vetme, edhe kur kemi përfshirjen e shumë autorëve²⁶⁵. Por, kur një person ndiqet për shumë vepra doganore ose të një vepre doganore, por edhe të një vepre tjetër penale, p.sh. kontrabandim armësh apo mosdeklarim të të hollave që vërtetohet se vijnë nga krim tjetër. Në këto raste, gjobat do të aplikohen duke i bashkuar ato. Një tjetër veçori e gjobës doganore, në krahasim me

²⁶⁵ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim. Dt. 6 maj 1971, Bul krim. Nr. 139.

gjobën penale, kërkohet të jetë në lidhje me aplikimin e parimit “*të retroaktivitetit in mitius*”. Për këtë rast, jurisprudenca e huaj ka theksuar, se, cilado qofshin modifikimet që mund të bëhen në tarifën në lidhje me vlerën e mallit, duhet të merret parasysh ajo që ishte në fuqi ditën e kryerjes së veprës²⁶⁶.

2. Baza e përlllogaritjes së gjobës doganore.

Një veçori tjetër e të drejtës penale doganore është dhe mënyra e përlllogaritjes së gjobës doganore. Ndryshe ndodh në të drejtën e zakonshme, ku gjobat janë të fiksuara në Kodin Penal, gjoba doganore, si bazë e përlllogaritjes, nuk varet nga graviteti i veprës doganore, por duke marrë në konsideratë mallin që është objekt kontrabandë²⁶⁷, d.m.th. duke marrë parasysh shumën e taksave dhe detyrimeve që janë evituar, si dhe vlerën e mallit.

Mendojmë se parashikimi në Kodin Doganor në nenin 281 të Kodit Doganor, si dënime administrative për veprën penale kontrabandë, pavarësisht nga dënimi penal, nëpikëpamje formale të teknikës legjislative mund të bëhet edhe objekt ndryshimi, por nëpërmbajtjen e saj nuk gjendemi përpara dy dënimeve për një vepër të kryer.

Së pari, legjislatori në fushën penale ka parashikuar dispozita me dy dënime për një shkelje, edhe në raste të tjera, jo vetëm në fushën doganore (neni 298 i Kodit Penal).

Së dyti, legjislacioni ynë doganor është një ligj i përafuar me vendet e BE-së, ku dënimi me gjobë dhe dënimi me burg, për rastet e kontrabandës, jepen njëherazi për të njëjtën shkelje²⁶⁸.

Mbështetur në parimin e mirënjohur në teorinë e sëdrejtës, të dobishmërisë shoqërore, të individualizimit për një dënim të përshtatshëm, legjislatori ka pasur si qëllim që, ndaj personit fizik apo juridik të shpallur fajtor, të godasë me mjete efektive, duke ndëshkuar fizikisht me heqje të lirisë (burg), me pasoja jo vetëm për vetë personin, por edhe për kredibilitetin e shoqërisë tregtare. Ndërkohë që, duke u nisur nga karakteri dhe natyra e veprës penale të kontrabandës, e cila si pjesë të anës subjektive ka qëllimin e posaçëm të

²⁶⁶ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim. Dt. 12 nëntor 1986, Bul krim. Nr. 334.

²⁶⁷ Në legjislacionin doganor francez për deliktet doganore, neni 414 i KD, përcakton gjobën duke marrë parasysh vlerën reale të mallit, e cila dyfishohet duke marrë parasysh vlerën e mallit kur “kemi fakte kontrabandë, import ose eksport pa deklarambi mbi mallra të cilat janë shumë të tatueshme ose të ndalueshme”. Gjoba pesëfishohet kur kemi delikt në rrethana përkeqësuese, sipas pikës 2 të nenit 414 “kur faktet e kontrabandës, import ose eksport janë mbi mallra të rrezikshme për shëndetin, ose kur ato ushtrohen në banda të organizuara”. Përlllogaritjet sipas shumës që rezultojnë nga kontrabanda.

²⁶⁸ Në Kodin Doganor Francez, në Art. 414, përcaktohet se: “... Dënohet me burg prej 5 vjetësh dhe me gjobë sa trefishi i vlerës së mallit objekt shmangie, kur kontrabanda ka të bëjë me mallra me përdorim të dyfishtë, civile e ushtarake, për qarkullimin e të cilave janë parashikuar kufizime në bazë të ligjeve apo konventave. Dënohet me 10 vjet dhe një gjobe sa pesëfishi i vlerës së përfituar, kur mallrat objekt kontrabande janë të dëmshëm për shëndetin, moralin, sigurinë publike.

përfitim material, duke u shmangur nga pagesat e detyrimeve të import/eksportit dhe qëllimin e goditjes së konkurrencës, ka vendosur ndaj subjektit fajtor një ndëshkim ekonomik nëpërmjet gjobës, në shumën e shumëfishit të shmangur.

Duke pasur parasysh misionet e administratës doganore, i gjendur përpara shkeljeve financiare dhe veprimeve penale, ligjvënësi ka gjykuar ta ndajë kompetencën.

Për autoritetin doganor është parashikuar të dënojë administrativisht subjektin shkelës, për kontrabandë me gjobë, sa shumëfishi 2-5 herë detyrimeve të shmangur për shkeljen e kryer, që në pikëpamje të objektit e konsideron kontrabandë. Ndërsa për dënime penale gjykatës i jepet tagri të dënojë me gjobë ose burg, pra vetëm një dënim kryesor penal (burg ose gjobë dhe jo njëherazi të dyja), në këtë mënyrë gjendet zgjidhje edhe për rastet kur gjykata penale (apo gjatë hetimit të çështjes), nuk provon të gjithë elementët e veprës penale, duke u pushuar çështja dhe deklaruar i pafajshëm subjekti i kallëzuar për veprën penale kontrabandë, apo kur çështja penale pushohet për efekte ligjore si amnistia. *(P.sh. Në rastin kur mungon ana subjektive, dashja, megjithëse objektivist, pra ana objektive e veprës penale, provohet kontrabanda)*. Kështu subjekti shkelës është përgjegjës për shkeljen e kryer, duke u dënuar administrativisht (pavarësisht nga ndjekja penale), me një gjobë sa 2-5-shin e detyrimit të papaguar²⁶⁹.

Përveç dënimit penal të kontrabandistit, siç kemi parashtruar edhe më lart, zbatohet dënim edhe për personin juridik. Në legjislacionin e vendeve të BE-së, dënimi për kontrabandën është kompetencë e Gjykatës Penale dhe si dënim për të njëjtën veprë jepen dënimi me gjobë dhe dënim me burg²⁷⁰. Kështu, në Kodin Doganor Italian dhe atë Francez, kontrabanda në kushte të rënduara, përveç gjobës së zbatuar për kontrabandën e thjeshtë, i shtohet edhe dënim me burg²⁷¹.

²⁶⁹ Në çështjen civile "Shoqëria tregtare "A" shpk., kundër Drejtorisë së Përgjithshme të Doganës", Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë në Vendimit nr. 205, datë 07.01.2001, ka arsyetuar se: "Në nenin 62 të Kodit Doganor ndryshuar me dekretin nr. 1578, datë 13.08.1996, në pikën 4 parashikohet se: "Përbëjnë kundërvajtje gjetja e mallrave të padeklaruara ose mospërputhja e dokumenteve shoqëruese të mallit me gjendjen e tij faktike në sasi, cilësi dhe lloj, kur nuk përbën veprë penale". Ndërsa në pikën 10, që është shtuar me dekretin e mësipërm, parashikohet si kundërvajtje "gjetja e mallrave të paregjistruara në anije, në manifest ose në listën e përgjithshme të ngarkesës së anijes". Në këtë rast, mallrat nuk janë deklaruar, që të mund të regjistrohen në manifest dhe në polici ngarkesën e anijes dhe, për rrjedhojë, ky mall është transportuar në mënyrë të kundërligjshme nga porti i Koperit. Në këto rrethana, organet doganore, bazuar edhe në nenet 68 dhe 70 të Kodit Doganor, me të drejtë kanë sekuestruar mallin e palës paditëse. Pushimi i çështjes penale për kontrabandë, për shkak të amnistisë nuk mund të shmangë nga përgjegjësia civile palën paditëse për futjen e mallrave në territorin e Shqipërisë në mënyrë të kundërligjshme. Prandaj, edhe ky pretendim i tij, lidhur me këtë pikë është i pabazuar". (Vendimit nr. 205, datë 07.01.2001).

²⁷⁰ Në ligjin Nr. 1045, datë 1.1.1995, "Për të Drejtën penale financiare dhe të drejtën procedurale financiare", në versionin BGBI NR.1045/1994, në nenin 22 është përcaktuar "Nëse dikush ka kryer shkelje financiare dhe veprime penale me anë të një akti apo disa akteve të pavarura nga njëri-tjetri, dhe këto janë ndjekur njëkohësisht me gjyq, atëherë dënimi për shkelje financiare sipas nenit 21 duhet të vendoset krahas veprimeve të tjera penale".

²⁷¹ Më shumë "Codice Doganale" dhe "Code des douanes". Version 20120302.

3. Dënimi plotësues.

Legjislatori, përveç dënimeve kryesore, ka parashikuar edhe dënime plotësuese, të cilat shprehin politikën penale në rastet e krimeve në fushën doganore. Ndër dënimet plotësuese për veprat penale të kontrabandës të parashikuara në dispozitat e përgjithshme të Kodit Penal është konfiskimi i detyruar i mallrave objekt kontrabande. Konfiskim i mallit, i mjetit objekt i kontrabandës, nëvështrim të doktrinës dhenatyrës juridike, konsiston në një dënim të ndërmarrë nga administrata doganore ose gjykata për privimin apo kalimin nëpronësi të përhershme të pasurisë së përfshirë në kontrabandë. Në dënimet për shkeljet doganore konfiskimi i mallit konceptohet:

- Si dënim administrativ për mallrat e gjetura në sasi më tepër se ç'është deklaruar (neni 261 i Kodit Doganor).
- Si dënim penal për rastet kur subjekti deklarohet penalisht fajtor.

Në të dyja rastet e mësipërme, konfiskimi parashikohet si dënim plotësues dhe i detyrueshëm. Në raste të caktuara, gjykatat, ndryshe nga sa përcaktohet në Kodin Penal për veprën penale të kontrabandës, ku konfiskimi i mallrave objekt kontrabande është një masë e detyrueshme, duke mos kuptuar sa duhet ligjin, nuk e kanë aplikuar këtë dënim plotësues “Konfiskim të mallit”²⁷².

3.1 Natyra e konfiskimit doganor.

E drejta penale bën një ndarje ndërmjet konfiskimit të përgjithshëm, i cili mund të ndërmerret për gjithë pasurinë e autorit të veprës (çka ekziston në fushën e lëndëve narkotike dhe të krimit të organizuar) dhe konfiskimi special (i veçantë), i cili limitohet tek tërësia e krimit. Konfiskimi doganor merr nga të dyja nocionet, pasi ajo nuk shtrihet vetëm mbi objektet e veprës doganore, por gjithsesi as mbi komplet pasurinë e personit, veçse kur kemi të bëjmë me rastet për mashtrim nëorigjinën e mallrave. Nga doktrina, konfiskimi konsiderohet si një sanksion penal, si një masë sigurie dhe si një riparim për Thesarin Publik.

• Konfiskimi i objektit të veprës doganore.

Konfiskimi mund bëhet mbi mallrat objekt i veprës doganore, mbi mjetet e transportit apo mbi mallrat, të cilat kanë shërbyer për të fshehur veprën doganore. Jurisprudenca mban një konceptim të gjerë të nocionit “mallra”. Po ashtu jurisprudenca thekson se cilësohen si mallra “objektet të cilat janë të destinuara të shiten, cilado qoftë vlera e tyre reale”²⁷³ apo

²⁷² Më shumë shiko “Vendimin e Kolegjit Civil”, Nr. 56, datë 15.02.2006.

²⁷³ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim. dt. 24 qershor 1948.

“universaliteti i sendeve të cilat mund të marrin një vlerësim individual ose mund të trashëgohen, madje nuk ka rëndësi se cila është origjina e tyre, duke përfshirë këtu edhe mallrat e huaja, ashtu sikurse nuk ka rëndësi se për çfarë përdoren ato”²⁷⁴. Jurisprudence thekson gjithashtu se konfiskimi është i detyrueshëm, kur mallrat objekt i veprës janë të kategorisë së parashikuar në Kodin Doganor “Mallrat e rrezikshme për shëndetin, moralin dhe sigurinë publike, mallrat e falsifikuara dhe ato të cilat u nënshtrohen kufizimeve sasiore”. Mirëpo, konfiskimi është i mundshëm edhe kur mallrat nuk janë të ndaluara, në këtë rast shitja e tyre do garantojë pagimin e detyrimeve ndaj Thesarit Publik, si dhe një kompensim në të ardhurat e parealizuara për shkak të kontrabandimit të mallit të taksueshëm.

Konfiskimi doganor mund të prononcohet vetëm një herë për të njëjtin objekt të veprës doganore, kur kemi më shumë se një kualifikim të mbajtur për të njëjtat fakte²⁷⁵. Kur konfiskimi ushtrohet mbi mallin objekt vepre doganore kemi të bëjmë me një konfiskim real.

• Konfiskimi i mjeteve të transportit.

Përveç mallit objekt vepre doganore, konfiskimi mund të ushtrohet edhe mbi mjetet e transportit që kanë lehtësuar kryerjen e kësaj vepre doganore (ky konfiskim bëhet me qëllim që të kemi sa më shumë siguri për riparimin e dëmit të shkaktuar Thesarit Publik, si dhe për të goditur më me efikasitet kontrabandimin). Një rëndësi të veçantë duhet t’i kushtohet faktit, se ky rregull aplikohet mbi mjetet e transportit që i përkasin autorit të veprës, bashkëpunëtorit të tij ose njeriut që mund të kishte “interes” për veprën doganore, por edhe personave të cilët janë komplet jashtë veprës doganore dhe s’kanë as njohuri, as qëllim për t’u bashkuar apo për të përfituar nga kjo vepër doganore (si p.sh. kur kemi rastin e një mjeti që është dhënë me qira në mirëbesim).

Në mungesë të një përkufizimi legal, nocioni i “mjete transporti” është përkufizuar nga jurisprudenca, e cila është në favor të një konceptimi të gjerë. Për jurisprudencën nuk ka shumë rëndësi natyra e mjetit, sesa fakti që ka shërbyer si mjet për të transportuar mallrat objekt vepre doganore (mjete si anije, avion, kamion, autovetura, por edhe valixhe, çanta apo mjete të cilat shërbejnë për transportin publik²⁷⁶). Kur kemi shumë mjete transporti, konfiskohen të gjitha. Jurisprudenca shkon edhe më tej, duke kualifikuar si mjet transporti jo vetëm atë që ka shërbyer për të transportuar mallrat objekt vepre doganore, por edhe mjetin që mund të ketë shoqëruar mjetin e transportit të mallit^{277/278}.

²⁷⁴ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim. dt. 30 maj 1842.

²⁷⁵ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim. dt. 3 tetor 1997, Bul. Krim. Nr. 364.

²⁷⁶ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim. dt. 5 qershor 1950, në këtë shembull pati konfiskim të një vagon treni, ku njëri nga pasagjerët transportonte mallra kontrabandë. Vendim i cituar nga J-M Gonnard, në Jurisclasseur penal aneks: “Doganat, regjimi i dënimeve”, fashikull 30, 1997.

²⁷⁷ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim. dt. 25 tetor 1827 dhe Gjykata e Lartë, Sek. Krim. Dt. 18 qershor 1958, Bul. Krim. Nr. 472.

- **Konfiskimi i objekteve të cilat kanë shërbyer për të fshehur veprën penale.**

Konfiskimi i objekteve konsiston në atribuimin për Shtetin, mbas sekuestrimit nga administrata, të të mirave materiale, të cilat janë në pronësi ose jo të një autori të një vepre doganore, si dhe i kanë shërbyer këtij autori të kryejë veprën doganore.

Në përgjithësi, kemi të bëjmë me rastet kur mallrat e padeklaruara ose të ndaluara janë fshehur midis një ngarkese, si p.sh në mes të frutave dhe perimeve, shisheve të ujit. etj²⁷⁹. Duke marrë parasysh faktin se konfiskimi mbi gjithë ngarkesën mund t'i shkaktojë një dëm kolosal edhe personave që s'kanë asnjë rol në veprën doganore, nëlegjislacionin tonë, por edhe në vendet komunitare p.sh. në legjislacionin francez, është parashikuar një konfiskim në "ekuivalencë". Kjo praktikë administrative zbatohet nga autoriteti doganor dhe përbën vlerën reale të tregut të objekteve të cilët duhet të konfiskohen.

Sipas legjislacionit doganor francez Gjykata e Lartë kërkon që pronari i objektit që ka shërbyer për të fshehur mallin objekt vepre doganore, duhet të citohet për t'u paraqitur në gjykatë, pasi gjyqtari nuk mund të prononcojë një konfiskim, nëse pronari nuk ka shprehur argumentet e veta, sipas dispozitave të nenit 6 të KEDNJ²⁸⁰. Nëse rezulton se për mallin e padekluar objekt i kontrabandës,²⁸¹ përfshirë në aktin e kontrabandës, ose në rastet kur pronari zotëron mjetet e transportit në mirëbesim, si pasojë e procedurave të zakonshme të tregtisë, pa qenë në gjendje të dijë në mënyrë objektive se mjetet në fjalë ishin një mjet ose objekt i aktit të kontrabandës, apo të një akti apo krimi të ngjashëm, Gjykata, bazuar edhe në nenin 286 të Kodit Doganor e përjashton nga përgjegjësia personin, duke mos vendosur as për konfiskimin e mallit. Por nuk do të përjashtohet nga konfiskimi pronari, kur mjetet e transportit janë të përgatituraposaçërisht si depozita për karburant, që kanë vende të fshehta, të cilat nuk parashikohen në konstruksionin normal të mjetit të transportit.

Në rast se malli i sekuestruar ka të bëjë me mallra që prishen, apo për shkak të veçorive të tyre kërkojnë mirëmbajtje të veçantë, apo paraqesin rrezik për jetën e njerëzve, si dhe,

²⁷⁸ Një rast i veçantë ngelet për t'u përmendur, ai i parashikuar në nenin 434, pika 1 i Kodi Doganor Francez, ku thuhet se konfiskimi mund të bëhet vetëm për objektet e veprës dhe jo mbi mjetet e transportit apo mbi objektet, të cilat ndihmojnë në fshehjen e kontrabandës. Kemi të bëjmë me vepra të parashikuara në nenet 424-2 dhe 427-1 të Kodit Doganor Francez mbi objektet e ndaluara apo fortësisht të taksuara të gjendura në anije, të cilat ndodhen në "limit të porteve dhe në limanet komerciale" dhe të zbuluar përgjatë ankorimit të tyre.

²⁷⁹ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim. dt. 20 dhjetor 1957, vendim i cituar nga ZZ Berr dhe Tremeau, "E drejta Doganore", fq. 497, ed. 6.

²⁸⁰ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim. Dt. 29 nëntor 2000, Bul. Krim. Nr. 356

²⁸¹ Në Kodin Doganor të Francës, në nenin 412, konfiskohen mallrat në rastet e kontrabandës, si dhe çdo akt importimi/eksportimi i padekluar, i rremë që ka të bëjë me çfarëdolloj peshe të dërguesit real, që ka të bëjë me origjinën, mungesën e manifestit ose mosparaqitjen e origjinalit). Siç mund të shihet në Kodin Doganor Francez konfiskimi parashikohet edhe në rastet e kundërvajtjeve, madje në diapazone më të mëdha, ndryshe nga Kodi Doganor, ku parashikohet vetëm në nenin 261.

kur ekzistojnë prova të mjaftueshme për rastin, autoritetet gjyqësore kompetente marrin një vendim në lidhje me konfiskimin e tyre brenda 48 orëve nga çasti i marrjes së dosjes. Kjo bëhet në mënyrë që mallrat të mos zhvleftësohen apo të shmanget një rrezik evident. Kur kemi të bëjmë me mjete transporti, autoritetet gjyqësore, kur ka prova të mjaftueshme në lidhje me aktin e kontrabandës, mund të marrin vendim përse i përket konfiskimit të tyre brenda 5 ditësh.

Nëse, brenda afatit të 12 muajve, gjykata nuk është shprehur për fatin e mallit të sekuestruar, atëherë prezumohet sikur ky vendim është marrë dhe mallrat e sekuestruara konfiskohen. Autoritetet Doganore përjashtohen nga përgjegjësia materiale për dëmin që i shkaktohet, duke përjashtuar të drejtën e të dëmtuarit për të kërkuar dëmin e shkaktuar si rrjedhojë e sekuestrimit të mallit apo konfiskimit të tij gjatë kryerjes së veprës penale nga një tjetër²⁸². Kjo dispozitë mbështetet në të drejtën që ka Autoriteti Doganor për të vepruar "*In rem*" kur ekziston ana objektive, ndërkohë që nuk gjendet subjekti i veprës, apo kur mungon elementi subjektiv i kontrabandës, edhe pse objektivisht ndodhemi para kontrabandës. Në legjislacionin doganor dhe në zbatimin praktik instituti i konfiskimit është i përzier. Në varësi të gjendjes së mallit objekt i shkeljes, konfiskimi zbatohet me elementë të përzier të konfiskimit *in personam* dhe të konfiskimit *in rem*²⁸³.

Sa i përket aplikimit të dënimeve për kontrabandën, kanë lindur diskutime lidhur me:

- sistemin e dënimit.
- ashpërsinë e masës së dënimit²⁸⁴.

Në legjislacionin e vendeve të BE-së, konfiskimi i aseteve është parashikuar²⁸⁵ si një mundësi për administratën doganore për të kërkuar konfiskimin "e të mirave materiale

²⁸² Kodi Doganor, nenin 284.

²⁸³ Në legjislacione të ndryshme, në vend të mallra objekt sekuestrimi ekzekutiv apo të konfiskuara, mund të bëhet kompensimi në vlerë. Gjithashtu, kompensimi në vlerë mund të bëhet edhe për rastet e zbulimit të shkeljes doganore pas çlirimit apo konsumit të mallrave, që, nëse do të konstatoheshin në kohën e shkeljes doganore, do të përbënin objekt sekuestrimi apo konfiskimi, si dhe për rastet kur nuk ka siguri, nëse në çastin e marrjes së vendimit, malli gjendet për t'u sekuestruar apo konfiskuar. Ligji "Për të Drejtën Financiare", Versioni BGBI Nr. 1045/1994; Ligji nr. 2361, datë 16.11.1956, "Për Kodin Doganor", neni 95.

²⁸⁴ Ligji nr. 92, 19 mars 2001, "Ndryshimet në rregullat në lidhje me goditjen e kontrabandës së produkteve të duhanit" (Botuar në Gazeta Zyrtare Nr. 79, 4 prill 2001) Neni 1. (Ndryshimet e ligjeve të konsoliduar për doganat, të miratuara me Dekretin e Presidentit, janar 23, 1973, nr. 43, i ndryshuar); 1. Në ligjet e konsoliduar për doganat, të miratuara nga Dekretin e Presidentit Janar 23, 1973, n. 43, të ndryshuar, do të ndryshohet si vijon: a) "Neni 291-bis (Kontrabanda e duhanit të huaj) 1. Kushdo që prezanton, shet, transporton, blen ose mban brenda shtetit një sasi kontrabandë duhani jashtë vendit më shumë se dhjetë kilogramë është e dënueshme me gjobë dhjetë mijë paund për çdo herë të produkteve konvencionale, siç përcaktohet në nenin 9 të Ligjit 7, mars 1985, n.76, dhe me burgim nga dy deri në pesë vjet.

²⁸⁵ Në nenet 414 dhe 415 të Kodi Doganor Franceze.

dhe aseteve që janë produkte direkte apo indirekte të veprës doganore”, duke zgjeruar në këtë mënyrë fushën e ushtrimit të konfiskimit.

3.2.Efektet e konfiskimit doganor.

Malli për të cilin është prononcuar një konfiskim, i përket Shtetit ndryshe nga ligji doganor francez, ku përcaktohet se administrata doganore ushtron të gjitha të drejtat e pronësisë, kur vendimi merr formë të prerë ose pas ratifikimit të dhënë nëpërmjet transaksionit²⁸⁶.Mendoj se një zgjidhje e tillë duhet të parashikohet edhe nëlegjislacionin tonë doganor,çka do të thjeshtëzontejo vetëm procedurat e administrimit të këtyre mjeteve, por do të ndikonte edhe në fuqizimin e logjistikës së organeve të luftës kundër kontrabandës.

Pjesa e Tretë

ASPEKTE KRAHASUESE TË PROCEDIMIT TË VEPRAVE PENALE TË KONTRABANDËS

KREU I

Procedimi nga autoriteti doganor dhe prokurorialidhur me veprat penale të kontrabandës

- 1. Kërkim, zbulimi dhe konstatimi i veprës penale në fushën doganore**
 - 1.1 Kompetencat**
 - 2. Kontrolli për konstatimin e shkeljes doganore**
 - 2.1 Kontrolli i mallrave të deklaruarra për zhdoganim dhe pas zhdoganimit**
 - 2.1.1 Objekti i kontrollit të përgjithshëm**
 - 2.1.2 Kontrolli i mjeteve të transportit**
 - 3. Sekuestrimi i mallrave në procesin e kontrollit dhe hetimit të çështjevedoganore**
 - 4. Kompetencat e autoritetit doganor për hetimin nëambiente private**
 - 5. Kontrolli i personave**
 - 5.1 Kufizimet e specifikuarra nga jurisprudenca**
 - 5.2 Masat e sigurisë ndaj personave**
 - 5.2.1 E drejta e ndalimit dhe arrestit**
 - 5.2.2 Masat e tjera doganore të privimit të lirisë**
 - 6. Procesverbali i akteve të hetimit dhe i veprave penale doganore**
 - 6.1 Llojet e ndryshme të procesverbaleve doganore**
 - 6.1.1 Procesverbali i konstatimit**

²⁸⁶ Neni 390 i Kodi Doganor Franceze jep kushtet e transferimit të pronësisë dhe udhëzimi dt. 26 shtator 1949, i ndryshuar, parashikon se si mund ta përdorë administrata këtë objekt që tashmë i ka kaluar në pronësi; ose t’ia shesë ndonjë administrate tjetër ose ndonjë individ ose të procedojë me shitjen e tij në ankand.

- 7. Vlerësimi mbi respektin e kontradiktoritetit në gjetjen e provave doganore**
 - 8. Vlerësimi mbi rregullsinë e akteve të procedurës doganore**
 - 9. Ushtrimi i procedimit penal në të drejtën penale doganore**
 - 9.1 Oficerët e policisë gjyqësore**
 - 9.1.1 Kushtet e ushtrimit të misionit të policisë gjyqësore nga punonjësit doganorë**
 - 9.1.2 Kompetencat e deleguara**
 - 9.2 Ushtrimi i procedimit në të drejtën penale doganore**
 - 9.2.1 Kushtet e ushtrimit të ndjekjes penale në të drejtën penale doganore**
 - 9.3 Palët e procedimit penal në të drejtën penale doganore**
 - 9.4 Koekzistenca dhe pavarësia e ndjekjeve fiskale dhe penale**
 - 9.5 Transaksioni doganor**
 - 9.5.1 Zgjidhje administrative e kontrabandës**
 - 9.6 Ushtrimi i rekurseve në të drejtën penale doganore**
 - 9.7 Pengesat për ushtrimin e ndjekjes (penale / fiskale) në të drejtën penale doganore**
 - 9.7.1 Parashtrimi i ndjekjes së ushtruar për ndëshkimin e veprave doganore**
- 1. Kërkimi/Zbulimi dhe konstatimi i veprës penale në fushën doganore.**

Ligji doganor në fuqi²⁸⁷, është një ligj i përafuar me ligjin doganor komunitar,ndërkohë qëKodi Doganor i Republikës së Shqipërisë (*Ligj nr. 102/2014, datë 31.7.2014*)²⁸⁸ është njëhsuar tërësisht me atë komunitar ²⁸⁹. Meqenëse e drejta evropiane ka kontribuar gjithashtu për të evoluar anën hetimore dhe atë gjyqësore në çështjet penale, po ashtu paralelisht atë të çështjeve penale doganore dhe të procedurës hetimore për veprat penale të fushës doganore,do na duhet të ndalemi në disa aspekte krahasuese të procedimit penal të krimeve doganore.

Domosdoshmëria për trajtimine problemeve të procedimit penal të veprave penale të kontrabandës ka lindur edhe për faktin se jurisprudenca jonë, në fushën doganore, i ka kushtuar fare pak kujdes kësaj çështjeje, duke u mjaftuar kryesisht me dërgimin (përfshirjen) në procedurën penale të përgjithshme. Ndërkohë që vetë organizimi dhe ndjekja e çështjeve doganore nëtërësi dhe ato që kanë të bëjmë me krimet në fushën doganore, si rezultat i një tradite që në fillesat e lindjes së të drejtës doganore, por edhe vetë historia e kësaj administrate të fuqishme, ka shpjeguar edhe një sërë veçorish, si në procedurë, ashtu dhe tek rregullat në themel. Si p.sh.bashkëngjitja e çështjeve doganore

²⁸⁷ Kodi doganor dhe VKM nr. 205, datë 13.04.2000, “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor...”.

²⁸⁸Ligj nr. 102/2014, datë 31.07.2014 “ Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” injesuar me Direktivën e BE 952/2013, datë 9 Tetor 2013 “Kodi Doganor i Unionit”.

²⁸⁹Regulation (EU) No 952/2013 of the European Parliament and of the Council of 9 October 2013 laying down the **Union Customs Code**.

me të drejtën administrative, preferencën e saj për të drejtën penale doganore, mundësitë dhe, shpesh, detyrimi që i ngarkohet administratës për të vepruar përpara organit të akuzës dhe gjykatave. Më shumë shiko nenet 281-293, të Kodit Doganor. etj. Si rregullat në themel, ashtu dhe ato të procedurës në ndjekjen e veprave penale të fushës doganore, paraqesin një kompleksitet të spikatur. *“I gjithë arsenalit ligjor i fushës doganore dallohet për karakterin e fortë ndëshkues, duke qëndruar larg evoluimeve që kanë njohur degët e tjera të drejtësisë, edhe pse normalizimi i tij po bëhet gjithnjë e shumë i dukshëm”*²⁹⁰.

Procedura e saj, jo vetëm pas viteve 1992, por edhe pas vitit 1999, ka njohur ndryshime që e kanë shtyrë drejt procedurës së të drejtës penale të zakonshme, por në disa raste kjo shtysë e përgjithshme është bërë shkak diskutimesh, madje edhe mosaprovimesh. Diçka e tillë po haset si në kompetencat e kërkimit dhe konstatimit të shkeljeve doganore, qëshqyrtohen në dispozitat e Kodit Doganor nenet 8/11/4²⁹¹, por edhe nga synimet e ligjvënësit për t'i dhënë shërbimit doganor^{292/293} kompetenca të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale²⁹⁴. Përkundrejt këtij realiteti të legjislacionit tonë doganor, i cili synon të përfarohet gjithnjë e më shumë me legjislacionin e vendeve komunitare, si Italia, Franca, siç trajtohen në këtë punim, na duket i pakuptimtë vazhdimi i përfshirjes së veprave penale të fushës doganore në të drejtën penale dhe jo në të drejtën penale doganore si pjesë e së drejtës doganore.

1.1 Kompetencat.

Vlen të theksojmë se punonjësve doganorë historikisht u janë njohur kompetenca të veçanta dhe shumë të gjëra për të kërkuar dhe konstatuar veprën penale të fushës

²⁹⁰ BERR C.-J., «Introduction au droit douanier», Economica, botimi i fundit 2008.

²⁹¹ Për të siguruar respektimin e dispozitave të përcaktuara nga ky Kod dhe nga akte të tjera ligjore dhe nënligjore, zbatimi i të cilave u është ngarkuar autoriteteve doganore, punonjësit e doganave ushtrojnë kontroll mbi të gjitha mallrat, mbi mjetet e transportit dhe udhëtarët që kalojnë vijën doganore në zonat doganore e përgjatë vijës kufitare tokësore e ujore, në ujërat e brendshme dhe në hapësirën ajrore, që janë nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore. Me qëllim që të rritet efikasiteti i kontrolleve, autoritetet doganore mund të lidhin edhe marrëveshje për shkëmbim informacioni me organizma publikë ose privatë, shqiptare ose të huaja të këtij sektori.

²⁹² Neni 9, në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave krijohet organi i luftës kundër kontrabandës dhe trafikut të paligjshëm, i cili kryen funksionet e policisë gjyqësore. Detyrat dhe të drejtat e personelit që kryen funksionet e policisë gjyqësore janë të përcaktuara me ligj.

²⁹³ Më shumë shiko: Neni 16 i Kodit Doganor. Urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm nr.7, datë 01.09.1995, Udhëzimin e përbashkët të Prokurorisë të Përgjithshme dhe të Ministrisë së Brendshme, kompetenca të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

²⁹⁴ GASSIN R., «Études du droit pénal douanier», Annales de la Faculté de droit et sciences économiques d'Aix-en-Provence, PUF, 1968.

- RIDEAU-VALENTINI S., « Contribution à l'étude des particularismes de la matière pénale douanière », thèse 1999.

doganore. Në nenet 8/13-14dhe, në veçanti, nënenet 282-288 të Kodit Doganor, përcaktohen kompetencat dhe procedurat e autoritetit doganor për shkeljet doganore. Në bazë të këtyre dispozitave ligjore, si rregull, konstatimi, hetimi, verifikimi i shkeljes doganore kundërvajtje kryhet nga inspektorët e antikontabandës²⁹⁵ ose, sipas rastit, nga doganierët në degën e doganës, ndërsa vendimmarrja për dënimet administrative në të gjitha rastet është kompetencë e Degës së Doganës. Për rastet e shkeljeve doganore kontrabandë, verifikimi kryhet nëpërmjet organeve të specializuara doganore²⁹⁶, të cilat kryejnë veprimet e para hetimore (sipas neneve 30, 31, 32, etj. të K.Pr.P.), të cilët në bazë të nenit 9/4 dhe 16/1 të Kodit Doganor kanë edhe funksionet e policisë gjyqësore. Mirëpo, kur kallëzimi në organet e prokurorisë për një vepër penale bëhet nga organe të tjera, si organet e policisë kufitare, organet e krimit ekonomik apo persona të tjerë të parashikuara në ligj, procedimi penal bëhet kryesisht dhe drejtpërdrejtë nga Prokuroria²⁹⁷. Në varësi të klasifikimit të veprës, si dhe kur ka arsye bindëse që tregojnë se gjendemi para veprës penale të kontrabandës, është e kuptueshme që çështja regjistrohet dhe ndiqet nga organi i akuzës, si organi që ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën, në bazë të Kushtetutës dhe ligjit²⁹⁸.

Sipas studiuesve të së drejtës Penale Doganore Franceze “*Presionet e shumta të ardhura nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese që rrjedh prej saj, ka kontribuar për të përafruar procedurën doganore të krimeve doganore me procedurën e të drejtës penale të zakonshme*”²⁹⁹.

Është fakt se e drejta doganore u atribuon punonjësve doganorë kompetenca të mëdha në fushën hetimore, ndërsa, nga ana tjetër, reformat në procedurën penale kanë ndikuar edhe në procedurën doganore. Ashpërsia e rregullave haset si në fazën e ndërtimit të provave, ashtu edhe në atë të ruajtjes së tyre. Këto partikularizma janë prezente në Kodin Doganor, i cili përmban kompetencat tradicionale të punonjësve të doganës, duke parashikuar modalitetet e kontrollit mbi mallrat, mjetet e transportit, personat, por edhe vendet ku mund të fshihen mallrat kontrabandë.

²⁹⁵ Drejtoria e Antikontabandës në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

²⁹⁶ Drejtoria e Hetimit në Departamentin Operativ Hetimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

²⁹⁷ Mendojmë se organet e lartpërmendura, kur konstatojnë një shkelje doganore, si në rastet kur/dhe prokuroria është vënë në dijeni për një shkelje doganore që mendohet se është kontrabandë dhe plotëson kushtet e nenit 291 të Kodit Doganor, çështja fillimisht mund të kalojë për shqyrtim autoritetit doganor për të proceduar në përputhje me nenin 291 të Kodit Doganor. Në këtë mënyrë, do të shmangeshin praktikat e gabuara, në rastet e kallëzimit të çështjeve që kanë të bëjnë me shkelje administrative, ndërsa për vepra kontrabandë që plotësojnë kushtet e nenit 291 të Kodit Doganor do të zgjidheshin më shpejt në mënyrë racionale në rrugë administrative, pa qenë nevoja e angazhimit të organit të akuzës.

²⁹⁸ Më shumë shiko neni 148/1 i Kushtetutës, nenet 24/1, 277 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale.

²⁹⁹ BERR C.-J., TREMEAU H., «Le droit douanier communautaire et national», Economica, Botimi i fundit, edicioni 6.

Është e padiskutueshme që ligjvënësi ka dashur ta bëjë sa më gjyqësore procedurën doganore³⁰⁰. Përafrimi i çështjeve penale doganore me parimet e të drejtës penale të zakonshme është i pamohueshëm, po të njëjtën gjë mund të themi edhe për përkufizimin e disa të drejtave që shprehen:

-Me mbrojtjen e vendbanimit, duke parashikuar të drejtën e vizitës/kontrollit në vendbanim sipas përcaktimeve që ofron Kodi i Procedurës Penale.

- Me të drejtën të “arrestojnë dhe të ndalojnë”³⁰¹ personin që pretendohet se ka kryer një shkelje doganore kontrabandë, si dhe procedimin sipas parashikimit të dispozitave ligjore të procedurës penale të zakonshme.

Përsecilën nga këto kompetenca kemi nivele të ndryshme të përfshirjes dhe të kontrollit nga ana e autoriteteve të policisë gjyqësore. Ligjvënësi ka dashur t’u japë një formë sa më gjyqësore kompetencave kryesore për kërkim/zbulim dhe konstatim të veprës doganore. Nga ky këndvështrim, duhet të kuptohen dhe interpretohen edhe përdorimi i shpeshtë nga ana e ligjvënësit i termit “*autoritetet gjyqësore*”, në dispozitat e Kodit Doganor, duke nënkuptuar prokurorinë, si një organ “pranë sistemit gjyqësor”³⁰², por që kurrsesi nuk bën pjesë në pushtetin gjyqësor natyreshëm dhe lidhje vartësie nga pushteti ekzekutiv³⁰³. Në çdo rast, edhe për veprën penale të kontrabandës, veprimtaria e autoritetit doganor kryhet nëpërputhje me zbatimin e nenit 148/1 të Kushtetutës, që i njeh Prokurorisë kryesisht ushtrimin e ndjekjes penale dhe nenin 24/1 të K.Pr.Penale.

• **Bashkëpunimi i ndërsjellë**

Aktiviteti doganor, në drejtim të procedimit për veprat penale të fushës doganore, kërkon të dallohet veçanërisht nëpërmjet një bashkëpunimi të anasjelltë me organin e akuzës dhe gjyqësorin, që, fillimisht, shprehet me shkëmbimin e informacioneve në mënyrë që drejtësia të funksionojë si duhet. Kështu, autoritetet doganore kanë detyrim ligjor të bashkëpunojnë me Prokurorinë.

Lidhur me këtë, ligjvënësi nëpërmjet dispozitave të drejtpërdrejta të K.Pr.Penale dhe të Kodit Doganor³⁰⁴ ... përcaktohen detyrime për autoritetin doganor, që do të thotë ta njoftojnë dhe t’i kallëzojnë me shkrim organit të Prokurorisë për krimet dhe kundërvajtjet

³⁰⁰ Shiko nenet 245; 282/5; 285/1; 286/6; 288; 289; 292-294 të Kodit Doganor.

³⁰¹ Neni 293 i Kodit Doganor; nenet 251, 253 të K. Pr. Penale.

³⁰² Neni 148/2 i Kushtetutës.

³⁰³ E gjej me vend të theksoj se ky përdorim i termit “autoritet gjyqësor” në vend të “organit të akuzës”, prokurorisë, përbën një pasaktësi, e cila mund të keqinterpretohet, ndaj mendoj se duhet të korrigjohet duke përcaktuar saktë organin e procedurës, të cilit i drejtohet autoriteti doganor në rastet e procedimit për veprat penale të kontrabandës.

³⁰⁴ Nenet 181, 293 të K. Pr. Penale dhe në Kodin Doganor në nenin 288.

penale doganore, për të cilat ata janë në dijeni³⁰⁵. Ndërkohë, në ushtrimin e funksioneve të tyre të kërkimit dhe zbulimit të veprës penale, punonjësit e doganës mund të vihen në dijeni nga struktura të luftës kundër krimit në fushën doganore për vepra penale të zakonshme (krime apo kundërvajtje penale, por që ata nuk janë apo nuk kanë qenë në gjendje t'i konstatojnë³⁰⁶). Përveç kësaj, autoriteti doganor, në bazë të nenit 290 të Kodit Doganor³⁰⁷ vihet në dijeni për ekzistencën e këtyre krimeve edhe nga denoncime qëiu përçohen nga persona të ndryshëm. Në këto rrethana, ata kanë për detyrë të informojnë prokurorinë dhe, në bazë të nenit 283 të K.Pr.Penale³⁰⁸, bëhet fjalë për një informim të thjeshtë me anën e akteve, procesverbaleve, të cilat nuk i nënshtrohen asnjë lloj detyrimi formal³⁰⁹.

Në rastet kur gjendemi në të njëjtën kohë para një vepre penale të zakonshme dhe një vepre penale doganore, autoriteti doganor mund të bashkëngjijtë veprimin e saj me atë të Prokurorisë. Ndërkohë që, në bazë të ligjit për policinë gjyqësore^{310/311} e lejon gjithashtu Prokurorinë që të vejë nëlëvizje organet e hetimit doganor³¹² për hetim paraprak, duke u bazuar në nenin 24/1 të Kodit të Procedurës Penale, në qoftë se faktet janë të mjaftueshme për një hetim të tillë. Veç detyrimit për bashkëpunim reciprok, mund t'i shtojmë edhe detyrimin që kanë punonjësit e doganës, si çdo nëpunës i shtetit, për të bashkëpunuar me autoritetet e akuzës, megjithëse në këtë rast merr një dimension të veçantë, më saktë si një detyrim i zyrtarit të administratës publike për të kallëzuar një vepër penale. Një detyrim të kësaj natyre e tillë e gjejmë të parashikuar edhe në Legjislacionin e Francës, ku në Kodin e Procedurës Penale parashikohen mundësi, që, çdo qytetar që ka kapur në

³⁰⁵ Kur shkelja doganore përbën kontrabandë, kallëzimi penal, bashkë me dosjen përkatëse, të përmendur në nenin 287(1), i transferohet autoriteteve gjyqësore, kompetente për procedimin penal, brenda 24 orëve nga çasti i verifikimit të shkeljes.

³⁰⁶ Në titullin e dytë do trajtohen punonjësit, të cilët janë të autorizuar që të konstatojnë edhe vepra penale të zakonshme.

³⁰⁷ Kur shkelja doganore përbën kontrabandë, autoritetet doganore, pasi të kenë filluar procedurat e përmendura në nenin 289 për vjeljen e detyrimeve doganore, që duhen paguar për mallrat objekt kontrabandë dhe të gjobave përkatëse, i transferojnë autoriteteve gjyqësore kompetente, brenda 48 orësh nga çasti i verifikimit, të gjithë dosjen sipas nenit 287(1). Në raportin e dërguar këtyre autoriteteve, autoritetet doganore tregojnë edhe shumën e gjobës që është zbatuar për rastin konkret, të përcaktuar sipas nenit 287(2).

³⁰⁸ Neni 283 i K.Pr.Penale kallëzimin në rastet e kryera nga shtetasi e konsideron jo vetëm si një akt të ndërgjegjshëm, por edhe të detyrueshëm në rastet e përcaktuara me ligj, kështu raste të kësaj natyre mund të parashikohen në Kodin Doganor për agjentin doganor dhe persona të tjetër që punojnë në administratën ndihmëse doganore, si magazinierët, rojet privatë, etj.

³⁰⁹ Informacioni i dhënë, i cili prezumon ekzistencën e një vepre penale nuk i nënshtrohet asnjë kushti apo forme - Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 28 janar 1992, Gazette du Palais, 1992, 1, 365.

³¹⁰ Neni 13 dhe neni 16 i Kodit Doganor.

³¹¹ Neni 16. Policia gjyqësore sipas nenit 9(4) të këtij Kodi gëzon statusin e ushtarakut. Ajo vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi.

³¹² Drejtorinë e Hetimit pranë Departamentit Operativo-Hetimor në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave.

flagrancë autorin e një krimi, përfshirë edhe ato në fushën doganore, të sanksionueshëm me burgim, duhet ta çojë atëpërpara një oficeri të policisë gjyqësore. Ky procedim gjen përdorim të gjerë nga administrata e doganës edhe në zbatim të Konventës së Schengen³¹³.

Sipas këtyre dispozitave, punonjësit e doganës mund të gjenden para dy hipotezave:

- së pari, në qoftë se vepra është flagrante, ata sipas nenit 73 të Kodit të Procedurës mund ta mbajnë personin, në mënyre që ta drejtojnë te një oficer i policisë gjyqësore, ose,
- së dyti, në qoftë se vepra nuk është flagrante, ata mund të aplikojnë dispozitat e nenit 40 të K.Pr.Penale dhe të informojnë organin e akuzës kompetent, i cili vendos se çfarë drejtimi do i japë çështjes më tej.

Në këtë këndvështrim, mendoj se në ligjin doganor duhet të parashikohen dispozita më të plota lidhur me detyrimin e organeve doganore, të prokurorisë dhe gjykatës për bashkëpunim, në veçanti për detyrimin e autoritetit të akuzës dhe gjyqësorit për t'i transmetuar autoritetit doganor të gjithë informacionin, në interes për aktivitetin e saj kundër krimit në fushën doganore. Madje, edhe kur kemi të bëjmë me një procedim civil apo administrativ, qoftë thjesht me një hetim i cili mund të jetë mbyllur pa vazhdim gjykimi, akuza dhe autoriteti gjyqësor duhet të bëjë me dije shërbimet e doganës për çdo indikacion, që ajo mund të mbledhë, të natyrës që prezumon një shkelje të kryer në fushën doganore apo një manovër të çfarëdollojshme që ka pasur si objekt apo rezultat për të shkelur dispozitat e Kodit Doganor. Po ashtu, në stadin e hetimit, kur kemi të bëjmë me një vepër penale të zakonshme, në bazë të konstatimeve të bëra nga një organ hetimor i fushës fiskale, akuza dhe gjyqësori mund t'ia komunikojnë informacionet autoritetit doganor për hapjen e një procedure doganore.

2. Kontrolli për konstatimin e shkeljes doganore.

Përtej aspekteve të përgjithshme të bashkëpunimit reciprok ndërmjet shërbimit doganor dhe autoritetit të akuzës e gjyqësorit, të përmendura më lart, Kodi Doganor përmban dispozita në lidhje me kontrollin për konstatimin, verifikimin dhe zbulimin e veprës doganore, si dhe përcaktohen modalitete për kontrollin e mallrave, mjeteve të transportit dhe udhëtarëve.

Megjithëqë, roli i punonjësve doganorë nuk kufizohet vetëm në kërkimin, konstatimin dhe sekuestrimin e mallrave objekt kontrabande. Përgjegjësia kryesore e tyre është zbulimi i shkeljeve doganore të përcaktuara në nenin 256 të Kodit dhe autorëve të saj.

³¹³ BERR C.-J, «Introduction au droit douanier», Economica, botimi i fundit 2008.

Nëpërmjet kontrollit qëiu bëhet mallrave, realizohet edhe kontrolli për dërguesin, marrësin dhe transportuesin. Si rregull, edhe pse tradicionalisht kontrolli është i parashikuar vetëm mbi mallrat, tashmë ai bëhet edhe për operacionet tregtare³¹⁴.

Mallrat janë kyçi i të drejtës doganore dhe, historikisht, gjithë legjislacioni ishte ndërtuar rreth tyre. Për një kohë të gjatë, vepra doganore mund të ishte vetëm flagrante dhe malli përbënte provën e vetme të veprës doganore. Kërkohej që doganierët të kishin kompetenca shumë të gjera për t'u futur kudo. N.q.s. "*kontrolli i mallit*" bëhej zakonisht në zonën doganore, kur kalohej kufiri apo në zyrat e destinacionit, baza ligjore u kompletua më pas, me njohjen e një të drejte për akses në vendet ku mund të magazinohet malli. Për këtë, administratësë doganës i është njohur e drejta të "vizitohet" ose "kontrollohet" ambientet profesionale ose private, vende ku ajo konsideron se mund të ndodhet malli ose dokumentet që kanë shërbyer për të kryer kontrabandën³¹⁵, si dhe e drejta për të kërkuar informacion në lidhje me operacionet tregtare, që kanë filluar apo përfunduar jashtë territorit në bazë të letër-porosisë. Në literaturën juridike, diskutohet nëse në këtë rast kemi të bëjmë me shkelje të së drejtës së pronës dhe të vendbanimit, apo shkelje të cilat kufizohen nga ligjvënësi dhe nga KEDNJ.

Kështu n.q.s do hyjmë në ambientet e shoqërisë apo ato tregtare, përfshirë dhe ambientet ku pjesërisht shërbejnë për banim dhe pjesërisht për tregti³¹⁶, punonjësit e doganës duhet të procedojnë dhe me kapjen e autorëve të veprës doganore. Meqenëse ligji doganor, ai i procedurës penale dhe praktikës gjyqësore nuk i ka dhënë përgjigje rasteve të kësaj natyre, mendoj se masat shtrëngues të përdorura kundrejt personave në rastet e

³¹⁴ Konventa e Kiotos, 2012

³¹⁵ Neni 102(*Kontrollet a posteriori*)/ 2. Autoritetet doganore, pasi të kenë lejuar çlirimin e mallrave dhe, me qëllim që të sigurohen për saktësinë e të dhënave të deklaratës doganore, mund të verifikojnë dokumentet tregtare dhe të dhënat që lidhen me veprimet e importit dhe eksportit, si dhe veprimet e mëtejshme tregtare që kanë të bëjnë me këto mallra. Ky verifikim mund të kryhet në ambientet e deklaruesit ose të çdo personi, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, të përfshirë në veprimet e mësipërme, për arsye të veprimtarisë së tij profesionale, ose të çdo personi tjetër në zotërim të të cilit janë dokumentet dhe të dhënat e mësipërme për qëllime tregtie. Autoritetet doganore mund të kontrollojnë dhe mallrat, kur paraqitja në doganë e tyre është ende e mundur.

3. Kur rishikimi i deklaratës doganore ose verifikimi i saj, pas çlirimit të mallrave, tregon se dispozitat për regjimet doganore në fjalë janë zbatuar në bazë informacionesh të pasakta e të paplota, autoritetet doganore, veç zbatimit të sanksioneve të parashikuara në pjesën VIII të këtij Kodi, marrin në përputhje me dispozitat në fuqi, masat e nevojshme për të rregulluar situatën, duke u mbështetur në informacionin e ri që disponojnë. Neni 102/2,3 i Kodit Doganor.

Në bazë të normave të përcaktuara në këtë nen, zyrat doganore mund të procedojnë edhe me verifikimet kontabël të përgjithshme për të rivlerësuar një ose më shumë deklarata doganore, si edhe për të hetuar ndonjë shkelje të Kodit ose ligjeve të tjera, zbatimi i të cilave i është ngarkuar Administratës Doganore. Verifikimet kontabël me kërkesë të Administratave Doganore të huaja në zbatim të Marrëveshjeve dypalëshe për Asistencë Administrative të firmosura me autoritete kompetente të vendeve të tjera. Dhe pika 15/d të VKM nr.205, datë 13.04.1999 "*Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*".

Më shumë shiko pikën 15 të VKM nr. 205, datë 13.04.1999 "*Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor*".

³¹⁶ Shpesh e njëjta godinë shërben për magazinim si të mallrave, ashtu edhe për banim.

mësipërme, duhet të konkretizohen nga ligjvënësi në një kuadër shumë më të gjerë dhe strikt, ndryshe mund të gjendemi ose përpara shkeljes së të drejtave të njeriut, ose në kushtet e paaftësisë së autoritetit doganor për të goditur në kohë personat pjesëmarrës në një krim doganor.

Megjithatë, nëvështrim të dispozitave të mësipërme, por edhe të përcaktimeve të parashikuara në Konventat e fushës doganore³¹⁷, na duhet të pranojmë se nëkuadër të luftës kundër trafikëve,³¹⁸ ligjvënësi u ka dhënë punonjësve të doganës mjete të barabarta me mjetet e përdorura nga rrjetet e organizuara kriminale. Përveç kësaj, shërbimi doganor ka një kompetencë të përgjithshme kontrolli, që mund të ushtrohet në mbarë territorin, jo vetëm kur kalohet kufiri, përkundrazi shtrihet edhe përtej territorit doganor. Këto kompetenca kontrolli shoqërohen gjithashtu edhe me mundësinë për të sekuestruar, apo bllokuar mallra për të cilat ka dyshime të arsyetuara se përbëjnë objekt kontrabande.

2.1 Kontrolli i mallrave të deklaruar për zhdoganim dhe pas zhdoganimit.

Misioni kryesor i doganës është t'i vendosë mallrat në një regjim doganor (destinacion doganor), ashtu sikurse me kërkesë të subjektit të bëjë zhdoganimin e tyre, duke i çliruar për konsum apo t'i vendosë në një regjim të veçantë doganor. Kontrollat e ushtruara përgjatë kësaj procedure doganore bëhen në bazë të dispozitave të nenit 11, dispozita e Kreut 2, pjesës III të Kodit Doganor dhe pikave 95-108 të VKM-së, nr.205, datë 13.04.1999 "Për dispozitat zbatuese..."³¹⁹, si dhe të nenit 68 të Kodit Doganor Komunitar. Për të kryer verifikimin e deklaratave të pranuar, autoritetet doganore duhet:

- a) të shqyrtojnë dokumentet në mbështetje të deklaratës dhe dokumentet shoqëruese.
- b) t'i kërkojnë deklaruesit të paraqesë dokumente shtesë për të verifikuar saktësinë e të dhënave të deklaratës.
- c) të kontrollojnë mallrat dhe të marrin mostra për analiza ose për ekzaminime më të hollësishme.

Në këtë kuadër, bëhet fjalë për një kontroll të ushtruar mbas pranimit të deklaramit në doganë dhe, para se të kemi akordin për lirimin e mallit, që sipas dispozitave të Kodit Doganor, konsiderohet "verifikimi mallit". Për këtë nevojitet të verifikohet konformiteti i

³¹⁷ Më shumë shiko: "Konventën e Kiotos", "Nairobi" dhe "Johanesburgut".

³¹⁸ Në bazë të normave të përcaktuara në këtë nen zyrat doganore mund të procedojnë edhe me verifikimet kontabël të përgjithshme për të rivlerësuar një ose më shumë deklarata doganore, si edhe për të hetuar ndonjë shkelje të Kodit ose ligjeve të tjera, zbatimi i të cilave i është ngarkuar Administratës Doganore. Verifikimet kontabël me kërkesë të Administratave Doganore të huaja në zbatim të Marrëveshjeve dypalëshe për Asistencë Administrative të firmosura me autoritete kompetente të vendeve të tjera. Pika 15.5. VKM nr. 205, datë 13.04.1999 "Për Dispozitat Zbatuese të Kodit Doganor".

³¹⁹ Neni 93 i Kodit Doganor Francez.

natyrës, llojit, origjinës dhe vlerës reale të mallit, me të dhënat që figurojnë në deklarinimin doganor. Përveç kësaj, dogana kontrollon edhe respektimin e normave teknike, sanitare, etj. Fillimisht, ky kontroll mund të bëhet vetëm në zyrat doganore përgjatë orareve zyrtare, por, me kërkesë të deklaruesit dhe me shpenzimet e tij, ky kontroll mund të bëhet edhe në orare dhe vende të tjera. Verifikimi mund të bëhet si p.sh. në ambientet e ndërmarrjes, qëgëzon në këtë mënyrë një procedurë zhdoganimi në ambiente private, procedurë e cila po përdoret, por që mund të kthehet në një procedurë normale me hyrjen në fuqi të Kodit të Ri Doganor³²⁰.

Krijimi i procedurave të informatizuara për zhdoganim, ka sjellë si pasojë përgjithësimin e trajtimit të deklarimeve doganore nëpërmjet procedurës së zhdoganimit në ambientet profesionale³²¹. Një situatë e tillë e detyroi doganën të riorganizonte sistemin e kontrollit, si për nga struktura, ashtu edhe nga metodat, por njëherazi edhe për mbledhjen e informacionit, shënjestrimin e mallit që duhet kontrolluar, si dhe përzgjedhjen e kontrolleve që duhen kryer në bazë të analizës së riskut.

Si fillim, sistemi i kontrollit bazohej mbi deklarinimin spontan. Tashmë, fusha e veprimit të punonjësve doganorë nuk kufizohet vetëm në zyrat doganore apo në vende në kontroll doganor. Dispozita të shumta të Kodit Doganor iu mundësojnë punonjësve të kryejnë kontrolle edhe në qarkullimin rrugor. Madje, prerogativa të tjera iu lejojnë punonjësve të ndërhyjnë edhe nëpër ambientet e shoqërisë tregtare.

Neni 11 i KD i atribuoi punonjësve doganorë mundësinë për një kontroll të përgjithshëm, i cili ka një themel ligjor shumë të gjerë, me qëllim që të zbulohet akti i mashtrimit apo kontrabandimi nëpërmjet kalimit të kundërligjshëm në/dhe nga kufiri shtetëror. Mirëpo, shprehimisht ligji doganor dhe ai penal nuk parashikon ndalime për kërkimin e veprave penale, që nuk kanë të bëjnë me veprime të fushës doganore, përkundrazi diçka e tillë duhet të nënkuptohet, në ndryshim nga legjislacioni francez dhe praktika gjyqësore, në të cilat përcaktohet ndalimi i punonjësve doganorë për të ushtruar kompetenca për kërkimin e veprave të cilat nuk parashikohen në ligj si krime doganore³²².

2.1.1. Objekti i kontrollit të përgjithshëm.

Fillimisht duhet të theksojmë se shërbimi doganor monitoron të gjithë territorin doganor. Në nenin 11 përcaktohet e drejta për kontroll në të gjithë territorin doganor që përputhet me territorin e RSH. Megjithatë, legjislatori nuk ka parashikuar dispozita konkrete lidhur

³²⁰Regulation (EU) No 952/2013 of the European Parliament and of the Council of 9 October 2013 laying down the “**Union Customs Code**”

³²¹ Procedura, sipas të cilave ndërmarrjet realizojnë vetë formalitete doganore.

³²² Gjykata e Lartë Franceze, Sek. krim, 18 dhjetor 1989, Buletini krim, nr. 485.

me kufizimet, sikurse dhe me shtrirjen e tij, p.sh. për rastet kur ky kontroll ka filluar brenda territorit doganor dhe kërkohet të vazhdojë përtej, në ndjekje të një veprë të mundshme kontrabandë. Sipas studiuesve francezë, jurisprudenca e ka përcaktuar fushën e veprimit sipas neneve 60-61 të Kodit Doganor³²³ dhe, në rast refuzimi, punonjësit mund të kërkojnë asistencën e një gjyqtari³²⁴. Me një vendim të datës 29 mars 1999, Gjykata e Apelit të Rennes, cilësoi si vendbanim pjesët e banueshme të një anijeje private dhe anuloi procedurën doganore, në bazë të dispozitave të neneve 60 dhe 62 të Kodit Doganor.

Në këtë mënyrë, veprimi në bazë të neneve 62 dhe 63 mund të kushtëzohet, duke u bazuar në karakterin e banueshëm apo jo të pjesëve të anijes. Përveç kësaj të drejtetë kontrollit, mbështetur edhe në legjislacionin doganor të vendeve të BE-së, kërkohet të parashikohet edhe e drejta për ndjekje nga ana e punonjësve doganorë, jashtë territorit doganor, mirëpo ndjekja duhet të këtë filluar brenda këtyre zonave dhe të vazhdojë më pas me zonën e lirë ekonomike. Kjo prerogativë i lejon punonjësit të kapin një anije dhe ta drejtojnë në port, për të ushtruar kontrollin doganor. Si rrjedhojë, nëse kjo ndjekje realizohet si bashkëpunim doganor bilateral ose ndërkombëtar, do të lejojë përfundimin e operacionit të antikontabandës edhe në ujërat detare të huaja.

Për zbatimin e dispozitave të këtij kodi dhe me synim zbulimin e mashtrimit doganor, punonjësit doganorë mund të kryejnë kontrolle mbi mallrat, mjetet e transportit dhe mbi personat³²⁵. Kur flasim për territorin doganor apo vende të vëna në përgjegjësi doganore,

³²³ N.q.s. dispozita e nenit 61 aplikohet për të gjitha mjetet e transportit në përgjithësi, Kodi Doganor Francez parashikon edhe dispozita të veçanta, p.sh. për mjetet e transportit detar³²³. Neni 62 i Kodit Doganor Francez i jep punonjësve të doganës një të drejtë akses në anijet, të cilat ndodhen në territorin e brendshëm detar (12 milje) apo të zonës bashkangjitur (24 milje). Përdorimi i këtyre dispozitave ka për synim kontrollin p.sh. të dokumentacionit, por edhe të mallrave të ndryshme që gjenden në bord. Kurse neni 63 i Kodit Doganor Francez iu referohet anijeve, që ndodhen në port, në lumenj, duke përfshirë edhe anijet ushtarake n.q.s. janë franceze. Punonjësit doganorë mund të qëndrojnë në bordin e tyre, derisa të shkarkojnë mallin ose të nisen. Gjithashtu, kapitenët apo komandantët e anijeve janë të detyruar t'i drejtojnë punonjësit e doganës në vendet ku ata kërkojnë, po ashtu edhe tek ngarkesa e anijes.

³²⁴ Neni 63 i Kodit Doganor Francez.

³²⁵ Neni 60 bis Kodi Doganor Francez. Kur kemi prova serioze, të cilat prezumojnë se një person ka transportuar produkte narkotike të fshehura në organizmin e vet, punonjësit doganorë mund t'i kërkojnë këtij personi që t'i nënshtrohet një ekzaminimi mjekësor, gjithsesi punonjësit duhet të kenë marrë paraprakisht pëlqimin e tij.

Në rast se personi refuzon, punonjësit doganorë mund t'i kërkojnë një autorizim Presidentit të Gjykatës së Shkallës së Madhe (shkalla e parë) ose gjyqtarit të deleguar prej tij. Kjo kërkesë i transmetohet autoritetit gjyqësor me çdo mjet.

Gjyqtari mund ta autorizojë ekzaminimin mjekësor, në këtë rast ai cakton mjekun i cili do e kryejë në një kohë sa më të shkurtër.

Rezultatet e ekzaminimit të komunikuar nga mjeku, observimet mbi personin e ekzaminuar dhe procedurat, duhet të paraqiten në një procesverbal, i cili i dërgohet gjyqtarit. Çdo person që refuzon ekzaminimin mjekësor, kur autorizohet nga një gjyqtar, do të dënohet me burg deri një vit dhe një gjobë prej 3750 euro.

u referohemi vendeve publike, duke përjashtuar këtu vendet private, sipas përkufizimit që jep jurisprudenca³²⁶. Të drejtën e kontrollit për konstatimin e shkeljeve doganore kanë organet e policisë dhe organet e krimit ekonomik, kur kanë dyshime në lidhje me *mallrat e ndaluara*, neni 11 i Kodit Doganor, por në çdo rast kontrolli duhet të kryhet në praninë e autoritetit doganor dhe në një zonë doganore.

2.1.2. Kontrolli i mjeteve të transportit.

Me qëllim që kontrolli mbi mallrat, të cilat qarkullojnë në territorin kombëtar, të jetë sa më efikas, duhet të ekzistojë mundësia për të proceduar me verifikimin e mallrave, mjeteve të transportit dhe të personave. Për të zbuluar kontrabandën nuk mjaftojnë vetëm kontrollet³²⁷ që bëhen përgjatë kalimit të mallrave në doganë. E drejta doganore interesohet edhe për rastin kur një akt kontrabande nuk zbulohet përgjatë kalimit kufitar, por mund të zbulohet përgjatë kontrolleve që mund t'u bëhen mallrave në brendësi të territorit. Kodi ynë Doganor, si edhe ai Francez dhe Italian, parashikon një mjet të rëndësishëm për të drejtën e “vizitës” apo “kontrollit” që është “urdhri i ndalimit në vend”. Dispozitat doganore të lartpërmendura, por edhe prerogativat që i njeh ligji i procedurës penale oficerit të policisë gjyqësore të administratës doganore, i lejon punonjësit doganor që ta përdorë këtë urdhër-ndalim (Tabela ndalimi) për të ndaluar dhe kontrolluar automjetin³²⁸ dhe, nëse është në plumbosje ta drejtojnë në zyrën më të afërt doganore, në mënyrë që të kryejnë kontrollin e mjetit dhe mallrave. Sipas këtyre dispozitave, shoferi është i detyruar t'i bindet autoritetit doganor, duke hapur bagazhin ose rimorkion për të peshuar mallin³²⁹. Nëse shoferi nuk i bindet urdhrin për ndalim, ai sanksionohet me kundërvajtje doganore të parashikuara në nenet 260-275 të Kodit Doganor. Sipas legjislacionit doganor francez theksohet, se, në rast refuzimi, punonjësit doganorë mund të kërkojnë asistencën e një gjyqtari³³⁰. Në përfundim, duhet të theksojmë se urdhri për ndalim automjeti duhet të përdoret vetëm për të zbuluar shkelje në fushën doganore.

³²⁶C-j Berr. Koment mbi Gjykatën e Lartë, Sek. Krimit. 15 tetor 1984, JCP 1984, ii 20410.

³²⁷ Kur autoritetet doganore kanë dyshime se është kryer një shkelje doganore, atyre u lejonet të kontrollojnë mjetet e transportit dhe mallrat që kanë hyrë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, edhe para se të jetë depozituar deklarata përmbledhëse.

³²⁸ “Mbikëqyrja doganore fillon menjëherë, sapo mjeti lundruar ankorohet, arrin në radar ose hyn në port dhe vazhdon deri në çastin, kur mallrat shkarkohen nga mjeti lundruar për t'iu caktuar një destinacion doganor. Menjëherë pas përfundimit të inspektimit policor dhe atij fitosanitar, autoritetet doganore mund të ushtrtojnë të gjitha kontrollet e nevojshme në bordin e mjetit lundruar”. Neni 53 i Kodit Doganor dhe pika nr. 95-101, VKM nr. 205, datë 13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese...”.

³²⁹ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. krim, 28 maj 1984, Bul krim. Nr. 192.

³³⁰ Me një vendim të datës 29 mars 1999 Gjykata e Apelit e Rennes ka cilësuar si vendbanim pjesët e banueshme të një anije private dhe anuloi procedurën doganore në bazë të dispozitave të neneve 60 dhe 62 të Kodit Doganor Francez.

Kodin Doganor parashikon edhe dispozita të veçanta, p.sh. për kontroll të mjeteve të transportit detar³³¹. *Sipas ligjit doganor francez, dispozitat e Kodit Doganor i japin autoriteteve doganore të drejtë aksesi në anijet, të cilat ndodhen në territorin e brendshëm detar (12 milje) apo edhe jashtë tyre në raste të veçanta.* Përdorimi i këtyre dispozitave ka si synim jo vetëm kontrollin e dokumentacionit, por edhe mallrave të ndryshme që gjenden në bord. Doganierët kontrollues, grupi i praktikës doganore, si dhe grupet e antikontabandës detare mund të qëndrojnë në bordin e tyre, derisa të shkarkohet malli ose të nisen sërish. Gjithashtu, kapitenët apo komandantët e anijeve janë të detyruar t'i drejtojnë punonjësit e doganës, në vendet që u kërkohet, sikurse të paraqesin edhe manifestin apo çdo dokumentacion tjetër që ka të bëjë me ngarkesën e mallit në anije.

Sipas dispozitave të lartpërmendura, kontrolli i mjeteve të transportit përfshin një të drejtë vizite ose kontrolli për mjetet e transportit, pa theksuar se cilat mjete: ato tokësore, detare apo ajrore. Kontrolli ushtrohet si për mjetet e transportit publik, ashtu edhe për mjetet e transportit privat. Këto dispozita parashikojnë një inspektim të gjithanshëm të mjetit, që do të thotë se doganierët nuk janë të detyruar të bëjnë vetëm kontrollin e mallit që ai transporton. Ky kontroll ka si synim:

Së pari, të verifikojnëse të gjitha mallrate deklaruar janë të rregullta, si edhe nëse taksat e detyrueshme janë likuiduar; *së dyti*, të verifikojë nëse mjeti i transportit nuk është mjet që përdoret për të kryer kontrabandë të çfarëdollojshme. Mjetet e transportit janë objektivi kryesor në importin apo eksportin e mallrave, që s'janë deklaruar apo të ndalueshme. Kontrolli që u ushtrohet mjeteve ka si synim gjetjen e mallrave që janë fshehur. "Në qoftë se për të fshehur mallrat janë krijuar pjesë të fshehta në mjetet e transportit, atëherë në këto raste sekuestrimi i mjetit është i menjëhershëm, në mënyrë që t'i kërkohet autoritetit të Prokurorisë të prononcohet mbi konfiskimin e tij³³². Në këto raste veprohet në dy drejtime: ose mallrat që ndodhen në mjet janë të ndaluara, ose shumë të taksuara, kështu që gjendemi para një veprë penale të parashikuar në nenin 276 të Kodit Doganor dhe nenit 171 të Kodit Penal, ose, nëse nuk gjendemi përpara mallrave të ndaluara lihen detyra për një kontroll të plotë në zonën doganore. Sekuestrimi i mjetit dhe i mallit bëhet sipas neneve 281-282 të Kodit Doganor dhe për t'u përdorur si provë materiale, derisa të vendoset konfiskimi nga gjykata.

Në ligjin doganor francez, kur mallrat nuk janë as të rrezikshme, as shumë të taksueshme, por janë sjellë në mënyrë të kundërligjshme, atëherë konsiderohen kundërvajtje administrative, për të cilën, ndryshe nga legjisllacioni ynë³³³, nuk vendoset sekuestrimi apo konfiskimi. Edhe në këtë rast, mjeti sipas ligjit doganor francez, por edhe sipas

³³¹ Nenet 62 dhe 63 të Kodit Doganor Francez.

³³² Sipas ligjit doganor francez, në qoftë se nuk ka pasur vende të fshehta sekuestrimi mund të jetë fakultativ.

³³³ Neni 61 i Kodit Doganor.

legjislacionit tonë³³⁴, mund të mbahet i bllokuar për qëllim garancie. Nëse autori nuk është pronari i automjetit, atëherë i kthehet pronarit të vërtetë në qoftë se ai s'ka qenë bashkëpunëtor apo bashkautor i veprës^{335/336}.

2.1.3.Kontrolli i mallrave.

OBT-ja³³⁷ dhe Legjislacioni komunitar, siç kemi theksuar edhe në krerët e mëparshëm, ka parashikuar lirinë e qarkullimit të mallrave. Por, në bazë të neneve 71-83/2,82 të Kodit Doganor dhe ligjit për kontrollin e eksporteve, sikurse ligjeve të veçantë të fushave të tjera, parashikohet mundësia për ndalimin apo për kufizimin ndaj disa mallrave. Natyra specifike bën që t'i nënshtrohen rregullave të veçanta për qarkullim apo për t'u ndaluar.

• Kontrolli i mallrave të quajtura si “të ndjeshme”.

Ekzistojnë mallra të cilësuar si “të ndjeshme” për nga natyra, vlera e tyre ose fiskaliteti që i nënshtrohen. Administrata doganore ka kompetenca shumë të veçanta për të kontrolluar këto mallra, ashtu sikurse punonjësit doganorë kanë prerogativa të veçanta për të kontrolluar fluksin e këtyre mallrave.³³⁸

Në Kodin Doganor dhe atë Penalpërcaktohen vepra penale nga mallra të ndalueshme³³⁹, mirëpo në të dy këto ligje, materialet dhe aktet nënligjore, nuk gjejnë përcaktime lidhur me to, të cilat deri në njëfarë mase mund t'i gjejnë të specifikuar në ligjin për kontrollin e eksporteve ose në Konventa ku Shqipëria ka aderuar. Mendoj se përcaktimi i nocioneve dhe listimi i tyre paraqet rendësi, si për studiuesit e jurisprudencës fushës doganore, ashtu edhe për avokatët, prokurorët dhe gjyqtarët, në rastet e kualifikimit të veprave penale të kontrabandës dhe zbatimit të sanksioneve penale e doganore.

³³⁴ Neni 181 i Kodit Doganor.

³³⁵ Neni 326/3 i Kodit Doganor Francez.

³³⁶ Sekuestrimi i objekteve të kontrabandës kryhet pavarësisht nga shkalla e pjesëmarrjes në kontrabandë të kujtdo që ka të drejta mbi këto objekte.

3. Kur personi përgjegjës për kontrabandën ka në dorësi, si pasojë e një vepre penale tjetër, objekte të sekuestruara të kontrabandës për qëllim të këtij neni, këto i kthehen pronarit të ligjshëm.

4. Mjetet e transportit përjashtohen nga sekuestrimi kur:

- në bazë të provave që disponohen, pronari i tyre nuk është përfshirë në aktin e kontrabandës.

- pronari zotëron mjetet e transportit në mirëbesim, si pasojë e procedurave të zakonshme të tregtisë, pa qenë në gjendje të dijë në mënyrë objektive se mjetet në fjalë ishin një mjet ose objekt i aktit të kontrabandës ose të një akti apo krimi të ngjashëm.

³³⁷ Organizata Botërore e Tregtisë.

³³⁸ Nocioni i “mallra të ndjeshme”, neni 38 i Kodit Doganor përkufizon mallra të cilësuar si të ndjeshme dhe kufizimi i tyre zbatohet për hyrjen dhe daljen nga territori komunitar. Neni 215 i KD jep një listë të kategorive të mallrave, të cilat i nënshtrohen një kontrolli më të detajuar. (Kodi Doganor Francez).

³³⁹ Shiko nenin 171 të Kodit Penal dhe nenet 276, 280 të Kodit Doganor.

Mallrat cilësohen si të ndalueshme, kur importi apo eksporti i tyre ndalohej në çfarëdolloj mënyre, kur i nënshtrohet kufizimeve apo rregullave cilësore, si dhe rregullave formale. Ky përkufizim na lejon të dallojmë mallra, të cilat cilësohen si absolutisht të ndalueshme dhe ato që janë relativisht të ndalueshme. Në rastin e parë, mallrat nuk mund të importohen apo eksportohen në territorin doganor shqiptar (p.sh. lëndët helmuese luftarake, droga, plehurat), ndërsa, në rastin e dytë, importi apo eksporti i nënshtrohet rregullave, si p.sh. paraqitja e një licence të veçantë, autorizim apo certifikatë (p.sh. armatimi, lëndë eksplozive, etj.).

• **Kontrolli i mallrave për të cilat importimi, eksportimi, tranzitimi dhe vendosja në një procedurë të veçantë rregullohet me ligj.**

Në ligje të veçantë përcaktohen mallra, të cilat paraqesin rrezikshmëri për shëndetin publik (si p.sh. narkotikët, lëndët psikotrope, estrogenë dhe anabolizantët), mallra të dëmshme për sigurinë publike (armët, municionet dhe eksplozivët), çfarëdo imazhi apo prodhimi pornografik që kanë në skenë të mitur, mallra pirate dhe të falsifikuara, mallra të ndaluara me anën e marrëveshjeve ndërkombëtare (p.sh. në zbatim të Konventës së Uashingtonit, datë 3 mars 1973), mallra që kanë qenë shkak i një trafiku ndërkombëtar (p.sh. alkoolët, duhani, perlat dhe gurët e çmuar).

Mbajtja e këtyre mallrave i nënshtrohet detyrimit për të prezantuar një dokument origjine. Kontrolli mund të bëhet në të gjithë territorin dhe cilido qëi ka në posedim duhet t'u paraqesë punonjësve doganorë dokumentet që vërtetojnë origjinën e tyre. Përveç dokumentit të origjinës së mallit, personi duhet të paraqesë edhe dokumentacionin që malli është futur në mënyrë të rregullt në territorin doganor, si dhe të paraqesë një dokument për origjinën e mallit.

Në aktet nënligjore për "Kontrollin e Eksporteve" jepet një listë e mallrave, të cilat u nënshtrohen formaliteteve të ndryshme dhe që mund të jenë objekt i kontroleve doganore, ku përfshihen: mallrat dhe teknologjitë me përdorim të dyfishtë (produkte që kanë një përdorim, si civil, ashtu edhe ushtarak), armët dhe municionet, thesaret shtetërore dhe objektet e kulturës, lëndët narkotike dhe psikotrope, medikamentet për përdorim njerëzor, organet, qelizat dhe gametat, gjaku njerëzor, radioelementët artificialë, falsifikimi i markave, plehurat, filmat pornografikë, në të cilët shfaqen të miturit³⁴⁰. Gjithashtu, në bazë të legjislacionit material të institucioneve të ndryshme, aplikimi i këtij mekanizmi mund të

³⁴⁰ Duhet theksuar se filmat pornografikë, në të cilët nuk ka paraqitje minorenësh, nuk cilësohen si mallra të ndaluara sipas nenit 38 pika 4, por dispozitat e nenit 227-4 i Kodit Penal mund të aplikohen me kërkesë të Prokurorisë.

zgjerohej për mallrat të cilat parashikoheshin me urdhër ministror. Kështu, me një urdhër ministror të vitit 2001, u parashikua kufizimi i “produkteve të mishit të lopëve” me origjinë nga Anglia dhe Portugalia, nëtë ashtuquajturën periudhë e “lopës sëçmendur”.

Përveçdokumentit të origjinës së mallit, personi duhet të paraqesë edhe dokumentacionin që malli është futur në mënyrë të rregullt në territorin e RSH, si dhe të paraqesë një dokument për origjinën e mallit.

Autoriteti doganor ka të drejtën e bllokimit apo të vendosjes së sekuestros konservative të mallrave si në vendet qëata fiksojnë, ashtu edhe për mjetet e transportit, me qëllim që, nëse dyshohet për kontrabandë, të kenëmundësinëtë kryejnë hetime për të mbledhur provat e duhura. Këto mallra mund të mbahen në ambientet profesionale të ndërmarrjes, ose në çdo lloj vendi të autorizuar nga punonjësit doganorë, me shpenzimet e pronarit, të dërguesit ose të marrësit, ose nëse nuk njihenkëta persona, në kurriz të çdo personi i cili merr pjesë në import-eksport. Ky veprim ka si objekt të verifikojënatyrën e saktë të mallit. Për këtë arsye punonjësit mund të bëjnë testet e nevojshme ose ta detyrojnë pronarin ta çojëmallin në vende të përshtatshme, ku mund të jetë më e lehtë të kryhen këto teste.

Në këto raste, nuk kemi të bëjmëasesi me sekuestrim, si rezultat zbulimin e një vepre doganore,por me një masë parandaluese, e cila lejon lehtësimin e hetimit. Pra, këto veprime të domosdoshme të autoritetit doganor për të goditur krimin doganor duhet të sanksionohen me dispozita konkrete në Kodin Doganor dhe, në veçanti, në dispozitat zbatuese të Kodit Doganor, duke parashikuar edhe afatet e përpikta të mbajtjes të tyre.Sipas ligjit doganor francez, zbatimi i masave të mësipërme të parashikuara edhe në nenin 322 bis të Kodit Doganor Francez, kufizohet duke përfshirë një afat kohor prej 10 ditësh, afat i cili mund të zgjatet vetëm me autorizim të prokurorit, por pa tejkaluar nëtotal 21 ditë³⁴¹.

Sipas legjislacionit francez për mbajtjen dhe ndalimin e mallrave kërkohet të përmbushen dy objektiva. Nga këta, objektivi i parë parashikohet në nenin 323 pika 2 e Kodit Doganor dhe i lejon punonjësit të mbajnë mallin, i cili ka qenë objekt i veprës doganore, kurse objektivi i dytë i parashikuar njëkohësisht edhe nga neni 323 dhe neni 378 i Kodit Doganor, i kualifikuar si “mbajtje parandaluese”, ka si qëllim të garantojë pagimin e gjobave doganore.

Në rast se kemi të bëjmë me bllokim, ose të mallit si objekt kontrabande,ose të mjetit të transportit, pak rëndësi ka nëse malli është apo jo i konfiskueshëm³⁴². Si rrjedhojë, lind

³⁴¹ Neni 322 bis Kodi Doganor Francez.

³⁴² Me një vendim, datë 6 prill 1987, Gjykata e Lartë Franceze thekson se mbajtja për arsye parandalimin e parashikuar në nenin 323 pika 2 të Kodi Doganor mund të kryhet nga punonjësit doganorë për çdo lloj objekti, i cili mund të përdoret për pagimin e penaliteteve.

nevoja që ta veçojmë këtë procedurë nga procedura e parashtruar në nenin 378 të Kodit Doganor Francez, që parashikon mbajtjen për arsye parandaluese, vetëm në rastin kur kemi të bëjmë me vepër flagrante, e cila aplikohet vetëm për objektet që e shkaktojnë, si dhe që janë të konfiskueshme³⁴³.

- **Kontrolli i mallrave të cilësuar si të ndjeshme në marrëdhëniet ndërkomunitare.**

Në bazë të ligjit organik, ligjit për bankat, çdo person është i detyruar të deklarojë në hyrje apo në dalje nga/dhe në territorin doganor shumën e parave, çeqeve, konfirmimet bankare mbi shumën 1 milion lekë, ndërkohë që lufta kundër pastrimit të parave ka shtruar nevojën e kontrollit të hyrjes dhe daljes së parave, si dhe detyrimin për të deklaruar burimin e tyre. Në Kodin Doganor nuk ka dispozita konkrete lidhur me këtë detyrim, gjë që kërkontë përfshihen me patjetër dispozita konkrete lidhur me këtë çështje, por për Kodin Penal, neni 179/1, mosdeklarimi i shumave të lartpërmendura, si dhe sendeve me vlerë, përbën vepër penale. Në këto kushte, autoriteti doganor ka detyrimin ligjor që të ushtrojë kontroll për të verifikuar saktësinë e deklaramit të personit lidhur me paratë dhe shumën me vlerë që disponon deklaruesi dhe, nëse rezultojnë para dhe sende me vlerë të padeklaruar, autoriteti doganor gëzon të drejtën e vendosjes së sekuestros konservative, deri në përfundimin e hetimit dhe gjyqimit të çështjes. Një gjë e tillë shprehet në nenin 465 të Kodit Doganor Francez, ku parashikohet dhe drejta ndalimit, bllokimit të shumave të parave, titujve, të cilët nuk janë deklaruar në hyrje apo në dalje të territorit francez. Gjykata e Lartë ka pranuar se dispozitat e këtij neni ishin konformme dispozitat e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (neni 6 paragrafi 2 dhe neni 7)³⁴⁴.

3. Sekuestrimi i mallrave në procesin e kontrollit dhe hetimit të çështjeve doganore.

Sipas doktrinës, sekuestrimet të çfarëdo natyre qofshin përbëjnë mjet kërkimi prove, që kanë për qëllim marrjen dhe ruajtjen nga organi procedues të mjeteve dhe sendeve, të cilat lidhen dhe i përkasin veprës penale të kontrabandës. Në fakt, në rastin e sekuestrimit të mallrave që mendohet se janë objekt kontrabande pararendës të konfiskimit, i cili

³⁴³ Gjykata Kushtetuese Franceze, kur bëri studimin e kushtetutshmërisë së pikës 2 të nenit 323 të Kodit Doganor vendosi, që “ky dispozicion nuk është kundër asnjë dispozite kushtetuese dhe nuk shkel asnjë të drejtë apo liri që mbrohet në të”. (Gjykata Kushtetuese Franceze, 22 shtator 2010, Fz, 23 shtator 2010, fq. 17291).

³⁴⁴ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. krim, 4 dhjetor 1997, Bul. Krim. Nr. 416.

vendoset nga gjykata. Sipas nenit 281 të Kodit Doganor ata që konstatojnë një veprë doganore, kanë të drejtë të sekuestrojnë të gjitha objektet e kontrabandës, të mbajnë procesverbalet dhe çdo dokument tjetër në lidhje me objektet e sekuestruara dhe të procedojnë, në mbajtjen me qëllim parandalues të objekteve për arsye prove materiale. Si përfundim, gjithçka finalizohet me përgatitjen e konfiskimit definitiv në bazë të vendimit të gjykatës, çka do të thotë, se, si rregull, sekuestrimi është pararendës i konfiskimit dhe zgjidhje e një prej pasojave të dëmit të shkaktuar nga krimi i kontrabandës^{345/346}.

Sekuestrimi i objekteve të kontrabandës kryhet pavarësisht nga shkalla e pjesëmarrjes në kontrabandë të kujtdo që ka të drejta mbi këto objekte. Kur personi përgjegjës për kontrabandën ka në dorësi, si pasojë e një vepre penale tjetër, objekte të kontrabandës të sekuestruara për qëllim të këtij neni, këto të fundit i kthehen pronarit të ligjshëm. Gjithashtu, ligji parashikon rastet kur mjetet e transportit përjashtohen nga sekuestrimi dhe kur mallrat objekt sekuestrimi rrezikojnë të prishen, si dhe në ç'fazë të veprimeve të kryerjes së kontrabandës realizohet sekuestrimi³⁴⁷.

Sekuestrimi doganor³⁴⁸, nëvështrim të dispozitave të Kodit Doganor, nenet 282-283 të Kodit Doganor, kryhet nga doganierët e grupit të kontrollit dhe verifikimit të deklarimit, si dhe doganierët e antikontarabandës, të cilët gëzojnë edhe statusin e oficerëve të policisë gjyqësore. Gjatë hetimit paraprak është e nevojshme që sendet objekt sekuestrimi të paraqiten si provë materiale në procesin e hetimit dhe gjykimin e çështjes, gjithmonë nëse çështja kalon për hetim në organin e akuzës dhe gjyqësor.

4. Kompetencat e autoritetit doganor për hetimin në ambientet private.

Në bazë të nenit 286/6 të Kodit Doganor, autoritetet doganore, me qëllim që të parandalohen, verifikohen dhe frenohen shkeljet doganore, mund të kryejnë të gjitha kontrollet e nevojshme pranë ambienteve të operatorëve ekonomikë, në magazinat e tyre dhe në të gjithë ambientet, ku mbahen regjistrat e llogarisë së firmës. Një gjë e tillë prezantohet edhe në nenin 102 të Kodit Doganor. Një përcaktim të tillë e gjejmë edhe në nenin 298 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit oficerit të policisë gjyqësore i lejohej të kryejë kontroll edhe në lokal.

³⁴⁵ Sipas nenit 281 të Kodit Doganor.

³⁴⁶ Neni 282 të Kodit Doganor

³⁴⁷ Neni 283 “Objektet e kontrabandës, të parashikuara në nenin 282, sekuestrohen: kur veprimi i kontrabandës është në kryerje e sipër, këtu do të përfshihet jo vetëm faza e tentativës, por edhe në kushtet e përgatitjes së veprës penale të kontrabandës.....

³⁴⁸ Pa rënë ndesh me ligjet e tjera në këtë fushë, mallrat në fjalë sekuestrohen nga autoritetet doganore, më pas, me vendim të autoriteteve gjyqësore kompetente, mund të konfiskohen dhe, në vijim, të trajtohen në bazë të legjislacionit në fuqi. (Neni 282).

Në kuptim të kësaj dispozitë ligjore, rezulton se legjislatori nuk ka parashikuar kontrollin doganor në ambientet private të banimit, si dhe ndaj personave, drejtpërdrejtë ose tërthorazi, të përfshirë në veprimet e kontrabandës për arsye të veprimtarisë së tij profesionale, ose të çdo personi tjetër në zotërim të të cilit janë dokumentet dhe të dhënat e mësipërme për qëllime tregtie. Mirëpo, për të kryer hetimet në mënyrë të kënaqshme, autoritetit doganor i duhet të ketë akses jo vetëm në dokumentacion, por edhe në mallrat, të cilat mund të jenë vendosur në ambiente private banimi, madje edhe mbi personat, veçanërisht kur ka të dhëna të besueshme se gjendemi përpara një trafikimi të kundërligjshëm apo të një tjetër shkelje doganore kontrabandë.

E drejta e shërbimit doganor për të vizituar apo kryer kontrole në ambientet private ka qenë dhe mbetet çështje e diskutueshme. Gjithsesi, praktika e deritanishme ka pranuar si zgjidhje për hyrjen dhe kontrollin në ambientet private nga autoriteti doganor, metodën e delegimit të detyrave policisë gjyqësore doganore dhe përkundrejt autorizimit të prokurorit.

Nisur nga këto rrethana, mendoj se do ishte jashtëzakonisht e volitshme që në Kodin Doganor të integroheshin dispozita, që të trajtojnë kryesisht kontrollet në ambientet private. Por, për këtë duhet mbajtur parasysh, që, në rastet e hetimeve doganore, është e nevojshme të respektohen garancitë që uofrohen individëve, duke iu deleguar doganës një kontroll i tillë në ambientet private pa autorizimin e akuzës, vetëm në rastet flagrante për dyshime të arsyetuara apo në ndjekje të një rasti kontrabandë.

Në praktikën gjyqësore të gjykatës franceze, nëpërmjet një vendimi, Gjykata Kushtetuese, i ka dhënë vlerë kushtetuese parimit të mosdhunimit të vendbanimit³⁴⁹. Sipas legjislacionit doganor francez në rastet e kontrollit në banesa private, punonjësit doganorë duhet të jenë të autorizuar për kryerjen e këtij operacioni. Autorizimi jepet nga ministri, që ka në autoritetin e tij doganën, ashtu sikurse prezenca e autorizimit verifikohet nga Gjykata e Lartë. Vizita mund të kryhet prej orës 6 deri në 21:00. Kushti i dytë kërkon domosdoshmërisht prezencën e një oficeri të policisë gjyqësore, përgjatë gjithë kohës së vizitës. Gjithsesi, ekziston edhe rasti kur prezenca e OPGJ nuk është e detyrueshme, p.sh. në rastin kur kemi rast flagrant dhe jemi në ndjekje e sipër, ndërkohë që mallrat bashkë me autorët futen në ndërtesë apo në ambiente private³⁵⁰.

Kjo e drejtë në ligjin doganor francez³⁵¹ përfshin edhe rastet kur autoritetit doganor i jepen kompetenca hetimi shumë të përgjithshme, duke i lejuar të kryejnë hetime jo vetëm në ambientet e personave që kanë marrëdhënie të drejtpërdrejta me hetimin, por njëherazi edhe tek personat e tretë, pa u krijuar mundësi këtyre të fundit të kundërshtojnë për sekret

³⁴⁹ Gjykata Kushtetuese Franceze, Vendim nr. 83-164, datë 29 dhjetor 1983.

³⁵⁰ Neni 332 i Kodi Doganor Francez.

³⁵¹ Neni 65 i Kodit Doganor Francez.

profesional. E thënë ndryshe, e drejta e komunikimit të dokumenteve, mund të ushtrohet jo vetëm për dërguesit dhe marrësit e mallrave, por edhe për personat e tjetër fizikë e juridikë, të cilët lidhen drejtpërsëdrejti apo indirekt me operacionet e ligjshme apo të paligjshme që hyjnë në fushën e veprimit të Doganës³⁵². Gjithashtu, Kodi Doganor Francez parashikon shprehimisht, në nenin 64 A të tij, mundësinë për komunikim dokumentesh nga administrata e shtetit, departamentet, komunat, ndërmarrjet në koncesion, entet, si dhe të gjitha ndërmarrjet dhe institucionet që ndodhen nën kontrollin e autoritetit administrativ. Përveç këtyre, punonjësit doganorë mund t'i përdorin këto prerogativë edhe në rastin e fondeve të dhëna nga Fondi Evropian i Orientimit dhe i Garancive Bujqësore.

Ligji konsideronte si dokument të gjitha ato shkresa, por edhe dokumente të përmbajtura në një suport telematik apo informatik. Madje, të përdorej edhe në rastet e komunikimit të të dhënave të konservuara apo trajtuara nga operatorët telefonikë. Këto të dhëna duhej të përdorreshin vetëm për t'u informuar mbi përdoruesin dhe në asnjë mënyrë rreth përmbajtjes së bisedave telefonike që zhvillohen midis personave. Cilido qoftë suporti i dokumentit, sipas nenit 65 të Kodit Doganor, doganës i njëjti e drejta të kërkonte që t'i vihej në dispozicion.

Mbështetur në legjislacionin e vendeve komunitare, për të mbuluar boshllëqet që gjenden në dispozitat e Kodit Doganor, lidhur me të drejtën e administratës doganore për ushtrimin e kontrollit në banesat private (vendbanimet), përveç sa parashtrua më lart, më lejoni të shpreh mendimin se në ligjin doganor mund të përfshihen dispozita të veçanta, që diçka e atillë të lejohet vetëm:

- kur gjenden para një vepre penale doganore;
- përkundrejt një autorizimi nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;
- në prezencën e një OPGJ, me përjashtim të rasteve, kur kemi rast flagrant dhe jemi në ndjekje e sipër, ndërkohë që mallrat bashkë me autorët futen në ndërtesë apo në ambiente private³⁵³.
- në intervalin kohor nga 6.00 deri në 21.00
- nëse respektohet parimi i kontradiktoritetit dhe kjo vizitë të kryhet në prezencë të personit që banon në këto ambiente ose të përfaqësuesit të tij. Nëse ai s'është prezent, atëherë OPGJ-ja duhet të marrë dy dëshmitarë.

³⁵² Gjykata e Lartë Franceze, në gjykimin e një çështje të kësaj natyre, konfirmoi se dispozitat rreth kësaj të drejte nuk janë kundër dispozitave të KPDNJ. (Neni 6 paragraf 2 dhe neni 8). Gjithashtu thekson kushtet e kësaj të drejte, duke sanksionuar shprehshërë procedurat doganore, të cilat dëlnin nga kuadri ligjor.

³⁵³ Neni 332 i Kodit Doganor Francez.

5.Kontrolli i personave.

Kjo e drejtë përfshin disa etapa, domethënë nga kontrolli i thjeshtë i identitetit, të sapo trajtuar, deri tek kontrolli fizik. Në hipotezën e fundit, autoritetit doganor duhet t'i krijohet mundësia që të kërkojë për të gjetur veprën doganore, ndërkohë që policët nuk e kanë këtë të drejtë, nëse nuk provojnë dot që ndodhen në prezencë të një vepre flagrante. Praktika doganore, ndryshe nga ajo në vendet komunitare, ka treguar se kemi mjaft kufizime për një përdorim të gjerë të nocionit të “kontrollit mbi personat”, duke e shtyrë kështu jurisprudence të vendosë herë pas here limite. E gjitha çështja qëndron te natyra e operacioneve doganore të kryera gjatë kontrollit. Kontrolli fizik (prekja e personit) për sigurinë e punonjësit gjatë kontrollit, duhet të jetë i lejuar. Në këtë mënyrë punonjësit mund të verifikojnë, në qoftë se personi nuk ka me vete mallra objekt kontrabandë. Nga ana tjetër, jurisprudence ka cilësuar qartë, se deri ku mund të shkojmë me termin “person”. Në këtë kuadër, me kontrollin e personit kemi të bëjmë me kuptimin e mirëfilltë të fjalës apo kontrolli mund të shtrihet edhe tek aksesoret që ai mbart me vete? Çështja qëndron në dallimin midis të drejtës së kontrollit dhe kërkimit ose kontrolleve të detajuara, që mund të bëhen për hetim. Sipas legjislacionit francez, kjo e fundit bëhet vetëm me autorizim të autoritetit gjyqësor. Jurisprudence, në bazë të nenit 64 të Kodit Doganor³⁵⁴ lejon që të kryhet kontroll në bagazhet dhe nëçantat e dorës tek personi i kontrolluar³⁵⁵.

Përveç faktit se punonjësve doganorë i njihet edhe kontrolli më i hollësishëm mbi personat, në mënyrë që të zbulohet vepra doganore, këtu pa qenë e nevojshme të jemi në raste flagrante. Personi i ndaluar nuk mund të refuzojë, në të kundërt kemi veprën e moslejimit të ushtrimit të funksioneve, shkelje kjo që duhet të përfshihet më e plotë në ligjin doganor. Për të kryer kontrollin mbi personin, si fillim duhet që ai të mbahet për një kohë të nevojshme, d.m.th. ushtrimi i kontrollit dhe redaktimi i procesverbalit³⁵⁶. Përveç kësaj, jurisprudence ka lejuar edhe kontrollin e ushtruar mbi agjendat apo mbajtëset e dokumenteve që ndodheshin në bagazhet e personave^{357/358}.

³⁵⁴ Neni 64 i Kodit Doganor Francez.

³⁵⁵ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. krim, 26 shkurt 1990, Bul. Krim. Nr. 93.

³⁵⁶ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. krim, 15 qershor 1987, Bul. Krim. Nr. 249.

³⁵⁷ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. krim, 20 shkurt 1990, Bul. Krim. Nr. 93.

³⁵⁸ Sipas legjislacionit doganor francez, në bazë të nenit 60 të Kodit Doganor punonjësit doganorë mund t'i kërkojnë personit të ndaluar t'i nënshtrohet edhe një testi (test toksikologjik) për të verifikuar prezencën e lëndëve narkotike në kavitetet e trupit. Në këtë rast personi duhet të japë pëlqimin e tij. Nëse personi refuzon, ligji parashikon një procedurë të dytë, që është ajo e kontrollit të quajtur “*in corpore*”. Personi i kontrolluar duhet të njoftohet në një gjuhë që merr vesh për të drejtën e tij për të refuzuar këtë lloj testi. Refuzimi i personit nuk është pa pasoja, pasi mund të nënkuptohet si një “indikacion serioz” i cili lejon vënien në zbatim të dispozitave të nenit 60 të Kodi Doganor Francez. Ligji nr 87-1157, datë 31 dhjetor 1987, ka integruar një procedurë të veçantë për të drejtën doganore. Kemi dy situata të parashikuara, të cilat varen nga sjellja e personit të kontrolluar. Neni 60 bis Kodi Doganor Francez supozon “të dhëna serioze të cilat lënë të

5.1.Kufizimet e specifikuar nga jurisprudenca.

Sipas literaturës juridike franceze, jurisprudencës ka vendosur ca limite për sa i përket nenit 64 të Kodit Doganor, i cili i atribuon punonjësve doganorë kompetenca shumë të gjera. Meqë e drejta e kontrollit nuk kërkon që të jemi në prezencë të një vepre flagrante, jurisprudencangre disa pyetje, së pari,për të ditur se cili është limiti kohor për të kryer kontrollin dhe,së dyti, a munden punonjësit doganorë të përdorin masa sigurie ndaj personave, gjatë kohës së kontrollit? Njëkohësisht, edhe nëse kufizimi i kontrollit për persona të përcaktuar me ligj shtrihet edhe mbi mjetet dhe bagazhet e tyre.

Sipas një vendimi, datë15 qershor 1987, Gjykata e Lartë franceze shprehet rrethlimitit kohor dhe mbi ligjshmërinë e arrestit gjatë një kontrolli. Në këtë rast, disa punonjës doganorë të aeroportit të Orly-së në Paris, kishin ndaluar një person, i cili dyshohej si transportues i lëndëve narkotike, për një periudhë prej 15 orësh, derisa të mbërrinin bagazhet e veta. Personi, gjatë mbajtjes doganore, kishte pranuar se transportonte lëndë narkotike. Gjykata e kishte anuluar procedurën doganore me motivin, nëse e drejta e punonjësve doganorë për të mbajtur personat është një e drejtë ligjore e njohur nga neni 60 i Kodit Doganor, për të proceduar me kontrollin e mallrave dhe mjeteve të transportit, si dhe personave. Mirëpo, kjo masë mund të zgjasë vetëm për një periudhë të caktuar, pra për të kryer kontrollin dhe për të redaktuar procesverbalin. Jurisprudenca franceze thekson gjithashtu, se personat nuk mund të mbahen kundër vullnetit të tyre nën kontroll dhe,ndaj tyre,nuk mund të përdoret asnjë masë shtrënguese³⁵⁹. Jashtë rastit, kur kemi të bëjmë me vepër flagrante, por edhe atij të parashikuar në nenin 323-1 të KD, doganierët s'kanë të drejtë të përdorin masa shtrënguese ndaj personave. Refuzimi për t'iu nënshtuar kontrollit përbën kundërvajtje të klasit të 5-të, parashikuar në nenin 413 bis KD.

Për sa i përket kufizimeve të përcaktuara me ligj, rastet janë të listuara në dispozitave Kodit Doganor. Atëherë, në bazë të nenit 57, mjetet e huaja lundruese tranzit, që ndalojnë

nënkuptohet se personi fsheh në brendësi të trupit të vetë lëndë narkotike". Një qarkore e Ministrit të Drejtësisë i ka përkufizuar këto të dhëna, të atilla që duhet të ngjallin interesimin e punonjësve për të kryer kontrollin e pasagjerit. Si p.sh. një prej tyre mund të jetë mungesa e bagazheve, koha e shkurtër e qëndrimit në territorin francez, shteti prej të cilit ka ardhur (pasi kemi shtete, të cilat janë prodhuese të lëndëve narkotike), sjellja e tij dhe vështirësia për të lëvizur, etj.

Këto të dhëna nuk nënkuptojnë flagrancë, rezultati i testit do tregojë n.q.s. kemi të bëjmë me vepër penale dhe që më pas mund të procedojmë me arrestin doganor. Neni 60 parashikon lëshimin e autorizimi të autoritetit gjyqësor. Jurisprudenca ka specifikuar edhe kushtet e kontrollit që bëhet në bazë të këtij neni në veçanti kohën e përdorur për kontroll dhe masat shtrënguese në dispozicion të punonjësve.

³⁵⁹ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 4 dhjetor 1997, Bulet. Krim. Nr. 416.

në porte, liqene, apo lumenj për furnizim, ose për pajisje, por jo për të ngarkuar, shkarkuar mallra, përjashtohen nga kontrolli, por jo nga mbikëqyrja. Mallrat e transportuara nga korrierë diplomatikë të shoqëruara me një notë diplomatike, apo nga deputetë dhe çdo person tjetër që i është dhënë me ligj status i veçantë, ashtu si bagazhet dhe posta, që u dërgohet këtyre personave, nuk i nënshtrohen kontrollit doganor, neni 64. Por mjeti i transportit mund t'i nënshtrohet kontrollit, nëse ngrihen dyshime të arsyetuara se në të gjenden mallra të padeklaruara apo të ndaluara. Në këto raste, argumenti për të justifikuar kontrollin është se ka dyshime që dikush, shoferi apo një person tjetër, mund të ketë vendosur mallra të ndaluara apo çfarëdolloj malli për t'iu shmangur detyrimeve dhe pa dijeninë e personit të trupit diplomatik apo deputetit.

Gjykata e Lartë e Francës ka bërë një vlerësim shumë të gjerë rreth të drejtës për komunikim dokumentacioni, duke cilësuar se mund të komunikohet çdo lloj dokumenti, që hyn në fushëveprimin kompetencave të doganës dhe janë të përshtatshme për të ndihmuar në përmbushjen e misioneve të saj³⁶⁰.

Ligji konsideron si dokument gjithçka të shkruar, ndërsa në Kodin e Procedurës Penale parashikohen edhe përgjimet telefonike. Jurisprudenca ka theksuar gjithashtu që e drejta për komunikim dokumentesh mund të ushtrohet jo vetëm mbi dokumentet që posedon një person, por edhe mbi dokumentet që mbartin të tretët³⁶¹.

Sipas legjislacionit francez, kjo e drejtë nuk mund të aplikohet për mallrat objekt diskutimi, edhe nëse ato janë dorëzuar vullnetarisht nga pronari i tyre. Për të lehtësuar punën e punonjësve, ligji ka parashikuar një detyrim për mbajtjen e këtyre dokumenteve, të cilat duhet të konservohen për një periudhë kohore prej trevjeçare nisur nga dërgimi apo marrja e mallit.

Në përputhje me misionin e shërbimit doganor, në luftën kundër krimit doganor, për ta angazhuar sa më shumë Doganën në luftën kundër veprave kibernetike, falsifikimit të markave, kontrabandës së alkooleve dhe cigareve, të armëve dhe lëndëve narkotike, është idomosdoshëm forcimi strukturor i administratës doganore përmes një shërbim hetimor të posaçëm. Gjithashtu, në procesin e hetimit të ndërsjellët të një vepre penale, autoriteti doganor ka të drejtë detyrimi të ndërsjellë për shkëmbimin e informacionit dhe hetimin e një vepra penale të fushës doganore.

Kjo pikë parashikon që me anën e Konventave për Asistencë, administrata e doganës të autorizohet, nën rezervë të reciprocitetit, t'i japë autoriteteve të vendeve që janë anëtare të këtyre Konventave, dokumente të cilat vërtetojnë kryerjen e një vepre penale, të marra si rezultat i përdorimit të drejtës së komunikimit. Ndërsa, bazuar në Konventat ku

³⁶⁰ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 5 shkurt 1998, Bulet. Krim. Nr. 47.

³⁶¹ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 21 nëntor 1983, Bulet. Krim., Nr. 304.

Shqipëria ka aderuar dhe marrëveshjet shumë dhe dypalëshe, lejon autoritet doganore të kërkojnë përdorimin e dokumentacionit të dhënë nga autoritetet huaja.

Sipas doktrinës është tejet e vështirë të parashikosh kuadrin ligjor dhe limitet e kësaj të drejte. Si rrjedhojë e ushtrimit të kësaj të drejte, jashtë kuadrit të konstatimit të një vepre doganore, administratës doganore nuk ia mohon kurrëgjë mundësinë që të kontrollojë në këtë mënyrë edhe kontrollin e ligjshmërisë së operacioneve ekonomike.

Nga ana tjetër, është vështirë të bësh dallimin ndërmjet kësaj të drejte dhe asaj që kanë punonjësit në rastin e një hetimi, ku ata duhet të tregojnë se kanë interes për t'u njohur me dokumentacionin. Dëshmia e vetme që supozon limiti, është fakti se punonjësit doganorë duhet të theksojnë se cilat janë dokumentet të cilat duhet t'u vihen në dispozicion, pasi nuk mund të njihen me të gjitha dokumentet në përgjithësi.

5.2.Masat e sigurisë ndaj personave.

5.2.1.E drejtat ndalimit dhe arrestit.

Parimi i lirisë së individit mbrohet me Kushtetutë dhe KEDNJ.Sipas nenit 293 të Kodit Doganor, oficeri i policisë gjyqësore doganore ka të drejtë të ndalojë dhe të arrestojë, sipas neneve 251 dhe 253 të Kodit të Procedurës Penale, në kushtet e flagrancës. Pra, personat mund të kapen në kushtet e kryerjes së kontrabandës,mund të ndiqen nga autoriteti doganor, ose kur kapen me mallra kontrabandë.

Mirëpo, këtu duhet të sqarojmë faktin se termi i “dyshuar” në të drejtën penale doganore s'ka të njëjtin kuptim si në të drejtën penale të përgjithshme, ngaqë ai nënkupton personin kundër të cilit ekziston prezumimi që ai të ketë kryer një vepër penale doganore,vepër që bie në kundërshtim me legjislacionin doganor.

Kjo masë përdoret vetëm për rastet e veprave penale të kontrabandës në kushtet e prezencës së elementëve seriozë dhe të shumtë. Për këtë arsye, nuk lejon që kjo masë të ndërmerret kundrejt personave, ndryshe nga procedura e të drejtës penale të përgjithshme, ku edhe një i dyshuar mund të arrestohet. Pra, kur kemi të bëjmë me kontrabandë që konstatohet dhe jo kur për të kemi dyshime. Ndërkohë që marrja e masës së arrestit doganor nuk është e nevojshme, kur personi bashkëpunon me punonjësit doganorë,duke pranuar zgjidhjen administrative sipas nenit 291 të Kodit Doganor.

Gjithsesi, arresti dhe ndalimi doganor ushtrohet jo vetëm për vepra që cilësohen të rënda dhe në rrethana komplekse, po gjithashtu edhe për ato raste kur vepra penale doganore është në lidhje me një vepër penale të zakonshme dhe mbajtja doganore është paraprake e

arrestit të ushtruar në të drejtën penale të përgjithshëm. Gjithashtu, ndalimi kryhet kur, pasi shqyrtohen rrethanat, paraqitet nevoja për kryerjen e hetimit doganor.

Vlen të përmendim se neni 73 i Kodit të Procedurës Penale Franceze nuk parashikon shprehimisht masa sigurie, për të mbajtur me çdo kusht personin e ndaluar, ndërsa jurisprudenca lejon përdorimin e mjeteve të nevojshme dhe të përshtatshme, por me kusht që të respektohet parimi i proporcionalitetit të mjeteve në mjetet e përdorura³⁶². Sipas jurisprudencës franceze, Gjykata e Lartë ka pranuar se punonjësit doganorë mund ta marrin në pyetje personin e arrestuar edhe për vepra penale të tjera, veç asaj që ish flagrante dhe që shkaktoi këtë masë sigurie³⁶³. Marrja e kësaj mase sigurie parashikon edhe detyrimin për punonjësit të njoftojnë menjëherë Prokurorinë e Republikës së vendit ku është konstatuar delikti flagrant³⁶⁴. Madje paralajmërohet paraprakisht për kualifikimin që është bërë fakteve, në të kundërt ai mund të bëjë një kualifikim të ri dhe, pasi është bërë kualifikimi i ri, duhet njoftuar personi i ndaluar. Evitimi i këtij detyrimi sjell anulimin e procedurës së ndalimit doganor³⁶⁵. Jurisprudenca bën gjithashtu dallimin ndërmjet masës së sigurisë së ndalimit doganor dhe kontrolleve doganore, në të cilat personi nuk ndalohet pa dëshirën e vet. Ndalimi doganor nuk mund t'i kalojë në asnjë mënyrë 48 orë, ndryshe nga ç'ekziston në të drejtën penale të zakonshme³⁶⁶. Megjithatë, si jurisprudenca e vendit tonë, ashtuedhe ajo e vendeve komunitare, ka tendencën për të përforcuar të drejtat e personit të ndaluar, me të njëjtat modalitete që parashikohen për arrestin në përgjithësi, një gjë e tillë shprehet edhe në nenin 293 të Kodit Doganor.

5.2.2. Masat e tjera doganore të privimit të lirisë.

Në Kodin Doganor, ndryshe nga sa përcaktohet në nenin 232 të Kodit të Procedurës Penale, parashikohen masa shtrënguese që të çojnë në privimin e lirisë, megjithatë ato nënkuptohen.

Prerogativae parë, e cila sjell heqje të lirisë së një personi, ka të bëjë me mundësinë që kanë punonjësit doganorë për të kryer kontroll të përgjithshëm ndaj personave, në bazë të dispozitave doganore të lartpërmendura. Gjatë ushtrimit të kontrollit të përgjithshëm, punonjësit doganorë mund të verifikojnë edhe identitetin e personit, sipas dispozitave të Kodit Doganor. Megjithëse, për këto masa ligji nuk parashikon afat kohor. Jurisprudenca kufizohet rreth kësaj çështje me nocionin “koha e nevojshme për kontroll”, kurse masa të tjera sigurie parashikojnë një limit kohor.

³⁶² Gjykata e Lartë Franceze, Seksioni Krim., 13 prill 2005, Buletini Kriminal, Nr. 131.

³⁶³ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 23 mars 2011.

³⁶⁴ Neni 323 pika 1 e Kodit Doganor Francez.

³⁶⁵ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 22 shkurt 2006, Bul. Krim., Nr. 53.

³⁶⁶ Ku, për shembull, për aktet e terrorizmit mund të shtyhet edhe në 72 orë.

a. Prania e personit në kuadër të kontrollit të përgjithshëm.

Ligji doganor parashikon të drejtën për të qenë i pranishëm në kontrollin doganor, ndërkohë që, në bazë të pikës 15/7 të dispozitave zbatuese, parashikon detyrimin për të përballuar shpenzimet dhe ndihmën e nevojshme në rastet e kontrollit doganor³⁶⁷. Çështja qëndron në faktin se kush është natyra juridike e periudhës që fillon me kontrollin paraprak dhe përfundon me mbarrimin e saj, ose me mundësinë për ta nënshtruar këtë individ në një mbajtje doganore. Asnjë dispozitë ligjore nuk e parashikonte këtë limit kohor.

Sipas jurisprudencës së Gjykatës së Lartë Franceze³⁶⁸, mbajtja e një personi për 15 orë nga autoriteti doganor, pasi pritej të kontrolloheshin bagazhet, ndërkohë që nga autoritetet e huaja ai u sinjalizua si person që merrej me trafikim të lëndëve narkotike, konsiderohet një kohë e gjatë dhe përbën shkak për gjykatën për të refuzuar kërkesën për ndalim të personit në kushtet e mungesës së flagrancës.

Punonjësit e doganës duhet t'i bëjnë me dije individët se ata po i nënshtrohen një kontrolli të thjeshtë në të cilin nuk do ketë përdorim të masave shtrënguese. Çka dënohet në këto raste është *refuzimi për t'ju bindur urdhrave të punonjësve për të ndaluar (me kundërvajtje doganore)*. Me të filluar operacioni i kontrollit punonjësit nuk mund të përdorin asnjë masë shtrënguese ndaj individëve që po kryhet ky kontroll.

Masat e sigurisë duhet të fillojnë vetëm në rastin kur zbulohet një vepër penale që çon në ndalimin doganor. Në fakt, së pari, duhet të theksojmë konsekuencat se kur fillon ky ndalim? Kështu që, duhet të marrim parasysh kohën se kur është ndaluar personi për kontroll. Nëse kemi të bëjmë vetëm me mbajtje administrative, e cila nuk është kryer në kushte abuzive, atëherë ajo nuk merret për bazë për përllogaritjen e asnjë afati kohor.³⁶⁹ Kjo zgjidhje tregon edhe diferencimin e të drejtës doganore me atë penale të përgjithshme, ku afati i arrestit fillon që në momentin kur personi dorëzohet në ambientet e policisë. Në rast se kemi të bëjmë me një të huaj, ai duhet të njoftohet në një gjuhë që ai kupton.

6. Procesverbali i akteve të hetimit dhe i veprave penale doganore.

Sigurimi i provave të një veprë penale për të mbështetur akuzën para gjykatës është finaliteti i çdo hetimi: si penal, në përgjithësi, ashtu dhe ai doganor, në veçanti. Edhe pse krimet në fushën doganore mund të provohen në të gjitha mënyrat ligjore³⁷⁰, administrata doganore ka mjete provuese shumë efikase³⁷¹.

³⁶⁷ Pika 15/7 të VKM-së Nr. 205, datë 13.04.1999 "Për Dispozitat Zbatuese...".

³⁶⁸ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., dt. 17 shtator 1991, Gaz. Pal., 1992, 2, 585.

³⁶⁹ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., dt. 15 qershor 1987, Bul Krim., Nr. 249.

³⁷⁰ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., dt. 2 mars 1996, Bul Krim., Nr 73.

³⁷¹ Në bazë të nenit 285 të Kodit Doganor "Për të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij Kodi dhe akteve të tij nënligjore mbahet një procesverbal me shkrim".

Forca bindëse që ka procesverbali doganor, si mjete të zakonshme për konstatimin e veprave doganore, u jep atyre një pozicion privilegjues. Në ligjin doganor francez, për të lehtësuar administratën doganore dhe për të goditur më me efikasitet krimin doganor, ligjvënësi i ka akorduar procesverbalit doganor një autoritet më të lart se atyre të lëshuara nga administrata të tjera. Kjo arsyetohet për faktin se rregullat e provave në fushën doganore marrin një dimension të veçantë, për arsye të natyrës së veçantë të veprave doganore. Në mbështetje të dispozitave të veçanta të Kodit Doganor, procesverbalit doganor i është atribuar një fuqi/forcë bindëse e veçantë, çka i dallon edhe nga regjimi i akteve të procedurës në të drejtën penale të zakonshme.

Prapëseprapë, një gjë e tillë duhet të parashikohet dhe forcohet më tej edhe në ligjin e ri doganor³⁷², ndërkohë që mbetet detyrë e doganierëve në Degët e Doganave dhe inspektorëve në Departamentin Operativ Hetimor, që të formalizojnë çdo akt të procedurës që ata ndërmarrin gjatë hetimeve.

6.1. Llojet e ndryshme të procesverbaleve doganore.

Të gjitha procesverbalet administratave, po ashtu dhe procesverbalet e procedurës në të drejtën penale kanë një finalitet të dyfishtë. Ata raportojnë jo vetëm faktet e konstatuara, por përbëjnë gjithashtu edhe provën e veprës penale³⁷³

Ndryshe nga procedura penale, neni 302/2 i Kodit të Procedurës Penale, që parashikon raportet dhe njeh një shumëllojshmëri procesverbalesh³⁷⁴, madje në dy forma: *të plotë* dhe *të shkurtuar*, e drejta doganore parashikon dy tipe procesverbalesh, që u përkasin njëherazi dy fazave të ndryshme të procedurës. Në fakt, në nenin 286 të Kodit Doganor, përshkruhet në mënyrë të detajuar përmbajtja e procesverbalit, duke mos i ndarë në natyra të ndryshme, por në udhëzimin përkatës³⁷⁵, por dhe në praktikën hetimore dallojmë dy lloje procesverbalesh: *procesverbalin e sekuestrimit* dhe *procesverbalin e konstatimit*, sipas përcaktimeve të neneve 285-286 të Kodit Doganor, të cilët që të dy kanë fuqi/forcë bindëse të njëjlojtë. Gjatë procedurës së sekuestrimit mund të kemi edhe *procesverbalin e konstatimit* për të relatuar zhvillimin e operacioneve të tjera.

Në jurisprudencën franceze i mëshohet faktit, se, që procesverbali të konsiderohet si *procesverbal sekuestrimi*, mjafton të jetë redaktuar sipas rrethanave dhe formave të

³⁷²Ligj nr. 102/2014, datë 31.7.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

³⁷³ Në nenin 280 është përcaktuar se “Për të gjitha shkeljet e dispozitave të këtij Kodi dhe akteve të tij nënligjore mbahet një procesverbal me shkrim”.

³⁷⁴ (P.sh. PV njoftim arresti, flagrancë, ndalime. etj., Më shumë shiko Henerik Ligori: “Manual i Procedurës Penale për Policinë Gjyqësore”, botim i Shtypshkronjës “KOTTI”, viti 1999).

³⁷⁵ Udhëzimi nr. 4, datë 30.09.1999 dhe udhëzimi nr. 4, datë 4.08.2006 “Për zbatimin praktik të procedurës... borxhit doganor të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”.

parashikuara nga neni 323 i Kodit Doganor, pa qenë e nevojshme të kemi një sekuestrim real të mallit objekt i veprës³⁷⁶. Sipas kësaj dispozite ligjore, për shembull, kapja e një të dyshuari mbas konstatimit të një vepre doganore flagrante, mund të relatohet në procesverbalin e sekuestrimit. Në procesverbal punonjësit duhet të theksojnë nëse sekuestruan mallin apo dokumentacionin.

Gjithashtu, legjislacioni francez³⁷⁷ lidhur me fiksimin e mallrave objektshkeljeje, të cilat nuk mund të konfiskohen përcakton se sekuestrimi...Po ashtu përcaktohet se nërastet e konstatimit të një vepre doganore flagrante, me procesverbalin e sekuestrimit “mjetet e transportit dhe mallrat të cilat nuk janë të konfiskueshme, mund të mbahen për të siguruar pagimin e penaliteteve të mundshme, derisatë jepet një garanci”³⁷⁸. Në dallim nga procesverbali i sekuestrimit, procesverbalit të konstatimit i njihet një fushë veprimi mëe kufizuar.

6.1.1. Procesverbali i konstatimit.

*Procesverbal*ishërben për kontrollet që bëhen gjatë dhe pas operacioneve doganore. Ai lejon jo vetëm konstatimin e veprave doganore joflagrante dhe operacionet e kontrolleve e hetimit, por edhe marrjet në pyetje të kryera nga punonjësit doganorë. Neni 286 thekson “rezultatet e kontrolleve të kryera në bazë të dispozitave të Kodit Doganor, marrjeve në pyetje të kryera nga punonjësit doganorë, të cilët duhet të nënshkruajnë në procesverbal dhe, në rast se refuzojnë lidhur me të, atëherë mund të realizohet përkundrejt firmës së dy dëshmitarëve, etj.”

E drejta për të marrë në pyetje të dyshuarin, në sensin doganor, del nga neni 286/3 i Kodit Doganor³⁷⁹ dhe materializohet me redaktimin e një *procesverbal konstatimi*.

Pranimi i fajit ka të njëjtën vlerë si në të drejtën penale të përgjithshme. Ky lloj procesverbali lejon në të njëjtën kohë konstatimin e një fakti dhe relativimin e akteve juridike. Sipas legjislacionit francez punonjësit doganorë nuk janë të detyruar të mbajnë procesverbal për çdo akt të procedurës hetimore, por ata mund të rigruojnë në një rezultatet e disa hetimeve³⁸⁰ dhe se mungesa e nënshkrimit të tyre nga personat e

³⁷⁶ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 21 maj 1968, Bul. Krim., Nr. 164.

³⁷⁷ Neni 378 i Kodit Doganor Francez.

³⁷⁸ Kjo theksohet edhe nga neni 323 pika 2 e Kodit Doganor Francez.

³⁷⁹ Autoritetet doganore për të marrë në pyetje të akuzuarin dhe dëshmitarët, fillimisht duhet t’u bëjnë atyre një njoftim, në të cilën përcaktohet data dhe ora kur duhet të paraqiten personalisht ose duhet të depozitojnë një dëshmi me shkrim. Afati kohor për t’u paraqitur për këtë qëllim nuk mund të jetë më shumë se 10 ditë. Në rastet e flagrancës, marrja në pyetje e shkelësve dhe dëshmitarëve bëhet menjëherë. Konsiderohen gjithashtu dëshmitarë të gjithë ata persona që mund të jenë bashkëpunëtorë në shkelje, si dhe vetë punonjësi ose nëpunësi i doganës që ka verifikuar shkeljen dhe ka nënshkruar procesverbalin.

³⁸⁰ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 5 maj 1997, Bul. Krim., Nr. 164.

interesuar nuk shkakton pavlefshmëri të tyre, në qoftë se në të paraqitet nocioni se personit ju kërkua ky nënshkrim. Gjithashtu, jurisprudenca vlerëson në mënyrë të pavarur kualifikimin në: *procesverbal sekuestrimi* apo *procesverbal konstatimi*, si rrjedhojë mund t'i rikualifikojë ato nëse punonjësit e doganës kanë proceduar me sekuestrimin e mallit.

Krahas mbajtjes së procesverbalit doganor, autoriteti doganor procedon edhe me magazinimin e mallrave objekt kontrabande, të cilat përbëjnë të mira materiale dhe garantojnë të ardhura në interes të shtetit, për shembull, lidhur me mallrat që rrezikojnë të prishen, gjykata brenda 48 ditëve merr vendim për konfiskim, duke i hapur rrugëkështu shitjes së tyre të menjëhershme, nga ana tjetër, lidhur me mjetet e transportit, gjykata vendos brenda 5 ditëve për konfiskimin e tyre, duke i dhënë mundësi autoritetit doganor t'i përdorë për interesat e veta.

Megjithatë, si në nenin 281 të Kodit Doganor, në aktet nënligjore dhe në dispozita të Kodit të Procedurës Penale, nuk përcaktohet kërkesa për ruajtjen dhe administrimin e mallrave të ndryshme objekt sekuestrimi, të cilat kërkojnë trajtim të veçantë, si pasojë e së cilës në vijim ndodh që mallit të mos procedohet me sekuestrim ose në fund të procedimit penal të humbasë vlerën e tij. Në praktikën doganore nuk ka gjetur zgjidhje çështja se si do të procedohet me sekuestrimin e kafshëve, viçave, sendeve me vlerë, apo mallrave të rrezikshme, si eksplozivë, si dhe mallrave që kërkojnë ruajtje të veçantë, gjë që kërkon përmirësime në fushën legjislative doganore.

- **Fuqia/forca bindëse e provave doganore.**

Në legjislacionin tonë doganor dhe penal, procesverbaleve: procesverbalit të sekuestrimit dhe procesverbalit të konstatimit të shkeljes doganore kontrabandë, nuk i jepet ndonjë fuqi bindëse e veçantë. Një dëshmitë tillë e gjejmë edhe në legjislacionin francez, ku procesverbalet e përdorura për konstatimin e veprave penale në të drejtën penale të përgjithshme nuk mbartin një forcë/fuqi bindëse shumë të madhe. Në parim, procesverbali³⁸¹, sipas legjislacionit të procedurës penale franceze, përmban fuqi bindëse minimale dhe vlen thjesht për të dhënë informacion. Megjithatë, disa procesverbaleve specifike, ligji francez u jep një fuqi bindëse të veçantë. Për shembull, procesverbalet e mbajtura në fushën e shkeljeve penale, të cilët, në qoftë se janë redaktuar sipas rregullave nga agjentë të kualifikuar, vlejnë derisa të vërtetohet e kundërta³⁸² vetëm në qoftë se ligji shprehet ndryshe. Në këtë rast i takon të dyshuarit të gjejë prova për të hedhur poshtë këtë procesverbal, i cili mund të arrihet vetëm me dy mënyra: me shkrim ose me anë të dëshmisë³⁸³.

³⁸¹ Neni 430 i Kodit të Procedurave Penale.

³⁸² Neni 537 i Kodit të Procedurave Penale

³⁸³ Neni 431 i KPP, çka nënkupton se personi nuk mund të provojë vërtetësinë me të gjitha mjetet. Vetëm këto dy mjete janë në dispozicion të tij. Kundërshtimet e të dyshuarit dhe elementët e prezumuar nuk mjaftojnë.

Rastet e mësipërme arsyetohen me faktin se sipas doktrinës kemi të bëjmë me vepra penale teknike, të cilat janë shumë të vështira për t'u provuar dhe për të cilat shpeshherë nuk ka as dëshmitar, as shenja dalluese. "Veprat doganore shpesh nuk kanë asnjë dëshmitar dhe nuk lënë ndonjë shenjë, për këtë arsye procesverbali duhet të jetë i mjaftueshëm për të arritur në një vendim gjyqësor"³⁸⁴. Në këtë pikëpamje, procesverbalit doganor i japin një fuqi bindëse shumë të lartë dhe kjo fuqi bindëse varion nga numri i nënshkruesve dhe natyra e konstatimit.

Gjithashtu, në legjislacionin doganor francez, ndryshe nga procedimi i një krimi doganor të parashikuar në legjislacionin tonë, parashikohet vlerësimi i "ndershmërisë" në gjetjen e provave doganore. Administrata doganore, ashtu si dhe policia dhe xhandarmëria, i bën thirrje disa personave të veçantë, të cilët kanë aftësinë ta informojnë atë për një vepër doganore, këta të fundit përmbledhen si "këshilltarë" doganorë. Informimi mund të bëhet edhe nga persona të cilët duan t'i shpëtojnë përgjegjësisë penale, kështu që bashkëpunojnë në këtë mënyrë me punonjësit doganorë³⁸⁵. Neni 391 i Kodit Doganor parashikon shpërbelimin për këta "këshilltarë".

Sipas tyre, origjinaliteti i statutit të këtyre "këshilltarëve" ngjall interesimin e doktrinës. Debatë lidhet kryesisht me parimin e "ndershmërisë" në gjetjen e provave penale dhe parimin e lirisë së provave të parashikuar në nenin 427 të KPP³⁸⁶. Gjykata e Lartë, me një vendim të datës 28 tetor 1991, ka njohur parimin e "ndershmërisë" në gjetjen e provave doganore, mirëpo njëherazi përmend edhe parimin e lirisë së provës në të drejtën penale doganore. Kësisoj, kemi limit kohor në rastin e anulimit të një procedure, me anë të së cilës konstatohet shpërdorim detyre nga ana e punonjësve doganorë.

7. Vlerësimi mbi respektin e kontradiktoritetit në gjetjen e provave doganore.

Një problem i rëndësishëm lidhur me provat në procesin e gjykimit të veprave penale të fushës doganore konsiston edhe tek parimi i kontradiktoritetit në kërkimin e provave. Gjatë një çështjeje, qëshqyrtonte ndjekjet e ushtruara në bazë të importit kontrabandë të mallrave të falsifikuara, që sipas ligjit përbëjnë delikt doganor, ndodhi që gjatë kontrollit doganormostrat t'i nënshtrohej ekspertizës nga ana e titullarit të të drejtave të mbrojtura, i cili kishte konfirmuar karakterin fals të mallrave. Në argumentimin e dytë të rekursit në Kasacion, i akuzuari konsideronte se ekspertiza e

³⁸⁴ R. Merle, A. Vitu "Traktat i së drejtës kriminale". Vëllimi II, nr. 235, fq. 292.

³⁸⁵ Neni 392 pika 2 e Kodit Doganor Francez.

³⁸⁶ Do i referohemi për këtë temë, J. Letang "Denoncimi dhe ndershmëria e provave në të drejtën fiskale dhe doganore", Gaz. Pal., 1994, 1 doc., fq. 807.

kryer nga vetë shoqëria e konsideruar si viktimë, kishte karakter jo kontradiktor, kështu që, prej këtij momenti, kjo ekspertizë nuk mund të pranohej si mjet prove.

Jurisprudenca e Gjykatës së Lartë Franceze refuzoi të hidhte poshtë vendimin e Gjykatës së Apelit, për faktin se kjo ekspertizë i ishte nënshtruar debateve kontradiktore dhe se ajo ishte pranuar si mjet prove³⁸⁷, duke theksuar se është e vërtetë se nga ana praktike titullari i markës shpeshherë është i vetmi që disponon elementet teknike që lejojnë të karakterizojnë produktet dhe t'i dallojnë ato nga mallrat që i imitojnë, por, gjithsesi, ky titullar mund t'ia transmetojë ato një eksperti të kualifikuar, gjë që do e rëndonte më shumë procedurën doganore në fushën e markave dhe të falsifikimit të tyre.

8. Vlerësimi mbi rregullsinë e akteve të procedurës doganore.

8.1. Pavlefshmëria e akteve të procedurës doganore.

Fuqia e veçantë bindëse që ka procesverbali doganor shpjegojnë nga njëra anë regjimin e veçantë të pavlefshmërive që parashikohen në këtë fushë. Kërkesa për anulim nënkupton sanksionimin e parregullsisë së akteve ose pjesëve të procedurës. Regjimi i pavlefshmërive, ashtu siç e jep KPP i përgjigjet dy teorive të mëdha në fushën penale.

Referuar neneve 122 dhe 315 të Kodit të Procedurës Penale procesverbali është i pavlefshëm³⁸⁸, kur ekzistojnë dyshime rreth personave që kanë marrë pjesë, apo kur mungon nënshkrimi i oficerit të policisë gjyqësore. Ndërsa, mungesat ose pamjaftueshmëria e të dhënave të përmbajtjes së procesverbalit nuk e bëjnë assesidrejtëpërdrejtë të pavlefshëm. Një pohim i tillë mund të deklarohet nga prokurori i çështjes apo gjykata, pasi të jetë çmuar në tërësi përmbajtja e procesverbalit.

Sipas legjislacionit francez ka dy kategori pavlefshmërie: *pavlefshmëritë tekstuale* dhe *pavlefshmëritë e konsiderueshme*. Pavlefshmëritë tekstuale janë parashikuar qëllimisht nga ligjvënësi, madje janë të pakta në numër dhe kanë të bëjnë me sekuestrimet dhe kontrollet³⁸⁹, verifikimet e identitetit, si dhe disa përgjime telefonike³⁹⁰. Profesori Jean Pradel konsideron se diçka e tillë nënkupton, se “duhet të jemi në dijeni që në fillim se çfarë konsideron thelbësore ligji, nga ana tjetër, ai mënjanon çdo interpretim të gjyqtarit dhe, në këtë mënyrë, çdo arbitraritet nga ana e tij”³⁹¹. Ndërsa pavlefshmëritë e konsiderueshme, të cilat nuk janë parashikuar nga tekstet e veçanta, kanë të bëjnë me

³⁸⁷ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 9 janar 2008, rekurs nr. 07-82339.

³⁸⁸ Më shumë shiko Henerik Ligori “Manual i procedurës penale për policinë gjyqësore”.

³⁸⁹ Nenet 56, 56-1, 57, 59, 95 dhe 96 të Kodit të Procedurës Penale.

³⁹⁰ Nenet 78-3 dhe 100-7 të Kodit të Procedurës Penale.

³⁹¹ Jean Pradel “Procedura Penale”, Nr .501, fq. 591.

rregulla thelbësore, ku shkelja e tyre sjell pavlefshmërinë e aktit të procedurës³⁹². Sjellin pavlefshmëri të aktit rregullat thelbësore që mbrojnë rendin publik. Gjithashtu, sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale franceze³⁹³ parashikohet dhe pavlefshmëria e akteve që shkelin të drejtat e mbrojtjes. Megjithëse, edhe në këtë rast, pavlefshmëria pranohet, me përjashtim të rastit kur është kundër rendit publik, nëse shkelja i sjell pasoja ankuesit, veprim që duhet të demonstron³⁹⁴.

Regjimi i pavlefshmërisë së procedurave në fushën doganore, i zhvilluar nga jurisprudenca, synim kryesor ka respektimin e rreptë të lirive individuale, ndaj, në rastet e hartimit të një procesverbalit, autoritetit doganor do t'i duhet të procedojë nëpërputhje me KMDNJ.

Jurisprudenca thekson detyrimin për regjistrim të procesverbalit në librat e autoritetit doganor. Për sa i përket pavlefshmërive të zhvilluara nga jurisprudenca, sipas legjislacionit francez, si fusha të privileguara paraqiten ato të kontroleve/vizitave në ambientet e banimit, ushtrimi i të drejtës së komunikimit, sekuestrimet dhe mbajtjet parandaluese. Për shembull, mos prezenca e një OPGJ-je gjatë një kontrolli/vizite në ambientet e banimit, mund të konsiderohet si një pavlefshmëri e urdhrin publik dhe kjo pavlefshmëri mund të ngrihet në çdo stad të procesit, madje për herë të parë edhe në Kasacion³⁹⁵. Në të kundërt, mungesa e nënshkrimit të OPGJ-së në procesverbal nuk sjell pavlefshmëri të aktit. Po ashtu anulimi i kontrollit/vizitës në ambientet e banimit nuk sjell medoemos anulim të procedurës doganore. Anulimi i procedurës ndodh vetëm në rastin kur konstatimet janë të lidhura me vizitën/kontrollin sipas një lidhje shkak/pasojë. Për sa i përket zbatimit të këtyre pavlefshmërive, dispozitat procedurale penale franceze³⁹⁶ kërkojnë që kërkesa për pavlefshmëri të ndërmerret në themele përpara çdo mbrojtjeje. Këto pavlefshmëri kërkojnë vetëm nga personat e parashikuar në procesverbal.

Në fushën doganore, lidhur me pavlefshmërinë, ngrihet pyetja nëse gjykata duhet ta anulojë aktin e pavlefshmërisë në tërësi³⁹⁷ apo pjesërisht. *Jurisprudenca e gjykatës franceze, në lidhje me masat sigurisë, kur kishte të bënte me raste që kishte kaluar afati 24 orësh dhe nuk kishte pasur asnjë ndërhyrje të autoritetit gjyqësor, me vendimin datës 11 dhjetor 1997, e*

³⁹² Neni 171 i Kodit të Procedurës Penale.

³⁹³ Neni 171 i Kodit të Procedurës Penale.

³⁹⁴ Neni 802 i Kodit të Procedurës Penale.

³⁹⁵ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 2 qershor 1986, Bul. Krim., Nr. 185.

³⁹⁶ Neni 385 i Kodit të Procedurës Penale Franceze.

³⁹⁷ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 20 mars 1997, Procedura 1997, koment nr. 215. Në këtë rast kemi të bëjmë me anulimin e një procesverbalit sekuestrimi që rridhte si rezultat i një vizite/kontrolli në ambiente banimi, i cili nuk kishte nënshkrimin e OPGJ-së.

anulonte procedurën vetëm në mënyrë të pjesshme. Në këtë rast, u anuluan vetëm procesverbalet që ishin mbajtur mbas afatit 24 orësh të parashikuar nga ligji.

9. Ushtrimi i procedimit penal në të drejtën penale doganore.

9.1. Oficerët e Policisë Gjyqësore.

Përforcimi i rolit të autoritetit doganor në procedimin e krimeve të fushës doganore gjatë veprimtarisë së punonjësve doganorë, vërehet edhe në faktin që disa prej punonjësve doganorë u janë atribuuar kompetenca gjyqësore sipas Kodit të Procedurës Penale, në mënyrë që të kryejnë hetime me kërkesë të Prokurorit. Dekreti nr.1188, datë 10.08.1995 “Për Policinë Gjyqësore” dhe nenet 13,16 të Kodit Doganor, siç kemi parashtruar edhe më lart, u njeh atributet e Policisë Gjyqësore efektivave të Departamentit Operativ Hetimor³⁹⁸. Mbi këtë bazë, prokurori mund t’i autorizojtë kryejnë hetime në disa fusha të përcaktuara.

OPGJ-ja, ndryshe nga doganierët në degët doganore, aplikon rregullat e Kodit të Procedurës Penale dhe jo të Kodit Doganor. Ligjvënësi ka dashur t’i japë kompetenca punonjësve të doganës për të ndërmarrë hetime gjyqësore, sipas rregullave të Kodit të Procedurës Penale, në fusha specifike, si në veprën e kontrabandës doganore, mashtrimet (shkeljet) e kryera në kontributet indirekte, në falsifikimin e markave dhe modeleve, po ashtu edhe veprave penale të lidhura me to. Kjo gjë lejon gjithashtu shtimin e mjeteve në dispozicion të autoritetit gjyqësor. Po ashtu, kjo dispozitë lejon përforcimin e kooperimit në luftën kundër krimit doganor dhe trafikeve ndërkombëtare në tërësi.

Si rrjedhojë, teksti që krijoi atëherë ODGJ-ja u integrua në Kodin e Procedurës Penale (neni 28-1) dhe ndodhet në një seksion të KPP i titulluar “Funksionarët dhe punonjësit, të cilëve u lejohet të kryejnë misione të PGJ”-së, domethënë se ODGJ-ja ka gati të njëjtët prerogativë me OPGJ-në, por që nuk e kanë këtë cilësi.

9.1.1. Kushtet e ushtrimit të misioneve të policisë gjyqësore nga punonjësit doganorë.

Për të kryer misione të policisë gjyqësore, nga njëra anë punonjësit doganorë duhet të kenë kualifikimin si ODGJ dhe, nga ana tjetër, duhet të emërohen nga Prokurori i Përgjithshëm, i cili, në këtë mënyrë, ushtron kontroll rreth aktivitetit të tyre. Sipas neneve 9, 16 të Kodit Doganor dhe të KPRP, organi i luftës kundër kontrabandës dhe trafikut të

³⁹⁸ Në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave krijohet organi i luftës kundër kontrabandës dhe trafikut të paligjshëm, i cili kryen funksionet e policisë gjyqësore. Detyrat dhe të drejtat e personelit që kryen funksionet e policisë gjyqësore janë të përcaktuara me ligj.

kundërligjshëm³⁹⁹ kryen funksionet e policisë gjyqësore. Duke u mbështetur në praktikën e deritanishme, roli i oficerëve të policisë gjyqësore në administratën doganore ka qenë thjesht në rolin e përgatitjes së dokumentacionit, duke reduktuar ndjeshëm përgjegjësitë në zbulimin dhe ndjekjen e çështjeve që kanë të bëjnë me veprën penale të kontrabandës.

Duke u mbështetur në ligjin penal dhe doganor francez mendojmë se kushtet e dhënies së cilësisë së ODGJ-së inspektoreve të DOH-së janë:

-inspektor të kategorisë B;

-2 vite punë si titullar në shërbimet efektive në DPD;

- të kalojë me sukses një provim teknik, me shkrim dhe me gojë, për çështje që kanë të bëjë me të drejtën penale dhe procedurën penale, para një jurie të kompozuar nga gjyqtarë dhe përfaqësues të administratës doganore, president i së cilës të jetë në avokat shteti;

- miratimi nga një komision i specializuar, i kompozuar me numër të barabartë anëtarësh, si nga ana e punonjësve të doganës, ashtu edhe nga gjyqtarë. President komisioni duhet të jetë Prokurori pranë Gjykatës së Lartë. Anëtarët e komisionit emërohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Drejtësisë dhe Ministrisë së Financës. Përveç këtyre, punonjësi duhet të emërohet nga Prokurori i Përgjithshëm.

Edhe pse OPGJ-të administratës doganore kanë pothuajse kompetenca të ngjashme me ato të OPGJ-së, prapëseprapë kemi një dallim për sa i përket shtrirjes së këtyre kompetencave.

9.1.2.Kompetenca të deleguara.

OPGJ-të administratës doganore ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm kur ato u delegohen nga autoriteti i akuzës. Kompetenca të ushtruara vetëm me delegim, do të thotë se nuk mund të ndërmarrin një hetim me iniciativë të vetë (OPGJ-të mund ta bëjnë këtë gjë sipas dispozitave të KPP). Ata mund të ndërmarrin hetime gjyqësore vetëm me kërkesë të Prokurorit të Republikës.

Për të eliminuar konkurrencën mundshme midis shërbimeve, ligjvënësi ka përjashtuar nga mundësia për të ndërmarrë hetime me iniciativën e tyre ODGJ-të. Si në rastin e hetimeve paraprake, ashtu edhe për hetimet në rast fragrance, ata duhet të veprojnë duke pasur autorizimin e Prokurorit. Çka do të thotë se pa këtë autorizim nuk lejohet asnjë lloj akti, si p.sh. marrja e një deponimi. Për hetimet në rast fragrance, për OPGJ-të ligji parashikon një procedurë ndryshe nga ajo çfarë përdoret për OPGJ-në. OPGJ-të, në rast të krimit doganor flagrant, kanë mundësi të hapin hetime me iniciativë të tyre, gjë që nuk u lejohet OPGJ-ve të doganës, të cilët paraprakisht duhet t'i japin llogari Prokurorit për ekzistencën e këtij krimi flagrant dhe, më pas, të marrin autorizimin e tij për të hapur një

³⁹⁹ Nenet 9,16 të Kodit Doganor.

hetim flagrant. Për rastin e hetimeve paraprake, ligji parashikon vetëm hipotezën e autorizimit nga prokurori.

9.2.Ushtrimi i procedimit në të drejtën penale doganore.

9.2.1.Kushtet e ushtrimit të ndjekjes penale në të drejtën penale doganore

Procedurat që përdoren përpara gjykatave, për të zgjidhur çështjet e veprave penale doganore, u nënshtrohen rregullave të Kodit të Procedurës Penale. Nga ana tjetër, Kodi Doganor përmban dispozita specifike për vënien në lëvizje të procedimit penal, duke paraprirë jo vetëm me hetime paraprake përgatitjen e dosjes me prova dokumentare, procesverbalin e konstatimit të shkeljes,⁴⁰⁰ vendosjen e sekuestrimeve dhe bllokimeve të mallrave që mendohet se kanë të bëjnë me një vepër penale kontrabandë, por edhe me vendosjen e sanksioneve, dënimeve me gjobë 2-5 shin e detyrimeve⁴⁰¹. Por, gjithsesi, rregullat, të cilat përcaktojnë kompetencën juridiksionale të gjykatave, ushtrimin e procedimit penal, si dhe rolet respektive të administratës doganore dhe prokurorisë, për vënien në lëvizje dhe ushtrimin e procedimit penal dhe fiskal, parashitohen në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Në të vërtetë, dogana jo vetëm për kundërvajtjet e fushës doganore, por edhe në rrethana të caktuara të përcaktuara në nenin 291 të Kodit Doganor ka një pushtet diskret, për të përcaktuar mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, çka përbën një veçori për fushën doganore. Ndëshkimi i veprave penale të kontrabandës, të parashikuara në Kodin Doganor, mund të kryhet në dy mënyra. Në funksion të kushtëzimeve të parashikuara në nenin 291 të Kodit Doganor, ato mund të zgjidhen nëpërmjet procedurës së parashikuar në Kodin e Procedurës Penale, duke kallëzuar çështjen në organin e prokurorisë, ose nëpërmjet marrëveshjes dhe transaksionit.

Efikasiteti i ndëshkimit të veprave doganore, të parashikuara nga Kodi Doganor, shprehet jo vetëm me shumëllojshmërinë e dënimeve që përmban Kodi Doganor, por edhe me mekanizmat për dhënien e këtyre dënimeve. Në thelb, dhënia e dënimeve penale (procedimi penal dhe gjykimi) bëhet sipas rregullave të përgjithshme të procedurës penale. Ndërkohë, edhe pse prokuroria është autoriteti ekskluziv që procedon sidomos veprat penale të kontrabandës dhe gjykata që shqyrton e gjykon krimet në fushën doganore, sipas kërkesave të procedurës penale, ndryshe nga procedimi për krimet në fusha të tjera, kurrësi nuk mund të minimizohet roli i veçantë i doganësi në ushtrimin e procedimit fiskal, ashtu edhe në procedimeve veprave penale të kontrabandës, çka dëshmon për veçorinë e kompetencave të jashtëzakonshme që i janë atribuar në këtë fushë. Nga çasti i kryerjes së një vepre doganore, lindin njëkohësisht, si procedimi në

⁴⁰⁰ Neni 285 i Kodit Doganor.

⁴⁰¹ Neni 281 i Kodit Doganor.

fushën fiskale, ashtu dhe ai penal, që normalisht për doganënkonsiderohet si një veprim civil për aplikimin dhe rikuperim e detyrimeve të importit dhe gjobave të vendosura. Njëkëtë mënyrë, procedimi ushtrohet kryesisht nga administrata e doganës për aplikimin e dënimeve fiskale, si dhe nga prokuroria që ka kompetencë ekskluzive për të filluar procedimin penal kryesisht apo me kërkesë të autoritetit doganor.

Nëlegjislacionin doganor francez, lidhur me procedimin fiskal, paraqiten disa veçori, të cilat konsistojnë kryesisht mbisanksionet e vendosura nga autoriteti doganor, me një fjalë “kërkohet procedimi fiskal i ushtruar kryesisht nga administrata e doganës para një gjykate, e cila shprehet përmes një vendimi gjyqësor për sanksionet fiskale të parashikuara në Kodin Doganor, që rezultojnë nga veprat penale doganore”⁴⁰².

Në këtë rast, autoriteti doganor, kërkon zgjidhje gjyqësore duke iu drejtuar gjykatës për të sanksionuar dhe rikuperuar forcërisht dënimet e ndryshme pasurore të parashikuara në Kodin Doganor, domethënë gjobat dhe konfiskimet. Sipas jurisprudencës franceze, në fushën fiskale, një procedim i tillë, duke iu drejtuar gjykatës penale, nuk konsiderohet ndjekje me karakter civil, edhe pse në proces administrata ndodhet në të njëjtin pozicion me çdo “viktimë” tjetër⁴⁰³. Ndjekja e ushtruar nga administrata, sipas tyre, cilësohet si një “ndjekje penale me karakter të veçante”. Pra, administrata e doganës franceze ushtron një “ndjekje penale të veçantë”, pasi në procesin penal doganor ka pothuajse të njëjtat prerogativa që ka edhe prokuroria.

Përkundrejt këtij procedimi, apo ndjekje penale në fushën doganore, është ndjekja e ushtruar nga prokuroria, e cila synon prononcimin e dënimeve në sensin penal të parashikuar për ndëshkimin e veprave doganore. Ndërkohë që Padia civile ka të njëjtin funksion, siç është përcaktuar edhe në dispozitat e Kodit tonë të Procedurës Penale, për pagimin e detyrimeve dhe taksave. Procedimi i fundit që mund të ushtrohet si rezultat i një veprë doganore është procedim i një natyre të thjeshtë, që, sipas dispozitave të Kodit Doganor, debitori nuk mund të mënjanohet nga pagimi i shumave, të cilat i ka përfituar nga kjo shkelje, plus kësaj administratës së doganës, edhe pse mund të mos ketë dënim të të akuzuarit, kur gjendet elementi material i veprës, i lejohet të kërkojë ndreqjen nga ana pasurore të dëmeve që ka shkaktuar vepra doganore⁴⁰⁴. Gjykata e Lartë Franceze ka pranuar edhe faktin që “ndjekja” e ushtruar nga administrata doganore ka natyrë komplekse, nga njëra anë cilësohet si “ndjekje penale specifike” për aplikimin e dënimeve fiskale, ndërsa, nga ana tjetër, si “ndjekje” civile për sa i përket rikthimit të shumave të cilat kanë qenë rezultat i shkeljes.

⁴⁰² Neni 343 pika 2 i Kodit Doganor Francez.

⁴⁰³ Në çështjet e zakonshme penale Prokuroria ushtron vetëm ndjekjen penale dhe në asnjë mënyrë nuk mund të ushtrojë një veprim për dëmshpërblim për të dëmtuarit në një çështje. Ndërsa, në fushën doganore, Prokuroria mund ta bëjë këtë gjë.

⁴⁰⁴ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., 14 qershor 1993, Bul. Krim., Nr. 207.

Nëkëtëkëndvështrim, duhet kuptuar dhe zbatuar edhe neni 281 i Kodit Doganor, ku përcaktohet se autoriteti doganor vendos gjobë 2-5 fishpavarësisht nga ndjekja penale, duke interpretuar si një të drejtë, që, edhe nëse çështja penale pushon për shkak të mungesës elementeve të veprës penale, shkelja doganore e konstatuar nga autoriteti doganor është ekskluziviteti i këtij autoriteti, ndaj edhe gjoba e zbatuar nuk mund të kontestohet veçse në kushtet e një gjykimi civil, duke iu nënshtruar një hetimi të plotë e të gjithanshëm.

9.3.Palët e procedimit penal në të drejtën penale doganore.

Në fushën doganore, palët proceduese janë njëkohësishtadministrata doganore dhe prokuroria. Administrata doganore vendos vetë mbi gjobat dhe detyrimet e papaguara, që vinë nga veprapenale e kontrabandës.Në pamje të parë, ushtrimi i ndjekjes penale dhe i rekurseve në fushën doganore përfshihen nga e drejta penale e zakonshme. Mirëpo, në qoftë se vepra penale doganore shkakton dëm në rendin publik, atëherë duhet të trajtohet si vepër e të drejtës penale të zakonshme dhe pranohet se i shkakton dëm thesarit publik,apo një interesi publik në tërësi, i cili duhet të mbrohet e përfaqësohet jo vetëm nga prokuroria, por edhe nga administrata e doganës, gjë që kërkon njëherazi edhe ekzistencën e rregullave procedurale të së drejtës së zakonshme dhe të rregullave të veçanta. Gjithsesi, ideja se i përket ekskluzivisht Prokurorisëngre për diskutim çështjethelbësore.

9.4.Koekzistenca dhe pavarësia e ndjekjeve fiskale dhe penale.

Roli i veçantë që kaadministrata doganore në një proces penal (proces ku kemi vepra penale doganore), si dhe natyra e veçantë e “ndjekjes” së procedimit doganor, kanë sjellë debate të shumta si në doktrinë, edhe në jurisprudencë:

Së pari,natyra e procedimit doganor.

Administrata doganore vepron në mënyrë që të “aplikohen sanksionet fiskale” sipas përcaktimit të nenit 281 të Kodit Doganor. Për mendimin tim, kyduhet konsideruar si një veprim miks, që ndodhet midis procedimit penal dhe padisë civile, ose e ashtuquajtur “procedim penali një natyre të veçantë”. Procedimi apo ndjekja fiskale ka për qëllim përcaktimin e gjobave, konfiskimet dhe rikthimin e shumave, poredhe riparimin e dëmeve. Po ashtu, ndjekja penale në fushën doganore mund të nisë dhe të ushtrohet vetëm nga prokuroria, ndërkohë që administrata doganore, në kushtet e nenit 291 të Kodit Doganor, mund ta shuaj këtë ndjekje vetëm nëpërmjet transaksionit, nëse akuza para se të fillojë procedimin dhe në kushtet e plotësimit të kërkesave të nenit 291 të Kodit Doganor,ia delegon çështjen autoritetit doganor,ndryshe nga çfarë ekziston në të drejtën penale të zakonshme.

Gjithashtu, ndarja e çështjes civile (padsisë civile në procesin penal) nga gjykimi penal, nuk shoqërohet me pasoja për vazhdimin e procesit penal. Ndryshe nga një palë civile, e cila mund të kërkojë dëmshpërblim si para gjykatave penale, ashtu dhe atyre civile, administrata e doganës mund të ushtrojë ndjekjen fiskale vetëm përpara gjykatave penale⁴⁰⁵ sipas francezëve ose drejtpërdrejtë në rrugë administrative, siç parashikohet në nenin 281 të Kodit Doganor. Nga ana tjetër, prokuroria nuk mund të apelojë kundër një vendimi të prononcuar mbi procedimin e ushtruar nga administrata doganore në rastin e vendosjes dhe arkëtimit e dënimit me gjobë të përcaktuar në nenin 281 të Kodit Doganor dhe as për sekuestrimin e mallrave objekt kontrabande.

Së dyti, pavarësia e ndjekjes penale nga ajo fiskale.

Në fushën doganore, procedimi fiskal dhe ai penal janë të pavarur. Ndjekja fiskale e ndërmarrë nga administrata doganore nuk varet paraprakisht nga ekzistenca e procedimit penal të ushtruar nga prokuroria. Në të vërtetë, administrata doganore ka të drejtën e apelit kundër vendimi të akuzës për mosfillimin e çështjes penale apo pushimin e saj. Pavarësia e ndjekjes fiskale dhe asaj penale është gjithsesi relative. Kështu, prokuroria nuk mund të ushtrojë ndjekje penale, kur kemi një transaksion doganor të kryer sipas dispozitave të nenit 291 të Kodit Doganor, nga administrata doganore dhe autorit të veprës doganore.

Gjithsesi, pavarësia e procedimit penal me atë fiskal ka si pasojë edhe mospranimin në fushën doganore të konstituimit të palës civile përpara gjykatave penale. Padia civile pranohet përpara gjykatave penale, vetëm kur kemi shkaktimin e një dëmi, burimi i të cilit rezulton drejtpërsëdrejti në veprën penale doganore. Gjithsesi, praktika gjyqësore, lidhur me çështje të kësaj natyre, e ka ngushtuar sferën e aplikimit të padsisë civile në procesin penal, duke e lidhur vetëm me interesat e përgjithshme dhe me interesat e administratës doganore⁴⁰⁶.

⁴⁰⁵ Në bazë të terminologjisë së neneve 356 dhe 357 të Kodit Doganor Francez.

⁴⁰⁶ Me një vendim, datë 14 janar 1991, Gjykata e Kasacionit ka hedhur poshtë vendimin e Gjykatës së Apelit të Amiensit, e cila kishte urdhëruar dëmshpërblim për pronarin e një objekti arti, të cilit, pasi i ishte vjedhur ky objekt dhe ishte eksportuar kontrabandë nga një shitës i gjërave antike, i cili e kishte blerë në një panair, ky i fundit nuk ishte ndjekur penalisht as për vjedhje, as për fshehje, por vetëm për deliktet doganore të parashikuara nga nenet 417 dhe 414 të Kodit Doganor Francez, në këtë mënyrë, i ngelet atij që e cilëson veten si viktimë të kërkojë dëmshpërblim, sipas procedurave specifike të parashikuara nga Kodi Doganor Francez, si p.sh. kemi rastin e nenit 326 pika 3 i Kodit Doganor Francez, që autorizon heqjen e sekuestrimit mbi objektet pa pasur garant, kur pronari i tyre është në besim të mirë. Gjykata e riafirmoi këtë parim, duke hedhur poshtë vendimin e marrë nga Gjykata e Apelit, e cila kishte pranuar konstituimin si palë civile të shoqërisë “Philip Morris INC” për fakte të kualifikuara si delikt importi në kontrabandë të mallrave të falsifikuara, për motivin që “padia civile është e pranueshme nga gjykatat penale, kur vërtetohet se ajo sjell një dëm, i cili e ka burimin direkt nga vepra që po ndiqet... veprat doganore të autorëve sjellin veç dëme për administratën doganore. (Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., dt. 27 mars 1997, Bul. Krim., Nr. 126).

Njëtjetër problem i diskutueshëm, që ende s'ka gjetur zgjidhje nga ligji ynë doganor, ka të bëjë me çështjen, sesi do të veprohet lidhur me procedimin administrativ të parashikuar në nenet 281,291 të Kodit Doganor. Në këtë kuadër, kryesisht kur akuza e ka filluar procedimin penal, atëherë nuk ka detyrim ligjor për t'ia deleguar fillimisht autoritetit doganor për ta zgjidhur sipas nenit 291 të Kodit Doganor (në fakt, legjislacioni ynë nuk e parashikon një detyrim të tillë, madje nuk parashikon as thirrjen e autoritetit doganor si palë e interesuar gjatë gjykimit të çështjes penale). Në legjislacionin doganor francez, administrata doganore mund të ndërhyjë në çdo procedim të ndërmarrë fillimisht nga prokuroria, për të kërkuar aplikimin e sanksioneve fiskale, edhe pse duhet vënë në dukje fakti se prokuroria gëzon kompetencën ekskluzive për të ushtruar ndjekjen penale, si dhe për të kërkuar dënimet përkatëse, kështu që, në këtë rast, dogana kufizohet vetëm në kërkimin e aplikimit të sanksioneve fiskale.

Sipas legjislacionit doganor francez, për afërsisht siç procedohet edhe në nenin 245 të Kodit Doganor për rikuperimin forcërisht të borxhit doganor, administrata doganore franceze, sipas dispozitave të nenit 343 pika 2 të Kodit Doganor, ka mundësinë të hapë një procedim përpara gjykatës sipas mënyrës së "citimit të drejtpërdrejtë". Kjo mënyrë përdoret kur administrata konsideron se të gjitha elementet gjatë hetimit janë të mjaftueshëm për një gjykatë që të japë një vendim. Kjo metodë përdoret shumë për aplikimin e sanksioneve fiskale për kundërvajtjet doganore.

Citimi i drejtpërdrejtë duhet të përmbajë fakte, të cilat janë objekt i ndjekjes dhe kualifikimit penal në bazë të tyre ligjore. Përveç kësaj, këtë akt doganor duhet t'informojtë akuzuarit, sipas dispozitave të nenit 368 të Kodit Doganor, që e autorizon të përdorë shërbimet që mund të përdorë një përmbanues.

Për sa i përket kompetencës së gjyqtarit penal, citimi përmban tipin e gjykatës e cila doshqyrtojë çështjen. Faktet dhe kualifikimet duhet të jepen në mënyrë të qartë, edhe pse gjykata nuk është e detyruar t'i mbajë ato. Kur gjykata vihet në lëvizje vetëm nga citimi i drejtpërdrejtë i doganës, atëherë s'i mbetet tjetër veçse të marrë vendim në lidhje me shkeljet fiskale. Në qoftë se prokurori kërkon t'i bashkëngjitet këtij procesi, ai pranohet si palë në gjykim.

Gjithashtu, kryesisht në rastet e procedimit nga prokuroria, ai e transferon çështjen për procedim fiskal në organin doganor, duke i krijuar mundësi njëkohësisht doganës që në kushtet e transaksionit të procedojë drejtpërdrejtë duke zgjidhur çështjen në themel⁴⁰⁷.

⁴⁰⁷ Ligji nr. 2010-1685, datë 29 dhjetor 2010, riformuloi dispozitat e nenit 343 pika 3, duke i krijuar mundësinë prokurorisë që t'ia transferojë ushtrimin e ndjekjes fiskale administratës doganore dhe, po në njëjtën kohë, administrata fiton edhe të drejtën për të kryer transaksione.

9.5. Transaksioni doganor.

E drejta doganore përdor praktikën e negocimit mbi dënimet fiskalenëpërmjet mekanizmit të transaksionit, por edhe me anë të një mënyre më të gjerë, nëpërmjet mekanizmit të marrëveshjes.

Synimi për t'çliruar sadopak gjykatat penale nga procedurat komplekse, por dhe zgjidhje sa më e shpejtë për rikuperimin e dëmit fiskal të shkaktuar nga vepra penale e kontrabandës, ka bërë qëligjvënësi të krijojë hapësira për transaksionet, por edhe për zgjidhjen administrative të kontrabandës, të cilat nuk përbëjnë asnjë anashkalim apo kundërshti me dispozitën kushtetuese se prokuroria është organi që ngarkohet kryesisht me ndjekjen e çështjeve penale. Jurisprudenca doganore franceze e konsideron si një mekanizëm shumë të përdorur dhe të efektshëm nga administrata doganore. Sipas profesor Pradel, kemi dy kategori: i pari, ka të bëjë me transaksionin që zëvendëson ndjekjen penale nëpërmjet derdhjes së një shume parash për administratën. Ky tip parashikohet si në fushën e kontributeve indirekte, ashtu edhe në atë doganore. etj. Nëse kemi transaksion, atëherë kemi njëherazi edhe shuarje të ndjekjes penale dhe asaj fiskale. Tipi i dytë i transaksionit parashikohet nga neni 41-2 pika 3 i KPP. Transaksioni pranohet vetëm nëse është nën kontrollin e autoritetit gjyqësor. Deri në fazën e gjykimit, kontrolli bëhet nga prokurori. Në fazën e gjykimit, kontrolli ushtrohet nga një gjykatës. Në legjislacionin tonë penal, një formë e tillë transaksioni nuk parashikohet me ligj, çka kërkon ndërhyrje në kuadrin e përmirësimit të legjislacionit doganor dhe atij penal.

9.5.1. Zgjidhja administrative e Kontrabandës.

Në nenin 291 të Kodit Doganor përcaktohet edhe "*Zgjidhja administrative e Kontrabandës*", që konsiston në procedimin administrativ nga autoriteti doganor përrastet e kryerjes së një kontrabande.⁴⁰⁸

⁴⁰⁸ Në çështjen penale "Shteti kundër të gjykuarve P.Z dhe I. Q." etj, Kolegji Penal duke e çmuar të drejtë qëndrimin e gjykatës në lidhje me juridiksionin në zgjidhjen administrative të kontrabandës të parashikuar në nenin 291 të Kodit Doganor, në vendimin nr. 588, datë 5.11.2003, ka arsyetuar se: "Zbatimi i ligjit penal, lidhur me cilësimin juridik të veprave penale të kryera nga të gjykuarit, është i drejtë dhe pretendimet e tyre në këtë drejtim janë të pabazuara. Pretendimit të pabazuar të të gjykuarve P. Z. dhe I. Q., se në rastin konkret jemi para një kundërvajtje administrative, gjykatat ju kanë kthyer përgjigje, duke arsyetuar se, në referim të nenit 291/a të Kodit Doganor, kjo çështje mund t'i përkiste juridiksionit administrativ deri në atë moment, kur ende nuk kishte filluar ndjekja penale ndaj shkelësve të ligjit doganor... Ndryshe nga sa pretendohet në rekursin e prokurorit, Kodi Doganor ka parashikuar, që, edhe në rastet e kryerjes së veprës penale të kontrabandës, mund të mos fillojë procedimi penal nga ana e organit të akuzës, në rast se plotësohen disa kushte të përcaktuara në nenin 291 të Kodit. ...Nuk ka rëndësi fakti nëse vepra penale e kontrabandës konstatohet nga autoritetet doganore apo nga organizma të tjerë të

Ç'është e vërteta, duket sikur "gjendemi" përpara një dispozite antikushtetuese, për vetë faktin se veprat penale ndiqen kryesisht nga Prokuroria⁴⁰⁹. Por këtu mbahet parasysh fakti, se:

- Para procedimit administrativ, dosja i dorëzohet autoritetit gjyqësor kompetent në kuptimin që organi i prokurorisë është organi i cili miraton ose jo procedimin nga autoriteti doganor⁴¹⁰. Pra, kjo nënkupton se është në kompetencë të plotë të këtij organi të lejojë ose jo procedimin administrativ të kontrabandës, por gjithsesi për sa kohë nuk është regjistruar çështja penale në zgjidhjen administrative të kontrabandës, nuk ka rëndësi se kush e konstaton shkeljen doganore kontrabandë: organi doganor apo organi i akuzës.

- Vepra e krimit të kontrabandës konsiderohet kryesisht si vepër e krimit ekonomik, pra goditen financat e shtetit nëpërmjet shmangies nga pagesa e detyrimeve.

-Hetimi i çështjes dhe gjykimi në tre shkallët e gjyqimit kërkon kohë, ndërkohë që, në rrethanat e një sistemi ende të pakonsoliduar të shoqërivetregtare me aktivitete të bllokuara apo të falimentuara, risku i pagesës së detyrimeve të shmangura është i lartë.

-Mbahet në konsideratë fakti se bëhet fjalë për vepra të kontrabandës që parashikojnë një dënim alternativ gjobë apo dënim me burg dhe jo vetëm dënim me burg.

Referuar edhe përcaktimeve të Konventës "Për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komunitetit Evropian"⁴¹¹. Një qëndrim të tillë e gjejmë edhe në vendet komunitare⁴¹², si dhe,

-Organi i akuzës dhe ligjvënësi nuk ka konstatuar ndonjë pasojë negative, që ka rezultuar nga zbatimi i kësaj dispozite, përkundrazi.

specializuara brenda kufijve të parashikuara në ligj. Si një ndër kushtet që duhet të ekzistojë, së bashku me kushtet e tjera, edhe kushti i përcaktuar në pikën "a" që thotë se "ndjekja penale nuk ka filluar ende", Kodi i Procedurës Penale nuk ka ndonjë dispozitë specifike për përcaktimin e fillimit të ndjekjes penale, por në nenin 287 është parashikuar regjistrimi i njoftimit të veprave penale, i cili në rastin e shqyrtimit është bërë dy ditë më pas nga përfundimi i zgjidhjes në rrugë administrative. (Vendimi nr. 588, datë 5.11.2003).

⁴⁰⁹ Në këtë përfundim të gabuar është dalë edhe në studimin: Lehtësimi i Procedurave Doganore ...". (ACIT, 2004.)

⁴¹⁰ Kodi doganor neni 288.

⁴¹¹ Përafërsisht sa është parashikuar edhe në Konventën "Për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komunitetit Evropian", Botuar në Fletoren Zyrtare nr. C 316, dt. 27.11.1995, fq. 49-57. Në nenin 2/1 të Konventës për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komunitetit thuhet se 'Çdo anëtar duhet të marrë masat e nevojshme për t'u siguruar se akti referuar Nenit 1, dhe pjesëmarrja nxitja, tentativa për akte referuar nenit 1 /1, janë të dënueshme nëpërmjet sanksioneve penale efektive, të balancuara dhe bindëse, përfshirë, të paktën për rastet e shkeljeve të rënda, sanksione që privojnë lirinë dhe që sjell ekstradimin, duke patur parasysh se një shkelje e rëndë do të konsiderohet një shkelje me një minimum vlerë të përcaktuar nga secili Vend Anëtar. Kjo vlerë nuk mund të kalojë shumë prej 50.000 Euro.

⁴¹² Neni 334 të Kodit Doganor Francez, parashikon një formë të zhdukjes së veprave penale të dënueshme vetëm me gjobë..."administrata doganore mund të lejojë shkelësin të bëjë pagesë, përveç detyrimit tatimor, të një shume jo më të vogël se dyfishi dhe jo më të madhe se dhjetëfishi i këtij detyrimi tatimor. Shuarja e veprës penale nuk pengon zbatimin e konfiskimit, e cila është e drejtë ekskluzive e administratës doganore.

Gjithashtu ligji parashikon një sërë kushtëzimesh, si:

-Personi i akuzuar për kryerjen e kontrabandës mund t'u kërkojë autoriteteve doganore zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative, me kusht që:

- të mos ketë filluar ndjekja penale,
- shuma e detyrimeve doganore të mos jetë më shumë se 5 milion lekë.(I jepet e drejta Këshillit të Ministrave që me propozim të Ministrit të Financave, ta ndryshojë këtë kufi).

- personi të kryejë menjëherë pagesën e detyrimeve dhe gjobës;
- personi të deklarojë në mënyrë të parevokueshme se heq dorë nga e drejta e ankimit.

Këtokatër kushte duhet të plotësohen njëkohësisht.

-Ligjvënësi ka parashikuar jo vetëm kufizime, po dhe ndalime në zbatimin e kësaj dispozite për rastet e kryera nga subjekt i cilësuar, është recidivist, etj.

Së fundi, nuk mund të mos theksojmë faktin se praktika e deritanishme ka qenë efektive, duke pasur parasysh edhe misionet e doganës, si pjesë e administratës shtetërore për mbledhjen e të ardhurave për Buxhetin e Shtetit.

9.6.Ushtrimi i rekurseve në të drejtën penale doganore.

NëKodin Doganor nuk parashikohen rastet e kundërshtimit të vendimit të organit të akuzës dhe gjykatës, në rrethanat e një procedimi penal të personit përgjegjës për veprën penale të kontrabandës,por nëKodin e ProcedurësPenale është parashikuar ankimi kundër vendimit të mosfillimit të procedimit penal dhe vendimit kundër pushimit të këtij procedimi, si dhe kundër vendimit të gjykatës për rrëzimin e padisë civile në procesin penal të apelit,nenet 291,329,411të Kodit të Procedurës Penale. Një qëndrim të tillë e gjejmë edhe nëjurisprudencën franceze⁴¹³.

Megjithatë, interes për diskutim paraqesin çështjet:

-Gjatë hetimit administrata doganore, si autoritet shtetëror, i bashkëngjitet apo paraqitet si palë me prokurorinë apo me një palë civile? Veçanërisht, cili do jetë pozicioni i administratës doganore?Po kështu, për vendimet që kanë të bëjnë me masën e sigurisë me arrest të personit që është vënë nën hetim. Pyetja qëndron, nëse administrata doganore, si një autoritet shtetëror,meqë ushtron të drejtën e kallëzimit për një veprë penale të

⁴¹³ Cilado qoftë mënyra e vënies në lëvizje të gjykatave penale, dogana, ashtu si çdo palë në procesin penal, ka të drejtën për t'u ankuar në një shkallë më lart, si për të kundërshtuar vendimet e marra gjatë hetimeve, por edhe ato të marra gjatë shqyrtimit të çështjeve. Rregullat për rekurset në Kasacion rezultojnë të njëjta me ato që kemi në të drejtën penale të përgjithshme.

kontrabandës e cila sipas saj ka dëmtuar interesat e shtetit, vallë a ka të drejtë të ndërhyjë nëçështjete masësisë sigurisë që vendos gjykata?

Jurisprudenca e gjykatës së lartë franceze, ndryshe nga ligji dhe qëndrimi i gjykatave tona, e ka pranuar këtë fakt me një vendim, datë 5 janar 1967, duke e lejuar kështu doganën të bënte apel, kundër një vendimi për të lënë të lirë të dyshuarit, ndaj gjyqtarit duke i njohur kështu të njëjtat prerogativa qëi ka edhe prokuroria, por që nuk i ka një palë civile⁴¹⁴. *Mendojmë se asgjë nuk e pengon administratën që të japë mendimin e vetë përpara se të jepet vendimi për lëniene lirë të të dyshuarit, madje duke kërkuar edhe garanci për dëmin e shkaktuar dhe të papaguar, si dhe gjobat e aplikuara*⁴¹⁵.

Sipas jurisprudencës franceze, lidhur me të drejtën e apelit të administratës doganore në çështjet që kanë të bëjnë me masa sigurie për të dyshuarit, theksohet se “në qoftë se kemi ndërhyrje nga ana e administratës, me qëllim aplikimin e sanksioneve, kjo administratë ndryshe nga ç’parashikojnë nenet 185 dhe 186 të KPP, mund të apelojë kundër vendimeve të gjyqtarit. Mirëpo, për të siguruar rikuperimin e detyrimeve fiskale (të cilat mund të mos paguhen, nëse personi lihet i lirë), zgjidhja mbetet tek kërkimi i një garancie në nivelin e penaliteteve doganore.

Gjithashtu, mendoj se në kushtet, kur autoriteti doganor mbron një interes publik, sikurse dhe prokuroria, doganën nuk e pengon doganënasgjë që të bëjë apel kundër vendimeve të Shkallës së Parë, edhe pse ajo ka qenë e “përfaqësuar” nga Prokuroria. Veçse, duhet të kemi parasysh se në këtë rast apeli duhet të ketë të bëjë vetëm me sanksionet fiskale dhe në asnjë mënyrë me ato penale. Apeli i administratës doganore duhet të vërë në dyshim fajësinë e të akuzuarit, vetëm për sa i përket sanksioneve fiskale⁴¹⁶. Një gjëe tillë është e përcaktuar në ligjin doganor francez dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, në bazë të së cilës administrata doganore mund të bëjë apel ndaj vendimit të një gjykate “korrektuese”, e cila është shprehur vetëm për sanksionet penale.

Efekti evolutiv i apelit vlen edhe për të akuzuarit, çka do thotë se një i akuzuar nëse bën apel dhe, në aktin e apelit, kundërshton vetëm sanksionet penale, gjatëseancës në apel ai nuk mund të kërkojë që të shqyrtohen edhe sanksionet fiskale^{417/ 418}. Vështirësia mund të qëndrojete fakti se për shumicën e apellantëve, sanksionet doganore janë ekuivalente me ato penale. Në këtë mënyrë, duke bërë apel për sanksionet penale, ata pandehin se bëjnë apel edhe për sanksionet fiskale. S’mund të anashkalojmë këtu edhe natyra hibride të

⁴¹⁴ Neni 186 i KPP.

⁴¹⁵ C. J Berr dhe H. Tremeau: “E drejta doganore komunitare dhe kombëtare”, Economica, edic 6, fq. 558.

⁴¹⁶ Gjykata e Lartë Franceze, Seksioni i krimeve, dt. 26 gusht 1996, Bul. Krim., Nr. 307.

⁴¹⁷ Gjykata e Lartë Franceze, Seksioni i krimeve, dt. 6 shkurt 1997, Bul. Krim., Nr. 52.

⁴¹⁸ Në çështjen “Shteti kundër të gjykuarit Delijorgji”, Gjykata e Apelit vendosi të pranojë kërkesën ankimore të të gjykuarit në fjalë, lidhur me padinë civile në procesin penal të ngritur nga ana e Degës së Doganës Durrës, megjithëse i gjykuari nuk kishte ushtruar ankim kundër vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë në lidhje me padinë civile në procesin penal.

sanksioneve pasurore doganore, të cilat cilësohen gjysma penale, gjysma dëmshpërblim civil, duke i larguar sa më shumë nga ndjekja penale dhe duke i paraqitur në të shumtën e rasteve si “interesa civile”.

Së fundmi, në rast se kemi dënim solidar për pagimin e penaliteteve doganore kundër shumë të akuzuarve, ushtrimi i apelit vetëm nga njëri prej tyre është pa efekt mbi të tjerët. Secili prej tyre duhet të ushtrojë apelin në mënyrë individuale⁴¹⁹.

Sipas legjislacionit francez, apeli i prokurorisë nuk e ndalon administratën doganore të bëjë një transaksion me autorizim të autoritetit gjyqësor, kur vendimi është definitiv (gjithsesi duhet edhe autorizimi i prokurorisë, kur kemi një veprë në të cilën parashikohen edhe sanksione penale, edhe fiskale).

9.7.Pengesat për ushtrimin e ndjekjes (penale ose fiskale) në të drejtën penale doganore.

Në fushën doganore këto shkaqe i klasifikojmë në pengesa, të cilat janë specifike të ndjekjes penale (vdekja e të akuzuarit, amnistia dhe abrogimi i ligjit penal), por gjithashtu janë të përbashkëta si për anën penale, ashtu dhe civile (parashkrimi, autoriteti i vendimeve të marra, transaksioni dhe tërheqja e ankimit).

9.7.1. Parashkrimi i ndjekjes së ushtroar për ndëshkimin e veprave doganore.

Në kuptim të nenit 66 të Kodit Penal, me parashkrim të ndjekjes penale kuptohet shuarja e saj, ngaqë nga çasti i kryerjes së veprës penale, deri në çastin e marrjes së personit sitë pandehur, janë tejkaluar afatet e caktuara me ligj⁴²⁰. Sipas Profesor Jean Pradel, “në vija të përgjithshme parashkrimi është pamundësia e mosnjohjes së veprimit një të drejte për një titullar, kur ai ka qëndruar shumë gjatë joaktiv”⁴²¹. Ligji ynë doganor nuk ka përcaktime lidhur me institutin e parashkrimit, për këtë qëllim duhet t’i referohemi ligjit penal. Në Kodin Doganor nuk përcaktohen rregulla lidhur me parashkrimin, si rrjedhojë duhet të pranohen ato që parashikon ligji penal. Një gjë e tillë, me përjashtim të disa specifikimeve, është pranuar edhe në jurisprudencën franceze, përveç një rregulli të veçantë të parashikuar në nenin 344 të Kodit Doganor Francez⁴²².

⁴¹⁹ Gjykata e Lartë Franceze, Seksioni i krimeve, dt. 25 nëntor 1991, Buletini krim., Nr. 432.

⁴²⁰ Prof. Dr. Ismet Elezi “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2009.

⁴²¹ Jean Pradel: “Procedura penale”, ed 12, Cujas, 2004, fq. 199, Nr. 235.

⁴²² Ky nen përcakton që: “Kur autori i veprës doganore vdes përpara dhënies së një vendimi përfundimtar nga gjykata, administrata mund të ushtrojë, kundër trashëgimisë së tij, një veprim që konsiston në dhënien e një vendimi nga Gjykata e Shkallës së Madhe (gykata kompetente për trashëgiminë në shkallë të parë), për konfiskimin e objekteve për të shlyer sanksionin dhe, nëse nuk është i mundur konfiskimi, të prononcohet

Sipas tyre, për çdo kategori veprash, ligji ka parashikuar një afat të së drejtës së përgjithshme që është: një vit në fushën e kundërvajtjeve, tre vjet për delikte dhe 10 për krimet⁴²³. Kalimi i këtyre afateve e bën të papranueshme ushtrimin e ndjekjes penale. Po e njëjta gjëndodh edhe për ndjekjen fiskale doganore⁴²⁴. Si pikënisja e afatit të parashkrimit për veprat e menjëhershme është dita e kryerjes së tyre dhe, kur kemi deklaram të rremë, është dita e depozitimit të këtij deklarimi ose data e përfundimit të veprimit ndëshkues në rast se kemi të bëjmë me një vepër në vazhdueshmëri⁴²⁵. P.sh kundërvajtja e mosprezantimit në shërbimet doganore të disa dokumenteve që kërkohen në rastet e anijeve, është një vepër në vazhdueshmëri, e cila përfundon ditën kur këto dokumente u prezantohen shërbimeve doganore⁴²⁶. Sipas legjislacionit doganor francez, vdekja e autorit të veprës doganore shuan njëkohësisht si ndjekjen penale, ashtu edhe atë fiskale.

a. Amnistia.

Amnistia mund të jetë shkak i shuarjes së ndjekjes fiskale, vetëm në qoftë se është reale, e pakushtëzuar dhe është marrë përpara se të jepej vendimi. Nëse amnistia është personale, domethënë jepet një kategorie delinkuentësh, ajo prodhon efekt vetëm për ta dhe le në fuqi mundësinë për të ekzistuar ndjeka fiskale dhe ajo penale për bashkautorët dhe bashkëpunëtorët. Amnistia mund të shuajë ndjekjen fiskale apo penale, por kurrësi veprimin civil. Kështu që administrata doganore mund të kërkojë nga gjykata civile pagimin e një dëmshpërblimi të barabartë me shumën e detyrimeve dhe të taksave të cilat janë evituar.

b. Abrogimi i ligjit.

Abrogimi i ligjit shuan njëkohësisht si ndjekjen penale, ashtu dhe atë fiskale.

Abrogimi përkufizohet si tërësia e efekteve që i bashkëngjiten një vendimi gjyqësor. Çka do të thotë, se, sipas parimit të “*non bis in idem*”, faktet e gjykuara një herë nuk mund të jenë objekt i një gjykimi të dytë. Kështu, një vendim definitiv, i marrë nga një gjykatë penale, pengon që kundra të njëjtit person dhe për të njëjtat fakte të zhvillohet një ndjekje penale e dytë (me kusht që të ketë të njëjtin objekt, shkak dhe palë). Vlen të theksojmë se pyetja që ka shkaktuar debat ka qenë, se a mund të kemi ndjekje të të njëjtit person për të njëjtat fakte, por mbi kualifikime të ndryshme penale? Gjykata e Lartë ka dhënë përgjigje negative për

fiksimi i një shume të barabartë me këto sende”. Gjithsesi, sipas jurisprudencës, kjo ndjekje nuk është ndjekje fiskale, po thjesht një ndërhyrje civile autonome, çka do thotë se efektet e shuarjes nuk shtrihen për kërkesën civile, pasi trashëgimtarët duhet të paguajnë borxhet e trashëgimisë.

⁴²³ Nenet 7 dhe 9 të Kodit të Procedurave Penale.

⁴²⁴ Sipas nenit 351 të Kodit Doganor Francez, ndjekja për ndëshkimin e veprave doganore parashkruhet në të njëjtat kushte dhe afate që ushtrohet ndjekja penale në të drejtën penale të zakonshme. Çka nënkupton se, në fushën doganore, ndjekja për aplikimin e sanksioneve fiskale zgjat 3 vjet dhe kjo vlen si për deliktet, ashtu edhe për kundërvajtjet (në të drejtën penale të zakonshme parashkrimi për kundërvajtjet është 1 vit).

⁴²⁵ Shembull, diversion i shkaktuar në rast destinacioni të privilegjuar (neni 427 pika 5 dhe 6 i Kodit Doganor Francez).

⁴²⁶ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., dt. 14 janar 2004, i papublikuar.

këtëgjë⁴²⁷. Por ç'ndodh me rastin, kur të njëjtat fakte mund të marrin një kualifikim penal dhe doganor? (Siç ndodh në rastin e trafikimit të lëndëve narkotike). Me një vendim të datës 11 mars 2009, Gjykata e Lartë duket se ka sqaruar qëllimin e parimit "*non bis in idem*" edhe për fushën doganore. Me këtë vendim, ajo autorizon administratën doganore që të ushtrojë ndjekjen fiskale për import ilegal të produkteve narkotike, edhe pse i akuzuari u dënua në bazë të Kodit të Shëndetit Publik nga një gjykim definitiv.

⁴²⁷ Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., dt. 13 dhjetor 1990, Bul. Krim., Nr. 433.

KREU II

Llojet e krimeve në fushën doganore

1. Disa probleme lidhur me klasifikimin e kontrabandës si kalim në/dhe nga kufiri shtetëror dhe krimet e kontrabandës që shmangen nga pagesat doganore.
 - 1.1 Ndryshimet midis kontrabandës nëpërmjet kalimit, zhvendosjes së mallrave në/dhe nga kufiri shtetëror nga kontrabanda nëpërmjet shmangies ngapagesat doganore.
2. Figurat e veçanta të krimit doganor.
 - 2.1 Kontrabandë me mallrat e ndaluara .
 - 2.1.1 Objekti i drejtpërdrejtë
 - 2.1.2 Ana objektive
 - 2.1.3 Ana subjektive
 - 2.2 Kontrabanda me mallrat e licencuara
 - 2.3 Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë
 - 2.4 Kontrabanda e vlerave kulturore
 - 2.5 Kontrabanda e mallrave duke përfshirë dhe ato që paguhen me akcizë
 - 2.6 Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore
 - 2.7 Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm
 - 2.7.1 Objekti i krimit
 - 2.7.2 Ana objektive
 - 2.7.3 Subjekti i veprës penale
 - 2.8 Tregtimi, tjetërsimi dhe transporti i mallrave që janë kontrabandë dhe çdo ndihmë që i jepet personit që merret me këtë veprimtari.

1. Disa probleme lidhur me klasifikimin e kontrabandës si kalim në/dhe nga kufiri shtetëror dhe krimet e kontrabandës që shmangen nga pagesat doganore.

Në pjesën e dytë të këtij punimi do trajtojmë çështje që kanë të bëjnë me klasifikimin e veprës penale të kontrabandës si kalim në/dhe nga kufiri shtetëror dhe krimet e kontrabandës si shmangie nga pagesat doganore. Por, meqenëse në teorinë e të drejtës penale dhe legjislacionin doganor të vendeve të BE-së⁴²⁸, një nga çështjet e ndërlikuara në praktikën e zbatueshmërisë ligjore, në sferën e krimeve doganore, aktualisht mbetet raporti apo korrelacioni ndërmjet *konstruksionit të normave juridike të së drejtës penale*,

⁴²⁸ Në legjislacionin doganor francez krimet në fushën doganore ndahen në: Kontrabandë dhe Mashtrim.

të cilat përcaktojnë *përgjegjësinë* për kontrabandën⁴²⁹, si dhe shmangia nga pagesat doganore⁴³⁰. Gjithsesi, para se të trajtojmë figurate veçanta të veprës penale, si “*cilësimi ligjor i drejtë*”⁴³¹, e gjejmë me vend tëndalemi veças për këto çështje:

Legjislacioni ynë penal nuk ka një ndarje të qartë të këtyre krimeve, megjithëse nënkuptohen. Tek dispozitat e Kodit Doganor dhe Penal⁴³² ato përfshihen nënëndarje të një dispozite ligjore. Ndërkohë që në Kodin Doganor, në dispozita të veçanta, veprat penale të kontrabandës evidentohen si kalim i kundërligjshëm në/dhe nga kufiri shtetëror, përfshi këtu edhe shmangien nga pagesat e detyrimeve doganore⁴³³. Njëevidentim të tillë e gjejmë edhe në Kodin Doganor Italian⁴³⁴.

Mendoj se ky trajtim ka rëndësi në planin teorik, ashtu edhe praktik, pasi kontrabanda përmes kalimit të kufirit është një krim që dallohet për koklavitjen apo kompleksitetin konstruktiv universal, gjë që reflektohet edhe në procesin e kualifikimit të kësaj vepre penale, duke përfshirë momentin e mbarimit apo përfundimit të veprës së kontrabandës, etj. Ndaj për kualifikimin e drejtë është e domosdoshme të prekim çështjet më problematike të ndërtimit dhe të kualifikimit të këtyre veprave, për të dhënë më pas përgjigje të mbështetura mbi baza shkencore.

Ashtu sikurse kemi trajtuar në kapitullin e parë të kësaj pjese, *ana objektive* e secilit krim të fushës doganore, kalimit të paligjshëm dhe shmangies nga pagesat doganore, qëndron kryesisht në rrafshin ekonomik të veprimtarisë apo aktivitetit me një interes të caktuar, veçanërisht në kryerjen e operacioneve të import/eksportit apo tranzitit, ku dispozitat, si ato të Kodit Penal për fushën doganore, ashtu edhe të Kodit Doganor kanë një seri shenjash apo simptomash të përbashkëta, të cilat mund të krijojnë probleme gjatë kualifikimit të shkeljes ligjore.

Pa dyshim, lista e veprimeve që formojnë elementin (apo përbërësit) e krimit dhe pikërisht, kalimi i mallrave dhe mjeteve të transportit jashtë kontrollit doganor ose

⁴²⁹ (Nenet 417/1, 2a, c; 417/3; 419/1; 421, 422/1; 423-424; 459; 465; 427 të Kodit Doganor Francez).

⁴³⁰ (Nenet 2417/2.b; 428, 418; 426/b të Kodit Doganor Francez).

⁴³¹ Shefqet Muça: “E Drejta Penale”.

⁴³² Nenet 171; 175; 176; 179 të Kodit Penal.

⁴³³ Nenet 176/1 a-d; f-h; 277-279 të Kodit Doganor.

⁴³⁴ Sipas legjislacionit doganor italian, kontrabanda mund të verifikohet në rastet e mëposhtme: Në lëvizjen e mallrave përtej kufijve tokësorë dhe në hapësirën doganore (art 282 Kodit Doganor Italian); Në lëvizjen e mallrave në liqenet kufitare (art 283 Kodit Doganor Italian); Në lëvizjen detare të mallrave (art 284 Kodi Doganor Italian); Në lëvizjen e mallrave në rrugë ajrore (art 285); Në zonat extradoganore (art 286); Në mospagim në përdorim të mallrave të importuara me lehtësira doganore (art 287); Në magazinat doganore (art 288); Në lëvizjen jo shumë larg bregut (art 289); Në eksportimin e mallrave të pranuar si rikthim të të drejtave (art 290); Në importimin e përkohshëm. Më shumë referohu edhe Francesco Pittaluga: “Kontrabanda e mallrave dhe kontrabandimi i duhanit të huaj”.

shoqëruar kjo me mosdeklarimin ⁴³⁵, kalimi, duke shkelur rregullat doganore për mallrat e ndaluara, me akcizë, sendet me vlera të çmuara historike e kulturore, janë në mënyrë të pakrahasueshme, më të gjera se mënyrat e shmangies nga pagesat doganore, neni 276/d,e; neni 280/a,f të Kodit Doganor dhe nenet 172-174;177 të Kodit Penal; si dhe nenet 178-179 (në të cilat *nënkuptohet shmangia nga detyrimet doganore*) të Kodit Penal. Ndërkohë që kuptimi apo nocioni kontrabandë përmes kalimit (zhvendosjes) është fiksuar në nenin 276/a,b,c -279; neni 280/b i Kodit Doganor dhe nenet 171;175;176;172-174,176 ;179/1 të Kodit Penal, ku përveç të tjerash përfshin në vetvete nocionin e importimit,eksportimit dhe tranzitimit të paligjshëm,vendosje të mallrave në regjimin doganor, nocione këto që në praktikë janë shumë të përhapur si metoda që kryesisht bëjnë të mundur shmangien nga pagesat doganore.

Vlen të nënvizohet se klasifikimi i kontrabandës nëpërmjet kalimit, zhvendosjes, dhe kontrabandës nëpërmjet shmangies nga pagesat doganor kanë disa veçori, që shpjegohen me specifikën e veprimtarive të tilla. Me qëllim që t'u jepet një vlerësim i drejtë veprimtarive me rrezikshmëri shoqërore, të kryera në sferën e çështjeve doganore, nëpunësit e organeve doganore, avokatët dhe akuza, madje edhe gjykata, duhet t'u drejtohen si normave penale, ashtu edhe atyre doganore, administrative, tatimore, financiare dhe degëve të tjera *të së drejtës*.

Nenet 276/a,b,c -279; neni 280/b i Kodit Doganor dhe nenet 171;175;176;172-174,176; 179/1 të Kodit Penal nuk përcaktojnë mënyrat e shmangies nga pagesat doganore. Përgjegjësia fillon direkt apo menjëherë me fillimin e veprimtarisë, e cila (d.m.th. përgjegjësia) qëndron në kalimin jashtë zonës doganore apo në/dhe nga zona doganore me mashtrim, fshehje të mallit objekt kontrabande, kalimi jashtë orarit ose forcërisht.

Shmangia mund të shprehet në “fshehjen” e mallit, që kalon në *uljen e vlerës së mallit, në paraqitjen e informacionit jo të besueshëm mbi përkatësinë apo destinacionin, si në rastin e mospagimit të plotë apo të pjesshëm të pagesave doganore, fakt ky që tashmë të tërheq vëmendjen*.

I njohur në praktikën ligjzbatuese se për *shmangiet*, në të shumtat e rasteve, veprohet duke mos deklaruar apo duke deklaruar të dhëna jo të vërteta (false), domethënë mënyra të cilat dalin apo shprehen edhe në cilësinë e simptomave të anës objektive të kalimit kontrabandë përmes kufirit doganor të mallrave e mjeteve të tjera.

Pyetja që shtrohet për çështjen objekt studimi është se a *kakritere* për ndarje të krimeve të kontrabandës nëpërmjet kalimit dhe asaj nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore?

⁴³⁵(Nenet 276-279 të Kodit Doganor, neni 171 i Kodit Penal, pjesërisht).

1.1.Ndryshimet midis kontrabandës nëpërmjet kalimit,zhvendosjes së mallrave në/dhe nga kufiri shtetëror nga kontrabanda nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore.

Nëse i referohemi dispozitave të Kodit Penal dhe atij Doganor që kanë të bëjnë me kontrabandën, vërejmë se kontrabanda nëpërmjet kalimit, zhvendosjes së mallrave në/dhe nga kufiri shtetëror ndryshon nga kontrabanda nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore në tëkatër elementët përbërës të krimit:

- objektit
- anës objektive
- subjektit
- anës subjektive

a. Sipas objektit të drejtpërdrejtë.

Objekti i drejtpërdrejtë i kontrabandës përmes kalimit, zhvendosjes së mallrave kontrabandë është *rregulli i vendosur apo i përcaktuar për kalimin e mallrave, mjeteve transportuese dhe i objekteve të tjerë përmes kufirit shtetëror (doganor).*

Objekti i drejtpërdrejtë i kontrabandës përmes shmangies nga pagesat doganore është sfera financiare,detyrimet e import/eksportit ose “marrëdhëniet shoqërore” për shkak të formimit apo grumbullit në buxhetin e shtetit të të ardhurave financiare dhe të rregullit të përcaktuar për realizimin e pagesave doganore.

Mjet i kontrabandës është *kalimi jo ligjor*, nëpërmjet kufirit doganor të mallrave dhe objekteve të tjerë, ndërsa mjet i shmangies janë pagesat doganore. Në këtë mënyrë, ndryshimi dhe *mospërputhja e objekteve dhe mjeteve të kontrabandës*, shmangies nga pagesat doganore, lejojnë apo bëjnë të mundur që këto krime të veçohen nga njëri-tjetri.

Në shqyrtimin e çështjeve të mësipërme është i rëndësishëm fakti, se në rastin e kontrabandës përmes kalimit, duke mosdeklaruar ose duke deklaruar ndryshe nga ajo çfarë influencon apo ndikon në marrjen e vendimit për lejimin e kalimit të mallrave nëpërmjet kufirit doganor, mund të jetë *mënyrë* për shmangien nga pagesat doganore tërësisht apo pjesërisht.

Kontrabanda përmes kalimit, zhvendosjes dhe kontrabanda nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore,megjithëse hyjnë në grupin e krimeve doganore, në esencë kanë përbërje të ndryshme të kriminale, ku asnjëra nuk përjashton tjetrën.Analiza e praktikës hetimore dhe gjyqësoree përdorur për kualifikimin e krimeve, gjatë pranisë së simptomave të kontrabandës dhe shmangies nga pagesat doganore, si edhe gjatë trajtimit të mendimeve apo opinioneve të juristëve, na lejon të konstatojmë faktin problematik të interpretimit të veprimtarive të trajtuara më sipër. Ndodh rëndom që gjyqtarët të bëjnë

gabime tipike, gjatë zbatimit të kualifikimeve për krimet, gabime këto që lidhen me mospërcaktimin e saktë të veprimit të kryer, nga veprimi i mbetur në tentativë, të objektit të kontrabandës dhe të objektit të krimit nëpërmjet shmangies apo edhe të përmbajtjes së anëve objektive e subjektive të veprimtarive në fjalë. Aq më shumë që, duke mos kuptuar ndryshimet në këto vepra penale të fushës doganore, vazhdon të ketë qëndrime të ndryshme si në rrafshin teorik doktrinar, ashtu edhe në praktikën gjyqësore lidhur me përcaktimin e figurës së krimit të kontrabandës, si figura krimi formale apo materiale të veprës kontrabandë të konsumuar apo të hipotezave të mbetjes së krimit në fazën e tentativës.

Është interesante se, duke përjashtuar disa skeptikë,⁴³⁶ debatit lidhur me këtë çështje mund t'i jepet fund, nëse do kuptohen saktë karakteristikat e veprave penale në fushën doganore në tërësi dhe, në veçanti, ato të kontrabandës nëpërmjet kalimit, me veprat penale të kontrabandës nëpërmjet shmangies.

Duke analizuar dispozitat e Kodit Doganor për kontrabandën dhe ato të Kodit Penal arrijmë në konkluzionin se nenet 276/a,b,c -279; neni 280/b i Kodit Doganor dhe nenet 171;175;176; 179/1 të Kodit Penal, si dhe paragrafi i parë i neneve 172-174 të Kodit Penal është karakteristikë për krimet e kryera direkt gjatë kalimit të mallrave përmes kufirit doganor, d.m.th. në zonat doganore kufitare. Ndërsa neni 276/d,e; neni 280/a,f i Kodit Doganor dhe nenet 172-174;177 të Kodit Penal, si dhe nenet 178-179 (*të cilat nënkuptojnë shmangien nga detyrimet doganore*) të Kodit Penal është karakteristikë për krimet e kryera deri ose mbas kalimit të mallrave përmes kufirit doganor, d.m.th. në doganat e “brendshme” apo në kushtet e vendosjes së mallrave në procedura të veçanta doganore.

b.Sipas qëllimit.

Qëllimi i kontrabandës është kalimi i paligjshëm i pagimittë taksave doganore. Në këtë mënyrë, kontrabanda dhe shmangia nga pagesat doganore nuk përputhen si në objekt, ashtu edhe në qëllim.

c.Sipas subjektit.

Në të vërtetë, rrethi i subjektit të kontrabandës përmes kalimit nuk është përcaktuar si i tillë. Subjekt kontrabande mund të jetë cilido person fizik i përgjegjshëm që ka arritur moshën 16 vjeç, moshë kjo e mjaftueshme për sigurimin e përgjegjësisë penale, persona në detyrë që kryejnë krime, duke përdorur shfrytëzuar postin për këtë qëllim, neni 175 i Kodit Doganor. Në krahasim me kontrabandën përmes kalimit, *lista e personave të cilët*

⁴³⁶ Më shumë referoju artikullit “Për kuptimin e tentativës në trafikimin e lëndëve narkotike dhe armëve. Henerik Ligori, botuar në revistën “Jeta Juridike” dhe vendimi nr. 608, datë 26.09.2007, i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

mund të futen për përgjegjësi penale për kryerje krimesh, të parashikuara në nenin 276/d,e;nenin 280/a,f të Kodit Doganor dhe paragrafi i dytë i neneve 172-174 të Kodit Penalështë tepër i ngushtë.

Kështu, subjekti i kontrabandës nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore nuk mund të jetë *çdo person* që bën kalimin e mallrave përmes kufirit doganor, por vetëm një i tillë kur në detyrat e tij hyn edhe ajo e pagesës doganore.

Kontrabanda përmes kalimit,nuk i përmban simptoma të tilla të domosdoshme, prandaj jo të gjithë personat, të cilët janë vënë para përgjegjësisë penale për kryerje të kontrabandës, mund t'i nënshtrohen ndjekjes penale për shmangie nga pagesat doganore.

d.Ana objektive.

Elementi bazë i anës objektive është veprimtaria (apo aktiviteti), pasoja dhe lidhja shkak-pasojë midis tyre.Përveç kësaj, rol të rëndësishëm luajnë vendi, koha dhe mënyra e kryerjes së krimit. Megjithëse, konstruksioni i veprës penale të kontrabandës dhe veprës penale të shmangies nga pagesat doganore janë të ndryshme. Kontrabanda nëpërmjet kalimit, zhvendosjes hyn në krimet *meelementë formale*⁴³⁷, (*figura krimi të prera apo formale*), ndërsa shmangia nga pagesat doganore ka *përbërje materiale*. Në rastin e fundit, është e domosdoshme *prania* (apo ekzistenca) e *pasojave kriminale*, në formën e mospagimit të taksave doganore.Moskuptimi i këtij ndryshimi është bërë shkas për qëndrime të ndryshme si nga studiues, ashtu edhe gjatë praktikës gjyqësore.

Kontrabanda përmes lëvizjes, zhvendosjes së mallrave nga/dhe në kufirin shtetëror mund të kryhet vetëm nëpërmjet rrugës së veprimit⁴³⁸. Nëpërmjet rrugës së mosveprimit, ajo (d.m.th. kontrabanda) është e pamundur të kryhet, sepse duke u nisur nga dispozitat e lartpërmendura nëKodin Doganor dhe Kodin Penal, ky lloj krimipërfaqëson në vetvete së pari, zhvendosjen apo kaliminpërmes kufirit doganor.Ndërkohë që kontrabanda përmes shmangies nga pagesat doganore mund të kryhet apo realizohet si nëpërmjet veprimeve, ashtu edhe nëpërmjet mosveprimeve.

Për njohjen si fajtor të personit në kryerjen e kontrabandës nëpërmjet lëvizjes është e domosdoshme prania e dy simptomave të domosdoshme në mënyrën e kryerjes së krimit:

- kalimi i mallrave apo mjeteve të tjera përmes kufirit shtetëror;
- ky kalim duhet të shoqërohet ose me shkeljen e rregullave për kalimin përfshi edhe ato të vendosura për kalim në pikat e kontrollit doganor nëpërmjet mashtrimit, përdorimit të

⁴³⁷ “Me figura materiale kuptohen figura që kërkojnë si element të domosdoshëm ardhjen e pasojave shoqërisht të rrezikshme, ndërsa me figura formale kuptohen ato figura për ekzistencën e të cilave nuk është e domosdoshme ardhja e pasojave kriminale”. I. Elezi & Komentari i Kodit Penal... Botim i vitit 2009.

⁴³⁸ Ismet Elezi. “E Drejta Penale”, Pjesa e posaçme.

dokumenteve false (mjete të identifikimit doganor), po ashtu edhe nëpërmjet shkeljes së rregullave të deklarimit, kalimit jashtë kohës së punës apo forcërisht.

Gjithashtu, *ana objektive* e kontrabandës nëpërmjet kalimit *ndryshon* nga ana objektive e kontrabandës nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore, *për vendin dhe kohën kryerjes së krimit*.

Në rastin e kontrabandës përmes kalimit të kufirit, del në plan të parë vendi i kryerjes së krimit që, në këtë rast, është kufiri doganor. Një shenjë apo simptomë e tillë, *që është vendi, nëpërbërësit e shmangies nga pagesat doganore*, nuk ka. (domethënë nuk ekziston nocioni vend).

Rëndësi të veçantë ka edhe momenti i përputhjes së kryerjes së krimit me momentin e kalimit (apo zhvendosjes) përmes kufirit doganor. Në kontrabandën përmes kalimit, këto dy nocione janë identike, pra të barasvlershme. Gjatë kontrabandës përmes shmangieve nga pagesat doganore nuk ekziston një reciprocitet kompakt i tillë. Shmangia nga pagesat doganore mund të kryhet edhe *gjatë kalimit të paligjshëm të kufirit* (d.m.th. të kufirit shtetëror), por në rastin kur kalimi bëhet *në përputhje me rregullat e caktuara*, detyrimi për pagesat doganore lind jo nga momenti i kalimit të mallrave, por nga momenti i dorëzimit, apo dhënies së Deklaratës Doganore (apo dhënies së saj brenda afateve të caktuara), sikurse gjatë kohës së shmangies nga kushtëzimet e vendosura për mallrat në procedura të veçanta doganore. Shmangia nga pagesat doganore mund të bëhet jo vetëm në rajonet e kufirit doganor, por edhe në rajonet e brendshme të vendit, në zonën e veprimtarisë apo aktivitetit të brendshëm të doganave, në të cilat bëhet dokumentacioni i duhur për mallin.

Në këtë mënyrë, *ana objektive* e kontrabandës mund të *përputhet* me shmangien nga pagesat doganore, por nuk është e barabartë me të.

f. Ana subjektive

Ndryshime, midis krimit të kontrabandës nëpërmjet kalimit dhe asaj të shmangies nga pagesat doganore, ka edhe për sa i përket anës së tyre subjektive. Në qoftë se shmangia nga pagesat doganore kryhet për qëllime *interesimaterial* dhe qëllimi i fajtorit synon t'i përfitojë, duke i mohuar shtetit "të drejtën e kufirit" dhe, në tërësi, detyrimet e importit/eksportit të llogaritura për buxhetin e shtetit, atëherë kontrabanda si një akt kriminal i kryer nëpërmjet kalimit, zhvendosjes mund të realizohet, duke pasur edhe motive të tjera, që mund të mos kenë karakter interesi pasuror.

Gjithashtu, kontrabanda nëpërmjet kalimit të kufirit shtetëror ndryshon edhe nga mënyrat e kryerjes së veprës penale, e cila ndikon drejtpërsëdrejti në rrezikshmërinë e saj, madje i cilëson ato. Si rrjedhojë, në këto raste, kontrabanda mund të kryhet edhe nga grupe të

armatosura, mund të jetë në kushte trafikimi, sikundër mund të përdorë dhunën në kalimin jashtë apo përmes zonave doganore.

Si përfundim, pikërisht këto dallime specifike duhet të merren në konsideratë nga autoriteti doganor, akuza e gjyqësori, në raport me shqyrtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me krimet doganore, me qëllim shmangien e gabimeve në klasifikimin e veprave penale kontrabandë.

2. Figurat e veçanta të krimit doganor

Vepra penale e kontrabandës, sipas objektit të drejtpërdrejtë, rrezikshmërisë dhe subjektit, ndahet në këto lloje:

2.1. Kontrabandë me mallra të ndaluara⁴³⁹.

Në nenin 171 të Kodit Penal përcaktohet se *“Importimi,eksportimi apo tranzitimi i paligjshëm i mallrave të ndaluara, që hyjnë e dalin në Republikën e Shqipërisë, i kryer me çfarëdolloj mënyre apo mjete, dënohet me burgim gjer në dhjetë vjet...”*.

Në përcaktimin e mësipërm, duhet të ndalemi sidomos në lidhje me disa saktësime që kanë të bëjnë me veprimin, mosveprimin, karakterin formal apo material, cilësimin e veprës penale të kontrabandës, nëpikëpamje të rrezikshmërisë dhemënyrësë kryerjes së tyre. Legjislatori, në përcaktimin e lartpërmendur, është mjaftuar me përdorimin e termit importimit,eksportimit, tranzitimit të mallrave të ndaluara, ndërkohë që, siç e kemi trajtuar edhe në kapitujt e mëparshëm, nëvështrim të Konventës së Kiotos, termat importim, tranzitim eksportim, përbëjnë veprimtari që kryhen në fushën doganore. Natyrisht që në kuptimin lateral ato nuk kanë të bëjnë me kalimin jashtë zonave doganore përmes kufirit shtetëror, ku nuk ka as zona doganore dhe as pikatë kalimit kufitar. Sipas gjasës, diçka e tillë duhet të nënkuptohet, sepse shpeshherë kemi të bëjmë edhe me raste të veprave penale që përfshihen jashtë zonave doganore, në të kundërt duhet t'i referohemi neneve 270 -279 të Kodit Doganor.

Aksh ndarjemë të qartë e gjejmë në legjislacionin doganor italian dhe në atë francez (edhe pse jo plotësisht të saktë), ku përcaktohet se përbëjnë kontrabandë mallrat e importit, eksporti i padeklaruar i mallrave të ndaluara, çdo shkelje e dispozitave ligjore që ka të bëjë me ndalimet e importeve, eksporteve, rieksperteve, brenda ose jashtë zonës doganore, kështu “si mallra të ndaluara konsiderohen të gjitha mallrat e import-

⁴³⁹ Sipas jurisprudencës doganore franceze, nocioni i mallrave të cilësuar si të “ndaluara”, konsiderohen “Mallrat të cilat cilësohen si të ndaluara, kur importi apo eksporti i tyre *ndalohet në çfarëdolloj lloj mënyre* ose i *nënshtrohet kufizimeve* apo rregullave cilësore apo rregullave formale”.

eksportit, të cilat ndalohen në çdo mënyrë ose u nënshtrohen kufizimeve sipas rregullave të cilësisë, të kondicionimit apo formaliteteve të veçanta”⁴⁴⁰.

Për këto arsye, si në këtë dispozitë, por edhe në ato që vijojnë më pas, nevojitet të riformulohen më qartë, duke përcaktuar saktë kalimin jashtë zonës doganore në/dhe nga kufiri shtetëror dhe importimi, eksportimi, tranzitimi i kundërligjshëm, në të kundërt mund të bëhen gabime në klasifikimin e veprave penale dhe përcaktimin e rrezikshmërisë të tyre.

Gjithashtu, ligjvënësi, por dhe praktika gjyqësore, është mjaftuar me termin “mallra të ndaluara” (*ndryshe nga legjislacioni doganor francez, ku mallrat e ndaluara dhe ato që i nënshtrohen kufizimeve janë të listuara*⁴⁴¹) për sa përcaktohet në referim të neneve 81-82

⁴⁴⁰ Konsiderohet si import ose eksport pa deklarim të mallrave të ndaluara çdo shkelje e dispozitave ligjore ose nënligjore, që janë mbi ndalimin e importit, eksportit ose riekportit... ose në përmbushjen e formaliteteve të veçanta, kur mashtrimi është bërë ose tentuar të bëhet në zyrat dhe që ajo nuk ndëshkohet në mënyrë të veçantë nga një tjetër dispozitë e kodit. Në rastet kur mallrat, të cilat kanë qenë të eksportuara me dërgim të ndalimeve në dalje, me destinacion një shtet të përcaktuar, mbas mbërritjes së tyre në këtë shtet janë ridërguar në një tjetër shtet, dërguesi ndëshkohet me sanksione për eksportimin pa deklarim, nëse vërtetohet se ridërgimi është bërë sipas udhëzimeve të tij, me nxitjen e tij ose me bashkëpunimin e tij ose nëse tregohet që ai ka përfituar ose që ai kishte dijeni, si dhe për ridërgimin e planifikuar në momentin e eksportit. Dispozitat e para në pikën 1 nuk janë të aplikueshme kur kemi shkelje të rregullave të cilësisë dhe kondicionimit të detyrueshëm për eksport. (Neni 428 i Kodit Doganor Francez). Konsiderohen kontrabandë me mallra të ndaluara “Shkelje e dispozitave ligjore dhe nënligjore, që kanë të bëjnë me ndalimin e eksportit ose të riekportit... ose të përmbushjes së formaliteteve të veçanta, kur mashtrimi është bërë ose tentuar të bëhet jashtë zyrave doganore dhe që ajo nuk ndëshkohet veçanërisht nga një dispozitë tjetër e këtij kodit”.

⁴⁴¹ Sipas nenit 38 të Kodit Doganor Francez:

- kur import-eksporti është i lejueshëm vetëm me prezantimin e një autorizimi, licence, certifikate, etj., malli është i ndalueshëm, në qoftë se nuk shoqërohen me një titull të rregullt ose në qoftë se ajo paraqitet nën një titull të pa aplikueshëm.
- të gjithë titujt që kanë të bëjnë me autorizimin e import-eksportit, nuk mund të jenë objekt i një huaje, të një shitje, dhe në një mënyrë të përgjithshme të një transaksioni të çfarëdoshëm, nga ana e titullarit të tyre.
- duke iu referuar dispozitave dërguese të parashikuara në nenin 2 bis, dispozitat e këtij neni janë të aplikueshme për produktet që kanë të bëjnë me mbrojtjen, transferimi i të cilave i nënshtrohet një autorizimi paraprak të parashikuara në nenin L. 2335-10 të Kodit të Mbrojtjes, për produktet kimike të Tabelës 1 të aneksuar në Konventën e Parisit dhe të përmendur në nenin L. 2342-8 të Kodit të Mbrojtjes, për materialet e përmendura në nenin L. 2335-18 të të njëjtit kod, po ashtu edhe për lëndët eksplozive të destinuar për ushtrinë të parashikuara në nenin L. 2352-1 të KM, për mallrat e parashikuara nga dispozitat e neneve 2, 3, 4, 5 dhe 19 të ligjit nr. 92-1477, datë 31 dhjetor 1992 mbi produktet, të cilat u nënshtrohen disa kufizimeve për qarkullim dhe për komplimentaritetin midis shërbimeve policore, të xhandarmërisë dhe të doganës, për mallrat e klasifikuara të kategorisë së 1 nga aneksi i Rregullores CE nr 273/2004 të PE dhe të KE datë 11 shkurt 2004 mbi prokurorët e drogës, për mallrat e parashikuara në nenin L. 5132-9 të Kodit të Shëndetit Publik, për mallrat të prezantuara mbi një markë të falsifikuar ose të inkuorporuar në një nga dizenjot e përmendura në nenin L. 513-4 të Kodit të Veprave Intelektuale dhe ashtu siç është përmendur në nenin 19 të Rregullores (CE) nr. 6-2002 të Këshillit, datë 12 dhjetor 2001, mbi vizatimet dhe modelet komunitare, po ashtu edhe për produktet e gjakut dhe plazmatike të përmendura në 1 dhe 2 të nenit L. 1221-8 të të njëjtit Kod, për gjakun, komponentët dhe produktet e derivuara me përdorim shkencor të parashikuara në nenin L. 1221-12, për organet, indet dhe derivatet e tyre, qelizat, gametet dhe indet

të Kodit Doganor dhe rregullave të vendosura nga ministrinë përkatëse, por pa i kategorizuar ato. Deri diku këtë fakt e hasim në aktet ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me kontrollin e eksporteve, të cilat kanë dalë shumë më vonë se ligji doganor dhe ai penal⁴⁴², por edhe në ligje të veçanta. Duke u mbështetur në këto përcaktime të rëndësishme, mendoj sedo të ishte nevralgjike çështja e dallimit të mallrave, domethënë mallratë cilat cilësohen si absolutisht të ndaluara dhe mallra që janë relativisht të ndaluara. Në rastin e parë, mallrat nuk mund të importohen, eksportohen apo tranzitohen në territorin e një vendi tjetër, ndërsa në rastin e dytë importi apo eksporti i nënshtrohen disa rregullave, si për shembull, paraqitja e një licence të veçantë, autorizimi apo certifikata.

Vlen të theksojmë se çështjet tjetër interesante që paraqet studimi është edhe fakti, që në legjislacionin tonë penal dhe atë doganor, për veprat penale të kontrabandës, nuk është përcaktuar kalimi jashtë zonave doganore, kalimi me grup të armatosur, në kushte trafikimi gjë që çon në moscilësimin e veprave penale të kontrabandës të kryer në këto kushte, ndërkohë që në ligjin doganor francez, kontrabandimi jashtë zonave doganore, me grup të armatosur, është specifikuar duke u konsideruar vepër penale me një rrezikshmëri më të madhe.

2.1.1. Objekti i drejtpërdrejtë.

Në këto raste, *objekti i drejtpërdrejtë* i kontrabandës janë:

- Marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj të veçantë dhe aktet nënligjore për hyrjen, daljen, tranzitimin e mallrave në territorin doganor që kërkojnë një autorizim të

embrionale të marra nga trupi i njeriut, po ashtu edhe për preparatet e terapisë celulare dhe mostrat biologjike të përmendura në nenin L.1235-1, L.1243-1, L.2141-11-1 dhe L.1245-5 të të njëjtit kod, për indet dhe qelizat embrionale të fetusit të parashikuara në nenin L.2151-6 të po të njëjtit kod, për burimet artificiale dhe natyrore të radionukleidës së përkufizuar në nenin L.1333-1 të Kodit të Shëndetit Publik dhe sipas neneve L.1333-2 dhe L.133-4 të të njëjtit kod, po ashtu edhe për vendimet e autoriteteve komunitare të marra për aplikimin e kësaj Rregulloreje. Dispozitat e këtij neni aplikohen edhe për sendet e çfarëdolloj natyre, të cilat japin një imazh me karakter pornografik, ku janë të përfshirë minorenët sipas neneve 227-23 të Kodit Penal.

- sipas dispozitave dërguese të parashikuara nga neni 2 bis, dispozitat e këtij neni janë gjithashtu të aplikueshme për mallrat të cilat iu nënshtrohen kufizimeve për qarkullim të parashikuara nga ligjet komunitare. Lista fiksohet në mënyrë të përbashkët nga Ministri i Doganave dhe ministrat që kanë interes

⁴⁴² a. Ligji nr. 9707, datë 05.04.2007 "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë".

c. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 09.02.2011 "Për miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve".

veçantë për t'iu nënshtruar kontrolleve specifike⁴⁴³.

- Marrëdhëniet juridike të vendosura me Konventa, Marrëveshje Ndërkombëtare, ligje të veçantë dhe akte nënligjore që ndalojnë hyrjen, daljen, tranzitim të mallrave në territorin doganor, për shkak se:

- paraqesin rrezik për jetën e njerëzve, kafshëve, bimëve apo ngaqë mund të përbëjnë kërcënim për sigurinë kombëtare.
- atakojnë respektimin e një akti ndërkombëtar, ndaj të cilit Shqipëria ka detyrime, për shembull në kushtet e embargos ndaj ish-Jugosllavisë.

Veçoria karakteristike e këtij krimi, në të shumtat e rasteve është prania e *mjetit* material, ndaj të cilit janë drejtuar veprimtaritë apo sjelljet e *fajtorit*, pasojë e të cilave është fakti që ai shkel apo u bën atentat marrëdhënieve shoqërore, të cilat përbejnë thelbin e objektit të këtij krimi⁴⁴⁴.

Në bazë, apo në përputhje me përmbajtjen e dispozitave të nenit 171 të Kodit Penal, nenit 82 të Kodit Doganor dhe akteve ligjore dhe nënligjore për kontrollin e eksporteve⁴⁴⁵, mjetet e krimit ndahen:

⁴⁴³ Sipas legjislacionit doganor francez, neni 68 i Kodit Doganor. Mallrat e ndaluara duhet të shkruhen në manifest bashkë me emrin e tyre të vërtetë, natyrën dhe llojin.

⁴⁴⁴ Sipas nenit 215 të Kodit Doganor Francez.

1. Ata që mbajnë ose transportojnë mallra të rrezikshme për shëndetin, sigurinë dhe moralin publik, mallra të falsifikuara, mallra të ndaluara sipas angazhimeve ndërkombëtare apo mallra që janë objekt i një rrjeti mashtrimesh (kontrabandë) ndërkombëtare apo të një rrjeti klandestin, të cilat dëmtojnë interesat legjitime të tregtisë së rregullt dhe të Thesarit, veçanërisht të përcaktuara nga një udhëzim i Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, duhet që me kërkesën e parë të punonjësve doganorë, t'u japin faturat, të cilat vërtetojnë që këto mallra janë importuar në mënyrë të rregullt në territorin doganor komunitar, ose faturat e blerjes, borderotë e prodhimit apo çdo lloj tjetër vërtetimi mbi origjinën, të prodhuara nga persona apo ndërmarrje të krijuara rregullisht në brendësi të territorit komunitar.

2. Ata që mbajnë, transportojnë, shesin, japin apo shkëmbejnë mallrat të këtij lloji, dhe ata që bëjnë këto vërtetime për origjinën duhet ta konservojnë atë për një periudhë 3 vjeçare ose nga momenti i dhënies së këtij vërtetimi ose nga momenti kur malli nuk ndodhet më në duart e tyre.

3. Nuk përfshihen në zbatim të këtyre dispozitave, mallrat për të cilat mbajtësit, transportuesit, ose ata që i kanë mbajtur ose transportuar ose shitur ose shkëmbyer, që me një shkresë të tyre mund të kenë qenë transportuar, mbajtur ose blerë në territorin doganor përpara datës së publikimit të aktit nënligjor të përmendur më sipër.

Çdo person që mban mallrat e përmendura për herë të parë nga akti nënligjor i parashikuar më sipër, brenda një afati 6 mujor, duke nisur nga publikimi i këtij akti, duhet që të bëjnë një deklaratë me shkrim në shërbimet doganore. Pasi verifikojnë vërtetësinë, shërbimet doganore bëjnë autenticitetin e deklaratës, e cila shërben më tej si një vërtetim.

⁴⁴⁵ a) Ligji nr. 9707, datë 05.04.2007 "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë".

b. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 106, datë 09.02.2011 "Për miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë, që i nënshtrohen kontrollit shtetëror të import-eksporteve".

a.Në mallra që janë të ndaluara me Konventa(duke përfshirë edhe mallra të cilat ndalohen të importohen, tranzitohenapo eksportohen në zbatim të një Konvente të OKB-së të vendosur për embargo)dhe MarrëveshjeNdërkombëtare apo me ligje të veçanta.

-Lëndët helmuese luftarake

-Lëndët narkotike, psikopatike, lëndët me veprim të fortë, lëndët shpërthyes, si dhe ato radioaktive, burimet radioconizuese e materialet bërthamore.

-Mallra që ndalohen me ligj të veçantë, si specie të rralla, korale, etj.

2.1.2.Nga ana objektive.

Nga ana objektive krimi kryhet nëpërmjet kontrabandimit në/dhe nga kufiri shtetëror duke kaluar përmeszonës doganore ose jashtë tyre, si dhe gjate rieksporimit drejt një vendi tjetër si destinacioni përfundimtar.Në këtë vepër penale, përgjegjësia ligjore lind me kalimin e mallrave në/dhe nga kufiri shtetërorjashtëzonës doganore apo brenda saj,gjithmonë duke iu shmangur kontrollit doganor dhe kontrollit të autoriteteve të tjera të ngarkuara me ligj.

Në këtë këndvështrim, krimi i *kontrabandës futet në veprat penale të prera,formale*, që nga ana objektive kërkohet vetëm kalimi i mallrave në/dhe nga kufiri shtetëror i mallrave të ndaluara.

b.Mallra të cilat i nënshtrohen kontrolleve dhe rregullave të veçanta, përfshirë edhe pajisjen me autorizim të lëshuar nga një autoritet shtetëror i përcaktuar me ligj.

Këto mallra gjenden kryesisht të listuara në ligje të veçanta⁴⁴⁶sipas fushave, si:

-Armët e zjarrit, pajisjet shpërthyes, municionet luftarake, si dhe çfarëdolloj armësh teknike luftarake.

-Materialet dhe pajisjet speciale, të cilat mund të shërbejnë si mjet bazë për prodhimin e armëve, ndaj të cilave janë vendosur rregulla speciale për kalimin e tyre përmes kufirit doganor.

-Materialet strategjike të rëndësishme dhe që kanë vlera të veçanta kulturore, ndaj të cilave janë vendosur rregulla të posaçme për kalimin përmes kufirit doganor.

-Mallra me karakter të dyfishtë⁴⁴⁷.

-Mallra që paraqesin rrezik për shëndetin e njerëzve⁴⁴⁸.

⁴⁴⁶ Më shumë referoju ligjit të sipër cituar.

⁴⁴⁷ Çdo transport në territorin doganor të sendeve me përdorim të dyfishtë civil dhe ushtarak jo komunitar, me destinacion një vend jo anëtar i BE-së, në kundërshtim me ndalimet dhe autorizimet e parashikuara në nenin 6 të Rregullores (CE) nr 428/2009 të Këshillit, datë 5 maj 2009, i cili krijoi një regjim komunitar për kontrollin e eksporteve, transferimeve, kurtazhit dhe tranzitit të sendeve me përdorim të dyfishtë. Neni 427 i KD Francez.

⁴⁴⁸ Neni 38 i Kodit Doganor Francez për medikamentet për përdorim njerëzor të parashikuara në nenin L. 5124-13 të Kodit të Shëndetit Publik, për mikroorganizmat dhe për toksinat e përmendura në nenin L.

Gjithashtu i kontestueshëm është edhe përcaktimi, se objekti i drejtpërdrejtë me mallrat e ndaluara janë marrëdhëniet juridike të mbrojtura nga mosveprimi kriminal, pasi karakteristikë e veprës penale të kontrabandës përmes kalimit, zhvendosjes së mallrave në/dhe nga kufiri shtetëror mund të kryhet vetëm me veprime dhe jo mosveprim.

2.1.3. Ana subjektive.

Ana subjektive e krimittë kontrabandës kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, por në varësi nga objekti i drejtpërdrejtë, qëllimi është i ndryshëm, jo vetëm për përfitim material, por si qëllim mund të ketë edhe destabilizimin e vendit, terrorizmin, furnizimin e makinerisë së luftës në kushtet e embargos, etj.

Autorë të ndryshëm i përmbahen mendimit se *“qëllimi i krimit të kontrabandës me mallra të ndaluara, edhe pse nuk përmendet shprehimisht si element i domosdoshëm i figurës së krimit, por kuptohet vetvetiu, është nxjerrja e përfitimeve materiale”*⁴⁴⁹. Mendojmë se ky qëndrim është i gabuar, për më tepër që paqartësia absolute e termit *kontrabandë*, e kuptuar vetëm si shkelje e fushës fiskale, ka krijuar një situatë konfuzioni për arsye se:

-Ligjvënësi realisht nuk është shprehur lidhur me këtë, ndërkohë që në veprat e tjera të kontrabandës ka theksuar edhe qëllimin e shmangies nga detyrimet doganore.

-Në rastet e kontrabandimit absolut (kontrabanda e luftës, politike, strategjike, artistike, arkeologjike, që janë praktikuar në një formë të ngjashme, por jo përkatësisht apo vetëm me mashtrim në të drejtën doganore),⁴⁵⁰ apo në rrethanat e një embargoje, si dhe në çdo rast për kryerjen e veprimeve që rrezikojnë sigurinë kombëtare, natyrshëm është evidente se qëllimi nuk është për interesa materiale, por për mbështetjen e një organizate terroriste, të palëve në luftim apo për qëllimi të tjera që nuk kanë të bëjnë me ato materiale⁴⁵¹.

2.2. Kontrabanda me mallra të licencuara.

Në nenin 173 të Kodit Penal është parashikuar se importimi, tranzitimi apo eksportimi i mallrave që kërkojnë licencë nga organi kompetent, nëpërmjet kalimit jashtë pikave

5139-1 të Kodit të Shëndetit Publik, për medikamentet për përdorim veterinar të përmendura në nenin L. 5142-7 të Kodit të Shëndetit Publik.

⁴⁴⁹ I. Elezi. “E Drejta Penale”, Pjesa e posaçme.

⁴⁵⁰ S. Gallo. “Kontrabanda doganore një vepër antike dhe ende aktive”, Revista della Guardi di Finanza nr.1-2001.

⁴⁵¹ P.sh. në kontrabandimin e vajgurit duke tranzituar nëpër territorin shqiptar në vitin 1995, subjekti importues jo vetëm që nuk i shmangej detyrimeve të importit, por paguante edhe taksën e qarkullimit 12% të vlerës doganore, e cila, nëse malli do të tranzitohej në mënyrë të ligjshme jashtë territorit doganor rimburohej nga organet tatimore, por që në kushtet e embargos, duke qenë se kontrabandohej drejt ish-Jugosllavisë, subjekti kontrabandist nuk mund ta realizonte një rimbursim të tillë. (*Shënimi i autorit*)

doganore, fshehjes së pjesshme apo të plotë, mosdeklarimit të saktë në doganë, deklarimit të rremë për natyrën apo forma të tjera, që kanë si qëllim shmangien nga detyrimet doganore...”, ndërsa në Kodin Doganor është përcaktuar se kryen kontrabandë në lëvizjen e mallrave përmes kufirit shtetëror tokësor dhe në brendësi të zonave doganore, kushdo që sjell mallra nëpërmjet kufirit tokësor, nëpërmjet kufirit detar, ajror, në kundërshtim me këtë Kod dhe aktet nënligjore në zbatim të tij⁴⁵², të gjitha këto kundërshtime përbëjnë kontrabandë.

Sipas legjislacionit doganor francez “*Mallrat pirate apo të falsifikuara që cenojnë interesat legjitime të tregtisë janë të ndaluara, kur për ta mungon licenca, autorizimi, i cili e bën të ligjshëm importin/eksportin apo tranzitimin e tyre...*”⁴⁵³. Vepra penale e kontrabandimit me mallra që kërkojnë një licencë, autorizim të autoritet shtetëror i përcaktuar në nenin 173 të Kodit Penal dhe në nenin 280/b të Kodit Doganor është i përafërt me kontrabandimin me mallra të ndaluara, pasi objekti i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj, kryesisht me ligje të posaçme⁴⁵⁴. Pra, objekti i krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura me ligj për të siguruar veprimtarinë në fushën doganore lidhur me një kategori mallrash, për të cilat importimi apo eksportimi i tyre është i rregulluar dhe mbrohet me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Ndërkohë që ana objektive konsiston te kalimi i mallrave në/dhe nga kufiri shtetëror, nëpër zonën doganore apo jashtë saj, mallra të cilave u mungon licenca apo autorizimi përkatës. P.sh. kur importohen fishekzjarrë, armë gjuetie, eksplozivë, pa pasur autorizimin e Ministrisë së Mbrojtjes. Ndryshimi, në këtë rast, nga krimi i lartpërmendur është se qëllimi i fitimit është evident, madje i përcaktuar edhe nga ligjvënësi.

⁴⁵² Më shumë referoju neneve 276-279 të Kodit Doganor.

⁴⁵³ Kur import-eksporti është i lejueshëm vetëm me prezantimin e një autorizimi, licence, certifikate etj., malli është i ndalueshëm, nëse nuk shoqërohet me një titull të rregullt ose në qoftë se ajo paraqitet nën një titull jo të aplikueshëm. Neni 38 i Kodit Doganor Francez.

Ata që mbajnë ose transportojnë mallra të rrezikshme për shëndetin, sigurinë dhe moralin publik, mallra të falsifikuara, mallra të ndaluara sipas angazhimeve ndërkombëtare apo mallra që janë objekt i një rrjeti mashtrimesh (kontrabandë) ndërkombëtare apo të një rrjeti klandestin, të cilat dëmtojnë interesat legjitime të tregtisë së rregullt dhe të Thesarit, veçanërisht të përcaktuar nga një udhëzim i Ministrit të Ekonomisë dhe Financave, që me kërkesën e parë të punonjësve doganorë, duhet t’u japin faturat të cilat vërtetojnë që këto mallra janë importuar në mënyrë të rregullt në territorin doganor komunitar, ose faturat e blerjes, borderotë e prodhimit apo çdo lloj tjetër vërtetimi mbi origjinën, të prodhuar nga persona apo ndërmarrje të krijuara rregullisht në brendësi të territorit komunitar. Ata që mbajnë, transportojnë, shesin, japin apo shkëmbejnë mallra të këtij lloji dhe ata që bëjnë këto vërtetime për origjinën, duhet ta konservojnë atë për një periudhë 3 vjeçare ose nga momenti i dhënies së këtij vërtetimi ose nga momenti kur malli nuk ndodhet më në duart e tyre. Neni 215 i Kodit Doganor Francez.

⁴⁵⁴ Më shumë referoju Ligji nr. 9707, date 05.04.2007, "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë

Vepra penale e kontrabandimit me mallra që kërkohet licencë apo autorizim, si edhe krimet e lartpërmendura *futet në vepra penale formale*, që nga ana objektive kërkohet vetëm kalimi i mallrave të palicencuara, edhe pse qëllimi përfundimtar është përfitimi material.

2.3. Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe sendeve me vlerë.

Kjo veprë penale, kontrabanda monetare⁴⁵⁵, përcaktuar në nenin 179/1 të Kodit Penal⁴⁵⁶, si dhe në nenin 280/g të Kodit Doganor, paraqet interes studimi dhe kuptimi në zbatim praktik. E përbashkët me krimet e lartpërmendura është fakti se edhe kjo veprë penale përfshihet në krimet formale⁴⁵⁷. Mendoj se kjo dispozitë e ka kufizuar anën

⁴⁵⁵ Kushdo që do shkelë ose tenton të shkelë legjislacionin ose rregullat në marrëdhëniet financiare me jashtë, ose duke mos respektuar detyrimet për deklarim ose për riatdhesim, ose duke mos respektuar procedurat e kërkuara dhe formalitetet, ose duke mos u pajisur me autorizimin e kërkuar ose duke mos përbushur kushtet që nevojiten për marrjen e këtij autorizimi, do të dënohet me një dënim me burgim për 5 vjet, me konfiskimin e tërësisë së mjetit të deliktit, konfiskimin e mjeteve të transportit të përdorura për të kryer mashtrimin, konfiskimin e të mirave dhe aseteve që janë produkt i drejtpërdrejtë ose i tërthortë i veprës dhe me një gjobë e barabartë sa minimumi në moment dhe maksimumi i dyfishit të shumës mbi të cilën ka të bëjë vepra ose tentativa e saj 1 bis. Dënohet më të njëjtat dënime çdo person që shkel ose tenton të shkelë masat e kufizimit në marrëdhëniet ekonomike dhe financiare të parashikuara nga ligjet komunitare të marra në zbatim të nenit 215 të Traktatit të Funkcionimit të BE-së, ose nga traktate dhe akorde ndërkombëtare rregullisht të pranuar dhe ratifikuara nga Franca. 1 ter. Personat juridikë të deklaruar penalisht përgjegjës, sipas kushteve të parashikuara në nenin 121-2 të KP, për veprat e përmendura në 1 dhe në 1 bis të këtij neni, marrin përveç gjobës së parashikuar në nenet 131-38 të KP edhe dënime të parashikuara nga nenet 131-39 i po të njëjtit kod.

- Do të dënohet me 5 vite burg dhe me një gjobë nga 450 deri në 225.000 euro çdo person që ka nxitur nëpërmjet shkrimit ose propagandës ose publicitetit kryerjen e një krimi të parashikuar në pikën 1 si më sipër, qoftë kjo nxitje me apo pa efekt.

- Personat e dënuar për vepra në kundërshtim me legjislacionin dhe rregullat mbi marrëdhëniet financiare me jashtë, deklarohen gjithashtu të paafte për të ushtruar funksione të agjentit për shkëmbime, të jetë zgjedhës ose të zgjidhet në dhomat e tregtisë, gjykatën e tregtisë, këshillat e punës, për aq kohë sa kjo paafte si nuk i është hequr. Gjykatat urdhërojnë që vendimet e tyre të shfaqen me shpenzimet e të dënuarit nëpër gazetatat që ata vetë caktojnë. (Neni 459 i Kodit Doganor Francez).

- Transferimi drejt një shteti anëtar të BE-së ose me prejardhje nga ky shtet të titujve, vlerave monetare, i nënshtrohet një deklarimi sipas kushteve të parashikuara në nenin L.152-1 të Kodit Monetar dhe Financiar. Neni 464 i Kodit Doganor Francez.

- Shkeljet mbi mosdeklarimin në transferimin e kapitalit, të përmendur në nenin L. 152-1 të Kodit Monetar dhe Financiar dhe në Rregulloren (CE) nr. 1889/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 26 tetor 2005 "Mbi kontrollin e parave që hyjnë dhe dalin nga Komuniteti", konstatohen dhe ndëshkohen sipas kushteve të parashikuara në nenin L. 152-4 të Kodit Monetar dhe Financiar. Neni 465 i Kodit Doganor.

⁴⁵⁶ Shtuar me ligjin nr. 9086, datë 19.06.2003.

⁴⁵⁷ Dispozitat e mësipërme gjejnë vend edhe në legjislacionin francez, ku në nenin 465 të Kodit Doganor, shkeljet mbi mosdeklarimin në transferimin e kapitalit, të përmendura në nenin L. 152-1 të Kodit Monetar dhe Financiar dhe në Rregulloren (CE) nr. 1889/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit dt. 26 tetor 2005 "Mbi kontrollin e parave që hyjnë dhe dalin nga Komuniteti", konstatohen dhe ndëshkohen sipas

objektive, duke përcaktuar me mosveprim, kur në fakt kemi të bëjmë me një veprë penale që realizohet përmes kalimit të të hollave dhe sendeve me vlerë nga/dhe në kufirin shtetëror, në zonat doganore kufitare apo jashtë tyre. Përcaktimi i rregullave të deklarimit tëparave dhe sendeve me vlerë është bërë me ligjin e posaçëm⁴⁵⁸. Nëkushtet aktuale, kur shteti ndodhet përpara fenomeneve të tilla, sikurse janë veprime të parregullta hyrja e valutës, të cilat si rregull shoqërohen me mashtrim të ngjashëm me shkeljet që praktikohen për t'u shmangur në kufirin shtetëror, çuan në hartimin e një dispozite ndaluese apo kufizuese, pasi qenia e një dispozite të tillë, në Kodin Penal, u bë një domosdoshmëri edhe për faktin se indirekt favorizon luftën kundër pastrimit të parave. Kjo për shkak se nuk lejon futjen ose nxjerrjen e shumave të të hollave, tej limiteve të parashikuara nga ligji, apo edhe të sendeve me vlerë tej. Në praktikën gjyqësore, bazuar në nenet 179.1 dhe 63 të Kodit Penal, kjo veprë penale konsiderohet kundërvajtje penale, neni 282 i Kodit Doganor, në këto kushte, me të drejtë objektin e kontrabandës e kushtëzojnë jo vetëm me mosdeklarimin e parave, por edhe me qenien e tyre nga burime kriminale⁴⁵⁹.

kushteve të parashikuara në nenin L. 152-4 të Kodit Monetar dhe Financiar. I njëjti qëndrim është edhe ai i Gjykatës së Faktit me Vendimin nr. 143, datë 08.02.2010.

⁴⁵⁸ Ligji nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit" dhe Udhëzimi nr. 15, datë 16.02.2009, i Ministrisë të Financave "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës për financimin e terrorizmit në sistemin doganor"

⁴⁵⁹ Në çështjen "Shteti kundër të gjykuarit O. Z.", Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me Vendim (180) të datës 27.06.2012, vendosi lënien në fuqi të vendimit nr. 967, datë 06.11.2009, i Gjykatës së Apelit, e cila kishte vendosur "Lënien në fuqi të vendimit nr. 1839, datë 23.12.2008 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, në pjesën që deklaroi fajtor të pandehurin Ozer Tekin dhe dënimin e tij me gjobë". Ndryshimin e vendimit në pjesën tjetër, duke hequr masën e sekuestrimit dhe kthimin e shumës prej 110.000 USD të pandehurit Ozer Tekin, është rezultat i zbatimit të drejtë të ligjit penal me arsyetimin, se:

- Arsyetimi i Gjykatës së Apelit, se mbajtja e parave në vetvete nuk përbën veprë penale, kur dihet origjina e tyre, është i drejtë. Neni 36 pika 1 e Kodit Penal ka për qëllim konfiskimin në favor të shtetit të sendeve, që kanë shërbyer për kryerjen e veprës penale, gjë që nuk i përgjigjet rastit konkret. Fakti i mosdeklarimit të të hollave përbën veprë penale dhe dënohet sipas parashikimeve të nenit 179/a të Kodit Penal, por kjo nuk do të thotë që paratë të cilat nuk janë deklaruar në kufi nga ana e të gjykuarit, të kenë shërbyer si mjet për kryerjen e veprës penale.

- Çështja që mund të diskutohet lidhur me kuptimin dhe zbatimin e nenit 179.1 të Kodit Penal është nëse objekti material për të cilat ato nuk janë deklaruar përbëjnë objekt kontrabande apo, përveç mosdeklarimit të parave, në kuptim të nenit 36 të Kodit Penal, ato duhet të kenë shërbyer për kryerjen e veprës penale, që kërkon edhe origjinën e tyre.

Siç mund të konstatohet, Gjykata, duke interpretuar me përpikëri nenin 36 të Kodit Penal ka arsyetuar se përderisa u dihet origjina, mosdeklarimi i parave në zyrën doganore nuk përbën veprë penale. Mendoj se kemi të bëjmë me një kuptim të ngushtë të dispozitave ligjore, që kanë të bëjnë me veprat penale të kontrabandës.

Së pari, ligji material ka përcaktuar një kufi të parave objekt deklarimi dhe nuk e lidh me origjinën e tyre. Objekti i kundërvajtjes penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për deklarimin në kufi të të hollave dhe ligjëvënisi nuk e ka kushtëzuar burimin e tyre.

Njëqëndrim i tillë gjenmbështetje ligjore, për sa kohë ligjvënësi e ka konsideruar këtë veprë penale kundërvajtje penale dhe, mbi këtë bazë, ligji penal nuk parashikon konfiskim të mallit objekt kontrabande për rastet e kundërvajtjes penale⁴⁶⁰.

Objekti i kundërvajtjes penale janë marrëdhëniet juridike të vendosura për deklarim të hollave dhe sendeve me vlerë në/dhe nga kufiri shtetëror, detyrim ky i kushtëzuar nga udhëzimi i Bankës së Shtetit pa i lidhur me marrëdhëniet juridike të vendosura me origjinën apo burimin e fitimit të këtyre parave.

Nga ana objektive, kundërvajtja penale kryhet me mosdeklarim në zyrën doganore të shumës së hollave, sendeve me vlerë, çekut bankar apo stolive të tjera, të përcaktuara në udhëzimin e Bankës së Shtetit. Pra, mjafton ky veprim apo mosveprim për të penalizuar atë, i cili ka shkelur një rregull në hyrjen dhe daljen e të hollave dhe sendeve me vlerë në/dhe nga kufiri shtetëror⁴⁶¹.

Objekti material i veprës penale të kundërvajtjes janë të hollat, çeku bankar në çdo formë, metale dhe gurë të çmuar, të cilat, të përcaktuara nga Banka, përtej kufirit duhet të deklarohen. Këto objekte të kontrabandës, në kushtet kur provohet se është kryer vepra penale e kontrabandës, do të duhet të konfiskohen, si sendet me vlerë dhe paratë.

2.4. Kontrabanda e vlerave kulturore.

Në nenin 176 të Kodit Penal dhe në nenin 280/g të Kodit Doganor është parashikuar se “importimi, eksportimi, apo tranzitimi i vlerave kulturore kombëtare në kundërshtim me dispozitat ligjore në lidhje me to...”⁴⁶².

Ky krim, nga pikëpamja e elementeve të veprës penale të kontrabandës ngjason me krimet e lartpërmendura dhe mund të përfshihet në krimet doganore që realizohen nëpërmjet kalimit, zhvendosjes së sendit me vlerë kombëtare në/dhe nga kufiri shtetëror. Mendoj se një riformulim më i plotë i kësaj dispozite, sidomos në përfshirjen edhe të rasteve të kalimit të tyre jashtë zonave doganore kufitare në/dhe nga kufiri

Së dyti, në kuptim të nenit 282 “objekte të kontrabandës” do të thotë mallrat objekt kontrabande, si edhe mjetet e transportit dhe objekte të tjera të përdorura për t’i transferuar ose fshehur ato. Më shumë referoju Vendimit nr. 180, datë 27.06.2012 të Gjykatës së Lartë.

⁴⁶⁰Më shumë shiko Disertacionin “Aspekte juridike penale dhe kriminologjike të pastrimit të parave”, Naim Mecalla

⁴⁶¹ Si rregull, nocioni i kontrabandës i referohet evazionit të taksave të konsumit, të prodhimit dhe të monopoleve. Megjithatë, kohët e fundit kjo është shtrirë edhe në disa kundërvajtje valutore, sepse çdo veprim i parregullt ose hyrje valute, instrumente borxhi (kontrabanda monetare) gjithmonë përfshin mashtrimin dhe mjete të tjera të valutës, shumë të ngjashëm me ato të cilat praktikohen për të shmangur në kufi një dispozite ndaluese ose normë kufizuese. S. Gallo, “Kontrabanda doganore një veprë antike dhe ende aktive”, në *Rivista della Guardia di Finanza* nr. 1-2001, fq. 337.

⁴⁶² Neni 176 i Kodit Penal, neni 280/g i Kodit Doganor.

shtetëror është më se i nevojshëm dhe do të ndihmonte në goditjen me më efikasitet të krimit të kontrabandimit të vlerave kulturore.

Gjithashtu, në këtë dispozitë duhet të përfshihet edhe mosrikthimi i vlerave kulturore të eksportuara përkohësisht sipas ligjit.

Përcaktimi i objektit material, ku si kusht përfshihet në vlera kulturore, është bërë me ligj të posaçëm. Në bazë të këtij ligji mbrohen të drejtat e pronësisë mbi këto materiale. Sipas dispozitave të këtij ligji me *vlerë kulturore* kuptohet lëvizja e sendeve apo objekteve të botës materiale që ndodhen në territorin doganor.

Për qëllime doganore në këto mallra duhet të përfshihen:

- vlerat e çmuara kulturore të krijuara nga individë të veçantë apo nga grupe njerëzish, të cilët janë nënshtetas shqiptarë.
- vlerat e çmuara kulturore, të cilat kanë rëndësi të veçantë për vendin, ato të krijuara brenda territorit shqiptar nga qytetarët e huaj ose nga individë pa shtetësi, por që banojnë në territorin shqiptar.
- vlerat e çmuara kulturore të zbuluara në territorin doganor.
- vlerat e çmuara, të zbuluara nga ekspertët shkencorë, arkeologë, etnografë dhe natyralistë, medakordsinë (apo me miratimin) nga organet kompetente të shtetit nga të cilët vijnë këto vlera.
- vlerat e çmuara kulturore, të siguruara (apo të marra) si rezultat i këmbimeve vullnetare.
- vlerat e çmuara kulturore, të siguruara si dhuratë ose të marra me dakordësinë e organeve kompetente të shtetit nga i cili kanë prejardhje këto vlera.

Në kuptimin vlera të çmuara një listim mëi gjerë dhe i shumëllojshëm i objekteve të ndryshme, rrethi i të cilëve duhet të përfshihet në ligjin përkatës. Midis të tjerash, në listë, duhet të përfshihen edhe objekte që përfaqësojnë:

-vlera historike

-vlera arkeologjike

-vlera artistike: tablotë, vizatimet, prodhime origjinale në skulpturë.

Të gjitha këto vlera të ndryshme të treguara më lart, nga ana e tyre ndahen në tre grupe:

1. Vlera të çmuara kulturore, të cilat nuk lejohen të hyjnë apo të dalin nga Shqipëria.
2. Vlera të çmuara kulturore, zhvendosja e të cilave përmes kufirit doganor shqiptar (import dhe eksport) mund të realizohet, *por me detyrimin e kthimit të tyre* brenda afatit të caktuar në marrëveshje.
3. Vlera të çmuara kulturore, zhvendosja e të cilave përmes kufirit doganor (import-eksport) lejohet *pa detyrimin e kthimit gjatë importit apo eksportit të tyre*.

Eksporti i përkohshëm i vlerave të çmuara kulturore të grupit të 2-të, sigurohet apo realizohet *vetëm nga organe të veçantë të plotfuqishëm* për qëllime tepër të përcaktuara dhe, pikërisht, nga:

- Muzeumet, arshivat, bibliotekat dhe nga persona të ndryshëm juridikë, si dhe nga persona fizikë të autorizuar për këtë qëllim.
- Për organizimet e ekspozitave.
- Për kryerjen e punimeve restauruese dhe kërkimeve shkencore.
- Veprimtari artistike teatrale, koncertore apo veprimtari të tjera të kësaj natyre.
- Në raste të veçanta, vetëm me aprovimin e organeve shtetërore kompetente.

2.5. Kontrabanda e mallrave duke përfshirë edhe ato që paguajnë akcizë.⁴⁶³

Në dallim nga vepra penale e mësipërme, këtu objekti ka të bëjë me marrëdhëniet juridike për import/eksportin apo tranzitin e mallrave me taksa të larta, mallra të cilat zënë një vend të rëndësishëm në sigurimin e të ardhurave në Buxhetin e Shtetit, për rrjedhojë këto marrëdhënie shtetii mbron absolutisht me anë të dispozitave të veçanta, kryesisht nga veprimet apo mosveprimet kriminale.

Objekti material gjendet në listimine mallrave me akcizë, ku vendin kryesor e zëduhani, përfshi këtu edhe cigaret dhe karburantet të përcaktuar me ligjin për akcizat, zbatimin e të cilit, që nga viti 2012, i është ngarkuar administratës doganore⁴⁶⁴. Në legjislacionin e vendeve komunitare shpesh në vend të termit mallra me akcizë gjejmë mallra me taksa të larta, por që nënkupton mallrat e akcizës⁴⁶⁵.

Ana objektive e kësaj vepre penale nuk dallon nga ajo e mallrave të tjera, krimi kryhet përmes kalimit jashtë zonave doganore, pikave të kalimit kufitar të mallit objekt kontrabandë, apo nëpërmjet zonës doganore duke mosdeklaruar mallin, me fshehje të pjesshme apo të plotë të tij, ose duke deklaruar një sasivlere, lloj, cilësi, të ndryshëm nga

⁴⁶³ Sipas studiuësve italianë “Pjesërisht kjo formë e evazionit, që zakonisht ndodhin në kontrabandën doganore të jashtme, ka forma të kontrabandës së brendshme, që parashikohen nga ligje financiare jo doganore, nën tutelën e taksave të tjera, të tilla si taksa e prodhimit, e monopoleve fiskale, të taksave të konsumit komunal”. Më shumë shiko. S. Gallo: “Kontrabanda doganore një vepër antike dhe ende aktive”, në *Rivista della Guardia di Finanza nr. 1-2001*, fq. 337.

⁴⁶⁴ Në ligjin nr. 61/2012, “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”.

⁴⁶⁵ Sipas praktikës gjyqësore franceze “Një mall konsiderohet si “shumë i taksuar” (neni 7 i Kodit Doganor), nga njëra anë, kur detyrimet dhe taksat e importit tejkalojnë 25% të vlerës së mallit dhe, nga ana tjetër, kemi mallra, të cilat janë parashikuar në një urdhër ministror (urdhër datë 26 shkurt 1969 “Mbi përkufizimet e mallrave shumë të taksuara sipas Kodit Doganor”) mallra që edhe pse bashkësia e taksave që i nënshtrohen është më e ulët ose e barabartë më 25% të vlerës që kanë, por që nuk kanë vlerë më poshtë se 20 % (Cass. crim. 23 shkurt 2005, rekurs nr. 03-84441, Bul. Crim., Nr. 71 fq. 250 ose Cass crim 26 shtator 2001, rekurs nr. 01-80476).

ajo e konstatuar nga autoriteti doganor, deklarim fiktiv në eksport dhe duke e përdorur këtë mall në tregun e brendshëm, apo duke kaluar kufirin jashtë zonave doganore⁴⁶⁶.

Në këtë kuadër, është e provuar dhe e dokumentuar, se shumë mallra që janë futur në Shqipëri, kanë hyrë me dokumente të falsifikuara, në të cilat zvogëlohensasitë, çmimet, vlefata, tonazhet, destinacionet, etj. ose nuk dokumentohen fare, duke mos lënë gjurmë në doganat shqiptare. Subjektet që merren me aktivitet tregtar veprojnë me dy palë dokumente. Mallin që blejnë, prej vendit ku blihet deri në doganën kufitare të shtetit të huaj, e qarkullojnë me dokumente të rregullta, origjinale, të lëshuara nga fabrika apo subjekti qëbën shitjen. Në doganat shqiptare nuk dorëzojnë këto dokumente, por të tjera, me përmbajtje jo reale, të cilat i përgatisin vetë në territorin shqiptar, pasi disponojnë formularët dhe vulat e shteteve të huaja. Ka shumë raste që këto dokumente të falsifikuara i përgatisin në bashkëpunim me ortakët, që ndodhen në shtetet e huaja, të

⁴⁶⁶Në çështjen penale “Shteti kundër të pandehurit K.K. “Gjykata e Apelit me vendimin nr. 1589, datë 10/31/2012, ka lënë në fuqi vendimin Nr. 123, datë 18/02/2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, e cila ka vendosur ndër të tjera: “Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të “Kontrabandë me mallra që paguhet akcizë” e mbetur në tentativë, e parashikuar nga nenet 172 e 22 të Kodit Penal, me arsyetimin se Vendimi Nr. 123 (11-2011-788), datë 18/02/2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor është i bazuar në ligj e në prova për arsye se: “Në zbatim edhe të Ligjit Nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në R. Shqipërisë”... Në kushtet kur ky mall ka ardhur në mënyrë të paligjshme, nuk mund t’u nënshtrohet procedurave për zhdoganim dhe futje në tregun e lirë, referuar edhe nenit 280 të Kodit Doganor, sipas së cilit përcaktohet se kontrabandë konsiderohet edhe eksportimi ose importimi i mallrave të ndaluara ose që u nënshtrohen kufizimeve, me përjashtim të rasteve kur është lëshuar autorizim me shkrim nga organi kompetent”

Në lidhje me cilësimin ligjor të faktit penal, në rastet kur malli është deklaruar i saktë, cigare, por mungojnë pullat fiskale, zgjidhja e dhënë nga të dyja gjykatat nuk mund të mos lindin diskutime dhe të kërkojë një forcë argumentuese për dy probleme. Ky diskutim ka vlera praktike në fushën e jurisprudencës, pasi në raste analoge mund të gjendemi përpara një rëndimi të pozitës së subjektit, të gjykuar për veprën penale të kontrabandës”.

Së pari, të dyja gjykatat i janë referuar ligjit Nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat në R. Shqipërisë”...dhe, duke e konsideruar të ndaluar artikullin cigare pa pullë, ka gjykuar se kalimi i këtij malli në kufirin shtetëror në zonën doganore përbën veprim të kundërligjshëm dhe për rrjedhojë në kushtet e shmangies nga pagesat doganore, pasi mungojnë pullat fiskale, kjo përbën arsye të mjaftueshme për ta klasifikuar këtë veprim në kontrabandë me mallra akcize. Mirëpo, gjykata nuk ka mbajtur parasysh se për artikullin cigare pa pullë ka një ligj material ..., ku përcakton se kur gjenden cigare pa pullë ato konfiskohen, ndërkohë që në vështrim të nenit 256 të Kodit Doganor kontrabanda kërkon edhe elementin e anës objektive për deklarimin e mallit të përcaktuar në nenin 80 të Kodit Doganor. Për sa kohë malli është deklaruar, por gjendet pa pullë nuk është shkelur deklarimi i saktë, apo nuk janë kryer veprime të tjera që kanë synuar për t’u shmangur kontrollit doganor, përkundrazi.

Së dyti, pyetja që përbën objekt diskutimi është nëse në rastin konkret gjendemi përpara kontrabandës të mbetur në tentativë, siç ka arsyetuar gjykata. Mendoj se gjykatat kanë gabuar në vlerësimin e veprës penale kontrabandë të mbetur në tentativë për arsyen e thjeshtë, se veprat me karakter formal, si çështje edhe kontrabanda quhet e konsumuar që në kalimin e mallit të kufirit shtetëror të mallrave të padeklaruar dhe pa pullë fiskale. Ky mendim gjen mbështetje edhe në jurisprudencën e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Më shumë shiko edhe vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë Nr. 608, dt. 26.09.2007 dhe Vendimin nr. 372, datë 21.04.2010.

cilët paraqiten edhe si shitës të mallit tek ortaku, edhe si blerës i këtij malli së bashku me ortakun shqiptar.

Në rastet e cigareve, si rregull, kontrabandimi ose është bërë duke kaluar jashtëzonës doganore, porteve detare, pikave të kalimit kufitar, ose nëpër zonën doganore duke mashtruar lidhur me mallin objekt deklarimi, ose duke deklaruar një sasi më të vogël se ç'konstatohet realisht nga autoriteti doganor, apo duke bashkëpunuar me të përkundrejt përfitimit material.

Kontrabandimi me cigare nuk duhet ngatërruar me shkeljet fiskale të përcaktuara në legjislacionin tatimor, lidhur me cigaret pa pullë. Kështu, në çështjen penale që kishte të bënte me dy automjete me cigare pa pullë fiskale të trafikuar nga subjekti A, në vitin 2007, dhe të sekuestruara nga Policia e Shtetit, prokuroria e rrethit bazuar në kallëzimin e bërë nga autoriteti shtetëror filloi procedimin penal në ngarkim të subjektit A. Meqenëse, sipas organit të akuzës, nuk u provua vepra penale e kontrabandës, në vendimin e pushimit të procedimit penal u përcaktua edhe urdhërimi për kthimin e mallit të sekuestruar, cigare, edhe pse ato ishin pa pullë dhe në referim të ligjit tatimor përcaktohej ndalimi i tranzitimit të cigareve papullë dhe konfiskimi i tyre nga autoriteti i ngarkuar me ligj.

Legjislacioni doganor i vendeve komunitare⁴⁶⁷ dhe Gjykata Penale i ka kushtuar një vëmendje të veçantë goditjes së krimit të kontrabandës së duhanit, duke përfshirë si vepër penale edhe rastet e shitjes, transportimit, blerjes apo mbajtjes në territorin e shtetit të një sasive duhani të përpunuar dhe të kontrabanduar⁴⁶⁸ në territorin e shtetit në sasi më të madhe se 10 kg duhan të prodhuar jashtë, madje edhe tranzitimi i tyre përmes territorit të shtetit drejt një shteti tjetër, kur në të nuk janë paguar detyrimet doganore, apo nuk dihet origjina e mallit të duhanit⁴⁶⁹. Gjithashtu, në lidhje me këto vepra penale, duke pasur parasysh edhe rrezikshmërinë e madhe, legjislatori, ndryshe nga legjislacioni i vendittonë, ka parashikuar rrethana rënduese duke parashikuar përveç dënimit me gjobë dhe burg 4-15 vjet. Për shembull, kur krimi i kontrabandimit të duhanit kryhet me armë, kur vërtetohet se ka qenë posedues i tyre në momentin e kryerjes së veprës

⁴⁶⁷ Neni 291 i Kodit Doganor Italian.

⁴⁶⁸ Ligji nr. 92 i 2000, (ndryshime në Kodit Doganor Italian) ka përfshirë të gjitha normat që janë parë duke sanksionuar aspektet e ndryshme të kontrabandës së duhanit të punuar jashtë dhe, në mënyrë të veçantë, të kontrabandës së agravuar, mbuluar më parë nga Ligji i 18 Janarit 1994 nr. 5, i cili parashikon masa më të rënda, siç do shihet më qartë më poshtë. Me disiplinën e mëparshme, kontrabanda e duhanit të punuar jashtë u asimilua nga një tarifë e përbashkët dhe, në rast se kalohej pragu prej 15 kg, i ndëshkueshëm nga neni 2 i Ligjit nr. 50 i 1994, me artikullin 291, vepra e kontrabandës së duhanit të punuar jashtë vendit merr një identitet të saktë dhe autonom si në formën më të rëndë dhe në atë më të lehtë (kur produkti nuk kalon pragu të 10 kg).

⁴⁶⁹ Vendimi nr. 3552, datë 08.11.2000 i Gjykatës Penale Italiane.

penale, kur përdoren mjete transporti të përgatitur a posaçërisht që të çojnë në pengimin e ndërhyrjes së autoritetit shtetëror, të kryera në bashkëpunim, nëse kontrabanda kryhet nga grup i armatosur me pjesëmarrje mbi 10 vetë.

Për sa më lart, është më së e evidente që dispozitat penale për veprën e kontrabandës me mallra të akcizës të riformulohen, duke përfshirë edhe kontrabandën në kushte të cilësuar dhe duke forcuar dënimet penale si me gjobë edhe me burg dhe jo dënime alternative.

2.6. Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore.

Vepra penale e kryer nga punonjës të doganës ose punonjës që kanë lidhje me veprimtarinë doganore, neni 175, ka subjekt të posaçëm, në ndryshim nga dispozitat e tjera që bëjnë fjalë për veprën penale të kontrabandës. Ajo është cilësuar sipas dispozitave të Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, kontrabandë e kryer nga punonjës të doganave, pasi subjekte të kësaj figure krimi janë vetëm personat që janë mbajtës të këtyre cilësive të veçanta dhe jo çdo punonjës i ngarkuar me funksion shtetëror ose me shërbim publik, nga të cilat përbëhet subjekti i figurës së krimit të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

Figura e krimit të kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, është një variant i figurës së përgjithshme të krimit të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i tij, e cila realizohet në një fushë specifike të veprimtarisë shtetërore, sikurse është ajo e doganave dhe prandaj këto dy figura krimi nuk mund të konkurrojnë me njëra-tjetrën. Po kështu, kjo veprë nuk konkurren me asnjë nga veprat e tjera që parashikohen për kontrabandën, por duke qenë se kontrabanda kryhet nga një person zyrtar⁴⁷⁰, nëse provohet edhe mitmarrja, atëherë

⁴⁷⁰ Në çështjen penale “Shteti kundër të gjykuarve A. A. e të tjerë”, Gjykata e Shkallës së Parë me vendim nr. 58, datë 07.07. 2010, vendosi ndër të tjera: “Deklarimin fajtor të të gjykuarit A. A. për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve” parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal... Në bazë të nenit 39 të Kodit Penal i hiqet e drejta e ushtrimit të profesionit për të ushtruar veprimtarinë e agjentit doganor për një periudhë prej 6 (gjashtë) muaj.... Deklarimin fajtor të të pandehurit D.D. për veprën penale të “Kontrabandës me mallra të tjerë” parashikuar nga neni 174/1 i Kodit Penal, me arsyetimin se:

Nga shqyrtimi në tërësi i akteve që ndodhen në fashikullin e procedimit penal në ngarkim të të gjykuarit A. A., (akuzuar për veprën penale të “Falsifikimit të dokumenteve” dhe D. D. (“Kontrabandës me mallra të tjerë” parashikuar nga neni 174/1 i Kodit Penal) gjykata krijon bindjen e plotë se të gjykuarit janë autorë të veprave penale për të cilat akuzohen. Të gjykuarit kanë konsumuar të gjitha elementet e veprave penale për të cilat ata akuzohen dhe në bazë të dispozitave përkatëse të pandehurit duhet të deklarohen fajtorë dhe të dënohen”.

Në lidhje me çështjen objekt gjykimi, gjykata, siç mund të konstatohet me të drejtë, bazuar në praktikën e Gjykatës së Lartë dhe në veçanti të vendimit unifikues të Kolegjeve të Bashkuara. Më shumë shiko vendimin nr.1. datë 2002 të KBGJL ka arritur në konkluzionin e drejtë se falsifikimi nuk konkurren me veprën penale të kontrabandës, por ka qenë mjet për realizimin e saj.

nëkuptim të nenit 259 të Kodit Penal kemi të bëjmë gjithashtu edhe me korrupsion pasiv dhe për rrjedhojë "...do të përgjigjet për dy krime, në bazë të nenit 175 të Kodit Penal, për kontrabandë, dhe nenit 259 të Kodit Penal, për korrupsion pasiv⁴⁷¹".

Gjithashtu, personat që kryejnë kontrabandë, bashkëpunojnë me doganierët dhe punonjësit e policisë doganore, për të realizuar pjesërisht mallin në doganë. Në vitet e fundit, dhjetëra punonjës të doganave janë ndjekur penalisht, pikërisht për këtë shkak, pasi kanë bashkëpunuar me personat që kryejnë kontrabandë, duke fshehur ose pakësuar detyrimet për mallrat që kontrabandohen.

Në këto rrethana, veprat penale të parashikuara në nenin 175 të Kodit Penal, "Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore" konkurron edhe me veprat penale të parashikuara në nenet 259 dhe 260 të Kodit Penal. Por, në praktikë, është e vështirë për t'u vërtetuar akuza e marrjes së mitës nga ana e punonjësve të doganës, për faktin se dhe personi që jep mite, duhet të merret në përgjegjësinë penale për veprën penale të "dhënies së shpërblimit punonjësit që kryhen një detyrë shtetërore ose shërbim publik", parashikuar nga neni 245 i Kodit Penal. Në rastet kur provohet edhe marrja e mitës, krahas veprës penale të parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal, punonjësi i doganave do të dënohet edhe për këtë vepër penale.

Sipas dispozitës së lartpërmendur, parashikohet së veprimet që cenojnë marrëdhëniet, të cilat garantojnë sigurimin e interesave shtetërore për rendin e importimit, eksportimit apo tranzitimit, në veprimtarinë e rregullt të doganave, interesat ekonomikë të shtetit apo të shtetasve të mbrojtur nga legjislacioni penal, gëzojnë një mbrojtje të posaçme juridike, që passjellin përgjegjësi penale. Këto veprime, për t'u cilësuar si vepër penale nga ligji, duhet që:

- të kenë prekur marrëdhëniet juridike (dispozitat përkatëse ligjore) që rregullojnë respektimin e interesave shtetërore nga importimi, eksportimi apo transitimi, në veprimtarinë e rregullt të doganave.
- nga ana objektive, këto veprime duhet të jenë aktive ose me mosveprime të kundërligjshme.

Për sa i përket kualifikimit të veprës penale të kryer nga agjenti doganor na duhet të shprehemi me rezerva, duke ngritur pyetjen nëse agjenti doganor përfshihet në rrethin e personave. Mendojmë se duke qenë se agjenti doganor është i licencuar nga autoriteti doganor për të punuar me dokumentacion doganor, nuk mund të vihet në diskutim se e gjithë veprimtaria e tij jo vetëm që lidhet me veprimtarinë doganore, por është e vetmja veprimtari që ai kryen në emër të agjencisë doganore dhe për llogari të shoqërisë tregtare apo subjektit individ. Ai duhet të përfshihet në rrethin e subjekteve të posaçme, që, ndërkohë, falë cilësive të tij të veçanta si agjent doganor dhe përdorimi i tyre për veprën penale të kontrabandës, vepra penale e kryer prej tij nuk duhet të klasifikohet si falsifikim i dokumenteve, por kontrabandë e kryer nga një punonjës që lidhet me veprimtarinë doganore.

⁴⁷¹ I. Elezi: "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", Pjesa e posaçme.

-subjekti që kryen këto veprime është subjekt i posaçëm dhe njëkohësisht duhet të ketë mbushur moshën për përgjegjësi penale, në rastin konkret të ketë mbushur moshën 14 vjeç.

-veprimet e autorit duhet të kryhen me dashje të drejtpërdrejtë.

- si rezultat i veprimeve të kundërligjshme, të subjektit të figurës së veprës penale të mësipërme, të shkaktohet pasoja e përcaktuar në këtë dispozitë dhe, midis tyre, duhet të ekzistojë lidhje e drejtpërdrejtë shkak/pasojë.

Praktika gjyqësore, edhe pse në fillim, deri në unifikimin e praktikës gjyqësore nga Gjykata e Lartë ka pasur paqartësi në lidhje me klasifikimin e veprës penale të kontrabandës, që kryhej nga punonjësit e doganës, duke u orientuar nga qëndrimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në përgjithësi ka gjykuar me profesionalizëm çështjet penale të kësaj natyre^{472/473}.

⁴⁷² Në çështjen penale “Shteti kundër të pandehurit L. B.” akuzuar për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, Gjykata e Rrethit Gjyqësor me vendimin Nr.1091, datë 5/29/2012, vendosi Deklarimin fajtor të të pandehurit Levzat Brahim, për veprën penale të “Kontrabandë nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore” dhe bazuar në nenin 175 të Kodit Penal, dënimin e tij me 4 (katër) vjet burgim me arsyetimin se :

- Gjykata krijoi bindjen se faktit i duhej dhënë një cilësim juridik i ndryshëm nga ai i dhënë nga prokurori dhe me vendim të ndërmjetëm të datës 09.01.2012, bazuar në nenin 375 të Kodit të Procedurës Penale, i jep faktit një cilësim të ri, sipas nenit 175 të Kodit Penal “Kontrabanda nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore”.

- Nga administrimi që iu bënë akteve shkresore të ndodhura në dosje, rezultoi i provuar fakti se, i pandehuri L.B. ka kryer plotësisht me dashje veprën penale të “Kontrabandës nga punonjës që lidhen me veprimtarinë doganore” parashikuar nga neni 175 i Kodit Penal.

- Është provuar se subjekti «A» shpk ka kaluar mall kontrabandë pa kryer veprimet e zhdoganimit të mallit në Degën e Doganës Kakavijë dhe se, nga personeli doganor, nuk janë kryer veprimet sipas ligjit.

- Në rastin në shqyrtim është provuar se subjekt i veprës penale është i pandehuri L. B. me persona të tjerë të sistemit zinxhir doganor...

⁴⁷³ Ndryshe ka qenë qëndrimi i Kolegjit Penal në çështjen penale “Shteti kundër I.S.” ku Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë me Vendimit (245) datë 17.03.2010, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 200, datë 23.06.2008 të Gjykatës së Apelit dhe vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe pushimin e çështjes penale në ngarkim të të gjykuarit I. S. me arsyetimin se :

- Të dyja vendimet e gjykatave janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit material, pasi nuk është pasur parasysh roli dhe pozita e të gjykuarit në momentin që ai akuzohet se ka kryer kontrabandë.

- I gjykuari nuk është subjekt i veprës penale të kontrabandës nga punonjës të doganave, pasi ai nuk e ka pasur këtë cilësi. Më datën 30.07.2007 ai ka mbaruar punën në orën 13.00, por rreth orës 17.00 përgjegjësi i pikës doganore i kërkon me telefon që të shkonte në vendin e punës për të ndihmuar në kryerjen e punës doganierin D. S. Duke munguar një nga elementët e kësaj vepre penale, çështja penale në ngarkim të të gjykuarit duhet të pushohet pasi:

-I gjykuari jo vetëm që nuk ka kryer veprime që lidhen me veprimtarinë doganore, por nuk kishte të drejtë të kryente veprime

- I gjykuari nuk kishte njohje me drejtuesit e automjeteve dhe nuk ka pasur asnjë përfitim prej tyre.

2.7.Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm.

Me vepra penale në lidhje me mallra të vendosura me regjimtë ndërmjetëm kuptojmë ato vepra të kundërligjshme, të kryera me dashje dhe me qëllim për t'iu shmangur pagimit të detyrimeve të importit apo për përfitime të tjera në forma dhe mënyra të ndryshme.

Në Kodin Penal, në nenin 177 “figura e krimit të kontrabandës me regjim të ndërmjetëm“ përcaktohet siimportimi, eksportimi apo tranzitimi i mallrave, duke i paraqitur ato me regjim të ndërmjetëm, me qëllim shmangien nga detyrimet doganore, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet⁴⁷⁴. Në fakt, kjo dispozitë është me tepër një reminishencë e Kodit Doganor të mëparshëm, ku ligjvënësi në nenin 49 të Kodit Doganor të vitit 1992, ndryshuar në vitin 1996, kishte përcaktuar regjimet e ndërmjetëm.⁴⁷⁵ Përmes kësaj dispozite, regjimi i ndërmjetëm konceptohej si mallra të cilat nuk paraqiteshin nëzyrën doganore për konsum.

Në Kodin Doganor në fuqi⁴⁷⁶, nuk e gjejmë këtë term. Ajo që përafrohet me të, janë regjimet doganore pezulluese, nenet 107-113 të Kodit Doganor, që konsiston në pezullim të detyrimeve të importit për sa kohë mallrat janë në regjimin doganor të miratuar.

Lidhur me këto dispozita doganore, në Kodin Doganor, është parashikuar vepra penale e kontrabandës në rastet e hedhjes në konsum të mallrave të vendosura në qarkullim të lirë, pasi janë importuar me pezullim të plotë ose të pjesshëm⁴⁷⁷ nga detyrimet doganore për

Pa dashur të vëmë në diskutim një vendim gjyqësor, lidhur me arsyetimin e Kolegjit Penal, se të dyja vendimet e gjykatave janë marrë në zbatim të gabuar të ligjit material, pasi nuk është pasur parasysh roli dhe pozita e të gjykuarit në momentin që ai akuzohet se ka kryer kontrabandë mund të ngrihen disa pyetje:

1. Referuar fakteve a janë cenuar *marrëdhëniet shoqërore të mbrojtura nga ligji penal, duke sjellë objektivisht një pasojë kriminale nga veprimi ose mosveprimi shoqërisht i rrezikshëm.*
2. Cila ka qenë pozita e të gjykuarit: të një doganieri që ka kryer një veprim apo mosveprim duke përdorur cilësitë e tij si nëpunës dogane, apo të një qytetari të zakonshëm? Nëse nuk do t'i kishte këto cilësi dhe bashkëpunimin me subjektin e mallit, a mund të realizohej kontrabanda? Përse gjendej në zyrën doganore, kishte një kërkesë urdhërimi nga eprori apo u gjend rastësisht?
3. Në këtë vepër penale kërkohet domosdoshmërisht qëllim pasuror.

⁴⁷⁴Neni 17 i Kodit Penal.

⁴⁷⁵ Kodi Doganor, botim i vitit 1992.

⁴⁷⁶ Kodi Doganor i vitit 1999.

⁴⁷⁷ Në çështjen penale “Shteti kundër të gjykuarit L.M.” Kolegji Penal i Gjykatës së Rrethit, me vendimin nr.185, datë01/19/2010, ka vendosur të deklarojë fajtor të gjykuarin L.M. për veprën penale të “Kontrabandës me mallra me regjim të ndërmjetëm” dhe në bazë të nenit 177 të Kodit Penal të dënohet me 300.000 lekë gjobë me arsyetimin:

“... ka rezultuar sipas vërtetimit të hyrjes, datë 31.07.2007, se i gjykuari ka hyrë së bashku me automjetin në kushtet e regjimit të ndërmjetëm doganor, të cilin, më vonë, pa kryer zhdoganimin e mallit, e ka riekportuar brenda afateve ligjore. Në këto kushte, i gjykuari ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar në nenin 177 të Kodit Penal, neni 276 i K.D) dhe vendosjen e mallrave në regjim të

shkak të destinacionit përfundimtar ose të përdorimit të tyre të veçantë, kur autoriteti doganor vërteton, se destinacioni i tyre përfundimtar ose përdorimi i tyre i veçantë është i ndryshëm nga ai që është përcaktuar për të përfituar përjashtimin nga detyrimet doganore. Edhe në kodet doganore të vendeve komunitare përfaqësojnë këtë përcaktim e gjejmë për veprat penale me regjim pezullimi⁴⁷⁸.

Duke qenë se kemi të bëjmë me përcaktime të ndryshe, por që në thelb ligjvënësi ka synuar të parashikojë një vepër penale për mallrat, të cilat importohen/eksportohen apo tranzitohen në kushtet e pezullimit të detyrimeve të importit dhe, meqenëse lidhur me këtë figurë të veprës penale, studiues dhe praktikantë të së drejtës penale kanë pasur diskutime në lidhje me klasifikimin e krimit dhe elementet përbërës të veprës penale, na duhet që të ndalemi më shumë në shpjegimin e kuptimit të kësaj vepre penale, gjë që do të ndihmojë vetëm në hartimin e dispozitave të reja për kontrabandën, por edhe në zbatimin praktik nga akuza dhe gjyqësori.

Kështu:

-Termi *regjim i ndërmjetëm* i përcaktuar në nenin 177 të Kodit Penal duhet të kuptohet si regjim pezullimi i detyrimeve të importit. Meqenëse kjo është një normë referuese, për kuptimin e këtij regjimi, duhet t'i drejtohem dispozitave doganore, neneve 117-180 të Kodit Doganor. Në referim të këtyre dispozitave ligjore, kërkohet të mbahet parasysh, se, nëse në Kodin Penal parashikohet një dispozitë penale për regjimin e ndërmjetëm, atëherë për figurën e përgjithshme të krimit të kontrabandës në regjimet pezullues duhet të parashikohen disa figura të veçanta të krimit të kontrabandës, si forma specifike e figurës së kontrabandës me regjime pezulluese, variante të veçanta të saj. Mirëpo, nga pikëpamja teorike dhe nga praktika gjyqësore, mund të përbëjnë paragrafë të veçantë të së njëjtës dispozitë penale, atë të krimeve të kontrabandës në kushtet e regjimeve pezulluese. Dua të theksoj se kjo nënndarje, në dispozita të veçanta apo në paragrafë të veçantë në të njëjtën dispozitë penale, kërkohet:

ndërmjetëm doganor (neni 157 e vijues i K.D.) ku parashikohen krimet doganore në kushtet e regjimit të ndërmjetëm.

Objekti i drejtpërdrejtë është marrëdhënie vendosur për mallrat në një procedurë të veçantë doganore, ku janë përcaktuar afatet e qëndrimit në këtë procedurë, si dhe detyrimet për t'u zhdoganuar ose riekportuar pas përfundimit të afatit të qëndrimit në këtë procedurë. (Neni 157 i K. Doganor, neni 276 i K.D.). I gjykuari i ka dashur pasojat, duke paraqitur autoveturën e tij si mall me status për të qëndruar me regjim të ndërmjetëm doganor, duke pasur si qëllim shmangien nga detyrimi doganor”.

⁴⁷⁸ Kemi kontrabandë kur gjendemi para “Zbritje apo zëvendësim përgjatë transportit të mallrave të dërguara me një regjim të pezulluar, çdo mashtrim doganor mbi transportin e mallrave që janë në një regjim të pezulluar. Neni 417 i Kodit Doganor Francez. Konsiderohen si objekt importi pa deklarim, edhe mallrat e deklaruar për eksport të përkohshëm, në rast të mos paraqitjes ose të diferencës në natyrë ose në lloj të këtyre mallrave nga ato të paraqitura në fillim”. Neni 424 i Kodit Doganor Francez.

-për arsye të objektit grupor të përbashkët, marrëdhëniet e përbashkëta të vendosura në sferën e pezullimit të pagimit të detyrimeve të importit të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

-për natyrën dhe karakteristikat kryesore të ndryshme të regjimeve doganore pezulluese, në këtë mënyrë do të krijohen kushte sa më efektive për të luftuar kundër kontrabandës në fushën e marrëdhënieve që krijohen gjatë vendosjes së mallrave në regjimet pezulluese të pagesave doganore.

- objekti i përgjithshëm dhe mundësia për t'u përfshirë në një dispozitë me disa paragrafë të veçantë përbën argument të mjaftueshëm për të dalë në përfundimin, se figura e krimit të kontrabandës me regjime pezulluese, siç theksojnë edhe Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë "Figura e krimit të kontrabandës me mallra me regjim të ndërmjetëm, parashikuar në nenin 177 të Kodit Penal nuk konkurren me figurat e tjera të kontrabandës.

-në cilësimin juridik të veprës penale duhet bërë kujdes në dallimin e kundërvajtjes së kryer nën këtë regjim me figurën e krimit të kontrabandës.

Për arsyet e lartpërmendura dhe për faktin që në praktikën gjyqësore dalin në pah moskuptime të veçorive dhe karakteristikave të veçanta, që kanë krimet e kontrabandës në regjimet e pezullimit, e shohim me vend të ndalemi veças për veprën penale, të cilat cenojnë regjimin juridik të mallrave në kushtet e vendosjes së tyre në një regjim pezullimi.

a.Kontrabanda me mallra në regjimin e tranzitimit

Kontrabanda me mallra në regjimin e tranzitimit do të konsiderohet.⁴⁷⁹

- *Shkarkimi, zëvendësimi i mallrave të vendosura në regjimin e tranzitimit, me qëllim që t'u shmangët detyrimeve të importit, si dhe çdo falsifikim apo mashtrim doganor mbi transportimin e mallrave në regjimin e tranzitit.*

2.7.1 Objekti i krimit të kontrabandësme regjim tranzit⁴⁸⁰, janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar lëvizjen e lirë të mallrave përmes territorit doganor nëkushtet

⁴⁷⁹ Në nenin 114-120 të Kodit dhe pikave 183-233, dispozita zbatuese, përcaktohen rregullat e detyrueshme për funksionimin e regjimit të tranzitit. Rregulli ligjor i regjimit të tranzitimit të mallrave mbështetet në nenin 5 të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tregtinë dhe Tarifat (GATT), i cili përcakton rregullat për lirinë e tranzitit në bazë të parimeve të Kombit më të favorizuar dhe të mos-diskriminimit, të cilat vihen në praktikë nga instrumentet e Organizatës Botërore të Doganave (OBD) me qëllimin final lehtësimin e tregtisë ndërkombëtare. Sipas kësaj dispozite "Trafiku në tranzit mund të bëhet me ose pa transportim, magazinim ose ndryshim të mënyrës së transportimit". Dhe se të gjitha këto procedura kryhen nën kontrollin e doganës, si pjesë e tranzitit doganor. Gjithashtu tranzitimi i mallrave gjen rregullim edhe në Konventat ATA, TIR, CMR, ku, në bazë të dokumentit *Carnet TIR*, apo *Carnet ATA*, malli në pikëpamje të pagimit të detyrimeve të importit garantohej nga shoqëria lëshuese e *Carnet-it*. Duke qenë me element sigurie, *Carnet ATA*, *TIR*, në vështrim të nenit 229 të Kodit të Procedurës Civile, përbëjnë provë të plotë lidhur me mallin që transportohet, sasinë, llojin. Më hollësisht shiko konventat përkatëse ATA, TIR.

e pezullimit të detyrimevetë import/eksportitqë ligji doganor i mbron posaçërishtnga veprimi mosveprimi kriminal⁴⁸¹.

Objekti material janë mallra të importuara, “mallra jo shqiptare dhe se vetë ai kishte leje të rregullt qëndrimi në atë shtet”⁴⁸², ose mallratë deklaruar për eksport të vendosura në një regjim tranzitimi me një pezullim të plotë apo të pjesshëm të detyrimeve të importit.

Krimi kryhet me veprime në kundërshtim me nenin 114- 120 të Kodit dhe pikave 183-233 DZB “Për dispozita zbatuesetëudhëzimeve që rregullojnë regjimet e tranzitimit dhe kushtëzimeve që kanë të bëjnë me:

- paraqitjen e mallrave të paprekura nëzyrën doganore të destinacionit, në përputhje me masat e ndërmarra nga autoritetet doganore për të siguruar identifikimin e tyre, apo respektimin e dispozitave doganore gjatë tranzitimit të mallrave.
- largiminemjetit të transportit në regjimin e tranzitit nga zyra doganore nisëse vetëm me miratim të autoriteteve doganore.
- paraqitjen e menjëhershme pranë autoriteteve doganore më të afërta të dërgesës dhe dokumentit T1, në rast devijimi nga itinerari i përcaktuar i mjetit të transportit.
- kryerjen e transportimit të mallit në një mjet tjetër transporti, vetëm nën mbikëqyrjen e autoriteteve doganore kompetente, në territorin ku do të bëhet transportimi apo nëvarësi të rrethanave të vëna në dijeni prej tyre.

⁴⁸⁰ Tranziti përbën një nga procedurat doganore që lejon lëvizjen e mallrave në territorin doganor, në kushtet e pezullimit të detyrimeve të import/eksportit. Në kuptim të nenit 114 të Kodit, me regjim doganor të tranzitit kuptohet lëvizja e mallrave:

a. Në procedurën e tranzitit të jashtëm, të mallrave jo-shqiptare pa qenë subjekt i detyrimeve të importit; pagesave të tjera të parashikuara nga dispozita të tjera në fuqi; masave të politikës tregtare, për aq kohë sa ato nuk e ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në/ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, duke zbatuar:

- procedurën e tranzitit të jashtëm kombëtar, ose,
- sipas Konventës TIR, me kusht që kjo lëvizje, filloi ose do të përfundojë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, është kryer midis dy pikave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet territorit të një vendi ose jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

- sipas Konventës ATA/Konventa e Stambollit 1990, apo në kushtet e respektimit të Marrëveshjeve.

b. Në procedurën e tranzitit të brendshëm, të mallrave shqiptare nga një pikë tek një pikë tjetër brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, si dhe kur kalojnë nëpërmjet një territori tjetër jashtë këtij territori, pa ndonjë ndryshim në statusin e tyre doganor:

- në procedurën e tranzitit të brendshëm kombëtar, me kusht që një mundësi e tillë të jetë e parashikuar në një marrëveshje ndërkombëtare:

- sipas Konventës TIR.

- sipas Konventës së ATA/Konventa e Stambollit, kur kryhet një lëvizje tranziti apo sipas Marrëveshjeve e Konventave ndërkombëtare.

⁴⁸¹ Më hollësisht shiko nenet 117 -178 të Kodit Doganor.

⁴⁸² Vendimi nr. 2904, datë 6.29.2009 i Gjykatës së Shkallës së Parë.

2.7.2 Ana objektive.

Vepra penale kryhet me veprime aktive të kundërligjshme në mënyra dhe forma të ndryshme, duke shfrytëzuar kushtet e pezullimit të detyrimeve doganore si:

- transporton mallra apo mjete transporti, duke shfrytëzuar kushtet e regjimit të tranzitimit me garanci të agjencisë doganore, me qëllim shmangiene detyrimeve të importit, duke i hedhur në qarkullim të lirë pa dijeninë dhe deklarin para autoritetit doganor.

“Ata, pasi i kanë futur këto automjete në territorin e Republikës së Shqipërisë pa paguar detyrime zhdoganimi, i kanë lënë në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe vetë janë larguar si këmbësorë në drejtim të “FYROMacedonia”. Si pasojë, Dega e Doganës Durrës, ka mbledhur detyrimin doganor të importit në 364.890 lekë për secilin mjet, shumë e cila duhej të paguhej nga të pandehurit”. Vendiminr. 6508, datë 10.12.2012 i Gjykatës së Shkallës së Parë.

- heqja ose falsifikimi nëçfarëdolloj mënyre të numrave të identifikimit të mjetit të transportit, thyerja, zëvendësimi ose ndërrimi i shenjave të sigurisë së mallit me çdo mënyrë që t’i hedhë në qarkullim të lirë:

- ngarkon, shkarkon ose transporton mallra, bagazhe pa leje të autoritetit doganor *“duke paraqitur përpara agjencisë doganore dhe autoriteteve doganore shqiptare rrethana të rreme lidhur me regjimin doganor (tranzit T1)”*⁴⁸³.

- ndalimin e mjetit detar dhe shkarkimin, transportimin e mallrave pa njoftuar dhe pa lejen e autoritetit doganor, në kushtet e regjimit të tranzitimit të brendshëm, neni 278 i Kodit Doganor.

- çdo mashtrim për të paraqitur mungesën e mallrave në bordin e anijes së eksportuar drejt Shqipërisë, apo çdo hedhje në konsum të mallrave të vendosura në qarkullim, përdorim, pasi janë importuar me pezullim të plotë apo të pjesshëm të detyrimeve doganore për shkak të destinacionit përfundimtar ose përdorimi i veçantë i tyre, kur autoritetet doganore vërtetojnë se destinacioni përfundimtar ose përdorimi i tyre vakant është i ndryshëm nga ai i përcaktuar, për të përfituar nga përjashtimi i detyrimit doganor.

*“Duke paraqitur mallin si me regjim të ndërmjetëm (në rastin tonë tranzit), me qëllim shmangien nga detyrimi doganor, rezulton se malli nuk është kaluar tranzit për në Greqi, po i është dhënë shtetasit E. L., i cili është banues në Burrel, pra gjeografikisht, në anë të kundërt me pikën kufitare Kakavijë, ku është bërë deklarimi se do të kalonte tranzit mjeti”*⁴⁸⁴

⁴⁸³Vendimit nr. 6508, datë 10.12.2012 i Gjykatës së Shkallës së Parë.

⁴⁸⁴Vendimit nr. 2284 datë 05/22/2009 Gjykatës Shkallës Parë.

2.7.3 Subjekti i veprës penale.

Si rregull është drejtuesi i automjetit, i mjetit detar, hekurudhor, ajror apo personi përgjegjës i vendosjes së mallrave në regjimin e tranzitimit.

Ana subjektive e krimit të kontrabandës me mallra në regjimin e tranzitimit doganor kryhet me dashje, ashtu si të gjitha veprat penale të mësipërme, me qëllim parësor shmangien nga detyrimet e importit. *“I pandehuri nuk kasi qëllim kalimin tranzit të motorit, por shitjen e tij brenda vendit”*⁴⁸⁵.

Ana subjektive e kësaj vepre penale duhet të shihet në lidhje të ngushtë me anën objektive, pasi *“ana subjektive plotësohet edhe nga fakti që i pandehuri merret me shitblerjen e automjeteve. Pra, e rëndësishme në vlerësim është fakti, nëse nga ana objektive dhe mënyra konkrete që ka vepruar subjekti, a lexohet ana subjektive, qëllimi i tij për t’iu shmangur detyrimeve doganore”*⁴⁸⁶.

Rrezikshmëria e kësaj vepre penale është më e madhe, ngaqë importimi i mallrave apo tranzitimi i tyre për eksportim mund të kryhet në përputhje me ligjin, por kundërligjshmëria realizohet pas vendosjes në këtë regjim ose gjatë funksionimit të këtij regjimi, duke përdorur format e mësipërme. P.sh. duke shfrytëzuar mundësitë për të kryer procedura të përshpejtuara, në kalimin e pikave doganore kufitare tranziton mallra në plumbosje të dyfishtë si nga vendi eksportues, ashtu edhe në vendin importues (plumb mbi plumb), dhe gjatë tranzitimit shkarkon mallrat kontrabandëtë fshehura, duke prishur dhe falsifikuar shenjën e vulave apo rivendosjete tyre në bashkëpunim me doganierin.

Kontrabanda me mallrat e vendosura në regjimin magazinimit doganor

*Kontrabanda e mallrave të vendosura në regjimin e magazinimit doganor*⁴⁸⁷ konsiston në: *“Nxjerrjen, hedhjen në qarkullim të lirë të mallrave të vendosura në regjimin e magazinimit doganor dhe çdo formë tjetër mashtrimi për të paraqitur këto mallra të asgjësuar, shkatërruara për shkaqe natyrore, me qëllim shmangien nga pagimi i detyrimeve të importit”*. Baza juridike, ku referohet Kodi Penal për kontrabandën me mallrat e vendosura në regjimin e magazinimit doganor, janë nenet 121 -135; 181-187

⁴⁸⁵Vendimit nr. 6508 datë 10/12/2012 Gjykatës Shkallës Parë.

⁴⁸⁶Vendimit nr. 2904 datë 6/29/2009 Gjykatës Shkallës Parë.

⁴⁸⁷Me magazinim doganor kuptohet vendosja në një procedurë magazinimi të mallrave jo shqiptare në ambiente ose vende të tjera të autorizuara nga autoritetet doganore për këtë procedurë dhe nën mbikëqyrjen doganore, brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, pa iu nënshtruar detyrimeve të importit, pagesave të tjera siç parashikohen në dispozitat e tjera përkatëse në fuqi....,

të Kodit Doganor, pika 240 -271;452-472 VKM Nr.205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese”⁴⁸⁸.

Objekti i krimit të kontrabandësme regjim magazinimi doganor janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar funksionimin e magazinimit të mallrave me pezullim të detyrimeve të importit, që ligji doganor i mbron posaçërisht nga veprimi mosveprimi kriminal⁴⁸⁹.

Objekti material janë mallra të importuara, të vendosura në një magazinë doganore me një pezullim të plotë apo të pjesshëm të detyrimeve të importit. Në raste të veçanta, objekti material mund të jenë edhe mallra shqiptare të vendosura në këtë regjim për t'u eksportuar. Në kushtet e magazinimit të tipit C, magazina të furnizimit të anijeve dhe mjeteve fluturuese dhe për “*duty free shop object*” material mund të jenë mallrat e furnizimit të anijes, mjeteve fluturuese dhe mallrat e destinuar për “*free shop*”.

- **Ana objektive.**

Krimi kryhet me veprime në kundërshtim me nenet 121 -135;181-187 të Kodit Doganor, pika 240 - 271;452-472 VKM nr.205, datë. 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese” si dhe me kushtëzimet që kanë të bëjnë me:

-Përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga magazinimi i mallrave të mbuluara nga procedurat e magazinimit të përkohshëm ose magazinimit doganor. P.sh. subjekti “A” ka vendosur në regjimin e magazinimit doganor një sasi prej 2000 ton karburant me pezullim të pagesave të detyrimeve të importit për një periudhë 1-vjeçare, me të drejtën e zgjatjes të afatit edhe një vit, ai kërkon tranzitimin e këtij malli në drejtim të Kosovës.

⁴⁸⁸ Tranziti përbën një nga procedurat doganore që lejon lëvizjen e mallrave në territorin doganor, në kushtet e pezullimit të detyrimeve të import/eksportit. Në kuptim të nenit 114 të Kodit, me regjim doganor të tranzitit kuptohet lëvizja e mallrave:

a. Në procedurën e tranzitit të jashtëm të mallrave jo-shqiptare, pa qenë subjekt i detyrimeve të importit; pagesave të tjera të parashikuara nga dispozita të tjera në fuqi; masave të politikës tregtare, për atë që nuk e ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në/ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, duke zbatuar:

- procedurën e tranzitit të jashtëm kombëtar, ose,

- sipas Konventës TIR, me kusht që kjo lëvizje, filloi ose do të përfundojë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, është kryer midis dy pikave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë nëpërmjet territorit të një vendi ose territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

- sipas Konventës ATA/Konventa e Stambollit, apo në kushtet e respektimit të Marrëveshjeve.

b. Në procedurën e tranzitit të brendshëm të mallrave shqiptare nga një pikë tek një pikë tjetër brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, si dhe kur kalojnë nëpërmjet një territori tjetër jashtë këtij territori, pa ndonjë ndryshim në statusin e tyre doganor.

- në procedurën e tranzitit të brendshëm kombëtar, me kusht që një mundësi e tillë të jetë e parashikuar në një marrëveshje ndërkombëtare:

- sipas Konventës TIR.

- sipas Konventës së ATA/Konventa e Stambollit, kur kryhet një lëvizje tranziti apo sipas Marrëveshjeve e Konventave ndërkombëtare.

⁴⁸⁹ Më hollësisht shiko nenet 117 -178 të Kodit Doganor.

Nëdoganën kufitare deklaror, me deklaratën doganore, fiktivisht mbylljen e tranzitimit të brendshëm dhe daljen e karburanteve në drejtim të subjektit “B” në Kosove, duke u shkarkuar nga detyrimet e importit të lindura nëçastin e vendosjes së mallrave në regjimin doganor të magazinimit.

-Respektimin e kushteve të veçanta të specifikuara në autorizimin për operimin e magazinës doganore⁴⁹⁰, ose ambienteve të magazinimit të përkohshëm, futjene paligjshme të mallrave në një pjesë të territorit doganor, të cilat kanë qenë të vendosura në një magazinim të lirë.

-Përdorimin ose konsumimin në një zonë magazinimit të lirë të mallrave që u nënshtrohen detyrimeve të importit, në kushte të ndryshme nga ato të parashikuara me ligj, duke i paraqitur këto mallra nëpërmjet mashtrimit sikur janë në kushtet e parregullsive të parashikuara në pikën 574.2 apo të nenit 221 dhe pikave 577-581 të Dispozitave zbatuese, apo sikur këto mallra janë zhdukur, djegur, transformuar, apo kanë humbur për shkaqe natyrore.

-Futjen e mallrave të blera në “*Free shop*” në aeroportin e Rinasit, në territorin doganor të RSH, apo konsumimin, shitjen e mallrave të importit të destinuara për *freeshop* nëpërmjet falsifikimit të dokumenteve doganore.

- **Subjekti i veprës penale.**

Si rregull është mbajtësi i autorizimit të regjimit doganor, por mund të përfshihet edhe subjekti përgjegjës i mallrave të vendosura në regjimin e magazinimit doganor.

- **Ana subjektive** e krimit të kontrabandësme mallra në regjimin e magazinimit doganor kryhet me dashje, si të gjitha veprat penale të mësipërme, me qëllim parësorshmangien nga detyrimet e importit.

Rrezikshmëria e kësaj vepre penale është më e madhe për arsye se importimi i mallrave apo tranzitimi për eksportim i tyre mund të kryhet në përputhje me ligjin, por kundërligjshmëria realizohet pas vendosjes në këtë regjim ose pikasja e funksionimit të këtij regjimi, duke përdorur forma apo hapësira ligjore që në dukje janë legale, ndërkohë që investigimi doganor apo i organit të akuzës e ka të vështirë t’i provojë faktet që kanë të bëjnë me mashtrimin, në humbjet e pakthyeshme të mallrave të vendosura në regjimin e magazinimit doganor me pezullim të detyrimet doganore. P.sh : A pasi ka vendosur mallrat nën regjimin e magazinimit doganor, duke deklaruar saktë mallin e vendosur në këtë regjim, madje duke garantuar edhe borxhin doganor në rast diferencash të

⁴⁹⁰ Me veprime aktive, si nxjerrja e mallrave jashtë magazinës doganore pa lejen e doganës dhe hedhja në qarkullim pa deklaruar sasinë e tyre në organet tatimore e doganore, mbyllja e këtij regjimi përmes rieksporimit. Rast “Kafe de Brazil”, Vendimi nr.1, datë 26.03.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, apo me mosveprime, mosdeklarimit të saktë të mallit gjatë importimit, që do të vendoset në një regjim doganor, apo mosdeklarimi i saktë i produktit kompensues gjatë rieksporimit dhe mbylljes së regjimit doganor.

konstatuara nga autoriteti doganor. Gjithsesi, duke përdorur forma të ndryshme, pasi duke e zhvendosur mallin nga magazinat doganore, e paraqet situatën sikur këto mallra rezultojnë të asgjësuar, pra mehumbje të pakthyeshme (janë shkatërruar, djegur për shkak të një qarku të shkurtër elektrik, janë derdhur nga saraçineska të dëmtuara). Për shembull, pasi është marrë furnizimi me 1 ton cigare për dyqanin “Free shop” në aeroportin e Rinasit, nëpërmjet falsifikimit të dokumentacionit tatimor, sepse ka bërë hyrje fiktive të sasisë prej 1 ton cigare, 0.5 ton i shet pa i vendosur në regjimin magazinimit doganor, ndërkohë që në dokumentacionin tregtar i paraqet sikur janë shitur në dyqanin “Free Shop”.

Kontrabanda me mallrat e vendosura në regjimin lejimit të përkohshëm⁴⁹¹

Përbën kontrabandë në regjimin e lejimit të përkohshëm “hedhja në qarkullim të lirë të mallrave në lejim të përkohshëm, duke i paraqitur ato sikur janë riekportuar, shkatërruar apo duke përdorur forma të tjera të mashtrimit, me qëllim shmangiene detyrimeve të importit”.

Rregullimet juridike të regjimit të lejimit të përkohshëm gjenden në nenet 157-164 të Kodit, si dhe në pikat 342-402 të DZB. Në përcaktimin e masave dhe kushtëzimeve për dhënien e autorizimit për përdorimin e mallrave në procedurën e lejimit të përkohshëm, autoriteti doganor i referohet jo vetëm legjislacionit të brendshëm, por edhe atij komunitar, duke marrë në konsideratë marrëveshjet ndërkombëtare, natyrën dhe përdorimin e mallrave⁴⁹².

Bazuar në këto dispozita, lidhur me regjimin e lejimit të përkohshëm, përcaktohen një sërë kërkesash të detyrueshme:

-Procedura e pranimit të përkohshëm mund të përdoret vetëm kur:

a. mbajtësi i procedurës është i vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, përveçse kur është e parashikuar ndryshe në legjislacionin doganor.

b. kërkesat për përjashtimin të plotë ose të pjesshëm të detyrimeve të përcaktuara në legjislacionin doganor janë plotësuar.

⁴⁹¹ Referuar nenit 157 dhe pikës 392 me Regjim i lejimit të përkohshëm kuptohet “Përdorimi i mallrave jo shqiptare në procedurën e pranimit të përkohshëm në territorin doganor deri në riekportimin e tyre, duke u përjashtuar plotësisht ose pjesërisht nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtruar pagesave të tjera të parashikuara sipas dispozitave përkatëse në fuqi, si dhe masave të politikës tregtare, për aq kohë sa ato nuk ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në/ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë”.

⁴⁹² Për qëllimet e kësaj Konvente, termi: a) lejim i përkohshëm do të thotë: “Procedura doganore, sipas së cilës mallra të caktuara (duke përfshirë mjetet e transportit) mund të hyjnë në një territor doganor, duke u përjashtuar me kusht nga tatimet dhe taksat e importit dhe pa zbatuar ndalimet ose kufizimet e importit të natyrës ekonomike. Këto mallra (duke përfshirë mjetet e transportit) mund të importohen për një qëllim specifik dhe duhet të kenë për qëllim riekportimin brenda një periudhe të specifikuar dhe pa pësuar ndonjë ndryshim, përveç amortizimit normal për shkak të përdorimit të tyre”.

c.mallrat e vendosura në këtë regjim të jenë nga ato që përcaktohen në pikat 343 -361 të DZB.

Në gjykimin penal, që lidhet me regjimin e lejimit të përkohshëm (RLP), në procesin e të provuarit për gjykatën, rëndësi të veçantë kanë:

- Administrimi me cilësinë e provave të praktikave doganore, si deklarata doganore e rieksporimit, deklarata doganore në vendin e hyrjes së mallit pas rieksporimit, që të provohet se malli është rieksportuar në vendin eksportues, autorizimi për vendosjen e mjetit, makinerisë në RLP, dokumentacioni që provon se malli që do të rieksportohet apo që është rieksportuar ka qenë njëjti me të vendosurin në RLP.

- Artikulli objekt i RLP-së të jetë në listimin e mallrave të parashikuara në aneksin e DZB-së, për këtë qëllim, gjykatës, gjatë një mosmarrëveshje në kushtet e RLP-së mund t'i duhet të dëgjojë edhe mendimin e ekspertit të fushës.

- Provat shkresore që përmbajnë informacion e kontrollit aposterior në vendin eksportues të mallit për rikthimin e mallit në origjinë.

• **Objekti i krimit të kontrabandës** me regjim të lejimit të përkohshëm janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar funksionimin e këtij regjimi me pezullim të detyrimeve të importit, që ligji doganor i mbron posaçërisht nga veprimi mosveprimi kriminal⁴⁹³.

Objekti material janë mallra të importuara në këtë regjim, që:

- përfshihen në listimin e përcaktuar nga DZB-ja.

- nuk kanë si qëllim të pësojnë ndryshime, përveç zhvlerësimit normal për shkak të përdorimit të tyre, dhe,

- është e mundur të sigurohet që mallrat e vendosura në procedurë mund të identifikohen, me përjashtim të rasteve kur, duke pasur parasysh natyrën e mallrave ose destinacionin e përdorimit, mungesa e masave identifikuese nuk sjell ndonjë abuzim të procedurës, sikurse përputhshmëria me kushtet e përcaktuara mund të verifikohet për sa i përket mallrave ekuivalente.

• **Ana objektive.**

Krimi kryhet me veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenet 157-164 të Kodit, si dhe në pikat 342-402 të VKM nr.205, datë 13.04.1999 “Për Dispozitat Zbatuese...”⁴⁹⁴, të udhëzimeve që rregullojnë regjimet doganore dhe kushtëzimeve të autorizimit që kanë të

⁴⁹³ Më hollësisht shiko nenet 117 -178 të Kodit Doganor.

⁴⁹⁴ Me veprime aktive, si nxjerrja e mallrave jashtë magazinës doganore pa lejen e doganës dhe hedhja në qarkullim, pa deklaruar sasinë e tyre në organet tatimore e doganore, mbyllja e këtij regjimi përmes rieksporimit. Rast “Kafe të Brazil”. Vendimi nr.1, datë 26.03.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, apo me mosveprime, mosdeklarimi i saktë i mallit gjatë importimit, që do të vendoset në një regjim doganor, apo mosdeklarimi i saktë i produktit kompensues gjatë rieksporimit dhe mbylljes së regjimit doganor.

bëjnë me vendosjen e mallrave, kryesisht pajisjeve në regjimin e lejimit të përkohshëm, duke hedhur në qarkullim mallra në regjimin e lejimit të përkohshëm, duke kryer riekспортim fiktiv në vendin e destinacionit të mallit në regjimin e lejimit të përkohshëm apo duke i paraqitur ato sikur janë shkatërruar.

Subjekti “A” importon një buldozer dhe dy auto betoniere nga Greqia, duke i deklaruar në kushtet e regjimit të lejimit të përkohshëm me pezullim të detyrimeve të importit. Pas një periudhe kohe, nëpërmjet veprimeve të kundërligjshme në bashkëpunim me doganierët, dorëzon një deklaratë doganore fiktive me anë të të cilit deklarohen mjetet në regjimin doganor sikur janë riekportuar në vendin e origjinës, ndërkohë që këto mjete i shet në tregun e brendshëm, duke iu shmangur detyrimeve doganore.

Në varësi nga kushtet dhe rrethanat e anës objektive “kjo vepër penale kryhet edhe me mosveprim në kundërshtim me Kodin Doganor dhe dispozitat zbatuese të tij”. P.sh ...i pandehuri ka mbajtur në territorin shqiptar një automjet të vendosur në regjimin e lejimit të përkohshëm tej afateve të pacaktuara pa e zhdoganuar apo pa e nxjerrë jashtë territorit shqiptar, ku si pasojë shtetit i është shkaktuar një dëm prej 413.118 lekë, si dhe një euro për çdo ditë qëndrimi nga momenti i hyrjes në Shqipëri, deri në ditën e zhdoganimit apo daljes nga territori shqiptar⁴⁹⁵.

- **Ana subjektive e krimit të kontrabandës** me mallra të vendosura në RPL-në kryhet me dashje të drejtpërdrejtë si të gjitha veprat penale të mësipërme, me qëllim parësorshmangien nga detyrimet e importit⁴⁹⁶. Por, siç parashtrua edhe në rastin e mallrave të ndaluara, qëllimi mund të jetë edhe për veprime të përkrahjessë terrorizmit, thyerjes së embargos, etj.

P.sh. “Subjekti “A” importon një impiant me përdorim të dyfishtë nga Gjermania, duke e vendosur në regjimin e lejimit të përkohshëm, më vonë, pas 6 muajsh, përmes një bashkëpunimi me doganierin, deklaron fiktivisht për rikthim në origjinë të impiantit, në fakt artikullin impiant e kontrabandon drejt një vendi tjetër, për shembull në Iran me qëllim përdorimine tij nëteknologjinë atomike.

Një rast i veçantë, që është hasur në praktikën gjyqësore dhe nuk është kuptuar siç duhet, por që ka rëndësi për shkak të problemeve që implikon, është edhe rasti i makinave të importuara në kushtet e regjimit të ndërmjetëm. Kjo sa i takon konsiderimit të kryer të

⁴⁹⁵Vendimi nr. 1466, datë 4.3.2009 i Gjykatës së Shkallës së Parë.

⁴⁹⁶ “Kontrabandë me mallra të regjimit të ndërmjetëm” e parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal, në rastin konkret është konsumuar tërësisht, pasi i pandehuri, me dashje të drejtpërdrejtë dhe me mosveprim, ka shmangur detyrimet doganore që duhet të paguante për automjetin e tij. Në këtë mënyrë ai ka shkelur nenet 157-164 të Kodit Doganor, ku përcaktohet regjimi i lejimit të përkohshëm, si dhe nenet 382-384 të VKM-së nr. 205 dt.13.04.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”. Vendimi nr. 1466, datë 4.3.2009.

kontrabandës në këtë rast, si dhe zgjidhjes administrative të kontrabandës. Një rast i tillë, është trajtuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës⁴⁹⁷.

⁴⁹⁷ Kështu ka rezultuar, që i pandehuri e ka importuar këtë automjet nga Italia, duke e futur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë përmes Portit të Durrësit, më datë 27.05.2007. Sipas akuzës, i pandehuri nuk ka paguar detyrimet doganore për këtë automjet, pasi e ka deklaruar si mall me regjim të ndërmjetëm, duke përfutur nga fakti që malli nuk ishte shqiptar, por i regjistruar në Itali, ku i pandehuri ishte me leje qëndrimi të rregullt. Sipas akuzës, i pandehuri nuk e ka riekportuar automjetin e tij drejt Italisë, në përfundim të afatit të lejimit të regjimit të ndërmjetëm dhe as ka paguar detyrimet doganore, duke konsumuar elementët e figurës së veprës penale të kontrabandës me mallra me regjim të ndërmjetëm. Vepra penale për të cilën u akuzua i pandehuri parashikohet nga neni 177 i Kodit Penal, ku thuhet: “Importimi, eksportimi apo tranzitimi i mallrave, duke i paraqitur ato si mallra me regjim të ndërmjetëm, me qëllim shmangien nga detyrimet doganore, dënohen me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet”. Kjo është një normë referuese, pasi kuptimin e regjimit të ndërmjetëm e gjejmë tek ligji specifik që është Kodi Doganor, ligji me nr. 8449, datë 27.01.1999.

Në nenin 157 të Kodit Doganor parashikohet se “Regjimi i lejimit të përkohshëm bën të mundur përdorimin në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit dhe pa iu nënshtruar masave të politikave tregtare, të mallrave jo shqiptare të destinuar për t'u riekportuar, pa pësuar ndryshime, përveç zhvleftësimit normal për shkak të përdorimit të tyre”. Në kuptim të kësaj dispozite, mallrat që mund të lejohen të importohen pa paguar detyrime doganore janë vetëm mallrat jo shqiptare, pra, jo të prodhuara e të regjistruara në Shqipëri, por që hyjnë në territorin e këtij vendi për përdorim të përkohshëm, me qëllim riekportimi.

Nga ana tjetër, ky qëllim pranohet nga autoritetet doganore mbi bazën e vetëdeklarimit të subjektit. Kështu, në nenin 158 të Kodit Doganor, thuhet se “Autorizimi për lejimin e përkohshëm lëshohet në bazë të kërkesës së personit që i përdor mallrat ose që bën të mundur përdorimin e tyre”. Kështu ka ndodhur edhe në rastin për gjykim, pasi i pandehuri ka provuar para autoriteteve doganore se është pronar i automjetit në fjalë, një automjet i prodhuar dhe regjistruar në Itali, pra, mall jo shqiptar dhe se vetë ai kishte leje të rregullt qëndrimi në atë shtet.

Nga aktet e fashikullit, në cilësinë e provave, nuk rezultoi që autoritetet doganore t'i kenë caktuar afat të pandehurit për riekportimin e mjetit apo caktimin e një destinacioni të ri doganor. Ky afat, që duhej të mos tejkalonte afatin 12 mujor, mund të ishte zgjatur më kërkesë të arsyetuar mirë personit të interesuar, por edhe kjo gjë nuk rezultoi nga aktet e fashikullit.

Sipas këtyre dispozitave të cituara deri tani, logjika e ligjit kërkon që autoritetet doganore, kur pranojnë kërkesën për lejimin e përkohshëm, duhet të përcaktojnë edhe afatin, se kur subjekti duhet të riekportojë apo deklarojë një destinacion tjetër doganor për mallin për të cilin ka kërkuar lejimin e përkohshëm me përjashtim nga detyrimet e importit. Nëse brenda këtij afati, subjekti nuk bën një kërkesë të arsyetuar mirë për zgjatjen e këtij afati, autoritetet doganore duhet të nisin kryesisht procedimin administrativ, siç do parashtrihet më poshtë. Kjo është plotësisht e mundur, sa kohë që autoritetet doganore kanë apo duhet të kenë të regjistruar çdo hyrje malli apo veprim me to, sikurse u përmend më lart.

Nga ana tjetër, dispozitat e Kodit Doganor, detajohen më tej me akte nënligjore që zbesin në nivelin e kuptimit të rastit konkret për gjykim. Kjo gjë parashikohet në nenin 161 të Kodit Doganor, ku thuhet: “Rastet dhe kushtet e veçanta në të cilat mund të përdoret regjimi i lejimit të përkohshëm me përjashtim të plotë nga detyrimet e importit, përcaktohen në aktet nënligjore në zbatim të këtij Kodi”. Akti nënligjor konkret që e përcakton rastin për gjykim është neni 384.5/a i VKM-së nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”. Në këtë dispozitë thuhet: “Pa rënë ndesh me pikën 384.4, automjetet rrugore për përdorim privat mund të qëndrojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë për: a) një periudhë deri në 6 muaj, të vazhdueshme ose jo, matur gjatë një periudhe 12 mujore...”.

Për raste analoge, në praktikën gjyqësore, nga gjykata është bërë kujdes, që në shqyrtimin dhe analizën e anës subjektive të krimittë kontrabandës me mallra me regjim të lejimit të përkohshëm ta shikojnë të lidhur ngushtë me ekzistencën e qëllimit për shmangien nga detyrimet doganore, duke dalë në përfundimine drejtë se çështja penale e filluar nuk duhet të vazhdojë, pasi i pandehuri ka paguar detyrimin doganor së bashku me penalitetet për vonesën, duke paguar edhe taksën e qarkullimit për ditët e qëndrimit⁴⁹⁸.

Rrezikshmëria e kësaj vepre penale është më e madhe për arsye se importimi i mallrave apo eksportimi i tyre mund të kryhet nëpërputhje me ligjin, por kundërligjshmëria realizohet pas vendosjes në këtë regjim, ose gjatë funksionimit të këtij regjimi, duke përdorur dokumentacion të falsifikuar në lidhje me identitetin apo duke u larguar nga territori i Shqipërisë, pasi ka realizuar shitjen e automjetit. Pra, si rregull, nuk kemi të bëjmë me veprime të kundërligjshme përmes kalimit të mallrave në/dhe nga kufiri shtetëror, por kryesisht pas vendosjes të tyre në regjimin e magazinimit doganor dhe hedhjes së tyre në qarkullim të lirë, nëpërmjet mashtrimit apo formave të tjera të kundërligjshme.

Në rastin për gjykim, automjeti rrugor i importuar nga i pandehuri është për përdorim privat, sikurse përcakton pika 384.3 e VKM-së nr. 205, datë 13.03.1999 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, por gjithsesi jo për t’u përdorur prej tij, për udhëtim nga vendi i qëndrimit të tij në vendin e punës dhe anasjelltas, sikurse parashikohet në pikën 384.4/b dhe pretendon mbrojtja e të pandehurit. Ky parashikim i fundit bën fjalë për rastet, kur vendi i qëndrimit normal të përdoruesit, ku është edhe regjistruar automjeti privat, ndodhet në një shtet tjetër nga ai i vendit të punës, që gjendet në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Veç zgjatjes së afatit të përdorimit të automjetit nën lejimin e përkohshëm, pika 384.11 e VKM nr. 205, parashikon edhe ndërprerjen e afatit të qëndrimit të një automjeti të importuar në këtë regjim. Përdoruesi i këtij regjimi duhet të njoftojë për këtë qëllim autoritetet doganore dhe duhet të respektojë të gjitha masat që gjykohen të përshtatshme nga këto autoritete. Ndonëse nuk u pretendua, nga aktet e dosjes, nuk rezultoi e provuar që të ketë pasur një korrespondencë të prokurorisë me autoritetet doganore për të kuptuar nëse ka patur ndonjë zhvillim në këtë drejtim.

⁴⁹⁸ Në çështjen penale “Shteti kundër B.B.” Gjykata me vendimin nr. 4583, datë 11.17.2008, ka arsyetuar se “...Prokurori ka ngritur akuzë për të pandehurin B. B. për veprën penale të “Kontrabandës me mallra në regjim të ndërmjetëm”, parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal, me pretendimin se nuk ka respektuar afatet për rieksporimin e autovecurës apo të pagesës doganore... e çmon të pabazuar akuzën e prokurorit dhe arrin në konkluzionin, se duhet vendosur pushimi i çështjes penale, pasi çështja penale në ngarkim të të pandehurit B. B. nuk duhet të vazhdojë.

Situata juridike e të pandehurit në lidhje me këtë mjet nuk ka ndryshuar që nga deklarimi i bërë para autoritetit doganor, më datën 24.02.2007 deri në momentin e arrestimit të tij, më datë 12.03.2008. I pandehuri gjatë kësaj periudhe që përdorte mjetin e lejuar të qëndrojë në regjim të përkohshëm nuk ka kryer asnjë veprim që të arrihet në konkluzionin që kishte qëllim shmangien nga detyrimet doganore. I pandehuri nuk ka kryer veprime konkludente, apo fiktive si për shitje, apo huapërdorje, ndërhyrje për të ndryshuar numrin e identifikimit të mjetit, apo ndonjë veprim tjetër për ta pajisur më targa shqiptare, pa paguar detyrimin doganor. Në këto rrethana, Gjykata çmon se çështja penale e filluar nuk duhet të vazhdojë, pasi i pandehuri ka paguar detyrimin doganor së bashku me penalitetet për vonesën, duke paguar edhe taksën e qarkullimit për ditët e qëndrimit”.

Kontrabanda me mallrat e vendosura në regjimpërpunimi aktiv(RPA)⁴⁹⁹

Hedhja në qarkullim të lirë të mallrave në regjimine objekt përpunimit apo produkt kompensues, duke iu shmangur detyrimeve doganore apo për përfitime të tjera.

Rregullimet juridike të regjimit të përpunimit aktiv gjenden në nenet 136-149 të Kodit si dhe në pikat 272-321 të DZB-së⁵⁰⁰.

Në funksionimin e këtij regjimi kërkohet që:

a. Mallrat objekt përpunimi të jenë mallra me origjinë jo shqiptare, kryesisht lëndë e parë për një proces të ri përpunimi, domethënë të jenë mallra të cilat plotësojnë kushtet e një origjine të huaj, sipas përcaktimeve të nenit 30-32 të Kodit Doganor dhe që përjashtohen sipas nenit 32 të Kodit për të qenë me origjinëshqiptare.

b. Si rregull, mallrat duhet të jenë të destinuara për rieksporim pas përpunimit në formën e produktit të gatshëm ose pjesërisht të gatshëm, të realizuar në procedurën e përpunimit aktiv.

c. Mallrat e importuara të vendosura në këtë procedurë nuk u nënshtrohen detyrimeve të importit.

d. Në kushte dhe rrethana që mallrat e vendosura në këtë procedurë të mund të kontrollohen dhe të mbahen nëmbikëqyrje nga autoriteti doganor, si dhe pas proceseve të përpunimit të mund të identifikohen.

Gjithashtu, në nenin 136 të Kodit përcaktohet se procedura e përpunimit aktiv mund të përdoret edhe në raste që kanë të bëjnë me mallra shqiptare të destinuara t'i nënshtrohen operacioneve për të garantuar përputhjen e tyre me kërkesat teknike për çlirimin e tyre në qarkullim të lirë apo për mallrat, të cilat duhet t'i nënshtrohen formave të zakonshme të trajtimit në përputhje me dispozitat ligjore, nëse ato rieksporthen ose eksportohen brenda afateve të përcaktuara.

• **Objekti i krimit të kontrabandës** me regjim përpunimin aktiv janë marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar funksionimin e këtij regjimi të mallrave të importuara në kushtet e pezullimit të detyrimeve të importit dhe rieksporimit të tyre produkt kompensues, (të gatshëm), që ligji doganor i mbron posaçërisht nga veprimi mosveprimi kriminal... Janë

⁴⁹⁹ Në bazë të nenit 136 të Kodit, me vendosje të mallrave në procedurën e përpunimit aktiv kuptohet përdorimi i mallrat jo-shqiptare, të cilat janë të destinuara për rieksporim në formën e produktit të gatshëm ose pjesërisht të gatshëm, në një procedurë doganore, në një apo më shumë operacione përpunimi, pa iu nënshtrohet detyrimeve të importit, pagesave të tjera siç parashikohen në dispozitat përkatëse në fuqi, masave të politikës tregtare, për aq sa ato nuk ndalojnë hyrjen ose daljen e mallrave në/ose nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

⁵⁰⁰ Më hollësisht shiko nenet 117 -178 të Kodit Doganor.

veprime me qëllim importimin e mallrave që i nënshtrohen regjimit të ndërmjetëm, duke i paraqitur ato si të tilla dhe mospagimi i detyrimit doganor për këto mallra⁵⁰¹

Objekti material janë mallra të importuara, kryesisht lëndë e parë, si dhe produkti kompensues i përfutur në këtë regjim, i cili është i destinuar të rieksporthet.

- **Ana objektive.**

Krimi kryhet me veprime dhe mosveprime në kundërshtim me nenet 136-149 të Kodit, si dhe në pikat 272-321 të VKM-së nr.205, datë 13.04.1999 “Për Dispozita Zbatuese...”⁵⁰², si dhe të udhëzimeve që rregullojnë regjimet doganore dhe kushtëzimeve të autorizimit që kanë të bëjnë me:

- Mosdeklarimin apo deklarimin në sasi më të vogël të mallit objekt përpunimi doganor në kushtet e regjimit të përpunimit aktiv gjatë importimit, ose deklarimit në sasi më të madhe të produktit të gatshëm të përfutur në procesin e përpunimit aktiv⁵⁰³.

Ndodh që, në raste të tjera, subjekti i autorizuar importon mallra lëndë e parë të deklaruara IM5 përkundrejt autorizimit të përpunimit aktiv dhe, pasi i hedh në qarkullim

⁵⁰¹ Pra “... Janë ato veprime të të pandehurit, me të cilat preken ato marrëdhënie juridike të vendosura nga shteti për të siguruar miradministrimin dhe vjeljen e detyrimeve doganore, për mallra që cilësohen me regjim të ndërmjetëm, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal, nga çdo veprim apo mosveprim kriminal. Në këtë rast, janë veprimet me qëllim importimin e mallrave që i nënshtrohen regjimit të ndërmjetëm, duke i paraqitur ato si të tilla dhe mospagimi i detyrimit doganor për këto mallra. I pandehuri Marco Sforza, sipas vlerësimit të Gjykatës, ka importuar mallra, duke i paraqitur si mallra me regjim të ndërmjetëm, pa qenë të përfshira në autorizimin e posaçëm të lëshuar nga organet kompetente për cilësimin e këtyre mallrave si mallra me regjim.

⁵⁰² Me veprime aktive, si nxjerrja e mallrave jashtë magazinës doganore pa lejen e doganës dhe hedhja në qarkullim, pa deklaruar sasinë e tyre në organet tatimore e doganore, mbyllja e këtij regjimi përmes rieksportimit. Rast “Kafe të Brazil”, Vendimi nr.1, datë 26.03.2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, apo me mosveprime, mosdeklarimi i saktë i mallit gjatë importimit, që do të vendoset në një regjim doganor, apo mosdeklarimi i saktë i produktit kompensues gjatë rieksportimit dhe mbylljes së regjimit doganor.

⁵⁰³ Në çështjen penale “Shteti kundër A.B.” KA lidhur me analizën e anës objektive ka arsyetuar se: “Për sa i përket anës objektive, Gjykata çmon, se, në këtë rast, vepra penale nga i pandehuri është kryer me anë veprimesh aktive të kundërligjshme, që kanë konsistuar në futjen me qëllim importimin për përdorim brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, të mallrave si mallra me regjim të ndërmjetëm, duke shmangur në këtë mënyrë pagimin e detyrimit doganor ndaj tyre. Në këtë rast, i pandehuri i ka kanalizuar veprimet e tij të kundërligjshme në futjen si mallra me regjim, përtej listës shoqëruese të autorizimit të lëshuar nga organet kompetente, autorizim ky i domosdoshëm për kualifikimin e një malli të caktuar si mall me regjim të ndërmjetëm. Autorizimi në këtë rast merr një rëndësi të veçantë, pasi njeh një mall si mall me regjim të ndërmjetëm, duke i dhënë një status të veçantë për sa i përket detyrimeve doganore. Për mallra me regjim të ndërmjetëm, subjekti importues nuk ka detyrimin të paguajë tarifë doganore, pasi një mall i tillë, si përpunohet tërësisht apo pjesërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë, produkti i gatshëm nuk mund të tregtohet në këtë territor, por duhet të kthehet në vendin e origjinës për t’u shpërndarë më pas. Një produkt i tillë mund të tregtohet në Shqipëri, vetëm pasi të jetë paguar tarifa doganore përkatëse në varësi të llojit të mallit e kodit tarifor referues.

të lirë me veprime të kundërligjshme, i paraqet sikur janë djegur nëmagazinën doganore apo janë dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme.

P.sh.Subjekti “A”, në kushtet e regjimit të përpunimit aktiv, deklaroi nëzyrën doganore mallin lëndë të parë konfeksione lëkure më pak se ajo reale, me qëllim përfitimi të një sasive prej 200 këmisha dhe 600 palëkëpucë (produkt kompensues) më shumë, të cilat i përdor për t’i shitur në tregun e brendshëm pa paguar detyrime importi të lëndës së parë të importuar, ndërkohë që realizon mbylljen e regjimit doganor me rieksporimin e produktit të gatshëm që i korrespondon sasisës deklaruar të lëndës së parë.

- **Subjekti i veprës penale**

Në të vërtetë, përfaqëson një rreth të caktuar subjektësh, sidomos ata që janë mbajtës të autorizimit të regjimit doganor të përpunimit aktiv.

- **Ana subjektive e krimit të kontrabandës** me mallra në një procedurë të veçantë doganore kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, si të gjitha veprat penale të mësipërme me qëllim parësorshmangien nga detyrimet e importit, duke i hedhur për qarkullim të lirë mallrat lëndë e parë apo produkt i gatshëm. *“Vepra penale është kryer me faj në formën e dashjes së drejtpërdrejtë dhe me qëllim të posaçëm për të nxjerrë fitim material për vete. Motivi i kryerjes së veprës penale është i qartë, ai i interesit”*^{504/505}.

Kontrabanda me mallrat e vendosura në regjim përpunimi pasiv (RPP)

Regjimi i përpunimit pasiv⁵⁰⁶ është një procedurë krejt e kundërt me atë të përpunimit aktiv dhe përdoret në rastet për përmirësim cilësor të produktit të eksportuar përkohësisht, apo për përpunim të mëtejshëm për të përfutur një produkt të gatshëm.

⁵⁰⁴Vendimi i Gjykatë Shkallë Shkallës Parë, nr. 11-2011-3024, data 06.03.2011

⁵⁰⁵ Qëllimi i kryerjes së veprës penale nga i pandehuri është shmangia e pagimit të detyrimit doganor dhe është element i domosdoshëm i anës subjektive të figurës së kësaj vepre penale dhe ka rëndësi në cilësimin juridik të kësaj figure vepre penale, del i qartë nga tërësia e veprimeve të kryera nga i pandehuri. I pandehuri me vetëdije të plotë, duke shfrytëzuar edhe Autorizimin për Lejimin e Përpunimit Aktiv të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, së bashku me mallrat e futura në regjimin e përpunimit aktiv, ka importuar dhe mbajtur një sasi malli prej 76.287 metër linear tesut (lëndë e parë) dhe sasi produkti i gatshëm gjithsej 7819 copë, për të cilën nuk kishte asnjë dokumentacion justifikues financiar lidhur me prejardhjen e rregullt të këtij malli. Ai ka shmangur kështu kontrollin dhe mbikëqyrjen doganore mbi mallrat e mësipërme, me qëllim shmangien e pagesës së detyrimeve doganore në shumën 1.515.363 lekë. Vendimi i Gjykatë Shkallë Shkallës Parë, nr. 11-2011-3024, datë 06.03.2011.

⁵⁰⁶ Në nenin 165 të Kodit Doganor përpunimi pasiv kuptohet, si një eksportim i përkohshëm i mallrave nga territori doganor i mallrave në procedurën doganore për t’iu nënshtruar operacioneve të përpunimit. Produktet e përpunuara që dalin nga këto mallra mund të çlirohen për qarkullim të lirë, me përjashtim të plotë ose të pjesshëm nga detyrimet e importit, me kërkesë të mbajtësit të autorizimit ose të çdo personi tjetër i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, me kusht që ky person ka marrë miratimin e mbajtësit të autorizimit dhe kushtet e autorizimit janë përmbushur.

Gjithashtu, në këto dispozita përcaktohen edhe rastet, kur autoriteti doganor lejon përdorimin e shkëmbimeve standarde, pra kur përpunimi ka të bëjë me riparim të mallrave shqiptare nëpërmjet shkëmbimeve standarde. Në këtë rast, produktet zëvendësohen importohen paraprakisht dhe zëvendësohen në vendin eksportues, me kusht që produkti zëvendësues të ketë të njëjtin klasifikim tarifor.

Në nenet 165-180 të Kodit përcaktohet funksionimi i vendosjes së mallrave në procedurën e përpunimit pasiv dhe në pikat 404-427 të DZB-së.

Në funksionimin e këtij regjimi kërkohet që:

- Mallrat që riimportohen e më pas eksportohen në procedurën e përpunimit pasiv, të mund të identifikohen se janë përfutur nga përpunimi i mallrave të eksportuara përkohësisht.

- Eksportimi i tyre të mos sjellë si pasojë rimbursimin, shuarjen e detyrimeve të importit.

- Mallrat që do të eksportohen para përpunimit, të mos jenë vendosur në qarkullim të lirë, me përjashtim të plotë të detyrimeve doganore për arsye të përdorimit të tyre të veçantë, apo që eksportimi i tyre të sjellë si pasojë mundësinë e rimbursimit të pagesave për eksporte, ose përparësi financiare të dhëna për këto raste.

Në bazë të nenit 167 të Kodit, për të vendosur mallrat në këtë procedurë, operatori ekonomik duhet të pajiset me një autorizim që lëshohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bazë të kërkesës së ushtruar prej tij, me kusht që përdorimi i këtij autorizimi të mos sjellë si pasojë cenimin e interesave thelbësore të prodhuesve dhe përpunuesve shqiptarë⁵⁰⁷.

Siç mund të vërehet, edhe pse e njëjta gjë ndodh edhe në praktikën administrative doganore, identifikimi i mallit pas procedurës së përpunimit merr rëndësi të veçantë, ndaj në rastet e konflikteve që mund të lindin, si me ato që kanë të bëjnë me të drejtën e subjektit për të kërkuar vendosjen e mallrave në këtë regjim, ashtu edhe në rastet e mbylljes së regjimit nëçastin e importimit si produkt i gatshëm, është më se e domosdoshme për gjykatën, caktimi i ekspertëve të fushës për identifikimin apo mundësinë e identifikimit të mallit nëçastin e riekportimit.

Në rastet e konflikteve administrative apo të dyshimeve të arsyetuara për kontrabandim nëpërmjet përdorimit të regjimit të përpunimit pasiv, është më se e domosdoshme për gjykatën, caktimi i ekspertëve të fushës për identifikimin apo mundësinë e identifikimit të mallit të importuar nëçastin e riekportimit. Gjithashtu, rëndësi të veçantë me

⁵⁰⁷ Paragrafi i fundit nuk gjen mbështetje në ligjin komunitar, gjithçka për faktin se evoluimi i marrëdhënieve tregtare në kushtet e globalizimit ka gjetur shprehje në reduktimin e tarifave doganore për mallrat e importit dhe heqjen e çdo barriere në tregtinë dhe konkurrencën e mallrave në lirinë e tregut.

vlerëprovuese ka karta e shfrytëzimit teknik, përmes së cilës përcaktohet koeficienti i shfrytëzimit të mallit në regjimin e përpunimit pasiv.

- **Objekti i krimit.**

Objekti i krimit të kontrabandës me regjimin e përpunimit pasiv janë marrëdhëniet juridike të vendosura për funksionimin regjimeve doganore të përpunimit pasiv që ligji doganor i mbron posaçërisht⁵⁰⁸.

Objekti material janë mallra të eksportuara dhe të vendosura në një regjim doganor, me qëllim që, pas përpunimit, të importohen në Shqipëri si produkt kompensues.

- **Ana objektive.**

- Janë veprimet aktive për hedhjen qarkullim të lirë të produktit kompensues të përftuar nga një produkt i ndryshëm në sasi dhe cilësi, nga ai i eksportuar përkohësisht. P.sh. "A" kërkon të vendos artikullin *gjethe duhani*, të cilësisë së dobët apo jashtë përdorimit në procedurën e përpunimit pasiv, për ta eksportuar përkohësisht në një vend tjetër, duke e trajtuar atje si mall mbetje dhe, pas riekportimit të një nja sasi cigaresh, ta paraqesë si artikull qëi është nënshtruar përpunimit, kështu që të riimportohet si produkt kompensues në cigare, duke u hedhur në qarkullim të lirë me përjashtim të plotë apo të pjesshëm nga detyrimet e importit.

-deklarimi i një sasi, cilësie për eksporte të përkohshme nga ai i konstatuar nga autoriteti doganor.

- **Subjekti i veprës penale.**

Në fakt, përfaqësohet nga një rreth i caktuar subjektesh, veçanërisht ata që janë mbajtës të autorizimit të regjimit doganor të përpunimit pasiv.

- **Ana subjektive e krimit të kontrabandës** me mallra në një procedurë të veçantë doganore kryhet me dashje, si të gjitha veprat penale të mësipërme, me qëllim parësor shmangien nga detyrimet e importit.

Rrezikshmëria e kësaj vepre penale është vështirësia e konstatimit të veprimtarisë kundërligjshme, pasi me anë të falsifikimit të analizave apo deklarimit ndryshe nëçastin e eksportimit, mund të realizohet shmangia nga detyrimet e plota osetë pjesshme doganore.

⁵⁰⁸ Më hollësisht shiko nenet 117 -178 të Kodit Doganor.

2.8.Tregtimi, tjetërsimi ose transportimi i mallrave që janë kontrabandë dhe ndihma që u jepet personave që merren me këtë veprimtari...

Kjo vepër penale, parashikuar në nenin 178 të Kodit Penal, ndryshon në objekt, pasi objekti i krimit është cenimi i veprimtarisë rregullt të tregtisë, transportit, tjetërsimit të mallrave që dihet se janë kontrabandë, neni 178 i Kodit Penal, dhe ruajtja apo depozitimi i mallrave kontrabandë, neni 179, janë të përafërta në pikëpamje të objektit, pasi nëpërmjet veprimit kriminal cenohen marrëdhëniet në fushën e tregtimit, tjetërsimit apo transportimit.

Ana objektive e kësaj vepre penale që e dallon nga vepra të tjera në fushën doganore janë :

- Shiten mallra që dihet se janë kontrabandë, p.sh. cigare, pije papullë.
- Me tjetërsimin e mallrave, të cilat u jepen të tretëve për t'i përdorur.
- Me transportimin nga magazina, anija, të mallrave objekt kontrabande.
- Me çdo ndihmë, përfshirë edhe fshehjen e mallrave kontrabandë.

Subjekti në këto vepra penale është vetëm rrethi i personave që nuk kanë marrë pjesë në importimin e kundërligjshëm, por që kanë magazinuar, fshehur, ruajtur, transportuar mallrat që dihet se janë kontrabandë.

Në krime të kësaj natyre, duhet të mbahet parasysh se nuk duhet të ngatërrohet tranzitimi i mallrave me konceptin transportim. Ndërsa i pari ka të bëjë me një procedurë doganore, në rastin e dytë kemi të bëjmë vetëm me rregulla në fushën e transportimit.

Jurisprudenca e gjykatësi ka dhënë zgjidhje të drejtë veprave penale të kontrabandës të parashikuar në nenin 178-179 të Kodit Penale⁵⁰⁹.

⁵⁰⁹ Në çështjen penale “Shteti kundër pandehurit A. G.”, i akuzuar për kryerjen e veprave penale të: “Ruajtje, depozitim, tregtim të mallrave që janë kontrabandë” parashikuar nga neni 178 dhe neni 179 i Kodit Penal, Gjykata e Shkallës së Parë me vendimin nr. 1224, datë 29.5.2008 vendosi “Deklarimin fajtor të të pandehurit për veprën penale të “Tregtimit të mallrave që janë kontrabandë” parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal dhe “Ruajtjes apo depozitimit të mallrave kontrabandë”, parashikuar nga neni 179 i Kodit Penal, Gjykata e Shkallës së Parë vendosi me arsyetimin se:

“Më datë 25.01.2008, rreth orëve të drekës, nga një kontroll i ushtruar në lokalim minimarket të të pandehurit, u gjetën një sasi prej 73 paketash cigare të llojeve të ndryshme pa pullë fiskale të Ministrisë së Financave, si dhe një sasi prej 3 shishe verë edhe këto pa pullë fiskale të Ministrisë së Financave. Në këto kushte, nga ana e këtij seksioni të policisë u ushtrua kontroll në banesën e të pandehurit, ku në bodrumin e banesës u gjetën rreth 758 shishe verë të llojeve të ndryshme pa pullë fiskale të Ministrisë së Financave.

Pretendimit të palës mbrojtëse të të pandehurit, se sasia e verës prej 758 shishesh shërbente si koleksion dhe nuk duhet trajtuar si vepër penale që parashikohet nga neni 179 i Kodit Penal, Gjykata konkludon se nuk duhet të merret në konsideratë, pasi, në qoftë se sasia prej 758 shishe vere do të konsiderohej si koleksion, i pandehuri duhej të pajisej me dokumentet përkatëse nga organet kompetente, gjë e cila nuk rezultoi gjatë hetimit gjyqësor.

Për sa më lart, Gjykata konkludon se i pandehuri ka konsumuar elementet e veprës penale “Tregëtim të mallrave kontrabandë”, parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal për të cilën akuzohet, meqenëse ekzistojnë elementet e kësaj figure, si më poshtë:

Megjithatë, duke mbajtur parasysh legjislacionin doganor të vendeve të BE-së, ku ndjekjen penale e kanë kufizuar edhe në varësi të shumës së detyrimeve doganore të shmangura, do të ishte me interes që edhe në këto raste të parashikohet limiti i shumës së shmangur nga vepra penale, e parashikuar në nenet 270-280 të Kodit Penal, gjë që do të lehtësonte organin e akuzës nga ndjekja e çështjeve të cilat mund të ndiqen administrativisht.

Objekti: Me veprimet e tij, i pandehuri ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për të siguruar ndalimin e tregimit të mallrave që janë kontrabandë, pasi janë dëmtuar interesat shtetërore të mbrojtura posaçërisht me legjislacion penal.

Anën objektive: I pandehuri ka kryer veprën penale me anë të tregimit të mallrave, që dihet se janë kontrabandë.

Subjekti: I pandehuri ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm para ligjit.

Anën subjektive: Vepra penale është kryer nga i pandehuri me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai e dinte që po tregonte mallra kontrabandë, të cilat ishin të pa pajisura me pullë fiskale të Ministrisë së Financave.

2. Gjithashtu Gjykata konkludon se i pandehuri ka konsumuar edhe elementet e veprës tjetër penale, atë të “Ruajtjes apo depozitimit të mallrave kontrabandë”, parashikuar nga neni 179 i Kodit Penal për të cilën akuzohet, meqenëse ekzistojnë elementet e kësaj figure, si më poshtë:

Objekti: Me veprën e tij i pandehuri ka cenuar marrëdhëniet juridike të vendosura për ruajtjen, depozitimin, mbajtjen e mallrave, që dihet se janë kontrabandë, të mbrojtura posaçërisht nga legjislacioni penal.

Anën objektive: I pandehuri ka kryer veprën penale me veprime të kundërligjshme që shfaqen në ruajtjen, depozitimin, mbajtjen e mallrave që dihet se janë kontrabandë në banesën e tij.

Subjekti: I pandehuri ka mbushur moshën për përgjegjësi penale dhe është i përgjegjshëm para ligjit.

Anën subjektive: Vepra penale është kryer nga i pandehuri me dashje të drejtpërdrejtë, pasi ai ishte i detyruar të dinte që mbante mallra kontrabandë dhe pasojat që rrjedhin prej këtij veprimi.

KREU III

ANALIZA KRIMINOLOGJIKE E VEPRAVE PENALE NË FUSHËNE DOGANAVE 2003-2013 DHE POLITIKA PENALE

Në përfundim të këtij studimi, nuk mund të mos trajtonim shkurtimisht disa aspekte të kriminologjisë, të kriminalitetit në fushën doganore, që gjejnë shprehje jo vetëm në fushën ekonomike, por edhe në drejtime të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e jetës së njerëzve, kafshëve, bimëve dhe sigurinë kombëtare.

Fuqia e kërkesës dhe ofertës ndikojnë njësoj si në tregun e ligjshëm, ashtu dhe në tregun e paligjshëm, duke i detyruar t'u nënshtrohen të njëjtave dinamika dhe të shfaqin sjellje të ngjashme me biznesin, duke marrë në konsideratë mundësitë më fitimprurëse. Prandaj, procesi i globalizimit i ndryshon kushtet jo vetëm për aktivitetet e ligjshme, por edhe për paligjshmet.

Në këtë drejtim, edhe në fushën e kontrabandës, e cila sjell fitime financiare, trendi është në rritje, pasi favorizohet edhe nga kushtet e tregtisë së lirë dhe diferencave të taksimit në vende të ndryshme. Si rrjedhojë, globalizimi mund t'i theksojë më tej asimetritë që mendohet se janë të natyrës që gjenerojnë krimin.

Globalizimi i tregjeve ecën paralel me globalizimin e trafiqeve të cigareve, të mallrave jo tradicionale, në kohë konfliktesh lokale edhe kontrabandim të armëve, karburanteve dhe mallrave të tjera të luftës. Kështu, tregjet kriminale në fushën e mashtimit, evazionit fiskal, të kontrabandimit të mallrave të akcizës zënë një vend të rëndësishëm në tregjet kriminale, duke deformuar ekonominë kombëtare, për pasojë ndikojnë me siguri edhe në uljen e besimit në sistemin ekonomik.

Impakti që ka krimi ekonomik është me përmasa tronditëse. Mendohet se 30% e të ardhurave kombëtare humbasin nga krimet ekonomike.

I. Neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”⁵¹⁰.

Në këtë grup veprash penale vihet re tendenca për veprën penale, të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal, “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”.

Një ndikim të madh në fushën e kontrabandimit të mallrave me akcizë luan edhe fakti, se rrjetet e kontrabandës, të ngritura para viteve '90 (e cila, siç dihet, realizohej nga shteti), e ruajtën aktivitetin e tyre, duke ndryshuar vetëm subjektin, nga ai shtetëror në atë privat. Ndërkohë që tendenca vazhdonte të ishte ende në rritje. Sipas studimeve, 19% e

⁵¹⁰ <http://www.pp.gov.al/>

rasteve përfshijnë duhanin, më pas vijnë cigaret dhe pijet. Korrupsioni i punonjësve të doganës luan një rol të rëndësishëm, për të mos thënë vendimtar në këtë trafikim.

Sipas statistikave të Prokurorisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, tendenca e kontrabandimit të cigareve dhe, në tërësi, të mallrave që paguhet akcizë është në rënie. Sigurisht, kjo mund të shpjegohet me normalizimin e rajonit, gjë që ka pakësuar ndjeshëm kontrabandimin përmes kalimit të paligjshëm të kufirit. Shërbimet e organizmave ndërkombëtare, si dhe kombinimi i masave represive me ato ekonomike në rajon, kanë ndikuar mjaft në këtë drejtim. Kështu:

Në 2005, nga 16 çështje të gjykuara, janë dënuar 13 persona për këtëvepër. Ndërsa, **në 2006**, nga 42 çështje të gjykuara, janë dënuar 31 persona.

Për vitin 2007- 2008, ka një rënie të numrit të procedimeve të regjistruara për këtëvepër penale, si dhe të çështjeve të dërguara në gjykatë për këtëvepër penale, në vitin 2008, në krahasim me vitin 2007.


Të pandehur të regjistruar, rënie me 38 për qind dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, me 31.3 për qind në krahasim me vitin 2007. Koeficienti i kriminalitetit për këtëvepër penale në vitin 2007 ishte 1,2, kurse në vitin 2008 ishte 0.5. Pesha specifike që zinte kjo veper penale për vitin 2007 ishte 10.8 për qind, kurse për vitin 2008 ishte 6.2 për qind.

Për vitin 2009 – 2010, vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara, me 66 procedime penale për këtëvepër penale, përkundrajt vitit 2009, kur janë regjistruar 17 procedime penale. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra që paguhet akcizë”, për 100.000 banorë në vitin 2010 ishte 2, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0.53 krime për 100.000 banorë.

Për vitin 2010 – 2011, vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, në vitin 2011 ishte 66,66% në krahasim me vitin 2010. Pesha specifike që zë kjo veper penale në grupin e veprave penale “Kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike” ishte 9,16 % për vitin 2011, ndërkohë që në vitin 2010 ka qenë 16,52%.

Dinamika e kësaj veprave penale në shtatë vitet e fundit (2004-2011) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Tabela nr.1



Por, këto përfundime, përfshi edhe rezultatet e përfuara nga studime të organizmave ndërkombëtare, duhen parë me rezerva për arsye se:

- Rrjetet e kontrabandimit të cigareve, për shkak të sofistikimit të tyre, vështirësojnë kapjen dhe procedimin e tyre penal, çka do të thotë se intensiteti i kontrabandimit të cigareve nuk mund të përcaktohet në varësi nga rastet e gjykuara, por nga shkalla e evazionit fiskal, e cila, për hir të së vërtetës, është konstante në nivele të larta.

- Në analizë niveleve të zhdoganimit të cigareve, të krahasuara ndër vite, nuk rezulton një rritje progresive, megjithëse prodhimi në vend nuk ka ndryshime.

Gjithashtu, gjithmonë në marrëdhënie me kontrabandimin me mallra me akcizë duhet mbajtur parasysh, se:

- goditja e kontrabandës së mallrave me akcizë është e individualizuar kryesisht ndaj subjekteve të veçanta, veçanërisht të një subjekti në bashkëpunim me doganierët, transportuesit, por jo me grupe të organizuara, çfarë e bën të pabesueshëm faktin se krimi i organizuar nuk është i përfshirë në këtë ndërmarrje kriminale me fitime marramendëse. Me sa duket, jemi ende larg organizimit të operacioneve të luftës kundër trafikut të cigareve dhe mallrave të akcizës në tërësi, çfarë nënkupton paaftësinë dhe nivelin e ulët të goditjes së këtij krimi. Për rrjedhojë, edhe gjykimet e çështjeve për veprën penale të kontrabandës për mallrat me akcize, në shumicën dërrmuese kanë qenë për subjekte të veçanta.

- është për t'u theksuar fakti se dënimet për këtë vepër penale kanë qenë kryesisht me gjoba, që, të krahasuara me dënimet administrative, kanë qenë më të vogla. Madje, në raste të veçanta, edhe konfiskimi i mallit si masë e detyrueshme nga Gjykata nuk është vendosur. Duke iu referuar legjislacionit doganor të vendeve komunitare, rezulton se dënimet, sidomos për kontrabandën e cigares, janë shumë më të rënda, se ato që parashikohen në legjislacionin tonë penal. Një fakt i tillë ka ndikuar negativisht në goditjen e këtij krimi. Për më tepër, nëse në ligjin penal, për shumë vepra penale dënimet janë ashpërsuar dhe dispozitat janë përmirësuar, në fushën e veprave penale të mallrave me akcizë, me disa ndryshime të vogla, aktualisht ushtrohet njëjtat dispozita ligjore të vitit 1996.

Neni 173 “Kontrabanda me mallra të licencuara”.

Nga të dhënat statistikore rezulton, se, në vitin 2005 dhe në vitin 2006, është regjistruar vetëm nga 1 procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 173 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të licencuara”; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale me 3 herë në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale, kurse në vitin 2009 janë regjistruar 5 procedime penale për këtë veprë penale.

Vihet re tendencanë rritje e procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale në vitin 2009. Janë regjistruar 5 procedime penale, në krahasim me vitin 2008, kur nuk është regjistruar asnjë procedim penal për këtë veprë penale.


Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2009 është 0,15%, ndërsa për vitin 2008 ka qenë 0 krime për 100.000 banorë.

Pesha specifike, që zë kjo veprë penale në raport me grupin e veprave penale ku bën pjesë, ka qenë 0% në vitin 2008 dhe është bërë 2% në vitin 2009.

Nga të dhënat statistikore, vihet re se numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është rritur në masën 200% në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009, me rritje rezulton të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e regjistruar, kështu në vitin 2009 janë regjistruar 3 të pandehur, ndërsa në vitin 2008 është regjistruar vetëm 1 i pandehur; gjithashtu, me rritje rezulton të jetë edhe numri i të pandehurve, për të cilët është ngritur akuzë mëshomë se 2 herë në gjykatë në vitin 2009 në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezulton se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata për këtë veprë penale, në vitin 2009 është 2, ndërsa në vitin 2008, rezulton 1 i pandehur i dënuar nga gjykata.

Dinamika e kësaj veprë penale në vitet 2005-2011 paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Tabela nr.2

**II. Neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera”.**

Kontrabandimi me mallrat e tjera vazhdon të mbetet në nivele të konsiderueshme, si rrjedhojë e nxjerrjes së përfitimeve nga shmangia e pagimit të detyrimeve të importit.

Megjithatë, heqja e detyrimeve doganore, në bazë të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë, forcimi i kontrollit tatimor dhe garantimi i rimbursimit të TVSH-së, kanë përbërë dhe do të ndikojnë dukshëm në uljen e kontrabandimit të mallrave të tjera.

Gjithashtu, rritja e bashkëpunimit ndërshtetëror në kuadrin e kontrollit aposterior, në zbatim të marrëveshjeve dhe konventave doganore, ka ndikuar ndjeshëm në luftën kundër kontrabandimit të këtyre mallrave dhe nëvënien para përgjegjësisë penale të personave fajtorë. Megjithatë, vlen të theksohet se kontrabandimi me mallra të tjera do të jetë më problematikë nga vendet e Lindjes, veçanërisht me vendet me të cilat nuk janë realizuar marrëveshje të ndërsjella për shkëmbim informacioni, si dhe marrëveshje për tregtinë e lirë.

Në bazë të të dhënave statistikore, konstatohet se nuk na rezulton të ketë pasur raste përsëritjeje apo me grupe të organizuara në kontrabandim me mallra të ndryshme. Kjo nuk do të thotë, se nuk ka pasur kontrabandim të kryer me grupe të organizuara. Në këtë këndvështrim, mendojmë se për shkak të nivelit të ulët të organizmave për luftën kundër kontrabandës, nuk është bërë e mundur organizimi i operacioneve për të identifikuar dhe goditur kontrabandimin e kryer nga grupe të organizuara.

Në vitin 2005, ka rritje të procedimeve penale prej 6.1 % në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006, kemi një rritje prej 55.2 % të procedimeve penale, të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 kemi rënie të procedimeve penale për këtë veprë penale prej 47.1 % në krahasim me vitin 2006, ndërsa në vitin 2008 ka përsëri një rënie të ndjeshme të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra të tjera” prej 57.2 % në krahasim me vitin 2007. Për sa i përket shpërndarjes gjeografike, kjo veprë penale më shumë vihet re në rrethet Tiranë, Kukës, Vlorë, Korçë, Durrës.


Në vitin 2007, ecuria e kësaj vepre penale rezultoi të kishte ulje të procedimeve penale të regjistruara me 47,11% në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 pati ulje me 57,21% në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009, konstatohet rritje me 27,55% të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2008, kurse në vitin 2010 konstatohet rritje të ndjeshme me 65,6% të procedimeve penale të regjistruara në krahasim me vitin 2009. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë për veprën penale të parashikuar nga neni 174 i Kodit Penal për 100.000 banorë, në vitin 2010 është 6,47, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 3,91 krime për 100.000 banorë.

Për vitin 2011 kemi një rënie me 49,27% në krahasim me vitin 2010 të procedimeve penale të regjistruara.

Nga të dhënat statistikore vihet rese numri i procedimeve për gjykim në vitin 2009 është ulur në masën 2,56% në krahasim me vitin 2008; në vitin 2009, me rritje rezultojnë të jetë edhe treguesi që ka të bëjë me të pandehurit e regjistruar, kështu në vitin 2009 janë regjistruar 15,38% më shumë se në vitin 2008; me ulje rezultojnë të jetë edhe numri i të pandehurve, për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë prej 10% në vitin 2009, në krahasim me vitin 2008; nga të dhënat statistikore rezultojnë se treguesi që ka të bëjë me të pandehur të dënuar nga gjykata.

Dinamika e kësaj vepre penale në shtatë vitet e fundit (2004-2011) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Tabela nr.3



Në të vërtetë, dënimet e dhëna kanë qenë kryesisht të ulëta, veçanërisht me gjopa në përmasa të vogla, si rrjedhojë mendojmë se një masë e tillë nuk ndikon në luftën kundër krimit doganor. Ndërkohë që, siç kemi parashtruar në këtë studim, gjykatat duke mos e respektuar drejt ligjin, krahas dënimet me gjopa, nuk kanë aplikuar dënimin plotësues “konfiskim të mallit”, si një masë e detyrueshme.

III. Neni 177 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm”.


Në vitin 2005 ka rënie të procedimeve penale prej 77.8 % në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rënie prej 50 % të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale prej 100% në krahasim me vitin 2006, ndërsa në vitin 2008 ka përsëri një rritje të ndjeshme të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 177 i Kodit Penal “Kontrabanda me mallra me regjim të ndërmjetëm” prej 5 herë më shumë në krahasim me vitin 2007.

Ka një rritje të ndjeshme të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale, 5 herë më shumë në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007. Ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë veprë penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 100 %.

Të pandehur të regjistruar, rritje me 2.3 herë më shumë dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë me 1.3 herë më shumë në krahasim me vitin 2007. Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale, në vitin 2007, ishte 0,06, kurse në vitin 2008 ishte 0.4. Pesha specifike që zë kjo vepër penale në raport me totalin e grup veprave që përfshihen në këtë seksion, për vitin 2007 ishte 0.6 % dhe për vitin 2008 është 5%.

Dinamika e kësaj vepre penale në pesë vitet e fundit (2004-2008) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Tabela nr. 4



IV. Neni 178 "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë".

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vitet, 2006-2010, paraqitet si vijon. Në vitin 2007 ka rritje prej 4,16% në krahasim me vitin 2006 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2008 ka rritje prej 98% në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 39,39% të procedimeve penale të regjistruara, ndërsa në vitin 2010 ka rritje prej 51,67% në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 178 i Kodit Penal "Tregtimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë".

Në vitin 2008, në krahasim me vitin 2007, ka një rritje të ndjeshme të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale, pra 98%. Në vitin 2008, në krahasim me vitin 2007 ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale, madje rritja arrin 112.5%.


Të pandehur të regjistruar, rritje me 1.6 herë më shumë dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, me 1.2 herë më shumë në krahasim me vitin 2007. Koeficienti i kriminalitetit për këtë veprë penale në vitin 2007 ishte 1,6 dhe në vitin 2008 ishte 3.12.

Pesha specifike që zë kjo veprë penale në raport me totalin e grup veprave që përfshihen në këtë seksion, për vitin 2007 ishte 14.5% dhe për vitin 2008 ishte 41%.

Në vitin 2010, në këtë grup veprash penale vihet re tendenca në rritje e procedimeve të regjistruara prej 51,67 %, në krahasim me vitin 2009.

Dinamika e kësaj veprë penale në shtatë vitet e fundit (2004-2011) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Tabela nr.5



V. Neni 179 "Ruajtja dhe depozitimi i mallrave kontrabandë".

Në vitin 2005 ka rënie të procedimeve penale prej 30 % në krahasim me vitin 2004; në vitin 2006 ka një rritje prej 42.85 % të procedimeve penale të regjistruara për këtë veprë penale në krahasim me vitin 2005; në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale për këtë veprë penale prej 40 % në krahasim me vitin 2006, kurse në vitin 2008 ka një rënie të ndjeshme të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale të parashikuar nga neni 179 i Kodit Penal "Ruajtja dhe depozitimi i mallrave kontrabandë" prej 64.3% në krahasim me vitin 2007.


Në lidhje me shpërndarjen gjeografike për këtë veprë penale, theksojmë se rrethet Kavajë, Korçë, Lushnjë, Pogradec dhe Shkodër, kanë regjistruar vetëm nga 1 procedim penal për këtë veprë penale. Ka një rënie të ndjeshme të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë veprë penale, 64.3 % në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007.

Ka rënie të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008 në krahasim me vitin 2007 dhe rritja është 45.5 %. 117 të pandehur të regjistruar, rënie me 82.4 % dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, rënie prej 53.8 % në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 0.4, kurse në vitin 2008 ishte 0.16. Peshat specifike që zë kjo vepër penale, në raport me totalin e grupve veprave që përfshihen në këtë seksion, për vitin 2007 ishte 4%, kurse për vitin 2008 ishte 2%.

Dinamika e kësaj vepre penale në shtatë vitet e fundit (2004-2011) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Tabela nr.6



VI. Neni 179/a i Kodit Penal “Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë”.

Transaksionet e dyshimta financiare janë shtuar, gjithçka jo për faktin se një dukuri e tillë nuk ka funksionuar më parë, por natyrisht për shkak se është rritur numri i konstatimeve të këtyre transaksioneve financiare. Megjithatë, numri i papërfillshëm i raportuar dhe i ndjekur penalisht lidhur me këtë vepër penale vazhdon të përbëjë një tregues të shkallës së ulët të luftës kundër kësaj vepre penale. Mënyra mbizotëruese për pastrimin e parave është përdorimi i kompanive fiktive, ndërkohë që kalimi jashtë zonave doganore ndikon në numrin e rasteve të kalimit të paligjshëm nëpërmjet mosdeklarimit të të hollave përmes kufirit shtetëror.

Ecuria e kësaj vepre penale në pesë vitet, 2006-2010, paraqitet si vijon. Në vitin 2007 ka rritje të procedimeve penale të regjistruara prej 33,33% në krahasim me vitin 2006; në vitin 2008 ka rritje 100% në krahasim me vitin 2007 të procedimeve penale të regjistruara; në vitin 2009 ka ulje prej 75% në krahasim me vitin 2008 të procedimeve penale të regjistruara, kurse në vitin 2010 ka ulje prej 42,86% në krahasim me vitin 2009 të procedimeve penale të regjistruara. Vihet re tendenca në ulje e procedimeve të regjistruara, në vitin 2010, prej 42,9 % në krahasim me vitin 2009. Koeficienti i kriminalitetit për 100.000 banorë në vitin 2010 ishte 0,25, ndërsa për vitin 2009 ka qenë 0,43 krime për 100 000 banorë.

Ka një rritje të ndjeshme të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale, 100% në vitin 2008, në krahasim me vitin 2007. Ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008, në krahasim me vitin 2007 me një rritje 66.7%. Të pandehur të regjistruar, rënie me 100% dhe të pandehur për të cilët është ngritur akuzë në gjykatë, rënie prej 66.7% në krahasim me vitin 2007.

Koeficienti i kriminalitetit për këtë vepër penale në vitin 2007 ishte 0.12, ndërsa në vitin 2008 ishte 0.25. Pështetja specifike që zë kjo vepër penale, në raport me totalin e grupve veprave që përfshihen në këtë seksion, për vitin 2007 ishte 1.16%, kurse për vitin 2008 ishte 3.3%.

Në lidhje me shpërndarjen gjeografike, nga të dhënat statistikore, rezulton se 7 procedime penale janë regjistruar në Prokurorinë e Tiranës dhe 1 procedim penal është regjistruar në Korçë. Ka një rritje të ndjeshme të numrit të procedimeve të regjistruara për këtë vepër penale, 100% në vitin 2008, në krahasim me vitin 2007. Ka rritje të procedimeve të dërguara gjyqit për këtë vepër penale në vitin 2008, në krahasim me vitin 2007 me një rritje prej 66.7%.

Dinamika e kësaj vepre penale në vitet e fundit (2004-2011) paraqitet në grafikun e mëposhtëm:

Tabela nr.7



PËRFUNDIME

1. Shërbimi doganorështënjë autoritet i shtetit, që ka për detyrë mbledhjen e detyrimeve të importit, si dhe kontrollin e mjeteve dhe mallrave që hyjnë-dalin në/dhe nga territori doganor i atij vendi. Ai ka lindur dhe është zhvilluar së bashku me shtetin. Madje, nuk mund të konsiderohet aspak gabim nëse mendohet se dogana ka lindur së bashku me tregtinë. Nga ana tjetër, bashkë me doganën dhe kërkesën për vjelje të detyrimeve doganore, duhet të ketë lindur tendenca për të mos paguar detyrimet e caktuara dhe, në ditët e sotme, e quajmë kontrabandëtregtare. Për të parandaluar dhe luftuar krimin e kontrabandës është dashur hartimi i një pakete normash juridike, në të cilat parashikohen figurat konkrete të veprave penale të kontrabandës.

2. Me kalimin e kohës historia ka bërë të vetën. Roli i shërbimit të doganave ka ndryshuar në mënyrë të dukshme, si rezultat i dyfishtë i evolucionarizimit, duke përfshirë rritjen e globalizimit të tregtisë dhe faktorëve të ndryshëm, si sulmet terroriste, trafiku i paligjshëm, krimin e organizuar.

Në bazë të doktrinave ekonomike, dikur, e drejta doganore kishte për vokacion kryesor mbrojtjen e shtetit kundër konkurrencës së produkteve të huaja, veprim që realizohej nëpërmjet një arsenali të përshtatshëm (detyrime doganore, ndalime, kufizime, kuotave, etj). Zhvillimi dhe shumëfishimi i tregtisë ndërkombëtaresollën “dënimin” e proteksionizmit (të paktën ai që ushtrohej në format më të dukshme), GATT-i, sot OBT-ja, simbolizojnë vullnetin e shumë prej shteteve, për të hequr barrierat për shkëmbimet ndërkombëtare.

3. Nëse do lexonim germë për germë ideologjinë liberale, atëherë, si rrjedhojë, zhdukja e doganierëve do kishte përfunduar me kohë, çka tregon se ekzistojnë një sërë faktorësh ekonomikë, të cilët mund të përcaktojnë politikën kriminale. Mirëpo, ndërkohë na duhet të sqarojmë, se edhe në proceset integruese elementë të veçantë të proteksionizmit do vazhdojnë të ruhen, pasi shtetet nuk i pengon asgjë, përfshiedhe Shqipërinë, madje edhe vetë BE-në, që të mbrohen dhe duhet të mbrohen. GATT-i nuk e ka ndaluar përdorimin e detyrimeve apo taksave doganore, nga momentikur ai konsideron se ato janë të arsyeshme edhe jo diskriminuese në mbrojtje të “Konkurrueshmërisë”.

Në këtë kuadër, shërbimit doganor i janë ngarkuar me ligj detyra të rëndësishme në luftën kundër trafikut, jo vetëm të mallrave të konsumit, detyrë kjo tradicionale, por edhe në fushën e lëndëve narkotike, të cigareve, të armëve, mallrave me karakter të dyfishtë, në luftën kundër pastrimit të parave, si dhe në sigurinë e porteve, aeroporteve, stacioneve të trenit dhe, në tërësi, të sigurisë kombëtare.

Në këtë këndvështrim, vullneti politik, për t'i siguruar administratës së doganës mjete veprimi të jashtëzakonshme në planin juridik, domethënë kompetenca të rëndësishme për të vepruar ndaj personave dhe mallrave qëu nënshtrohen kontrolleve, ashtu sikurse dhe kompetencat që mbart për të dënuar mashtruesit e kontrabandistët, në kuadër të një procedure represive specifike dhe veçanërisht efikase, rezulton që e drejta penale doganore në fushën e goditjeve të shkeljeve doganore, të jetë një e drejtë shumë e veçantë nga e drejta penale e përgjithshme.

4.Me interes teorik dhe praktik është gjithashtu edhe studimi i mekanizmave të ndjekjes dhe të sanksioneve në krimet e fushës doganore, në mënyrë që të kuptojmë veçoritë e tyre, të identifikojmë karakterin, si dhe perspektivat. Mbetet të perceptojmë më mirë ndryshimet e procedimit për krimet në fushën doganore me ato të fushave të tjera. Për të kuptuar mirë veçantinë e mekanizmave të ndjekjes penale dhe të sanksioneve në të drejtën doganore, është e nevojshme të rikujtojmë mutacionet historike, të cilat i kanë dhënë doganës, për një kohë të gjatë, kompetenca të jashtëzakonshme, në mënyrë që të sigurohej efikasiteti dhe shpejtësia e dhënies së dënimeve për veprat doganore.

5.Gjithashtu, na duhet të kuptojmëse çfarë i ka shtyrë ligjvënësit në vendet komunitare që t'i japë kësaj administrate gjithë këtë pushtet të jashtëzakonshëm. E cilësuar si policia e marrëdhënieve komerciale me jashtë, roje e financave, imazhi i saj duhet të pasqyrojë mbrojtjen e interesave të shtetit. Kjo administratë ka një arsenal juridik të përshtatur, ndryshe nga e drejta e përgjithshme, por që kërkon njëkohësisht përshtatje me ndryshimet që kërkon koha. Historia e veçantë e doganës dhe evoluimi i shpeshtë i kompetencave të saj, përnjë pjesë të madhe tregojnë partikularitete të së drejtës doganore në aspekte penale.

6.Ndryshe nga ç'mund të vërejmë në shumicën e administratave të tjera dhe ndryshe nga ç'ndodh me të drejtën fiskale të përgjithshme, e drejta doganore nuk bën dallim midis situatave të ndryshme: gabimii kryer nga një operator ekonomik, sado i vogël qoftë, përbën një vepër, edhe pse ky gabim mund të jetë bërënë mënyrë të pavullnetshme ose pa dashakeqësi. Në këtë mënyrë, në thelb, e drejta doganore bashkohet me fushën penale. Ndërkohë që ligjvënësi nuk bën dallimin midis kompetencave doganore: "Të gjitha kanëpër synim kërkimin dhe zbulimin e shkeljes (mashtrimin) doganore". Mes gjithëkëtyre kompetencave qëgëzon administrata e doganës, disa prej tyre u kufizuan, për rastet kur ato preknin liritë themelore.

7.Misioni i mbikëqyrjes dhe ai i kontrollit tëshërbimit doganor shkon edhe më tej sesa perceptimi i detyrimeve doganore dhe kontrolli i mallrave, ç'ka ka sjellë zgjerim tëkompetencave doganore nëmënyrë të ndjeshme. Këto ndryshime çuan nësituata të tilla, që në territorin doganor të ndodhen jo vetëm mallra, të cilat sipas legjislacionit doganor

mund të kishin statute të ndryshme, por edhe në zhvendosjen e aktiviteteve të kontrollit dhe përgjimit doganor, i cili përshumicën e rasteve kryhet në *posteriori* dhe në vendet e prodhimit, stokimit, komercializimit në territore doganore të vendeve të tjera. Në këtë mënyrë, u zhvilluan edhe metoda të reja, të cilat luhateshin nga kontrollet e përgjithshme, deri te kërkimi për vepra doganore flagrante ose hetime të detajuara, në mënyrë që të zbuloheshin trafiket e ndryshme. Tërësia e këtyre hetimeve dhe kontrolleve zhvillohen në bazë të të njëjtit kod. Në këto rrethana lind pyetja: a duhet t'i tërheqim nga sfera penale disa nga procedurat doganore? Mendoj se në këtë drejtim duhet të synojë si administrata doganore, ashtu edhe ligjvënësi në mënyrë që shërbimi doganor t'i përgjigjet sfidave të kohës, të cilat janë shumë herë më të mëdha se më parë.

8. Nga pikëpamja tregtare, kontrabanda është një formë e tregtisë ndërkufitare që ndalohet nga ligjet e vendosura nga shteti, por jo nga e drejta natyrale. Ajonëkupton transportin e paligjshëm të mallrave përtej kufijve, me qëllim që të shmangendetyrimet doganore dhe tati më të mirë të mallrave. Duke shmangur kontrollin e nëpunësit të doganave (doganës) ose duke mos i deklaruar mallrat që i nënshtrohen taksimeve apo detyrimeve, kontrabandistët tejkalojnë barrierat të krijuara për arsye tati më të mirë apo politikë ekonomike, duke shfrytëzuar kështu në favor të tij, dallimet nëçmimin natyral apo artificial, ndërmjet hapësirave të ndryshme ekonomike.

9. Nga këndvështrimi i doktrinës juridike, kontrabanda përcaktohet si një shkelje e ligjeve financiare dhe, në mënyrë më specifike, normat e vendosura mbi detyrimet e mallrave të huaja, të ndalimeve të hyrje-daljes në/dhe nga territori doganor kombëtar i mallrave të ndaluar me ligj, sikundër të gjitha sjelljet mashtruese të lidhura me detyrimet e brendshme të konsumit, por dhe monopolet e shtetit. Sipas jurisprudencës, sidomos asaj të SHBA-së, në termin kontrabandë përfshihen edhe kontrabanda absolute dhe kontrabanda e kushtëzuar. Ky lloj kontrabandimi përbën një veprimtari të kundërligjshme, që konsiston në transportimin apo furnizimin e fuqive ndërluftuese të çdo gjëje që është e nevojshme për zhvillimin e luftës dhe, si rrjedhim, fuqia tjetër, në gjendje lufte me të, gëzon të drejtën për ta parandaluar furnizimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

10. Nëse në shumë fusha të tjera, përfshirë edhe atë të procedurave dhe regjimeve doganore, legjislacioni doganor është drejt një unifikimi, në fushën e shkeljeve doganore vërehet një situatë krejt e kundërt. Mungesa e harmonizimit të dispozitave penale për veprat penale të kontrabandës, si me vendet komunitare, ashtu edhe me ato jashtë këtij bashkimi, përfshirë edhe vendin tonë, krijon jo më pak probleme. Në asnjë fushë tjetër të drejtës doganore, nuk është shfaqur një rezistencë kaq domethënëse për harmonizimin, sa ajo e shfaqur për litigacionet doganore.

12.Referuar jurisprudencës së fushës doganore në vendet komunitare, por dhe praktikës gjyqësore të pas viteve 1992, nuk mund të mos pranojmë se veprat penale tëkontrabandës përbëjnë një krim⁵¹¹ që dallohet për kompleksitetin e madh që reflektohet në procesin e kualifikimit, duke ndikuar në shume raste nëkeqkuptimin e ligjit dhe në zbatimin e tij në mënyrë të gabuar nga ana e policisë gjyqësore gjatë hetimittëçështjes, nga akuza dhe gjykatësit, madje edhe nga vetë avokatët gjatë procesit gjyqësor.

Qartësimi dhe kuptimi i veprave penale të kontrabandës është i domosdoshëm jo vetëm për përforcimin misionit dhe kompetencave të shërbimit doganor, por edhe për kërkimin dhe zbulimin e veprave doganore, ashtu sikurse edhe për ushtrimin e ndjekjes penale dhe sanksionimin e tyre.

13.Në klasifikimin e drejtë tëveprës penale tëkontrabandësështë e domosdoshme të prekim disa nga çështjet më problematike, si rrjedhojë të jepenpërgjigje të mbështetura mbi baza shkencore. Nëveçanti,çështje që kanë tëbëjnë me: Përmbajtjen e veprës penale tëkontrabandës, veçoritë dalluese nga vepra penale e zakonshme,çështje tëkonkurrimit të veprave kontrabandë, objektin, vendin e kryerjes sëkontrabandës, momentin e mbarimit apo përfundimit tëkontrabandës, si dhe të dallimeve tëveprës penale tëkontrabandës nga kundërvajtja.

14.Studiues të së drejtës penale doganore, lidhur me veprën penale tëkontrabandës, nënvizojnë faktin se çdo lloj kontrabande pakëson të ardhurat e buxhetit të shtetit. Pra, kryesisht diskutohet për anën objektive të një krimi të tillë, me qëllim shmangien nga pagesat doganor.

15.Në këtëpërcaktim, duhet të shprehemi me rezerva për faktin se, edhe pse në Kreun III të veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, elementët e parashikuar në nenet 172 -174,177 të Kodit Penal, madje edhe në nenet 179, 176 të Kodit Penal, tëçojnëdrejtmendimit se kemi të bëjmë me krime tësferës ekonomike, përveç këtyre dispozitave, për krimet e fushës doganore në Kodin Penal dhe në Kodin Doganor,janë përcaktuar dispozita konkrete që lidhen vetëm me shmangien nga kontrolli apo importimi, eksportimi, tranzitimi i paligjshëm i mallrave te ndaluara, pa i kushtëzuar me qëllimin e shmangies nga detyrimet doganore.

16.Me qëllim që të bëhet njëvlerësim i drejtë i veprimtarive me rrezikshmërishtohqërrore të kryera në sferën e çështjeve doganore dhe jo vetëm në të, vlerësojmë se kërkohet t'u referohemi si normave penale, ashtu edhe atyre doganore, administrative, tatimore, financiare dhe degëve të tjera të sëdrejtës.

⁵¹¹ Në Zvicër kontrabanda nuk është konsideruar në përgjithësi një vepër penale, por ndiqet nga e drejta penale fiskale. Marco Polli-Schönborn “**Contrabbando**”, published 10/11/2011.

17.Referuar doktrinës, studimi i veprave penale në fushën doganore përbën objektin e sëdrejtës penaledoganore, si pjesë e tëdrejtës sëposaçme të sëdrejtës penale. Nëliteraturën tonë juridike, nuk përmendet termi “*E drejta penale doganore*”, por ajo nënkuptohet, pasi gjendet në tëdrejtën e posaçme penale, si tërësi normash juridike të vendosura nga shteti, qëparashikojnë figurat konkrete të krimeve doganore që përmban aktualisht si Kodi Penal, ashtu dhe ligji doganor, elementët përbërës të tyre, si dhe sanksionet përkatësepërçdo figurë të krimit të kontrabandës.Gjithsesi, veprat penale tëfushës doganore përfshihen në konceptimin e sëdrejtëssë përgjithshme penale, pasi “parimet”, domethënë legaliteti i veprave penale dhe dënimeve, si dhe elementet përbërës të veprave penale, janë të aplikueshme edhe në rastin e një vepre penale doganore.

18.Në kushtet kur legjislatori ka vendosur unifikimin e ligjit doganor (KD dhe të dispozitave zbatuese) me atë komunitar (UCC), por dhe nisur nga faktit qëçdo shtet i vendeve komunitare vazhdon, që për shkeljet doganore ku përfshihet edhe krimi ikontrabandës, të ketë një ligj kombëtar, evidentimi i tëdrejtës penale doganore duhet jo vetëm të përfshihet në terminologjinë juridike, por edhe të konceptohet drejt klasifikimi i krimeve doganore në shërbim të efikasitetit të luftës kundër kriminalitetit në fushën ekonomike dhe në fusha të tjera, si: luftës kundër terrorizimit, zbatimin e detyrimeve ndërkombëtare nëtregtinëndërkombëtare, mbrojtjen e konkurrueshmërisë, mbrojtjen e jetës së njerëzve, mbrojtjene kafshëve dhe bimëve.

19.Midis kontrabandës nëpërmjet kalimit, zhvendosjes së mallrave në/dhe nga kufiri shtetëror, nga kontrabanda nëpërmjet shmangies nga pagesat doganore, ka ndryshime në elementët e figurës së krimit.Këto ndryshime janë fundamentale dhe bëjnë të mundur ndarjen e krimeve nga njëri-tjetri. Analiza e praktikës hetimore dhe gjyqësore e përdorur për kualifikimin e krimeve gjatë pranisësësimptomave të kontrabandës dhe shmangies nga pagesat doganore, si edhe gjatë trajtimit të mendimeve apo opinionëve të juristëve, na lejon të konstatojmë faktin problematik të interpretimit të veprimtarive të trajtuara më sipër. Gjyqtarët, jo rrallë, ndodh që bëjnë*gabime tipike* gjatë zbatimit të kualifikimeve për krimet, gabime këto që kanë lidhje me mospërcaktimin e saktë të veprimit të kryer, nga ai i mbetur në tentativë, të objektit të kontrabandës dhe të objektit të krimit nëpërmjet shmangies apo edhe të përmbajtjes së anëve objektive e subjektive të veprimtarive në fjalë. Për më tepër që, duke mos kuptuar ndryshimet në këto vepra penale të fushës doganore, vazhdojnë të kenë qëndrime të ndryshme, si në rrafshin teorik doktrinar, ashtu dhe në praktikën gjyqësore, lidhur me përcaktimin e figurës së krimit të kontrabandës, si figura krimi formale apo materiale, të veprës kontrabandë të konsumuar apo të hipotezave të mbetjes së krimit në fazën e tentativës.

20. Kontrabanda përmes kalimit, zhvendosjes, hyn në krimet *melemente formale (figura krimi të prerë apo formal)*, ndërsa shmangia nga pagesat doganore ka përbërje materiale.

Në rastin e fundit, është e domosdoshme *prania* (apo ekzistenca) e *pasojave kriminale*, në formën e mospagimit të taksave doganore. Moskuptimi i këtij ndryshimi është bërë shkak për qëndrime të ndryshme, si nga studiues, edhe gjatë praktikës gjyqësore.

21.Referuar dispozitave ligjore për kontrabandë, konstatojmë se ligjvënësinuk ka përfshirë në këtë vepër penale fazën e parë, atë *tëpërgatitjessë krimin të kontrabandës*, gjë që mund të bëhet shkak për rëndim tëpozitëssëshkelësit. Mirëpo, kompleksiteti dhe intensitetii veprimeve për kryerjen e kontrabandës, na detyron të mbajmë parasysh edhe raste të ekzistencës së mundësisëëndërprerjes sëveprimtarisë kriminale në stadin e përgatitjes dhe të zbatimit të anës objektive të krimin, para momentit kur krimi llogaritet i përfunduar, ndërsa në raste të tjera, ajo është e përjashtuar dhe,për rrjedhojë, janëpërjashtuarpërgatitja, tentativat dhe mundësia e refuzimit (heqjes dorë) vullnetar nga krimi. Për këtë qëllim, nëkëtë studim, mendoj se është me interes si trajtimi teorik, ashtu edhe ai praktik i çështjeve që kanë tëbëjnë me përgatitjen e krimin të kontrabandës dhe mbetjes së tij në tentativë.

21.1 Gjithashtu na duhet të pranojmë se veprimet e personit për importin e kundërligjshëm të mallrave në territorin doganor të Shqipërisë i nënshtrohen klasifikimit si tentativë për kontrabandë, në qoftë se është *bërëkalimi faktik* i kufirit shtetëror në zonën doganore përmes pikës së kalimit kufitar, ndërkohë që veprimtaria është ndërprerë për shkaqe objektive, të cilat nuk varen nga ky person, deri në momentin kur krimi vlerësohet si i kryer⁵¹², dhe pikërisht:

- Deri në momentin e fillimit faktik të kontrollit doganor, si dhe kur kryhen krime me fshehje nga kontrolli doganor.
- Deri në momentin e përdorimit të dokumenteve të falsifikuara ose mjeteve të identifikimit doganor, si vula, shenjat identifikuese doganore, në këto raste, stadi i tentativës për kontrabandë fillon nga momenti i kalimit të pikës së kalimit kufitar (tokësor) apo të vijës së ujërave territoriale.

⁵¹² Në lidhje me këtë, duke debatuar për një qëndrim të mbajtur nga Kolegji Penal, ku me të drejtë krimet e trafikimit janë konsideruar vepra penale formale dhe të realizuara, që në çastin e importimit, pavarësisht nga pasojat, autori i artikullit të lartpërmendur, duke moskuptuar drejt ligjin, ndryshe nga praktika gjyqësore mendon se “... një formulim i tillë bie në gabimin e zakonshëm të ngritjes së tentativës në nivelin e një krimi të konsumuar”. H. Ligori, Revista “Jeta Juridike”, “Për kuptimin e tentativës”. Më shumë shiko edhe vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë nr. 608, datë 26.09.2007.

⁵¹²/1. Duke u bashkuar me qëndrimin ndryshe, edhe pse jo drejtpërdrejtë të mbajtur në Komentarin e Kodit Penal të RSH. Pr. Ismet Elezi, Skënder Kacupu, Maksim Haxhia, mendojmë se mendimet e shprehura më lart nga autori i artikullit “Për kuptimin e tentativës...” H. Ligori, janë rrjedhojë e kuptimit të keq të ligjit lidhur me veprat penale të natyrës formale, siç është edhe kontrabanda përmes kalimit të kundërligjshëm të kufirit shtetëror.

-Deri në momentin e pranimit nga organi doganor i deklaratës doganore, në kushtet e deklarimit jo të vërtetë dhe të mosdeklarimit, në qoftë se në deklarim nuk janë shprehur (apo nuk janë deklaruar) të dhëna për mallrat objekt kontrabande.

-Deri në momentin e mbarimit të afateve, të parashikuara me ligj, të dorëzimit të deklaratës doganore, të magazinimit të përkohshëm.

22.Ndryshe nga legjislacioni i vendeve të BE-së, kontrabanda në legjislacionin tonë, gjen rregullim juridik në Kodin Doganor si shkelje doganore, nenet 276-279, 280 të Kodit Doganor, dhe si krime nëfushën doganore në nenet 171- 179 të Kodit Penal. Kjo është bërë shkak që, si në zbatimin praktik, edhe në doktrinë, tëkëtë diskutime në lidhje me dallimet midis kundërvajtjes dhe kontrabandës, rrezikshmërisë të tyre, ligjit material, ku duhet tëpërcaktohen normat ligjore tëkontrabandës, autoriteti procedues. etj. Madje, referuar praktikës gjyqësore, diskutimet janë shtrirë më tej, me mendimin se “bashkekzistenca e Kodit Penal me Kodin Doganor krijon jo pak probleme nëcilësimin ligjor të rasteve tëkontrabandës”.

23.Në këto rrethana, me rëndësi është jo vetëm kuptimi i drejtë teorik i figurave të krimit në fushën doganore, analiza e elementeve të veprës dhe figurës së kontrabandës, por edhe harmonizimi i dispozitave të Kodit Penal, përsa i përketveprës penale të kontrabandës, me ato të Kodit Doganor. Për mëteper, studimet teorike marrin rëndësipër faktin se hartimi i të dy ligjeve, të ligjit doganor dhe atij penal, është bërë në kohë të ndryshme, në kushtet e njëpërvoje të pamjaftueshme në formulimet e vetë figurave tëkontrabandës, ndërkohë që edhe vetë praktika gjyqësore nëatë kohë ka qenë e vakët⁵¹³, si nëfushën penale, ashtu edhe nëatë administrative doganore.

-Ka dublime në përcaktimin e krimeve në fushën doganore, në Kodin Doganor me atë Penal, madje edhe me shkeljen doganore kundërvajtje. (Si shembull është vepra penale e kontrabandës me mallra të ndaluara, me atë të sendeve me vlera kulturore kombëtare, neni 280 i Kodit Doganor, me nenet 171,176 të Kodit Penal; tregtimi i mallrave kontrabandë, neni 280 i Kodit Doganor, me nenin 178 nëKodin Penal, tjetërsimi dhe transportimi i mallrave që janë kontrabandë; apo nenet 261-268 të Kodit Doganor, deklarimi ndryshe në sasi, cilësi, etj, me mosdeklarimin e saktë, deklarimin e rremë për

⁵¹³ Në çështjen “Shteti kundër të gjykuarve I.N &..”, Kolegji Penal me vendimin nr. 56, datë 15.02.06, ka arsyetuar se Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. 64, datë 28.02.2005, ka prishur vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe ka pushuar çështjen penale në ngarkim të gjithë të pandehurve me arsyetimin, se Gjykata e Shkallës së Parë, në dhënien e vendimit ka zbatuar gabim ligjin material penal. Ajo e bazon vendimin e saj në një kod administrativ, ndërkohë që Kodi Penal parashikon dy figurat e veprave penale të kryera nga të pandehurit, në seksionin V të tij, ku përfshihen krimet në fushën e doganave. Përcaktimi që i bën kontrabandës ligjvënësi në nenin 276 e vijues të Kodit Doganor, ka të bëjë me kontrabandën si kundërvajtje administrative dhe jo si vepër penale. Po të pranohej e kundërta, kontrabanda nuk do të dënohej penalisht dhe dispozita e nenit 174 të Kodit Penal do të mbetej pa fuqi. Më shumë shiko: Vendimin nr. 56, datë 15.02.06 të Gjykatës së Lartë.

llojin, cilësinë e parashikuar në nenet 172- 178 të Kodit Penal), të cilat jo rrallë janë bërë objekt diskutimi teorik, keqkuptimesh, madje edhe në cilësimin ligjor të rasteve të kontrabandës nga praktika gjyqësore, me pasojë rëndimin e pozitës së shkelësit apo lehtësimin padrejtësisht të tij.

-Ka pasaktësira në terminologji, madje, në disa raste, formulime të paqarta, të cilat kanë çuar në keqinterpretime, veçanërisht në cilësimin e figurës së kontrabandës, në përllogaritjen e dëmit të shkaktuar gjatë shqyrtimit të padisë civile në procesin penal.

-Në ndonjë rast, edhe kufijtë ndarës të shkeljes doganore kundërvajtje nuk janë shumë të qarta me veprën penale të kontrabandës, duke vështirësuar deri në njëfarë mase organin e akuzës dhe gjykatën në klasifikimin e shkeljes doganore në kundërvajtje apo kontrabandë. (Nenet 261-271 të Kodit Doganor me nenet 172-177 të Kodit Penal).

Përkëtojmë se:

- Përkufizimi i kontrabandës mund të ishte më gjithëpërfshirës, pra jo vetëm në fushën ekonomike, por edhe në fusha të tjera jetike për shoqërinë, ndërkohë pasojat nuk duhet të shprehen në detyrimet doganore, pasi ato shtrihen në fushën fiskale (si detyrime import/eksporti dhe jo vetëm si detyrime doganore).
- Në Kodin Doganor duhet të jenë të përcaktuara të gjitha figurat e krimit të kontrabandës, përfshirë edhe sanksionet, duke mbajtur parasysh që ndarja të bëhet:
 - Sipas veprimeve dhe llojit të mallit, regjimit doganor.
 - Sipas rrezikshmërisë së vepra penale të kontrabandës së thjeshtë dhe në vepra penale të cilësuar të kontrabandës.

-Për kontrabandën e mallrave të ndaluara të ketë më shumë ndarje të veprave penale, duke përfshirë kontrabandën me mallra për luftën, për trafikim material për ndërtime të pajisjeve nukleare, mallra të tjera radioaktive, si dhe ato të karakterit të dyfishtë, apo për pastrimin e parave.

-Rishikimi i dispozitave të Kodit Penal dhe Kodit Doganor të bëhet njëherazi edhe duke mbajtur parasysh faktin se gjendemi përpara shkeljes në fushën doganore, përparësi të kenë dispozitat e Kodit Doganor.

-Në legjislacionin doganor të mëparshëm, si dhe në legjislacionin doganor të vendeve komunitare, figura e kontrabandës ndahet në të thjeshtë dhe të cilësuar. Kjo ndarje në figurat e veprës penale të kontrabandës mungon si në legjislacionin tonë penal, ashtu edhe në legjislacionin doganor, ndaj në projekt-kodin doganor, një ndryshim i tillë pa dyshim do të ishte një hap tjetër i rëndësishëm, pasi realisht ekzistojnë rrethanat cilësuese të veprës penale të kontrabandës, si kontrabanda e kryer si zakon, trafikim, me grup të organizuar apo të armatosur, me mallra specifike, si cigare, karburante, teknologji që mund të përdoret për armë të dëmtimit në masë, me mallra të karakterit të dyfishtë, etj.

-Në Kodin Doganor dhe në Kodin Penal, figurat e veçanta të veprës penale të kontrabandës janë “forma të veçanta të figurës së përgjithshme të kontrabandës, më saktë

variante të veçanta të saj, pasi objekti i përgjithshëm i të gjitha figurave të veçanta të krimit janë marrëdhëniet juridike të vendosura për funksionimin normal të doganave...”. Duke iu referuaredhe qëndrimittë mbajtur të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë⁵¹⁴, si dhe nisur nga fakti që ligji ynë penal dhe ligji doganor është një ligj i përafuar me atë të vendeve të BE-së, në Kodin Penal, dispozita e kontrabandës duhet të jetë hapur, si dhe të gjithë figurat e plota të veprës penale të kontrabandës të përfshihen në Kodin Doganor. Kjo është edhe praktika legislative e vendeve të BE-së⁵¹⁵.

Mendojmë se parashikimi në Kodin Doganor në nenin 281 të Kodit Doganor, si dënime administrative për veprën penale kontrabandë, pavarësisht nga dënimi penal, në pikëpamje formale të teknikës legislative mund të bëhet edhe objekt ndryshimi, por në përmbajtjen e saj nuk gjendet përpara dy dënimeve për një veprë të kryer.

Së pari, legjislatori në fushën penale ka parashikuar dispozita me dy dënime për një shkelje, edhe në raste të tjera, jo vetëm në fushën doganore (neni 298 i Kodit Penal).

Së dyti, legjislacioni ynë doganor është një ligj i përafuar me vendet e BE-së, ku dënimi me gjobë dhe dënimi me burg për rastet e kontrabandës jepen njëherazi për të njëjtën shkelje⁵¹⁶.

Në Kodin Penal, në nenin 177, “Figura e krimit të kontrabandës me regjim të ndërmjetëm” përcaktohet si importimi, eksportimi apo tranzitimi i mallrave, duke i paraqitur ato me regjim të ndërmjetëm, me qëllim shmangien nga detyrimet doganore, dënohet me gjobë ose me burgim deri në pesë vjet⁵¹⁷. Në fakt, kjo dispozitë është më tepër një reminiscence e Kodit Doganor të mëparshëm, ku ligjvënësi, në nenin 49 të Kodit Doganor të vitit 1992, ndryshuar në vitin 1996, kishte përcaktuar regjimet e ndërmjetme⁵¹⁸. Përmes kësaj dispozite, regjimi i ndërmjetëm konceptohej si mallra të cilat nuk paraqiteshin në zyrën doganore për konsum.

Meqenëse kjo është një normë referuese, për kuptimin e këtij regjimi, duhet t’i drejtohem dispozitave doganore, nënena 117-180 të Kodit Doganor. Në referim të këtyre dispozitave ligjore, kërkohet të mbahet parasysh se, ndërsa në Kodin Penal parashikohet

⁵¹⁴ Vendimi nr. 1, datë 26.03.2002 i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

⁵¹⁵ BERR C.-J, « Introduction au droit douanier », Economica, botimi i fundit, 2008.

⁵¹⁶ Në Kodin Doganor Francez në Art. 414 përcaktohet se : “...Dënohet me burg prej 5 vjetësh dhe me gjobë sa trefishi i vlerës së mallit objekt shmangie, kur kontrabanda ka të bëjë me mallra me përdorim të dyfishtë, civile e ushtarake, për qarkullimin e të cilave janë parashikuar kufizime në bazë të ligjeve apo konventave. Dënohet me 10 vjet dhe një gjobë sa pesëfishi i vlerës së përfutur, kur mallrat objekt kontrabande janë të dëmshëm për shëndetin, moralin sigurinë publike”.

⁵¹⁷ Neni 17 i Kodit Penal

⁵¹⁸ Kodi Doganor, botim i vitit 1992.

një dispozitë penale për regjimin e ndërmjetëm, për figurën e përgjithshme të krimit të kontrabandës në regjimet pezulluese, duhet të parashikohen disa figura të veçanta të krimit të kontrabandës, si forma specifike të figurës së kontrabandës me regjime pezulluese, variante të veçanta të saj. Megjithëqë, nëpikëpamjen teorike, por edhe në praktikëngjyqësore, mund tëpërbëjnëparagrafë të veçantë të sënjëjtëdispozitë penale, atë të krimeve tëkontrabandës në kushtet e regjimeve pezulluese.

Për arsyet e lartpërmendura, por dhe për faktin se në praktikën gjyqësore vihen re moskuptime të veçorive dhe karakteristikave tëveçanta që kanë krimet e kontrabandës nëregjimet e pezullimit, e shohim të arsyeshme të ndalemi veçmas për veprat penale, të cilat cenojnë regjimin juridik të mallrave në kushtet e vendosjes së tyre në një regjim pezullimi.

Duke mbajtur parasysh këta faktorë, nuk mund të mos arrijmë në përfundimin se lufta kundër krimit në fushën doganore përbënjë problematikë aktuale,për të cilën do të duhet shumë punë për t'ia arritur qëllimit përfundimtar, veçanërisht në kushtet e nivelit të lartë tëkontrabandës, kur kërkon intensifikimin e luftës ndaj tij.

Për këtë kuadër mendoj se është më se e domosdoshme që:

-Hartimi i dispozitave tëkontrabandëssëKodit tëRi Doganor t'i nënshtrohet diskutimeve dhe analizave të thella jo vetëm nga rrethet akademike, po edhe nga specialistë autoritarë, duke kërkuar gjithashtu edhe mendimin e specializuar të ekspertizës shkencore të katedrave universitare. Në këtë mënyrë, do tëndihmoheshinedhe politikbërësit qëtëjenë më tëinformuarmbipolitikatkundërkrimin të kontrabandës dhe, më pas, të kenë mundësinë të miratojnë një ligj doganor që t'i përgjigjet kohës dhe politikave penale në luftën kundër krimit në fushën doganore.

Bibliografi

I. KONVENTA

1. **Konventa e Kiotos**, *World Customs Organization 2002, Kyoto 2000, The International Convention on the Simplification and Harmonization of Customs procedures*, (Ligji Nr. 37/2012 për aderimin Republikes Shqipërisë ne Konventen ndërkombëtare “Për thjeshtimin dhe harmonizimin e procedurave doganore).
2. **Konventa për «Sistemin e harmonizuar të kodifikimit dhe përshkrimit të mallrave»**, (Ligji Nr. 35/2012, datë 29.03.2012 ‘Për aderimin e Republikës së Shqipërisë’).
3. **Konventa për «Krijimin e Këshillit të Kooperimit Doganor»**(Organizata Boterore e Doganave,Viti 1952).
4. **Konventa Ndërkombëtare Johannesburgut** për «Asistence të ndërsjellë administrative për parandalimin, hetimin dhe goditjen e shkeljeve doganore», Johannesburg 1950.
5. **Konventa TIR**, «*Transport International Routier*», e OKB-së, 1975.
6. **Konventa e Nairobi** për«Harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave», Nairobi, 1997.
7. **Konventa për «Sistemin e harmonizuar e kodifikimit dhe përshkrimit të mallrave»**.
8. **Konventa e Vienës** dt. 18.4.1961 për«Marrëdhëniet diplomatike», dhe ajo dt. 24.4.1963 për«Marrëdhëniet konsullore».
9. **Konventa** për «Ndalimin e zhvillimin, prodhimin, stokimin e armëve kimike dhe shkatërrimi i tyre», (Ratifikuar me Ligjin nr. 7747 date 29.07.1993).
10. **Konventa** për «Kontratën e transportit rrugor ndërkombëtar të mallrave, CMR», (Ligji Nr.9503, datë 26.3.2006 . ‘Për aderimin e Republikës së Shqipërisë’).
11. **Konventa** për «Harmonizimin e rregullave për kontrollin kufitar të mallrave», (Ligj nr. 8754, datë 26.3.2001, për aderimin e Republikës së Shqipërisë).
12. **Konventës ATA/Konventa e Stambollit**, 1990
13. Konventën “**Për Mbrojtjen e Interesave Financiare të Komunitetit Evropian**”, Botuar në Fletoren Zyrtare nr. C 316 , dt. 27.11.1995

II. MARRËVESHJE

1. **Marrëveshjen e Përgjithshme për Tarifat dhe Tregtinë**, Viti 1994, GATT (General Agreement on Tariffs and Trade, (sot Marrëveshja për OBT).
2. **Marrëveshja e OBT**,*Akti final i Raundit të Uruguajit dhe Marrëveshja e Marakeshit* që krijuan Organizatën Botërore të Tregëtisë, Dokumenti përfundimtar i Raundit të Uruguait (Botim i Shtëpisë Botuese PEGI).

3. **Marrëveshja e Stabilizim Asociimit** ndërmjet Komunitetit European e Shteteve të tij anëtare dhe Republikës së Shqipërisë. (Ligji Nr 10 datë 12/02/2009).
4. **Marrëveshja për Amendimin dhe Zgjerimin** e Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Europës Qendrore (CEFTA2006).
5. **Kumulimi Diagonal i origjinës ndërmjet Bashkimit European, Vendeve anëtare të Cefta-2006** të cilat zbatojnë MSA-në dhe Turqisë (Fletore Zyrtare e Unionit European C 154/13,14 date 31/05/2012) në zbatim të rregullave të origjinës së mallrave (2012/C 154/07).

III.KODE

1. **Kodi Penal** i Vitit 1952.
2. **Kodi Penal** i Vitit 1977.
3. **Kodi Penal** 1995, (Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995, me ndryshimet përkatëse).
4. **AZIBERT Gilbert** «*Kodi i Procedurës Penale 2013*», Edicioni i 25-të (i azhornuar në 13 shtator 2012), Paris, Lexis Nexis Litec, Koleksioni Kodet Blu Litec, për b Vol 1., Lib V, 2297 fq. (Republika Franceze).
5. **MAYAUD Yves, GAYET Carole**, «*Kodi penal 2013*» Edicioni i 110-të (i azhornuar në 5 shtator 2012), Paris, Dalloz, Koleksioni Kodet Dalloz, për b Vol 1, XXXIII, 3381 fq. (Republikës Franceze).
6. **Jean Pradel** “Procedura Penale”, Nr .501
7. **Kodi doganor i Mbreterise**, Botim i Vitit 1937.
8. Ligjin nr.2361 datë 16.11.1956 “Mbi Kodin e Doganave”.
9. Dekreti nr. 4748, datë 30.9.1970, “Mbi doganat”.
10. **Kodi Doganor i Republikës Shqipërisë 1992**, Ligji nr.7599, datë 2.09.1992, ndryshuar me ligjin nr.8020 datë 1.11.1995, ndryshuar me Dekretin nr.1578 datë 13.08.1996, “**Kodi Doganor i Republikës Shqipërisë**”.
11. **Kodi doganor 1999**, Ligji nr. 8449 datë 27.1.1999, “*Kodi Doganor i Republikës Shqipërisë*”.
12. Ligj nr. 102/2014, datë 31.7.2014**Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë**
13. **Kodi Doganor Komunitar**,Community Customs Code(CCC) - *Rregullorja* Nr.2913/92
14. **Kodi Doganori Unifikuar**,*Regulation (EU) No 952/2013 of the European Parliament and of the Council of 9 October 2013 laying down the Union Customs Code*
15. Rregulloren (CE) nr. 1889/2005 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit datë 26 tetor 2005 “**Mbi kontrollat e parave që hyjnë dhe dalin nga Komuniteti**”
16. **MORDANT de MASSIAC Briec de., SOULARD Christophe**« *Kodi i Doganave, kombëtar dhe komunitar 2011*» Edicioni i 7 (i azhornuar në 15 prill 2011), Paris Lexis Nexis Litec, Koleksioni Kodet Blu Litec, për b Vol 1., XXI, 1024 fq (Republika franceze).

17. **Code des douanes**, (*Kodi Doganor Francez*)Version 20120302
18. **Nuovo Codice Doganale d'Italia**.
19. **Kodi Doganor dhe i akcizave të Kosovës**.

IV. LIGJE

1. **Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë**
2. **Rregulloren Nr. 214/2007** të Komisionit të datës 28 shkurt 2007
3. **Ligji penal financiar Austriak**, versioni BGBI Nr. 1045/1994 .
4. **Ligji nr. 9707, datë 05.04.2007**, "Për kontrollin shtetëror të veprimtarisë së import-eksportit të mallrave ushtarake dhe mallrave e teknologjive me përdorim të dyfishtë";
5. **Ligji nr. 92, 19 mars 2001**, "Ndryshimet në rregullat në lidhje me goditjen e kontrabandës së produkteve të duhanit"
6. **Ligj Nr. 9754, Datë 14.6.2007** "Për Përgjegjësinë Penale të Personave Juridikë"
7. **Ligji nr. 61/2012** "Për akcizat në Republikën e Shqipërisë"
8. **Ligji nr. 9135 datë 11.09.2003** "Për Mbrojtjen Konsumatore"
9. **Ligji nr. 10081 datë 23.02.2009** "Për lincensat, autorizimet dhe lejet në RSH;
10. **Ligji nr. 10137 datë 11.05.2009** "Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet në RSH.
11. **Ligji nr. 9947 date 07.07.2008** "Për pronësinë industrial.
12. **Ligji Nr. 9461, datë 21.12.2005**"Për Nomeklaturën e Kombinuar të mallrave dhe tarifën e integruar doganore".
13. **Ligji Nr. 9715, datë 16.04.2007**Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9461, datë 21.12.2005 "Për Nomeklaturën e mallrave dhe tarifën doganore".
14. **Ligji Nr. 9982, datë 08.09.2008**Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9461, datë 21.12.2005 "Për Nomeklaturën e mallrave dhe tarifën doganore". Ligj Nr. 10098, datë 19.03.2009 "Për një ndryshim në Ligjin nr. 9981, datë 08.09.2008 "Për miratimin e niveleve të Tarifës Doganore", të ndryshuar.
15. **Ligji Nr. 10199 datë 17.12.2009**"Për ratifikimi e Protokollit 2 shtesë "Për përkufizimin e konceptit "Produkte të origjinës"
16. **Në ligjin nr. 9917, datë 19.5.2008** "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit"

V. VENDIME TË KESHILLIT TË MINISTRAVE (VKM)

1. **VKM NR. 205, DATË 13.4.1999** "Për Dispozitat Zbatuese... i ndryshuar".
2. **VKM NR. 43, date 16.01.2008**, "Për organizimin, funksionimin dhe statusin e Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve".

3. **VKM NR. 106, date 09.02.2011** “Për miratimin e listës së mallrave ushtarake dhe të listës së mallrave e teknologjisë”.
4. **VKM NR. 538 date 29.05.2009** “Për licencat...”.
5. **VKM Nr. 212, datë 08.07.1976** “Mbi sjelljen dhe dërgimin e sendeve dhe mbi tagrin doganor”

VI. UDHËZIME

1. **Udhëzim Nr. 11468 Prot., date 18.10.2007** “Mbi procedurat e mostrimit, transportimit, ruajtjes dhe administrimit të rezultateve të analizave laboratorike. Rregullore. Nr. 1089 Prot. date 14.02.2002 “Rregullorja e funksionimit laboratorit doganor Kimiko–merceologjik”.
2. **Udhëzim Nr. 2, date 14.02.2003** “Kushtet dhe procedurat për importimin e materialit mbjellës bimorë” (farave dhefidanëve).
3. **Udhëzim Nr. 1, datë 03.01.2003** “Për zbatimin praktik të procedurave të Trajtimit Tarifor Favorizues...”.
4. Udhërrëfyesi “Mbi rregullat e origjinës preferenciale të përdorura në tregëtinë ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve të tjera sipas Marrëveshjeve të Tregëtisë së Lirë”.
5. **Udhëzim Nr. 8327 Prot, datë 22.07.2007,** “Mbi çertifikatën e lëvizjes EUR 1, ne kuadrin e Marrëveshjes CEFTA”.
6. **Udhëzimin Nr. 25, date 30.11.2007** “Për procedurat e shqyrtimit të vlerës doganore”.
7. **Udhëzimi nr. 15, datë 16.02.2009,** i Ministrisë të Financave “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës për financimin e terrorizmit në sistemin doganor”

VII. BOTIME/LIBRA TË PËRGJITHSHËM DHE TË POSACËM

1. **Herbert L.A.Hart** “*The concept of law*” – 1961
2. **Ine Lejeuneb, Ruud Tusveld** ‘*Implementation of the Modernised Customs Code*’. ECT – 2012.
3. **Marco Polli-Schönborn** “*Contrabbando*”, published 10/11/2011
4. **Marek Nowicki,** “*Rreth Konventës Europiane*”, Botim i QSH DNJ – 2003.
5. “*Proposal for directive of European Parliament and of Council on the Union legal framework for customs infringements and sanctions*” – 2013
6. **BOULOC Bernard., MATSOPOULOU Haritini** “*E drejta penale e përgjithshme dhe procedura penale*”, Editori Sirey, Edicioni i 18-të – 2011.
7. **GASSIN R.,** “*Études du droit pénal douanier*” Annales de la Faculté de droit et sciences économiques d'Aix-en-Provence

8. **CORNU Gérard.**, « *Fjalor Juridik* », në bashkëpunim me **CAPITANT Henri**, edicioni i 3-të, , Editori PUF (Press Universitaire de France), Paris – 2002.
9. **BLACK’S LAW DICTIONARY** – 2000.
10. **Jenet Dine, Michael Blecher.** Ligji nr.9901 “*Për Tregëtarët dhe Shoqeritë Tregëtare*” Komentë – 2009.
11. **Charles G. Oakes, PhD**, Blue Ember Technologies, LLC.“*Safety & Security in Fire Protection Planning,*” The American Institute of Architects.
12. West's Encyclopedia of American Law, by **Jeffrey Lehman and Shirelle Phelps**, published in 2005.
13. Safety & Security Implementation of the Modernised Customs Code; **Mrs. Ine Lejeuneb Mr. Ruud Tusveld ect.** Stady– 2012.
14. Glossary of International Customs Terms – 2011.
15. Importing into the United States.Department of the Treasury United States Customs Service – 1991.
16. **Chris Parker**Internacinal Conference on Export Controls list 1997-2000.
17. **V.sul Punto C. De Vincedintis**, *Voce Contrabbando doganale in Novissimo Digesto italiano*, Vol.IV, p.430, Utet Torino – 1959.
18. Il nuovo Zingarelli minore, Milanostampa S.p.A. Farigliano (CN), Gennaio 2001.
19. Manuali “Masat për të përmirsuar eficiencën në pikat e kalimit kufitar”. Botim i Eurocustoms Secretariat.
20. Export of International Foreign Affairs and International Trade Canada Human Trafficking and Migrant Smuggling - International Crime and Terrorism.
21. **Francesco Pittaluga**, “Kontrabanda e mallrave dhe kontrabandimi i duhanit”.
22. **Hajdinjak, Marko** “*Smuggling in Southeast Europe*”, Center For The Study of Democracy, Sofia - 2002
23. **Bhagwati, J. and B. Hansen:** “A Theoretical Analysis of Smuggling”, *Quarterly Journal of Economics*, 1973, p.172.
24. Proposal of the European Commission of 9 November 2011 for a regulation of the European Parliament and the Council establishing an action programme for customs and taxation in the European Union for the period 2014-2020 (Fiscus) and repealing Decisions No. 1482/2007/EC and No. 624/2007/EC, COM(2011), 706 final.
25. Commission Staff Working Paper of 9 November 2011 on impact assessment – Accompanying the document proposal for a regulation of the European Parliament and the Council establishing an action programme for customs and taxation in the European Union for the period 2014-2020 (Fiscus) and repealing Decisions No.1482/2007/EC and No. 624/2007/EC, SEC(2011), 1317 final & 1318/3.
26. **BERR Claude - Jean**, “*Hyrje në të drejtën doganore*”, Editori Economica, Paris 2008

27. **BERR Claude - Jean, TREMEAU Henri**, “*E drejta doganore komunitare dhe kombëtare*”, Edicioni i 7-të, Editori Economica, Paris - 2006
28. **RIDEAU-VALENTINI Sébastien**, “*Kontribuimi për studimin e partikularizimeve në fushën penale doganore*”, Tezë Doktorature në Drejtësi, , Editori A.N.R.T (Atelier national de reproduction des thèses), Nice - 1999
29. **SOULARD Christophe** «*Guidë praktike për litigacionet doganore*”, Koleksioni Litec Profesinals, Editori Litec, Paris - 2008
30. **Sokol Sadushi** “E Drejta Administrative”, botim i vitit 2005.
31. **Shefqet Muci**. “E drejta penale, pjesa e përgjithshme” , botim i shtëpisë botuese Dudaj – 2007.
32. **Ismet Elezi** “E Drejta Penale”, pjesa e posaçme viti 2009.
33. **Ermir Dobiani**, “Kundërvatjet administrative ne Shqipëri ” Tirane 1998.
34. **Sherif Bundo** “Bazat e Finances”, viti 2010.
35. **Pr.Dr.I. Elezi, Pr.Dr. S. Kacupi; Prof.as.Dr.M. Haxhia** “Komentari i Kodit Penal” – 2012.
36. **Prof. Dr. Ismet Elezi** “Komentari i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë”, Tiranë 2009
37. **Arben Rakipi** “Korrupsioni dhe evazioni fiskal” – 2010.
38. **Dhimitër Lala** “Koment mbi Kodin e Procedurës Penale” – 2010.
39. **Dr.Av.Ersi Bozheku & Prof.Dr.Ismet Elezi**, “Përgjegjësia penale e personave juridik”, Botim Toena, 2012.
40. **Gentian Trenova** “Interpretime Gjyqësore të K.Pr.Penale” – 2008.
41. **Prof.Dr. Sh.Shabani, Dr.Alket Hyseni** “Ligji doganor dhe Praktik Gjyqësore”.. Botim i Shtëpisë botuese “Dita 2000” – 2007.
42. **Krime në Fushën e Doganave. Aspekte të Veprës Penale e Kontrabandës** Dr.Alket Hyseni & Prof.dr.Shamet Shabani, 2014
43. **J.Janao** “Historia e Doganave” – 2002.
44. **Teki Selenica** “Shqipëria në vitet 1927” – 1928.
45. **Henerik Ligori**: “Manual i Procedurës Penale për Policinë Gjyqësore”, botim i Shtypshkronjës “KOTTI”, viti 1999
46. “Lehtësimi i Procedurave Doganore ...”. (ACIT, 2004.)
47. “Explanatory Notes to the Harmonized Commodity Description end Coding Sistem”, Botim i OBT.
48. “Statuti di Scutari della prima meta del secolo XIV con le addizioni fino al 1469”
49. Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale, Strategjia e Mbrojtjes së Pronësisë Intelektuale nga Administrata Doganore”. Botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, 2013
50. Masat për të përmirësuar efincën në pikat e kalimit kufitar”. Botim i Euro customs Secretariat, si dhe “*Importing into the United States*”.1991

VIII. Raporte

1. **Raport i FONDAFIP** (Shoqata për Fondacionin Ndërkombëtar të Financave Publike), «*Kontratë apo ndëshkim: Sfida për Doganën e shekullit të XXI*», Paris, Qershor 2009.
2. Raportet e Interpolit mbi Trafikimin e Njerëzve “People Smuggling” <http://www.interpol.int/>.
3. **Regional effort against smuggling and counterfeit goods intensifies** By Aleksandar Pavlevski for Southeast European Times in Skopje - 25/01/13.
4. **“Report of International Foreign Affairs and International Trade Canada Human Trafficking and Migrant Smuggling** - “International Crime and Terrorism”.

IX. Revista dhe artikuj

1. **BERR. Claude-Jean**“*A janë sanksionet doganore në disproporcion*”; D. 1987, Kronikë, fq. 119.
2. **BERR C.-J.TREMEAU H.**“*Le droit douanier communautaire et national*”, Economica, Botimi i fundit, edicioni 6
3. **BOULOC Bernard**,“*E drejta komunitare dhe e drejta penale doganore*”, Problemet aktuale të shkencave kriminale, P.U.A.M. 1993, fq.9.
4. **BOULOC Bernard**, “*Kompetencat e punonjësve doganor*” Revista e Shkencore Krimi. 1996, fq. 143.
5. **BOULOC Bernard**, “*Interesi për mashtrim` në fushën doganore*”, RTD 1997.
6. **LETANG Jérôme** “*Denoncimi dhe ndershmëria e provave në të drejtën fiskale dhe doganore*” Gaz Pal, 1994, 1 doktr, fq 807.
7. Teksti “*Strategjia Doganore e Biznesit të Administratës Doganore Shqiptare*.”
8. Lehtësimi i Procedurave Doganore dhe i Marrëdhënieve të Biznesit me Administratën Doganore”, realizuar nga Qendra Shqiptare për Tregtinë Ndërkombëtare (ACIT), nëntor 2004
9. **M. Polli**, Zollpolitik und illegaler Handel, 1989
10. **A. Megevand Rakotobarison**, *La contrebande dans le Département du Léman* », 1798-1813, mem. lic. Ginevra, 1990.
11. “*Das Grenzwachtkorps 1894-1994*”, in Rivista delle dogane, 39, 1994, n. 2 (n. speciale).
12. **A. Ferrer**“*Les contrebandiers sur la frontière franco-suisse au XVIII siècle*”, in RSS, 49, 1999,
13. **M. Kuder**“*Sigarette, orologi e caffè: le esportazioni di contrabbando dalla Svizzera all'Italia dal 1945 al 1970*”,

14. **M. Delmas - Marty**, “Materia penale sipas GJEDNJ-së, mjegullimi i të drejtës penale”, Rev. shk. krim. 1987
15. World Trade Organization 2002, Trade facilitation: overview of trade facilitation work
16. **Jean Pradel**: “Procedura penale”, ed 12, Cujas, 2004
17. **CC Pond 1992**, The portcullis, Factsheet No. 12, Public Information Office, House of Commons, London
18. **S. Gallo**. “Kontrabanda doganore një vepër antike dhe ende aktive”, Revista della Guardi di Finanza nr.1-2001.
19. **T. Hayes**, “Can EDI eliminate Customs?”, 1993.
20. West's Encyclopedia of American Law, by **Jeffrey Lehman and Shirelle Phelps**, published in 2005.
21. **Steve Thompson: David Widdowson**. “Evolucion apo revolucion”. **Dott. Nicola Monfreda**. Zyra e Gurde De financa
22. **H. Ligorì**, Jeta Juridike nr. 1 Tirane, “Për kuptimin e tentativës në trafikimin e lëndëve narkotike dhe të armëve” – 2009.
23. “International Conference on Export Control”, të vitit 1997-2002

X. Mikro-Teze dhe Disertacione

1. “Aspekte juridike penale dhe kriminologjike të pastrimit të parave”, **Naim Mecalla - 2014**
2. **G.Cani**. Veprat penale në fushën e Kontrabandës : veshtrim i legjislacionit doganor dhe penal shqiptar (Probleme teorike dhe praktike).
3. **Shaban Kurpali**. “Kontrabandimi i mallrave me tarifa të larta doganore. Universiteti AAB Prishtine.
4. **Ledina Riza** “Trajtime teorike lidhur me veprat penale në fushën e tatimeve e doganave dhe problematikën e tyre” – 2008.

XI. VENDIME GJYQËSORE

Vendim GJEDNJ.

1. Çështja Nr. C-262/10 Dohler Neuenkirchen kundër Hauptzollamt Oldenburg
2. Çështja Nr. C-234/09 Skateministeriet kundër DSV Road A/S
3. Çështja Nr. 167 B.E.E kundër Drejtorisë së Doganave, Haskovo, BG;
4. Çështja x kundër Hollandës datë 16.03.1975;
5. Çështja Albert kundër Hollandës ;
6. Çështja Kreuz kundër Polonisë.

XI. B.Gjykata Kushtetuese:

1. Vendimi nr. 9 datë 2.04.2003.
2. Vendimin nr. 16, datë 25.07.2008.

XII. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese (FRANCE)

1. Gjykata Kushtetuese, dt. 22 shtator 2010, FZ 23 shtator 2010, fq. 17291.
2. Gjykata Kushtetuese, dt. 29 dhjetor 1983, vend nr 83-164.

Cështje në Gjykatën eShkallë I /Apel / Lartë.

1. *Vendimi i Gjykatës së Lartë 218 datës 29.04.2010 dhe datë 07.05.2010.*
2. *Vendimi i Gjykatës së Lartë nr, 272, datës 10.06.2010.*
3. *Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 256 datë 17.05.2011.*
4. *Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 1139 datë 12.10.2006.*
5. *Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 36 dt.19.02.2009.*
6. *Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 76 i datave 09.02.2012 dhe 16.02.2012.*
7. *Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 356 datë 06.07.2012.*
8. *Vendimi i Gjykatës së Lartë nr. 43 datë 16.01.2007.*
9. *Vendimi nr. 983 datë 25.09.2001; nr.470 datës 16.12.2001.*
10. *Vendimit Nr.1885 11.12.2003; nr.22 datë 28.03.2003;.*
11. *Vendimin nr.1738 datë.30.09.2004;nr. 1431 dt. 06.07.2004; Nr.527 dt. 27.04.2006; nr.1983 datë 25.11.2004; Nr. 1983 datë 25.11.2004, Nr.124 datë 27.01.04.; Nr.531 datës 03.11.2004.*
12. *Gjykata e Apelit vendimi nr. 1589, datë 10/31/2012; Vendimi Nr. 1667 datë 15.12.2005; Vendimi nr. 809 datë 20.06.2006; nr.1139 datë 12.10.2006; Nr.28 datë 12.01.06; nr. 12 datë 06.01.2006, nr.56 date 15.02.06. Vendimit Nr. 86 date 08.02.07. Vendimin Nr.432 i datës 21.11.2008.*
13. *Vendimi nr.36 datë 19.02.2009; nr. 602 datë 11.11.2009.Vendim nr. 272 datës 10.06.2010;nr. 2012, datë 03.11.2010; nr. 272 datës 10.06.2010; nr. 218 datë 29.04.2010; nr. 161 datë 21.12.2010; nr. 272 datë 10.06.2010, nr. 272 datë 10.06.2010; nr.272 datë 10.06.2010 nr.470 datës 16.12.2010. Vendimit nr. 344 datë 30.06.2011; nr.367 datë13.09.2011; nr.1 datë 11.1.2011, nr. 256 date 17.05.2011..*
14. *Vendimi nr. 1, datë 12.03.2002, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës Lartë
Vendimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, nr. 608, datë 26.09.2007 dhe
Vendimin nr. 372, datë 21.04.2010.*
15. *Vendimi unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nr.1 datë 26.03.2002)*
16. *Vendimi nr. 205, datë 07.01.2001 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë*

17. *Vendim (180) të datës 27.06.2012; Vendimin nr.588 datë 5.11.2003; Vendimi nr.598 datës 5.11.2003; Vendimi nr.190 datës 21.04.2004; Vendimi Nr.99 datës 18.03.2008; Vendimi Nr.455 datës 15.10.2008* **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë**
18. *Vendimi nr. 2904, datë 6.29.2009; Vendimit nr. 6508 datë 10/12/2012; Vendimit nr.2284 datë 05/22/2009; Vendimi nr. 1466, datë 4.3.2009; Vendimi nr. 4583, datë 11.17.2008; Vendimi, nr. 3024 data 6.3.2011; Vendimi nr. 1224, datë 29.5.2008,* **Gjykatae Shkallës së Parë**

Vendimet e Gjykatës së Kasacionit (FRANCE)

1. *Gjykata e Lartë, Sek Krim, dt. 28 janar 1992, Gazette du Palais, 1992, 1, fq 365.*
2. *Gjykata e Lartë, Sek Krim, dt. 13 prill 2005, Buletini Kriminal, nr 131.*
3. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 18 dhjetor 1989, Buletini krim, nr 485.*
4. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 18 prill 1988, Gazette du Palais, 1988. 2, fq 608.*
5. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 28 maj 1984, Bul, krim nr 192.*
6. *Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim. dt. 5 qershor 1950*
7. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 24 janar 1994, Bul, krim nr 32.*
8. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 14 nëntor 1996, Dr, penale 1997, koment., nr 49 .*
9. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 26 shkurt 1990, Bulk rim nr 93.*
10. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 20 shkurt 1990, Bul krim, nr 93.*
11. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 15 qershor 1987, Bul krim nr 249.*
12. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 4 dhjetor 1997, Bul krim, nr 416.*
13. *Gjykata e Lartë, Sek krim dt. 6 prill 1987, Bul krim, nr 156.*
14. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 5 shkurt 1998, Bul, krim nr 47.*
15. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 21 nëntor 1983, Bul krim nr 304.*
16. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 15 tetor 1984, Bul krim nr 298.*
17. *Gjykata e Lartë, Dhomat e bashkuara, dt. 15 dhjetor 1988, Bul krim nr 432.*
18. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 2 mars 1971.*
19. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 5 maj 1999, Bul, Krim nr 87.*
20. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 23 mars 2011, D. 2011.*
21. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 22 shkurt 2006, Bul krim nr 53.*
22. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 17 shtator 1991, Gaz. Pal 1992, 2, 585.*
23. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 2 mars 1996, Bul Krim nr 73.*
24. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 21 maj 1968, Bul krim nr 164.*
25. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 5 maj 1997, Bul Krim, nr 164.*
26. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 14 shkurt 1996, procedurat 1996, koment nr 232.*
27. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 6 mars 1989, Bul Krim nr 102.*
28. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 9 janar 2008 rekurs nr 07-82339.*
29. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 12 shkurt 1998, Bul krim nr 59.*
30. *Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 29 prill 1921.*
31. *Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim. dt. 20 dhjetor 1957*
32. *Gjykata e Lartë Franceze, Sek. Krim., datë 2 korrik 1932*

33. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 2 qershor 1986, Bul krim nr 185.
34. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 30 prill 1996, Bul Krim nr 182.
35. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 20 mars 1997, Procedura 1997, koment nr 215.
36. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 20 korrik 1988, Bul krim nr 305.
37. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 5 janar 1967, Bul krim, nr 9.
38. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 11 maj 1995, Bul krim, nr 173.
39. Gjykata e Lartë Franceze, Sek i krimeve, dt. 26 gusht 1996, Bul. Krim.,Nr.307
40. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 14 qershor 1993, Bul krim, nr 207.
41. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt.6 shkurt 1997, Bul krim, nr 52.
42. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt.11 maj 1992, Bul krim nr 182.
43. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt.27 mars 1997, Bul krim nr 126.
44. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt.11 qershor 2008, rekurs nr 07-83-400 i papublikuar.
45. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 4 korrik 1973, Bul krim nr 316.
46. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 13 maj 1991, Bul krim nr 199.
47. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 11 maj 1992, Bul krim nr 182 dhe Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 23 tetor 1997 Bul krim nr 349.
48. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 28 prill 1996, Bul krim nr 142.
49. Gjykata e Lartë, Sek krim, 5 janar 1967, Dalloz 1967 fq 393, Shënime J. Mazard.
50. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 7 tetor 2003, Bul krim nr 182.
51. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 3 qershor 1991, Dr penale1991 koment nr 260.
52. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 21 mars 1996, Bul Krim nr 128.
53. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 20 gusht 1996, Bul krim nr 307.
54. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 25 nëntor 1991, Bul krim nr 432.
55. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 14 janar 2004, i papublikuar.
56. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 13 dhjetor 1990, Bul krim nr 433.
57. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 7 prill 1992, Bull krim nr 145.
58. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 11 qershor 1949, Bul krim nr 208 dhe Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 2 tetor 1975, Bul krim nr 220 .
59. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 11 maj 1995, Bul krim nr 173.
60. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 6 maj 1971, Bul krim nr 139.
61. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 12 nëntor 1986, Bul krim nr 334.
62. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 14 shkurt 1983, Bul krim nr 51.
63. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 24 qershor 1948.
64. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 30 maj 1842.
65. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 3 tetor 1997, Bul krim nr 364.
66. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 25 tetor 1827 dhe Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 18 qershor 1958, Bul krim nr 472.
67. Gjykata e Lartë, Sek krim, dt. 29 nëntor 2000, Bul krim nr 356.

68. Gjykata e Lartë, 1 dhjetor 2010, resur nr 10-84.141 dhe Gjykata Lart, Sek krim, 15 dhjetor 2010, rekurs nr 10-80675, Drejta penale 2011, Koment nr 34, Obs J-H Robert.
69. Gjykata e Lartë, Sek krim, 10 janar 1973, Bul. krim nr 15.
70. Gjykata e Lartë, Sek krim, 22 shkurt 2006, jo i publikuar.
71. Gjykata e Lartë Franceze Sek. Krim, datë 22 qershor 1987, Bul. krim, nr. 257
72. Gjykata e Lartë Franceze, Cass. Crim., 7 mars 1996, kërkesë nr. 94-84553, Bull, crim. Nr. 108,

Vendimet e Këshillit të Shtetit FRANCE (Kasacioni administratif)

Këshillit të Shtetit, dt. 28 shkurt 1964, «Federata e importuesve të metalurgjisë dhe të mekanikës».

Vendime të Gjykatës së Konflikeve(FRANCE)

1. Gjykata e Konfliktit, dt. 28 maj 1970, fq 620, koment B. Castagnede.
2. Gjykata e Konfliktit, dt. 24 prill 1978.
3. Gjykata e Konfliktit, dt. 16 mars 1998, JPC 1998, IV, 3068, koment M-C Rouault.

XIV.WEB SITE (Faqe interneti) / Librari elektronike

1. www.dogana.al
2. <http://www.drejtesia.gov.al/>
3. <http://www.pp.gov.al/>
4. www.legifrance.gouv.fr
5. <http://www.legifrance.gouv.fr/affichCode.do?cidTexte=LEGITEXT000006071570&dateTexte=20130701> – Versioni i Korrikut 2013.
6. www.douane.gouv.fr
7. www.wisegeek.com.
8. <http://www.interpol.int/>
9. <http://www.douane.gouv.fr/page.asp?id=164>
10. <http://www.douane.gouv.fr/data/file/7756.pdf>
11. <http://www.douane.gouv.fr/data/file/7113.pdf>
12. <http://www.douane.gouv.fr/data/file/6589.pdf>
13. <http://www.douane.gouv.fr/page.asp?id=213>
14. <http://alize.finances.gouv.fr/organigrammes/dgddi/orgdgdidi.htm>
15. <http://www.douane.gouv.fr/data/file/4197.jpg>
16. <http://www.douane.gouv.fr/data/file/8135.pdf>
17. <http://definitions.uslegal.com/c/conditional-contraband/> (Faqja zyrtare e USLegal Program, përkufizime të termave ligjore për USLegal).
18. <http://www.treccani.it/vocabolario/contrabbando/>
19. "Northern Visions of Race and Reform"<http://historymatters.gmu.edu/>